




**LEXIME**  
**MBI EPOKËN**  
**PASNORMALE**



PËRGATITUR NGA **ZIAUDDIN SARDAR**





# LEXIME MBI EPOKËN PASNORMALE

*Lexime mbi epokën pasnormale* (Albanian)  
*Përgatitur nga Ziauddin Sardar*

Copyright © Center for Advanced Studies and the International Institute of Islamic Thought (IIIT), First Edition 1445AH / 2023CE

ISBN: 9789928195470 Paperback

Translated into Albanian from the English Title:  
*The Postnormal Times Reader*  
Edited by Ziauddin Sardar

Copyright © Centre for Postnormal Policy & Futures Studies, International Institute of Islamic Thought, Ziauddin Sardar and individual contributors, First Edition, 1439AH / 2018CE  
ISBN: 978-1-56564-991-0 Paperback

IIIT  
P.O. Box 669  
Herndon, VA 20172, USA  
www.iiit.org

MAHYA Yayıncılık  
Vatan Cad. No: 76 B2 Blok D.  
29 Fatih-İstanbul  
www.mahyayayincilik.com.tr

Center for Postnormal Policy and  
Future Studies  
www.cppfs.org;  
www.postnormaltim.es

PËRKTHIMI	Astrit Hykaj
KONSULENT SHKENCOR	Ramiz Zekaj
REDAKTIMI SHKENCOR	Ardian Muhaj
REDAKTIMI GJUHËSOR	Oriola Sula
KOORDINATORE	Anisa Hykaj
FAQOSJA DHE DIZAJNI	Suhejb Xhemali
BOTUES	Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam www.aiitc.net / contact@aiitc.net
SHTYPUR NGA	Shtypshkronja dhe Shtëpia Botuese “Mileniumi i Ri” Autostrada Tiranë-Durrës, km 26 Cel: +355 672063702 email: info@mileniumiri.al web: www.mileniumiri.al

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Në varësi të përjashtimit ligjor dhe dispozitave të marrëveshjeve përkatëse të licencimit kolektiv, nuk lejohet asnjë riprodhim i asnjë pjese, pa lejen me shkrim të botuesve.

Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë libër janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë medoemos edhe ato të botuesit. Botuesi nuk mban përgjegjësi për saktësinë e adresave të jashtme, ose të faqeve të internetit të palëve të treta, të cituara në këtë botim, dhe nuk garanton se përmbajtja e faqeve të tilla është ose do të vazhdojë të jetë e saktë ose e përshtatshme.

---

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Lexime mbi epokën pasnormale / përgat. Ziauddin Sardar ; përkth. Astrit Hykaj ; red. shkenc. Ardian Muhaj ; red. Oriola Sula. - Tiranë : AIIS, 2023.412 f. ; 24 cm Tit. origj.: The Postnormal Times Reader.  
ISBN 9789928195470

1.Shkenca politike 2.Shkenca shoqërore 3.Aspekte fetare  
321 .01(4/9) (082)  
3(4/9) (082)

---



# LEXIME MBI EPOKËN PASNORMALE

*Përgatitur nga Ziauddin Sardar*

*Përkthimi*  
Astrit Hykaj



Tiranë, 2023



Botimi i këtij libri u mbështet nga Instituti Ndërkombëtar i Mendimit Islam (IIIT) dhe Qendra për Studime të Avancuara (CNS).



## Përmbajtja

ÇFARË NDODHI?	7
---------------	---

*Ziauddin Sardar*

### ZANAFILLA DHE TEORIA

Shkenca për epokën e kohëve pasnormale	29
--	----



*Silvio O. Funtowicz i Jerome R. Ravetz*

Mirë se vini në kohët pasnormale	55
----------------------------------	----

*Ziauddin Sardar*

Rishikim mbi kohët pasnormale	83
-------------------------------	----

*Ziauddin Sardar*



### METODAT DHE PYETJET

Tri të nesërmet e kohëve pasnormale	123
-------------------------------------	-----

*Ziauddin Sardar dhe John Sweeney*

Lidhshmëria ngjitëse: sqarimi i tri të nesërmeve	153
---	-----

*John Sweeney*

Padituria, Pasiguria dhe 'Po sikur?'	177
--------------------------------------	-----

*Jerome Ravetz*

Rreziqet gjenden këtu: Hulumtimi i "Të panjohurës së të panjohurave"	187
---	-----

*Shirin Elahi*




## KOHA DHE HAPËSIRA

Artefaktet e kohëve pasnormale <i>Ziauddin Sardar</i>	205
Çudia e përbotshme <i>John Sweeney</i>	221
Lindja-Perëndimi në kohët pasnormale <i>Ziauddin Sardar</i>	231
Mosmarrëveshjet e Bashkimit Europian <i>Jordi Serra</i>	241
Kinemaja amerikane e kohëve pasnormale <i>C. Scott Jordan</i>	251
Qeverisja në kohët pasnormale <i>Jordi Serra</i>	265
Japonia e kohëve pasnormale <i>C. Scott Jordan</i>	277
Lindja e Mesme në kohët pasnormale <i>Ziauddin Sardar</i>	287

## JETA DHE VEPRAT

Loja e pushteteve fetare <i>C. Scott Jordan</i>	305
E ardhmja e Islamit në kohët pasnormale <i>Ziauddin Sardar</i>	323
Shkenca dhe shkencëtarët në kohët pasnormale <i>Jerry Ravetz</i>	365
Krijimtaria dhe udhëheqësia në kohët pasnormale <i>Alfonso Mantouri dhe Gabrielle Donnelly</i>	385
Bashkautorët	407
Mirënjohje	411





## Çfarë ndodhi?

*Ziauddin Sardar*

Ju, atje nga fundi, vëmendje! Li Gates ka diçka të rëndësishme për t'ju thënë. Për ata që nuk e njohin, ai është personazhi televiziv i filmit “Money Monster” (2016), i cili jep këshilla të pafundme financiare për dëgjuesit e zellshëm. Ja se çfarë ka për t'ju thënë: “Ju as që e keni idenë, se ku gjenden paratë tuaja. Një herë e një kohë, ju mund të hynit në bankë dhe të hapnit kasafortën tuaj, të zgjasnit dorën dhe të thoshit: - *Ja shufrat e mia prej ari.*

Jo më. Lekët tuaja, ajo gjë për të cilën ju bie bretku duke punuar, nuk janë gjë tjetër, veçse disa protone energjie që udhëtojnë nëpër një rrjet masiv kablosh me fibra optike. Pse e bëjmë? Ne e bëjmë që ato të udhëtojnë më shpejt, që paratë tuaja t'i keni sa më të shpejta, më të shpejta se të tjerëve. Por, nëse doni tregje më të shpejta dhe tregti më të shpejtë, fitime më të shpejta, gjithçka më shpejt, ndonjëherë do t'ju çahet goma”.

Një vëzhgim i arsyeshëm dhe në kohën e duhur ky. Vetëm nëse nuk është një gomë e përdorur, e shpuar aty-këtu, apo makina dhe vetë rruga janë tërësisht në gjendje të pandreqshme. Çarjet janë të shumta dhe duket se po ndodhin njëkohësisht me një rregullsi të frikshme. Në vitin 2016, ishim dëshmitarë të një sërë ngjarjesh të pashembullta. Lufta e vazhdueshme në Siri, Libi dhe Irak, që çuan në një gjëmë refugjatësh me përmasa të pashembullta. Të shtëna masive në Francë, Gjermani dhe SHBA, nga terroristë dhe ujqër të vetmuar. Një përpjekje për grusht shteti në Turqi. Që të dyja, Turqia dhe Franca, janë në gjendje të jashtëzakonshme prej muajsh. Politika gjithëpërfshirëse e krahut të majtë nxori Jeremy Corbyn si udhëheqës të Partisë Laburiste në Britani dhe Bernie Sanders si udhëheqësin e “neverisë politike” në SHBA. Apo politika gjithëpërfshirëse





e krahut të djathtë në Francë, Austri, Holandë, Poloni, Hungari, që mund të sjellë të djathtën e skajshme në pushtet në Europë. Virusi Zika. Hedhja poshtë e një marrëveshjeje paqeje historike në Kolumbi. Përshkallëzimi i fërkimeve midis Kinës dhe Japonisë në Detin e Kinës Jugore. Presidenti Rodrigo Duterte, i cili tha: - Vrasja e të varfërve që marrin para të shpejta nga shitja e drogës, është e nevojshme për të shkatërruar 'sistemin', në luftën e tij të etshme kundër drogës në Filipine. Hija dhe zbatimi i qëllimeve famëkeqe. *Brexit*. Çarjet në Bashkimin Europian. E, sigurisht, Donald Trump - Presidenti i 45-të i Shteteve të Bashkuara, i cili u zgjodh me mbështetjen e Alternativës së Djathtë (apo: *Alt-Reich*, siç thonë disa).

Nuk janë vetëm paratë që ecin kaq shpejt. Gjithçka po përshpejtohet. Siç vë në dukje Robert Colville në "*Përshpejtimi i Madh*", *prirjet, idetë dhe krizat e reja shfaqen sa hap e mbyll sytë, duke përshpejtuar zhvillimet në media, industri, politikë dhe shoqëri. Ideat e përcaktuara dhe aq të dashura mund të përmbysen brenda natës. Pikëpamjet dhe ngjarjet e posaçme të pazakonta mund të shtohen dhe të bëhen mbizotëruese. Fjala ndërkomëtare e vitit për fjalorin e gjuhës angleze të Oxfordit, për vitin 2016, është "e tejuverteta", e cila lidhet me rrethana ku të dhënat janë më pak ndikuese në formësimin e opinionit publik, sesa ç'janë thirrjet ndaj ndjenjave dhe besimeve të secilit.*<sup>2</sup> Duke u përpjekur të mos mposhtej nga kundërshtarët e vet, fjalori Merriam-Webster zgjodhi '*sureale*' si fjalën e vitit, pasi "bindshëm u përdor më shpesh nga përdoruesit në 2016, sesa në vitet e mëparshme, por edhe për shkak se kishte shumë raste në të cilat kjo fjalë ishte ajo që i shtynte njerëzit qartë drejt fjalorit që ata përdornin".<sup>3</sup>

**PAPRITMAS, TANI PO JETOJMË NË NJË SHOQËRI, KULTURË E BOTË TË TEJVËRTETËS, KU SHPIFJET JANË MË TË RËNDËSISHME SE FAKTET E VËRTETA, PIKËPAMJET E ARSYESHME, APO TË DHËNAT E PAKUNDËRSHTUESHME.**

Tradicionalisht, e kemi parë shkencën kryesisht si fushë të njohurive të vërteta, por tani provat shkencore mund të hidhen poshtë si të parëndësishme. E gjithë historia ku e pamë të vërtetën si vlerë parësore, është përmbysur.

1 Robert Colville, *The Great Acceleration*, Bloomsbury, Londër, 2016  
2 OED: <https://en.oxforddictionaries.com/word-of-the-year/wordof-the-year-2016>  
3 Fjala e Vitit 2016. [www.merriam-webster.com/wordsat-play/woty2016-top-looked-up-words-surreal](http://www.merriam-webster.com/wordsat-play/woty2016-top-looked-up-words-surreal).



Meqenëse e vërteta lidhet me lirinë: - *'Do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta do t'ju bëjë të lirë'*, - tha Krishti (Gjoni 8:32), ne tani e kemi gjetur lirinë në gënjeshtrë dhe duhet të përballemi me shkatërrimin e rregullimit që vjen së bashku me këtë thënie. Siç ka paralajmëruar Hanah Arendt, "nënshtetasi i përkryer i sundimit totalitar nuk është nazisti i bindur, apo komunisti i përkushtuar, por njerëzit për të cilët dallimi midis faktit dhe trillimit, të vërtetës dhe gënjeshtrës, nuk ekziston më".<sup>4</sup> Me sa duket, Europa e kishte hedhur fashizmin në koshin e plehrave të historisë. Njerëzit e qytetëruar nuk bëjnë fashizëm, megjithatë lëvizjet e skajit të djathtë po lulëzojnë në të gjithë Europën. Diçka nuk është në rregull me botën. Vërtet, ç'po ndodh?

Shumë akademikë, mendimtarë, shkrimtarë dhe vëzhgues janë përpjekur ta kuptojnë këtë për më shumë se një dekadë. Për shembull, sociologu i majtë britanik, i ndjeri Zygmunt Bauman, ka skicuar zhvillimet e çuditshme të kohës sonë në një seri librash - zakonisht me tituj të "lëngshëm". "*Ne po jetojmë në një epokë Kohësh të Lëngshme*<sup>5</sup>, *prodhim i Modernitetit të lëngshëm*<sup>6</sup>, *e cila ka prodhuar një gjendje të përhershme shtrëngese*<sup>7</sup>" - mendon ai. Në *Babel*<sup>8</sup>, që është një seri bisedash të hapura, gjatë një bisede midis Baumanit dhe gazetarit italian Ezio Mauro, dy mendimtarët theksojnë se kriza është e gjithëpërhapur dhe ka 'depërtuar' në 'gjithçka'. "Si një ushtri pushtuese në një mbretëri të fjetur", - thotë Mauro, "kriza, me lehtësi mahnitëse, marshon mbi të gjithë rrjetin material, institucional dhe intelektual të strukturave demokratike" perëndimore. Gjithçka që u krijua pas Luftës së Dytë Botërore, "qeveria, kuvendi, organet ndërmjetësuese, çështjet shoqërore, armiqësitë, shteti bamirës, partitë dhe lëvizjet kombëtare, ndërkombëtare dhe kontinentale"<sup>9</sup> janë në një gjendje krize të thellë. Për më tepër, ky rrjet i krizës sillet si një forcë e pavarur. "Është një forcë që pohon autonominë e saj, pa ndonjë teori të qartësuar për veten dhe veprimin e saj, pa një plan, por me një forcë veprimi, pasojat e së cilës janë dukshëm të dhimbshme" - thotë Mauro.<sup>10</sup>

Amory Lovins, fizikan amerikan, aktivist mjedisor dhe bashkëthemelues i Institutit *Rocky Mountain*, shpiku emërtesën '*çuditje globale*' për të përshkruar ndryshimet që po ndodhin në shkallë botërore.<sup>11</sup> Në librin e tij të fundit, "*Faleminderit që u vonuat*"<sup>12</sup>, komentuesi neoliberal amerikan,

4 Hannah Arendt, *Origins of Totalitarianism*, Meridian Books, New York, 1958, f. 474

5 Zygmunt Bauman, *Liquid Times*, Polity, Cambridge, 2007.

6 Zygmunt Bauman, *Liquid Modernity*, Polity, Cambridge, 2000

7 Zygmunt Bauman, *State of Crisis*, Polity, Cambridge, 2014.

8 Zygmunt Bauman dhe Ezio Mauro, *Babel*, Polity, Cambridge, 2016.

9 Po aty., f. 51.

10 Po aty., f. 6.

11 ed.ted.com/lessons/a-40-year-plan-for-energy-amory-lovins

12 Thomas Friedman, *Thank You for Being Late*, Allan Lane, Londër, 2016.



Tomas Friedman, thekson se gjithçka po ndryshon aq shpejt, sa ne thjesht nuk kemi kohë të mjaftueshme për të menduar, apo për t'u përshtatur me ndryshimin. Një mori 'përshpejtimesh' po ndërveprojnë me njëri-tjetrin për të prodhuar grupime të reja që po e bëjnë krizën botërore të paqëndrueshme. Regjisori britanik i filmave dokumentarë, Adam Curtis, mendon se ne jetojmë në një periudhë "Mbirregullimi" dhe po humbasim drejt një bote të rreme, ku është e pamundur ta shohim realitetin e jashtëm.<sup>13</sup> Gjeologët po shqyrtojnë mundësinë, se mos e kemi çuar veten në një epokë të re gjeologjike, *Antropocene*, ku veprimtaritë njerëzore kanë ndikim të rëndësishëm dhe mbarëbotëror në ekologjinë dhe gjeologjinë e tokës.<sup>14</sup> Ndryshimi i klimës, acidifikimi i oqeanëve, rritja e shkallës së zhdukjes së gjallesave janë vetëm tre shembuj, se si po e ndryshojmë Tokën. Fizikani i madh britanik, Stephen Hawking, dhe kolegu i tij astronom i Cambridge-it, Martin Rees, theksojnë se teknologjitë digjitale lejojnë grupe shumë të vogla njerëzish të nxjerrin shumë shpejt fitime të mëdha. Inteligjenca artificiale e ka fuqinë për të zhdukur një sërë punësh, duke përfshirë zanatet e krahut dhe të mendjes. Pra, pabarazia është vendosur të rritet më tej. Hawking shpreh: "Ne jemi në çastin më të rrezikshëm të zhvillimit të njerëzimit".<sup>15</sup> Rees beson se shekulli njëzet e një (XXI) mund të jetë *Shekulli ynë i fundit*.<sup>16</sup>

Tani, të gjithë këta zëra, nga e majta dhe e djathta e hapësirës politike, nga bashkësia e shkencës dhe kulturës, kanë të drejtë. Por fryma e kësaj periudhe nuk mund të përshkruhet nga asnjëra prej këtyre vlerësimeve të veçanta, vetjake. Përqasje të ndryshme, nga këndvështrime të ndryshme, përfundojnë duke përshkruar pjesë të ndryshme të trupit të elefantit, përmendur në fjalën e urtë. Për të pasur një fushëpamje më të madhe, për ta parë elefantin në tërësi, duhet të zmbrapsemi. Në thelb, ajo që thonë të gjithë, është se politika tradicionale nuk bën të mirën e mundshme për numrin më të madh të njerëzve.

## NE E KEMI HUMBUR, OSE PO E HUMBIM BESIMIN DHE SHPRESËN NË ATË QË KEMI PARË DERI TANI SI NORMË, DOK APO ZAKON.

13 Alan Curtis, 'HyperNormalisation', në BBC iPlayer.

14 'The Anthropocene epoch: scientists declare dawn of human-influenced age', *The Guardian*, 29 Gusht 2016.

15 Stephen Hawking, 'This is the most dangerous time for our planet', *The Guardian*, 1 Dhjetor 2016; në theguardian.com

16 Martin Rees, *Our Final Century: Will Civilization Survive the Twenty-First Century*, Arrow, Londër, 2004.



“Ka një largësi që rritet dita-ditës midis atyre që votojnë dhe atyre që vijnë në pushtet, përmes votave të tyre”, thotë Bauman.<sup>17</sup> Politika është kthyer në një vegël vetëm për elitën e pasur dhe duket se i shërben qëllimit të tyre. Demokracia është kthyer në qeverisje nga *paguesi më i lartë* dhe shpesh kthehet në sundim të shumicës. Ekonomia kapitaliste tradicionale vetëm i bën të pasurit më të pasur me një ritëm përshpejtues në rritje. Pasoja shumë e lavdëruar e përfitimit të shumicës nuk është materializuar kurrë. Edhe qëllimi më i dashur i të drejtave të njeriut, i përshkruar nga akademiku britanik i marrëdhënieve ndërkombëtare, Stephen Hopgood, si një mënyrë krishterimi laik që Perëndimi e ktheu fillimisht në rregullore mbarëbotërore, përmes fuqisë perandorake, dhe më pas si ligj ndërkombëtar në veprim<sup>18</sup>, duket se është duke mbërritur në fund të rrugës. Gjithnjë e më shumë, ato ligje po kundërshtohen nga shtetet në zhvillim e sipër, të cilat vënë në dyshim pretendimet e eprorit të deritanishëm mbizotërues të shteteve perëndimore.

Pra, është e natyrshme se, sido që të përcaktohet, ligji ndërkombëtar po avullon. Po ecim drejt asaj që unë e kam quajtur *'kohë pasnormale'*. Kjo *Përmbledhje* skicon zhvillimin e teorisë së kohëve pasnormale, bashkë me zanafillën e saj në shkencën e kohëve pasnormale, duke bashkuar disa punime dhe shkrime kyçe. Qëllimi im këtu, është të ofroj një përmbledhje të teorisë së kohëve pasnormale dhe të tregoj se si ngjarjet e fundit mund të kuptohen përmes këtij këndvështrimi.

Por, së pari, disa fjalë rreth *Përmbledhjes*. Ajo është ndërtuar në katër pjesë: *Zanafilla dhe Teoria, Metodat dhe Pyetjet, Koha dhe Hapësira, Jeta dhe Vepra. Zanafilla dhe Teoria* ofron një përzgjedhje të ngjeshur themelore mbi shkencën dhe kohët pasnormale. Punimi nga Silvio Funtowicz dhe Jerry Ravetz, i vitit 1993, *“Shkenca për Epokën Pasnormale”*, së pari përvijoi strukturën thelbësore të shkencës gjatë kohëve larg të qenit normale dhe ofroi një argument të bindshëm për demokratizimin e shkencës. Shkenca bëhet larg normales, argumentuan ata, kur “faktet janë të pasigurta, vlerat vihen në pikëpyetje, rreziqet janë të mëdha dhe vendimet e ngutshme”. Për herë të parë në këtë punim, u parashtrua pikëpamja e “bashkësisë së zgjeruar të kolegëve”. Ajo është një pararendëse e idesë së një punimi nga shumë autorë, i cili është përbërësi qendror i teorisë së kohëve pasnormale.

*“Mirë se erdhët në kohët pasnormale”* të Ziaudin Sardar, botuar në vitin 2010, parashtron bazat e kohëve pasnormale, si një kuadër teorik, për të kuptuar të tashmen dhe për të rritur aftësinë tonë për të përfytyruar të

17 Zygmunt Bauman dhe Ezio Mauro, vep. cit., f. 10.

18 Stephen Hopgood, *The Endtimes of Human Rights*, Cornell University Press, 2015.



ardhmen e mundshme. Është artikulli që përcaktoi për herë të parë strukturën thelbësore të kohëve pasnormale, ndërlikimet, çoroditjet dhe mospërputhjet. Sardar kthehet tek argumentet burimore në *“Rishqyrtimi i kohëve pasnormale”*, duke iu përgjigjur edhe zhurmës kritike që shkaktoi punimi i tij fillestar. Ai e plotëson pretendimin e tij për kohët pasnormale me shembuj shtesë dhe ofron një analizë largpamëse, se si zhvillimet e epokës sonë bashkëkohore mund të ndikojnë te brezat e ardhshëm.

Pjesa *Metodat dhe Pyetjet* jep një mori këndvështrimesh mbi qasjet për zgjerimin e shtrirjes së fushëpamjes së kohëve pasnormale, si një kuadër teorik për përdorimin e së ardhmes. Në artikullin *“Tri të Nesërmet e Kohëve Pasnormale”*, Sardar dhe John Sweeney përvijojnë qasjen që vë theksin te padituria dhe pasiguria për të hulumtuar dhe përvijuar të ardhme alternative, të zhvilluara nga Qendra për Politikën Pasnormale dhe Studimet e së Ardhmes (QPPSA). Punimi, gjithashtu, parashtron dhe sqaron *Përzgjedhjen e Mundësive Pasnormale*. Zbatueshmëria e metodës *Tri të Nesërmet*, ofrohet nga Sweeney në një hulumtim skenarësh të mundshëm për të ardhmen e internetit, në shkrimin e tij *“Ndërlidhja Ngjitëse”*. Ai i shtjellon dukuritë e mbindjeshmërisë elektromagnetike, si një çështje në zhvillim, që mund të na çojë drejt një të ardhmeje vërtet të pamenduar. Në punimin e tij të vitit 1997, *“Shkenca e hamendësimit”*, Ravetz arsyeton se kërkimi shkencor duhet të përfshijë një gjendje analize parashikuese drejt të ardhmes, të cilën ai e përmbledh në pyetjen: Po sikur? Pikërisht në këtë shkrim, Ravetz thekson rëndësinë e paditurisë dhe pasigurisë, të cilat janë bërë shtylla të analizës së kohëve pasnormale. Në *“Lufta bëhet këtu: Hulumtimi i së panjohurës së të panjohurave”*, Shrin Elahi angazhohet me shkencën e ‘largnormales’, çështjet e mbrapshta dhe mjellmat e zeza, për të prodhuar një arsytim bindës të mënyrave në të cilat pasiguria është nënvlerësuar brenda një shumëllojshmërie shembujsh të vyer, shkencorë dhe organizativë. Dy pjesët e mëposhtme, *Koha dhe Hapësira* si dhe *Jeta dhe Vepra*, trajtojnë një sërë çështjesh dhe institucionesh që përvijojnë të ardhmen e kohërave largnormale - nga ndryshimet klimatike, te qeverisja, Japonia, Bashkimi Europian dhe Lindja e Mesme, si dhe shkenca, feja, Islami dhe filmat. Punimi përfundimtar, me temën *“Krijimtaria dhe udhëheqja në kohët pasnormale”*, nga Alfonso Mantouri dhe Gabriell Donelli, del me përfundimin, se në epokën e ndryshimit të përshpejtuar, ndërlikimit dhe çoroditjes, kemi nevoja të ngutshme për ide të reja dhe mënyra thelbësore të të menduarit, që shkojnë deri te rrënjët e hamendësimeve dhe çështjeve tona.



## PËRSHPEJTUAR, GLOBALIZUAR DHE RRJETËZUAR

Pra, si ta kuptojmë natyrën e ndryshimit në këto kohë pasnormale? Duhet të pranojmë se jo gjithçka ka ndryshuar, por kanë ndryshuar shumë gjëra dhe gjëra të tjera po ndryshojnë. Kohët pasnormale përkufizohen më së miri, si “një periudhë pasnormale ku zakonet e vjetra po vdesin, të rejtat ende nuk kanë lindur dhe shumë pak gjëra duket se kanë kuptim”.<sup>19</sup> Ose, siç shprehet Ezio Mauro: “Ne po rrimë pezull midis “jo më” dhe “ende jo”, dhe kështu, detyrimisht jemi të paqëndrueshëm. Asgjë rreth nesh nuk është e qëndrueshme, madje as drejtimi ynë i udhëtimit”.<sup>20</sup> Për të kuptuar natyrën e ndryshimit bashkëkohor dhe se ku mund të na çojë ai, duhet të kuptojmë tiparin dhe zhvillimet e kohëve pasnormale.

Le t’ia fillojmë me disa vërejtje të dukshme: bota jonë është e globalizuar dhe rrjetëzuar, dhe kjo ka pasoja të caktuara. Në një botë të globalizuar, gjërat priren të kenë një shkallë dhe shtrirje mbarëbotërore. Një ngjarje vendore, si shfaqja e virusit Zika, apo një ngërç bankar në një vend të caktuar, shumë shpejt mund të marrë përmasa botërore dhe të depërtojë edhe në pjesët më të largëta të planetit. Ndërsa bota është e lidhur në rrjet, gjërat lëvizin me shpejtësi të shtuar. Pra, një ndotje lokale, shumë shpejt mund të bëhet një pandemi botërore. Njerëz të panjohur tani mund të vihen në qendër të vëmendjes ndërkombëtare, në mënyra të tilla, që për brezat e mëparshëm do të kishin qenë befasuese. Malala Yusufza u bë një ikonë botërore brenda vetëm pak muajsh: nga e sulmuar prej talebanëve, në tetor 2012, ajo u bë fituese e Çmimit Nobel për Paqen, në tetor 2014. Gjatë kësaj kohe, ajo mbajti një fjalim në OKB, botoi një jetëshkrim dhe udhëtoi në të gjithë botën, duke bërë fushatë për arsimimin e vajzave. Terry Jones, prifti i një kishe të vogël ekstremiste në jug të SHBA-së, paralajmëroi se do të digjte Kuranin dhe tërhoqi vëmendjen e Sekretarit Amerikan të Shtetit, i cili i kërkoi të përmbahej, për të mos vënë në rrezik jetën e ushtarakëve. Brenda disa ditësh, pasi lajmi mori dhenë, Jones tërhoqi vëmendjen që e lakmonte dëshpërimisht dhe trazirat u përhapën në shumë vende.

Përtej shpejtësisë, shkallës dhe shtrirjes, ka edhe njëkohshmëri. Ndërsa gjërat lëvizin me shpejtësi të madhe dhe fitojnë shkallë dhe shtrirje mbarëbotërore, ato gjithashtu priren të ndodhin njëkohësisht, një dukuri

19 Ziauddin Sardar, ‘Welcome to Postnormal Times’, *Futures*, 42 (5), f. 435–444 (2010).

20 Zygmunt Bauman dhe Ezio Mauro, vep. cit., f. 20.



fillimisht e vërejtur nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së në largim, Ban Ki-Mun. Në një fjalim të korrikut 2009, të mbajtur në Dublin, ai vërejt:

Ne po jetojmë një epokë si asnjë tjetër. Ka kriza të shumta: krizë ushqimore, krizë karburanti, krizë gripi dhe krizë financiare. Secila është një ngërç që nuk e kemi parë për shumë vite, madje edhe me breza. Por këtë herë, ngërçet po godasin botën përnjëherë. Ne nuk kemi parë kurrë, në asnjë epokë, që të jemi goditur nga të gjitha këto ngërçe të shumta në të njëjtën kohë”.<sup>21</sup>

**KJO NJËKOHSHMËRI ËSHTË NË THELB TIPAR I RRJETEVE TË NDËRLIDHURA, PRANDAJ DUHET TA SHIKOJMË BOTËN TONË: SI NJË SISTEM I NDËRLIDHUR RRJETESH, KU GJËRAT TURREN SHUMË SHPEJT, SHPESHHERË NË TË NJËJTËN KOHË, DHE MARRIN PËRMASA BOTËRORE.**

Kjo është ajo që ndodhi në Britaninë e Madhe, për shembull, me votën e daljes nga BE, gjë që çoi në zgjedhjen e Presidentit Trump dhe në votën “Jo” ndaj Referendumit në Itali. Të gjitha këto tani po çojnë në rritjen e votave të skajit të së djathtës ekstreme në Europë. Forcat e brendshme dhe të jashtme po ndryshojnë natyrën e shteteve kombëtare. Kjo lëvizje paraqet një ndryshim të prekshëm në qeverisje dhe flet për ndryshimin e zhvillimeve të jetës në kohët pasnormale, veçanërisht pasi, sipas Ministrit të Jashtëm të Danimarkës, “këto ndërmarrje janë bërë njëfarë *kombesh të reja* dhe ne duhet t’i përballojmë ato”.<sup>22</sup>

Për të dhënë një shembull tjetër të dukurive të njëkohshme, merrni parasysh, se si shumë luftëra po zhvillohen njëkohësisht sot. ‘Lufta e Ftohtë’ mes Rusisë dhe Perëndimit është kthyer në hakmarrje. “Luftërat me përfaqësi” midis Rusisë dhe Perëndimit, midis Arabisë Saudite dhe Iranit, u zhvilluan në fushëbetejat e Sirisë dhe Irakut. ‘Luftërat hibride’ ku shtetet përdorin sulme kibernetike dhe propagandë, zgjedhjet në vende të tjera mund të hakohen (vidhen) dhe zhvillimet politike mund të përmbysen. Vëreni, po ashtu, ‘Sulmet kibernetike’ ku shtetet, spiunët, kriminelët, terroristët, mashtruesit, hajdutët dhe keqbërësit përpiqen të vjedhin të dhëna, dhe / ose shkaktojnë dëme në shtete, ndërmarrje, banka, spitale e njerëz. Pa harruar ‘Betejat Twitter’ ku luftohen mes njëri-tjetrit

21 “United Nations peace missions in peril, says Ban Ki-moon”, *The Guardian*, 7 Korrik 2009.

22 In world first, Denmark to name a ‘digital ambassador’. Janar 27, 2017. [www.thelocal.dk/20170127/in-world-first-denmark-to-name-a-digitalambassador](http://www.thelocal.dk/20170127/in-world-first-denmark-to-name-a-digitalambassador)





me plot 140 shkronjat që mund të përdorësh. Jo vetëm që kemi lloje të reja luftërash për të luftuar, por e vjetra dhe e reja ndodhin njëkohësisht.

Përtej shkallës, shpejtësisë dhe njëkohshmërisë, kohët pasnormale kanë të tjera tipare të rëndësishme që ne i shprehim si treshe: ndërlikimi, mospërputhja dhe çoroditja. Sistemet e ndërlydhura, të ndërvarura, të kyçura në rrjet priren të ndërveprojnë në mënyra të shumta, duke ndjekur rregulla vendore të ndryshme. Me fjalë të tjera, ato priren të jenë të ndërlikuara. Në të vërtetë, pothuajse çdo gjë me të cilën duhet të merremi në ditët e sotme, është e ndërlikuar, domethënë e lidhur dhe e ngulitur në një mori gjërash të tjera të ndërvarura. Për të zgjidhur një hall, ne duhet të zgjidhim një varg çështjesh të tjera, të cilat ndërveprojnë me njëra-tjetrën në mënyra të shumta. Por jo të gjithë e ndajnë këtë pikëpamje.

Më 27 janar 2017, Presidenti Trump lëshoi një urdhër zbatimi që ndalonte të gjithë refugjatët për 120 ditë (shkelje e drejtpërdrejtë e Marrëveshjes së Gjenevës). Ky urdhër ia ndalonte hyrjen kujtdo nga Siria dhe gjashtë vende të tjera: Irani, Iraku, Sudani, Libia, Somalia dhe Jemeni. Ajo që duket qartë në lidhje me urdhrin (jokushtetues) e Trump-it, është se ai synonte tërheqjen e vëmendjes, një taktikë që synon shtangien dhe një zgjidhje “e thjeshtë” për një rrethanë të ndërlikuar. Megjithëse Trump-i bëri fushatë në një platformë që përfshinte ndalimin e plotë të hyrjes së myslimanëve në SHBA, ky propozim i zbutur, megjithëse po aq i tmerrshëm, duket se u krijua vetëm për të qetësuar bazën ekstremiste të Presidentit dhe flet për mënyrat me të cilat ndërlikimet keqkuptohen, ose ndoshta edhe më keq, përvetësohen për qëllime politike. Në një postim të gjatë dhe të shpërndarë gjerësisht në *Facebook*, Heather Richardson, Profesoreshë e historisë në Kolegjin e Bostonit, e quajti ndalimin e myslimanëve një “ngjarje tronditëse”, duke vënë në dukje, se dukuri të tilla “varen nga shpejtësia dhe çoroditja, sepse kërkojnë reagime gjithëpërfshirëse, por njerëzit ndahen sipas linjave të përcaktuara”.<sup>23</sup> Do të ishte marrëzi të nënvlerësohej kjo lloj dinakërie.

Nuk ka çështje të thjeshta apo përgjigje të thjeshta. Bota nuk është as njëpërmasore dhe as e parashikueshme. Kur qytetarët kërkojnë zgjidhje të shpejta, përgjigje të thjeshta për hallet e tyre të ndërvarura e të ndërlydhura, ne përballemi me një mospajtim. Asnjë politikan i pacenueshëm nuk mund të prodhojë plane të qarta, të thjeshta apo të japë përgjigje të lehta e të kup-tueshme. Ata as nuk janë të gatshëm të thonë: ‘është çështje e ndërlikuar,

23 [www.dallasnews.com/opinion/commentary/2017/01/31/americans-canturn-tables-steve-bannons-shock-event](http://www.dallasnews.com/opinion/commentary/2017/01/31/americans-canturn-tables-steve-bannons-shock-event)





nuk dimë çfarë të bëjmë! Pra, ata gënjejnë dhe votuesit priren të pëlqejnë politikanët me përgjigje të thjeshta, të sajuara, përgjigje larg të vërtetës. Siç tha dikur shkencëtari politik dhe parashikuesi amerikan, Jim Dator, “e ardhmja nuk vlen, sepse e ardhmja nuk voton”. Gjithnjë e më shumë, ne përballemi me sfida të ndërlikuara, me ndikim te shumë breza.

Le të marrim parasysh rastin e strukturës më të madhe të lëvizshme në botë: një kub çeliku që u vendos së fundmi mbi reaktorin bërthamor të dëmtuar në Çernobil. Pas dekada përpjekjesh të bashkërenduara, një ngërç i mëtejshëm u zbut, por zgjidhja nuk ishte e thjeshtë apo afatshkurtër. E njëjta gjë ka të ngjarë të jetë rasti në Fukushima që, në fakt, mund të përfundojë më keq. Pas pesë vjetësh, nivelet e rrezatimit mbetën aq të larta, sa që robotët e dërguar për të mbledhur të dhëna po vdesin me një ritëm rekord.<sup>24</sup> Ndërlikimi i gjendjes në Fukushima nuk mund të nënvlerësohet dhe, ashtu si me Çernobilin, sigurisht që do të ketë pasoja për shumë breza. Brezat e ardhshëm nuk do të kenë zgjidhje tjetër, veçse të merren me këtë moçal. Ne e kemi kolonizuar të ardhmen e tyre, tashmë të ndërlikuar, dhe i kemi lënë trashëgim një mori ngatërresash.

Ky ndërlikim shtohet nga mospajtimet që gjenden gjithandej rreth nesh, të shprehura si pabarazi shoqërore, kërkesa të papajtueshme dhe përplasje të drejtpërdrejta midis interesave të panumërta konkurruese dhe bashkësive të ndryshme me pikëpamjet, ideologjitë, planet dhe dëshirat e tyre, duke e tërhequr shoqërinë në drejtime të shumta. Në një botë të ndërlikuar, të lidhur në rrjet, përplasjet janë prodhim i natyrshëm i rrjeteve të shumta kundërshtish shoqërore dhe kulturore që luftojnë për mbizotërim. Mospërputhjet janë gjithashtu, pasojë e faktit se çdo politikë ka një çmim dhe ndikon për keq në diçka ose dikë.

## DIÇKA E ÇUDITSHME PO NDODH...

Mospërputhjet e qenësishme të kohëve pasnormale janë kapur mirë nga një thënie që i kushtohet njohësit të marketingut Tom Goodwin, që qar-kulloi në Facebook gjatë majit 2016:

24 [www.independent.co.uk/news/world/robots-fukushima-nuclear-disaster-dying-probecle-anuptepcotoshibareactornuclearradiationa7612396.html?cmpid=facebook-post](http://www.independent.co.uk/news/world/robots-fukushima-nuclear-disaster-dying-probecle-anuptepcotoshibareactornuclearradiationa7612396.html?cmpid=facebook-post)



**UBER, KOMPANIA MË E MADHE E TAKSIVE NË BOTË, NUK ZOTËRON ASNJË AUTOMJET. PRONARI I FACEBOOK, MEDIA MË POPULLORE NË BOTË, NUK KRIJON PËRMBAJTJE. ALIBABA, SHITËSI MË I VLERËSUAR, NUK KA INVENTAR. DHE AIRBNB, OFRUESI MË I MADH I SHTRETËRVE NË BOTË, NUK ZOTËRON ASNJË PASURI TË PATUNDSHME. DIÇKA E ÇUDITSHME PO NDODH.**

Kur këto mospërputhje të dukshme dhe të ndërlikuara bashkohen, përfundimi i përbashkët është çoroditja. Një botë e ndërlikuar, e kyçur në rrjet, e mospërputhjeve dhe e ndryshimeve të përshpejtuara është e hapur ndaj kundërveprimeve për mirë, ku gjërat mund të shumohen me shpejtësi dhe, në mënyrë të rrezikshme, në progresion gjeometrik mund të kthehen në rrëmujë. Edhe gjërat e vogla, të parëndësishme, mund të shkaktojnë trazira dhe të çojnë në ndryshime të mëdha me shpejtësi të madhe në shkallë botërore. Një *tweet* i vetëm, një 'hakerim' kompjuteri, një grevë, një dorëheqje e vetme mund të shkaktojë një kundërveprim zinxhir me pasoja të paparashikuara. Pra, për të kuptuar se çfarë ka ndodhur dhe çfarë mund të ndodhë më pas, duhet t'i shohim gjërat brenda kornizës së kohëve pasnormale. Katër pjesët dhe treshja e lartpërmendur sillen si forca të pavarura, autonome, të cilat mund të shkaktohen dhe gjallërohen nga çdo shqetësim i vogël. Rreziku që gjërat të shumohen me shpejtësi në progresion gjeometrik është gjithnjë i pranishëm. Kur shfaqen ngërçet, ato shpesh shfaqen njëkohësisht dhe grumbull. Rrjetet ndërlidhëse të ndërlikuara prodhojnë vlerësime për mirë, por që mund të prodhojnë ngjarje çoroditëse, si dalja e Britanisë së Madhe nga BE dhe, siç e quajti gazeta *New Statesman*, "Tmerri Trump".<sup>25</sup>

Nga një këndvështrim larg së qeni normal, populizmi nuk ka asgjë për t'u habitur. Ai është prodhim i një sërë prirjesh dhe dukurish kundërshtuese dhe të ndërlikuara, të maturuara ndër vite, të cilat, falë teknologjive të reja, janë ndërlidhur dhe janë shfaqur njëkohësisht. Zemërimi dhe pakënaqësia janë shkaktuar nga pabarazia në rritje. Për shembull, përforcimi i etikës shkatërruese, si nga tregu, ashtu edhe nga media, në lëminë e gjerë të shfaqjeve të vërtetësisë jetësore në televizion, që i bëjnë jehonë pamëshirshmërisë, lakmisë dhe veljes lakuriq. Paaftësia e sistemeve politike për të ofruar mjete me të cilat t'u drejtohen ankesave të pakicave, qofshin afrikano-amerikanët në SHBA, apo aborigjenët në Australi, ose shiitët në Irak, është gjerësisht e dukshme. Të gjitha këto prirje kanë nxi-



tur një ndjenjë tjetërsimi dhe vetmie. Tani, natyrisht, ndryshimet demografike kanë krijuar një pakicë të re: punëtorët pa të drejta dhe të mënjanuar, si dhe të bardhët e klasës së mesme në SHBA dhe Europë, njerëz që në mënyrë tradicionale kanë pasur përparësi dhe nuk janë mësuar ta shohin veten në fund të zinxhirit ushqimor.

Pastaj, janë rrjetet shoqërore të cilat, si shumë të tjera, gjatë kohëve pasnormale, kanë një mospërputhje të qenësishme: lidhin dhe shkëputin njëkohësisht. Ju e rrethoni veten me ata që ndajnë pikëpamjet tuaja dhe e shkëputni veten nga ata që nuk pajtohen me ju. Kështu forcohen ndarjet. Si populizmi i majtë, i llojit Bernie Sanders dhe Jeremy Corbyn, ashtu edhe populizmi i krahut të djathtë, i tipit Trump dhe Le Pen, janë prodhim i mënjanimit dhe i zhgënjimit të skajshëm që, nga ana tjetër, janë pasojë e moskujdesit, se fituesi politik merr gjithçka. Pamëshirshmëria e një 'vëllai të madh' dhe kultura e mbështetur në njerëz "të famshëm", apo teknologjia e rrjeteve shoqërore ua mundëson njerëzve të krijojnë lidhje të ndërlikuara që mund të prodhojnë me shpejtësi ngjarje çoroditëse. *Brexit* shërbeu si shkas për të nxitur këto forca dhe për t'i shtyrë drejt rrëmujës.

Pothuajse e njëjta gjë mund të thuhet për forcat që na kanë shtyrë drejt një shoqërie të tejvërtetës. Në fund të fundit, ky ishte qëllimi i pasmodernizmit, i cili na sugjeroi se "rrëfimet e mëdha janë të pakuptimta", se të gjitha të vërtetat, pavarësisht nga burimi i tyre, janë vetëm përafërsisht dhe, si të tilla, po aq të këqija sa njëra-tjetra.<sup>26</sup> Për tridhjetë e ca vitet e fundit, kjo ideologji ka ushqyer akademinë, arkitekturën, kinemanë, televizionin, madje edhe qendrat tregtare. Një brez i tërë është rritur me këtë besim të ngulitur në mendje. Politikanët, të paaftë për të përballuar ndërlikimet dhe pasigurinë, kanë qenë vazhdimisht të kursyer me të vërtetën. Ndërmarrjet dhe grupet ndikuese kanë paguar për të prodhuar padituri, mohuesit e klimës dhe ndikuesit pro duhanpirjes ishin maja fillestare e dukshme e këtij ajsbergu. Skaji i djathtë dhe islamofobët kanë përhapur gënjeshtër dhe mashtrime prej vitesh. Teknologjitë e reja të ndërlidhjes kanë mundësuar që të gjitha këto prirje të bashkohen në një fuqi botërore dhe të shndërrohen në një rrjet të ndërlikuar. Trump shërbeu si një përshpejtues që u mundësoi këtyre rrjeteve të dilnin në shesh.

Kohët pasnormale kanë minuar marrëveshjet rreth faktit se si duhet të vihet në punë shoqëria. Hamendësimet që shërbyen si themeli i rendit botëror gjithashtu kanë avulluar. E gjejmë veten ballë për ballë me vërtetësi

26 Ziauddin Sardar, *Postmodernism and the Other*, Pluto Press, Londër, 1998.



jetësore të reja dhe në zhvillim, që ende nuk i kemi kuptuar. Për të pasur sadopak shpresë, që të lundrojmë në rrugën tonë drejt daljes nga lëkundjet e së tejvërtetës, duhet të fillojmë ta pranojmë se ku ndodhemi në këtë pikë të veçantë të historisë.

## NË BOTËN PASNORMALE TË SAPOSHFAQUR, PUSHTETI KA PËRPARUAR, TJETËRSUAR, SHTERUAR DHE ZHVENDOSUR NGA PERËNDIMI NË LINDJE DHE KUDO NDËRMJET TYRE.

Kemi kaluar nga një botë njëpolare, në një botë shumëpolare me superfuqitë që hahen në mosmarrëveshje me njëra-tjetrën. Përmbysja digjitale po krijon mundësi të reja për vendet në zhvillim, për të përforcuar zotërimet e tyre të pushtetit.<sup>27</sup> Janë shfaqur aktorë të rinj joshtetërorë që vihen në punë si rrjete me ndikim të jashtëzakonshëm. Vetmitarët, me aftësinë për të nisur kundërveprime virale, me dashje ose pa dashje, kanë fuqi të jashtëzakonshme çoroditëse. Kërcënimet kibernetike nga shtetet, aktorët joshtetërorë, rrjetet e kodthyesve dhe kriminelëve minojnë të gjitha burimet e pushtetit. Rusia dyshohet se ka ndërhyrë në zgjedhje, jo vetëm në SHBA, por edhe në Gjeorgji e Ukrainë. Në qershor 2016, një kodthyes kolumbian shumë i stërholluar ndryshoi zgjedhjet në tetë vende të Amerikës Latine, në përkrahje të kandidatëve të krahut të djathtë.<sup>28</sup> Shtetet e tjera do të ndiqnin të njëjtin shembull. Ndryshimet në pushtet si dhe burimet e reja të pushtetit jo vetëm që kanë rritur ndërlikimin dhe natyrën mospajtuese të gjeopolitikës, por, gjithashtu, kanë prodhuar një mori pasigurish. Rrallëherë ka një marrëdhënie të drejtpërdrejtë shkak-pasojë ndërmjet një vendimi ose veprimit dhe pasojave të tij. Nëse i hidhni benzinë një zemërimi politik në botën pasnormale, ka të ngjarë të digjni veten, po aq sa edhe qëllimin tuaj të synuar.

Si pasojë e zhvendosjes së fuqisë botërore, epërsia morale e hamendësuar e kulturës perëndimore ka avulluar.<sup>29</sup> Kur Ghandi këshilloi se “qytetërimi perëndimor është një ide e mirë”, ai po vinte në dukje, se ana qytetare e qytetërimit perëndimor është vetëm sipërfaqësore. Kapardisja shumë e lavdëruar, se Europa nuk mund të kthehet kurrë në të kaluarën e saj fashiste, nuk është më e vlefshme. Ngritja e së djathtës ekstreme në

27 Taylor Owen, *Disruptive Power: The Crisis of State in the Digital Age*, OUP, 2015.

28 Jess Staufenberg, 'Political cyberhacker Andrés Sepúlveda reveals how he digitally rigged elections across Latin America', *The Independent*, 2 Prill 2016.

29 Pankaj Mishra, *The Age of Anger*, Allan Lane, Londër, 2017.



Europë është tashmë një pririje e qartë. E kemi parë tashmë rolin e luajtur nga skaji-djathtas në zgjedhjen e Donald Trump. Partitë e skajit të djathtë në vende të tjera europiane, si Austri, Holandë, Hungari, Poloni, Norvegji, Gjermani, janë rrënjësor thellë dhe po fitojnë hapësirë. Presidentja Le Pen e Frontit Nacional fashist është një mundësi në Francë. Në kohët pasnormale, Europa mund të kthehet në të kaluarën e saj të afërt fashiste me shpejtësi mahnitëse në shkallë krahinore dhe, në të njëjtën kohë, pjesa më e madhe e infrastrukturës ndërkombëtare të pasluftës, që nga Banka Botërore, te Marrëveshja e të Drejtave të Njeriut, e mbështetur në kulturën dhe moralin perëndimor, do të vihet në pikëpyetje dhe rishqyrtim gjithnjë e më shumë. Në kohët pasnormale, të gjitha kulturat njerëzore kanë humbur drejtimin e tyre dhe çdo pikëpamje shoqërore, kulturore, politike, filozofike e fetare e njohur për njerëzimin duhet të rimësojë se si të përfshihet në parimet e veta morale dhe etike.

Hamendësimi se kapitalizmi, siç është sot, mund të përpunohet ose ndryshohet për t'i bërë jehonë barazisë, siç thekson sociologu gjerman, Wolfgang Streeck, është një 'ëndërr utopike'. Tashmë është e qartë se kapitalizmi, ashtu si dhe komunizmi, përmban farat e vetë shkatërrimit. Çështja nuk është se tregjet janë të këqija, ose krijimi i pasurisë apo prona vetjake janë gjë e keqe. Çështja është se në formën e tij të tanishme të pakufizuar, kapitalizmi është krijuar në thelb për të rritur pabarazinë me ritme në rritje. Në fillim të dhjetëvjeçarit, Oxfam vlerësoi se 388 njerëzit më të pasur në botë zotëronin të njëjtën pasuri, sa 50% e të varfëve. Në vitin 2014, ky numër ra në 80 personat më të pasur. Një vit më vonë, ai zbriti më tej, në 62 persona. Në vitin 2016, vetëm tetë njerëz në planet zotërojnë aq pasuri, sa gjysma e varfër e popullsisë (3.5 miliardë njerëz). Për më tepër, bota ka ndryshuar rreptësisht, me qëllim që kapitalizmi tradicional rregullisht të vihet në jetë. Mervin King, ish-gubernatori i Bankës së Anglisë, thekson në librin e tij, *Fundi i Alkimit*<sup>30</sup>, se ne nuk jetojmë më në një botë ku rreziqet mund të përcaktohen saktësisht. Në vend të kësaj, ne jemi në një gjendje 'pasigurie rrënjësore'. Ka shumë të panjohura për t'u përballur me peshën e rrezikut të kapitalit. Kështu, kapitalizmi e ka kaluar datën e "skadencës". Më në fund, do të vdesë. Por, siç shtrohet pyetja edhe në librin e Streeck, *Si do të marrë fund kapitalizmi*<sup>31</sup>, përgjigja është: pa zhurmë. Përpara se kapitalizmi të zhduket, ai do të ecejaket për një të ardhme të parashikueshme, në harresë, në dremitje. Edhe pasi të ketë vdekur, trupi i tij i kalbur do të qelbë ajrin për breza të tërë. Shteti kombëtar është kapur në kurthin e mospërputhjes, është bërë

30 Mervyn King, *The End of Alchemy: Money, Banking and the Future of Global Economy*, Little Brown, Londër, 2016.

31 Wolfgang Streeck, *How Will Capitalism End*, Verson Books, Londër, 2016.



shumë i ndërlikuar për t'u qeverisur në mënyrë të mjaftueshme, pa mundur ta përballojë ndërlikimin e një bote të ndërvarur. Ai ka humbur aftësinë për të mbrojtur lirinë dhe barazinë e të gjithë qytetarëve të vet. Ngrehinat e veta institucionale nuk janë në gjendje të përballojnë kërkesat e papajtueshme të qytetarëve gjithnjë e më të ndryshëm. Një shqetësim i vogël, një shpërfaqje kundër pabarazisë ekonomike, një tubim kundër politikave jopopullore të qeverisë mund të çojë në pasoja të mëdha çoroditëse të paqëllimta, që mund të shpërbëjnë shtetin. Siç mund ta shohim në *You Tube*, shkëndija të tilla shkaktuan shqetësim të thella në Venezuelë, në Egjipt dhe Ukrainë. Dëshmuam se sa shpejt Greqia u gjunjëzua dhe u shndërrua në një shtet të 'Botës së Tretë' brenda Europës. Disa shtete thjesht nuk mund të veprojnë fare si shtete – Iraku dhe Siria janë shembull i qartë. Kudo, shteti po afrohet gjithnjë e më shumë drejt skajit të çoroditjes. Populizmi nënvizon zhgënjimin me shtetin bashkëkohor dhe paaftësinë e tij për të përballuar kohët pasnormale.

Në kohët pasnormale, ajo që është teknikisht e mundur, do të përmbushet dhe kthehet në realitet, pavarësisht nëse është apo jo vërtet e nevojshme, e ligjshme apo e moralshme. Teknologjitë e reja shiten gjithmonë për arsye përfitimi. Por në kohët pasnormale, të gjitha teknologjitë kanë një anë edhe më të errët që nuk mund të nënvlerësohet. Merrni, për shembull, dy prirje në zhvillim: armatimin e kodimit dhe ADN-së. Ndërveprimi i disa teknologjive, si rrjetet shoqërore, ruajtja me shumicë e të dhënave përmes resë kompjuterike, apo inteligjenca artificiale, do të gjallërojnë mundësi të reja në përvijimin dhe përqendrimin në bashkësi të përcaktuara njerëzish. Përparimet në atë që quhet Sistemi i Armëve të Pavarura Vdekjeprurëse (shkurt SAPV), një sistem ky i aftë për të zbuluar dhe përzgjedhur një shënjestër, bazuar në përvijimin racor, sjelljen dhe tiparet e tjera njerëzore, rrisin mundësinë e zhvillimit të robotëve vrasarë, të krijuar posaçërisht për të shënjuar grupe të caktuara.

Jo të gjitha zhvillimet e tilla mund të ishin të qëllimshme; disa prej tyre janë pasojë e valës së dytë të përparimeve të pafajshme teknike. Le të marrim parasysh, për shembull, fatin e *Tay-it*, programi kompjuterik i ndërtuar që të flasë si një vajzë adoleshente, me qëllim që të përmirësojë shërbimin e blerësve të Microsoft-it. Mirëpo, brenda pak orëve nga publikimi në *Tweeter*, *Tay* u shndërrua në një qenie fashiste që cicëronte me kënaqësi "Heil Hitler".<sup>32</sup> Ndërveprimi njerëzor mund t'i japë një rrotullim krejtësisht të ri një teknologjie në zhvillim. Diçka e ngjashme mund të ndodhë me tjetërsimin e ADN-së, e paguar nga investitorë të rëndësishëm, si *Fondacioni Bill & Melinda Gates*,

32 Helena Horton, 'Microsoft deletes 'teen girl' ai after it became a Hitler-loving sex robot within 24 hours', *The Telegraph*, 24 Mars 2016.



*Google Ventures* dhe *Du Pont*, i stisur si një ilaç për zvogëlimin e vuajtjeve të njerëzimit. Hëpërhë, përdorimet e tij kryesore janë të kufizuara në inxhinierinë gjenetike, modelimin e sëmundjeve dhe biomjekësinë. Por pasojat përfundimtare për shoqëritë njerëzore mund të jenë të mëdha, pasi mund të çojnë lehtësisht në foshnja të ndërtuara gjenetikiisht (diçka që po ndodh tashmë në Indi), duke rritur mundësinë fizike ose mendore të njerëzve të caktuar dhe mënyra të tjera të përzgjedhjes së racës njerëzore. Një dëshirë e tepruar për pastërtinë racore mund të kthehet lehtësisht në një dëshirë të tillë për gjenetikën, siç na mëson historia. Mund të përdoret gjithashtu, për t'u përfshirë në luftë gjenetike kundër disa grupeve, si myslimanët, arabët, homoseksualët, ose mund të përdoret për të shkatërruar gjallesa të caktuara në shtetet "armike". Për më tepër, bakteret, parazitët, viruset dhe kërpudhat e veçanta mund të projektohen për t'u përqendruar në bashkësi të zgjedhura. E gjithë kjo mund të vihet në jetë, ngaqë është teknikisht e zbatueshme. Pavarësisht nga organet rregullatore dhe 'këshillat e etikës', nuk ka kontrole të vërteta për të penguar zhvillime të tilla.

**KOHËT PASNORMALE NUK KUFIZOHEN VETËM ME 'LAJMET E RREME', 'TË DHËNA TË NDRYSHME' DHE NJOFTIME 'LARG TË VËRTETËS'. PËRKUNDRAZI, PADIJA ËSHTË SHFAQUR SI DIÇKA E RE ME SHUMË VLERË, GJITHËPËRFSHIRËSE, ARTIKULL I LEHTË PËR T'U NDËRTUAR, PRODHUAR DHE SHPËRNDARË NË SHKALLË TË GJERË.**

Padija vjen e vijëzuar në lloje të ndryshme, si një vegël pushteti dhe mashtrimi, si përfaqësuese e mospërputhjes dhe çoroditjes, si një strategji shpërqendrimi dhe për prodhimin e pasigurisë. Është një mjet i vlefshëm për shtetet, grupet, rrjetet dhe njerëzit. Mund të përdoret, në të gjitha duart, për të pjellë ngjarje të mëdha çoroditëse. Një shembull i mirë është dhënë nga një histori e rreme e kohëve të fundit, që prodhoi një shkëmbim të pakëndshëm në *Tweeter*, midis dy fuqive bërthamore. Një postim në Twitter, me titullin: "Ministri izraelit i Mbrojtjes: Nëse Pakistani dërgon trupat në Siri për çdo lloj arsyeje, ne do ta shkatërrojmë këtë vend me sulm bërthamor", qarkulloi në dhjetor 2016. Ministri pakistanez i Mbrojtjes u përgjigj me postimin e vet në Twitter: "Pakistani është gjithashtu një shtet bërthamor". Çështjet ndaluan së përshkallëzuar më tej, kur qeveria izraelite veprroi shpejt, për të vënë në dukje, se historia ishte "krejtësisht fiktive" dhe thënia ishte shpikur. Në



kohët pasnormale, studimi i paditurisë është po aq i rëndësishëm, sa jehona e dijës. Tashmë, nuk ka asgjë të tillë, si mendimi i përgjithshëm i qytetarëve. Njerëzit lëvizin si një lavjerrës, nga një skaj në tjetrin, nga dëshira për më shumë liri, te dëshira për më shumë siguri, nga kërkesa që shteti të ndërhyjë për të ndihmuar nevojtarët, deri te fajësimi i shtetit për zotërimin e jetës së tyre. Pothuajse në çdo demokraci, shoqëria është thellësisht e copëzuar: ka hendek të pakalueshëm midis së majtës dhe së djathtës, laikëve dhe fetarëve, liberalëve dhe fundamentalistëve, modernistëve dhe tradicionalistëve, dhe shumë të vërteta të tjera të pikëpamjeve e botëkuptimeve në mes. Secili grup gjendet brenda dhomës së vet, ngujuar në zhurmën digjitale ku mendimet dhe paragjykimet e tij jehojnë pafundësisht. Teknologjia digjitale gjithashtu, u mundëson njerëzve dhe grupeve të veprojnë në mënyrë anonime në largësi. Nuk ka asnjë lidhje të dukshme midis agjentit dhe veprimit. Prandaj, nuk ka, ose ka fare pak ndjenjë përgjegjësie. Si pasojë, njerëzit që, normalisht, kurrë nuk do të vepronin me vetëdije, sipas pikëpamjeve fanatike, ndikohen në një nivel të thellë ndjenje dhe nënvetëdijeje për të projektuar “përfytyrimin” e tyre. Kështu, çështjet e paragjyqimit, fanatizmit, urrejtjes dhe qëndrimeve përçarëse ndizen vazhdimisht. Nuk është për t’u habitur, që ka një rritje të shpejtë të keqpërdorimit dhe fyerjeve nëpër mediat në internet, e përforcuar nga mungesa e llogaridhënies.

Duhet të jetë e qartë, se, duke pasur parasysht ndërlikimet, mospërputhjet dhe çoroditjet, kohët pasnormale nuk mund të menaxhohen dhe zotërohen. Në të vërtetë, gjendja pasnormale nuk mund të kuptohet as brenda këndvështrimeve të padyshimta, kornizave të sigurisë, kufijve disiplinorë ose krahinorë, fushëpamjes inxhinierike dhe teknike, apo skajeve gjeopolitike. Kur asgjë nuk është e përcaktuar, tërësisht ose plotësisht e sigurt, dhe nxitimi është e vetmja konstante, më e mira për të cilën mund të shpresojmë, është të ecim në rrugën tonë përmes këtyre periudhave të turbullta, duke mos e harruar asnjëherë të ardhmen tonë të parapëlqyer. Edhe pse mund të jetë e lehtë të ndihesh i mbingarkuar nga vorbulla pasnormale rreth nesh, nuk duhet të humbasim kurrë shpresën dhe të bëjmë çmos për të ushqyer ndryshime për mirë, të qëndrueshme dhe që përmirësojnë jetën. Projekte të tilla, si *Seeds of Good Anthropocenes*<sup>33</sup>, të cilat shpërfaqin nisma ekologjike që nuk njihen mirë, ofrojnë një kundër-rrëfë një të fortë ndaj oreksit për të përhapur ferrin. *Appropedia*<sup>34</sup> - një faqe interneti për zgjidhjet e qëndrueshmërisë me burim të hapur, që mburret me mbi 7.000 mjete dhe burime për ata që kanë nevojë, ofron një dëshmi

33 <https://goodanthropocenes.net/>

34 [www.appropedia.org](http://www.appropedia.org)





tjetër të mundësisë që, përtej kohëve pasnormale, një e ardhme tjetër është e mundur. Por, siç vëren Jim Dator, ne duhet të mësojmë se si të lundrojmë në stuhi, një metaforë e përshtatshme për jetën në kohët pasnormale.

Lundrimi në kohët pasnormale kërkon disa parakushte. Kemi nevojë për një ndërgjegjësim, për të ardhme të ndryshme: cilat janë mundësitë që fshihen në horizont? Një vëmendje ndaj pasojave të së ardhmes mund të rrisë veprimtarinë në kohë rrënjësisht të pasigurta dhe të mbështesë cilësinë e arsimit të së ardhmes. Siç thotë Mervin King, është më mirë të kesh përafërsisht të drejtë, sesa të gabosh saktësisht. Kjo do të thotë se, në vend që të përpiqemi të parashikojmë, ne duhet të besojmë. Në një botë të ndërlikuar e të ndërvarur, ngjarjet mund të kthehen me shpejtësi në rrëmujë. Ne duhet të vlerësojmë se nuk ka zgjidhje të vetme ose të thjeshta për asnjë problem. Shumica e halleve tona janë të ndërlikuara, të ndërlikura dhe 'të liga'. Trajtimi i tyre ka nevojë për aftësi dhe teknika të bazuara në mënyra të shumta mirëkuptimi dhe gjithëpërfshirëse, të qenit dhe të bërit. Ne duhet të kalojmë nga zgjidhja tradicionale e çështjeve, mbështetur te matematika e saktë zhgënjyese, siç është formula e PBB-së<sup>35</sup>, derivatet dhe algoritmet e pakuptimta<sup>36</sup>, drejt administrimit rregullisht. Duhet të punojmë 'për të krijuar kushtet në të cilat faktorët ndërveprues në sistem do të përshtaten drejt përfundimeve të dëshiruara shoqërore'.<sup>37</sup> Duhet të lidhim njohuritë me vlerat dhe të dyshojmë te pasojat morale të përparimit të përherëshëm teknologjik. Mbi të gjitha, lundrimi në kohët pasnormale kërkon një angazhim për disa cilësi mjaft të vjetruara që shoqëria e globalizuar i ka anashkaluar, si modestia, përgjegjshmëria, përlësia dhe bashkësia. Ka një vlerë që duhet ta mësojmë me ngut: si të përballemi me larminë befasuese, të dëgjojmë zëra të shumtë, të vlerësojmë një bollëk këndvështrimesh, të akomodojmë mënyra të ndryshme të të qenit, të bërit dhe të diturit, si dhe të bashkërendojmë një rrugë gjithëpërfshirëse përpara. Këtu hyjnë në lojë

Polilogët, domethënë, punimet shkencore me disa autorë. Polilogët janë hapësira ku, siç këshillon teoricienia e kulturës, Julia Kristeva,<sup>38</sup> logjika, këndvështrimi, zëra dhe qenësi të shumta bashkohen për të gjallëruar bashkërendime të reja.

35 Ehsan Masood, *The Great Invention: The Story of GDP and the Making and Unmaking of the Modern World*, Pegasus Books, New York, 2016.

36 Cathy O'Neil, *Weapons of Math Destruction*, Allan Lane, Londër, 2016.

37 Eric Beinhocker, 'New economics, policy and politics' in Tony Dolphin dhe David Nash, editors, *Complex New World*, Institute for Public Policy Research, Londër, 2012, f. 143


38 Julia Kristeva, *Polylogues*, Seuil, Paris, 2008 (në frëngjisht).




Polilogët janë pranimi i vërtetësisë, se dialogu nuk është i mjaftueshëm në një botë me larmi dhe pluralizëm të jashtëzakonshëm.

Gjithashtu, pikëpamja del nga të kuptuarit se mospërputhjet nuk mund të zhbëhen, por vetëm të kapërcehen, dhe se bashkërendimi e njohurive të reja prodhohen në bashkësi, përmes shkëmbimit të fuqishëm dhe të strukturuar të mendimeve. Polilogët janë kryesorë në punën tonë të kohëve pasnormale.

*Përmbledhje e kohëve pasnormale*, mishëron dhe flet për vlerat e poli-logëve, mjetin thelbësor për të ecur në rrugën tonë, për të shmangur pengesat që po ndërtohen në autostradën drejt të ardhmes. Ligjërimi rreth kohëve pasnormale mbetet një punë në vijimësi. Prandaj, vetë lexuesi do të ndryshojë dhe do të zhvillohet me kalimin e kohës, me botime të reja. Por do të jetë gjithmonë një tekst me larmi e pluralizëm në thelb dhe një hapësirë që mirëpret ndihmesat tuaja.



The background of the image is a vibrant blue color. Overlaid on this background are numerous black, hand-drawn style lines that swirl and loop in various directions, creating a complex, organic pattern. The lines vary in thickness and density, giving the impression of a dense, textured field of movement.

ZANAFILLA  
DHE TEORIA





# Shkenca për epokën e kohëve pasnormale

*Silvio O. Funtowicz dhe Jerome R. Ravetz*

Shkenca përparon gjithmonë, duke iu përgjigjur sfidave të saj kryesore, ndërsa ato ndryshojnë gjatë historisë. Pas shekujsh ngadhënjimi dhe shprese, shkenca tani thirret për të shëruar sëmundjen e sistemit industrial botëror, themeli i të cilit është vetë ajo. Ndërsa më parë shkenca kuptohej se po përparonte në mënyrë të qëndrueshme në sigurinë e njohurive tona dhe zotërimit të botës natyrore, tashmë ajo duket se po përballet me shumë pasiguri në çështjet e linjës së veprimit me rreziqet dhe mjedisin. Si përgjigje, po zhvillohen stile të reja të veprimtarisë shkencore. Botëkuptimi zvogëluar, logjik, i cili i ndan sistemet në përbërës gjithnjë e më të vegjël, të studiuar nga një degë e veçantë gjithnjë e më e pakuptueshme për shumicën, po zëvendësohet nga një qasje rregullisht bashkërenduese dhe njerëzore. Ndasitë e vjetra të fakteve dhe vlerave, të dijes dhe padijes, po kapërcehen. Sistemet natyrore njihen si gjallëruese dhe të ndërlikuara; ato që përfshijnë ndërveprimet me njerëzimin, janë 'të ngutshme', duke përfshirë vetitë e pasqyrimin dhe mospajtimin. Shkenca e përshtatshme për këtë kusht të ri do të mbështetet në hamendësimet e paparashikueshmërisë, zotërimit jo të plotë dhe një shumice këndvështrimesh të arsyeshme.

**HËPËRHË, NUK KA PËRSHKRIM TË MIRATUAR, SE ÇFARË DO TË SJELLË E ARDHMJA, POR KA NJË NDJESI TË PËRGJITHSHME, SE SHUMË PREJ TRASHËGIMISË SONË MENDORE, ME SIGURI, TANI GJENDET NË TË SHKUARËN.**



“Pas-moderniste” përdoret gjerësisht si një emërtesë për përshkrimin e dukurive kulturore bashkëkohore.<sup>1</sup> Bëhet fjalë për përqasjen e kritikës së papërmbajtur të hamendësimeve që gjenden në themel të kulturës sonë mbizotëruese dhe që përkëdhelet nga mohimi dhe dëshpërimi. Ndryshe nga kjo përqasje, në këtu parashtrojmë emërtesën “pas-normale”. Kjo ka ngjyrimë të punës thelbësore mbi shkencën bashkëkohore nga Kuhn.<sup>2</sup> Për të, ‘shkenca normale’ nënkupton zgjidhjen e enigmave të zakonshme të topitura, në të vërtetë, anti-intelektuale, me anë të së cilave shkenca përparon në mënyrë të qëndrueshme gjatë revolucioneve të saj ideore. Në këtë gjendje “normale” të shkencës, pasiguritë zotërohen vetvetiu, vlerat janë të pathëna dhe çështjet themelore të padëgjua. Dukuria *pasmoderne* mund të shihet në një kuptim, si një përgjigje ndaj shembjes së një “normaliteti” të tillë si normë për shkencën dhe kulturën. Në vend të pas-modernitetit, sqarojmë se këtu po zhvillohet një ndërgjegjësimit i ri dhe më i pasuruar, lidhur me prirjet dhe metodat e shkencës. Në këtë kuptim, shkenca e përshtatshme për këtë epokë është “pas-normale”.

Kjo shkencë në zhvillim nxit një metodologji të re që ndihmon drejtimin e zhvillimit të saj. Në këtë, pasiguria nuk mënjanohet, por zotërohet dhe vlerat nuk hamendësohen, por bëhen të qarta. Modeli për arsyetimin shkencor nuk është një vogëlsi e formalizuar, por një dialog ndërveprues. Shkenca shembullore nuk është më ajo në të cilën vendndodhja (në kohë dhe hapësirë) dhe vijimësia janë të parëndësishme për shpjegimet. Përmasa historike, duke përfshirë të menduarit mbi të kaluarën dhe të ardhmen e njerëzimit, po bëhet pjesë përbërëse e një tipari shkencor të natyrës.

Ndihmesa jonë në këtë metodologji të re përqendrohet në dy këndvështrime. Njëra është cilësia e të dhënave shkencore, e analizuar si nga llojet e ndryshme të pasigurisë në njohuri, ashtu edhe nga qëllimet e synuara të të dhënave. Deri më tani, ka qenë një sekret i ruajtur mirë, se ‘faktet’ shkencore mund të jenë të një cilësie të ndryshueshme. Një ndërgjegjësimit i njoftuar për këtë fytyrë njerëzore të shkencës, është një çelës për pasurimin e saj lidhur me detyrat e së ardhmes. Ndihmesa tjetër, nga ana jonë, lidhet me strategjitë e zgjidhjes së çështjeve të shqyrtuara në kuptimin e pasigurive në njohuri dhe ndërlikimeve në etikë. Kur shkenca zbatohet në linja të ndryshme veprimi, ajo nuk mund të ofrojë siguri rreth këshillave lidhur me këtë linjë veprimi, ndërsa vlerat në mospërputhje të çdo mënyre vendimmarrjeje nuk mund të mohohen as në vetë punën e

1 S.O. Funtowicz dhe J.R. Ravetz, ‘The good, the true and the post-modern’, *Futures*, 24 (10), Dhjetor 1992, f. 963–976; Z. Sardar, ‘Terminator 2: modernity, postmodernism and the “Other”’, *Futures*, 24 (5), Qershor 1992, f. 493–506.

2 T.S. Kuhn, *The Structure of Scientific Revolutions*, Chicago, il, University of Chicago Press, 1962.



zgjdhjes së çështjeve. Për cilësinë e të dhënave, ne kemi zhvilluar një sistem të dukshëm shënimesh (*nusap*), ku mund të shprehen llojet e ndryshme të pasigurisë që ndikojnë në të dhënat shkencore. Kështu që, ai mund të ndërlihdë saktësisht, qartësisht dhe me gjithë larminë e vet, bashkësitë tradicionale dhe të zgjeruara. Përjasja *nusap* mishëron parimin se pasiguria nuk mund të dëbohet nga shkenca, por ajo cilësi e mirë e të dhënave varet nga menaxhimi i mirë i pasigurive të tyre.<sup>3</sup>

Ne përdorim ndërveprimin e pasigurive të sistemeve dhe rrezikun e vendimeve për të ofruar udhëzime në zgjedhjen e strategjive të përshtatshme për zgjidhjen e çështjeve. Mjeti zhbirues është një vitrinë grafikësh të tri strategjive të ndërlihdura, nga ato më të përcaktuarat saktë, deri tek ato më gjithëpërfshirëse. Dy prej tyre janë të njohura nga përvoja e kaluar e praktikës shkencore ose profesionale. E fundit, ku pasiguritë e sistemeve ose përfitimet e vendimeve janë të larta, përputhet me praktikën e shkencave të epokës pasnormale.<sup>4</sup> Një mënyrë për të dalluar midis llojeve të ndryshme të kërkimit, është të nisemi nga qëllimet e tyre: shkenca e zbatuar 'anon drejt qëllimit'; këshillimi profesional 'i shërben klientit'; dhe shkenca pas-normale është 'e shtyrë nga çështjet'. Këto të tria mund të krahasohen me shkencën themelore, kërkimin tradicional "të pastër" ose "bazë", i cili "shtyhet nga kureshtja". Në fushën e shkencës pasnormale, problemet e sigurimit të cilësisë së të dhënave shkencore janë veçanërisht të mprehta dhe zgjidhja e tyre kërkon kuptime të reja të metodologjisë shkencore.

Në këtë lloj të ri të shkencës, vlerësimi i prurjeve shkencore, me qëllim vendimmarrjen, kërkon një "bashkësi të zgjeruar kolegësh".<sup>5</sup> Kjo shtrirje e arsytimit të pjesëmarrësve të rinj në dialogun e veprimtarive, ka ndikim të rëndësishëm, si për shoqërinë, ashtu edhe për shkencën. Me vlerësim të ndërsjellë midis këndvështrimeve dhe mënyrave të ndryshme të njohjes, gjendet mundësia e zhvillimit të një elementi të mirëfilltë demokratik dhe frytdhënës në jetën e shkencës. Sfidat e reja për shkencën mund të bëhen pasardhëse të 'pushtimeve' të mëdha të mëparshme, si të sëmundjes dhe më pas të hapësirës, në ofrimin e kuptimit simbolik dhe një ndjesie të ringjallur të aventurës për një brez të ri anëtarësh për shkencën e së ardhmes.

3 S.O. Funtowicz dhe J.R. Ravetz, *Uncertainty and Quality in Science for Policy* (Dordrecht, Kluwer, 1990).

4 S.O. Funtowicz dhe J.R. Ravetz, 'A new scientific methodology for global environmental issues', in R. Costanza (editor), *Ecological Economics. The Science and Management of Sustainability* (New York, Columbia University Press, 1991).

5 S.O. Funtowicz dhe J.R. Ravetz, 'Three types of risk assessment and the emergence of postnormal science', in D. Colding dhe S. Krimsky (editors), *Theories of Risk* (New York, Greenwood Press, 1991).





## RIKTHIMI NË LABORATOR SI FORCË ZAKONI

Vendin e shkencës në botën e industrializuar e ka përshkruar më së miri Bruno Latour,<sup>6</sup> kur ai e përfytyronte biologun Paster, duke e shtrirë laboratorin e tij në të gjithë fshatrat franceze, për ta zotëruar atë në dobi të shkencës dhe për veten e tij. Me këtë lloj përfytyrimi, vetë natyra nuk ka më nevojë të përqaset me egërsi dhe kërcënim, por të zbutet dhe të bëhet e dobishme për njerëzimin, nëpërmjet metodologjisë së shkencës. Mrekullia e shkencave natyrore bashkëkohore është se përvoja laboratorike, studimi i një pjese të mënjanuar të natyrës që mbahet veçanërisht e pastër, e qëndrueshme dhe e riprodhueshme, mund të shtrihet me sukses deri te kuptimi dhe zotërimi i natyrës së papërpunuar. Teknologjia dhe mjekësia e kanë bërë natyrën të parashikueshme dhe pjesërisht të zotërueshme. Në këtë mënyrë, ato ua kanë mundësuar shumë njerëzve të gëzojnë një mjedis më të sigurt, më të rehatshëm, si dhe të kenë një jetë më të këndshme nga sa mund të ishte përfytyruar ndonjëherë në historinë tonë. Ana e kundërt e kësaj arritjeje është se ajo mund të jetë e paqëndrueshme, jo thjesht sa i përket barazisë, por edhe sa i përket mbijetesës në kuptimin e plotë të fjalës.

Ngadhënjimi i metodës shkencore, duke vënë njohuritë e larta teknike të ekspertëve të saj në vendin që i takon, ka çuar në përvetësimin e të gjitha mënyrave të tjera të njohjes. Kjo vlen për njohuritë tona, për natyrën dhe për shumë gjëra të tjera përveç kësaj. Fuqia e arsyes dhe aftësitë e trashëguara për të krijuar dhe jetuar, kanë humbur pretendimin e të drejtës së autorit. Ato janë zëvendësuar me kundrinën teorike të ligjëritimit shkencor, diçka e nevojshme për trajtimin e gjërave të padukshme, si mikrobot, atomet, gjenet dhe trupat qiellore. Edhe pse zyrtarisht demokratike (pasi tani nuk ka pengesa zyrtare, që të stërvitesh për atë lloj mjeshtërie), shkenca është një kështjellë vetëm e atyre që mund të angazhohen në rrjedhat arsimore të zgjatura dhe të mbrojtura, pra, në këtë mënyrë, e grupeve shoqërore të cilave u përkasin. Në një traditë që rrjedh nga Iluminizmi i shek. XVIII, arsyetimi i vendimmarrjes publike duhet të duket si shkencor. Prandaj, dijetarët me stil shkencor (përfshirë ekonomistët e shkëlqyer) janë parë si prijës të besueshëm, në të vërtetë, zotërues dhe furnizues të mençurisë në zbatim. Ka pasur një hamendësim të përgjithshëm (ndonëse sipërfaqësor dhe i mbushur me cinizëm), se zotësia shkencore është përbërësi thelbësor i vendimmarrjes, qoftë në lidhje me natyrën apo shoqërinë.

6 B. Latour, *The Pasteurization of France* (Cambridge, MA, Harvard University Press, 1988).



Tani, fuqitë që vetë shkenca ka krijuar, kanë çuar në një marrëdhënie të re të shkencës me botën. Zgjerimi i laboratorit ka shkuar përtej ndërhyrjes në shkallë të vogël, e tipizuar nga përpjekja e Paster-it për zhdukjen e bakterit *Antraks*. Ne nuk vëzhgojmë thjesht shqetësimet e njohura bruto të mjedisit natyror, shkaktuar nga vënia në jetë e industrisë dhe bujqësisë bashkëkohore. Metodologjia e përballimit me sukses të këtyre shqetësimeve të reja nuk mund të jetë e njëjtë me atë që ndihmoi në krijimin e tyre. Pjesa më e madhe e suksesit të shkencës tradicionale qëndronte në fuqinë e saj për largimin e vëmendjes nga pasiguria, lidhur me vlerat dhe njohuritë. Kjo shfaqet në traditën mbizotëruese të mësimdhënies në shkencë, e cila krijoi një gjithësi faktesh të padiskutueshme, të paraqitura në mënyrë parimesh, për t'u përthithur nga studentët pa arsyttime të gabuara. Tashmë, aftësia shkencore na ka çuar në mëdyshe politike, të cilat nuk mund të zgjidhen vetvetiu. Ne nuk kemi humbur thjesht kontrollin dhe parashikueshmërinë. Tani po përballemi me pasiguri rrënjësore, madje edhe padituri, si dhe me pasiguri morale e cila qëndron në qendër të çështjeve të politikave shkencore.

Për të kuptuar detyrat dhe metodat e reja të shkencës, qëllimet e saj dobi-prurëse, mund ta përmbysim metaforën e Latour-it dhe ta shohim natyrën, si një zotëruese të këtij laborator. Ne e shohim këtë në shumë mënyra. Për shembull, teknologjia jonë mbështetur në shkencë, e cila për një kohë dukej se ishte një risi e krijuar për forcë zakoni nga dora e njeriut, mbizotëruese mbi të vjetrën, tani vlerësohet si thellësisht e varur nga një ekosistem më i madh në të cilin është mbjellë dhe rrezikon të vetëshkatërrohet, nëse kjo mbështjellëse trazohet ose nënvlerësohet thellësisht. Në mënyrë të ngjashme, shtrirja e teknologjisë bashkëkohore të mbarë njerëzimit, thelbësore në këtë rast, që të përmbushet barazia midis popujve në sistemin e tanishëm, do të përshpejtonte prirjet vetëshkatërruese të vetë sistemit teknologjik. Përmes kësaj, natyra pohon praninë e saj të gjithë planifikimit tonë shkencor, si për këndvështrimin teknik, ashtu edhe për atë njerëzor.

Përgjatë historisë, ka pasur ngjarje të tjera, kur shkenca është tjetërsuar, kur një veprimtari veçanërisht e suksesshme për zgjidhjen e çështjeve ka zhvendosur format e vjetra dhe është bërë shembull i shkëlqyer i shkencës. Këto tjetërsime janë njëjtësuar me emrat e shkencëtarëve të tillë të mëdhenj, si Galileo, Darvini dhe Ajnshtajni. Ato kanë prekur kryesisht shkencën teorike, sepse, deri vonë, teknologjia dhe mjekësia nuk ishin ndikuar përgjithësisht në afat të shkurtër nga përfundimet e kërkimit shkencor. Sfidat ndaj shkencës ishin kryesisht në fushën e ideve. Tani, pasi fuqitë e shkencës kanë shkaktuar kërcënime për vetë mbijetesën e njerëzimit, përgjigjja do të jetë në zbatueshmërinë shoqërore të shkencës, po aq sa në ngrehinat e saj intelektuale.



## QENDËRZIMI I PASIGURISË DHE I CILËSISË

Tani që mënyrat e veprimit ndaj rrezikut dhe mjedisit paraqesin shqetësim me më të ngutshme për shkencën, pasiguria dhe cilësia po i afrohen qendrës (këto, dikush mund t'i quajë edhe hije të metodologjisë shkencore), për të përmbushur qendërzimin e pikëpamjeve të njëjta. Deri më tani, ato janë mbajtur në kufirin e të kuptuarit të shkencës, si për laikët, ashtu edhe për shkencëtarët. Një nga detyrat e reja të shkencëtarëve, do të jetë edhe menaxhimi i këtyre pasigurive thelbësore. Këtu qëndron edhe rëndësia e sigurimit të të dhënave cilësore shkencore të ofruara për vendimmarrjen e linjave të veprimit.

Këto mënyra të reja veprimi kanë tipare të përbashkëta që i dallojnë ato nga shqetësimet tradicionale shkencore. Ato janë të një shkalle përgjithësuese dhe afatgjata në ndikimin e tyre. Të dhënat rreth ndikimit të tyre, madje edhe të dhënat për linjat themelore të sistemeve “të pashqetësuar”, janë rrënjësisht të pamjaftueshme. Ngaqë dukuritë janë të një lloji të ri, të ndërlikuara dhe të ndryshueshme, vetvetiu nuk kuptohen aq sa duhet. Shkenca nuk mund të ofrojë gjithmonë teori të mbështetura në eksperimente për shpjegim dhe parashikim. Mirëpo, vazhdimisht mund të arrijë, në rastin më të mirë, të paraqesë modele matematikore dhe përngjasime kompjuterike, të cilat në thelb janë të pamundura të provohen. Mbi bazën e të dhënave të tilla të pasigurta, vendimet duhet të merren në rrethana të ngutshme. Prandaj, linja e veprimit nuk mund të vazhdojë e mbështetur në parashikime faktike, por vetëm në parashikimet e mënyrave se si të veprohet.

Modelet kompjuterike janë mënyra më e përdorur për prodhimin e njoftimeve për të ardhmen, mbështetur në të dhënat e së shkuarës dhe së tashmes. Për shumë njerëz, kompjuterët ende kanë një cilësi magjike, pasi besohet se ata arsyetojnë shpejt dhe pa gabime. Mirëpo, përlllogaritja që del në fund nga një program, nuk është domosdoshmërisht një parashikim shkencor dhe mund të mos jetë edhe një parashikim i mirë i linjave të veprimit. Të dhënat numerike të përdorura si hyrje për t'u llogaritur, nuk mund të rrjedhin nga studime eksperimentale ose në terren. Numrat më të mirë të disponueshëm, si në shumë studime të rrezikut industrial, mund të jenë thjesht hamendësime të mbledhura nga të diturit. Në vend të këtyre teorive që japin një përfaqësim më të thellë të vijimësisë së zakonshme në fjalë, fare mirë mund të kishim një deng programimesh të caktuara që zbatohen sipas vlerësimeve numerike më të përshtatshme. Në vend të provave eksperimentale, në terren apo historike, siç hamendësohet normalisht për teoritë shkencore, mund të



kemi vetëm një krahasim të përfundimeve, me ato që dalin nga modele të tjera kompjuterike po aq të pamundura të provohen.

Pavarësisht burimeve dhe përpjekjeve të mëdha që janë bërë për zhvillimin dhe zbatimin e metodave të tilla, janë bërë pak përpjekje të bashkërenduara për të parë nëse ato ndihmojnë në mënyrë të konsiderueshme, qoftë në njohuri, qoftë në linjën e veprimit. Në kërkimet lidhur me përqsasjet vepruese për rrezikun dhe mjedisin, që janë kaq thelbësore për mirëqenien tonë, ka pasur pak përpjekje për sigurimin e cilësisë së atij lloji që shkenca tradicionale eksperimentale e merr si të mirëqenë gjatë zbatimit të saj në jetën e përditshme. Ndërsa kompjuterët, në parim, mund të përdoren për të përmirësuar aftësitë njerëzore dhe krijimtarinë, ngaqë mund ta bëjnë të gjithë punën e përditshme me shpejtësi dhe pa mundim. Në shumë raste, ata janë bërë zëvendësues të mendimit të disiplinuar dhe saktësisë shkencore.<sup>7</sup> Edhe kur ka të dhëna të përfuara nga gjykimi dhe gabimi, lidhur me çështjet e qasjes së veprimit, ato nuk bindin aq sa për t'u studiuar përmes të dhënave statistikore tradicionale. Siç thotë edhe J.C. Baila:

E gjithë algjebra statistikore dhe të gjitha llogaritjet statistikore kanë vlerë vetëm aq sa ato mund t'i shtojnë ecurisë së përfundimit. Shpesh, ato nuk ndihmojnë në nxjerrjen e përfundimeve të shëndosha. Në të vërtetë, ato mund të bëjnë të kundërtën dhe, në përvojën time, kjo ndodh për shkak se llojet e ndryshueshmërisë së rastësishme që shohim në çështjet e mëdha të ditës, priren të jenë të vogla, në krahasim me pasiguritë e tjera. Kjo është e vërtetë, për shembull, për të dhënat mbi varfërinë ose papunësinë; tregtinë ndërkombëtare; prodhimin bujqësor; masat themelore të shëndetit dhe mbijetesës së njeriut. Më afër shtëpisë, ndryshueshmëria e rastësishme - përbërja e vlerave të probabilitetit dhe kufijve të besimit thjesht mbytet, nga lloje të tjera pasigurish në vlerësimin e rreziqeve shëndetësore, të shpërfaqja ndaj kimikateve, ose gjurmimi i lëvizjes së një ndotësi mjedisor, ose parashikimi i ndikimeve të veprimtarisë njerëzore në temperaturën globale, ose në shtresën e ozonit.<sup>8</sup>

Kështu që, sipas nivelit tradicional të metodës shkencore, cilësia e kërkimit mbi këto çështje të lidhura me përqsasjet vepruese, në rastin më të mirë, është e dyshimtë. Detyrat e zotërimit të pasigurisë dhe sigurimit të cilësisë, si fusha të reja veprimi, të përdorura ashtu siç duhet në shkencën tradicionale nga aftësi njerëzish të veçantë dhe të zbatuara bashkërisht, gjenden tërësisht në rrëmujë të plotë. Duhet të zhvillohen mënyra të reja

7 S. Mac Lane, 'Letters', *Science*, 241 (1988), f. 1144; dhe 242 (1988), f. 1623-1624.

8 J.C. Bailar, *Scientific Inferences and Environmental Problems: The Uses of Statistical Thinking* (Chapel Hill, Institute for Environmental Studies, The University of North Carolina, 1981, f. 19.



për ta vënë në punë paditurinë tonë.<sup>9</sup> Për këtë, duhet të ketë një largim rrënjësor nga mbështetja e plotë në teknika, drejt një përjashtimi të hamendësimeve metodologjike, shoqërore ose morale, si veçori e deritanishme e shkencës tradicionale 'normale'.

Një përjasje përbashkimi ndaj çështjeve të pasigurisë, cilësisë dhe vlerave është siguruar nga sistemi (QPPSA). Sipas këtij sistemi, lloje të ndryshme pasigurie mund të shprehen dhe të përdoren për një vlerësim të cilësisë së të dhënave shkencore. Duhet të bëjmë dallimin midis niveleve teknike, metodologjike dhe teorisë së njohjes së pasigurisë. Këto përkohë përkatësisht me pasaktësinë, jobsueshmërinë dhe 'kufirin me padijen'.<sup>10</sup> Pasiguria zotërohet në nivel teknik, kur përditshmëria është e mjaftueshme. Kjo, zakonisht, merret vesh nga të dhënat (të cilat në vetvete janë në thelb ndryshime simbolike) e shtuara nga teknika dhe marrëveshjet e zhvilluara për fusha të veçanta. Niveli metodologjik përfshihet kur ana më e ndërlikuar e të dhënave, si vlera ose besueshmëria, janë të ndërlikdhura. Më pas, nevojiten gjykime vetjake në varësi të aftësive të nivelit më të lartë. Puna për të cilën po flasim, është një këshillim profesional, një 'art i mësuar', si mjekësia apo inxhinieria. Së fundi, niveli i teorisë së dijes hyn në lojë, kur pasiguria e pandreqshme është në thelb të çështjeve, si në rastin kur modeluesit kompjuterikë hetojnë 'pasiguritë e plotësisë', të cilët mund të dëmtojnë gjithë punën, ose, më në përgjithësi, në shkencën pasnormale. Në qendrat për politikën pasnormale dhe studimet të së ardhmes (QPPSA), këto nivele të pasigurisë përçohen përkatësisht nga kategoritë e përhapjes, vlerësimit dhe prejardhjes.

Sigurimi i cilësisë është po aq thelbësor për shkencën, sa ç'është për industrinë. Ndërsa në shkencën tradicionale të kërkimit mund të menaxhohet joformalisht nga një këshill shkencor, në çështjet e politikave të reja të rrezikut dhe mjedisit cilësia e shkencës duhet të trajtohet urgjentisht. Rishikimi i pamjaftueshmëm i punës shkencore tradicionale është analizuar gjerësisht për disa fusha të ndryshme të 'shkencës thelbësore',<sup>11</sup> 'shkencës së caktuar'<sup>12</sup> dhe shkencës 'rregullatorë'.<sup>13</sup> Siç shihet, vlerësimi i cilësisë në këtë kuptim të ri të shkencës nuk mund të jetë i kufizuar në përfundimet kërkimore. Ai duhet të përfshijë gjithashtu ecurinë dhe njerëzit, si gur të fundit, edhe qëllimet. Kjo lloj përjasjeje për sigurimin e

9 J.R. Ravetz, 'Usable knowledge, usable ignorance: incomplete science with policy implications', in J.R. Ravetz, *The Merger of Knowledge with Power* (Londër, Cassell, 1990).

10 Funtowicz dhe Ravetz, vep. cit., referenca 3.

11 J. Turney, 'End of the peer show?', *New Scientist*, 22 Shtator 1990, f. 38-42.

12 L. Salter, *Mandated Science* (Dordrecht, Kluwer, 1988).

13 S. Jasanoff, *The Fifth Branch* (Cambridge, ma, Harvard University Press, 1990).




cilësisë së shkencës përfshin domosdoshmërisht pjesëmarrjen e njerëzve të ndryshëm nga hulumtues të aftë teknikisht. Në të vërtetë, të gjitha palët e përfshira në një çështje formojnë një “këshill të zgjeruar shkencor”, për një strategji frytdhënëse të zgjidhjes së shqetësimeve, lidhur me rreziqet botërore të mjedisit.

## STRATEGJITË E ZGJIDHJES SË PROBLEMEVE

Për të përshkruar një çështje që përfshin rrezikun dhe mjedisin, në atë që ne e quajmë ‘*Shkenca pasnormale*’, duhet ta mendojmë atë si një gjë ku faktet janë të dyshimta, vlerat në mosmarrëveshje, rreziku i lartë dhe vendimet nuk presin.


Figura 1. Strategjitë e zgjidhjes së çështjes





Në një rast të tillë, emërtesa ‘problemë’, me domethënien e një ushtrimi ku një metodologji e përcaktuar ka të ngjarë të çojë në një zgjidhje të qartë, nuk është aq e përshtatshme. Do të mashtroheshim, nëse do të ruanim përfytyrimin e një ecurie, gjatë së cilës faktet e vërteta shkencore thjesht përcaktojnë përfundime të sakta mbi përjasjen e të vepruarit. Megjithatë, sfidat e reja nuk ia zbehin rëndësinë shkencës tradicionale. Detyra e saj është të zgjedhë llojet e duhura të përjasjeve për zgjidhjen e problemeve në secilin rast të veçantë. Figura 1 përfshin tri veçori dalluese. Së pari (dhe kjo është një risi për metodologjinë shkencore), ajo tregon ndërveprimin e pikëpamjeve njohuridhënëse (diturisë) dhe masës vlerësuese (vlerave) të çështjeve shkencore. Këto përshkruhen si boshtet e figurës, që përfaqësojnë përkatësisht dendësinë e pasigurisë dhe rreziqet e vendimmarrjes. Siç vihet re, pasiguria dhe rreziku i vendimeve janë e kundërta e vetive që tradicionalisht mendoheshin si tipari dallues i shkencës, përkatësisht siguria e saj dhe asnjansësia e vlerës (kjo është risia e dytë e arsyetimit tonë). Së fundi, që të dyja përmasat shfaqen si të përbëra nga tri hapësira të dallueshme. Në këtë mënyrë, ne përmbushim një diagramë me tri zona që përfaqësojnë dhe përshkruajnë tri lloje përjasjesh në zgjidhjen e çështjeve.

Figura 2. Shkenca e zbatuar





Emërtesa “pasiguritë e sistemeve” përcjell parimin se çështja nuk ka të bëjë me zbulimin e një fakti të veçantë, por me të kuptuarit ose të zotëruarit e një realiteti në thelb të ndërlikuar. Me ‘rreziqet e vendimmarrjes’, ne kuptojmë të gjitha çmimet, përfitimet dhe rëndësinë e vlerës që përfshihen në këtë çështje, nëpërmjet palëve të ndryshme të interesuara. Nuk është e nevojshme të përpiqemi të bëjmë një hartë të hollësishme të tyre, pasi ato lindin nga pikëpamjet teknike dhe shoqërore gjatë bashkëbisedimit për ndonjë çështje të caktuar rreth përqsjes së veprimit. Sa për zbërthimin e tanishëm ideor, mjafton që të jetë e mundur zbardhja parimisht e elementeve kryesore apo mbizotëruese dhe, më pas, të përshkruajmë sistemet tërësore sipas këtyre elementeve.

Shpjegimi i grafikut të qasjeve të zgjidhjes së çështjes fillon me strategjinë më të njohur. Ne e quajmë këtë shkencë të zbatuar e cila futet në lojë, kur pasiguritë e sistemeve dhe rreziqet e vendimmarrjeve janë të ulëta. Pasiguritë e sistemeve do të jenë në nivel teknik dhe do të zotërohen nga mënyra veprimi standarde. Këto do të përfshijnë teknika të veçanta për të mbajtur veglat në gjendje pune, si dhe mjete e paketa statistikore për trajtimin e të dhënave. Rreziqet e vendimmarrjes do të jenë të thjeshta dhe të papërfillshme; burimet janë vënë në kërkim, ngaqë ka një qëllim të veçantë të jashtëm e të drejtpërdrejtë për përfundimet e këtij kërkimi. Të dhënat që dalin, do të përdoren në sipërmarrje më të madhe, e cila nuk është shqetësuese për studiuesin në punë. E sqarojmë këtë në Figurën 2.

Në figurën 2, shkenca tradicionale “e pastër”, “themelore” ose “thelbësore” mund të gjykohet si e përqendruar rreth kryqëzimit të boshteve. Me përkufizim: nuk ka interesa që rrezikohen nga jashtë, sa u përket kërkimeve të shtyra nga kureshtja, kështu që rreziqet e marrjes së një vendimi janë të ulëta. Gjithashtu, përgjithësisht nuk ndërmerren humurtime, nëse nuk ka besim, se pasiguritë janë të ulëta, domethënë se e panjohura e problemit ka të ngjarë të zgjidhet nga një përqsje normale. Është e qartë, se kërkimi shumë i përparuar ose revolucionar, qoftë i pastër, apo i përdorur më parë, nuk është pjesë e kësaj kategorie, ngaqë pasiguritë e sistemeve janë në thelb të larta dhe, për arsye të ndryshme, të tilla janë edhe rreziqet e vendimmarrjes. Kërkimet astronomike të Galileos, fjala vjen, përfshinin një varg çështjesh, që nga teknika astronomike, deri te dijet fetare. Pra, edhe pse nuk ishin drejtpërdrejt të zbatueshme në çështjet industriale ose mjedisore, ishin padyshim të tejskajshme, si në pasiguritë, ashtu edhe në rreziqet e vendimmarrjes. E njëjta gjë mund të thuhet për veprën e Darwin-it, *Prejardhja e llojeve*. Nga kjo pikëpamje, ka një vazhdimësi midis ‘filozofisë së natyrës’ klasike dhe shkencës pasnormale që po shfaqet së fundmi.





Ne mund të krahasojmë në mënyrë të dobishme shkencën themelore dhe shkencën e zbatuar, lidhur me besueshmërinë e cilësisë. Aty ku pasiguritë dhe rreziqet e jashtme të vendimmarrjes janë të ulëta, ecuritë tradicionale të vlerësimit akademik të projekteve dhe kërkimeve shkencore kanë ecur mjaft mirë, pavarësisht vështirësive të njohura. Megjithatë, kur përfundimet e kërkimit marrin një rëndësi të veçantë për ndonjë qëllim shtesë, këshilli përkatës shkencor zgjerohet përtej një bashkësie kërkimore të veçantë, duke përfshirë përdoruesit e të gjitha llojeve, si dhe drejtuesit. Rrethana e vlerësimit të cilësisë shkon përtej prodhuesve dhe shpenzuesve, duke sjellë një rend dite dhe aftësi të ndryshme në treg. Për të parë se si mund të ndryshojë shkalla e cilësisë midis prodhuesve dhe shpenzuesve, le të marrim parasysh sigurinë e mallit: një aksident i rrallë mund të jetë më pak i rëndësishëm për prodhuesit (veçanërisht, nëse ligjet e përgjegjësive të mallit janë të dobëta), sesa për shpenzuesit. Në rastin e shkencës së zbatuar, një përfundim i arritur në mënyrë të vlefshme, brenda një numri të caktuar kushtesh, mund të jetë i papërshtatshëm, kur zbatohet për të tjerët. Pra, nëse matjet e një helmi jepen në shifra mesatare, me kalimin e kohës, hapësirës ose popullatave të rrezikuara, kjo mund të jetë e përshtatshme për qëllime të përgjithshme rregullatore, por kjo mënyrë mund të shpërfillë nivelet më të larta të helmimit që janë shumë të dëmshme, ose grupet që preken nga ky helmim.

**SHPESHHERË, NDODH QË PASOJAT E ZBATIMIT TË NJË PROJEKTI SHKENCOR NUK BËHEN TË 'NJOHURA PUBLIKISHT', PRA, TË JENË LIRSHËM TË ZOTËRUESHME PËR TË GJITHË PËRDORUESIT E PËRSHTATSHËM. PËRKUNDRAZI, ATO JANË 'NJOHURI E PËRBASHKËT', 'PRONËSI INTELEKTUALE' E NDËRMARRJEVE PRIVATE APO AGJENCISË SHTETËRORE QË KA PAGUAR MBARËVAJTJEN E KËRKIMEVE.**

Nëse të dhënat janë të rëndësishme për disa çështje të përqasjes së veprimit, detyrat e besueshmërisë së cilësisë mund të bëhen të diskutueshme, duke përfshirë mosmarrëveshjet lidhur me ruajtjen e fshehtësisë dhe rreziqet e vendimmarrjes që mund të lindin nga kjo pikëpamje joshkencore. Atëherë, strategjia e tanishme e zgjidhjes së çështjeve nuk është më shkencë e zbatuar, sepse çështja mund të përfshijë beteja mbi pushtetin administrativ dhe



politik, si dhe parimet kushtetuese të 'së drejtës për të ditur' të qytetarëve (për shembull, në lidhje me rreziqet mjedisore ose rreziqet teknologjike). Prandaj, këshilli shkencor përkatës shtrihet përtej prodhuesve, pagesve dhe përdoruesve të drejtpërdrejtë të hulumtimit shkencor, për të përfshirë të gjithë ata që kanë pjesën e tyre në këtë mall, vijimësinë e tij dhe ndërlikimet, si krahinore, ashtu edhe botërore. Ky zgjerim i rrethit akademik mund të përfshijë gazetarë hetuesie, avokatë dhe grupe të ndryshme me ndikim. Pra, një çështje që mund të duket krejtësisht e drejtpërdrejtë shkencërisht, mund të bëhet një shqetësim që i kapërcen kufijtë e shkencës së zbatuar, duke krijuar një strategji më të ndërlikuar për zgjidhjen e çështjeve, siç është 'shkenca pasnormale'. Kur shkencëtarët me një pikëpamje tradicionaliste ankohen për ndikimin e keq të "shtypit", ndonjëherë është për shkak të vështirësisë së tyre për të kuptuar këtë veçori të re të shkencës, kur ajo është e përfshirë në linjat e vepimit.


## KËSHILLIMI PROFESIONAL

Grafiku për këshillimin profesional (Figura 3) ka dy zona, brenda së cilave përfshihen shkencat e zbatuara. Kjo do të thotë se këshillimi profesional përfshin shkencën e zbatuar, por merret vetëm me çështje të cilat kërkojnë një metodologji të ndryshme për zgjidhjen e tyre të plotë. Pasiguria nuk mund të zotërohet në nivelin e përditshëm teknik, sepse anët më të ndërlikuara të çështjes, siç është besueshmëria e teorive dhe e të dhënave, janë të rëndësishme. Përveç kësaj, kërkohen gjykime vetjake, në varësi të aftësive të nivelit më të lartë, ndërsa pasiguria është në nivelin metodologjik.

Marrëdhënia ndërmjet pasigurive të sistemeve dhe rreziqeve të vendimmarrjes është e mirësuaruar, përmes detyrës së përfshirjes së pasojave të gabimit në një vendimmarrje. Për të shfrytëzuar shkencën e zbatuar, përgjithësisht, këto marrëdhënie përfshihen si të nënkuptuara në rregullat e caktuara statistikore.



Figura 3: Këshillim profesional



Kufijtë e besimit dhe kufizimet për të dy llojet e gabimeve të përfundimeve, zakonisht përdoren në vlera të qëndrueshme të paracaktuara, pa kundërshtim. Por, në detyrat profesionale, pasojat e gabimeve mund të jenë aq të mëdha, sa të rrezikojnë vazhdimin e karrierës. Prandaj, ato duhet të trajtohen si rreziqe, përmes përdorimit të disa llogaritjeve, por ku gjykimi doemos duhet të mbizotërojë. Përpara një rrethane mjeko-ligjore, profesionisti do të duhet të marrë parasysh barrën e provës për shqetësimin e caktuar, i cili do të pasqyrojë vlerat e një shoqërie të caktuar (dëmtimi i kujt është më i rëndësishëm për t'u parandaluar?). I njëjti arsyetim vlen për çdo çështje në përjasjen e veprimit, por një shqetësim i ndotjes së mjedisit do të trajtohet ndryshe, në varësi të faktit, nëse një ecuri vlerësohet e padëmshme, derisa të provohet e rrezikshme, ose anasjellas. Përndryshe, ne mund të pyesim nëse mungesa e dëshmisë së dëmit përkthehet si dëshmi e mungesës së dëmit. Edhe pse çështje të tilla metodologjike janë përtej rrjedhës së shkencës së zbatuar, në këshillimin profesional ato kushtëzojnë fuqishëm të gjithë punën. Përshkrimet e thjeshta, siç janë dhënë këtu, nuk përfshijnë hollësitë e barrës së provës, siç përdoret në praktikë.




Këshillimi profesional ndan shumë veçori me shkencën e zbatuar, duke i veçuar të dyja nga shkenca thelbësore. Të dyja veprojnë sipas nënkufizimeve të kohës dhe burimeve me projekte të paguara dhe të udhëzuara nga ndikime të jashtme. Shpesh, përfundimet e tyre mbeten jashtë fushës së 'njohurisë publike'. Për shumicën e kohës, detyrat profesionale mund të thjeshtohen në stërvitje të përditshme, pasi puna përcaktohet nga zotërimi i pasigurisë dhe teknika e saj. Por këshillimi profesional përfshin gatishmërinë për t'u përballur me rrethana të reja dhe të papritura, si dhe marrjen përsipër të përgjegjësisë për pasojat e tyre. Inxhinieria është në kufirin midis të dyjave, sepse shumica e punëve inxhinierike bëhen përbrenda shoqërive dhe jo për blerës vetjakë. Megjithatë, problemet nuk mund të thjeshtohen plotësisht në nivelin e përditshmërisë, prandaj 'grykimi inxhinierik' është një anë e njohur e punës. Për inxhinierinë mund të themi se shumica e punës së përditshme inxhinierike është një çështje e aftësive vëzhguese dhe artizanale, duke përdorur përfundimet e shkencës së zbatuar, ndërsa në nivelet e saj më të larta bëhet vërtet një këshillim profesional.

Një rast i kundërt i ndërmjetëm është ai i rolit të "ekspertit". Zakonisht, ky është dikush që këshillon, por përgjegjësia e të cilit përcaktohet nga vendi i punës, prandaj nuk është interesi i blerësit ai që përcakton rolin e tij, por ai i punëdhënësit të vet. Në këtë drejtim, rreziqet e vendimmarrjes janë më të thjeshta se ato të këshilltarit profesionist dhe, sipas tij, pasiguritë e sistemeve janë përkatësisht të thjeshtuara. Është e mundur që një njeri i vetëm t'i përvetësojë këto tre role, duke i këmbyer herë pas here, apo edhe (në një farë mase) njëkohësisht, duke shkaktuar çoroditje te ndjekësit e tij, ose ndoshta edhe për veten e vet. Një hulumtues akademik mund të japë këshilla për një çështje të lidhur me linjat e veprimit; epërsia dhe ligjshmëria i tij rrjedhin nga emri i mirë gjatë kërkimeve, qoftë në shkencën themelore, qoftë në shkencën e zbatuar. Ai merr të drejtën e këshilluesit profesionist, kur shpreh gjykimet e veta dhe, nëse kërkimi i tij kontrollohet nga afër nga ndonjë shoqatë që e paguan, atëherë ai mund të jetë duke vepruar si ekspert në emër të saj. Kjo është arsyeja, pse lind mundësia e 'përplasjes së qëllimeve', kur shkencëtarët bëjnë shpallje publike, pa kundërshtuar askush paprekshmërinë e tyre vetjake, siç e shohin vetë ata.

Si një strategji për zgjidhjen e çështjeve, këshillimi profesional ka dallime të rëndësishme nga shkenca e zbatuar. Pasojat e shkencës së zbatuar, si në rastin e shkencës themelore, kanë tiparet e riprodhueshmërisë dhe parashikimit. Kjo do të thotë se, në parim, çdo eksperiment duhet të jetë i mundur të riprodhohet kudo, nga çdo zbatues i aftë, sepse ata veprojnë brenda metodave natyrore të veçuara dhe të mbikëqyrura.



Figura 4: Shkenca pasnormale



Prandaj, përfundimet e dala u afrohen parashikimeve, lidhur me sjelljen në të ardhmen të metodave natyrore ose teknike, në kushte të ngjashme. E kundërta mund të thuhet për detyrat profesionale të cilat merren me rrethana të veçanta, sado të ngjashme të jenë ato. Tipari vetjak bëhet po aq i rëndësishëm; kështu që është e drejtë të kërkohet një mendim i dytë, pa vënë në dyshim aftësinë ose paprekshmërinë e një mjeku, në një rast mjekësie. Përndryshe, kujt do t'ia priste mendja, që dy arkitektë të prodhojnë një projekt të njëjtë për një shkurtesë të vetme? Në të njëjtën mënyrë, nuk do të ishte e arsyeshme të pritej që dy inxhinierë sigurie të prodhonin të njëjtin model (ose të njëjtat përfundime) për një analizë rreziku, gjatë ndërtimit të një ngrehine. Publiku mund të hutohet ose zhgënjehet, ndërsa shikon shkencëtarët që nuk pajtohen fort për një problem që, me sa duket, përfshin vetëm shkencën e zbatuar (edhe vetë shkencëtarët mund të jenë të hutuar). Por, kur mendohet se mënyrat se si të veprojmë, kanë nevojë të përfshijnë edhe këshilla profesionale, mosmarrëveshje të tilla duhet të shihen si të pashmangshme dhe të shëndetshme. Fitimi në qartësi duhet të bëjë më shumë sesa thjesht të dëmshpërblejë humbjen e magjepsjes rreth pagabueshmërisë shkencore.



Kjo dukuria e fundit na kujton ndryshimet në besueshmërinë e cilësisë që shfaqet kur shtrihemi nga shkenca e zbatuar, drejt këshillimit profesional. Ne mund të parashikojmë katër përbërës, lidhur me detyrën e zgjidhjes së çështjeve; ecuria, përfundimi, njeriu dhe qëllimi. Kjo është përqsaja 'katër-përbërës' për besueshmërinë e cilësisë së përmendur më sipër. Në shkencën themelore, përqendrimi kryesor në detyrën e vlerësimit të cilësisë është gjatë ecurisë; vlerësimi bëhet në bazë të të dhënave që dalin nga hulumtimi dhe kërkon një bashkësi akademikësh njohës të lëndës (të cilët mund të "lexojnë midis rreshtave" në të dhënat rreth hulumtimit), për sa i përket rendimentit. Në shkencën e zbatuar, vatra e vlerësimit shtrihet në përfundimet dhe bëhet nga shfrytëzuesit, sepse puna kërkimore bëhet në emër të tyre. Për pasojë, besueshmëria te cilësia nuk është edhe aq e brendshme, pasi shfrytëzuesit kanë më pak nevojë të kuptojnë ecurinë e hulumtimeve; prandaj ajo vetvetiu shtrihet edhe te qytetarët, përmes pjesëmarrjes me të drejtë vlerësimi. Në këshillimin profesional nuk mund të ketë kushte apo ecuri të thjeshta qëllimore për besueshmërinë e cilësisë (përtej aftësisë së thjeshtë). Blerësit bëhen pjesë e rëndësishme e asaj bashkësie njerëzish që vlerëson cilësinë e punës, megjithëse nuk e kanë aftësinë teknike përkatëse. Prandaj, në këto tre raste, ne shohim një zgjerim të 'këshillit shkencor' të përfshirë në besueshmërinë e cilësisë. Në këtë aspekt, "këshilli shkencor" i shkencës pasnormale është një vazhdim i natyrshëm i kësaj prijëje.

## SHKENCA PASNORMALE

Tani, le t'i hedhim një sy llojit të tretë të strategjisë së zgjidhjes së çështjeve, ku pasiguritë e metodave ose rreziqet e vendimmarrjeve janë të larta (Figura 4).

Në përshkrimet e tyre, çështjet e linjës së veprimit që nxisin shkencën pasnormale, mund të përfshijnë një pjesë të madhe të shkencës, ndonjëherë deri në atë pikë, sa të jenë të afta për t'u shprehur në gjuhë shkencore. Në këtë kuptim, këto çështje janë të ngjashme me problemet 'përtej-shkencës', të shpallura fillimisht nga Alvin Weinberg.<sup>14</sup> Prandaj do të bënim mirë, që t'i ndanim problemet e shqyrtuara këtu, nga ato të brezit të mëparshëm, sepse Weinberg përfytyronte probleme që ndryshonin vetëm nga shkalla ose plotësueshmëria teknike, nga ato të shkencës së zbatuar. Ato ishin pothuajse të

14 A. Weinberg, 'Science and trans-science', *Minerva*, 10, 1972, f. 209-222.



ndryshme nga ato të këshillimit profesional, siç e përcaktojmë ne.<sup>15</sup> Në kushtet e diagramës sonë,

**SHKENCA PASNORMALE NDODH KUR PASIGURITË LIDHEN ME  
DITURINË OSE MORALIN, OSE KUR RREZIQET E VENDIMMARRJES  
PASQYROJNË QËLLIME TË KUNDËRTA MES PALËVE.**

Ne e quajmë “pasnormale”, për të treguar se ushtrimet për zgjidhjen e të panjohurave të shkencës normale (në kuptimin Kuhnian); të cilat u shtrinë me kaq sukses nga laboratorit, deri në pushtimin e plotë të natyrës; nuk janë më të përshtatshme për zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me mënyrat e veprimit, lidhur me rreziqet dhe mjedisin. Siç mund ta vërejmë në figurat 2-4, shkenca e zbatuar shfaqet tri herë dhe këshillimi profesional dy herë. A nënkuptojnë këto dy emërtesa të njëjtat gjëra, kur përfshihen në një strategji më të gjerë të zgjidhjes së çështjeve, njësoj si në rastin kur qëndrojnë të veçuara? Në kuptimin e jetës së tyre të përditshme, po. Mirëpo, kur ato përfshihen në një strategji më të gjerë për zgjidhjen e çështjeve, e gjithë veprimtaria rishikohet. Çështjet marrin udhë dhe zgjidhjet vlerësohen sipas kushteve të një bashkësie më të gjerë njerëzish. Kështu, shkenca pasnormale është, me të vërtetë, një lloj shkence dhe jo thjesht mënyrë veprimi apo pjesëmarrje publike. Sado e ndryshme nga llojet e zgjidhjes së çështjeve që tani janë kthyer në traditë dhe janë rrënjësor, ajo është një formë e vlefshme e kërkimit, e përshtatshme për nevojat e së tashmes.

Shembuj të çështjeve me rrezik të lartë vendimmarrjeje që ndërthuren me metoda të pasigurta, mbi çështjet e linjave të veprimit për rrezikun e vendimmarrjes dhe mjedisit, janë të njohura nga kultura e tanishme. Në të vërtetë, ndonjë nga shqetësimet e rreziqeve të mëdha teknologjike, ose ndotjes në shkallë të gjerë, i përket këtij brezi. Shkenca pasnormale ka veçorinë paradoksale të veprimtarisë së vet në zgjidhjen e problemeve, ngaqë është përmbysur mbizotërimi tradicional i ‘fakteve të pamohueshme’, duke u zëvendësuar me ‘vlerat e panumërta’. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, duke përqsaur padituri të plotë në disa raste, si dhe rreziqeve të tejskajshme në vendimmarrje, na lejohet që në disa raste të shkëmbejmë boshtet në diagramën tonë, duke i bërë vlerat horizontale të ndryshojnë në mënyrë të pavarur. Një shembull i mirë i një përmbysjeje të tillë, jepet nga veprimet që do të duhet të ndërmerren në përgatitje për zbutjen e ndikimit

15 A. Weinberg, ‘Letters’, *Science*, 180, 1972, f. 1124.



të rritjes së nivelit të detit, si pasojë e ndryshimeve klimatike botërore. “Zinxhiri shkakësor” këtu fillon me pasojat e ndryshme të veprimtarisë njerëzore që shkaktojnë tjetërsime të biosferës, të cilat çojnë në ndryshime klimatike, më pas në ndryshime në nivelin e detit (të gjitha këto ndërveprojnë në mënyra të ndërlikuara, me kohë vonesash të ndryshme). Nga e gjithë kjo, duhet të dalin një sërë parashikimesh të cilat do të ofrojnë të dhëna shkencore në ecuritë e vendimmarrjes. Këto do të ndihmonin në këshillimin e mënyrave të vendimmarrjes, që më pas duhet të zbatohen në shkallë të gjerë. Por të gjitha elementet shkakësore janë të një pasigurie të tejskajshme dhe do të ishte një formë tjetër e pakujdesisë, të prisje derisa të gjitha faktet të zbuloheshin. Kjo mund të rrezikonte pjesën më të madhe të mjedisit të ndërtuar si dhe vendbanimet e njerëzve. Mërgime masive nga vendet e ulëta mund të kërkohen herët a vonë, të ndjekura nga trazira ekonomike, shoqërore dhe kulturore.

Vendimmarrje të tilla, me ndikim të gjerë në shoqërori, do të merreshin mbi bazën e të dhënave shkencore që, në thelb, janë të një lloji të tejskajshëm pasigurie; aq më tepër kur planet lehtësuese duhet të fillojnë me një periudhë të gjatë ndërgjegjësimit, në mënyrë që programet e mëdha të rindërtimit dhe zhvendosjes të mund të fillojnë. Rritja e nivelit të detit nuk do të ishte si një baticë e ngadaltë, por do të ishte më shumë në formën përmbytjeje me dridhje gjithnjë në rritje dhe shkatërruese. Qytetet porte të përgatitura (si shumica e qendrave politike dhe financiare të botës) mund të shkatërrohen. Një mënyrë e re e krizës së ligjërit mund të shfaqet, sepse, nëse autoritetet përpiqen t’i mbështesin thirrjet e tyre për sakrificë në besueshmërinë tradicionale të shkencës së zbatuar, si në modelin e Paster-it, me siguri, kjo do të dështojë. Marrëveshja dhe pjesëmarrja qytetare që, në thelb, rrjedhin nga angazhimet e vlerave, do të jenë vendimtare për vlerësimin e rreziqeve dhe përcaktimin e mënyrës së veprimit. Pra, prurjet tradicionale shkencore janë bërë ‘të panumërta’ në kuptimin e angazhimeve të vlerës ‘së pamohueshme’, çka do të përcaktojë suksesin e linjave të veprimit për zbutjen e ndikimeve në një rritje të mundshme të nivelit të detit. Në këtë mënyrë, ne shohim se si “metodat” e përfshira në çështjet e qasjeve mjedisore janë me të vërtetë “të ngutshme”, duke përfshirë përmasat e njohjes dhe vlerës që i kapërcejnë ato, metodat e studiuara sipas teorisë tradicionale, mënyrat dhe teknikat e modelimit. Kështu, shkenca pasnormale përputhet me një teori të pasuruar metodash, duke përfutur prej tyre ashpërsinë arsyetuese, duke u ofruar atyre përvojë dhe njohuri.

Dallimi tradicional fakt/vlerë nuk është vetëm i përmbysur; në shkenecat pasnormale këto dy kategori nuk mund të ndahen vërtet. Pasiguritë





shkojnë përtej metodikës, duke përfshirë edhe moralin. Të gjitha çështjet e sjelljes ndaj rrezikut dhe mjedisit përfshijnë forma të reja drejtësie, të cilat më parë shiheshin si “të padëmshme” për punët e ndërmarrjes shkencore-tekni-ke, që është prodhimi dhe shpenzimi i mallrave. Këto çështje të reja përqasjeje përfshijnë mirëqenien e palëve të reja të përfshira, të tilla si brezat e ardhshëm, gjallesat e tjera dhe mjedisin planetar në tërësi. Lidhja e ngushtë midis pasigurive në dituri dhe në moral sqarohet mirë, përmes problemit të zhdukjes së gjallesave, qoftë vetjake apo mbarëbotërore. Është e pamundur të krijohet një arsyetim i thjeshtë për të gjykuar midis të drejtave të njerëzve që do të përfitonin nga një lloj zhvillimi, dhe atyre të një kafshe ose bime që do të dëmtohej. Megjithatë, pasiguritë morale nuk duhet të na pengojnë nga kërkimi i zgjidhjeve; as vendimmarrësit nuk mund të anashkalojnë forcën politike të atyre njerëzve që kanë një shqetësim të zjarrtë për ata që nuk mund të luten ose të votojnë. Vetëm një dialog midis të gjitha palëve, në të cilin ekspertiza shkencore zë vendin e saj në tryezë, me shqetësimet vendore dhe mjedisore, mund të arrijë zgjidhje krijuese për shqetësime të tilla, të cilat më pas mund të hyjnë në fuqi dhe të zbatohen. Përndryshe, do të mbizotërojnë ndikimet e vrazhda tregtare, rregulloret e pahijshme burokratike, apo tubimet e paparashikueshme, në dëm të pashmangshëm të të gjitha palëve të përfshira.

Të gjitha këto ndërlikime nuk e pengojnë zgjidhjen e çështjeve të vendimmarrjes në shkencën pasnormale. Grafiku nuk duhet parë si diçka e ngurtë, por si diçka gjallëruese, si anë të ndryshme të çështjes, të vendosura në zona të ndryshme, që ndërveprojnë dhe çojnë në zgjidhjen përfundimtare të tij. Gjendet një model i zhvillimit të çështjeve, me strategji të ndryshme të zgjidhjes së problemeve që dalin në pah në mënyrë të njëpasnjëshme, i cili ofron mënyrat me të cilat dialogu mund të ndihmojë përfundimisht në zgjidhjen e tyre. Sepse, ndërsa debati nis të përparojë nga faza e paqartë fillestare, me kalimin e kohës, qëndrimet sqarohen dhe nxiten hulumtimet e reja. Megjithëse përkufizimi i çështjeve nuk është kurrë plotësisht i çliruar nga përqasja e veprimit, një debat i hapur siguron që vëmendje të tilla nuk janë as të njëanshme dhe as të fshehta. Ndërsa përdorimi i shkencës së zbatuar sjell përfundimisht fakte të reja, detyrat e këshillimit profesional bëhen më frytdhënëse. Një shembull i mirë i këtij modeli zhvillimi, është plumbi në benzinë, ku, pavarësisht mungesës së të dhënave përfundimtare mjedisore, apo të teorisë së dijes, përfundimisht, u arrit në mirëkuptimin, se rreziqet e shëndetit të qytetarëve nuk ishin të pranueshme. Një zgjidhje e tillë nuk vjen gjithmonë shpejt apo lehtë; disa përbërës mund të emërtohen si ‘rreziqe luhatëse’, për shkak të mënyrës se si ato shkojnë lart e poshtë në përshtypjen e



ekspertëve. Dioksina duket të jetë një e tillë. Në këto raste, sjellja qytetare në një vendimmarrje të dobishme do të mbështetej më mirë në vlerësimin e pasigurive të qenësishme dhe jo në shpresën e kotë, se këtë herë shkenca e zbatuar ka dhënë vendimin e saktë rreth sigurisë apo rrezikut.

## ZGJERIMI I KËSHILLAVE SHKENCORË

Gjallëria e zgjidhjes së çështjeve të vendimmarrjes në shkencën pasnormale nënkupton përfshirjen e një grupi gjithnjë e në rritje të pjesëmarrësve të arsyeshëm në ecurinë e sigurimit të cilësisë së prurjeve shkencore. Siç e kemi parë, në shkencën e zbatuar dhe këshillimin profesional, këshillat shkencorë tashmë janë zgjeruar përtej atyre vetëm për shkencën themelore. Në shkencën pasnormale, pasiguritë e shumëfishta, si në përfundime, ashtu edhe në ecuri, kërkojnë që rëndësia përkatëse e vendimmarrësve të rritet. Prandaj, themelimi i arsytimit dhe zotësisë së pjesëmarrësve do të përfshijë, në mënyrë të pashmangshme, institucione dhe lëvizje më të gjera shoqërore dhe kulturore. Për shembull, njerëzit e prekur drejtpërdrejt nga një çështje mjedisore, do të kenë një ndërgjegjësim më të mprehtë për gjatë dhe një shqetësim më të ngutshëm për cilësinë e rivendosjes zyrtarisht të besimit, sesa ata në çdo rol tjetër.<sup>16</sup> Pra, ata kryejnë një detyrë të ngjashme me atë të këshilltarëve profesionistë në ecurinë e vlerësimit apo gjyqimit në shkencën tradicionale, që, përndryshe, mund të ishte e pamundur në rrethanat e reja të krijuara. Ndonjëherë, puna e arsyeshme e këshillave shkencorë mund të shkojë përtej kundërveprimit ndaj vlerësimit të cilësisë dhe debatit rreth vendimmarrjes. Fusha e re e *'teorisë së përhapjes së dijeve'* përfshin qytetarë të shqetësuar që bëjnë kërkime rregullisht, të cilat mund ose ndoshta do të duhej të ishin bërë nga institucionet e caktuara, por që nuk i kanë kryer.<sup>17</sup> Në raste të tilla, ata mund të ndeshen me mosmiratim dhe armiqësi profesionale, duke u kritikuar, ose për mungesë aftësish të vërtetuara, ose ngaqë vetë ata janë shumë të shqetësuar për çështjen në fjalë. Mosmarrëveshja krijuese mes teorisë së përhapjes së dijeve dhe asaj të dijetarëve, jo vetëm që çon në zotërim më të mirë të çështjeve të mjedisit, por përmirëson edhe njohuritë shkencore. Një rast tipik është *'sëmundja Lyme'*, ku qytetarët vendas, fillimisht, vunë re disa lloj shenjash të paqarta,

16 S. Krimsky, 'Epistemic considerations on the value of folk-wisdom in science and technology', *Policy Studies Review*, 3, 1984, f. 246–262.

17 F. Brown, 'Popular epidemiology: community response to toxic waste-induced disease in Woburn, Massachusetts', *Science, Technology and Human Values*, 12, 1987, f. 78–85.



të cilat më vonë morën veçorinë e një sëmundjeje të panjohur më parë, por jo të pazakontë, shkaktuar nga rriqrat.

**KUR ÇËSHTJEVE U MUNGOJNË ZGJIDHJE TË QARTA, KUR ANA MJEDISORE DHE MORALE E ÇËSHTJEVE JANË TË RËNDËSISHME, KUR VETË DUKURITË JANË TË DYKUPTIMTA, DHE KUR TË GJITHA TEKNIKAT E KËRKIMIT JANË TË HAPURA KUNDREJT KRITIKËS METODOLOGJIKE, ATËHERË DEBATET PËR CILËSINË NUK PËRMIRËSOHEN DUKE I PËRJASHTUAR TË GJITHË, PËRVEÇ HULUMTUESVE TË AFTËSUAR DHE EKSPERTËVE ZYRTARË. ATËHERË, ZGJERIMI I KËSHILLIT SHKENCOR NUK ËSHTË THJESHT NJË LËVIZJE E MORALSHME APO POLITIKE, POR MUND TË PASUROJË ECURINË E HETIMEVE SHKENCORE.**

Njohja e gjendjes në vend mund të përcaktojë se cilat të dhëna janë të sigurta e të rëndësishme dhe, gjithashtu, mund të ndihmojë në përcaktimin e çështjeve të vendimmarrjes. Një njohuri e tillë vendore përbrenda vetes, nuk vjen natyrshëm për ekspertët e lëndës së posaçme, përgatitja dhe punësimi i të cilëve i shtyn ata drejt përshtatjes së ideve të turbullta, të përgjithësuara për vërtetësinë e çështjeve dhe rëndësinë e të dhënave. Ata, jeta e të cilëve varet nga zgjidhja e çështjeve, do të jenë thellësisht të ndërgjegjësuar rreth zbatimit të parimeve të përgjithshme në “oborret pas shtëpive të tyre “. Gjithashtu, ata do të kenë ‘fakte të zgjeruara’, duke përfshirë rrëfenja, vëzhgime të thjeshta dhe të dhëna zyrtare të botuara me mjete jozyrtare. Mund të pohohet se atyre u mungojnë njohuritë teorike dhe janë të njëanshëm nga interesi vetjak, por po aq mirë mund të thuhet se dijetarëve u mungojnë njohuritë e përdorshme dhe kanë format e tyre të pavetëdijshme të anësisë.

Shembulli i ri i shkencës pasnormale që përfshin këshillat shkencorë të zgjeruar, si pjesëmarrës thelbësorë, shihet qartë në rastin e Sidës. Këtu, shkencëtarët hulumtues veprojnë në shkëlqimin e plotë të publicitetit, duke përfshirë të sëmurë, kujdestarë, gazetarë, moralistë, veprimtarë dhe grupe të vetofruar, si dhe institucione tradicionale për mbledhjen e të hollave dhe rregullimin e tregut. Zgjedhja e çështjeve nga hulumtuesit dhe vlerësimet e zgjidhjeve i nënshtrohen njësoj një shqyrtimi të thellë dhe, në mënyrë të ngjashme, mosmarrëveshjet e tyre parësore tërhiqen zvarrë në sytë e qytetarëve. Kjo kushton, kështu që nuk është më e lehtë për shkencëtarët të ushtrojnë sundimin e tyre dashamirës mbi njerëzit që përpiqen t’i mjekojnë



në mënyrë “provo dhe gabo”, ndërsa të tjerët nuk marrin asnjë mjekim. Por, vetëm nëse nuk besojmë se është e drejtë, që të sëmuret nga kjo sëmundje e tmerrshme duhet të varen tërësisht nga vetëmohimi dhe përkushtimi i hulumtuesve, prodhuesve dhe rregullatorëve, përndryshe ata duhet të përfshihen në dialog, sado përçarës që mund të bëhet ndonjëherë.

Deri më tani, raste të tilla janë ende të rralla. Këshillat shkencorë të zgjeruar, përgjithësisht, veprojnë të veçuar për çështje të veçanta vendim-marrëse në vendbanime të veçuara, pa u mbështetur rregullisht me mjete financiare dhe me fare pak përgatitje për aftësitë e tyre të veçanta. Në shumë raste, aftësia është e pamjaftueshme në dialog dhe ndërveprim me palët e tjera të përfshira.<sup>18</sup> Miratimi i punës së tyre është shumë i ndryshueshëm. Në SHBA, me traditat e kalimit të pushtetit në nivel vendor, ‘ndërhyrësve’ në disa prej ecurive në vendimarrje u sigurohet mbështetje. Në vende të tjera ata mund të përbuzen ose pengohen në mënyrë veprorë. Brenda këshillave shkencorë të tillë, do krijohet vazhdimisht një gjendje e nderë midis atyre me kërkesa për qëllime të veçantë dhe veprimtarëve të jashtëm me një rend dite më të gjerë, së bashku me ndasinë e pashmangshme përgjatë kufirit klasor, përkatësisë racore, gjinisë dhe arsimit zyrtar. Megjithatë, e gjithë kjo çoroditje është e pashmangshme dhe, me të vërtetë, e shëndetshme në një lëvizje fillestare që po nxit kalimin në një epokë të re për shkencën. Mund të ndodhë që fusha e shëndetësisë ku ‘parapëlqimet’ vetjake të shpenzuesve mund të veprojnë në mënyrë më të dobishme, në një shkallë më të gjerë sesa në çështjet e përqsasjeve mjedisore, prandaj dhe zgjerimi i shkencës pasnormale do të ndodhë më lehtë. ‘Mjekësia plotësuese’ mund të gjykohe në shumë mënyra, si një shembull për shkencën pasnormale dhe, përkundër kundërshtimeve të pashmangshme të jashtme dhe çoroditjeve të brendshme, ajo rritet në mënyrë të qëndrueshme.

Është e rëndësishme të vlerësohet se shkenca pasnormale është plotësuese e shkencës së zbatuar dhe këshillimit profesional. Ajo nuk është një zëvendësim i mënyrave tradicionale të shkencës dhe as nuk kundërshton thirrjet për njohuri të besueshme, ose aftësim të vërtetuar, që bëhen në emër të shkencës në rrethanat e saj të arsyeshme. Mjeshtëria teknike e shkencëtarëve dhe profesionistëve të aftësuar në lëmitë (fushat) e pranuar të punës nuk po kundërshtohet. Ajo që mund të vihet në pikëpyetje, është cilësia e asaj pune në rrethana të reja, veçanërisht në pikëpamjen mjedisore, shoqërore dhe morale. Sipas mendimit mbizotërues të mëparshëm, këto ishin “të padëmshme” ndaj punës së shkencës ose teknologjisë dhe se, kur të lindin shqetësime të

18 Salter, vep. cit., referenca 12.



tilla, një përgjigje e përshtatshme do të shpikëj disi nga “shoqëria”. Tani detyra është të shohim se çfarë lloj ndryshimesh në të ushtruarit e shkencës dhe në institucionet e saj, do të shkaktohen nga pranimi i pasigurisë, ndërlikimit dhe cilësisë, në kuadër të kërkimit të qasjes përkatëse.

Si në çdo ndryshim të thellë, e tashmja përmban farat e shkatërrimit dhe të gjallërimit. Disa pjesëmarrës në betejat mjedisore arrijnë t’i shohin shkencëtarët thjesht si armë me qira, të cilët duhet të japin të dhënat që na duhen ‘ne’ dhe të pranojnë ndrydhjen nga të tjerët. Të tjerët do të jenë mospërfillës, kundrejt çdo argumenti dhe prove që dobëson çështjen e tyre të paragjykuar. A janë pjesëmarrës të tillë, anëtarë të përshtatshëm të një këshilli shkencor të zgjeruar? Edhe shkenca tradicionale ka përfshirë gjithmonë lloje të tilla, por ka pasur një angazhim moral të nënkuptuar ndaj ndershmerisë, ku këshilli në tërësi ka ruajtur cilësinë e punës së vet.<sup>19</sup> Ruajtja e cilësisë, pa të cilën të gjitha përpjekjet për të zgjidhur çështjet e përqasjes kundrejt rrezikut dhe mjedisit janë të dënuara, është një detyrë kryesore për metodologjinë e shkencës së të ardhmes.

## PËRFUNDIM

Në çdo epokë, shkenca formohet përgjatë çështjeve të saj kryesore dhe përparon bashkë me to.

**ÇËSHTJET E PËRQASJES SË RE NDAJ RREZIKUT DHE MJEDISIT JANË BOTËRORE, JO VETËM NË SHTRIRJE, POR EDHE NË NDËRLIKIMIN, PËRHAPJEN DHE RISINË E TYRE, SI QËLLIM I KËRKIMIT SHKENCOR.**

Me mbizotërimin e shkencës së zbatuar, deri më tani, kërkimi i arsyeshëm dhe me masë në shkencat e natyrës është marrë si model për arsyetimin e veprimtarisë intelektuale dhe shoqërore në përgjithësi. Sado i suksesshëm të ketë qenë në të kaluarën, miratimi i çështjeve të linjës së veprimit kundrejt rrezikut dhe mjedisit, tregon se ideali i arsyetimit nuk është më i përshtatshëm në mbarë botën. Veprimtaria e shkencës tani përfshin menaxhimin e pasigurive të vazhdueshme në dituri dhe në moral, si dhe njohjen e këndvështrimeve dhe mënyrave të ndryshme më të pranueshme të njohurive. Në

19 J.R. Ravetz, *Scientific Knowledge and its Social Problems* (Oxford, Oxford University Press, 1971).



këtë mënyrë, ushtrimi i saj po bëhet më i ngjashëm me prirjen e një shoqërie demokratike, ku pjesëmarrja e gjerë dhe durimi i shumëllojshmërisë janë veçoritë e saj dalluese. Ndërsa politika në vijimësi tani njeh detyrimet tona ndaj brezave të ardhshëm, ndaj gjallesave të tjera dhe ndaj mjedisit mbarë-botëror, shkenca, gjithashtu, zgjeron shtrirjen e shqetësimeve të veta. Ne po jetojmë përgjatë kësaj periudhe kalimtare të shpejtë dhe të thellë, kështu që nuk mund të parashikojmë pasojat e saj. Por ne mund të ndihmojmë në krijimin e kushteve dhe mjeteve mendore, me anë të të cilave ecuria e këtij ndryshimi mund të menaxhohet për përfitimet më të mundshme të mjedisit dhe njerëzimit kudo në botë.

Demokratizimi i kësaj ane shkencore nuk është çështje dashamirësie nga palët e përfshira, por (si në fushën e politikës) synon mbërritjen e një metode e cila, përkundër mungesës së rendimentit të saj, është mjete më i dobishëm për shmangien e fatkeqësive që vijnë nga periudha e zgjatur e mbytur në kritika. Përvoja e kohëve të fundit ka treguar se prania e një rëndësie të tillë, është po aq vendimtare për zgjidhjen e çështjeve të përqasjes kundrejt rrezikut dhe mjedisit, sa ç'është edhe për vetë shoqërinë. Duhet të jemi mjaft të qartë rreth kësaj; ne nuk po shqyrtojmë demokratizimin e shkencës, mbështetur në një dëshirë të përgjithësuar për shtrirjen sa më të madhe të demokracisë në shoqëri. Arsyetimi i mbështetur në teorinë e dijes së shkencës pasnormale, rrënjësuar në detyrat e posaçme të besueshmërisë së cilësisë, tregon se një shtrirje e tillë e këshillave shkencorë, bashkë me faktet përkatëse, është e nevojshme për dobinë e shkencës në përballimin e sfidave të reja të çështjeve botërore të mjedisit.

Kjo analizë është një shtesë e shkrimit tonë të mëparshëm rreth pasmodernizmit.<sup>20</sup> Të dyja kanë të bëjnë me humbjen e mbizotërimit të një botëkuptimi të vetëm, mbështetur në një përfytyrim të veçantë mbi shkencën. Dukuria pasmoderniste është dukuri e një zhgënjimi të thelluar dhe e një copëzimi me pasoja në të gjitha nivelet, përfshirë atë ideologjik e shoqëror. Çdo kundërvënie, si ajo e disa përfaqësuesve kryesorë të pasmodernizmit, është dëshpërim. Një kundërvënie tjetër është ripohimi i 'normalitetit'; kështu që disa shkencëtarë kryesorë pohojnë se zgjidhja e çështjeve tona ekologjike arrihet duke paguar për programin e tyre të zgjeruar në hulumtime themelore përkatëse, në të cilat pasiguria nuk përmendet kurrë.<sup>21</sup> Në të vërtetë, ndrydhja e pasigurisë në shkencën "normale" e vendos atë në pajtueshmëri me kundërvëniet mjaft të ashpra ndaj

20 S.O. Funtowicz dhe J.R. Ravetz, vep. cit., referenca 1.

21 J. Lubchenko et al., 'The Sustainable Biosphere Initiative: an ecological research agenda (A report from the Ecological Society of America)'. *Ecology*, 72, 1991, Dazes, f. 371-412.



gjendjes bashkëkohore. Prandaj është vënë re se disa fundamentalistë fetarë nuk e kanë të vështirë të zbatojnë njohuri shkencore të llojeve të ndryshme, pasi të dyja dogmat, me përcaktimet e duhura të kufirit, mund të bashkëjetojnë lehtësisht.<sup>22</sup> Së fundi, kundërpërgjigjja ndaj pasnormales është njohja e sfidës me të gjitha rreziqet dhe premtimet e saj, që më pas të fillojmë drejt një bashkërendimi, nëpërmjet pranimit të pasigurisë dhe mirëpritjes së larmisë.

---

22 Z. Sardar, *Explorations in Islamic Science* (Londër, Mansell: 1989, kapitulli 2, 'Anatomy of a confusion'.



## Mirë se vini në kohët pasnormale

*Ziauddin Sardar*

“Ra nga shiu në breshër”, thotë fjala e urtë dhe kohët e fundit ka pasur shumë breshër. Nëse kërcënimet e shumta nga ndryshimet klimatike nuk do të mjaftonin për të na lënë pa gjumë, tashmë jemi nën zotërimin e një prej rënieve ekonomike më të këqija në histori. Brenda natës, bankat u shembën si shtëpi letre, shoqëritë e sigurimeve u përkulën, emrat e njohur në mbarë botën filluan të zhdukeshin nga qendrat tregtare. Qeverisë sonë iu desh të hynte dorëzanë me një shumë mbresëlënëse prej 1.3 trilion *pound* dhe të lehtësonte në mënyrë sasiore sistemin tonë financiar vetëm për ta mbajtur atë në lëvizje. Përpara se të kishim kohë për të marrë frymë, një pandemi e gripit të dërrit kërcënoi të përfshinte botën. Pas gjithë kësaj, fshihet kriza energjetike, burimet natyrore në pakësim, si nafta (ndoshta) dhe peshku (padyshim), kërcënimi i vazhdueshëm i riprodhimit bërthamor dhe kërcënimi gjithnjë i pranishëm i terrorizmit. Për të mos folur për krizën e pensioneve, krizën e dhunës së bandave dhe vrasjeve me thika në rrugët tona, si dhe krizën me të cilën përballlet ‘Nëna e të gjithë Kuvendeve’ (Anglia). Ne i urrejmë bankierët, nuk u besojmë politikanëve tanë dhe shqetësohemi vazhdimisht për sigurinë e vendeve tona të punës, sigurinë e fëmijëve tanë dhe dëmtimin e vendbanimeve tona. Asgjë nuk është e sigurt, vërtet e sigurt, ose plotësisht jashtë rreziku.

Mirë se vini në kohët pasnormale! Është një kohë kur pak gjëra mund të besohen, ose të na japin besim. *Espirito del tiempo* - fryma e epokës sonë, shquhet nga pasiguria, ndryshimi i shpejtë, riorganizimi i pushtetit, trazirat dhe sjellja çoroditëse. Jetojmë në një periudhë të ndërmjetme ku parimet e vjetra po vdesin, të rejtat ende nuk kanë lindur dhe shumë pak





gjëra duket se kanë kuptim. Epoka jonë është një epokë kalimtare, një kohë pa besimin se ne mund të kthehemi në çdo të kaluar që kemi njohur dhe pa besimin në ndonjë rrugë drejt një të ardhmeje të dëshirueshme, të arritshme ose të qëndrueshme. Është një kohë kur të gjitha zgjedhjet duken të rrezikshme, që, me gjasa, të çojnë në rrënim, nëse jo tërësisht, atëherë buzë greminës. Në kohën tonë është e mundur të ëndërrojmë të gjitha ëndrrat për të ardhme aq përfytyruese, por pothuajse e pamundur ta besojmë se kemi aftësinë ose përkushtimin për ta përjetuar ndonjë prej tyre. Jetojmë në një gjendje vërshimi të rrethuar nga pavendosmëria: çfarë është më e mira, çfarë është më keqja? Jemi të pafuqishëm kundrejt rreziqeve, të turpëruar nga frika e zgjedhjeve që mund të jemi të prirë ose të detyruar t'i mendojmë.

Në sajemat e përditshme të gjërave, ne e dimë se ku jemi. Dimrat janë të ftohtë dhe verat janë të nxehta, stinët rrjedhin (pranvera përshpejton, vjeshta ikën si me kurdisje) në një rrethore të natyrshme. Ekonomia rritet në mënyrë të qëndrueshme, me ritme që variojnë nga të ngadalta, në të befta, por duke ruajtur një rritje të besueshme e të përgjithshme të begatisë dhe sigurisë. Tregjet bëjnë punën e tyre, *keq e zi*, ata rregullojnë çmimet dhe ne kemi besim të sigurt në institucionet tona financiare. Politikanët, që asnjëherë nuk janë më të besueshmit, pranojnë dhe kryesisht u përmbahen parimeve të pranuarra të sjelljes, ndërsa ligjërojnë në mënyrë të dobishme për të rregulluar punët e shoqërisë. Kur përballemi me një sëmundje apo rrezik të ri, shkenca dhe mjekësia na vijnë në ndihmë menjëherë. Një baraspeshë botërore e pushtetit, me të gjitha papërsosmëritë e veta, ruan atë përshtypjen paqësore të ligjit dhe rendit; diktatorët e ndryshkur, nga frika e pasojave të veprimeve të tyre, e dinë se kur është mjaft. Ne jetojmë në vendbanime të arsyeshme dhe të ndërlidhura, jashtë rrezikut, duke ditur se e ardhmja e fëmijëve tanë është e sigurt. Në një kohë të zakonshme, kur gjërat shkojnë keq, siç ndodh shpesh, e dimë se çfarë të bëjmë. Ne e përcaktojmë dhe e mënjojmë problemin, përdorim burimet tona fizike dhe mendore për të gjetur një përgjigje të qëndrueshme. Themelet e forta dhe teoritë e vërtetuara të lëndëve të ekonomisë dhe shkencave politike, apo shkencat biologjike dhe natyrore, na drejtojnë për nga zgjidhja e mundshme. Pësha dhe fuqia e plotë e bindjeve intelektuale, akademike dhe politike siguron që ne ta kalërojmë me sukses *tigrin* e ndryshimit.

Tani vetëm një pjesë e vogël prej kësaj është e vërtetë. Pjesa më e madhe e asaj që kemi marrë si normale, parimore dhe zakonore, thjesht nuk bën më punë. Në të vërtetë, vetë normaliteti u vërtetua se është rrënja



e të gjitha sëmundjeve tona. Merrni si shembull rënien e tanishme ekonomike. Kjo ofron prova të shumta, se modeli i vjetër i tregtisë, në të cilin ne jemi mbështetur për shekuj me radhë, është shkatërruar. Jo vetëm që kapitalizmi i tregut të lirë është vjetruar në mënyrë të rrezikshme, por edhe dega e ekonomisë e cila përligji teorikisht këtë ngrehinë, është gjithashtu mendërisht e mbaruar.<sup>1</sup> Tregtari, shtylla mendore që mbështet ngrehinën, një krijesë që dikur lavdërohej për arsyet e tij, tani është zhdukur.<sup>2</sup> Tregjet e nxitura vetëm nga shtypa e fitimit janë bërë të paqeverisshme, mbështetur vetëm në lakminë vetjake dhe zhatjen e pandërgjegjshme të pasurive të paimagjinueshme që përqendrohen në pak duar. Konkurrenca dhe qar-kullimi i lirë i mallit rreth botës bujare e të çrregullt është një përrallë e lypsarëve që vërtiten rreth fqinjëve, duke u kërkuar të prodhojnë mallra gjithnjë e më të lira, por që po i kthejnë gjithnjë e më shumë lagjet tona në djerrina 'të ndryshkura' me lavdinë e dikurshme, ndërsa ndreqja e çrregullimeve të tregtisë botërore rrit paqëndrueshmërinë dhe mosbesimin e ndërsjellë brenda dhe ndërmjet kombeve.<sup>3</sup>

Vetë bota është tani një vend shumë më i pasigurt sesa ishte gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX. Nuk është vetëm se rendi ynë politik, mbështetur në vetërregullimin dhe rregullat e mirësjelljes së shtresës së pasur, është thyer në mënyrë të pariparueshme. Por, sa më shumë që politikanët nxjerrin ligje, reformojnë dhe ndryshojnë, aq më pak të rëndësishme dhe të dobishme duken ligjet, sa i përket përfitimeve të shumta të shoqërisë dhe, aq më shumë, shfaqen pasoja të paqëllimshme dhe të padëshiruara. Pamja gjeopolitike botërore po ndryshon gjithashtu me shpejtësi. Vështirë se ka një vend ku politikanët, të çfarëdo bindjeje qofshin, të kenë besim ose vlerësim. Edhe cikleve të rregullta të motit nuk mund t'u besohet më - falë ngrohjes globale, me rritjen e temperaturave dhe niveleve të detit, ndryshimin e përbërjes së oqeanit dhe ekosistemeve të tjetërsuara.

### „DEKADA E PARË E SHEKULLIT XXI KA QENË NJË THIRRJE PAFUND PËR T'U ZGJUAR“

1 Graham Turner, *The Credit Crunch*, Pluto, Londër, 2008.

2 Alex Brummer, *The Crunch: How Greed and Incompetence Sparked the Credit Crisis*, Random House, Londër, 2009.

3 David Boyle dhe Andrew Simms, *The New Economics*, Earthscan, Londër, 2009.



- thotë një reklamë e IMB-së. “Këto janë kriza metodike, që nga siguria, klima, ushqimi dhe uji, energjia, tregjet financiare etj.”<sup>4</sup> E veçantë e këtyre gjëmave është se ato kanë ndodhur në të njëjtën kohë: “Nuk kemi parë kurrë ndonjë epokë ku të jemi goditur nga të gjitha këto kriza të shumëfishta njëkohësisht”, - thotë Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-Moon.<sup>5</sup> Nuk është vetëm se gjërat po shkojnë keq, ato po shkojnë keq në mënyrë të mahnitshme, në shkallë botërore, në shumë mënyra dhe njëkohësisht. Kështu, ne e gjejmë veten në një rrethanë që nuk është normale, pra kemi hyrë në fushën e pasnormales.

Ideja e “pasnormales” u shtrua për herë të parë nga Jerry Ravetz, filozofi i njohur britanik i shkencës dhe matematikani argjentinas, Silvio Funtowicz.<sup>6</sup> Duke punuar në matematikën e rrezikut, ata vunë re se përfytyrimi i vjetër i shkencës, ku të dhënat e marra përmes vëzhgimit çojnë në përfundime të vërteta dhe arsyetimi shkencor çon në përqasje të sakta, nuk ishte më i besueshëm.<sup>7</sup> Kishte një pasiguri të madhe në punën shkencore e cila, së bashku me ndryshimet në financim, përfitimet, shqetësimet shoqërore rreth përparimeve në shkencë dhe çështjet e ndërlikuara të sigurisë, të gjitha nënkuptonin se shkenca nuk po anonte më drejt “normales”. “Sa herë që ka një çështje rreth mënyrës së veprimit që përfshin shkencën”, - shkruajnë Ravetz dhe Funtowicz, “ne zbulojmë se faktet janë të pasigurta, ndërlikimi është normë, vlerat janë në pikëpyetje, rreziqet janë të larta, vendimet merren ngutshëm dhe ka të ngjarë që rreziqet e pjella nga dora e njeriut të dalin jashtë kontrollit”.<sup>8</sup> Ata i përshkruajnë shpërfaqjet zhvillimore si “shkencë pasnormale”, e cila tani është kthyer në një fushë të përforcuar kërkimore.

Pjesa më e madhe e asaj që Ravetz dhe Funtowicz thanë për shkencën, në vitet 1990, tani janë po aq të vërteta edhe për degë të tjera, në të vërtetë, për mbarë shoqërinë në tërësi. Gjithçka, nga ekonomia, deri te marrëdhëniet ndërkombëtare, tregjet, mallrat në dyqanet vendore; nga politika, deri te mospajtimet, janë bërë pasnormale dhe ka arsye shumë të forta për këtë gjendje. Të gjitha ato lidhen me tri dukuri: ndërlikimet, çoroditjen dhe mosmarrëveshjet – tri forcat që formojnë dhe shtyjnë kohët pasnormale. Është e rëndësishme për ne, që t’i kuptojmë këto forca për t’u marrë vesh mbi një rrugë të qëndrueshme përpara.

4 [www.ibm.com/ibm/responsibility/agenda.shtml](http://www.ibm.com/ibm/responsibility/agenda.shtml)

5 *The Guardian*, 8 Korrik 2009.

6 Jerome R. Ravetz, Science for the post-normal age, *Futures*, 25/7, Shtator 1993, f. 735–755.

7 Po aty.

8 Jerome R. Ravetz dhe S.O. Funtowicz, Post-Normal Science: an insight now maturing, *Futures*, 31/7, 1999, f. 641–646.



## NDËRLIKIMI

Le të marrim arsyen e parë. Pothuajse gjithçka me të cilën duhet të përballlemi në ditët e sotme, është e ndërlikuar. Nuk ka asgjë të thjeshtë për rregullimin e ekonomisë, sigurimin e furnizimeve tona me energji, apo edhe për të bërë diçka për përmbytjet që duket se mundojnë Britaninë vit pas viti. Një arsye për këtë, është se ne jemi një pjesë e vogël (dhe disa prej nesh do të mendonin: jo aq të rëndësishëm) në një shoqëri mbarëbotërore. Për të 'rregulluar' gjërat këtu në Britani, gjithashtu duhet të bëjmë diçka rreth tyre, por në vende të tjera dhe në nivel botëror. Për shembull, për të siguruar furnizimet tona me energji, duhet t'i kushtojmë vëmendje çështjeve vendore dhe ndërkombëtare. Vendore do të nënkuptonte sigurimin e energjisë me çmim të arsyeshëm për shpenzuesit dhe shmangien e ndërprerjeve të pavullnetshme të furnizimit nga rastësitë, ose ndërprerje keqdashëse. Çështjet ndërkombëtare do të përfshijnë sigurinë që politika jonë e jashtme të mos jetë shumë kundërshtuese ndaj atyre të cilët ne mbështetemi për furnizimet tona me energji, si dhe shmangien e varësisë energjetike nga një minibashki e vogël kombesh. Por kjo është vetëm gjysma e ekuacionit. Gjithashtu, duhet të marrim masa rreth përhapjes së karbonit, t'i bëjmë jehonë energjisë me rendiment, të përshpejtojmë vendosjen e teknologjive me karbon të ulët dhe të sigurojmë që tregjet e energjisë të mbeten mjaft konkurruese dhe të mos përdoren në mënyrë përçarëse nga keqdashësit. Sjellja e të gjithë këtyre elementeve të ndryshëm të sigurisë sonë energjetike, në një politikë mirëkuptimi, nuk është aspak e lehtë. Ndërlikimi është një ndikim anësor natyror i faktit se shumica e shqetësimeve tona janë të një shkalle botërore.

**PËR MË TEPËR, GLOBALIZIMI E SHTON NDËRLIKIMIN, JO THJESHT DUKE NA BËRË TË NDËRVARUR, POR, GJITHASHTU, DUKE RRITUR NDËRLIDHJET MIDIS NESH.**

Në një botë të globalizuar, gjithçka është e lidhur me gjithçka tjetër. Asgjë nuk gjallon dhe nuk ndodh veçmas. Le të marrim, fjala vjen, shfaqjen e fundit të gripit të derrit. Nuk është thjesht një shqetësim shëndetësor dhe mjekësor, është edhe shqetësim për bujqësinë e qëndrueshme. Ndoshta nuk është rastësi, që epiqendra e shpërthimit, qyteti meksikan La Gloria,



është vetëm pesë milje larg një ngrehine madhështore industriale të derrave, në pronësi të prodhuesit më të madh të derrave në botë, *Smithfield Foods*. Por, sigurisht, *Smithfield Foods* nuk do të prodhonte në masë mish të lirë të fabrikuar, nëse blerësit nuk do ta gëlltisnin me kënaqësi. Pra, gripi i derrit është gjithashtu një shqetësim - një nga pasojat e asaj se çfarë dhe si hamë, me çmimin e lirë që kërkojnë blerësit - gjithnjë më i lirë, më i bollshëm dhe i arritshëm gjatë gjithë vitit, pavarësisht nga stina. Gjithashtu, do të kishte mbetur në nivel vendor, nëse pushuesit dhe tregtarët endacakë nuk do të ishin vendosur në të gjithë globin. Në fakt, një sëmundje vendore u shndërrua në një sëmundje që preku gjithë popullatën, falë shpejtësisë me të cilën udhëtojmë në pjesë të ndryshme të botës. Ndërsa pandemia përhapej, u shndërrua në çështje të edukimit shëndetësor. Prandaj dhe reklamat në televizion na thonë të mbulojmë gojën kur teshtijmë dhe, papritur, shfaqet xheli për pastrimin e duarve në vende publike.

Sikur të mos mjaftonte kjo, ka një prirje tjetër që i bën gjërat edhe më të ndërlikuara. Në kohët pasnormale, gjërat ndryshojnë me shpejtësi dhe shpesh ndodhin njëkohësisht. Vini re, për shembull, se si ekonomia botërore u tjetërsua gjatë një fundjave të vetme të 13-14 shtatorit 2008. Qeveria amerikane, duke luftuar me dobësinë dhe paqëndrueshmërinë në të gjithë qarkun ekonomik, vuri re se detyra e përbashkët ishte madhështore. Ndërlidhjet me ndërlikime midis bankave dhe institucioneve financiare nuk pranonin zgjidhje të kufizuara dhe të pjesshme. Pasi u shpëtua një bankë, duke mohuar shpëtimin e një tjetre (*Lehman Brothers*), u përshkallëzua vala e rënies së përgjithshme të bankave. Bankat amerikane po shembeshin në të njëjtën kohë dhe për të njëjtat arsye, si bankat në Britani dhe gjetkë. Sapo ra një bankë, duke mbyllur dyert e saj, shembja e sektorit financiar ishte mbarëbotërore dhe e njëkohshme.

Gjërat po ndodhin njëkohësisht edhe nga pikëpamja gjeopolitike. Fuqia amerikane po tkurret, ndërsa Kina po vesh mantelin e një superfuqie të re, ndërkohë që India fuqizon muskujt e saj ekonomikë, Brazili shfaqet në horizont dhe Rusia rifiton besimin në vetvete. Ndikimi i Japonisë bie, kurse Europa fuqizon risinë e saj në pavarësinë e përbashkët, ndërkohë që lojtarë josttetërorë (që nga shumëkombësh, deri tek Al-Kaeda) rriten në fuqi dhe ndikim, teksa pasuria dhe fuqia përkatëse lëviz nga Perëndimi, në Lindje.<sup>9</sup> Kur ndodhin kaq shumë ndryshime në të njëjtën kohë dhe bashkohen zhvillime e modele të shumta, ne e kemi të vështirë për të kuptuar shfaqjen e ndërlikimeve dhe pothuajse të pamundur t'i përballojmë.

9 Martin Jacques, 'No one rules the World', *New Statesman*, 30 Mars 2009, f. 22-23.



Natyra e çështjeve me të cilat përballemi, është shkruar me mjeshtëri nga filozofi australian, Poll Killies.

“Për të kuptuar plotësisht një metodë të ndërlikuar”, - shkruan ai, “ne duhet ta kuptojmë atë në të gjitha ndërlikimet e saj. Për më tepër, për shkak se metodat e ndërlikuara janë sisteme të hapura, duhet të kuptojmë mjedisin e plotë të sistemit, përpara se të kuptojmë vetë sistemin dhe, natyrisht, mjedisi në vetvete është i ndërlikuar. Nuk ka asnjë mënyrë njerëzore për ta bërë këtë. Njohuritë që kemi për metodat e ndërlikuara, mbështeten në modelimin që ne u bëjmë këtyre metodave, për t’u vënë në punë si modele dhe jo thjesht si përsëritje të metodës, prandaj ato duhet ta *zvogëlojnë* ndërlikimin e metodikës. Kjo do të thotë se disa anë të këtyre metodave lihen gjithmonë jashtë vëmendjes. Çështja vështirësohet nga fakti se ajo që është lënë jashtë, ndërvepron me pjesën tjetër të metodës, por jo në mënyrë drejtvizore. Për këtë arsye, nuk mund të parashikojmë se cilat do të jenë ndikimet e uljes së ndërlikimit, pa përmendur veçanërisht metodën dhe mjedisin ku ajo zhvillohet dhe tjetërsohet me kalimin e kohës.”<sup>10</sup>

Pra, ndërlikimi, që ka po aq ndikim në fizikë dhe biologji, sa ç’ka në mjedis, ekonomi, siguri dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, na jep një mësim të rëndësishëm, se ideja e mbizotërimit dhe e sigurisë janë duke u vjetruar. Nuk ka asnjë model të vetëm sjelljeje, mënyrë të menduari ose metodë që mund të japë një përgjigje për të gjitha sëmundjet tona të ndërlikura dhe të ndërlikuara. “Tregu i lirë” është po aq vegulli, sa edhe mendimi se shkenca apo shteti liberal do të na shpëtojnë nga ngërçi i tanishëm. Bota ka qenë prej kohësh një vend i ndërlikuar, gjithmonë i ndërlikur. Periudha e globalizimit që po jetojmë, megjithatë, ndryshon nga shkalla, thellësia e ndërlikimeve dhe nga pasojat e kundërveprimet e menjëherëshme. Në kohën tonë, ne nuk e kemi më luksin e kohës për të menduar, për të vëzhguar dhe për t’iu përshtatur përfundimeve të padëshiruara, për të shqyrtuar dhe udhëhequr me njëfarë rregulli. Njohja e thjeshtë e faktit se të gjitha çështjet tona janë në thelb të ndërlikuara, na mëson vlerën e modës së vjetër dhe shumë të lënë pas dore: përlulësinë.

## ÇORODITJA

Ndërlikimi është pararendës dhe një kusht i domosdoshëm për dukurinë tonë të dytë: çoroditjen. Kohët pasnormale përjetohen gjatë një periudhe çoroditëse, ku nxitimi është normë, parashikueshmëria është e rrallë dhe

10 Paul Cilliers, ‘Complexity, deconstruction and relativism’, *Theory, Culture & Society*, 22 (5), 2005, f. 255–267.



ndryshimet e vogla mund të çojnë në pasoja të mëdha.<sup>11</sup> Sjellja e çoroditur nuk është një dukuri e pazakontë, ajo ka gjalluar gjithmonë në rastet e motit. Por është mjaft e pazakontë të shohësh qytetërime, shoqëri të tëra ose të gjithë banorët e botës të sillen sipas urdhëresave të teorisë së çoroditjes.

Arsyeja kryesore është natyra e ndryshuar, shtrirja dhe veprimtaria e rrjeteve. Ne jemi më të lidhur dhe të ndërlidhur se çdo kohë tjetër në histori. E gjithë bota është një rrjet i kryqëzuar nga rrjete njerëzish, grupesh, shoqatash, institucionesh të lidhura vazhdimisht me njëri-tjetrin me e-mail, renditje elektronike, lajme në internet, telefona dore, video konferenca, përditësime faqesh, *Twitter*, *Facebook*, *My Space*, televizione digjitale ndërvepruese dhe transmetime lajmesh 24 orëshe. Vështirë se ka një qoshk në botë, ku mund të rrimë vetëm. Telefoni në xhepin tuaj u tregon atyre që duan të dinë saktësisht se ku jeni dhe jua mundëson të lidheni me cilindo, në çdo kohë, (pothuajse) kudo. Gjithnjë e më tepër, ndërlidhja po bëhet e menjëhershme, gjithëpërfshirëse dhe gjithnjë e pranishme. Në të vërtetë, duket se në ditët e sotme nuk ndërlidhemi për të jetuar, por jetojmë për t'u ndërlidhur.

Natyrisht, nuk është vetëm njeriu që lidhet vazhdimisht. Të gjitha institucionet kryesore në shoqëri tani janë të kyçura në rrjet. Ekonomia botërore është tërësisht e digjitalizuar, kështu që tani nuk janë tregtarët, por programet kompjuterike të krijuara për të vepruar në çast, ato që, në fakt, bëjnë tregtinë. Rrjetet e energjisë elektrike, shërbimet bashkiake, transporti, madje edhe institucionet e qeverisjes janë të gjitha të kyçura në rrjet. Nuk ka asgjë të rëndësishme e cila nuk është e lidhur me një rrjet apo një tjetër, që do të thotë se kuptimi i 'sigurisë kombëtare' merr një përmasë krejtësisht të re.<sup>12</sup>

Meqenëse çdo gjë është e lidhur dhe e ndërthurur me çdo gjë tjetër, një ngecje çfarëdo shkakton një ndikim zinxhir, duke shqetësuar pjesët e tjera të rrjetit, madje duke shembur të gjithë rrjetin. Përveç kësaj, mundësia për një vlerësim të sigurtë, se gjërat do shumohen me shpejtësi dhe në mënyrë të rrezikshme në progresion gjeometrik, është e pamat. Këtu hyjnë ato kushte fillestare të vogla, të parëndësishme, që mund të shkaktojnë trazira të mëdha, madje edhe një ndryshim i vogël mund të çojë në rrënim të përsheptuar. Një virus kompjuterik, një grevë, një dorëheqje e vetme, mund të shkaktojë një dobësim zinxhir që mund të ndalojë vendnumëro një komb, ose të gjithë botën. Merreni me mend, se sa kompani

11 Ziauddin Sardar, *Introducing Chaos*, Icon Books, Londër, 1999.

12 Neyla Neyla Arnas, ed., *Fighting Chance: Global Trends and Shocks in the National Security Environment*, National Defence University Press and Potomac Books, Washington DC, 2009.



konkurruese, organe rregullatore, institucione të shëndetit dhe sigurisë, ministri qeveritare dhe grupe pasagjerësh përbëjnë të gjithë rrjetin hekurudhor britanik, të gjitha me qëllime të ndryshme, plane të kundërta dhe zgjidhje të ndryshme. Për shembull, një lemzë e vogël në një pikë të caktuar të rrjetit, një grusht gjethesh mbi shina shkakton tronditje dhe, ndonjëherë, disa fish në të gjithë rrjetin, për të mos përmendur udhëtarët që vuajnë gjatë.

Shembulli më i dukshëm i sjelljes çoroditëse është dhënë nga tregjet në bursa. Një rrjet kompjuterësh i lidh të gjitha bursat në një treg të vetëm botëror. Investimet, zhvendosja e mallit, shit-blerjet ndodhin sa hap e mbyll sytë me shenja elektronike. Çdo ditë e më shumë ka vlerësime të vazhdueshme në prapavijë nga të gjitha pjesët e sistemit ekonomik botëror. Ndryshimet e vogla kanë rëndësi. Uljet dhe ngritjet shkaktojnë reagime. Programet kompjuterike që nxisin tregtimin, u përgjigjen shifrave, pavarësisht shkakut. Fuqia e lirisë së veprimit rrjedh nga metoda në dobi të kundërveprimit të menjëhershëm dhe të pashmangshëm, edhe kur kjo është krejtësisht e paparashikueshme. Ne nuk e dimë gjithmonë, se cili ndryshim i vogël është i rëndësishëm, saktësisht, se cilat rrethana vendore fare larg e kanë shkaktuar, ose ku do të na çojnë. Ndjesia e tregut u përgjigjet porosive të shit-blerjes të marra nga kompjuteri dhe kjo mund të shumëfishojë shpejt ndryshimet e vogla, duke çuar drejt një krize të thellë ekonomike. Nga këndvështrimi i çoroditjes, kriza e tanishme ekonomike ishte një rastësi që pritej të ndodhte dhe ishte parashikuar nga shumë dijetarë në fusha të ndryshme. J.K. Gallbreith, ekonomisti i sprovuar që e tregoi veten gjatë Rënies së Madhe (1930) dhe gjatë Ujdisë së Re, kishte paralajmëruar për më shumë se një dekadë përpara vdekjes së tij, në vitin 2006, se fluska ekonomike do të shpërthente në mënyrë të pashmangshme.<sup>13</sup>

Librat që renditin historikun e fluskave ekonomike, larmia e tulipaneve në shekullin e XVII dhe Deti i Jugut i shekullit të XVIII, u kthyen në paralajmërime të koduara joshëse, të gjendura nëpër librari.

Sjellja e çoroditur në rrafshin shoqëror dhe kulturor është pak më e vështirë për t'u dalluar. Ne kishim një parandjenjë sjelljeje të çoroditur gjatë revolucionit të hareshëm të vitit 2004 në Ukrainë, revolucionit të vitit 2005 në Liban dhe, së fundmi, në përpjekjen për revolucionin e gjelbër në Iran. Kur tubuesit fillojnë të sillen si një rrjet i vetëm dhe krijojnë ndjesi shprese, nëpërmjet përdorimit të internetit dhe telefonit të dorës, ata e rritin me shpejtësi numrin e tyre dhe marrin një vrull të pandalshëm.

13 John Kenneth Galbraith dhe Nassim Nicholas Taleb, *The Great Crash: 1929*, Penguin, Londër, 1992 (botim original, 1954).





Shembulli më i gjallë në Britani, se si rrjetet shoqërore mund ta kthejnë një rrethanë të zakonshme, në një rrethanë çoroditëse, janë tubimet e benzinës së shtatorit 2000. Këto tubime nisën si një pakënaqësi e thjeshtë dhe e paorganizuar. Por çdo shofer kamioni që tubohej, po fliste përmes telefonit të tij, ose i dërgonte e-mail apo porosi me shkrim çdo shoferi tjetër kamioni. Ndërlidhja e menjëhershme i ktheu një sërë tubimesh në një rrjet të ndërlidhur me ndjesinë e shpresës. Kështu, i njëjti grup i vogël shoferësh ishte në gjendje të lëvizte shpejt dhe lehtë nga një depo në tjetrën dhe ishin në gjendje të ndalonin kamionët që dilnin nga depot. Ky është vetorganizim rastësor në veprim. Ashtu si moti, tubimi i shoferit të kamionit dukej i njëjtë nga të gjitha këndvështrimet. Si qeveria, ashtu edhe qytetarët e panë atë si një ngjarje bashkërisht të rrëmbyer, të çrregullt, që nuk duhej marrë shumë seriozisht. Por, ndërsa tubimi mori përmasa çoroditëse, ai pothuajse e ndaloi në vend numëro Britaninë.

Falë telefonave të dorës, e-mail-eve, përditësimeve dhe lajmeve 24-orëshe, ne jemi vazhdimisht në dijeni. Prandaj, jemi të përgatitur për të kundërvepruar menjëherë, të pajisur me mjetet që na e mundësojnë gjallërimin e një modeli të ri të kundërveprimit zinxhir. Sa më shumë të zgjerohet teknologjia e ndërlidhjes për ta bërë njoftimin sa më të lehtë, më të shpejtë, të menjëhershëm dhe të vetvetishëm, aq më shumë ka të ngjarë që ne të shkaktojmë frikë të vetorganizuar dhe ta jetojmë jetën në zgrip të greminës. Frikërat e vetorganizuara, ashtu si revolucionet popullore të vetorganizuara, janë dukuri gjithnjë e më të mundshme që nuk parashikohen. Ato janë një mundësi e përherëshme në horizontin e pritjes, për t'u përfaqësuar në një gjendje shoqërore të paqëndrueshme dhe të dobësuar. Ato piketojnë, ndikojnë dhe ndryshojnë ecuritë dhe llogaritjet e qeverisjes dhe vendimmarrjes, pa marrë parasysh, nëse ato nxjerrin në pah ose jo çështje që janë jetike, anësore, thjesht pjesore dhe me qëllime vetjake, apo edhe të parëndësishme dhe, për këtë arsye, përligjin ose prodhojnë ndryshime thelbësore.

**ASHTU SI NDËRLIKIMI, EDHE ÇORODITJA NA MËSON NJË GJË  
THEMELORE: PËRGJEGJËSIA VETJAKE DHE SHOQËRORE JANË  
VEÇANËRISHT TË RËNDËSISHME PËR MBIJETESËN TONË TË  
PËRBASHKËT.**

Veprimet e njërës apo tjetrit, që nga politikanët e paskrupullt dhe deri te një nëpunës i lënë pas dore, mund të shkaktojnë paqëndrueshmëri dhe



trazira të thella. Nga ana tjetër, mëvetësia, ideja që një njeri mund të ndjehet i vetëplotësuar dhe të bëjë gjithçka që dëshiron, është një mjet fatkeqësie. Dukuria e lirisë së veprimit për një njeri të caktuar në dëm të shoqërisë lulëzon në rrethanat e një mjedisi pushteti dhe renditjesh, rrjetesh të ndërlikuara dhe të ndërlidhura në shpërpjesëtim. Kjo liri fuqizon të fuqishmit; ata që janë më të zotët në përdorimin e levave të pushtetit, për t'u dhënë pushtet grupeve që zgjedhin vetë. Nuk ka asnjë rregull të pashmangshëm apo domosdoshmëri që e pengon një fuqizim të tillë vetjak, për të qenë gjithëpërfshirës, i gjerë dhe i shpërndarë në mënyrë të barabartë, ose i përkushtuar në përfitime të përbashkëta. Të mos harrojmë se iu desh një numri përkatësisht të vogël bankierësh të babëzitur për të vepruar, që çoi në rënien e ekonomisë në të gjithë botën. Një grup edhe më i vogël terroristësh të 11 shtatorit shkaktoi një kundërveprim zinxhir që çoi në ngritjen e ideologjisë neokonservatore në SHBA dhe Europë, ndryshoi rrjedhën e historisë irakiane, afgane dhe pakistaneze, ripërcaktoi mendimin lidhur me sigurinë, nxori në pah kufijtë e fuqisë amerikane dhe nxiti tubime masive dhe mospajtim në të gjithë botën, për të mos përmendur miliona të vvarë, gjymtuar ose të kthyer në të pastrehë. Në kohët pasnormale, bota vërtet mund të shkatërrohet nga veprimet e disa njerëzve të pezmatuar.

## MOSMARRËVESHJET

Një botë e ndërlikuar, e lidhur në rrjet, me qëllime dhe ideologji të panumërta që përplasen, me përcaktime dhe dëshira që sillen në mënyrë të çoroditur, nuk mund të bëjë asgjë më shumë sesa të nxisë mosmarrëveshje – dukuria jonë e tretë. Është prodhim natyral i rrjeteve të shumta shoqërore dhe kulturore në kundërshti me njëra-tjetrën, që luftojnë për mbizotërim. Në fund të fundit, siç theksoi Njutoni, çdo veprim ka një tjetër veprim të barabartë dhe të kundërt. “Mosmarrëveshjet tregojnë gjithashtu, faktin se çdo gjë, çdo përjasje, kushton”, thotë Ravetz. “Pavarësisht se si mund ta përfytyrojmë përparimin, sa i dobishëm mund të mendojmë se është, ai gjithmonë ka ndikime anësore të dëmshme. Nuk ka përmbushje të së mirës, pa ndonjë prodhim të së keqes”.<sup>14</sup> Dhe mosmarrëveshjet mund të vijnë në të vërteta të ndryshme. Ato mund të jenë mikluese, ku forcat e kundërta mbahen gjallë në baraspeshë; ose shkatërruese, ku lufta çon në shembje; apo

14 Jerome R. Ravetz dhe Silvio O. Funtowicz, 'Emergent complex systems', *Futures*, 26 (6), 1994, f. 568-582.



krijuese, ku mosmarrëveshjet zgjidhen përmes tjetërsimit. Në kohët pasnormale, ka dy mosmarrëveshje që kanë nevojë për vëmendjen tonë të veçantë.

Mosmarrëveshja e parë lidhet me ndryshimin. Tani është në modë të arsyetohet se po kalojmë përmes një ndryshimi të pashembullt. Gjërat kanë ndryshuar gjithmonë, por nuk kanë ndryshuar me ritmin e përsheptuar që po shohim në ditët e sotme. Le të marrim, për shembull, teknologjinë e të dhënave që çdo vit dyfishon fuqinë e saj sipas çmimit, rendimentit dhe aftësisë së zotërimit të një rrethane. Në 25 vjet, do të ishte shumëzuar me një miliard, teksa ne zhvendosemi nga transistorët, në një teknologji më të fuqishme, siç është teknologjia *nano*, ose llogaritja molekulare. Në mënyrë të ngjashme, aftësia jonë për të renditur të dhënat gjenetike është dyfishuar çdo vit. Ndërsa u deshën 15 vjet për të renditur SIDA-n, virusi Sars u rendit brenda 31 ditësh. Pra, nuk është vetëm se ndryshimi është i shpejtë, por vetë shkalla e tanishme e ndryshimit po ndryshon – treguesi i përsheptimit tashmë është kthyer në normë.

Megjithatë, pjesë të mëdha të planetit dhe pjesë të jetës sonë shoqërore mbeten pothuajse të pandryshuara. Struktura e shoqërisë britanike, bashkë me përfitimet e saj klasore dhe paragjykimet në rritje e sipër ndaj arsimimit në Iten dhe Oksbrixh, nuk ka ndryshuar për shekuj. Gjykata e Lartë Britanike e sapokrijuar përbëhet nga ligjvënës ku vetëm dy prej të cilëve që janë përfaqësues nga Skocia dhe Irlanda e Veriut, nuk ishin arsimuar në kolegjet e Oksbrixhit. Varfëria e thellë në Afrikë është po aq e keqe, sa ç'ishte në kohët e pushtimit, nëse nuk është edhe më keq. Shpërndarja e pasurisë brenda kombeve është po aq e anuar drejt ajkës, sa ç'ka qenë gjithmonë.<sup>15</sup> Në të vërtetë, gjallëria e shpërpjesëtimit po rritet vetë. Periudha pas Luftës së Dytë Botërore përjetoi rritje të nivelit ekonomik, shoqëruar me shpërndarje më të gjerë të pasurisë, duke prodhuar shoqëri më të drejta, veçanërisht në vendet e zhvilluara dhe të industrializuara. Që nga vitet 1980, shpërndarja e pasurisë jo vetëm që është kthyer në modelet e shekullit të XIX, por ka vazhduar një përparim gjithnjë në rritje përtej këtyre normave. Dallimi midis shpërblimit të drejtorit të një ndërmarrjeje, me atë të të gjithë punonjësve të marrë së bashku, është zakonisht më e madhe, deri në 400 herë. Pjesa më e madhe e pasurisë së vendeve si Britania dhe SHBA-ja, është e përqendruar në duart e 1 për qind të eprorëve, pra, më shumë sesa zotërohet nga 90% e pjesës tjetër të popullsisë të marrë së bashku. Në një botë me ushqime të bollshme, rreth 850 milionë njerëz ende shkojnë në

15 John Hills, *New Inequalities: The Changing Distribution of Income and Wealth in the United Kingdom*, Cambridge University Press, Cambridge, 1996.



shtrat të uritur çdo natë.<sup>16</sup> Megjithëse gratë priren të jenë prodhueset kryesore të ushqimit të vendeve në zhvillim, më shumë se 60 për qind e të uriturve në botë janë femra. Luftërat dhe mosmarrëveshjet e dhunshme janë të pranishme si kurrë më parë. Sa më shumë që ndryshojnë gjërat, aq më shumë duket se mbeten njësoj.

Mosmarrëveshja e dytë ka të bëjë me njohuritë.

**NDËRSA NJOHURITË TONA JANË SHTUAR DHE PO RRIEN ME SHPEJTËSI MARRAMENDËSE NË TË GJITHA FUSHAT, EDHE NE, MESA DUKET, JEMI MË TË PADITUR SE KURRË.**

Vini re, se sa e kufizuar është njohuria jonë për kulturat e tjera - Islamin, fjala vjen; ose për kulturat vendase të Amerikës Latine; apo për larminë mahnitëse të Indisë e Kinës. Rritja e frikës ndaj së panjohurës në mbarë botën nuk është vetëm shqetësuese, por një tregues i padijes së thellë. Ndërsa ne shigjetohemi me të dhëna për pothuajse gjithçka dhe çdo temë, kemi aftësi shumë të kufizuara për të dalluar, në të vërtetë, se çfarë është e rëndësishme dhe çfarë është e parëndësishme.

Për më tepër, kohët pasnormale i kanë shtuar edhe një përmasë tjetër padijes sonë. Shumë çështje bashkëkohore kanë një pasiguri të brendshme e cila mund të zgjidhet vetëm diku në të ardhmen. Le të marrim virusin e gripit të dërrit. Nuk e dimë saktësisht, se si do të ndryshojë ky virus në të ardhmen e afërt. Kjo është diçka që ne nuk mund ta dimë, derisa virusi të ndryshojë vërtet, dhe ai mund të ndryshojë në një sërë formash dhe mënyrash. E njëjta gjë mund të thuhet për ushqimin që është përshtatur gjenetikisht. Nuk mund të jemi krejtësisht të sigurtë, nëse një ushqim i tillë është plotësisht i padëmshëm, derisa të ketë kaluar nëpër zinxhirin ushqimor dhe të bëhet pjesë e ushqyerjes sonë të përditshme. Këto janë gjëra që mund t'i zbulojmë vetëm dhjetë apo njëzet vjet më pas. E njëjta gjë mund të thuhet për teknologjinë *nano* të tjetërsimit të atomeve dhe molekulave. Shumë prej prodhimeve që blihen, përdorin thërmija *nano*, që nga kremrat e lëkurës e deri te pastruesit e duarve. Vetëm nëpërmjet përdorimit të tyre të qëndrueshëm gjatë një periudhe kohore do të zbulojmë ndikimet anësore të tyre të vërteta, të dorës së dytë dhe të tretë. Deri në atë kohë, duhet të jetojmë me rreziqet dhe padijen tonë...

16 Per Pinstrup-Anderson dhe Fuzhi Cheng, 'Still hungry: one-eighth of the world's people do not have enough to eat', *Scientific American*, Shtator 2007, f. 96-103.



Duke qenë se nuk mund t'i veçojmë problemet e ndërlidhura dhe t'i zgjidhim ato në sasi të rregullta, na del se çfarëdo zgjidhje që prodhojmë, ka gjithmonë ato pjesë shtesë që nuk zgjidhen dhe nuk mund të zgjidhen. Shpesh, as nuk jemi të vetëdijshëm për pjesën e pazgjidhur të çështjes, derisa ajo shfaqet në një formë tjetër, ose të jetë tepër vonë. Kriza në industrinë e makinave është një shembull i mirë. Pjesa më e madhe e përpjekjeve tona janë përqendruar drejt shpëtimit të prodhuesve të makinave, si GM, Vauxhall dhe LDV. Kjo është një pjesë thelbësore e sektorit të prodhimit, një pjesë jetike në ekonominë tonë dhe mijëra vende pune varen prej tyre. E dimë që tymrat e shkarkimit luajnë një rol të madh në ngrohjen globale dhe benzina e lirë po zhduket shpejt, kështu që ne kërkojmë që prodhuesit e makinave ta zhvendosin prodhimin drejt makinave elektrike, ose automjeteve të përziera. Por në përpjekjen për të zgjidhur hallet e prodhuesve të makinave, ekonomisë, punësisimit, mjedisit dhe burimet natyrore, ne anashkalojmë një përbërës jetik të problemeve të ndërlidhura: vetë makinën. Në fund të fundit, sa makina mund të vendosim fizikisht në tokë? Çfarë mund të zëvendësojë makinën, si një mënyrë e qëndrueshme transporti në të ardhmen? Si do të dukej një botë pa makina? Siç tregojnë Kingsli Denis dhe John Ari në studimin e tyre të shkëlqyer, *Përtej makinës*<sup>17</sup>, thjesht nuk e dimë sepse kjo përmasë e problemit është plotësisht e përjashtuar nga këndvështrimi ynë. Për të zbuluar mundësitë, duhet të mendojmë të pamendueshmen dhe të bëjmë pyetje që janë errësuar nga padija jonë. Në përgjithësi, mbetemi të paditur rreth mundësive dhe rasti për të fituar njohuri të reja humbet. Padija nuk zgjidhet me anë të një kërkimi të zakonshëm, prandaj nuk kemi asnjë ide për qenësinë e saj.

**PRA, NE PËRBALLEMI ME NJË PADIJE TË TREFISHTË, OSE PADIJE NË FUQI TË TRETË: PADIJA E PADIJES SONË; PADIJA E RRËNJOSUR THELLË MBI RREZIQET E MUNDSHME TË ZHVILLIMEVE TË FUNDIT; PADIJA E LINDUR NGA MBINGARKESA E TË DHËNAVE. NDRYSHE NGA PADIJA E ZAKONSHME, QË ËSHTË NJË ZBRAZËTI PËR T'U MBUSHUR, PËRMES KËRKIMEVE DHE NJOHURIVE; TË MERRESH ME PADIJEN NË FUQI TË TRETË KËRKON MËNYRA KREJTËSISHT TË REJA TË MENDIMIT.**

17 Kingsley Dennis dhe John Urry, *After the Car*, Polity, Oxford, 2009.



Mosmarrëveshjet mund të jenë nga më të çuditshmet, por ato kryejnë një punë shumë të dobishme. Ato na ofrojnë një mundësi për të parandaluar arsyetimin e tepërt të çështjeve ose rrethanave. Ne jemi të detyruar të marrim parasysh prirjet, pikëpamjet, faktet, hamendësimet dhe teoritë që përplasen dhe të kuptojmë se bota nuk është e përshtatshme për zgjidhje njëpërmasore, ndonëse ky nuk është aspak një përfundim i paramenduar. Përcaktimi më i përmbledhur i pohimit të padijes në fuqi të tretë doli nga ish-sekretari amerikan i mbrojtjes, Donald Rumsfeld, i cili e bëri të qartë gjendjen, pa e ndryshuar kurrë kursin njëpërmasor dhe të pamëshirshëm të politikës që ai mendoji fillimisht.<sup>18</sup> Si ndërlikimi, ashtu edhe mosmarrëveshjet, na lënë të kuptojmë se çdo çështje e caktuar ka përmasa të shumëfishta dhe se asnjë pikëpamje e pjesshme dhe e posaçme nuk mund të përfshijë tërësinë. Nga kjo, rrjedh se një çështje e caktuar nuk ka domosdoshmërisht një përgjigje “të saktë” ose “të gabuar”. Në të vërtetë, në kohët pasnormale logjika e Aristotelit dhe jo përgjigjja është pjesë e problemit. Për të kuptuar më mirë çështjen, duhet të kemi parasysh se përgjigjet mund të përfshijnë si të mirën dhe/ose të keqen, ashtu edhe asnjërën. Një logjikë e tillë e katërfishtë na mundëson të mendojmë shumëfish dhe kështu, mund të zotërojmë më mirë çështjet e ndërlikuara me kundërshti të tejzgjatura. Mënyra më e mirë e të menduarit në shumëfish është përmes bashkëbisedimit dhe shqyrtimit. Shumica e filozofive joperëndimore mbështeten në mënyra të tilla të të menduarit dhe ne mundemi (po të duam) të fitojmë shumë, nëse u japim rëndësinë e duhur traditave të tilla. Edhe një kuptim shumë themelor i një çështjeje kërkon një bashkëbisedim rreth përmasave të ndryshme të saj, që nënkupton një sërë këndvështrimesh dhe qëllimesh të të aftësuarve - fëmijëve dhe të rriturve - jashtë besimit fetar, njerëzve me prejardhje të ndryshme shoqërore dhe kulturore, ide të ndryshme mbi moralitetin, madje edhe shqyrtimin e nevojave të gjallesave jo-njerëzore. Mosmarrëveshjet mund të mos zgjidhen me rrahje mendimesh, por sigurisht që mund të zbuten duke u marrë vesh përmes mirëkuptimit të përgjithshëm.

## PASIGURITË

Kur mosmarrëveshjet, ndërlikimi dhe çoroditja ndërthuren me ndryshimin përsheptues, e vetmja rrjedhojë e caktuar është pasiguria. Në kohë

18 [http://en.wikipedia.org/wiki/Unknown\\_unknown](http://en.wikipedia.org/wiki/Unknown_unknown); dhe [www.youtube.com/watch?v=RpSv3HjpEw](http://www.youtube.com/watch?v=RpSv3HjpEw)



normale, pasiguritë janë të vogla dhe të zotërueshme, por në kohët pasnormale pasiguria zë vendin qendror.<sup>19</sup> Meqenëse gjithçka është e ndërlikuar, e ndërlikuar dhe e çoroditur dhe ndryshon me shpejtësi, asgjë nuk mund të përshkruhet me siguri. Parashikimet e modës së vjetër, mbi të cilat mbështetet kaq shumë ekonomia dhe mënyrat tona të veprimit, nuk kanë asnjë vlerë në rrethana ndryshimesh të shpejta, të papritura dhe të panjohura. Parashikimi i rritjes së Thesarit për gjashtë muajt e ardhshëm do të kundërshtohet menjëherë nga Banka e Anglisë, ndërkohë që një sërë institutesh kërkimore të besueshme do të nxjerrin parashikime të ndryshme kundërshtuese nga studimet e tyre. Të gjithë ato gabojnë dhe kanë të drejtë, të dyja dhe asnjëra. Ne duhet të përballemi me pasiguritë e natyrshme në këto parashikime, për t'i kuptuar ato. Pasiguria mund të jetë e vetmja gjë për të cilën mund të jemi të sigurt, por nuk është një themel i mirë dhe as i pranueshëm politikisht apo shoqërisht, mbi të cilin mund të shqyrtohen zgjedhjet vërtet të vështira.

Në çdo çështje të caktuar vendimmarrjeje, ka një mori pasigurish me të cilat duhet të përballemi. Le të kujtojmë rastin e gjedhit (*bse*), një sëmundje që preku trurin e lopëve, e cila u shfaq në Britaninë e Madhe, në vitet 1980. Tani dihet se është shkaktuar nga bujqësia e tejshfrytëzuar dhe mënyrat jonatyrore të të ushqyerit (kafshë barngrënëse që ushqehen me mbetjet e deleve dhe lopëve). Ndërsa përhapej epidemia, këshilltarët shkencorë duhej të fshihnin pasiguritë e vlerës përfundimtare ekonomike, çmimin për kontrollin me therjen e tyre bashkërisht dhe mundësinë pa gjasë, por ende të imagjinueshme, të përhapjes së saj te njerëzit. Edhe pasi macet u sëmurën në vitin 1990, kishte ende pasiguri për rrezikun e kësaj sëmundjeje për njerëzit. Në vitin 1996, kur u vërtetua një formë njerëzore e kësaj sëmundjeje, shkurtimisht pati një frikë të përgjithshme dhe kombi qetësisht priti për të parë nëse do të kthehej në një tragjedi të veçantë, apo në një tmerr mbarë shoqëror. Deri në shkurt 2009, 164 njerëz kishin vdekur në Britani nga përfshirja e një forme njerëzore të *bse*-së, e njohur si sëmundja Kroitsfelt-Xhakob.

Pasiguritë rëndohen në pothuajse çdo veprimtari të planifikuar. Për shembull, pas përmytjeve të vitit 2008 në Britani, përmytuesit duhej të vlerësonin mundësinë e ardhshme të përmytjeve në të njëjtat hapësira, pikëpamjet për mosmarrëveshjet midis hapësirave (parandalimi i përmytjeve në rrjedhën e sipërme mund të kërcënojë rrjedhën e poshtme), kërcënimet ndaj vlerës së pronës dhe tregtive, si dhe përballimi i çështjeve lidhur

19 Gabriele Bammer dhe Michael Smithson, *Uncertainty and Risk: Multiple Perspectives*, Earthscan, Londër, 2009.



me sigurimet dhe përgjegjësinë për dëmet në të shkuarën dhe në të ardhmen. Secili përbërës i çështjes kishte pasiguri të thella me të cilat duhej të përballlej.

Pasiguritë paraqesin mundësi dhe rreziqe të mëdha edhe në shkallë botërore. Duke rrezikuar në lidhje me ndikimin e pasigurive, disa institucione, si fondet mbrojtëse dhe shfrytëzuesit e monedhës, mund të nxjerrin fitime të pamata. Në kohët pasnormale, njerëz që veprojnë në nivel botëror, mund të fitojnë shuma marramendëse me një ritëm mahnitës. Vini re shtimin e papritur të miliarderëve kohët e fundit. Në librin e tij, *Shtresa e pasanikëve*<sup>20</sup>, David Rothkopf, studiues në Qendrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Uashington, ka vlerësuar se gati 6000 njerëz janë bërë jashtëzakonisht të pasur gjatë dy dekadave të fundit. Këta njerëz që merren kryesisht me tregti dhe financa, kanë 'shumë më shumë pushtet, se çdo grup tjetër në planet'. Kjo shtresë e re pasanikësh është e vetëpasuruar dhe, si të gjithë paraardhësit e fuqizuar përmes pasurisë gjatë epokave të shkuara, i bashkohet renditjes sipas rëndësisë së pushtetit, të krijuar nga pasuria dhe përfitimet e trashëguara. Kjo ndikon në rritjen e shtrembërimeve dhe shpërpjesëtimeve të qenësishme në rendin shoqëror. Mirëpo, kjo shtresë e re pasanikësh shquhet për të qenit "të përshtatur botërisht, të varur botërisht, që veprojnë botërisht". Kjo shtresë frymon përtej besnikërisë dhe detyrimeve kombëtare, të cilat mund të përdoren dhe ndryshohen si vegla strategjike për të rritur më tej begatinë e tyre. Pasuria e tyre krijohet kryesisht duke qenë anëtarë të rrjeteve dhe duke luajtur me pasiguritë mbarëbotërore.

Ndërsa mundësitë janë të kufizuara vetëm në disa, rreziqet ndahen mes njëri-tjetrit nga pjesa tjetër e botës. Për një grusht njerëzish, lulëzim ekonomik nënkupton fatkeqësi të ardhurash dhe fatkeqësi mjedisore për shumë njerëz. Në një shoqëri pasnormale, pasiguria dhe rreziqet, e vërteta dhe ndjeshmëria bëhen një tipar kryesor i jetës së përditshme për popullsinë e botës. Në shoqëritë e varfra, rreziqet e reja dhe të saposhfaqura kthehen në luftë për jetë a vdekje dhe çojnë në shembjen e institucioneve të tanishme dhe mënyrave të të jetuarit. Ndikimi i ndryshimeve klimatike, për shembull, është shumë më i thellë në vendet në zhvillim. Sipas një njoftimi të ri, nga *Forumi Global Humanitar*, ngrohja e botës tashmë po shkakton 300.000 vdekje në vit dhe po prek drejtpërdrejt 300 milionë njerëz në vendet më pak të zhvilluara.<sup>21</sup> Mbi gjysma e të varfërve në botë janë të cenueshëm dhe rreth 500 milionë janë në rrezik të madh nga fatkeqësitë e motit që sjellin urinë, sëmundjet, varfërinë dhe humbjen e jetesës.

20 David Rothkopf, *Superclass: The Global Power Elite and What they are Making*, Farrar, Straus and Giroux, New York, 2008.

21 Global Humanitarian Forum, *Human Impact Report: counting the human cost of climate change*, Geneva, 2009.





Ndërthurja e padijes me pasigurinë, një prirje drejt çoroditjes, arsye-timet kundërshtuese dhe çështjet e ndërlikuara të sigurisë dhe rreziqeve – të gjitha këto nënkuptojnë se mundësitë tona për të bërë “tregti, si zakonisht”, tashmë janë rrezikshmërisht të vjetruara. Në kohët pasnormale, mënyrat tradicionale të të menduarit dhe të sjelljes nuk janë gjë tjetër, veçse një ftesë për fatkeqësi të afërt. Disa ide që mbështesin shoqërinë kapitaliste perëndimore, të tilla si “përparimi është thelbësor”, “modernizimi është i mirë” dhe “prodhimtaria është e nevojshme”, e kanë kaluar me kohë datën e “skadencës”.

## PËRPARIM, MODERNIZIM, RENDIMENT

Të marrim idenë e përparimit, mbështetur në rritjen e vazhdueshme dhe të përhershme ekonomike. Ka një kufi natyror, se sa larg mund të rritemi: kufijtë e fundmë të tokës sonë dhe kufijtë e burimeve tona. Por janë pikërisht përparimi drejtvizor i pambikëqyrrur dhe rritja e përshpejtuar, ato që na kanë sjellë në buzë të humnerës. Përparimi i mëtejshëm, shoqëruar me rreziqe të jashtëzakonshme botërore, do të na hidhte në humnerë. Ne duhet të kalojmë nga ideja e përparimit, në idenë e gjendjes së qëndrueshme. Pemët, për shembull, nuk vazhdojnë të rriten, pasi të kenë arritur lartësinë e tyre natyrore – po ta bënin këtë, do të nënkuptonte vetëshkatërrim. Shumë studime arkeologjike na lënë të kuptojmë se të njëjtin fat kanë pasur qytetërimet e mëparshme, qytetërimet e lashta që u rritën përtej mundësive mjedisore, mundësive mbartëse teknologjike, politike dhe shoqërore, duke nxitur fatkeqësi dhe shembje.<sup>22</sup> Të hamendësosh se ekonomitë tona do të vazhdojnë të rriten me një ritëm të përshpejtuar, do të ishte kulmi i marrëzisë. Nuk ka asgjë të re në idenë e kufijve të rritjes: ky është parashtrimi i vjetër *mal-tusian* që u turbullua në shekullin e XIX-të nga industrializimi dhe një revolucion bujqësor - për të mos përmendur fuqitë shtrembëruese dhe përcaktuese të mbizotërimit kolonial. Raporti themelor *Kufijtë e zhvillimit*, i prodhuar nga Klubi i Romës në vitet 1960, e bëri të gjithë idenë pjesë të ndër-gjegjes sonë.<sup>23</sup> Megjithatë, botimi i këtij punimi është ndjekur më pas, nga zgjerimi më i madh në historinë njerëzore i begatisë së blerësve, shoqëruar me shpërdorimin e shumtë të burimeve natyrore dhe, si pasojë, prodhimin

22 Brian Fagan, *The Great Warning: Climate Change and the Rise and Fall of Civilizations*, Bloomsbury Press, New York, 2008.

23 Donella H. Meadows, Dennis L. Meadows, Jorgen Randers, dhe William W. Behrens III, *The Limits to Growth*, Universe Books, New York, 1971.



e pajisjeve gjithnjë e më të zotërueshme, lehtësisht të zëvendësueshme dhe të përmirësuara çdo vit, si dhe një mënyrë jetese që gërryen këto burime.<sup>24</sup> Dhe tani, disa nga kombet më të populluara në tokë, me të drejtë, e nuhasin mundësinë për të zënë vendin e vet në këtë liri shpirtërore shpenzimesh. Shfrytëzimi i kësaj mundësie nga ana e tyre, mbështetur në pohimin e nxjerrjes së miliarda njerëzve të tyre nga varfëria, nuk gjen përgjigje nga ana morale dhe njerëzore. Megjithatë, dëshira, sado e padyshimtë dhe e shëndoshë moralisht, paraqet mëdyshje të mëdha për të gjithë. Ajo që është marrë si normale, thjesht nuk e mbështet dot.

Tashmë, edhe modernizimi është bërë një ide helmuese. Dëshmi e saj është pikërisht ajo çfarë ka sjellë i ashtuquajtur i modernizim i shëndetësisë: sa më shumë të modernizohet, aq më pak dobiprurës bëhet. Sa më shumë të rritet zoni një institucion si shëndetësia, aq më i ndërlikuar dhe i çoroditur bëhet ai, më shumë mosmarrëveshje dhe padije dalin në pah, aq më i prirë ndaj rreziqeve dhe dështimit bëhet. Këto rreziqe janë të pandashme, ato lindin pikërisht nga institucionet moderne dhe u plasën në dorë posaçërisht këtyre institucioneve moderne, përpara se të na përpijnë ne të tjerëve. Për më tepër, të modernizosh, do të thotë t'i heqësh një institucioni mbarëvajtjen shoqërore dhe ndërgjegjen. Themeli i modernizimit ka qenë burokratizimi dhe, siç theksoi përkufizimi klasik i Maks Weber, burokracia është dizajnuar qëllimisht pa fytyrë, e papërcaktuar në kuptimin e paanshmërisë, duke i trajtuar të gjithë me të njëjtat qasje rutinë. Deri diku, ajo bën punë, sa i përket drejtësisë dhe barazisë. Megjithatë, ana e papërcaktuar, pa fytyrë dhe e pamëshirshme e burokracisë, siç kanë vënë në dukje vëzhguesit, që nga Kafka<sup>25</sup> e deri te Zigmund Bauman<sup>26</sup>, mund të sfidojnë njerëzimin, arsyen dhe logjikën dhe të punojnë me po aq rendiment për të keqen, sa për të mirën e përbashkët. Ata që punojnë në burokraci, ndjekin linjën e veprimit, ndjekin rregullat pa ndjenjën e përgjegjësisë vetjake dhe u ndalohet të ushtrojnë maturi përballë të vërtetave njerëzore, ashtu siç paraqiten. Ata nuk zotërojnë dhe as drejtojnë rrjedhën e institucioneve. Ata që shërbehen nga institucionet burokratike, ndihen po aq të tjetërsuar dhe të pafuqishëm, përpara fuqisë së tepërt të një përbindëshi pa fytyrë. Sa më shumë që ne modernizojmë institucionet burokratike, aq më shumë njerëzit bëhen të pakënaqur, të tjetërsuar, të pafuqishëm dhe të zemëruar.

24 Eleonora Barbieri Masini dhe Sam Cole, editors, 'Limits to Growth Revisited', *Futures* (Special Issue), 33 (1), 2001.

25 Franz Kafka, *The Castle*, Penguin Modern Classics, Londër, 2007 (botim origjinal, 1926).

26 Zygmunt Bauman, *Modernity and Holocaust*, Polity, Oxford, 1991.



Institucionet bashkëkohore, si bankat dhe ndërmarrjet, janë ngrehina të rregullta dhe shumë të ndërlidhura, që nuk kanë moral dhe ndjenjë pendese. Detyra e tyre është të rritin fitimin, nëpërmjet ecurisë së thjeshtimit të gjërave, duke grumbulluar gjithnjë e më shumë fuqi dhe burime, gjë që është pikërisht ajo që ata bëjnë, duke marrë gjithnjë e më shumë rreziqe në një mjedis padije, pasigurie dhe çoroditjeje. India kishte 130.000 lloje të ndryshme orizi, përpara se bujqësia e saj të modernizohet, në vitet 1970. Pas modernizimit, varietetet indiane të orizit ishin shkurtuar në vetëm 3000. Modernizimi shkurton larminë, burokracia sipas përkufizimit, ofron një madhësi që i përshtatet të gjitha rregulloreve. Kur një burokraci kërkon të zbutet, që të përfshijë shumëllojshmërinë e ndërlidhur të rrethanave njerëzore, ajo bëhet më e largët, më e vështirë, më pak e çiltër, e kuptueshme ose e përshtatshme. Modernizimi dhe burokracia kthejnë gjithçka në një rend ditor asnjans ndaj vlerave, të pashpirt, e cila paguan dhe lehtëson tregtinë ziliqare dhe shton rreziqet për të gjithë. Duke qenë se institucionet bashkëkohore janë shkaktarë të problemit, ata nuk mund të jenë pjesë e zgjidhjes.

E njëjta gjë mund të thuhet për rendimentin, një ide e lidhur ngushtë me modernizimin.

**MENDIMI QË NE DUHET TË AFTËSOHEMI GJITHNJË E MË SHUMË, QOFTË VEÇ E VEÇ, QOFTË SI INSTITUCIONE, DHE TË MARRIM SA MË SHUMË PRODHIME NGA TË GJITHA BURIMET TONA, TASHMË TINGËLLOJ I PAKUPTIMTË.**

Se sa dobiprurëse mund të jetë çdo gjë, duke përfshirë edhe shëndetësinë, ka një kufi të caktuar. Burokracia është përfaqësuese e rendimentit, duke bërë përpjekje për t'i thjeshtuar gjërat dhe rritjen gjithnjë e më shumë të menaxhimit, gjë që dështon në gjallërimin e një zotërimi më të dobishëm të kontrollit. Në mënyrë qesharake, ka diçka të brendshme në idenë e rendimentit, që, në fakt, prodhon mungesë rendimenti. Këtë mund ta dallojmë më qartë gjatë drejtimit të qarkullimit në një autostradë. Për të ulur mbipopullimin në një autostradë me dy kalime, ndërtojmë dy kalime të reja. Por një autostradë me katër kalime nuk e zvogëlon qarkullimin, por e rrit atë. Kështu që ne ndërtojmë gjashtë kalime. Por qarkullimi rritet sërish. Tetë kalime dhe qarkullimi vazhdon të rritet. Në këtë mënyrë, krijojmë makina me një rendiment më të lartë energjie. Pronarët i ngasin



makinat me më shumë kënaqësi. Me përmirësimin e rendimentit të makinës, rritet numri i kilometrave të kaluara.

Një vëzhgim i thjeshtë, se si rritja e rendimentit në përdorimin e një burimi çon në një përdorim më të madh të atij burimi, njihet si “paradoksi Jevons”. I përshkruar për herë të parë nga William Stanley Jevons, në 1865, në lidhje me qymyrin, ai është përdorur kohët e fundit për të treguar se shtytjet për rendiment të lartë në fusha të shumta, si karburantet dhe lëndët djegëse, i bëjnë gjërat më keq. Te *Miti i rendimentit të burimeve: paradoksi Xhevons*,<sup>27</sup> John M. Polimeni dhe bashkautorët e tij ofrojnë shembuj të shumtë nga ekonomia dhe ekologjia, deri te teknologjia dhe mjedisi. Rritja e rendimentit në prodhimin e ushqimit në Indi, për shembull, nuk e zgjidhi problemin e urisë, e përkeqësoi atë (jo vetëm prej zvogëlimit të llojit të farave). Frigoriferët janë bërë më dobiprurës, por edhe më të mëdhenj. Jehona e rendimentit të energjisë në nivel të ulët – familje dhe blerës vetjakë – rrit harxhimin e energjisë në shkallë të gjerë të shoqërisë në tërësi. Kjo do të thotë se ne nuk mund të mbështetemi në risitë e ardhshme teknologjike për të na ndihmuar në uljen e shpenzimit të burimeve, që, në këtë mënyrë, të krijojmë një botë më të qëndrueshme. Rendimenti rrit ndërlikimin dhe sjelljen çoroditëse; çka mund të çojë në një lloj fatkeqësie të paparashikuar.

Kapitalizmi i çrregulluar nga tregu i lirë, kulmi i kohëve të hamendësuar normale, është kthyer në çoroditje, në një mjet fatkeqësie. Vetë metoda është tashmë çështja që kërkon zgjidhje. Ajo ka krijuar institucione, mënyra dhe zbatime të cilat janë kundërshtuese dhe ndërlikuese, përtej çdo gjase të vërtetë të menaxhimit dhe zotërimit dobiprurës. Ajo nxiti dëshirat që nuk mund të përmbushen, përveçse pak prej tyre. Ajo prodhon dëshira për liri vetjake që fshehin qëndrueshmërinë në nivele gjithnjë e më të larta të shpenzimit, të shpërpjesëtimit në fuqi, që fundos strukturat e qëndrueshme të renditjes shoqërore. Shtresa e mesme, dikur në botën perëndimore ishin përfituesit kryesorë të sistemit, tani po shtrydhen, teksa përjetojnë rënien e niveleve të tyre të jetesës, ndërkohë që vazhdon varfëria deri diku e qëndrueshme dhe e plotë e shtresës së ulët. Është e qartë, se përparimi, modernizimi dhe rendimenti janë bërë terma të tepërt, nëse jo të vjetruar tërësisht.

27 John M. Polimeni, Kozo Mayumi, Mario Giampietro dhe Blake Alcott, *The Myth of Resource Efficiency: The Jevons Paradox*, Earthscan, Londër, 2009.



## CILËSITË

Ne duhet të merremi vesh për rrugën tonë drejt kohërave të reja normale. Megjithatë, çështja është se hapësira, koha dhe vullneti për t'u përfshirë në biseda të arsyeshme pakësohen, sa më ndërlkuese, kundërshtuese dhe çoroditëse bëhen gjërat. Demokracia e shfrenuar dhe mënyrat e saj historike të organizimit – nga pjesëmarrja e votuesve, tek anëtarësimi në parti politike – angazhojnë gjithnjë e më pak qytetarë. Veprimtari të vetvetishme vetorganizuese, siç janë tubimet botërore kundër kapitalizmit, edhe pse tërheqëse, janë vetëm një vetëpërzgjedhje. Anëtarësimi dhe rendi ditor i tyre shpeshherë janë kalimtare. Lëvizje të tilla mund të mbarojnë po aq shpejt sa fillojnë, si një veprimtari pa ndonjë qëllim tjetërsimi në vetvete. Në mënyrë të papritur dhe vetvetiu, ato mund të vijnë dhe të shkojnë, pa krijuar ngrehina të reja politike të qëndrueshme, ose pa ndryshuar ato që tashmë janë në fuqi. Për më tepër, rrjetet dhe lëvizjet vetorganizuese mund të nxiten po aq lehtësisht nga trembja, frika dhe ksenofobia, mjete këto për të ngjallur populizmin dhe veprimtari fashiste, si kërkesa për drejtësi shoqërore. Pra, rrjetet vetorganizuese nuk ofrojnë siguri premtuese: nuk ka asnjë ligj natyror, që thotë se veprimtaria do të mund të, ose duhet të jetë e përkushtuar vetëm për të mirën e përbashkët. As nuk ka ndonjë rregull, që ata duhet të kenë një pikëpamje të baraspeshuar dhe të mendojnë për rreziqet dhe përfitimet e rendit të tyre ditor. Në të vërtetë, është në natyrën e shumë prej rrjeteve vetorganizuese të shfaqura së fundmi, që të turbullojnë ujërat, duke ofruar zgjidhje të thjeshtuara, të vetme, njëpërmasore, duke rritur në këtë mënyrë helmatisjen, armiqësinë dhe pakënaqësinë e shoqërisë në tërësi.

Për t'u marrë vesh, lidhur me rrugën tonë drejt daljes nga periudha pasnormale, fillimisht, duhet të mësojmë se si të merremi vesh, si ta përkthejmë dëshirën në tjetërsim. Si ta organizojmë, dëgjojmë dhe angazhojmë me arsye gjithsecilin në ligjërimin, se si t'ia bëjmë për përfitim të ndërsjellë?

**MORALI QË DUHET TË NXIRRET NGA VEÇORITË E KOHËVE PASNORMALE, JANË CILËSITË E LASHTËSISË: PËRULËSIA, MODESTIA DHE PËRGJEGJËSIA.**

Duhet të fillojmë t'i japim rëndësi faktit se, gjatë gjithë kohës, nuk dimë dhe nuk mund ta dimë se si do të rrezikohet siguria jonë vetjake, shoqërore dhe e mbarë gjallesave.



**MENDIMI QË GJËRAT MUND TË MBIKËQYREN TËRËSISHT DHE TË  
MENAXHOHEN, NUK KA KUPTIM, KUR PROBLEMET JANË PA  
PËRGJIGJE 'TË SAKTA' APO 'TË GABUARA', POR KËRKOJNË THJESHT  
PIKËPAMJE TË SHUMËFISHTA PËR TË NA DHËNË TË KUPTOJMË  
PËRMASËN E TYRE TË VËRTETË.**

Përlësia, modestia dhe përgjegjshmëria nuk janë shtesa të tjera, por cilësi të domosdoshme, kërkesa thelbësore për të jetuar me pasiguri dhe ndërlikim.<sup>28</sup> Meqenëse nuk mund ta zhdukim kurrë pasigurinë dhe të kemi zotërim të plotë të çdo rrethane, synimet tona duhet të jenë të përlura. Në mënyrë të ngjashme, ne kurrë nuk mund të kemi njohuri të plotë për një metodë të ndërlikuar; ngaqë do të jetë gjithmonë e ndrojtur dhe e përkohshme. Duhet të pranojmë se padija na shoqëron në gjithçka që mendojmë se dimë. Pra, duhet të jemi modestë në lidhje me përpjekjet që bëjmë për njohuri të tilla. Dështimi për ta pranuar pasigurinë dhe ndërlikimin e rrethanave të caktuara, nuk është vetëm një gabim teknik, siç vëren Pol Killies, por edhe një gabim moral.<sup>29</sup>

Në të vërtetë, është morali dhe vetëm morali, ai që mund të na nxjerrë nga ngërçi pasnormal. Një normalitet i ri, i pajtuar brenda kushteve të kohëve pasnormale, duhet të jetë i rrënjësor në pikëpamjen morale, që të vihen sadopak në punë cilësitë e domosdoshme. Sjellja njerëzore nuk është as e veçuar dhe as e përgjithshme; ajo mund të zbatohet lehtësisht, si për të përveçmen, ashtu edhe për të përgjithshmen. Është aftësia e njerëzve për të kapërcyer atë shkallë që i bën ata të një rëndësie parësore për ideimin e një normaliteti të ri. Sjellja njerëzore mund të sigurojë parimet udhëzuese për një ndjenjë përbashkimi të drejtimit në të gjitha nivelet e organizimit, duke rrënjësor cilësitë - përlësi, modesti dhe përgjegjësi, - që ne duhet të sigurojmë për t'u kthyer në qendër të vëmendjes. Ligjërata e nevojshme duhet të qartësojë se për çfarë parimesh morale jemi përgjegjës. Ato duhet të përkrahen kur ne bëjmë një zgjedhje, me gjithë përlësinë dhe modestinë që zbatojmë për të kuptuar problemet tona, duke kërkuar zgjidhje mes gjithë atyre paqartësish. Pa marrë parasysh rreziqet dhe papërsosmëritë, duhet t'i pranojmë ato parime si pjesë përbërëse e punëve tona të përditshme.

Përgjigjja morale ndaj mëdyshjeve tona pasnormale nuk është aspak e lehtë dhe për shumë mund të tingëllojë si një kthim në vlerat e modës së

28 Stephen Chan, *The End of Certainty*, Zed Books, Londër, 2009.

29 Paul Cilliers, 'Complexity, deconstruction and relativism', *Theory, Culture & Society*, 22 (5), 2005, f. 255-267.



vjetër të rrënjosura në besimet fetare. Në këtë rast, do t'ia vlente të kujtohej se moderniteti, themeli i normalitetit, ishte në shumë mënyra një metodë besimi. Modernizimi, përparimi, burokracia, shkenca dhe të gjitha lëndët e dijes bashkëkohore u shfaqën të plotësuara me një gojëdhënë të pasur mbështetëse, parimi më themelor i së cilës ishte lajthitja ideore, se ato ishin vlera asnjëse, të përgjithshme dhe në thelb të mira. Ne kemi mbërritur në pasnormale pjesërisht, duke lejuar që kjo mënyrë e të menduarit të na bindë se metodat që ndërtoam në mënyrë të pashmangshme, pa ndryshim nga vetja dhe në vetvete, do t'i përgjigjen të gjitha nevojave për përmirësimin e njeriut. Me pak fjalë, morali në thelb ishte i tepërt. Ne kemi jetuar për të mësuar se ky parashtrim nuk është më i qëndrueshëm. Logjika dhe arsyetimi, cilësitë e modernitetit, të vetme, nuk do të sigurojnë dot ndryshimet që duhet të bëjmë në mënyrën e jetesës për të përballuar sfidat e kohëve pasnormale. Përgjegjësia morale që nxjerr në pah vlerat dhe cilësitë, duhet t'i vijë në ndihmë logjikës dhe arsyes. Pa një mbi-zotërim të ndjenjës së përgjegjësive, është e vështirë të përfytyrohet se si mund të binden të pasurit dhe të fuqishmit, që të bëhen më modestë në kërkesat dhe mënyrën e jetës së tyre, më të përlulur, të gatshëm për të zbutur shturjen e mënyrës së tyre të jetesës dhe përdorimin e shpërpjesëtuar të burimeve të kufizuara botërore që kërkon kjo mënyrë jetese.

Ka edhe diçka tjetër shumë të rëndësishme që duhet theksuar. Çdo pikëpamje shoqërore, kulturore, politike, filozofike dhe fetare e njohur për njerëzimin, duhet të rimësojë se si të merret me parimet e veta morale. Kjo na çon te një tjetër çështje jashtëzakonisht e rëndësishme. Logjika e vlerave asnjëse të ngulitura në sistemet e dijes, përparimit, modernizimit dhe burokratizimit mendohej se do të na mundësonte të kapërcehim çështjet e pazgjidshme të larmisë së besimit. Përkufizimet e ndryshme të besimit, secila me veçoritë dhe kufizimet e veta, secila me synime të posaçme, që të zotërojnë të vetmet përgjigje të drejta, u panë si pengesa të shtrirjes së kërkimeve të thella dhe, për rrjedhojë, si kufizime në përparimin njerëzor. Në një farë kuptimi, ndërlihdja laike e modernitetit e ka bërë punën e vet, ajo e ka futur të gjithë botën në të njëjtën mëdyshje: sundimin pasnormal. Shqyrtimi moral dhe llogaria që duhet të japim, nevojitet të kapërcejë kufizimet e traditës dhe të modernitetit. Kjo duhet të fillojë me pranimin e së vërtetës pasnormale, se askush nuk e zotëron plotësisht të vërtetën dhe, për rrjedhojë, nuk ka siguri në zotërimin e mjeteve për të gjetur përgjigje për të gjitha pyetjet. Të pranosh se nuk ka përgjigje të sakta dhe të gabuara, nuk do të thotë të braktisësh kërkimin e së vërtetës ose zgjidhjeve,



por të ndryshosh tërësisht ecurinë dhe llojin e qëllimeve që vendosim për përpjekjet tona. Kur nuk ka përgjigje të sakta ose të gabuara, gjithkush dhe çdo pikëpamje ka se çfarë të japë, çdokush ka po aq gjasa sa një tjetër, që të ketë një pjesë të zgjidhjes së mundshme. Në vend që të kthehemi tek e drejta e posaçme dhe përcaktoret e vjetra, më mirë të kalojmë në një lloj të ri përshtatjeje dhe lakueshmërie, në të cilën çdo pikëpamje dhe botëkuptim merr pjesë në kërkimin e zgjidhjeve për çështjet tona të përbashkëta. Në të vërtetë, ne nuk po kërkojmë një përgjigje, përgjigjen për gjithçka. Rëndësia që i kushtojmë pasigurisë, rrezikut dhe padijes, përqaftimi i përlulisë dhe modestisë si cilësi thelbësore të përqsjes sonë në kërkimin e përgjigjeve të përshtatshme, na mundëson të zbulojmë mundësi të tjera. Bëhet e mundur që të ketë qëllime të përbashkëta, të cilat përmbushen në mënyra të ndryshme dhe të përshtatshme në nivel vendor dhe të kuptojmë parimet e përbashkëta përmes dallimeve.

Ne nuk mund të fshijmë gjithçka dhe të fillojmë përsëri. Rruga drejt një normaliteti të ri fillon me gjithë ndërlikimet dhe mosmarrëveshjet e realitetit tonë të rrëmujsëm. Llogaridhënia fillon me marrjen e përgjegjësisë për atë që dimë dhe çmojmë, e cila vjen e mbështjellë me të gjitha larmitë e kulturave, historive dhe besimeve tona. Ajo që duhet t'i shtojmë kësaj, është një qartësi morale, një gjendje shpirtërore që pranon se të gjithë jemi të rrethuar nga padija dhe asnjëri prej nesh, asnjë traditë apo pikëpamje, nuk i ka të gjitha përgjigjet e duhura.

Një normalitet i ri nuk mund të kërkojë logjikë të thjeshtuar. Ai duhet të fitojë përmes formulimeve të shumta e të ndryshme të të gjitha pikëpamjeve të mundshme logjike. Ai duhet të merret me ndërlikimet e njerëzimit, po aq sa ç'merret me ndërlikimin e mjedisit botëror që ne e ndajmë në mënyra kaq të ndryshme. Vetëm qartësia morale në lidhje me përgjegjësitë e të qenit njerëzor, në çdo botëkuptim të veçantë, mund të na shtyjë drejt kuptimit më të mirë që na lejon të ofrojmë përkthim të menjëhershëm, të shohim parimin e përbashkët përmes ndryshimit që do të na ndihmojë të merremi vesh botërisht. Në kushtet pasnormale, lakueshmëria, përshtatja dhe ndjeshmëria ndaj kushteve fillestare, dukshëm të ndryshme, kërkojnë që ne të zhvillojmë mprehtësinë tonë morale për të rritur larminë e përgjigjes sonë. Ne nuk po kërkojmë një zgjidhje, por shumë mundësi që krijojnë gjykim të vërtetë dhe vrull për parime të përbashkëta. Një përqsje e tillë kërkon mendim të ri, përpjekje dhe pjesëmarrje nga të gjithë.





## PËRFYTYRIMI

Përbërësit më të rëndësishëm për të përballuar kohët pasnormale, siç mendon Pol Killies, dhe unë do ta përforcoj, janë përfytyrimi dhe krijimtaria. Pse? Sepse nuk kemi asnjë mënyrë tjetër për t'u marrë me ndërlikimin, mosmarrëveshjet dhe çoroditjen. Përfytyrimi është mjeti kryesor, në të vërtetë, unë do ta konsideroja si mjetin e vetëm, i cili na çon nga një zbërthim i arsyetuar thjesht, te zgjidhja e mosmarrëveshjes midis thënies dhe kundërthënies. Ndërsa përfytyrimi është i paprekshëm, ai krijon dhe formëson vërtetësinë tonë jetësore. Si një mjet mendor, ai ndikon në sjelljen dhe pritshmëritë tona. Ne do të duhet ta përfytyrojmë rrugën tonë për të dalë nga kohët pasnormale. Lloji i së ardhmes që ne përfytyrojmë, përtej kohëve pasnormale, do të varej nga cilësia e këtij përfytyrimi. Duke pasur parasysh, që përfytyrimi është i ngulitur dhe i kufizuar në kulturën tonë, do të na duhet të çlirojmë një spektër të gjerë përfytyrimesh nga larmia e pasur e kulturave njerëzore dhe mënyrave të shumta për të përfytyruar të tjera mundësi, përveç atyre tradicionale, të të qenit dhe të të bërit.

Në një masë shumë të madhe, ngërçi ynë i tanishëm përfaqëson një dështim të përfytyrimit, ose më mirë, nënshtrim ndaj përfytyrimit tradicional. Historia, tha Ibn Khaldun,<sup>30</sup> historiani dhe sociologu i shekullit të XIV-të, lëviz në spirale. Arnold Toynbee,<sup>31</sup> historiani i qytetërimeve të shekullit të XX-të, ishte i një mendjeje. Asnjëri prej tyre nuk vuri në dukje, se vrulli i spirales së historisë, në të vërtetë, ruan traditën. Pasi dhimbja dhe vuajtja mbarojnë dhe gjërat duket se kthehen në normalitet, këmisha e traditës e kthen shoqërinë nën sundim. Vini re, se sa shpejt tregjet financiare janë rikthyer në mënyrat e vjetra, edhe më të këqija. Rënia ekonomike pothuajse ka mbaruar, lastarët e gjelbër po shfaqen në shumë vende dhe na thuhet se ne mund t'i kthehemi tregtisë, si zakonisht, pa hequr dorë, ndonëse të tronditur. Sigurisht, do të mësojmë nga gabimet tona dhe e ardhmja do të jetë më e mirë dhe më e begatë. Kjo, në vetvete, është një shpresë e kotë dhe e rrezikshme.

Rrëshqitja me lehtësi drejt të kaluarës së sigurtë dhe të rehatshme shumë shpesh, do të thotë se ne po krijojmë kushtet për të përsëritur gabimet historike. Mendimi tradicional dhe varësia e tregjeve nga fuqia shpenzuese, siç tregon Tim Jackson, në mënyrë kaq të gjallë, në *Mirëqenie pa rritje*

30 Ibn Khaldun, *The Muqaddimah: An Introduction to History*, Routledge dhe Kegan Paul, Londër, 1967 (originali, rreth 1380).

31 Arnold Toynbee, *A Study of History*, Oxford University Press, Oxford, 1934. 30. Tim Jackson, *Prosperity Without Growth: Economics for a Finite Planet*, Earthscan, Londër, 20091.



*ekonomike*<sup>32</sup> dhe siç e ka sqaruar vazhdimisht Komisioni i Zhvillimit të Qëndrueshëm të Britanisë, tani janë bërë aq të sëmura dhe aq helmuese, sa që dalja nga kriza, shkatërrimi ekonomik i radhës, pandemia e ardhshme, ndikimi i radhës nga ngrohja globale, do të shënonin vërtet fundin e qytetëritimit, siç e njohim ne. Duhet të përfytyrojmë shtigje më të përshtatshme. Ne të gjithë kemi nevojë për një busull morale më të qartë dhe më të fortë, një busull morale të cilën nuk mundemi ta lëmë sërish mbyllur në sirtar, ndërkohë që rrimë dhe mjaftohemi me vetëpërgëzimin e vetëkënaqur, se metodika do të kujdeset për ne, për veten e vet, si dhe për tokën mëmë nga e cila ne të gjithë varem.

Bota pasnormale është një botë e shpërpjesëtuar. Shpërpjesëtimi në ndarjen e pushtetit, pasurisë, burimeve dhe kërkesat e larta për zotërimin dhe përdorimin e këtyre burimeve përputhen vetëm me fuqinë shpërpjesëtuese që njohuritë dhe teknikat tona na kanë dhënë për të shkatërruar mjedisin nga i cili varet pasuria jonë. Na është krijuar bindja se e kaluara është një vend i largët, që tashmë i mungon aftësia për t'u shprehur rreth fuqisë dhe stërthollimit të jetës sonë dhe ndërlikimit të botës në të cilën jetojmë sot. Nëse nuk mund të nxjerrim mësim nga historia, atëherë na duhet një burim tjetër përfytyrimi, që të ravijëzojmë të ardhme më të qëndrueshme dhe më të prekshme.

**NA NEVOJITET JO VETËM PËRFYTYRIM, POR NJË PËRFYTYRIM MORAL, QË TË MUND T'I PRANOJË PASIGURINË DHE RREZIQET ME TË CILAT PËRBALLEMI, QË MERRET ME NDËRLIKIMIN DHE LARMINË DUKE MBAJTUR GJALLË CILËSITË PËR TË CILAT KEMI NEVOJË: PËRULËSIA, MODESTIA DHE PËRGJEGJËSIA.**

Është shpresa jonë më e mirë për të marrë përgjegjësinë për zgjedhjet që do të na duhet të bëjmë, me qëllim që të sigurohemi se mund të mbërrijmë në të ardhmen tonë të përfytyruar me njerëzimin dhe tokën tonë të pacenuar.

32 Tim Jackson, *Prosperity without Growth: Economics for a Finite Planet*, Earthscan, Londër, 2009.





## Rishikim mbi kohët pasnormale

Ziauddin Sardar

Te “Mirë se vini në kohët pasnormale!”<sup>1</sup>, argumentova se ne po hyjmë në një epokë ku ndërlikimi, çoroditja dhe mosmarrëveshjet do të bëhen temat mbi-zotëruese, ndërsa padija e pasiguria do të rriten në mënyrë të ndjeshme. Punimi u shkrua për të shënuar fundin tim pesëmbëdhjetë vjeçar si redaktor i *Futures* dhe ishte menduar si një përmbledhje e asaj që kisha mësuar nga leximi i kujdesshëm i qindra letrave, të pranuar dhe papranuar, të dërguara në redaksi. Një tekst, ka shkruar Roland Barthes<sup>2</sup>, është një grusht thëniesh të nxjerra nga qendra e shumë kulturave. “Mirë se vini në kohët pasnormale” është një përpjekje për ndërthurjen e ideve të nxjerra nga pëlhura e larg-pamësisë dhe studimeve të së ardhmes. Natyrisht, çfarë mendojnë studiuesit e tjerë të së ardhmes, kuptimi që përçon, është krejtësisht i pavarur nga autori. Ai varet nga ajo që lexuesit lexojnë në atë shkrim, më shumë sesa nga ajo që kam dashur të them, çfarë kam apo nuk kam thënë. Megjithatë, u befasova këndshëm nga ndikimi dhe rrahjet e mendimit që nxiti punimi im. E gjitha u botua në një numër të veçantë të *Futures*, te rubrika ‘Kohët pasnormale’<sup>3</sup> dhe vetë emërtesa (kohët pasnormale ) është pranuar dhe është bërë e njohur. Analiza pasnormale tani buron nga shkenca në të cilën është ngulitur mirë, për studimet e së ardhmes, shqyrtimet politike, zgjuarsinë ekonomike si dhe arkitekturën e trashëgiminë kulturore.

Këtu do të doja të merrem thellësisht me disa nga ripërsëritjet gjatë punimit, të përpiqem t’u përgjigjem disa prej pyetjeve që janë ngritur, të

1 Sardar, Z (2010) ‘Welcome to Postnormal Times’ *Futures* 42 (5) 435–444 Qershor.

2 Barthes, Ronald (1967), ‘The death of the author’, *Aspen* 5–6.

3 Davies, Merryl Wyn (2011), Guest Editor, ‘Postnormal Times’, Special Issue, *Futures* 43 (2) 136–227.



përcaktoj disa veçori të gjendjes pasnormale, të vë theksin te pasnormalja që fshihet në horizont dhe të zbuloj se çfarë do të thotë të jesh pasnormal.

## KOHËT PASNORMALE DHE (PA)KËNAQËSIA E TYRE

Një pyetje që shtrohet shpeshherë, është kjo: Si mund të flasim për pasnormalen, kur nuk e dimë se ç'është të qenit normale? Gjithsesi, kush e përcakton se çfarë është normale? Është e qartë, se ajo që mund të mendohet si normale në ditët e sotme, është krejtësisht e ndryshme nga ajo që shihej si normale, le të themi, gjatë kohës së mesjetës ose periudhës së pushtimeve. Dikur, skllavëria dhe grabitja shiheshin si normale; vendet dhe nënshtetasit e kolonizuar u panë si njerëz dhe kultura inferiore në krahasim me Europën. Fatmirësisht, ne kemi ecur përpara, ose kemi përparuar moralisht. Për më tepër, ajo që mund të shihet si normale në një kulturë, mund të duket si lajthitje në një tjetër. Trishtimi në një kulturë mund të merret si diçka e zakonshme, ndërsa një tjetër kulturë mund ta renditi atë si “depression” që kërkon ndërhyrje mjekësore. Kështu, “normale” mund të ketë një sërë kuptimesh, diçka që psikologët e dinë mirë. E kundërta e normales nuk është pasnormale, por jonormale.

**NË SHQYRTIMIN E PASNORMALES, NE E MARRIM PËR NORMALE ATË QË HASET VAZHDIMISHT: AJO QË PRANOHEJ SI MËNYRA MBIZOTËRUESE E TË QENURIT, TË DITURIT DHE TË BËRIT; AJO QË SHIHET NË MËNYRË TRADICIONALE SI NIVEL I DIKTUAR NGA MARRËVESHJA DHE TRADITA, MBËSHTETUR NGA INSTITUCIONE DIJEJE DHE NDËSHKIMI; SI DHE AJO QË NE JEMI NË GJENDJE TA PARASHIKOJMË DHE TA ZOTËROJMË. PRA, NORMALJA ËSHTË E VENDOSUR NË ZAKONET E MIRËMENDUARA TË SJELLJES DHE MENDIMIT, SI:**

moderniteti, pasmodernizmi, kapitalizmi grabitqar, fundamentalizmi i tregut, shtesat e shoqërisë, institucionet dhe organizatat, mënyrat e caktuara të veprimit shkencor, lëndët e njohura akademike si ekonomia dhe shkencat politike, si dhe institucionet e ndëshkimit, politika nga lart-poshtë, qeveria e dështuar, industrinë ndotëse, teknologjia e përshpejtuar, lënia pas dore e



hapësirave të pamata të njerëzimit, ksenofobia, racizmi dhe urrejtja gjinore, padrejtësitë shoqërore dhe politike, shkenca dhe gjithçka tjetër që ka formësuar dhe përkufizuar ‘botën moderne’.

Arsyetimi kryesor i teorisë së kohëve pasnormale është se në epokën e sotme, kur, siç thotë formula e zhvilluar në gjuhën e shkencës pasnormale, “faktet janë të pasigurta, vlerat në mospërputhje, rreziqet e larta dhe vendimet e ngutshme”<sup>4</sup>, normalja e pranuar nuk bën punë. Idetë dhe hamendësimet themelore të normalitetit, të tilla si përparimi, modernizimi, rritja ekonomike, zhvillimi dhe rendimenti janë duke u vjetruar në mënyrë të frikshme.<sup>5</sup> Në fakt, normalja tani është bërë fushë e të vërtetave, përqa-sjeve, besëlidhjeve dhe kanuneve të vjetra që po vdesin. Fakti se ka diçka që thellësisht nuk shkon me botën e sotme, ngaqë ne po shkojmë me të shpejtë drejt një “ndryshimi grafiku”, po bëhet një arsyetim dhe qëndrim i zakonshëm. James Galbraith e përshkruan atë thjesht si *Fundi i Normales*<sup>6</sup>, ndërsa Michael Harris vajton te *Fundi i Mospasjes*.<sup>7</sup> “Shenjat” që gjallërohen vazhdimisht brenda rendit global, vë në dukje Richard Slaughter, përbëjnë *Paralajmërimin më të madh në histori*.<sup>8</sup> “Llogaritja e nënkuptuar” e periudhave të mëparshme, tani është bërë e parëndësishme, arsyeton Henry Kissinger. Ndryshimet që po ndodhin, janë të shpejta dhe të menjëhershme dhe e tërheqin njerëzimin në fusha të pashpjeguara deri tani, në të vërtetë, të pamenduara.<sup>9</sup> Sipas Ulrich Gehmann, ne po jetojmë në ‘një periudhë kohore, ku po shfaqen përshtypje të reja për botën, ku mënyrat tona përkatëse të përfytyrimit të “botës” dhe asaj çfarë do të thotë për ne në tërësi, po u nënshtrohen ndryshimeve të thella’.<sup>10</sup> Elizabeth Kolbert thekson se “asnjë krijesë nuk e ka ndryshuar jetën në tokë”, ashtu siç e kanë ndryshuar njerëzit dhe tani jemi dëshmitarë të një tjetërsimi të madh në historinë e jetës së planetit.<sup>11</sup> Emërtesa të ndryshme janë sajuar për të përshkruar atë që po kalojmë dhe me çfarë do të ndeshemi. Ulrich Gehmann dhe Martin Reiche e quajten atë epokën e ‘Shumë pranë së Vërtetës’. Kolbert e përshkruan si

4 Ravetz, J R dhe Funtowicz, S O (1999), ‘Postnormal science: an insight now maturing’ *Futures* 31 (7) 641–646.

5 Sardar, Z (2010) ‘Welcome to Postnormal Times’ *Futures* 42 (5) 435–444 Qershor.

6 Galbraith, James (2014), *End of Normal: The Great Crisis and the Future of Growth*, Simon and Schuster, New York.

7 Harris, Michael (2014), *The End of Absence: Reclaiming What We’ve Lost in a World of Constant Connection*, Current, New York.

8 Slaughter, Richard (2011) *The Biggest Wakeup Call in History*, Foresight International, Brisbane.

9 Kissinger, Henry (2014), *World Order: Reflections on the Character of Nations and the Course of History*, Allan Lane, Londër.

10 Gehmann, Ulrich (2014) ‘The Frame Context’ in Ulrich Gehmann dhe Martin Reiche, editors, *Real Virtuality*, Transcript, Bielefeld.

11 Kolbert, Elizabeth (2014), *The Sixth Extinction*, Bloomsbury, Londër.



*Shuarja e Gjashtë*. Biologu amerikan, Michael Soule, e përkufizon si Epoka e 'Gjëmës'.<sup>12</sup> Kimisti holandez dhe fituesi i çmimit Nobel, Paul Curtzen<sup>13</sup>, e quan atë *Epokën e shkatërrimit nga dora e njeriut*, duke theksuar shuarjen e veprimtarive njerëzore me ndikim të rëndësishëm botëror. Peter Allan dhe Liz Varga kanë këshilluar se periudha 'e copëzuar nga paqëndrueshmëria, prishja dhe rrënimi i ngrehinave të vjetra, ndërkohë që shfaqen tipare, teknologji, ndryshore dhe veçori të reja që çojnë në një periudhë të re qëndrueshmërie cilësore', na kujtojnë 'Valët e gjata' të Krondatieff dhe Schumpeter, pamjen e valëve të 'shkatërrimit krijues'.<sup>14</sup> Të tjerë e kanë cilësuar këtë epokë, si 'Çudi botërore'<sup>15</sup> dhe 'Gëlim botëror'.<sup>16</sup>

Dikush prej nesh që merret me teorinë e kohëve pasnormale, i ka zgjedhur këto kohë për pesë arsye themelore. *Së pari*, shmang të tingëlluarit fatkeqësi, pasi është një emërtesë krejt asnjane, që nuk nënkupton se sistemi botëror ka 'hyrë në periudhën përfundimtare', siç lë të kuptojë Gary.<sup>17</sup> Në fakt, *koha pasnormale* është përkufizuar qëllimisht si kalimtare: "një periudhë ndërmjet traditave të vjetra që po vdesin, të reja që ende nuk kanë lindur dhe shumë pak gjëra duket se kanë kuptim".<sup>18</sup> "Pasnormalja" na lë të kuptojmë se ka diçka që quhet "normale", që i parapriu asaj, dhe do të ketë një normale të re pas saj. *Së dyti*, kjo kohë thekson ndërmjetësinë. Ajo që vjen pas kohëve pasnormale, nuk duhet të jetë prirje drejt rreziqeve dhe kërcënimeve me të cilat përballemi, por normalja e re, thelbësisht e ndryshme nga ajo e vjetra, që mund të krijohet me vetëdije për të qenë më e mirë, më e arsyeshme, më e rëndësishme botërisht dhe ekologjikisht, më bashkëjetuese, më njerëzore dhe mundësi më paqësore. *Së treti*, ajo thekson dhe e përqendron vëmendjen tonë në ndërlikimin, mosmarrëveshjet dhe pasigurinë që duhet t'i kuptojmë, për të kuptuar realisht, se si po ndryshon bota. *Kohët pasnormale* nuk është as "metaforë me dy kuptime". Në të vërtetë, teoria e kohëve pasnormale këmbëngul se (dizimi) 'arsyetimi aristotelian është pjesë e problemit dhe jo zgjidhja e tij'. Kjo teori këmbëngul se duhet të kalojmë, pa humbur kohë, përtej logjikës së dizimit dhe të gjejmë një mënyrë të re të menduarit dhe shqyrtuarit të shqetësimeve tona dhe mënyrave të reja për zbulimin e zgjidhjeve të qëndrueshme. *Së katërti*, kohët pasnormale kanë një themel të

12 Po aty.

13 Curtzen, Paul J (2002), 'Geology of Mankind' *Nature* 415: 23.

14 Allen, Peter dhe Varga, Liz (2014), 'Modelling sustainable energy futures for the UK', *Futures* 57 28–40.

15 Sweeny, John (2014) 'Command-and-Control: Alternative Futures of Geoengineering in an Age of Global Weirding' *Futures* 57 1–13.

16 Walsh, Bryan (2014), 'Invasive Species' *Time* 184 (4) 20–26 Korrik 28.

17 Gary, Jay E (2011) 'Toward a new macrohistory: An extension to Sardar's 'postnormal times' *Futures* 43 48–51.

18 Sardar, Z (2010) 'Welcome to Postnormal Times' *Futures* 42 (5) 435–444 Qershor.



shëndoshë teorik, falë dhjetëra viteve pune shkencore për pasnormalen, metodave të ndërlikuara befasuese si dhe përpjekjeve më të fundit të vetë teorisë së kohëve pasnormale. *Së pesti*, puna teorike na mundëson të zhvillojmë mënyra veprimi në një mori fushash dhe çështjesh, për t'i shtyrë kohët pasnormale drejt të ardhmes së sigurtë. Rakesh Kapoor<sup>19</sup> ka pohuar se *kohët pasnormale* është teori ose ide perëndimore. Aspak e vërtetë. Nuk është as ide perëndimore, as lindore, është thjesht një kuadër teorik që përshkruan e shpjegon epokën tonë dhe, si shumica e teorive, ajo duhet të ketë një element parashikues, duhet të jetë në gjendje të parashikojë shfaqjen e dukurisë pasnormale. Siç kam shkruar diku tjetër:

Të flasësh për një ndarje të qartë midis Lindjes dhe Perëndimit, në një botë të globalizuar, të larmishme, të ndërvarur, me çështje të përbashkëta dhe fate të përbashkëta njerëzore, është e rrezikshme dhe e pakuptimtë. Kufijtë dhe vijat ndarëse të Lindjes dhe Perëndimit, jo vetëm që kanë ndryshuar, por janë bërë të paqarta dhe të padallueshme. Ka aq Lindje në Perëndim, sa ç'ka Perëndim në Lindje. Perëndimi nuk mund të vazhdojë ta përfytyrojë Lindjen, veçse si të patjetërsueshme. Përçarja klasike kundër Perëndimit, që i bën jehonë pafajësisë dhe lavdëron epërsinë e Lindjes, është e pamënçur. Fuqia e ideve që shtyn imperializmin perëndimor, është shëndoshë e mirë dhe e shfrytëzuar nga Lindja brenda vetes, në vetvete.

Kërkimi i keqbërësit fillestar dhe ndarja e fajit është një mënyrë për të vazhduar lojën e kundërshtisë së paepur dhe, në këtë mënyrë, të mbajë me vete të gjitha gjërat që i nevojiten: dyshimin, gatishmërinë ushtarake, tjetërsimin e mendimit të qytetarëve, sjelljet e dyfishta dhe mënjanimin e nevojave të ngutshme njerëzore. Lindja ka qenë bashkëfajtoare në përjetësimin e përqasjes së dyzuar të kundërshtimeve. Sa më shumë që Lindja ka kërkuar pa diskutim të përvetësojë mjetet e Perëndimit, të bëhet bashkëkohore në një mënyrë të pavlefshme, skllavërore, aq më shumë kërkon të shihet si e ndryshme, aq më shumë ka romantizuar përsosmëritë eprore të traditave dhe vlerave të veta. Por, pavarësisht se sa keq shkojnë gjërat, Lindja ka një nen shpëtimi të menjëhershëm, falë të kuptuarit mbizotërues të botës, sipas idesë Kiplingeske. Mjafton dënimi i Perëndimit për veprimet e qëllimshme (kolonializëm, neo-imperializëm, mbizotërim politik dhe ekonomik) dhe përjashtuese (dështimi për të kuptuar ose vlerësuar dhe kundërshtimi i paepur ndaj rëndësisë së vlerave dhe ideve lindore). Kjo i mbulon të gjitha rastet me vetëkënaqësi dhe shmang nevojën e Lindjes për të shqyrtuar të metat e veta të brendshme. Ideja se: Lindja është Lindje dhe Perëndimi është Perëndim, u shërben të gjithëve.<sup>20</sup>

19 Kapoor, Rakesh (2011) 'Is there a postnormal time? From the illusion of normality to the design for a new normality' *Futures* 43 216–220.

20 Sardar, Z (2013a) 'Editorial: East-West in Postnormal Times' *East-West Affairs* 1 3–12 Janar.





Megjithatë, është e vërtetë, siç pohon Kapoor, se bota duket shumë ndryshe “nga këndvështrimi i dikujt të ulur në Nju Delhi”, ose në pjesë të tjera të Azisë, si Kina dhe Vietnami. Vendet e “tregjeve në zhvillim” nuk kanë gëzuar nivelin e zhvillimit që gëzojnë vendet e industrializuara perëndimore. Por ‘bota’ është, gjithashtu, një metodë thellësisht e ndërlidhur, e globalizuar. Nën sistemet e një sistemi të tillë botëror, nuk mund t’i shpëtojnë ndikimeve të asaj që ndodh diku tjetër në sistem. India nuk mund të ketë qëndrueshmëri ndaj goditjeve të ekonomisë botërore. Ndryshimi i klimës nuk njeh kufij. Teknologjitë e reja të ndërlidhjes do të kenë po aq ndikim shoqëror, kulturor dhe ekonomik në Perëndim, sa ç’do të kenë edhe në pjesën tjetër të botës. Zhvillimet e fundit në biologjinë sintetike do të riformësojnë përbërjen shoqërore të vendeve të industrializuara, po aq sa “tregjet në zhvillim”. Vetë fakti që pushteti tani po zhvendoset nga ‘Perëndimi’ në Indi, Kinë, Rusi dhe Brazil, dhe ne po shkojmë drejt një bote me shumë qendra - disa qytetërime, është një dukuri pasnormale.

Në lidhje me faktin se jemi përballur me pengesa të ngjashme dhe ‘kohë të çuditshme’ në të kaluarën dhe, siç thotë Sam Cole<sup>21</sup>, duke pasur parasysh ‘rezervat e mjaftueshme të papërdorura njohurish’ dhe gjendjen tonë eprorë të përparimit, ne mund t’i zgjidhim të gjitha hallet tona, prandaj duhet të vazhdojmë në rrugën tonë të tanishme. Siç vëren Merryl Wyn Davies, ky është “besim madhështor në të ardhmen, bazuar në hamendësimin se, për shkak se kemi arritur të zgjidhim çështjet tona në të kaluarën, ne do të vazhdojmë ta bëjmë këtë përgjithmonë”.<sup>22</sup> E vërteta e ashpër që duhet kuptuar këtu, është se “rezervat tona të mjaftueshme e të papërdorura të njohurive”, me të cilat ma do mendja se Cole nënkupton përbërjen mbizotëruese të lëndëve akademike, nuk janë të përshtatshme për qëllimet e kohëve pasnormale. Ekonomia, ashtu siç është sot, është shkak kryesor i problemeve tona dhe një faktor kryesor që rrit pabarazinë. Studimet mbi zhvillimin kanë shkatërruar vazhdimisht shoqëritë joperëndimore gjatë dhjetëra viteve të fundit. Shkenca politike është ndoshta sipërmarrja më euro-qendrore e krijuar ndonjëherë nga njeriu.<sup>23</sup> Shumë çështje në shkencë kanë kaluar në pasnormalitet, nga lëndë të përcaktuara si ndryshimi i klimës dhe shkenca e peshkimit, deri te vetë përbërja e veprimtarisë shkencore.<sup>24</sup> Siç pohon Stephen Healy, shkencëtarët tani

21 Cole, Sam (2011) ‘Alliterative Logic: A Theory of Postnormal Times’ *Futures* 43 (2) 209–215 Mars.

22 Davies, Merryl Wyn (2011B) ‘Postnormal Times: Are we There Yet?’ *Futures* 43 (2) 136–141 Mars alexander-cyberwar/all/

23 Lummis, Douglas (2002), ‘Political theory: why it seems universal, but isn’t really’, *Futures* 34 63–73 Shkurt.

24 Ravetz, J R (2013) ‘The Structure of Science in Postnormal Age’, *East-West Affairs* 3–4 Korrik.



duhet të braktisin 'idetë e zotërimit dhe drejtimit' dhe 'të bëhen shërbëtorë të përfundimeve të përshtatura, kryesisht, në kushte shoqërorë'.<sup>25</sup> Lëndët tradicionale janë pjesë e problemit të asaj që na ka çuar në gjendjen e vështirë sot. Ndërsa jo të gjitha njohuritë janë të parëndësishme, një pjesë e madhe e asaj që ka prodhuar modernitetin, është e zhytur në padije, për shembull, padija e kulturave tradicionale dhe e mënyrave vendase të njohjes. Në fakt, teoria e *kohëve pasnormale*, nënkupton tri lloje të padijes: padija e përgjithshme e ndërlikimit të botës që na rrethon, si dhe njohuritë tona për kulturat dhe shoqëritë e tjera; padija e ndërtuar brenda disa çështjeve me të cilat përballemi, përgjigjet e të cilave mund të zbulohen vetëm në kohën e ardhme ('të panjohurat e të njohurave'); dhe ajo që në teorinë e kohëve pasnormale quhet 'E papeshuar', padija që kemi dhe i bëjmë jehonë, ngaqë jemi të paaftë, ose nuk dëshirojmë të shikojmë në drejtime të caktuara (në sajë, kryesisht, të përbërjes së degëve universitare të mirëpërcaktuara), ose të mendojmë përtej shembujve mbizotërues ('të panjohurat e të panjohurave'). Ne s'jemi përballur kurrë me kaq shumë probleme në të njëjtën kohë. Kurrë nuk kemi përjetuar një ritëm kaq të përshpejtuar ndryshimi, apo ndërlidhjeje dhe ndërlikimi të tillë botëror, kurrë nuk kemi qenë kaq të zhytur në padije rreth gjërave që kanë pasojë kaq të mëdha, përtej të kuptuarit tonë. Mënyrat themelore të nxënies, për të bërë dhe për të qenë, thjesht nuk janë të përshtatshme për të na kapërcyer përtej kohërave pasnormale me njerëzimin, mendjen dhe tokën tonë të paprekur.

Cole, gjithashtu, merr në shqyrtim tri shtylla themelore të analizës pasnormale: çoroditja, ndërlikimi dhe mosmarrëveshjet. Ai mendon se trashja përmbledh logjikën e përsëritjes së të njëjtës gjë dhe e gjurmon zanafillën e kësaj logjike në murtajen e shekullit të XIV-të. Kritika mbështetet në hamendësimin/pohimin se "në mungesë të lidhjes së përvojës jetësore midis ideve, njerëzit teorizojnë përmes përsëritjes së këtyre tri fjalëve".<sup>26</sup> Për fat të mirë, nuk mungojnë dëshmitë e 'lidhjes me përvojën jetësore' për mbrojtësit e pasnormalitetit. Ravetz e Functowicz dhe një numër në rritje i studiuesve që merren me shkencën pasnormale, janë munduar për disa dekada të grumbullojnë prova rreth kësaj shkence që

25 Healy, Stephen (2011) 'Postnormal Science in Postnormal Times' *Futures* 43 (2) 202–208 Mars.

26 Cole, Sam (2011) 'Alliterative Logic: A Theory of Postnormal Times' *Futures* 43 (2) 209–215 Mars.



është vërtet e frikshme.<sup>27</sup> Dëshmitë për ndërlikimin e botës sonë tani janë dërrmuese. Provat për kohët pasnormale, në shumicën e lëndëve, po grumbullohen në mënyrë të qëndrueshme. Do të shtoja se do të ishte më e dobishme të shikonim “lidhjen me përvojën jetësore”, midis idesë së kohëve pasnormale dhe asaj që po ndodh në të vërtetë rreth nesh, sesa të luanim me teoritë e diskutueshme të logjikës së përsëritjes. Përsëritja, meqë ra fjala, siç thekson Davies, është ‘pika nga e cila fillon mendimi, kujtesa e ndjenja’. Pajisja është projektuar ‘për të nxitur njerëzit të ndalojnë dhe të mendojnë, më e rëndësishmja, të mbajnë mend urat lidhëse jetësore të të dhënave dhe argumentit’.<sup>28</sup>

Megjithatë, Cole, Gary dhe Kapoor kanë dhënë ndihmesa të dobishme në zhvillimin e teorisë së kohëve pasnormale. Ne duhet t’i kushtojmë vëmendje paralajmërimit të Cole, se çdo përpjekje për të shpërfaqur të ardhmen, nuk bëhet përmes përsëritjeve të mërzitshme, në formë lutjeje. Pohimi i Gary-t, se teoria e kohëve pasnormale ka nevojë për më shumë punë dhe një kuadër të qëndrueshëm, është një vëzhgim i vlefshëm. Kapoor, me të drejtë, thekson se pjesë të mëdha të Indisë dhe Azisë, për të mos përmendur Afrikën dhe Amerikën e Jugut, kanë qenë të paprekura nga moderniteti. Në Indinë fshatarake, analfabetizmi është normë, bujqësia është në gjendje të keqe, qyteteve dhe fshatrave u mungojnë lehtësitë themelore, si energjia elektrike, uji dhe kujdesi shëndetësor. Sigurisht, një sistem i tillë, i cili nuk ka qasje në rrjetin ndërkombëtar, apo i mbushur me vetëkundërshti, nuk mund të shfaqë sjellje çoroditëse dhe të shkojë në pasnormalitet, apo jo?! Përgjigjia për këtë pyetje qëndron në përgjigjen e pyetjes së ngritur nga Merryl Wyn Davies: ‘A jemi ne ende atje?’ Po dhe jo! Ne jemi atje dhe jo atje. Pasnormaliteti nuk është një dukuri e njëtrajtshme: ai nuk prek të gjitha pjesët e tokës në mënyrë të barabartë. Ai mund të dëshmohej në disa ngjarje botërore dhe krahinore, por jo në të tjera. Mund të formësojë zhvillimet e prirjeve në vende të caktuara, por jo në çdo vend. Pra, jo çdo pjesë e botës ka shkuar në pasnormale, por çdo pjesë e botës mund të shkojë drejt pas-

27 Jerry Ravetz (2004), ‘The post-normal science of precaution’ *Futures* 36 (3) 347–357; Ravetz, J R (2013) ‘The Structure of Science in Postnormal Age’, *East-West Affairs* 3–4 Korrik; Ravetz, J R dhe Funtowicz, S O (1999), ‘Postnormal science: an insight now maturing’ *Futures* 31 (7) 641–646; Ravetz, J R dhe Funtowicz, S O (1994), ‘Emergent complex systems’ *Futures* 26 (6) 568–582; O’Connor, M., 2000. Pathways for Environmental Valuation: A Walk in the (Hanging) Gardens of Babylon, *Ecological Economics*, 34(2): 175–194; Martinez-Alier, J (2002), *The Environmentalism of the Poor: a study of Ecological Conflicts and Valuation*. Edwards Elgar, Londër. Laugharne, Richard dhe Laugharne, Jonathan (2002), ‘Psychiatry, postmodernism and postnormal science’, *Journal of the Royal Society of Medicine* 95 (4) 207–210.

28 Davies, Merryl Wyn (2011B) ‘Postnormal Times: Are we There Yet?’ *Futures* 43 (2) 136–141 Mars alexander-cyberwar/all/



normales. Mund të dallohet në sisteme të caktuara, ekologjike, ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore, por jo në të gjitha sistemet. Gjithçka varet nëse sistemi plotëson kushtet themelore të rrjeteve, ndërlikim, vlerësim të sigurtë dhe mosmarrëveshje. Ndërsa bëhemi gjithnjë e më shumë të ndërlidhur, ndërsa rrjetet bëhen gjithnjë e më mbizotëruese, ne do t'i afrohemi gjithnjë e më shumë gjendjes pasnormale.

## GJENDJA PASNORMALE

Gjendja pasnormale është mënyra e veçantë e qenies dhe pranisë në të cilën gjendemi. Ne po përballemi me çështje që janë shumë të ndryshme në përmasa dhe janë të ndërlidhura dhe të ngulitura në ritmin e përshpejtuar të ndryshimit. Përmasat, rrjetet dhe përshpejtimi gjallërojnë tri shtyllat - ndërlikimin, çoroditjen dhe mosmarrëveshjet e kohëve pasnormale, të cilat na çojnë drejt pasigurisë dhe padijes. Si shembull të dukurisë pasnormale, mendoni për Greqinë, një shtet deri diku i pasur, që u katandis në varfëri të tmerrshme pothuajse brenda natës. Mendoni se sa shpejt është tjetërsuar pamja e Lindjes së Mesme. Diktatori tunizian u rrëzua për 28 ditë dhe u zëvendësua me një demokraci parlamentare. Në tre vjet, Egjipti u rrotullua si një kokë, nga diktatura në demokraci dhe përsëri në diktaturë.<sup>29</sup> Kryengritja siriane filloi me pjesëmarrës të përcaktuar qartë: opozitën demokratike kundër sundimit të egër të Presidentit Asad. Shumë shpejt, ajo u bë një rrjet i ndërlikuar pjesëmarrësish të shumtë: demokratë, revolucionarë, islamikë, Hezbollahu i Libanit, milicia iraniane, shiitë, sunitë, alevitë, grupe pro dhe kundër qeverisë, duke bërë kërkesa të kundërta dhe duke luftuar njëri-tjetrin. U bë e pamundur të thuhej se kush ishte kush, kë dhe cilën anë duhej të mbështeste Perëndimi.<sup>30</sup> Përplasja në Siri lindi një grup të panjohur deri më tani, që e quajti veten Shteti Islamik i Irakut dhe Levantit (ISIS). Brenda disa muajsh, ai zotëroi një hapësirë më të madhe se Britania e Madhe, nga Alepo në Siri, deri në Mosul të Irakut. Siç e tha edhe gazeta *Guardian*, u bë "fuqia ushtarake më e aftë në Lindjen e Mesme, jashtë Izraelit". Grumbulloi miliarda dollarë në të holla dhe tjetërsoi vetë idenë e terrorizmit, për të përdorur fjalët e Sekretarit të Shtetit Amerikan, Chuck Hagel:

29 Sardar, Z (2013b) 'The Future of Arab Spring in Postnormal Times' *American Journal of Islamic Social Sciences* 30 125-136 Fall.

30 Sardar, Z dhe Yassin-Kassab, R (2014), *Critical Muslim* 11: Syria, Hurst, Londër.



“përtej çdo gjëje që kemi parë deri tani”.<sup>31</sup> Shkalla dhe shpejtësia - të arritura pjesërisht me përdorimin e zgjuar të mediave digjitale dhe botërore - me të cilat ekstremi i ‘Shtetit Islamik’, aq barbar, saqë edhe grupet e vjetra terroriste (si Al-Kaeda) iu shmangën, hodhën themelet për një financim mëse të mjaftueshëm ushtarak. Dhe rritja politike ishte vërtet befasuese. Paul Danahar vë në dukje se “Siguritë e Lindjes së Mesme të vjetër” janë “shkatërruar” brenda pak muajve.<sup>32</sup> Në anën tjetër të botës, Rusia ishte në gjendje të përvetësonte Krimenë brenda një jave, ndërsa qëllimet mospajtuese dhe të kundërta në Ukrainë nuk janë më pak të ndërlikuara. Për të zgjidhur çështjen e talebanëve në Afganistan dhe Pakistan, duhet të përballlemi me qindra lloje të ndryshme talebanësh, që mbulojnë të gjithë spektrin fisnor dhe politik, secili me kërkesat e veta të përcaktuara.

Ngjarjet e fundit politike tregojnë se nuk kemi të bëjmë më me një varg ngjarjesh të shkëputura, të natyrës krahinore, të ndashme në kohë, që prekin një pjesë të vogël të njerëzve ose një bashkësi të vogël dhe që trazojnë një numër të vogël ecurish. Ndryshimet që ne dëshmojmë sot, janë të shpejta dhe botërore. Ato shtrihen për të prekur çdo anë të jetës së njeriut dhe të institucioneve shoqërore, politike, ekonomike. Kissinger vëren se “Rendi botëror” po ndryshon me “pak ose aspak kufizime”, në një mënyrë kaq të ndërlikuar, saqë nuk ka “një shpjegim të thjeshtë - apo edhe mirëkuptim”.<sup>33</sup> Megjithatë, në kushte pasnormale, ngjarjet dhe rrethanat zhvillohen me shpejtësi dhe çoroditja mbështjell mbarë botën. Të pasurit, për shembull, bëhen më të pasur me shpejtësi marramendëse. Tani ka më shumë miliardë sesa përpara rënies ekonomike të vitit 2009: 1126 miliardë në vitin 2012, krahasuar me 739 në 2009-n. Në prill 2013, *Bitcoin* vlerësohej me 213 dollarë. Tetë ditë më vonë, ishte 63 dollarë. Disa muaj më vonë ishte 1200 dollarë. Brenda një viti nga fillimi i vet, *Wikileaks* kishte grumbulluar 1.2 milionë shkresa të fshehta.<sup>34</sup> Twitter doli papritur dhe u hodh në tregjet ndërkombëtare brenda shtatë viteve, me një vlerë prej 34.7 miliardë dollarë (në fakt, askush nuk e di se sa vlen në të vërtetë). Një shpërthim vullkanik në Islandë, në prill të vitit 2010, çoroditi Europën dhe ndaloi trafikun e linjës ajrore për më shumë se një javë. Malala Yusufzai, një nxënëse shkolle, e qëlluar nga talebanët, u shndërrua nga një përdoruese e panjohur e rrjeteve shoqërore, për t’u bërë një simbol botëror brenda gjashtë muajve. Ndërsa

31 Chulow, Matin (2014) ‘The Isis offensive aims to split Syria in two’, *The Guardian* 23 Gusht f. 4.

32 Danahar, Paul (2014), *The New Middle East*, Bloomsbury, Londër.

33 Kissinger, Henry (2014), *World Order: Reflections on the Character of Nations and the Course of History*, Allan Lane, Londër

34 Leigh, David dhe Harding, Luke (2013), *WikiLeaks: Inside Julian Assange’s War on Secrecy*, Guardian Faber Publishing, Londër.



brenda një viti ajo mbante ligjëratë në Kombet e Bashkuara dhe kishte botuar jetëshkrimin e vet<sup>35</sup>, brenda dy viteve fitoi Çmimin Nobel për Paqe. Në anën tjetër të krahut politik, pastori Terry Jones, një prift i panjohur i një qendre të parëndësishme për të krishterët gjithëpërfshirës në Gainsville, Florida, shkaktoi çoroditje, kur kërcënoi se do të digjte Kuranin, në shtator 2010. Kërcënimi i tij u përçua nga kanalet televizive botërore, a thua se donin të përsëritnin vetveten pafund. E gjithë bota myslimane kundërveproi menjëherë dhe pa menduar. U mbajtën tubime, u dogjën ambasada, vdiqën njerëz të pafajshëm, u dogjën dyqane dhe transporti publik. Të gjitha këto gjallëruan edhe më shumë vëmendjen televizive dhe shqyen rrjetet shoqërore. Sekretarja e atëhershme amerikane e Shtetit, Hillary Clinton, tha e prekur: “Është për të ardhur keq, që një grup kaq i vogël njerëzish kanë marrë kaq shumë vëmendje për një veprim të dyshimtë dhe të turpshëm”.<sup>36</sup> Megjithatë, jo të gjitha ngjarjet çoroditëse gjallërojnë ‘vëmendjen e botës’. Kujtoni ‘rëniet e menjëhershme në bursa’, që në minuta mund të heqin trilionat nga vlera e tregut. Një rënie e veçantë ndodhi më 6 maj 2010, kur në orën 14:30 me kohën lokale, u shfaq diçka e papritur:

Një luhatje në çmimin e marrëveshjeve të së ardhmes për ndërmarrjen E-mini, pastaj një mall hidhet për t’u provuar në bursën e Çikagos dhe shihet si një ogur i mirë. Pothuajse askush nuk e vëren, derisa luhatjet bëhet drithërima të vrullshme, teksa çmimet lëvizin poshtë e lart, dalldia E-mini përhapet në bursat e tjera dhe treguesit fillojnë të bien. Brenda sekondave, bursa e Nju Jorkut ka humbur 100 pikë. Punonjësit e financave kthehen tek ekranet e tyre. Por disa sekonda më vonë, bursa bie me 100 pikë të tjera dhe menaxherët fluturojnë nga zyrat e tyre, duke bërtitur: “Tërhiquni nga shit-blerja”, ndërsa tregtarët shtypin pullat e tastierave të kompjuterëve, duke anuluar porositë, në përpjekje për të kufizuar dëmin. Të tmerruar, ata mblidhen në hapësirat e përbashkëta dhe shikojnë rënien e çmimeve pikiatë, me një vrull të frikshëm dhe të paepur, si të qenë gërvishur nga një fëmijë hatërmbetur.

300 pikë më poshtë...

400 pikë...

500 pikë...

Kur humbi 600 pikë, bursa e Nju Jurkut ka rënë më shumë sesa kur mori lajmin për falimentimin e bankës Lehman Brothers, në 2008-n. Mirëpo, ajo rënie zgjati një ditë, kurse kjo, sa hap e mbyll sytë... Edhe 11 shtatori nuk e tronditi bursën si kjo, që do të thotë se diçka e tmerrshme ka ndodhur... (dhe askush nuk mund t’i ndërpresë shit-blerjet, sepse) ndërprerësit e paraparë për të ndaluar tregtinë, pas lëkundjeve të tilla të panatyrshme, punojnë vetëm deri në orën 14:30 dhe tani

35 Yousafzai, M (2013), *I am Malala*, Weidenfeld and Nicolson, Londër.

36 CBS News (2010), ‘Hillary Clinton: Qur’an burning not American way’, cbs News Shtator 8. [www.cbsnews.com/news/hillary-clinton-quranburning-not-american-way/](http://www.cbsnews.com/news/hillary-clinton-quranburning-not-american-way/)



është ora 14:47. Bursa e Nju Jorkut rrokulliset drejt një humbjeje të pashembullt prej 1000 pikësh dhe 11 për qind të vlerës. Më pas ndodh diçka edhe më e çuditshme: ndërsa i afrohet fundit të botës, tregu ndërron drejtim dhe fillon të ngrihet, po aq papritur sa ç'ra.<sup>37</sup>

Të tilla 'humnera' çoroditëse janë pjellë e natyrshme e një metode rrjetesh të ndërlikuara, që mund të përshpejtohen me shpejtësi mahnitëse. Tregu dhe sistemi ekonomik tani nuk drejtohen nga tregtarë tradicionalë, por nga formula të ndërlikuara matematikore, rregullore programimi dhe rrjete kompjuterike, të gjitha këto ofrojnë një shtresë respekti shkencor për themelet e tyre intelektuale. Për shembull, një model derivat i përdorur gjerësisht, i njohur si modeli Black-Scholes<sup>38</sup>, me sa duket, mund të vlerësojë mundësitë teorike të mënyrës europiane të tregtimit të letrave me vlerë. Ky model ofroi mbështetje ligjore shkencore për veprimtaritë e Këshillit të Mundësive të Shkëmbimit në Çikago, duke sjellë një rritje të mahnitshme në tregjet e letrave me vlerë, në mbarë botën. Por bursat nuk janë më si dikur. Shitblerja tradicionale, siç thotë Michael Lewis, në *Flash Boys*,<sup>39</sup> është zhdukur. Bursa e Nju Jorkut, për shembull, nuk është më një hapësirë fizike – është mbi një duzinë 'bursash' të vendosura rreth Nju Jorkut, secila një fermë serverësh me kompjuterë që zbatojnë rregulloret. Në këtë hapësirë virtuale të programuar e të rrjetëzuar, me një ndërlikim të jashtëzakonshëm, aksionet blihen dhe shiten me shpejtësinë e dritës, madje edhe një përparësi prej një të qindtat e sekondës mund të sjellë fitime të mëdha. Algoritmet e grabitqarëve gjuajnë lojtarë më të ngadaltë, ashtu sikurse një tufë piranjash mund të gjuajnë një ka". Nuk është për t'u habitur, sikurse për shumicën e kompjuterëve dhe rrjeteve, edhe bursat kanë prirje të çoroditen dhe të bien.

## KAOSI I KLIMËS

Sjellja çoroditëse e tregut dhe trazirat politike në mbarë botën janë vetëm dy shembuj të dukurisë pasnormale që ne mund të vëzhgojmë hëpërhë. Një tjetër kandidat i dukshëm, është ndryshimi i klimës. Fatkeqësitë e shkaktuara nga moti janë po aq të zakonshme, sa të ftohtët e zakonshëm.

37 Smith, Andrew (2014), 'What Just Happened', *The Guardian Weekend* 7 Qershor 23–33.

38 Black, Fischer dhe Myron Scholes (1973), 'The pricing of options and corporate liabilities', *Journal of Political Economy* 81 (3) 637–654.

39 Lewis, Michael (2014), *Flash Boys*, Allan Lane, Londër.





Krahina e Panxhabit në Azinë Jugore, që mbulon Pakistanin dhe Indinë, përmbytet rregullisht, duke vrrarë qindra njerëz çdo vit. Gjatë vitit 2013, bota pati një rekord prej 41 fatkeqësish të motit, duke tejkaluar nivelin më të lartë të vetëm tre viteve më parë. Kalifornia ka përjetuar një thatësi të rëndë për disa vite. 2013, ishte viti më i thatë në Kaliforni, që nga viti 1580. Në vitin 2014, Çikago përjetoj një “vorbull polare” historike. I gjithë qyteti ishte i ngrirë, duke përfshirë Liqenet e Mëdha. Britania përballet pikërisht me shqetësimin e kundërt: përmbytjet biblike. Përmbytja e madhe në Anglinë jugperëndimore, gjatë viteve 2013–2014, e shoqëruar me përhapje të përmbytjeve, theu një rekord 250-vjeçar. Lumi Tamiz ka rrjedhur në nivelin e tij më të lartë, që nga viti 1883. Shtrëngata Jolanda, që udhëtoi nëpër Filipine, në nëntor 2013, lëvizte me shpejtësinë e papërfytyrueshme të një treni plumb japonez (mbi 320 km/orë), duke shkatërruar gjithçka që i doli përpara.<sup>40</sup> Oqeanet e botës po ngrohen, ndërsa shtresat polare të akullit po shkrihen dhe akullnajat në mbarë botën po zvogëlohen. Ndërthurja e këtyre ndryshimeve po rrit nivelin e detit. I gjithë bregdeti i Floridës po gërryhet nga valët e detit, ndërsa bregu perëndimor i Majamit përballet me një rrezik të menjëhershëm të fundosjes në nivelin e detit.<sup>41</sup> Maldivet, të përshkruara si “niveli zero” i ndryshimeve klimatike, janë në rrezik të fundosjes tërësisht në det. Nga ana tjetër, pjesë të mëdha të botës po thahen. Australia është përballur disa vite me thatësi të ashpër. Thatësira e vitit 2006 u tha se ishte më e keqja në mijëra vjet, duke prekur pothuajse 80% të Kuinsland-it. Kalifornia është në “prag të një thatësie të tillë epike, me sistemet e rezervave ujore nëntokësore, aq të shteruara, sa që shenjat mund të dallohen nga satelitët që udhëtojnë 400 km mbi sipërfaqen e Tokës”.<sup>42</sup>

Rritja e temperaturave ka sjellë prishjen e baraspeshës në natyrë, e shkaktuar nga lëvizja e gjallesave në përpjekje për të gjetur ujë të ftohtë, ose për t’u përshtatur me rritjen e temperaturës. Shkalla dhe shpejtësia me të cilën gjallesat pushtuese po përhapen në mbarë botën, është e pashembullt. Vetëm në SHBA, ka mbi 50.000 gjallesa të huaja që bëjnë kërdinë me florën dhe faunën. Në Karaibe, peshku luan përgjon shkëmbinj-të koralorë të jetës nënujore. Në Teksas, derrat e egër harbohen nëpër fushat e bujqve. Në veriperëndim, krimbi i blertë i drurit i kthen pemët në shkarpa. Në Liqenet e Mëdha, një lloj butaku ndërthen tubacionet dhe

40 Stevenson, Tony (2013) ‘Yolanda’s Colour’ *East West Affairs* 3 Korrik–Shtator 21–28.

41 Mckie, Robin (2014), ‘How long before the ocean claims Miami?’, *The Observer* 3 Gusht, f. 20–22.

42 Goldenberg, Suzanne (2014), ‘Why Global Water Shortages Pose Threat of Terror and War’, *The Observer* 9 Shkurt 29–31.





rubinetet, duke i bërë termocentralet të pavlefshme'.<sup>43</sup> Ngrohja e detit në brigjet e Ishujve britanikë e ka detyruar peshkun e preferuar të Britanisë, merlucin, të kërkojë për ujëra të ftohta drejt veriut. Llojet e tjera të njohura, si shojza dhe gjuhëza, janë gjithashtu në rënie. Nga ana tjetër, ngrohja e deteve ka qenë e mirë për kandilin e detit, ku popullsia e tyre po rritet me shpejtësi. Nëse udhëtoni me anije nga Malajzia në Indonezi, gjithçka që do të shihni, janë tufa të pafundme me kandila deti. Në vitin 1999, tufat e kandilave ngecën dhe kjo shkaktoi mbylljen e termocentralit Sual me qymyr në Luzon, Filipine, duke shkaktuar një frikë të madhe. Në vitin 2006, kandili i detit bllokoi sistemin e ftohjes së *USS Ronald Reagan*, që në atë kohë ishte aeroplanmbajtësja më e përparuar në botë, duke e gjymtuar anijen prej 5 miliardë dollarësh. Në shtator 2013, një lulëzim i gjerë i një lloji kandili deti, i përhapur në të dyja anët e Atlantikut të Veriut, bllokoi termocentralin bërthamor Oskarsham, në Suedi, dhe e detyroi të mbyllet.<sup>44</sup> Ndërsa uji i ngrohtë krijon cekëtina 'normale', i detyron peshqit të kërkojnë ujë të ftohtë dhe bota shtazore vuan pasojat. Zogjtë e detit në Gjirin Maine, për shembull, po shkojnë drejt zhdukjes, ngaqë të vegjlit e tyre nuk mund të gëlltisnin peshkun. Në të vërtetë, temperaturat në rritje kanë zhdukur të gjitha mikrogjallesat që mbështetin të gjithë rrjetin ushqimor të Maine.<sup>45</sup> Tjetërkund, 'ylli i detit po tretet në llumë dhe askush nuk e di pse'.<sup>46</sup> Nëse prirje të tilla vazhdojnë, një e katërta e gjallesave të Tokës mund të shkojnë drejt zhdukjes, deri në vitin 2050.

Më 9 maj 2014, përqendrimi atmosferik i dyoksidit të karbonit, gazit që ndihmon më së shumti ngrohjen globale, arriti në nivelin e rrezikshëm prej 400 pjesë për milion (ppm) - një nivel i paparë në histori. Kështu, ndryshimi i klimës nuk është më një kërcënim teorik i së ardhmes, por një e vërtetë e kohëve pasnormale. Në një botë të globalizuar, të ndërlikur, nuk ka vend për t'u fshehur nga ndryshimet klimatike.

Shkenca e klimës na ofron, gjithashtu, një shembull të mirë të shkencës pasnormale. Siç vëren Hans von Storch dhe të tjerë, në parathënien e tyre të botimit të veçantë, *Natyra dhe Kultura*, mbi 'Shkencën e Klimës Pasnormale', ndryshimi i klimës 'ka shumë veçori që e bëjnë të vështirë trajtimin e tyre përmes veprimit normal shkencor'. Në përgjithësi, vendimet duhet të merren shumë më përpara se provat mbështetëse përfundimtare të jenë të

43 Sweeny, John (2013) 'Signs of Postnormal Times' *East-West Affairs* 3-4 Korrik 5-12.

44 Po aty.

45 Jacobson, Rowan (2014) 'Something is seriously wrong on the east coast—and it's killing all the baby puffins' *Mother Jones* May-Qershor.

46 Lunau, Kate (2014) 'B.C. starfish are dissolving into goo, and no one knows why' *Macleans* Qershor 13.



disponueshme dhe rreziqet e vendimmarrjes janë të larta. Ndikimet e mundshme të vendimeve të gabuara mund të jenë tepër të mëdha. Në rrethana të tilla, aktorët priren të mos pajtohen fort mbi vlerat që duhet të udhëheqin vendimmarrjen, si për shembull, mirëkuptimi ose rritja ekonomike. Themelet e disponueshme të njohurive, zakonisht, shquhen për kuptimin e papërsosur (dhe katandisja e tyre në modele të thjeshta) të metodave të ndërlikuara gjithëpërfshirëse. Modelet, mënyrat e veprimit dhe hamendësimet mbizotërojnë në vlerësimin e këtyre çështjeve. Shumë mendime të vlefshme (të fshehura) që anojnë në një drejtim të caktuar, flenë brenda kuadrit të çështjeve, treguesve të zgjedhur dhe hamendësimeve të bëra.

Në rrethana të tilla, hamendësimet e thjeshta të shkakut dhe provave, eksperimentet e kontrolluara që janë të riprodhueshme, nuk janë shumë të dobishme. Jemi përballë një morie pasigurish që nuk mund të zgjidhen. “Ne nuk mund të kryejmë një varg eksperimentesh me të dhëna të kënaqshme, të riprodhueshme, për të provuar ndikimin e përqendrimeve më të larta të gazit serrë në atmosferë, sepse ka vetëm një Tokë të disponueshme, madje edhe ajo mbikëqyret mjerisht”. Për më tepër:

Vlerësimet shkencore të ndryshimeve klimatike mbështeten në mënyrë të pashmangshme, në një përzjerje njohurish, hamendësimesh, modelesh, skenarësh, vlerësimesh e përfundimesh, të njohurash e të panjohurash. Për shkak të themelit të kufizuar të njohurive, vlerësimet shkencore do të përdorin në mënyrë të pashmangshme gjykimet e të aftëve dhe gjykimet emërore të probabilitetit. Kjo përfshin të lënat nga njohuri që ndryshojnë gjendje, duke mbuluar të gjithë spektrin, nga njohuritë e mirëthemeluara, deri te gjykimet, hamendësimet e mençura, hamendësimet paraprake, madje edhe arsyetimet e papërpunuara. Kërkimet mbi ndryshimet klimatike përfshijnë një larmi të madhe lëndësh shkencore që çojnë në dukurinë, tashmë të ditur, se, kur të dhënat sasiore prodhohen sipas teorisë së caktuar të një lënde, por përdoren në rrethana të tjera, paralajmërimet e rëndësishme priren të shpërfillen, pasiguritë të ngjeshen dhe numrat përdoren sa për sy e faqe.<sup>47</sup>

Problemi kryesor këtu, është zbatimi i ‘shkencës normale’ dhe metodat e saj në kushte pasnormale.

Por shkenca nuk është kthyer në pasnormale vetëm në metodën dhe mënyrat e saj të veprimit. Tradicionalisht, shkenca është paguar nga qeveritë dhe sipërmarrjet e mëdha, atë që Presidenti Dwight Eisenhower, e përshkroi në fjalimin e tij të lamtumirës, në janar 1961, si “fiksimi ushtarako-industrial i kuvendit”. Ndërsa një pjesë e shkencës paguhet ende nga qeveritë dhe ndërmarrjet shumëkombëshe, një përqindje në rritje tani

47 Werner Krauss, Mike S Schäfer dhe Hans von Storch, editors, ‘Postnormal Climate Science’, *Nature and Culture* Volumi 7, Numër 2, Verë 2012.



paguhet në mënyrë vetjake nga drejtorë të fondeve mbrojtëse, miliarderët e programeve kompjuterike, pasanikë të ndryshëm - që *Internacionalistët e Rinj*<sup>48</sup> i përshkruajnë si 'pasanikët e egër'. Njerëz si Sergey Brin i Google, Paul Allen i Microsoft, Richard Branson i Virgin dhe Jeff Bezos i Amazon, e shumë të tjerë kanë derdhur shuma marramendëse në kërkime shkencore që tejkalojnë çdo shumë që mund të paguajë qeveria. Sigurisht, ata nuk e ndihmojnë të gjithë shkencën, vetëm atë pjesë që ata parapëlqejnë. Ndoshta sepse një anëtar i familjes ka vdekur nga një kancer i caktuar, ose ngaqë një shkencë e caktuar mund të hapë një treg të ri, ose ngaqë ndjenja e madhështisë mund t'ua shërojë unin që kanë brenda vetes. Këta njerëz nuk kanë për qëllim kërkime themelore, por skema madhështore, si hulumtimi i hapësirës, minierat nën det, apo miqtë e oligarkut rus, Dimitri Itskov, një ish-pronar mediash, që janë mishërim i hyjnisë së gjallë. Siç vë në dukje Steven Edwards, i Shoqatës Amerikane për Përparimin e Shkencës, "përdorimi i shkencës po ngjizet më pak nga përparësitë kombëtare ose këshilli shkencor dhe më shumë nga shijet e veçanta të njerëzve me shuma të mëdha parash".<sup>49</sup>

E gjithë kjo nuk është e ardhmja. Kjo është e tashmja pasnormale: gjendja e botës, *Espiritu del tiempo*, shpirti i epokës.

## E TASHMJA E ZGJERUAR PASNORMALE

Megjithatë, pasnormaliteti është i vendosur të rritet në të ardhmen e afërt. Në teorinë pasnormale ne e quajmë atë "e tashmja e zgjatur" - kjo është e ardhmja e afërt e 10-15 viteve të ardhshme, që do të formësohet nga prirjet dhe zhvillimet e rrënjësura që mund të vërejmë sot. Kjo nuk do të thotë se këto prirje nuk mund të dalin nga shinat, ose që na paraqesin një të ardhme të caktuar të vetëkuptueshme. Prirja, siç është thënë shumë herë më parë, nuk është fat, por për të arsyetuar se, nëse këto prirje vazhdojnë, ne do ta gjejmë veten në një botë gjithnjë e më pasnormale. Më qartësisht, prirjet e lidhura me kapitalizmin, sistemet shëndetësore dhe mjekësore, të dhënat gjithëpërfshirëse dhe gjendja e shoqërisë po na çojnë me shpejtësi drejt një të tashmeje të zgjatur pasnormale. Vlen të përmendet se tri shtyllat: ndërlikimi, çoroditja dhe mosmarrëveshjet - nuk hyjnë në punë njësoj në të gjitha rrethanat. Në disa raste, ndërlikimi mund të jetë lojtari më i madh; në të tjerat, mund të jetë çoroditja ose mosmarrëveshjet. Por,

48 New Internationalist (2013a), 'The feral rich' *New Internationalist* Janar.

49 Broad, William J (2014) 'Face of science is reshaped by billionaires' *The New York Times* 23.



në përgjithësi, ndërsa këto tri shtylla përshpejtohen dhe rriten, ato ndërthuren për të krijuar një rrethanë pasnormale.

Mendojeni pak kapitalizmin. Mangësitë dhe mosmarrëveshjet e rendit kapitalist nuk janë thjesht pasojë e “Rrënimit ekonomik të 2008-2009”. Ato janë thellësisht në brendësi të sistemit që është bërë shumë i ndërlikuar, shumë i ndërlidhur, shumë mospërputhës, shumë i zhytur në pasiguri dhe padije të thellë, i paaftë për të qenë çdo gjë tjetër, veçse çoroditje. Në të vërtetë, çdo sistem i mbështetur në idenë, se ekonomia është shuma e veprimeve të atomizuara të miliona njerëzve të arsyeshëm që kërkojnë fitim, ku tregjet janë të qëndrueshme, faktet janë të sigurta, vlerat e qarta dhe barazia e gjithanshme, detyrimisht do të rrënohet në një botë ku ‘faktet janë të pasigurta, vlerat në mospërputhje, rreziqet e larta dhe vendimet që merren me ngulm’.<sup>50</sup>

Sipas Bernard Schwartz, njohës i mirë investimesh dhe botues i revistës *Democracy*, në sistemin financiar ‘ka ndodhur një ndryshim i jashtëzakonshëm’. Në vend që të ndërtonin rrugë dhe ura shumë të nevojshme, ose punishte që prodhojnë mallra dhe hapin vende pune, tregtarët janë dhënë pas shkëmbimeve të ndërlikuara të borxhit dhe “prodhimeve” të tjera të hamendësuara, kështu pasurohen vetëm duke qenë ndërmjetësues. Disa prej tyre qenë aq të ndërlikuara dhe të pështjelluara, siç e dimë tashmë, saqë nuk u kuptuan as nga vetë ata që drejtonin qendrat e investimeve. Vërejtjet më të zakonshme që Schwartz dëgjon nga ‘gjithnjë e më shumë njerëz’, janë: ‘sistemi ynë themelor është i shkatërruar’ dhe ‘sistemi financiar është i padobishëm’.<sup>51</sup> Nuk është vetëm sektori financiar, por i gjithë sistemi i mallkuar ekonomik që tani gjendet përtej mundësisë së ndreqjes.

Sipas David Simon, krijues i shfaqjes së njohur televizive “The Wire”, kapitalizmi është kthyer në një “argëtim të tmerrshëm”.<sup>52</sup> Bankierët nuk janë jashtë kontrollit, ata janë ‘përtej mundësisë për t’u kontrolluar’, thotë holandezi Joris Luyendijk, që shkruan për ekonominë dhe drejton bashkëbisedime në rrjete shoqërore për gazetën *The Guardian*.<sup>53</sup> Pasi mori në pyetje mbi 200 bankierë, Luyendijk doli në përfundimin: “Punonjësit në bankat e mëdha nuk besojnë se drejtuesit e tyre e dinë se çfarë po ndodh. Bankat e mëdha thjesht janë bërë shumë të ndërlikuara dhe shumë të mëd-

50 Ravetz, J R dhe Funtowicz, S O (1999), ‘Postnormal science: an insight now maturing’ *Futures* 31 (7) 641–646.

51 Schwartz, Bernard (2014), ‘Just say Yes’ *Democracy* 33 115–120 Summer.

52 Simon, David (2013), ‘There are two Americas. My country is a horror show. Capitalism is not a blueprint for building a society’, *The Observer* ‘In focus’, 8 Dhjetor.

53 Luyendijk, Joris (2013), ‘Our banks are not merely out of control. They’re beyond control’, *The Guardian* 19 Qershor.



ha për t'u drejtuar". Të drejtosh një bankë në ditët e sotme është si të 'luash ruletë ruse me kokën e dikujt tjetër'. I gjithë sistemi është "shumë i çrregullt, i rrënjësor thellë dhe jashtëzakonisht shpërdorues, si për punëtorët e vet, ashtu edhe për shoqërinë në të cilën vepron". Arsyetime dhe ndjesi të ngjashme jehojnë në një varg librash të kohëve të fundit, si për shembull: Kjo ndryshon gjithçka, nga Naomi Klei<sup>54</sup>; Jepini fund këtij depresioni, nga Paul Krugman<sup>55</sup>; *Shtatëmbëdhjetë mospërputhjet dhe fundi i Kapitalizmit*, nga David Harvey.<sup>56</sup> Të gjitha këto na lënë të kuptojmë se:

**KAPITALIZMI DHE I GJITHË SISTEMI EKONOMIK I MBËSHTETUR NË "TË, PO KTHEHET ME SHPEJTËSI NË PASNORMAL. ËSHTË VETËM ÇËSHTJE KOHE, SIPAS TEORISË SË KOHËVE PASNORMALE, PARA SE TË NA ÇOJË BUZË GREMINËS,**

– ...ose hidhet në erë dhe shembet, ose krijon një rend të ri, një tjetërsim të rrënjësor në një mënyrë më të qëndrueshme për të jetuar dhe për të bërë tregti.

Në thelb të sistemit ekonomik qëndrojnë hamendësimet që parashatrojnë mospërputhjet themelore të tij. Për shembull, kjo rritje është thelbësore dhe do të vazhdojë në të ardhmen e largët. Shifra e përkryer që çdo vend duhet të synojë të rrisë, duhet të jetë 4.5%. Megjithatë, siç vëren bankieri i investimeve, Jeremy Grantham, "fakti është se asnjë rritje përmes ndërlikimeve nuk është e qëndrueshme".<sup>57</sup> Për të treguar se sa e paqëndrueshme është kjo në jetën e përditshme, Grantham na këshillon të përfytyrojmë një kulturë të lashtë egjiptiane e cila kërkon të rritet me 4.5%. Sa pasuri do të kishin grumbulluar pas 3000 vjetësh? Përgjigjja: e barasvlershme me 2.5 miliardë sisteme diellore. Me një rritje vetëm prej 1%, pasurinë e tyre nuk do ta zinte planeti. Edhe një normë e ulët e rritjes prej 0.1% do të shkatërronte sistemin. Kështu, fatat e pasnormalitetit janë të pandara nga vetë ideja e rritjes. Sa më shumë rritje ekonomike të kemi, aq më pasnormalë bëhemi.

Por, në rendin kapitalist është edhe çështja e pabarazisë së pandashme. Siç tregon Thomas Piketty në studimin e tij të shkëlqyer, *Kapitali në*

54 Naomi Klein (2014) *This Changes Everything*, Simon and Schuster, New York.

55 Paul Krugman (2013) *End This Depression Now*, W W Norton, New York.

56 Harvey, David (2014), *Seventeen Contradictions and the End of Capitalism*, Profile Books, Londër.

57 Grantham, Jeremy (2012), 'On the road to zero growth' *GMO Quarterly Letter* Nëntor; www.cfasf.org/files/Grantham%20letter%20Nov%202020.pdf 103



*shekullin e njëzetë e një*<sup>58</sup>, kapitalizmi, në fakt, e ka rritur pabarazinë gjatë dy shekujve të fundit. Arsyetimi kryesor i Piket-it, i mbështetur nga të dhëna të shumta, është se, kur shkalla e kthimit të kapitalit tejkalon shkallën e rritjes së prodhimit dhe të ardhurave, kapitalizmi prodhon vetvetiu pabarazi të diktuar dhe të paqëndrueshme. Nëse vazhdojmë të hiqemi sikur asgjë s'ka ndodhur, do të kthehemi në nivelet e pabarazisë që e dallonte periudhën mesjetare dhe në shumë vende tashmë mund të kemi mbërritur tek ato nivele. Parashikimet e fundit të Shoqatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik për ekonominë botërore, deri në vitin 2060, na lënë të kuptojmë pikërisht një skenar të tillë.<sup>59</sup> Ajo parashikon ngadalësim të rritjes në dy të tretat e normës së saj të tanishme me rritje të theksuar të pabarazisë, pavarësisht se bota bëhet katër herë më e pasur, më frytdhënëse, më e globalizuar dhe më e arsimuar.

Pabarazia e pakuptimtë midis rrogave të drejtorëve dhe punëtorëve ka tërhequr shumë vëmendjen e qytetarëve. Por ka një lloj tjetër pabarazie në horizont. Njerëzit që shkruajnë dhe drejtojnë rregulloret e tregut, nuk janë financues, përfaqësues, bankierë investimesh, apo edhe programues. Ata janë fizikanë kuantikë, shkencëtarë të klimës dhe teoricienë të matematikës - të njohur si shqyrtuesit sasiore. Aftësitë e tyre teknike, jo vetëm që ua mundësojnë atyre të anashkalojnë rregullimin dhe mbikëqyrjen publike, por, gjithashtu, i fuqizon duke krijuar një lloj të ri pabarazie. Vetë rregulloret janë krijuar për t'u pasuruar njerëz të caktuar në kurriz të disa të tjerëve, si dhe për t'i dhënë përparësi një ane të caktuar të botës së globalizuar, në kurriz të anëve më të rëndësishme që përmirësojnë jetën. Siç tregon Costas Lapavitsas, në botimin *Përfitim pa prodhuar: Si financat na shfrytëzojnë të gjithëve*<sup>60</sup>, financat helmuese kanë hyrë në çdo anë të botës sonë të globalizuar, që nga lejet për tregjet e karbonit e deri te prejardhja e larmisë, nga letrat e tmerrshme me vlerë e deri te zanafilla e motit.

Për më tepër, rregulloret e hartuara nga *shqyrtuesit sasiore* tani janë gati të marrin përsipër pjesën më të madhe të jetës sonë. Ato tashmë janë përdorur në shërbimet e takimeve në internet. Së shpejti, rregulloret do të përdoren për përfshirjen, vlerësimin e studentëve, dhënien e përfitimeve, shërbimin shëndetësor dhe plot të tjera përveç kësaj. Pra, mundësia për "rrënim të çastit" dhe sjellje çoroditëse do të rritet shumëfish, siç do të shtohen tubimet kundër pabarazisë, korrupsionit dhe keqpërdorimit të

58 Piketty, Thomas (2014) *Capital in the Twenty-First Century*, translated by Arthur Goldhammer, The Belknap Press, Boston.

59 Braconier, Henrik (2014), Giuseppe Nicoletti dhe Ben Westmore, 'Policy Challenges for the Next 50 Years', OECD, Paris.

60 Lapavitsas, Costas (2013), *Profiting Without Producing: How Finance Exploits us All*, Verso, Londër.



qeverive. Tubimet masive që kemi parë nëpër botë gjatë viteve të fundit, duke përfshirë ato që shkaktuan Pranverën Arabe, në thelb, kanë të bëjnë me pabarazinë. Por ato nuk janë tubime tradicionale: ato janë rrjete të ndërlikuara; tubuesit u kthehen menjëherë rrjeteve shoqërore dhe lëvizin me shpejtësi drejt kufirit të çoroditjes. Për shembull, punëtorët në punishtet Yue Yuen, në Dongguan të Kinës Jugore, përdorin një zbatues të mesazheve të çastit, të quajtur QQ dhe *Weixin*, për të 'krijuar grupe të shumta të mbivendosura' dhe përdorin *Weibo*, një shërbim i ngjashëm me Twitter, për të shpërndarë lajme.<sup>61</sup> Në mënyrë të ngjashme, grevat e kamionistëve në Angli, SHBA dhe gjetkë, nxiten nga rrjetet shoqërore. Prandaj, mundësia që tubimet të çoroditen, është shumë e lartë. Jo më kot, në disa raste tubimet kanë rrëzuar qeveritë. Tubimet antiqeveritare në Tajlandë, ndërmjet nëntorit 2013 dhe majit 2014, kishin të bënin kryesisht me pabarazinë dhe korrupsionin. Ata ia dolën të rrëzonin qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike të kryeministrit Suthep Thaugsuban, e cila u zëvendësua nga një grusht ushtarakësh. Gjatë shtatorit 2012, gjysmë milion njerëz u mblodhën kundër qeverisë së Presidentes Cristina Fernández de Kirchner të Argjentinës. Tubimet i shkaktoi një rritje e çmimit të transportit publik, por që u përshkallëzuan me shpejtësi në të gjithë vendin dhe gati sa nuk rrëzuan qeverinë. Tubimet e Parkut Gezi në Stamboll, më 28 maj 2013, u kthyen në rrëmujë dhe tronditën qeverinë e Partisë për Drejtësi dhe Zhvillim në pushtet.<sup>62</sup> Dy tubime të mëdha në Pakistan, gjatë gushtit 2014, të udhëhequra nga Imran Khan, udhëheqësi i Partisë së Drejtësisë, dhe Tahir-ul-Qadri, një klerik që kryeson një lëvizje fetare, u nxitën nga pabarazia, korrupsioni dhe mbizotërimi i elitës në politikë. Tubimet frenuan Pakistanin për muaj të tërë. Të gjitha këto tubime u nxitën nga mediat digjitale, teksa u rrit vëmendja për t'i përcjellë 24 orë nga mediat botërore, derisa u çoroditën.

## TË DHËNAT MASIVE

Mundësia për kaos rritet më tej nga të dhënat marramendëse që po mblidhen, ruhen, kopjohen dhe shqyrtohen nga çdo burim i mundshëm. Në vitin 2013, kishte rreth 4.4 trilion giga të dhëna të disponueshme botërisht

61 Mason, Paul (2014), 'Striking Chinese workers are using 21-century tools to fight poverty and sweat labour', *The Guardian*, G2, Shtator 15.

62 Steffey, Gordon Blaine (2013) 'The Postnormal Lady in Red' *East-West Affairs* 2 5–11 Prill.





- e barasvlershme me 120 filma në DVD për çdo njeri në tokë. Ato mendohet të rriten me 40% çdo vit në të ardhmen e afërt. Por të dhënat marramendëse nuk janë vetëm në shkallë të gjerë, por janë, gjithashtu, gjëra të ndërlikuara dhe me shpejtësi të lartë. Ato duhet të mblidhen dhe të shqyrtohen me të njëjtin ritëm që mblidhen për të qenë të dobishme. Kjo përbën një larmi të madhe, ngaqë ka disa mënyra, dhe se mblidhen nga burime të shumta. Megjithatë, grumbullimi mund të jetë i madh dhe i shpejtë, por mund të jetë i pasaktë dhe shumë i pabesueshëm, me cilësi që mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Pra, ndërsa të dhënat marramendëse tani janë bërë një burim i përcaktuar i të gjitha llojeve të shqyrtimeve, të përdorura për të nxjerrë në pah të gjitha llojet e lidhjeve të ndërsjella, ato mendohet - siç lë të kuptojë nëntitulli i librit të fundit - të *'Tjetërsojnë mënyrën se si jetojmë, punojmë dhe mendojmë'*.<sup>63</sup> Por mendohet gjithashtu, se ne mund të bëjmë gabime të mëdha në të ardhmen. Lidhjet e ndërsjella mund të jenë të dobishme për parashikimin ose matjen e sjelljeve të panjohura ose të padukshme më parë, me kusht, që ato të jenë të besueshme. Por ato mund të jenë edhe mashtruese. Një shembull i përmendur shpesh, thotë se të qenit në dijeni, që një numër i madh njerëzish po përdorin Google për t'u informuar rreth përhapjes së gripit në një kohë të caktuar, mund të jetë e dobishme për ata që synojnë shitjen e ilaçeve kundër gripit. Mirëpo kjo s'na tregon asgjë për një përhapje të afërt të gripit.<sup>64</sup> Siç kanë theksuar Butler dhe të tjerë, këto të dhëna janë pa teori. Me fjalë të tjera, nuk ka asnjë hamendësim që ofron lidhje të dobishme midis kërkimit përmes emërtesave, si: 'shenjat e gripit', 'mjekimi i gripit', 'barnatore në lagjen time' dhe "përhapja e gripit". Nëse thjesht merrni një grup emërtesash kryesore dhe zbatoni rregulloren, nuk do të merrni një përgjigje kuptimplote. Lidhja e ndërsjellë nuk na tregon asgjë për shkaqet e gripit, i vetmi themel i vërtetë për të kuptuar përhapjen e një gripit.

Ky lloj "parashikimi i përpiktë" ka edhe rreziqe të tjera të qenësishme. Dikush që hulumton terrorizmin, për shembull, mund ta marrin për terrorist, siç ndodhi me Rizwaan Sabir, një student Doktorature në Britani, i cili punonte për antiterrorin në Universitetin Notingam të Mbretërisë së Bashkuar.<sup>65</sup> Ose dikush që mbledh thika për qejf, mund të përfundojë si shënjestër për t'u ndalur dhe rrëmuar nga policia. Pas sulmit me bombë

63 Mayer-Schonberger, Viktor dhe Cukier, Kenneth (2013), *Big Data: A Revolution That Will Transform How We Live, Work and Think*, John Murry, Londër.

64 Butler, Declan (2013), 'When Google got flu wrong' *Nature* 494 155-156 Shkurt 13.

65 Sabir, Rizwaan (2011), 'I won terror compensation, but my struggle for justice continues', *The Guardian*, 19 Shtator; [www.theguardian.com/commentisfree/2011/sep/19/terror-compensationpolice-university](http://www.theguardian.com/commentisfree/2011/sep/19/terror-compensationpolice-university)





në maratonën e Bostonit, një shkrimtare njujorkeze që kërkonte në Google 'tenxhere me presion' dhe 'çantë shpine', u gjend përballë policisë së armatosur, teksa shqyente derën e saj.<sup>66</sup> Policia Metropolitane në Londër tashmë po përdor shqyrtimin e të dhënave marramendëse në një taktikë parashikuese, të ngjashme me atë në filmin *Raporti i pakicave*, për të kapur vjedhësit dhe grabitësit. Në atë film, një zyrë 'parandaluese' i kap shkelësit, përpara se të kryejnë veprimet e tyre. Policia Metropolitane vendos oficerë në vendet e 'hartave të krimit të ardhshëm' që krijohen çdo ditë. Hartat janë prodhuar duke përdorur rregullore kompjuterike që ndërthurin modelet e krimit vendor, matematikën dhe teorinë e kërkimit të kafshëve të egra, për të përcaktuar se ku do të ndodhin krimet më pastaj. Çdo hartë ka një 'vend parashikimi', me një rreze tipike prej 300 metrash, që zakonisht mbulon një numër rrugësh të përcaktuar.<sup>67</sup> Duke pasur parasysh faktin se shkencëtarët tani mund të bëjnë dallimin midis skanimit të një truri 'normal' dhe atij të një krimineli, prirjet janë të mirëpërcaktuara për të na çuar drejt një bote të re të guximshme pasnormale - një pikë e theksuar në përshtatjen e kohëve të fundit të novelës *Viti 1984*, të George Orwell, nga Robert Icke dhe Duncan Macmillan. Winston, personazhi kryesor, e gjen veten në dy hapësira kohore të mbivendosura: pamja e përgjithshme e romanit brenda dy minutave urrëjtjeje, Ministria e Dashurisë dhe Dhoma e tmerrshme 101, si dhe një e ardhme e afërt e papërcaktuar. Paralelizmi është i goditur. E tashmja e zgjatur, përmes së cilës Winston i shpartalluar ecën kalamendës, na duket 'normale', por ku vetmia dhe liria vetjake ngjall dyshime në mungesë të tyre. Gjithmonë është një aparat fotografik që i shikon dhe ata janë gjithmonë në buzë të greminës.

Me ardhjen e të dhënave marramendëse, vetmia avullon. Shpesh, të dhënat mblidhen vetvetiu dhe nga dikush pa emër, megjithëse, ndonjëherë, detyrohemi të nënshkruajmë brenda vijave kufizuese për t'u dhënë 'leje'. Siç vëren John Naughton, ish profesor i lëndës *Kuptimi Qytetar i Teknologjisë*, në Universitetin e Hapur për të gjithë, në Britaninë e Madhe, si dhe gazetar i jashtëm i *Observer*, të dhënat marramendëse do të na kushtojnë shumë:

Asgjësimin e vazhdueshëm të jetës më vete që, nga ana tjetër, nënkupton shfaqjen e një shoqërie në të cilën mbikëqyrja është gjithëpërfshirëse dhe e përhapur. Ne mund të shkojmë në atë drejtim, gjithsesi, falë përfaqësive të inteligjencës dhe kompanive të internetit... Të dhënat marramendëse janë një teknologji për të mëdhenjtë, jo më për ne të tjerët. Kjo teknologji do të rrisë më tej fuqinë e qeverive

66 Gabbat, Adam (2013), 'New York woman visited by police after researching pressure online', *The Guardian* 1 Gusht.

67 Leppard, David (2013), 'Crystal ball cops halt the crimes of tomorrow', *The Sunday Times* Shtator 29.



dhe ndërmarrjeve të mëdha, si dhe do të shfuqizojë më tej të varfrit dhe të përjashtuarit nga shoqëria.<sup>68</sup>

Se deri ku shtrihet kjo mbikëqyrje, doli në pah më së miri nga shkresat e renditura që u bënë të njohura për të gjithë nga Edward Snowden, një nëpunës i krahut të djathtë në Agjencinë e Sigurisë Kombëtare të Amerikës (NSA). Gjatë Luftës së Ftohtë, do të ishte një arritje, nëse një spiun mund të vidhte më shumë se një apo dy shkresa pas vitesh (apo dekadash) spiunazhi. Në kohët pasnormale, Snowden arriti të vidhte 1.7 milionë dosje, të vendosura mjeshtërisht në një USB. Siç del në pah nga dosjet Snowden të Luke Harding<sup>69</sup>, Snowden ishte veçanërisht i tmerruar nga shkalla dhe ndërlikimi i NSA-së, shtrirja e saj e frikshme teknologjike, aftësia për të kapërcyer lirisht kufijtë dhe aftësia për të bërë emërime në gjigantët e teknologjisë, si Google, Facebook, Twitter, apo ndërmarrje telekomunikacioni, si Vodafone. Ishte kthyer në një makineri përbindëshe që thithte vetvetiu dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjithë ndërlihdjen njerëzore, me një aftësi marramendëse për të përgjuar këdo, kudo në botë, në çdo kohë, ku askush nuk dukej se kishte ndonjë përgjegjësi, ose nuk e dinte se çfarë po ndodhte. Në të vërtetë, ishte aq gjigante dhe aq e ngathët, sa as që e vuri re se çfarë po bënte Snowden, edhe pse ai tashmë dyshohej për detyrën që mbante më parë te CIA. Sapo të dhënat dolën në sytë e botës, asnjë pafytyrësi nuk mund t'i kthente ose t'i fshinte ato.

Ndërsa jeta më vete tretet, kufiri midis të përveçmes dhe të përbashkëtës bëhet gjithnjë e më i shpërhapur. Është e rëndësishme të theksohet se, ndërsa ka një shqetësim të madh për tretjen e jetës veçmas, ka gjithashtu një dëshirë të njëkohshme dhe mospajtuese për ta vendosur jetën tonë në sytë e qytetarëve. Ne, vazhdimisht, përshtremdhë ngjarje për jetën tonë në Facebook; ne botojmë çdo mendim që kemi në Twitter, sado i pakuptimtë; ne vendosim foto të foshnjave tona, ditëlindjeve, maceve, ushqimit dhe gjithçka tjetër në Instagram. Megjithatë, në të njëjtën kohë, ne duam që anët e 'papërshtatshme, të parëndësishme ose jo më të rëndësishme' të jetës sonë të fshihen nga interneti. Kemi, siç ka shpallur Gjykata Europiane, 'të drejtën për t'u harruar'.<sup>70</sup> Por si mund të 'harrohem', kur vetë ndjenja jonë, se kush jemi dhe çfarë është e rëndësishme për ne, është ngulitur tani në dëshirën tonë ngulmuese për të ndarë çdo anë të

68 Naughton, John (2014), 'We're all being mined for data – but who are the real winners', *The Observer* 8 Qershor.

69 Harding, Luke (2014), *The Snowden Files*, Guardian Faber Publishing, Londër.

70 Travis, Allen et al (2014), 'Europe upholds 'right to be forgotten'', *The Guardian* 14 Maj.



jetës sonë?! Këto përfshijnë pjesë të trupit tonë, të cilat, normalisht, shihe-shin si pjesët tona më vetjake e të shenjta. James Graham, autor i shfaqjes “Privacy”, vëren se rëndësia e diçkaje - një ide, një pamje, një argument, një përjasje - “nuk matet më me cilësinë e saj, por me atë se sa është shpërndarë. Masa e ndikimit tuaj në Twitter quhet “pushtet” - një vlerë e përcaktuar jo nga cilësia e asaj që shkruani, por nga numri i njerëzve që do ta shohin atë. Vlera e përvojës së jetës tkurret në numrin e pëlqimeve që merrni në Facebook”<sup>71</sup>. Çdo artikull gazete apo reviste, çdo shkrim apo botim, ju kërkon ta shpërndani dhe t’u tregoni miqve tuaj që e keni lexuar.

Sa më shumë të mbështetemi në mediat digjitale dhe internetin, aq më shumë e zbulojmë veten ndaj mashtrimeve, rrengjeve dhe veprimtarive kriminale. Nuk është e çuditshme që shkeljet e të dhënave po bëhen më të mëdha dhe të shpeshta. Në vitin 2013, mbi 800 milionë të dhëna u vodhën nga një varg i tërë industrish, që nga shërbimet financiare, deri te kujdesi shëndetësor, arsimi, barnat, blerësit, energjia, media, transporti dhe shitja me pakicë. Më të shquarit nga ata që u flijuan në SHBA, ishin: dyqani me pakicë Target, e-Bay, Sony, LinkedIn, RockYou.com dhe përbindëshi i programeve Adobe. Një virus kompjuterik, i njohur si Shamoon, fshiu gjithçka të ruajtur nga një rrjet prej dhjetëra-mijëra kompjuterësh në Saudi Aramco, gjiganti i naftës dhe gazit natyror, në Arabinë Saudite. Shpenzimet për ekonominë globale kundër krimit kibernetik janë 455 miliardë dollarë në vit, rreth po aq sa prodhimi i brendshëm bruto i Austrisë.<sup>72</sup>

Pra, përfytyroni, përveç të tjerash, fuqinë çoroditëse të ‘internetit të sa e sa gjërave’: kur frigoriferi, soba, alarmet e tymit, bravat e dyerve, sistemi i sigurisë së shtëpisë, kamerat, televizorët, veturat, pajisjet mjekësore dhe shumë të tjera janë të lidhura me internetin. “Së pari, ne do të vendosnim kamera në kuzhinat tona për të marrë udhëzime më të mira”, shkruan Efgeni Morozov,

më pas, ndërmarrjet ushqimore do të na thonë se do të dëshironin që ne t’i mbanim kamerat për të përmirësuar mallrat e tyre dhe, së fundi, do të zbulonim se të dhënat tona të gatimit tani gjenden të ruajtura diku në Kaliforni, me kompanitë e sigurimeve, duke marrë në shqyrtim sasinë e yndyrës që përdorim për të përshtatur këstet tona të sigurimit, në përputhje me rrethanat. Gatimi i nxitur nga teknologjia inteligjente mund të jetë një kalë troje që hap rrugën për projekte shumë më të liga.<sup>73</sup>

71 Graham, James (2014), ‘Hey, thanks for sharing, but this has gone too far’, *Evening Standard* 2 Maj (op ed).

72 Baker, Stewart dhe Lewis, James (2013), ‘Estimating the cost of cybercrime and cyber espionage’, *Centre for Strategic and International Studies*, Londër.

73 Morozov, Evgeny (2013), *To Save Everything Click Here*, Penguin, Londër.



Ne, me siguri, do të jemi të një mendjeje me qenësinë tonë pasnormale. Natyrisht, të gjitha këto të dhëna gatimi mund të vidhen me pak njohuri të veçanta. Pavarësisht sa i mirë është programi kompjuterik, ka gjithmonë mangësi të qenësishme. Një zbulim i kohëve të fundit është virusi *Heart-bleed*, që cenoi rëndë bibliotekën popullore të programit të kodeve, Open SSL. Ai lejon këdo në internet, të lexojë kujtesën e sistemit, të njihet me ofruesit e shërbimeve, emrat dhe fjalëkalimet e përdoruesve, si dhe përmbytjen e tanishme. Ai i lejon sulmuesit të përgjojnë ndërlidhjet, të vjedhin të dhëna drejtpërdrejt nga shërbimet dhe përdoruesit, të kopjojnë shërbimet dhe përdoruesit. Prodhuesit e programit, zakonisht, lëshojnë 'arna', herë pas here, që të rregullojnë programin e tyre. Por ka gjithmonë një vonesë kohore midis zbulimit të një cenueshmërie të re dhe shfaqjes së një "arnimi" që e rregullon atë. Koha e ndërmjetme, kur sulmuesit fillimisht nisin të shfrytëzojnë dobësinë duke shkaktuar çoroditje, ndërsa programuesit kuptojnë se ka një problem dhe prodhojnë arna për ta rregulluar atë, quhet *ditët zero*. Deri më tani, ditët zero kanë qenë të rralla; prurjet mbeten të pazbuluara mesatarisht deri në dhjetë muaj. Por, ndërsa programimi bëhet gjithnjë e më i ndërlikuar dhe gjithnjë e më shumë gjëra lidhen me internetin, ditët zero do të përshkallëzohen me pasoja të ndjeshme pasnormale.

**VETËM MENDONI SE SA NGA INFRASTRUKTURA JONË E RËNDËSISHME ËSHTË ON-LINE. SA MË SHUMË RRJETE KOMPJUTERIKE NGARKOHEN NË RRJETET KOMBËTARE, SIÇ ËSHTË ENERGJIA ELEKTRIKE (NDONËSE EDHE NJË "MATËS I THJESHTË" E BËN PUNËN), AQ MË SHUMË "SULM SIPËRFAQËSOR" TËRHEQ VETË RRJETI.**

Sa më e madhe të jetë "sipërfaqja e sulmuar", aq më e lartë është mundësia e rënies së rrjetit. Pothuajse të gjitha vendet e industrializuara janë të përfshira tani në luftën kibernetike, me SHBA-në që kryeson renditjen.<sup>74</sup> Në vitin 2012, pati një rritje prej 52 për qind të sulmeve kibernetike që kishin në shënjestër energjinë elektrike dhe atë bërthamore vetëm në SHBA. Përsëri, jemi përballë një sistemi që, sipas teorisë së *kohëve pasnormale*, është gati të sjellë çrregullime dhe pasoja shkatërrimtare.

74 Bamford, James (2013), 'NSA snooping was only the beginning, meet the spy chief leading us into cyberwar' *Wired* Dhjetor 6; [www.wired.com/2013/06/general-keith](http://www.wired.com/2013/06/general-keith).



## SISTEMET SHËNDETËSORE DHE MJEKËSORE

Edhe sistemi shëndetësor po shkon drejt pasnormalitetit. Gjatë dhjetë vjeçarit të fundit, pavarësisht shumë përparimeve mjekësore, ka pasur një rritje të përshpejtuar të sëmundjeve të reja. Sigurisht, sëmundjet kanë qenë me ne gjatë gjithë historisë. Ato u përhapën me shpejtësinë e udhëtimit të një periudhe të caktuar. Gjatë shekullit të XIV, rrugët tregtare të zgjeruara përhapën Murtajën e Zezë, të shkaktuar nga minjtë në të gjithë Europën, dhe linë përmes anijeve në të dy Amerikat. Në kohët më të fundit, bota e ndërlidhur ka parë përhapjen e sarsit, gripit të derrat, virusit të Nilit Perëndimor, atë të gripit të shpendëve H5N1 dhe Ebolës, me shpejtësi marramendëse. Për më tepër, ritmi me të cilin shfaqen shkaktarët e sëmundjeve, po përshpejtohet, pa marrë parasysh rritjen e ndërëgjegjësimit dhe mbikëqyrjes. Një shpërthim bashkëkohor, i shkaktuar nga një virus i panjohur më parë, mund të përfshijë botën me shpejtësi të frikshme.

Por nuk janë vetëm shkaktarët e rinj të sëmundjeve që përbëjnë shqetësim. Bota po përballet me një varg epidemish të shkaktuara nga mënyra e jetesës në ditët e sotme: mbipësia, sëmundja e sheqerit, frymëmarrja me vështirësi, ethet e barit, sëmundja e lëkurës, ndjeshmëria ushqimore, zbatia e gurmazit dhe kanceri, sëmundja e barkut, sëmundja Kron, zorra e trashë dhe autizmi.<sup>75</sup> Në SHBA, një në 13 fëmijë është mëse i ndjeshëm ndaj ushqimeve dhe numri i fëmijëve me alergji ndaj kikirikut u trefishua nga viti 1997 në 2007. Në nivel botëror, mbi 1.4 miliardë njerëz janë mbipeshë, rreth 300 milionë cilësohen si të dhjamosur. Rreth 800.000 fëmijë preken nga sëmundja e sheqerit çdo vit në mbarë botën. Vetëm në Mbretërinë e Bashkuar, 5.4 milionë njerëz vuajnë nga rrugët e frymëmarrjes. Astma te fëmijët u rrit me 50% në SHBA, nga viti 2001 në 2009. Rreth 30 për qind e fëmijëve australianë preken nga sëmundja e lëkurës, që në vitin e tyre të parë. Alergjitë ushqimore – nga kikiriku te qumështi, buka, vezët, soja, peshku dhe frutat – janë kudo. Rastet e sëmundjes së zorrëve, duke përfshirë sëmundjen Kron dhe zorrën e trashë, janë në rritje. Këto çrregullime na lënë të kuptojmë se fëmijët në mbarë botën po përjetojnë mungesë qëndrueshmërie trupore të paparë më parë, - vëren Martin Blaser, autor i *Mikrobeve të Munguara: Si na vjen murtaja nga zhdukja e baktereve*.<sup>76</sup>

Por kjo është vetëm një pjesë e vogël e historisë. Të dhënat e kohëve të fundit nga WHO, na bëjnë me dije se “një epokë pas-antibiotike, në të cilën

75 Blaser, Martin (2014b), ‘How antibiotics are making the whole world ill’, *The Observer* 1 Qershor.

76 Blaser, Martin (2014a) *Missing Microbes: How Killing Bacteria Creates Modern Plagues*, OneWorld, Oxford.



një molepsje e zakonshme dhe lëndimet e vogla mund të vrasin, jo vetëm që nuk është ëndërr e frikshme, por është një mundësi shumë e vërtetë për shekullin e XXI<sup>77</sup>. Antibiotikët e dobishëm kanë qenë një nga shtyllat e të qenit bashkëkohor, që na kanë mundësuar të jetojmë më gjatë, më shëndetshëm dhe të përfitojmë nga mjekësia bashkëkohore. Por qëndrueshmëria ndaj ndikimit të antibiotikëve, e cila është “e ndërlikuar dhe e shumëfishtë”, po përhapet me shpejtësi dhe “përfshin një varg mjetesh qëndrueshmërie që prekin një numër gjithnjë e më të zgjeruar bakteresh, shumica e të cilave mund të shkaktojnë një varg të gjerë sëmundjesh te njerëzit dhe kafshët”. Shkaktarë sëmundjesh të pamposhtur udhëtojnë me lehtësi nëpër botë. Sipas WHO, e ftohura do të kthehet sërish në një vrasës të frikshëm, heqja e barkut në vdekjeprurëse, ndërsa veremi (tuberkulozi) që s’do t’ia dijë për ilaçet dhe që kërkon më shumë se një vit mjekim, do të bëjë gjëmën. Gonorreja, një sëmundje gjinore e pamposhtur ndaj antibiotikëve, është e sigurtë se do të kthehet, ashtu si shtamet e HIV-it që nuk kanë ilaç. Qëndrueshmëria e shtuar kundrejt fluorokinoloneve – një nga barnat antibakteriale më të përdorura për shërimin e qelbëzimeve të shtresës urinare, të shkaktuara nga bakteri E. Coli – na vë përpara një rrethane vërtetë të frikshme. Nuk ka antibiotikë të rinj për të zëvendësuar ata të vjetrit. Ç’është e vërteta, nuk ka pasur antibiotikë të rinj në këto 25 vitet e fundit.

Mjekësia është një ekosistem i ndërlikuar. Mungesa e antibiotikëve do të ketë ndikim në të gjitha degët e mjekësisë. Kirurgjia do të bëhet e rrezikshme. Mjekimi i kancerit do të rrezikohet: të sëmurët me kancer që i nënshtrohen kimioterapisë, kanë nevojë për antibiotikë, për të mjekuar ndikimet anësore, me gjasa vdekjeprurëse, pasi qëndrueshmëria e tyre lëkundet nga ndikimi i kimioterapisë. Antibiotikët nuk vrasin vetëm bakteret e këqija; ata gjithashtu vrasin bakteret e mira. Përdorimi i tepërt i antibiotikëve do të thotë se kemi gjithnjë e më pak baktere të mira në trupin tonë, pra, qëndrueshmëria e trupit tonë ndaj sëmundjeve është gjithnjë e më pak në gjendje për t’i përballuar. Antibiotikët nuk prekin vetëm njeriun që i përdor, por prekin të gjithë planetin. Shpërdorimi apo përdorimi i tepëruar i tyre te njerëzit dhe kafshët është i prirë ta shtyjë të gjithë sistemin tonë shëndetësor drejt pasnormalitetit.

Shfaqja e shkaktarëve të sëmundjeve me qëndrueshmëri kundrejt antibiotikëve është vetëm një nga shumë arsytet për rritjen e shpejtë të sëmundjeve të reja. Disa çrregullime, si rritja e alergjive, mund të shpjegohen me faktin se jetojmë në ‘flluska pa mikrobe’; qëndrueshmëria e trupit

77 WHO, *Antimicrobial resistance: global report on surveillance 2014*, World Health Organisation, Geneva.



ka pasur pak mundësi për të zhvilluar kundërveprime ndaj alergjive. Por shpjegime të tilla, me një shkak të vetëm, nuk na çojnë shumë larg. Siç thotë Blaser: 'një shkak i vetëm është më i lehtë për t'u kuptuar; është më i thjeshtë, më i kursyer. Por cili shkak mund të jetë mjaft i madh për të përfshirë vështirësitë e frymëmarrjes, mbipeshën, zbatcën e gurmazit, sëmundjen e sheqerit të fëmijët dhe alergjitë ndaj ushqimeve të posaçme, ndër gjithë të tjerat?

Ngrënia e ushqimit me shumë kalori mund të shpjegojë dhjamosjen, por jo vështirësitë në frymëmarrje. Ndotja e ajrit mund të shpjegojë vështirësitë në frymëmarrje, por jo ndjeshmërinë e tepërt ndaj ushqimeve. Blaser na lë të kuptojmë se një nga shkaqet kryesore është humbja e larmisë së mikrobeve, e cila 'ndryshon vetë zhvillimin, duke ndikuar te shkëmbimi i mikroorganizmave të gjallë, qëndrueshmëria e trupit, ndoshta edhe aftësia jonë e të kuptuarit. Mikrobet në zorrët tona shërbejnë për prodhimin e disa prej blloqeve ndërtuese të trurit, si dhe molekulave që lëshojnë sinjale, nga një qelizë e trurit, në tjetrën. Blaser e quan këtë ecuri "zhdukja e mikroorganizmave". Ai parashikon se "do të jetë më keq në të ardhmen". Ashtu sikur motori me djegie të brendshme, ndarja e atomit, spërkatja, të gjitha kanë pasur ndikime të paparashikuara, po ashtu, ka edhe shpërdorimi i antibiotikëve dhe qasjeve të tjera mjekësore ose thujse mjekësore". Po shkojmë drejt një "dimri antibiotik". Ne e dimë se "bakteret e mira" na mbrojnë nga ato "të këqijat", shkaktarë sëmundjesh që mund të hasim gjatë gjithë jetës. Ndërsa popullatat tona të baktereve të mira varfërohen, ndjeshmëria jonë ndaj baktereve të këqija rritet'.<sup>78</sup>

**ÇDO TË THOTË TË JESH NJERI, GJITHASHTU KA TË BËJË SHUMË ME AFTËSINË PËR TË NDRYSHUAR RRËNJËSISHT.**

Për shekuj me radhë, Perëndimi ka kujtuar se ka vetëm një mënyrë për të qenë njerëzor: të jesh i kohës. Ky hamendësim ka qenë pengesa më e madhe në vlerësimin e larmisë njerëzore. Tani përparimet në inxhinierinë gjenetike dhe biologjinë sintetike po minojnë pikëpamjen tradicionale të asaj që përbën një qenie njerëzore. Merrni parasysh, fjala vjen, mjekimin eksperimental të quajtur zëvendësimi *mitokondrial*, që përfshin marrjen e lëndës gjenetike nga një burrë dhe një grua dhe lëndës qelizore nga një njeri i tretë, për të krijuar një farë. Mitokondritë e dëmtuara nga nëna

78 Blaser, Martin (2014b), 'How antibiotics are making the whole world ill', *The Observer* 1 Qershor.



zëvendësohen me ato të një dhuruesi të shëndetshëm. Kështu që fara e përfutur ka jo dy, por tre prindër. Ose, një shembull tjetër, mendoni për përcaktimin gjenetik para mbarsjes (PGD), i cili fillimisht u zhvillua në ndihmë të familjeve me histori çrregullimesh të rënda gjenetike, për të zgjedhur farat për pllenim me provëz që nuk preken nga rrethanat. Gjithashtu, mund të përdoret në mënyrë të barabartë, dhe është përdorur, për të zgjedhur gjininë e farës. Kjo mënyrë veprimi është përdorur gjerësisht në Indi dhe Kinë. Në Kinë, rreth 118 djem lindin nga çdo 100 vajza, ndërsa India ka një mesatare kombëtare prej 111 djem. Por kjo mënyrë veprimi po përparon edhe në Azerbajxhan, Armeni, Gjeorgji dhe Shqipëri.<sup>79</sup> Përveç përzgjedhjes së gjinisë, mund të përmirësohen edhe fëmijën. Në të vërtetë, në Indi, ku foshnjat e zbardhura dhe të bukura parapëlqehen nga klasa e mesme e pasur, PGD-ja është përdorur gjerësisht për të prodhuar foshnja 'me ngjyrë të bardhë qumështi'. Për më tepër, po aq lehtë, mund të zgjedhësh të kesh një fëmijë me aftësi të kufizuara.

Zhvillimet në bioshkenca dhe teknologjitë kompjuterike kanë qenë aq të shpejta, sa një grusht dijetarësh, adhurues të 'trans-humanistëve', tani pohojnë se "brenda disa dekadave të ardhme qeniet njerëzore të përmirësuara gjenetiki do të ecin në tokë".<sup>80</sup> Ose, siç tha 'Dr. Will Caster', gjatë prezantimit të tij në takimin "Përmirësojmë të ardhmen", në filmin "*Transcendence*", të vitit 2014:

Për 130.000 vjet, aftësia jonë për të arsyetuar ka mbetur e pandryshuar... Mirëpo, dikur, një pajisje e ndjeshme në internet do t'i kapërcejë shpejt kufijtë e biologjisë. Në një kohë të shkurtër, fuqia e arsyes së saj do të jetë më e madhe se inteligjenca kolektive e çdo njeriu që ka lindur në mbarë historinë e botës. Përfytyroni një krijesë të tillë, me një gamë të plotë ndjenjash njerëzore, madje edhe me vetëdije. Disa shkencëtarë, këtë e quajnë veçanti, por unë e quaj epërsi.

Nga mesi i shekullit, sqarojnë trans-humanistët, do të kemi një 'epërsi', përmes së cilës do të shfaqet një qenie e krijuar dhe e përmirësuar gjenetiki pas-njerëzore, shumë më e fortë, më e mençur dhe e aftë të jetojë shumë më gjatë se njerëzit e thjeshtë.<sup>81</sup> Ne mund ta hedhim poshtë këtë, thjesht si përfytyrim të dhimbshëm të së ardhmes dhe *epërsia*, sigurisht, është menduar të shihet si e tillë. Ajo përfundon me shuarjen e plotë të internetit që e vendos të gjithë botën në errësirë të plotë, por kjo nuk duhet të na verbojë për faktin se:

79 New Internationalist (2013b), 'Where have all the girls gone', *New Internationalist* Tetor.

80 Braidotto, Rosi (2013) *The Posthuman*, Policy Press, Oxford. More, Max dhe Vita-More, Natasha (2013), editors, *The Transhumanist Reader*, Wiley and Sons, New York.

81 Kurzweil, Ray (2006), *The Singularity is Near*, Penguin, Londër.





## PËRMIRËSIMI I NJERIUT PËRMES TEKNOLOGJISË, MENDOHEM TË JETË NJË PUNË E PËRBASHKËT.

Dy deri në tre vitet e fundit, tjetërsimi i gjeneve është bërë më i shpejtë, më i lirë dhe më i saktë. Kur teknologjia është e lirë dhe gjerësisht e zotërueshme, ajo synon të përdoret. Në të vërtetë, jeta artificiale tashmë është krijuar, nëse duam të besojmë Craig Venter, shkencëtarin amerikan, ndër të parët që renditi kromozomet njerëzore. Në veprën *Jeta me shpejtësinë e dritës: Nga heliksi i dyfishtë, deri në agimin e jetës digjitale*<sup>82</sup>, Venter përshkruan se si ai e krijoi jetën sintetike për herë të parë në botë. Kromozomi bakterial sintetik është ndërtuar nga një përbërës kimik në laborator dhe, më pas, është 'nxjerrë' për ta futur në një bakter të gjallë njëqelizor. Qeliza përsëritet në një koloni organizmash që përmbajnë vetëm ADN-në sintetike. "Është si një ide krejtësisht e re e jetës", thotë Venter. "Nuk ka asnjë molekulë të vetme origjinale prej andej - është njëlloj sikur ta kthesh njeriun në bretkosë". Gjallesa më të stërholluara mund të krijohen duke përdorur copa të lidhura të ADN-së, të quajtura *Bio Bricks*, të cilat programojnë një varg bakteresh për të kryer detyra të caktuara. Çdo *Bio Brick* është i mbuluar në të dy skajet me ADN-në përkatëse, për të mundësuar lidhjen e saj me tulla të tjera, për t'ia bashkëngjitur një plazme që mund të futet në një qelizë bakteriale.<sup>83</sup> Madje, ka edhe një regjistër të pjesëve të caktuara biologjike që mund të përdoret. Së shpejti, jeta, më në fund, do të jetë 'në gjendje të udhëtojë me shpejtësinë e dritës, gjithësia do të tkurret dhe fuqitë tona do të zgjerohen'.<sup>84</sup> Në një intervistë me *Observer*, Venter paralajmëron që të mos e marrim këtë si një përrallë: "në të vërtetë, ne po bëjmë të ardhmen".

Në të vërtetë, ajo që po bën Venter, nuk është 'e ardhmja', por ajo që quhet në teorinë e kohëve pasnormale: 'e tashmja e zgjatur'. Pasojat e punës së tij mund të shihen në të tashmen dhe do të shpalosen brenda disa viteve të ardhshme. Ashtu si edhe hulumtimi i tanishëm mbi biologjinë njerëzore, që na mundëson të prodhojmë pjesë të trupit, siç është mëlcia, me qelizat staminale që merren nga lëkura e njeriut dhe riprogramohen në një fazë fillestare. Kjo gjë shtron pyetjen: Çfarë është "trupit", kur përbëhet nga pjesë që mund të stampohen në tri përmasa? Siç vë në dukje romancieri Warren Ellis dhe shkrimtarët e komikëve të *Marvel*: "Të gjithë flasin për ndërprerje të normales, pavarësisht nëse është sintetike, e

82 Venter, Craig (2013), *Life at the Speed of Light*, Abacus, Londër.

83 Po aty.

84 Po aty.



stampuar në tri përmasa, apo çfarëdo qoftë. Ajo që ata nuk e kuptojnë, është se kemi të bëjmë me një ecuri të egër. Sapo trazira nxjerr kokën diku, ajo nuk ndalet. Pas 10 vitesh, do të ketë fëmijë në bodrume ku stampohen organe shtesë, duke kërkuar për mënyra se si t'i qepin ato në trupat e tyre".<sup>85</sup>

## PAMJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË DHE BREZI I ARDHSHËM

Së fundi, vetë pamja e shoqërisë është gati të tjetërsohet rrënjësisht. Mëndimet 'normale', se çfarë është një martesë, çfarë është familja, si dhe ideja e pafajësisë së fëmijërisë, tashmë kanë perënduar, ose po shkojnë drejt pasnormales. Ideja e vjetër e martesës midis një burri dhe një gruaje tani ka një shtesë të re: martesën mes së njëjtës gjini - të paktën në Perëndim. Siç mund të ketë një nënë dhe një baba, po aq lehtë mund të ketë dy baballarë ose dy nëna, ose tre prindër, ç'është e vërteta. Madje, vetë martesë me një grua të vetme duket se po zhduket ngadalë. Sipas Deborah Anapol, e shoqatës mediatike *Psychology Today*, 'fiksimi ynë kulturor me martesën ka të njëjtën ecuri që pati ndalimi i alkoolit, skllavëria, shkëmbimi i arit kundrejt kartëmonedhave dhe shërbimi i detyrueshëm ushtarak. Me fjalë të tjera, ndërkohë që martesë e përkohshme me një grua të vetme është më e përhapur se kurrë, martesë e përjetshme është pothuajse e vjetruar dhe, për mirë a për keq, martesë me më shumë se një grua po përhapet'.<sup>86</sup>

Fëmijët po rriten me një grup vlerash krejtësisht të ndryshme nga prindërit e tyre. Ndër gjërat e spikatura që të rinjtë ndajnë në mediat digjitale, është pornografia. Jo vetëm që dërgimi i fotove dhe fjalëve të ndyra tashmë është i zakonshëm, por të miturit dhe të rinjtë kanë, siç e thotë *Sunday Times*, 'një vitrinë shturjeje të papërfytyrueshme në pëllëmbë të dorës'. Kur mendoni se mbi 36% e internetit i kushtohet pornografisë, një në katër pyetje kërkimi ka të bëjë me pornografinë dhe një e treta e të gjitha shkarkimeve janë pornografi, merreni me mend shkallën e vërtetë në të cilën pornografia ka depërtuar në jetën e përditshme. Mendohet se mosha mesatare e përplasjes rastësore me pamje pornografike në Perëndim është midis gjashtë dhe tetë vjeç. Sido qofshin qëndrimet morale, pro ose kundër pornografisë, e vërteta është se ajo ka një ndikim shkatërrues të rinjtë që nuk mund të anashkalohet: 'ata mendojnë se këto skena të

85 Ellis, Warren (2014), 'The man whose comics predict the future' *Stuff* Tetor f. 44.

86 Anapol, Deborah (2013) 'The Truth about Polyamory', *Psychology Today* 18 Prill.



rënda janë normale dhe synojnë t'i kopjojnë ato, ndërsa hedhin hapat e tyre të parë drejt marrëdhënieve të mëvonshme seksuale.<sup>87</sup>

Gjashtë është moshë mesatare kur një fëmijë zotëron teknologjinë digjitale. Të dhënat e fundit nga *Ofcom*, autoriteti i pavarur që mbikëqyr konkurrencën për industrinë e ndërlidhjes, në Mbretërinë e Bashkuar, tregojnë se fëmijët e lindur në mijëvjeçarin e ri janë jashtëzakonisht të aftë për teknologjinë. Ndërsa ata janë rritur në moshën digjitale, zakonet e tyre të ndërlidhjes janë mjaft të ndryshme nga brezat e vjetër. Sipas *Ofcom*, fëmijët nga 12 deri në 15 vjeç, kalojnë më shumë kohë duke mbajtur lidhjet me teknologjinë, sesa duke fjetur.<sup>88</sup> Gjashtë dhe shtatë vjeçarët që janë rritur me You Tube, Spotify, Facebook dhe Instagram, kanë njohuri jashtëzakonisht të larta për broadband-ët super të shpejtë, telefonat celularë 4G, si të përdorin tabletat dhe zbatuesit. Herësi i tyre Digjital (DQ) është edhe më i lartë se ai i moshës 16-24 vjeçare.

Kjo grupmoshë do të rritet me kamera sa një komçë që shënjojnë çdo lëvizje dhe thënie të tyre, ku jetët jetojnë plotësisht në internet, ku çdo fytyrë dhe çdo fjalë mund të kapet menjëherë.<sup>89</sup> Ashtu si ndryshimi i klimës, ndikimet digjitale në këtë brez do të jenë të përbotshme, të pashembullta dhe të ndërlukuara. Siç pohon Susan Grenfield, rrjetet shoqërore, në fakt, po ndryshojnë trurin, duke ulur ndjeshmërinë dhe duke zvogëluar aftësinë për t'u marrë vesh te përdoruesit e tepërt.<sup>90</sup> Kur kjo grupmoshë të ulet në karriergen e pushtetit, brenda dy dekadave, vëmendja e saj nuk do të jetë, nëse gjërat janë të vërteta apo të rreme, të mira apo të këqija, por se si dhe sa shpejt të kryejnë punë. Ky brez, i rritur në gjuhën të përbotshme të shenjave, do të ketë dëshirat e veta të përcaktuara, prirjet, mënyrën e të parit dhe formësimin të botës: një botë me ndryshim të menjëhershëm dhe të përherëshëm, kënaqësi dhe dobi të menjëhershme, ku çdo anë e jetës është e lidhur në rrjet dhe ndërlikimi, mosmarrëveshjet dhe çoroditja janë paradhënie. Me fjalë të tjera, një ndërveprim vërtet pasnormal.

E ardhmja e shkencës, gjithashtu, mund të duket shumë e ndryshme, duke pasur parasysh ngërçin në fizikë. Çështjet e pazgjidhura të supersimetriës,<sup>91</sup> mangësia në rrezet e protonit<sup>92</sup>, çështjet e materies së errët dhe

87 Mills, Eleanor (2013), 'Generation Porn', *The Sunday Times*, News Review, 16 Qershor.

88 Ofcom (2014), 'Children and parents: media use and attitudes in the nations', Ofcom, Londër, <http://stakeholders.ofcom.org.uk/market-dataresearch/other/research-publications/childrens/attitudes-nations/>

89 Singer, Natasha (2014) 'Never forgetting a face', *New York Times International Weekly* 8, 2 Qershor.

90 Greenfield, Susan (2014), *Mind Change*, Rider, Londër.

91 Lykken, Joseph dhe Spiropulu, Maria (2014) 'Supersymmetry and the Crisis in Physics', *Scientific American* 310 (5) Maj.

92 Bernauer, Jan dhe Pohl, Randolph (2014), 'The Proton Radius Problem', *Scientific American* Shkurt f. 32-39.



energjisë së errët, shqetësimi i famshëm i të dhënave rreth vrimës së zeqë (nëse grimcat hyrëse fillojnë në një gjendje të pastër kuantike, përlllogaritja e Hawking parashikon që vrima e zeqë avullon në një gjendje përfundimtare të përzier, të ngjashme me gjendjen e nxehtësisë, me një humbje madhështore të të dhënave kuantike, që shkel mekanikën kuantike), të gjitha mund të çojnë në një ndryshim themelor të modelit të fizikës. Ne mund të jemi në prag të një këndvështrimi dhe kuptimi rrënjësisht të ri të gjithësisë – një pohim vërtet pasnormal.

### “BËHU PASNORMAL!”

Pra, si t'i përballojmë kohët pasnormale, duke pasur parasysh se mendimet rreth përparimit, rritjes, zotërimit, rendimentit, madje edhe drejtimit po bëhen gjithnjë e më të parëndësishme? Si të ecim përpara, pa rënë pre e çoroditjes? Si t'i mbijetojmë pasigurisë në rritje dhe llojeve të ndryshme të padijes me të cilat përballemi? Si t'i kapërcejmë dështimet e dukshme të kapitalizmit dhe t'i bëjmë jehonë barazisë dhe drejtësisë shoqërore? Çfarë duhet të vijë pas shpërbërjes së 'rendit botëror', të vërejtur me kaq mprehtësi nga Kissinger? Si mund t'i kapërcejmë rreziqet e 'jetës së krijuar me porosi'<sup>93</sup>? Si i përballojmë sfidat ndaj sistemeve tona shëndetësore në një kohë 'pas antibiotike'?

Përgjigjet për këto dhe një varg pyetjesh të tjera të ngritura nga kohët pasnormale, fillojnë me ndërjegjësimin dhe përfundojnë me krijimtarinë dhe përfytyrimin.

Ne duhet të jemi të vetëdijshëm, se nuk mund t'i drejtojmë dhe zotërojmë kohët pasnormale, por ne mund të lundrojmë nëpër 'to. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm për faktin se një varg çështjesh me të cilat përballemi njëkohësisht, nuk mund të zgjidhen të veçuara. Kur shikon një çështje, duhet të shikosh edhe të gjitha çështjet e tjera që lidhen me 'të. Siç vë në dukje Jordi Serra, marrëdhëniet shkak-pasojë nuk qëndrojnë më: 'veprimi te një element i vetëm nuk është vetëm i kotë, por shpeshherë edhe mjaft i rrezikshëm. Veprimi në A shkakton një varg kundërveprimesh në B, C, D e deri në Z. Shumë nga këto kundërveprime mund të marrin përmasa kaotike me shpejtësi rrufe'.<sup>94</sup> Për më tepër, duke qenë se këto çështje janë të ndërlikuara dhe të rrënjësura në një mjedis të ndërlikuar, zgjidhjet nuk mund të jenë të thjeshta.

93 Caplan, Arthur (2010), 'Life designed to order', *Scientific American* Shtator f. 75.

94 Serra, Jordi (2014) 'Postnormal Governance' *East-West Affairs* 5 Tetor 2014 5–13.



Një parim kryesor i mbijetesës në një mjedis të ndërlikuar, është: mekanizmi që merret me të, duhet të jetë vetë i ndërlikuar - ai që njihet si *Ligji i larmisë së kërkuar* të Ashby-t.<sup>95</sup> Sa më e madhe të jetë shumëllojshmëria e veprimeve të disponueshme për një sistem, aq më e madhe është shumëllojshmëria e shqetësimeve që është në gjendje të dëmshpërblejë. Ose, e thënë me fjalë të tjera, vetëm shumëllojshmëria mund të përballojë shumëllojshmërinë. Kështu, larmia, shumëllojshmëria dhe mundësitë e shumëfishta janë thelbësore për të kuptuar dhe lundruar përmes kushteve pasnormale.

Për më tepër,

**RRJETI I NDËRLIDHUR I HALLEVE TONA NUK MUND TË ZGJIDHET ME LOGJIKË DHE ARSYETIMIN E DYZUAR TË MODËS SË VJETËR. NEVOJITET NJË MËNYRË MË E LARTË LOGJIKIMI**

dhe ajo që Jennifer Gidley e quan 'arsyetim pasformal'<sup>96</sup>: ndërlikimi i të menduarit; aftësia për t'u marrë me këndvështrime të shumta, me ide konkurruese të së vërtetës; aftësia për të kapërcyer mospajtimet dhe nuhatja për t'u marrë me njohuritë e paqarta dhe pasiguritë e teorisë së dijes. Të jesh i vetëdijshëm për këtë vërtetësi, do të thotë të jesh "pasnormal".

Çfarë do të thotë kjo, për sa i përket studimeve të së ardhmes, si bëhet dhe si konceptohet? Unë do të sqaroj se e ardhmja tani duhet të përfshijë tablo pasnormale në fushën, metodat dhe analizat e saj. Duke pasur parasysh se e tashmja e zgjatur dhe e ardhmja e afërt do të mbizotërohen nga ngjarje pasnormale, është e domosdoshme që kërkimi dhe studimi i së ardhmes të përqendrohet në zbulimin dhe shqyrtimin e prirjeve dhe zhvillimeve pasnormale. Mënyrat e mjetet janë zhvilluar për të analizuar pasojat e rënda dhe të ndërlikohura të dukurisë pasnormale. Nuk mjafton më thjesht të hulumtosh një shumëllojshmëri të ardhmesh të mundshme. Ne duhet t'i kushtojmë vëmendje të madhe edhe mënyrës se si do të lundrojmë në gjendjen pasnormale – me rënien e mundshme ekonomike gjithnjë të pranishme, me pasojat e rënda të ndryshimeve klimatike në horizont, me dështimin e mundshëm të qëndrueshmërisë së trupave njerëzore - për të arritur një të ardhme të arsyeshme dhe të qëndrueshme. Në përgjithësi, futuristët kanë shmangur pyetjet e mëdha (ngaqë shihen si lëndë e filozofisë) dhe janë përqendruar në zberthimin e prirjeve, këqyrjen e horizontit, ndërtimin e modeleve mbarëbotërore

95 Ashby, W R (1956) *An Introduction to Cybernetics*, Chapman & Hall, Londër.

96 Gidley, Jennifer M (2010) 'Postformal priorities for postnormal times: A rejoinder to Ziauddin Sardar' *Futures* 42 625–632.



dhe krijimin e mënyrave të veprimit, vegimeve, përfytyrimeve të së ardhmeve të ndryshme.<sup>97</sup>

Por në kohët pasnormale, kur ajo që përbën veprimtari ekonomike vihet në dyshim, kur vetë trupi po riformohet, kur marrëdhëniet shoqërore po marrin trajta të reja dhe vetë ideja se çfarë do të thotë të jesh njeri po tjetërsohet, pyetjet e mëdha nuk mund të shpërfillen, lidhur me veprat e së ardhmes. Duke marrë parasysh, që kohët pasnormale po lënë të kuptohen ndryshime të natyrës themelore, është e rëndësishme të hulumtojmë se çfarë nënkuptojnë këto ndryshime për të gjitha kulturat e ndryshme njerëzore dhe jonjerëzore të planetit tonë, si dhe çfarë mundësish rrënjësish të ndryshme mund të shfaqen. Pothuajse të gjitha ndryshimet që po sjellin kohët pasnormale, kanë domethënie të thella morale. Kjo do të thotë se hulumtimi i së ardhmes duhet të përfshijë në mënyrë të hollësishme edhe çështje morale. Morali nuk ka të bëjë vetëm me mënyrën se si ne, qeniet njerëzore, zëmë vend në botë, por bëhet fjalë edhe për këtë lloj njeriu që tani zë vend. Nuk ka të bëjë vetëm me të qenit në botë, por edhe me të qenit me botën. Bëhet fjalë për mënyrën se si jemi të lidhur me pjesën tjetër të botës – njeriu brenda një rrjeti bashkësisht, burimet që ndajmë dhe shpërndajmë mes nesh, marrëdhëniet tona me florën dhe faunën, natyrën dhe mjedisin, tokën dhe gjithësinë. Prandaj, studimet e së ardhmes nuk mund të jenë thjesht për atë që mund të ndodhë në të ardhmen, ose çfarë mund të bëhet për të formuar një të ardhme, çfarë është e mundur dhe çfarë jo. Ajo duhet të jetë kryesisht për atë që duhet bërë për ruajtjen e së ardhmes së arsyeshme dhe morale. Ose, për ta thënë ndryshe: studimet e së ardhmes duhet të zbulojnë mënyra të tjera për të qenë njerëzorë në të gjithë të ardhmen tonë.

Ndoshta ndryshimi më themelor që do të sjellin kohët pasnormale, do ta ketë fuqinë për të përcaktuar. Gjatë periudhave të pushtimit, modernitetit dhe paskolonializmit, Perëndimi kishte përcaktuar se çfarë do të thotë të jesh njerëzor dhe “modern”: çfarë është liria, arsyeja, shkenca dhe qytetërimi, çfarë është “tregu i lirë”, “demokracia” dhe “ligji ndërkombëtar”, çfarë janë “të drejtat e njeriut” dhe “çështjet njerëzore”, si dhe çfarë është ekonomia, shkenca politike, arkitektura, arti, historia dhe tradita, çfarë është e shenjtë dhe çfarë jo. Fuqia e vërtetë e Perëndimit mbështetej në fuqinë e tij për të përcaktuar idetë kryesore të njerëzimit dhe shoqërisë njerëzore. Por kohët pasnormale tregojnë, nëse na tregojnë sado pak, se këto përkufizime e kanë kaluar datën e skadencës. Prandaj, tani hyn në lojë krijimtaria dhe përfytyrimi.

Alfonso Monturi ka vënë në dukje, se krijimtaria dhe përfytyrimi po tjetërsohen, si pasojë e ndikimeve anësore të kohëve pasnormale, nga

97 Sardar, Z (2013a) 'Editorial: East-West in Postnormal Times' *East-West Affairs* 1 3–12 Janar.



pikëpamja bashkëkohore e qenësisë vetjake, drejt një qasjeje më bashkëpunuese dhe më të ndërlikuar, që varet më shumë nga rrethanat.<sup>98</sup> Sean Cubitt dhe kolegët e tij kanë thënë se një rregullim i ri i rrjeteve tani ka po aq fuqi, sa kombet dhe tregjet. Sfida për kohët pasnormale është 'përftyrimi i së ardhmes, duke përftyruar pasojat politike të njohjes së përfaqësive jonjerëzore si aktorë politikë'.<sup>99</sup> Alfonso Montouri dhe Gabrielle Donnelly kanë këshilluar se ne duhet ta përqendrojmë vëmendjen tonë në krijimtarinë "me burime të miratuara", për të kaluar nga "marrëdhëniet humbje-fitore në botëkuptimin e vjetër", te "marrëdhëniet vetëm fitore" që tejkalojnë mosmarrëveshjet, dallimet dhe përplasjet.<sup>100</sup> Ne duhet t'i marrim këto këshilla shumë seriozisht. Por ka edhe një arsye tjetër, pse përftyrimi dhe krijimtaria do të bëhen parësore. Ne do të na duhen përkufizime të reja dhe më gjithëpërfshirëse të shumë gjërave që i kemi marrë si të mirëqena, që nga çfarë është trupi, deri tek ajo se çfarë i përbën marrëdhëniet shoqërore, çfarë do të thotë shëndet i mirë, çfarë është liria, çfarë do të thotë të jesh njeri. Ndërsa pushteti zhvendoset nga Perëndimi në Lindje dhe ndërsa ne lundrojmë në "prirjet dëmtuese" të kapitalizmit, përkufizime të reja të mendimeve tona themelore do të dalin nga kulturat joperëndimore, ndërsa fuqizojnë muskujt e tyre. Edhe pse Kina dhe India priren të ndjekin modelin kapitalist perëndimor, ato ende mund të prodhojnë përkthime rrënjësisht të ndryshme – edhe pse jo domosdoshmërisht gjithëpërfshirëse, të hapura dhe me shumicë. Ne duhet të zgjerojmë fushëpamjet e krijimtarisë dhe përftyrimin tonë, për të siguruar që shumëllojshmëria e nevojshme, ndërlikimi dhe arsyetimi pasnormal të jenë thelbësore për përkufizimet e reja. Me fjalë të tjera, ne kemi nevojë për krijimtari dhe përftyrim, për të formuar një moralitet pasnormal, që mund të na udhëheqë nëpër trazirat e kohërave pasnormale.

Frances Whitehead, artiste dhe profesoreshë e skulpturës, në Shkollën e Institutit të Artit të Çikagos, na jep një shembull të mirë, duke i parë hapësirat e qyteteve, si 'hapësira fizike të ndërlikuara, të paqarta dhe kundërshtuese', 'shenja të një begatie materiale që i ka kaluar koha', të cilat 'vazhdojnë të ndikojnë dhe të preken nga qytetarët, ekosistemi dhe infrastruktura'. Ajo e përshkruan me vetëdije punën e saj mbi gjallërimin urban dhe trashëgiminë kulturore si pasnormale: Parashtesa 'pas', - shkruan ajo, - 'shërben si një kujtesë e rrënjësjes së ndërlikimit', përshkruan 'gjendjen e

98 Montouri, Alfonso (2011) 'Beyond Postnormal Times: The Future of Creativity and the Creativity of the Future' *Futures* 43 (2) 221–227, Mars.

99 Cubitt, Sean, Hassan, Robert dhe Volkmer, Ingrid (2010) 'Postnormal network futures: A rejoinder to Ziauddin Sardar' *Futures* 42 617–624.

100 Montouri, Alfonso dhe Donnelly, Gabrielle (2014) 'Come together...for what? Creativity and Leadership in Postnormal Times' *East-West Affairs* 5 Janar.






tanishme të çështjeve ekologjike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore, si dhe nënkupton se ne, me të vërtetë, po jetojmë në të ardhmen e një kohe të shkuar. Kjo shprehje nënkupton gjithashtu, se ne thirrmi në të kaluarën tonë, si pjesë e modelit tonë të tanishëm: pas-dyoksid karboni, pas-industrial dhe pas-kolonial janë botëkuptime kulturore të trashëguara, fjalë për fjalë, trashëgimia kulturore pas-normale.<sup>101</sup> Puna e saj thekson ndërlihdjen e gjërave, përdor logjikën krahinore dhe lehtëson së tepërmi etikën dhe estetikën. Në një nga punët e saj në Çikago, e quajtur *The 606* (sipas tre shifrave të para të kodit postar) dhe që përfshin tjetërsimin e një hapësire të madhe të rrënuar në shtigje dhe parqe rikrijuese, Whitehead ka paraqitur idenë e 'Pastrimit të ngadaltë', i cili 'zhvendos rigjallërimin mjedisor pas-dyoksid karboni, drejt hapësirave të shkencës pasnormale, pasi angazhon qytetarët e Çikagos dhe shfrytëzon të ardhurat (pasuritë) e pashfrytëzuara të hapësirës, kohës dhe mundësive njerëzore'. Në një punim tjetër në qendrën historike të Lima-s, një vend i trashëgimisë së UNESCO-s në shkaktërrim, që është vendbanimi i të varfërve qytetas, ajo dhe kolegët e saj po përpiqen të krijojnë "program bujqësor kuptimplotë qytetas, duke ndërthurr ruajtjen arkitekturore me nevojat e banorëve të tanishëm". Lidhjet ruhen që nga hulumtimet rreth patates, kolonializmi, kultura peruane, ndërhyrjet moderne në qendrat e banuara, e deri në fshatrat e largët të Irlandës perëndimore. Këtu, - vëren ajo, - 'ne i kthehemi rrethit të plotë të trashëgimisë kulturore pasnormale, të shpërfaqur në mëdyshjen themelore morale dhe madje pragmatike të mirëmbajtjes së një qyteti të shkretë, që ndoshta është në vendin e gabuar - trashëgimi e përhershme koloniale që duhet të shqyrtohet si shembull i paqëndrueshëm vendbanimi'.<sup>102</sup>


Whitehead, fjalë për fjalë, po e paraqet veten jashtë kohëve pasnormale. Ajo, me siguri, do të ndiqet nga të tjerë që do ta përdorin krijimtarinë dhe përfytyrimin e tyre për të prodhuar përkufizime të reja për gjithçka, nga arti te arkitektura, nga përjasja te politika, shkenca, shpirtërorja dhe çfarë do të thotë të jesh njeri në kohët pasnormale. Tani është koha që unë të dëgjoj "*Arctic Blood and Ice*", nga grupi muzikor eksperimental kanadez "Pas Normal". Muzika e tyre ndërthur shkencën pasnormale, tema dhe përfytyrime nga tipare të ndryshme, duke përfshirë kultura vendore, me *rock* dhe *pop* magjepsës, për të vënë në dukje se diçka është tmerrësisht gabim me kohën tonë; ne duhet të jemi në gjendje të përmirësohemi. 'Po kërkoj një këngë për ta kënduar'.

101 Whitehead, Frances (2012) '(Post Normal) Cultural Heritage', Materials Architecture Design Environment (made), *Wesleyan Student Assembly*, f. 5.

102 Whitehead, Frances (2013), 'Post Normal Art' 13 Mars, The Schuylkill Centre, Environmental Art Department, [www.schuylkillcenter.org/art/?p=70](http://www.schuylkillcenter.org/art/?p=70)





The background is a solid, vibrant blue. Overlaid on this background are several thin, black, hand-drawn style lines. These lines are fluid and organic, forming various shapes such as loops, teardrops, and elongated curves. Some lines are more prominent, while others are fainter, creating a sense of movement and depth. The overall aesthetic is modern and artistic.

# METODAT DHE PYETJET





# Tri të nesërmet e kohëve pasnormale

Ziauddin Sardar dhe John Sweeney

## HYRJE

“Gjithçka ndryshon dhe asgjë nuk është e palëvizshme”. Kështu tha Herakliti, siç njofton Platoni në librin e tij, *Cratylus* [bashkëbisedimi] (402a), mbi dy mijë vjet më parë.<sup>1</sup> Por në ditët e sotme gjithçka po ndryshon me një ritëm të përshpejtuar në disa nivele: shoqëror, politik, kulturor, teknologjik, duke përfshirë gjeologjinë, siç na lë të kuptojmë shfaqja e idesë së shkatërrimit nga dora e njeriut<sup>2</sup>, ose pikëpamja edhe më rrënjësore e shkatërrimit prej teknologjisë.<sup>3</sup> Në një shkallë më të vogël, por të ndërlidhur, vetë ideja se çfarë është trupi i njeriut dhe çfarë do të thotë të jesh njeri, po ndryshon në mënyra që në dukje janë jashtë zotërimit dhe mundësisë sonë për të kuptuar ndërlikimet për atë që mund të vijë më pas. Siç arsyetojnë Enrike dhe Gullans, në “Vetë Përmirësimi”, ne po ndryshojmë qëllimisht dhe pa dashje, vetë kushtet e mundësisë për përparim. Ndërsa ne e kemi përshtatur gjithmonë qenësinë tonë në botë, përmes të mirave të prodhuara nga dora e njeriut, mjeteve dhe nyjave lidhëse, ndikimet e ndërlikimit të jetës sonë shumë bashkëkohore kanë sjellë një periudhë ‘përzgjedhjeje të panatyrshme’ dhe ‘ndryshime jo të rastësishme’.<sup>4</sup> Në

- 1 D.N. Sedley, *Plato's Cratylus*. Cambridge, UK; New York: Cambridge University Press, 2003.
- 2 F. J. Crutzen dhe E.F. Stoermer, ‘The ‘Anthropocene,’ *Global Change Newsletter*, vol. 41, f. 17–18, 2000.
- 3 P. Berthon dhe B. Donnellan, ‘The Greening of it: Paradox or promise?’, *The Journal of Strategic Information Systems*, 20 (1), Mars 2011, f. 3–5. J.A. Sweeney, ‘Command-and-control: Alternative futures of geoengineering in an age of global weirding,’ *Futures*, vol. 57, f. 1–13, Mars 2014.
- 4 J. Enriquez dhe S. Gullans, *Evolving ourselves: how unnatural selection and nonrandom mutation are changing life on earth*. New York, New York: Current, 2015.



nivel botëror, normat e dhjamosjes te njerëzit pothuajse u dyfishuan, nga viti 1980, deri në vitin 2014.<sup>5</sup> Vetëm në SHBA, shkalla e autizmit u rrit me 119%, nga 2001, deri në 2010.<sup>6</sup>

Për më tepër, ndryshimet me të cilat po përballemi sot, nuk janë në rritje dhe të veçuara, por ndodhin njëkohësisht dhe janë të lidhura e të ndërlidhura. Shpesh, kur këto ndryshime bashkohen, ato krijojnë një ndjenjë ngërçi, siç theksoi Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-Moon. Në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, në vitin 2014, ai deklaroi: “Bota po jeton një nivel të pashembullt periudhe krizash”<sup>7</sup> Bota u përball me një listë të frikshme krizash dhe duhej ta nuhaste çoroditjen që në vitin 2014: Ebola, ISIS, Republika e Afrikës Qendrore, Gaza, Iraku, Burma, Sudani i Jugut, Siria, Ukraina, paqëndrueshmëria financiare brenda BE-së dhe përkeqësimi i marrëdhënieve midis Rusisë dhe Perëndimit, përveç çështjeve të kahershme dhe të pazgjidhura të ndryshimeve klimatike. Çfarë do të thotë e gjithë kjo?

Të gjitha sa thamë më sipër, përbëjnë një vegim të shkurtër të jetës sonë në kohët pasnormale.<sup>8</sup> Në dritën e ndryshimeve kaq të gjera, të shpejta dhe të njëkohshme - veçori kryesore e kohëve pasnormale - lind një pyetje e re dhe e rëndësishme për ithtarët e së ardhmes për studiuesit dhe zbatuesit e largpamësisë:

**A MUND TË PËRBALLEN METODAT E TANISHME ME TË ARDHMEN QË ËSHTË THELBËSISHT E NDËRLIKUAR, KAOTIKE, KUNDËRSHTUESE, E PASIGURTË DHE, SI PASOJË, PO SHEMBET VETVETIU?**

Zakonisht, studimet e së ardhmes merren me shumësinë e mundësive të së ardhmes, duke bërë dallimin midis të ardhmeve të besueshme, të mundshme, që kanë të ngjarë dhe të parapëlqyeshme.<sup>9</sup> Por çfarë është e mundshme në një botë ku pasiguria dhe çoroditja janë normë? Çfarë është

5 World Health Organization, 'who | Obesity and overweight,' WHO, Janar 2011. [Online]. E disponueshme: [www.who.int/mediacentre/factsheets/fs311/en/](http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs311/en/) [Shikuar: 17-May-2015].  
6 Centers for Disease Control and Prevention, 'Facts About asds,' cdc - Facts about Autism Spectrum Disorders - ncbddd, Shkurt 2015. E disponueshme: [www.cdc.gov/ncbddd/autism/facts.html](http://www.cdc.gov/ncbddd/autism/facts.html) [Shikuar: 17 May 2015].  
7 J. Borger, 'Ban Ki-moon: 'World living in an era of unprecedented level of crises,' the Guardian, 21 Shtator 2014. E disponueshme: [www.theguardian.com/world/2014/sep/21/ban-ki-moon-world-living-era-undprecedentedlevel-crises](http://www.theguardian.com/world/2014/sep/21/ban-ki-moon-world-living-era-undprecedentedlevel-crises) [Shikuar: 17 May 2015].  
8 Z. Sardar, 'Welcome to postnormal times,' *Futures*, vol. 42, no. 5, f. 435-444, Qershor 2010.  
9 Z. Sardar, 'Postnormal times revisited,' *Futures*, vol. 67, f. 26-39, Mars 2015.  
9 N. Henchey, 'Making Sense of Futures Studies,' *Alternatives: Perspectives on Society and Environment*, f. 26, Winter 1978.



e besueshme në të ardhmen e mbizotëruar nga mospërputhjet? A janë mënyrat tona të trashëguara, të tilla si parashikimi, rrugët dhe modelimi, të përshtatshme për kohët pasnormale? A e marrin ato parasysh ndryshimin e ndryshimit të skenarëve për të ardhmen? A e lejojnë në mënyrë të saktë metodat e tanishme të modelimit të skenarëve shumësinë dhe punime me më shumë se dy autorë (aq të nevojshme), duke përfshirë qoftë edhe shqyrtimet midis krijesave njerëzore, çnjerëzore dhe mbinjerëzore, aq të nevojshme për t'u përballur me kohët pasnormale? Si mund të prodhohet qasje të qëndrueshme për të lundruar në kohët pasnormale? Ose, për ta thënë ndryshe, a na tregojnë rrëfenjat tona për të ardhmen(et) diçka kuptimplote, që mund të gjallërojë mënyra veprimi dhe strategji për të përballuar ndërlikimin, pasigurinë dhe çoroditjen?

“Kur gjithçka është e pasigurt, asgjë nuk është e parashikueshme”, shkruan Gardner te *Flluska e së ardhmes*.<sup>10</sup> Shumica e parashikimeve, në mënyrë të pandryshueshme, qëlluan të jenë të gabuara, siç zbuloi kohët e fundit *Scientific American*, kur bëri një përmbledhje të pohimeve të saj të së kaluarës, për të ardhmen.<sup>11</sup> Në të vërtetë, pohoi Gardner, parashikimet dhe largpamësia e të diturve, pavarësisht mundësive të marra parasysh, mënyra që ne përdorim në *Delphi*, i shtojnë problemet tona, sepse ato “largojnë ndërlikimin, moskuptimin dhe pasigurinë”.<sup>12</sup> Si një mjet për të zgjidhur këtë problem, shpesh ravijëzohet planin e veprimit. Por, siç arsyetën Glen dhe Gordon,

plan veprimi është ndoshta emërtesa më e keqpërdorur në kërkimin e së ardhmes. Ajo që zakonisht kalon si një plan veprimi sot, është shqyrtimi i një varg mundësish të ardhshme me të dhëna të zbërthyer. [...] Është si të ngatëroni tekstin e një artikulli gazete rreth një drame, me vetë tekstin e dramës së shkruar nga dramaturgu.<sup>13</sup>

Planveprimet nuk mund të marrin kurrë parasysh, sado me kujdes të jenë përpiluar, shumë prej (nëse jo shumicën) ndryshimeve që mund të ndodhin mes së tashmes dhe një horizonti kohor të caktuar. Ne besojmë se kjo vlen shumë edhe për planveprimet që theksojnë besueshmërinë.

Besueshmëria ka qenë gjithmonë një emërtesë e diskutueshme brenda Studimeve të së Ardhmes, qoftë edhe vetëm sepse një nga qëllimet

10 D. Gardner, *Future babble: why pundits are hedgehogs and foxes know best*. New York, NY: Plume, 2012, f. 139.

11 U. von Reibnitz, *Scenario Techniques*. Hamburg: McGraw-Hill Book, 1988.

12 D. Gardner, *Future babble: why pundits are hedgehogs and foxes know best*. New York, NY: Plume, 2012.

13 J.C. Glenn, T.J. Gordon, dhe Millennium Project., *Futures research methodology*. [Washington, dc]: Millennium Project, f. 2, 2009.



kryesore të largpamësisë është të vërë në pikëpyetje syrin normativ dhe logjik, me të cilin ne nuhasim atë çfarë na pret. Është e rëndësishme të theksohet se rrënja e emërtesës *besueshmëri* është nga latinishtja, *plausibilis*: “i denjë për duartrokitje”. Shkurtimisht, besueshmëria ka të bëjë me pranueshmërinë, aq sa ç’ka të bëjë edhe me lidhjen e ndërsjellë logjike, që do të thotë se ka të bëjë shumë më tepër me të tashmen, sesa me të ardhmen – një pikë e mirësquaruar drejtpërdrejt edhe nga Ligji i Dytë i së Ardhmes, i Datorit: ‘Çdo ide e dobishme për të ardhmen duhet të duket qesharake’.<sup>14</sup>


Kjo nuk do të thotë se metodat e tanishme për të ardhmen janë të parëndësishme, në çfarëdo lloj mënyre qoftë, por ato thjesht vënë në dukje kufizimet e tyre të qenësishme - veçanërisht në lidhje me kohët pasnormale. Nëse Studimet e së Ardhmes, para së gjithash, kanë të bëjnë me shqyrtimin e përfytyrimeve të së ardhmes, atëherë nuhatja dhe besueshmëria janë sigurisht diçka që duhen marrë parasysh, kur ravijëzohen planet e veprimtimit. Por kjo nuk duhet të jetë e vetmja njësi matëse dhe më e rëndësishmja. Në fund të fundit, qëllimi i çdo zbatimi të një planveprimi është të gjallërojë veprime për të ardhmen, duke shqetësuar të tashmen. Por ne nuk besojmë se metodat e së ardhmes po shkojnë në një hap me forcat dhe shtysat që, në të vërtetë, po shqetësojnë të tashmen dhe po na çojnë drejt të ardhmes së pamenduar. Një zberthim i metodës gjithnjë e më të dëgjuar, *Tre Horizontet*, ndihmon për të studiuar rrethanat e pikëpamjes sonë.

*Tre Horizontet*, fillimisht, u krijua për të ndihmuar blerësit ‘të angazhohen njëkohësisht me të ardhme afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata’. Përsëritja e parë synon strategji dhe nisma të llojit ‘tunele ere’, duke përdorur lakore të njëpasnjëshme *S*, për të modeluar kohën e ndryshimit.<sup>15</sup> Duke lëvizur përtej qasjeve të caktuara që anojnë nga udhëheqësia, *Tre Horizontet* mori një vëmendje të madhe, përmes punës së Sharpe dhe Hodgson, të cilët ripërcaktuan mjetin për ‘të parë rrethanën tonë të tanishme në mënyra të ndryshme dhe për të ndihmuar në sqarimin e zgjedhjeve të disponueshme’.<sup>16</sup> Së pari, krijohet një bosht *x*, duke përdorur njësinë matëse të kohës (nga e tashmja, në të ardhmen) dhe një bosht *y*, duke përdorur njësinë matëse të “përshtatjes strategjike” me një shtrirje të ulët (nga poshtë), në të lartë (nga sipër), siç përshkruhet në Figurën 1.

14 J.A. Dator, J. A. Sweeney, dhe A.M. Yee, *Mutative Media*. Switzerland: Springer International Publishing, 2015.

15 A. Curry dhe A. Hodgson, ‘Seeing in Multiple Horizons: Connecting Futures to Strategy’, *Journal of Futures Studies*, vol. 13, no. 1, f. 4, Gusht 2008.

16 B. Sharpe dhe T. Hodgson, ‘Intelligent Infrastructure Futures Technology Forward Look: Towards a Cyber-Urban Ecology’, *Foresight Programme*, Office of Science and Technology, UK, f. 6, Janar 2006.



Më tej, dikush përshkruan tre horizontet. Horizonti i parë qartëson shembujt dhe ideologjitë mbizotëruese të sotme, të cilat, siç lë të kuptojë metoda, do të trefren ndërsa njeriu ecën përpara në kohë. Më pas, dikush tjetër ravijëzon horizontin e tretë, i cili përbëhet nga çështje në zhvillim, ose shenja të dobëta – duke përfshirë ato që janë më të lidhura me të ardhmen e parapëlqyer ose të frikshme – që shtrihen më tej, duke përdorur një model të lakores S të rritjes. Së fundi, dikush harton horizontin e dytë për të modeluar sfidat dhe pasiguritë në lidhje me horizontin e parë dhe, si të thuash, sfidat me të cilat përballen të dy horizontet. Nuk ka dyshim, se kjo është përmasa më tërheqëse e metodës *Tre Horizonte*, veçanërisht pasi kjo është e vetmja hapësirë ku mund të shfaqen kushte vërtet pasnormale, të paktën në teori. Cilësia dhe mosmarrëveshja jonë përqendrohet në faktin se i vetmi vend i vërtetë i përplasjes në këtë metodë ndodh në mes të së ardhmes, që do të thotë se kjo përjasje i merr fare pak parasysht ndërlikimet dhe përshpejtimet gjallëruese që pushtojnë vazhdimisht mënyrat tona më të mira të veprimit, këtu dhe tani. Me fjalë të tjera, *Tre Horizontet* na ndihmojnë të përgatitemi për një të ardhme që mund të ketë kaluar tashmë, ose, ndoshta edhe më keq, mund të na bëjë pa dashje të besojmë se ndryshimi shpaloset në një mënyrë të parashikueshme, nëse jo të përsëritur. Për të qenë të ndershëm, asnjë mjet apo metodë nuk është e përsosur, por ne besojmë se nevojitet diçka më shumë, që të na ndihmojë të lundrojmë në kohët pasnormale.

Siç kemi thënë diku tjetër, ne dhe të tjerë, kohët pasnormale kërkojnë që ne të largohemi nga drejtvizorja dhe ta përqendrojmë vëmendjen tonë në ndërlidhjet midis ndërlikimit, çoroditjes dhe mospërputhjeve. Për më





tepër, të gjitha rrëfenjat që tregojmë për të ardhmen(et), duhet të theksojnë natyrën e tyre të gjallë dhe të larmishme mendore, fuqinë çoroditëse, mundësitë kundërshtuese, si dhe të nxisin përfytyrimin dhe krijimtarinë.<sup>17</sup> Kjo është arsyeja, pse ne, si edhe të tjerët, na pëlqen të flasim për 'çuditshmërinë mbarëbotërore', në vend të 'ngrohjes botërore'. Studimet e së ardhmes duhet të bëjnë më shumë, jo vetëm duke u angazhuar, por edhe duke e përqafuar vërtet të çuditshmen, qoftë edhe sa për të mbetur e rëndësishme në vazhden e ndryshimeve që do të vijjnë.<sup>18</sup> Në dritën e kësaj dukurie, Shulc pohon se Ligji i Dytë i Datorit duhet të shpallë "qesharaken" vetëm për "hamendësime sfiduese" dhe çdo ide vërtet e dobishme për të ardhmen(et) duhet të duket sikur "tejkalon çdo kufi (shembull sfidues) dhe sfidë vlerash të neveritshme".<sup>19</sup> Shtrirja dhe shkalla e çuditshmërisë botërore, të cilën ne ende nuk e kuptojmë plotësisht, i ka shtyrë disa të shpallin qëllimet me shkrim, në përgjigje të sfidave pasnormale të së tashmes dhe mundësive për atë që mund të vijë më pas. Themeluesit e *Përshpejtueshmërisë*, Williams dhe Srnicek, pohojnë:

Ajo me të cilën e majta duhet të rilidhet, janë rrënjët e saj në Iluministe [...], për të synuar një vegim të sigurtë të së ardhmes, të aftë për të zëvendësuar sistemet tona të tanishme ekonomike dhe politike me sisteme që mundësojnë, në vend që të shtypin, një lulëzim të përgjithshëm njerëzor... Sepse vetëm kur e majta merr drejtimin e së ardhmes dhe modernizimi përsëri bëhet shëmbëlltëyë e politikës thellësisht të majtë, në vend të neoliberalizmit, na mundëson që bashkërisht ta kuptojmë botën tonë, në mënyrë që ta ndryshojmë atë.<sup>20</sup>

Megjithëse në *Manifestin e Përshpejtueshmërisë* përmendet ideja e së ardhmes tronditëse, ata duken mjerisht të pavetëdijshëm rreth Studimeve të së Ardhmes, si një lëndë akademike dhe fushë e zbatimit. Ndërkohë që është ndoshta marrëzi të presësh zbërthime të shtyra nga hulumtimi i një manifesti. Manifesti i së ardhmes, nga Gonzo dhe Pikard, vendos veten krejtësisht brenda ecurisë së ndryshimeve të kohëve pasnormale dhe lëkundjeve, drejt nevojës për mënyra të reja të mendimit dhe veprimit.<sup>21</sup>

17 A. Montuori, 'Beyond postnormal times: The future of creativity and the creativity of the future,' *Futures*, vol. 43, no. 2, f. 221–227, Mars 2011.

18 J.A. Sweeney, 'Command-and-control: Alternative futures of geoengineering in an age of global weirding,' *Futures*, vol. 57, f. 1–13, Mars 2014.

19 W.L. Schultz, 'Beyond Vision and Eccentricity – Applied Crazy (for PostNormal Times),' presented at the *Crazy Futures II*, Romania, 23 Qershor 2014.

20 A. Williams dhe N. Srnicek, '#accelerate manifesto for an Accelerationist Politics,' *Critical Legal Thinking*, 14 Maj 2013. E disponueshme: <http://criticallegalthinking.com/2013/05/14/accelerate-0manifesto-foranaccelerationist-politics/> [Shikuar: 17 Maj 2015].

21 J. Pickard, 'A Gonzo Futurist Manifesto,' 2012. E disponueshme: <http://justinpickard.net/gonzo-futurist-manifesto.pdf> [Shikuar: 15 Mars 2015].



Ajo që është e rëndësishme për të dy manifestet, është dallimi i tyre në përmasa. Ndërsa njëri (Përshpejtueshmëria) përqendrohet te vogëlsitë, tjetri (Gonzo) kënaqet në 'një çerdhe afrie; në bashkësinë e qëllimeve tua-ja vetjake'.<sup>22</sup> Nëse diçka është e dukshme te kohët pasnormale, është se nuk duhet zgjedhur thjesht midis sipërmarrjeve të mëdha politike dhe jehonës së asaj që beson vetëm ai. Çfarë nevojitet? Hulumtime nga shumë autorë, të një shtrirjeje dhe shkalle të ndryshme.<sup>23</sup>

E themeluar në vitin 1977, nga Kristeva, e cila ka një libër me të njëjtin emër, punimet me shumë autorë tregojnë "logjikë, fjalime dhe qenësi të shumëfishta".<sup>24</sup> Siç e shohim, ata kërkojnë krijimin e hapësirave të reja fizike dhe mendore, ku larmia, shumësia dhe mospërputhja e pikëpamjeve janë të pranishme, sipas kushteve të tyre, por gjithashtu investohen thellësisht në angazhimin e të tjerëve, në krijimin dhe shkëmbimin e të dhënave dhe njohurive. Për disa, kjo ishte shpresa e asaj që do të bënte Wikipedia, por versioni në anglisht është parë si një 'dështim i madh, ' pasi 'vetëm një pjesë e vogël e përdoruesve tani redaktojnë artikuj dhe shumica dërrmuese e atyre redaktorëve janë meshku'.<sup>25</sup> Përveç gjetjes së mënyrave më të mira dhe më të barabarta për të ndarë atë që dimë dhe si e dimë, ne duhet të kërkojmë vazhdimisht mjete bashkëpunuese dhe gjallëruese për të krijuar dhe ndarë rrëfenjat tona. Siç vë në dukje Letur, 'tregimi i rrëfenjave nuk është vetëm një veti e gjuhës njerëzore, por një nga pasojat e shumta të të qenit në një botë që është, në vetvete, plotësisht e nyjzuar dhe në veprim. Është e lehtë të kuptosh, pse do të jetë krejtësisht e pamundur të tregohen ndryshimet e tokës sonë të përbashkët, pa të gjithë ne – romancierët, gjeneralët, inxhinierët, shkencëtarët, politikanët, veprimtarët dhe qytetarët – pra, të afrohe- mi gjithnjë e më shumë brenda një hapësire kaq të përbashkët bashkëpunimi'.<sup>26</sup> 'Zona e përbashkët e bashkëpunimit' të Letur-it, është pikërisht ajo që ne kërkojmë në thirrjen tonë për punimet me shumë autorë të Kristevës dhe ne besojmë se kjo ide është e munguar për shumë, nëse jo për shumicën, e ligjëratave të vazhdueshme mbi të tashmen dhe të ardhmen. Krijimi i hapësirave të tilla, nëpërmjet veprimtarive apo punimeve të caktuara me shumë autorë, nuk do të jetë një detyrë e lehtë, veçanërisht pasi kjo përpjekje kërkon që ne të rimendojmë traditat, qasjet dhe zakonet e përhapura

22 Po aty.

23 J. Kristeva, *Polylogue*. Paris: Seuil, 1977.

24 H. Chen, 'The Concept of the 'Polylogue' and the Question of 'Intercultural' Identity,' *Intercultural Communication Studies*, vol. xix, no. 3, f. 54–64, 2010.

25 J. Kleeman, 'The Wikipedia wars: does it matter if our biggest source of knowledge is written by men?,' *NewStatesman*, f. 35, 26 Maj 2015.

26 B. Latour, 'Agency at the Time of the Anthropocene,' *New Literary History*, vol. 45, no. 1, f. 14, 2014.



thellësisht të ndarjes dhe prodhimit të njohurive. Si e tillë, çdo zbërthim i së tashmes dhe së ardhmes duhet, gjithashtu, të pranojë se shumë gjëra që ne i marrim si të mirëqena, duke përfshirë një varg sistemesh të ndërlikuara, do të (vazhdojnë të) bëhen të çuditshme. Mund të jetë e vërtetë, se s'ka si rasti historik, por, sipas vlerësimit tonë, kjo është më së shumti një e vërtetë e së ardhmes.

## NORMALITETI, PASNORMALITETI, ZVARRITJA PASNORMALE DHE SHPËRTHIMI

E vërteta e parë e çuditshme që duhet të pranojmë, është se:

**NORMALITETI DHE PASNORMALITETI, TË DYJA MBIVENDOSEN DHE JETOJNË KRAH PËR KRAH.**

Jo të gjitha sistemet ndikohen në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën masë nga ndërlikimi, çoroditja dhe mospërputhjet (këtej e tutje, tri shtyllat) - 'forcat që formojnë dhe shtyjnë kohët pasnormale'.<sup>27</sup> Po ashtu, jo të gjitha sistemet janë në thelb pasnormale dhe do të bëhen pasnormale në të njëjtën mënyrë. Për shembull, bashkësitë, strukturat dhe shoqatat e veçuara që janë të vetëm-bështetura dhe jo të lidhura me ekonominë botërore dhe sistemin ndërkom-bëtar, mund dhe duhet të jenë më të përshtatura në vazhden e ndryshimeve klimatike. Megjithatë, herët a vonë, shumë sisteme 'normale' nuk do të vazhdojnë të punojnë 'normalisht' në kohët pasnormale - tri shtyllat e lartpërmendura, do të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi 'to. Për më tepër, ka disa sisteme që janë tashmë pasnormale, si shkenca, inteligjenca, privatësia dhe sistemet e tjera të rrjetit që i afrohen mundësive pasnormale - siç janë veturat<sup>28</sup> dhe frigoriferët.<sup>29</sup> Kur dikush ndalet e mendon mbi ndryshimet përreth nesh, gjërat sigurisht që mund të ndihen pasnormale. Megjithatë, për brezat e lindur në këtë mjedis, pasnormalja do të jetë normale - bota do të jetë ashtu siç ata e njohin dhe e banojnë.

27 Z. Sardar, 'Welcome to postnormal times,' *Futures*, vol. 42, nr. 5, f. 436, Qershor 2010.

28 S. Higginbotham, 'Samsung's smart fridge could be used to steal your Gmail login,' *Fortune*, 24 Gusht 2015.

29 A. Greenberg, 'Hackers Remotely Kill a Jeep on the Highway— With Me in It,' *Wired*, 21 Korrik 2015. [Online]. E disponueshme: [www.wired.com/2015/07/hackers-remotely-kill-jeep-highway/](http://www.wired.com/2015/07/hackers-remotely-kill-jeep-highway/) [Shikuar: 3 Shtator 2015].



Sido që të jetë, vetë ideja e normalitetit është disi e çuditshme, veçanërisht në kohët pasnormale. Ky normalitet nuk përputhet me përku-fizimet e pranuar: të përcaktuara, të zakonshme, tradicionale, të rregulluara dhe të natyrshme. Përkundrazi, siç thekson Rao, është, pa dyshim, një “normalitet i prodhuar”.<sup>30</sup> Është ‘prodhuar’ në kuptimin, siç përvijon Herman dhe Chomsky te *Prodhimtaria e miratuar*, që norma të tilla janë zhvilluar nga institucione dhe shoqata të fuqishme ndërkombëtare, duke përfshirë mediat dhe ndërmarrjet e teknologjisë, që punojnë duke u mbështetur në fuqitë e tregut, hamendësimet e brendshme të padiskutueshme dhe ndryshimet e brishta, për të ngjallur dëshira dhe ëndrra ideologjike dhe fuqi shpenzuese. Por, më e rëndësishmja, ajo prodhohet nga kundërveprimet tona dhe nuhatja e ndryshimit – si në të kaluarën, ashtu edhe në të tashmen. Siç vë në dukje Rao, kur njerëzit përballen me përvoja të reja teknologjike, ata bëjnë të gjitha përpjekjet e tyre për të ruajtur një “ndjenjë të njohur të një të tashmeje vazhdimisht të palëvizshme”.<sup>31</sup> Në të vërtetë, ne i ndryshojmë modelet dhe sjelljet tona mendore në përpjekje për të anashkaluar ose përbuzur ndryshimet që po ndodhin para syve tanë. Ne shikojmë prapa për të krijuar histori dhe metafora që lidhin ndryshimet e reja që po përjetojmë me diçka që tashmë e dimë dhe e kuptojmë. Telefoni i dorës përdori kuptimin e fshehtë të telefonit për ta kthyer kompjuterin në celular të kuptueshëm. Përpunimi i tekstit përdor kuptimet e fshehta të faqeve dhe shkresave që kanë qenë në përdorim për një mijëvjeçar dhe ‘ne e kuptojmë Facebook-un duke kujtuar librat shkollorë’.<sup>32</sup> Pastaj bëjmë zgjedhje të qëllimshme për të theksuar çuditshmërinë e së resë. Rao e shpjegon këtë, duke përdorur shembullin e udhëtimit ajror:

Udhëtarët e linjës ajrore nuk fluturojnë. Ata udhëtojnë në një fushë normaliteti të prodhuar. Kur jeni ulur në një avion tipik bashkëkohor, ju jeni duke udhëtuar me 500 mph në një tub alumini që është, në të vërtetë, i aftë për disa drejtpeshime mjaft të frikshme, duke përfshirë edhe gjallërimin e periudhave të shkurtra të mungesës së gravitetit. Megjithatë, një udhëtar tipik ajror nuk përjeton kurrë diçka që një nga paraardhësit tanë nuk mund ta përjetonte në një karrocë të shpejtë, ose në një varkë.<sup>33</sup>

30 V. Rao, ‘Welcome to the Future Nauseous,’ ribbonfarm: experiments in refactored perception, 9 May 2012. E disponueshme: [www.ribbonfarm.com/2012/05/09/welcome-to-the-future-nauseous/](http://www.ribbonfarm.com/2012/05/09/welcome-to-the-future-nauseous/) [Shikuar: 10 Prill 2015].

31 Po aty.


32 V. Rao, ‘Welcome to the Future Nauseous,’ ribbonfarm: experiments in refactored perception, 9 May 2012. E disponueshme: [www.ribbonfarm.com/2012/05/09/welcome-to-the-future-nauseous/](http://www.ribbonfarm.com/2012/05/09/welcome-to-the-future-nauseous/) [Shikuar: 10 Prill 2015].

33 Po aty.



Siç sqaron Rao, Fusha e Normalitetit të Prodhuar është një mjet për të rидrejtuar nuhatjet tona për atë që është dhe nuk është normale. Si një fushë që zgjerohet dhe tkurret në lidhje me përqendrimin tonë vetjak ose të përbashkët, ajo është formuar nga fuqitë e padijes dhe pasigurisë. Figura 2 ofron një pasqyrim të kësaj marrëdhënieje.

Figura 2



Dukuritë ‘normale’ lëvizin në drejtim të pasnormalitetit, përmes ecurisë së *Zvarritjes Pasnormale*, kur sistemet bëhen të ndërlydhura dhe të ndërlykuara, kur rrjetet shoqërore, televizioni 24-orësh dhe mënyra të tjera teknologjike përdoren për të gjallëruar kundërveprimet, atëherë shfaqet çoroditja, ndonjëherë me shpejtësi, dhe gjërat bëhen të çuditshme. Kjo ide është kapur shkëlqyeshëm në serialin e vlerësuar të BBC-së, *Pasqyra e Zezë*, i cili: përfytyron me shkathtësi ndryshimet e shumta që rrethojnë teknologjitë e reja dhe ato në zhvillim; shpjegon ndërveprimet dhe kundërveprimet e qarta njerëzore që qëndrojnë në themel të ‘përshtatjes së mediave’ të ndryshme.<sup>34</sup> Një numër studiuesish kanë vënë në dukje mënyrat e njohura me të cilat ‘të dhënat dhe mjetet e ndërlydhjes të bazuara në rrjet mund të shërbejnë si faktorë të fuqishëm përshpejtues të tubimeve shoqërore’.<sup>35</sup> Disa prej të cilave janë: kryengritjet në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut, zakonisht të njohura si ‘Pranvera Arabe’; tubimet e fundit në Baltimorë, Ferguson dhe qytete të tjera në SHBA, të cilat çuan në shfaqjen e lëvizjes *#blacklivesmatter*. Këta janë shembuj të qartë, se si teknologjitë e ndërlydhjes mund të shpejtojnë ecurinë e zvarritjes

34 J.A. Dator, J. A. Sweeney, dhe A.M. Yee, *Mutative Media*. Switzerland: Springer International Publishing, 2015.

35 E. Stepanova, “The Role of Information Communication Technologies in the ‘Arab Spring,’” PONARS Eurasia: New Approaches to Research and Security in Asia, *PONARS Eurasia Policy Memo* No. 159, f. 6, Maj 2011.



pasnormale. Megjithëse forcat që drejtojnë zvarritjen pasnormale mund të jenë të fuqishme, jo të gjitha përqafojnë rrjedhat e rrymave kaq të forta. Ka disa prej nesh që nuk mund ta shohin, ose, më mirë, e përbuzin dhe e hedhin poshtë shfaqjen e *zvarritjes pasnormale*, duke u kapur pas normalitetit të sajuar përballë çudirave. Ata vuajnë nga *vonesa pasnormale* - gjendje e ndjerë e mohimit. Një shembull i qartë janë mohuesit e ndryshimeve klimatike. Në psikologji, ideja e mohimit shpjegon se si dikush vazhdon të mohojë diçka që, në këtë rast, përbën një nga kërcënimet më të mëdha me të cilat përballet bota, edhe përballë provave të pakundërshtuara. Përmes mohimit, ashtu sikurse përmes vonesës pasnormale, zgjedhin, ndoshta me vetëdije, të mos ia dinë. Kështu, vonesa pasnormale është një mohim që mund të kapërcehet vetëm përmes *vrullit pasnormal*: kur sistemi përfundon plotësisht në pasormal dhe nuk ka vend për t'u fshehur.

Merrni parasysh rastin se si jeta jonë digjitale na mban vazhdimisht në buzë të humnerës. Twitter, fjala vjen, i cili kërkon kundërveprime të menjëhershme dhe shumëfishon kundërveprimet tuaja. Një cicërimë e pamenduar mund t'ju çojë menjëherë drejt horizonteve të papeshuara, siç zbuloi Xhastin Sako, përfaqësuesja e një botuesi amerikan, më 20 dhjetor 2013. Gjatë rrugës për në Kape Town (Kejp Taun), ajo u postoi në Twitter 170 ndjekësve të saj, pak para se t'i hipte aeroplanit në Hithrou:

"- U nisa për Afrikë. Shpresoj të mos marr SIDA-n! Bëj shaka! Jam e bardhë."<sup>36</sup> Edhe pse ajo e pa botimin e saj në *Twitter*, si një vërejtje ndaj përparësisë që kanë të bardhët, shumica dërrmuese e ndjekësve në *Twitter* e kuptuan mesazhin e saj ndryshe. Në kohën kur zbriti në Kejp Taun, njëmbëdhjetë orë më vonë, ajo ishte në qendër të 'vëmendjes' mbarëbotërore. Brenda 11 ditëve, për Sakon u kërkua 1.22 milionë herë në *Google* dhe disa ditë më vonë u pushua nga puna. Ajo ende nuk ka gjetur ndonjë punë fitimprurëse, apo një të dashur.<sup>37</sup> Siç tregon shembulli i Sakos, vrulli pasnormal mund të ketë një varg ndikimesh të llojeve të ndryshme, duke përfshirë edhe ato shumë vetjake.

## TRI TË NESËRMET E KOHËVE PASNORMALE – THEMELI

Duke pasur parasysh veçoritë e çuditshme të epokës sonë, hulumtimi i së ardhmes brenda përkufizimeve të kohëve pasnormale na paraqet sfida të

36 J. Ronson, *So you've been publicly shamed*, f. 64, 2015.

37 L. Moses, 'The Justine Sacco redemption tour: Too little too late?', *Digiday*, 13 Shkurt 2015.



përcaktuara. Duhet të përqendrohemi te njëkohshmëria dhe ndërlikimi, si dhe te natyra gjallëruese e themelit të kohëve pasnormale. Kemi nevojë për një vlerësim të pasigurisë, si dhe të niveleve të ndryshme të padijes. Në kohët pasnormale të panjohurat nuk mund të kthehen në rreziqe të matshme. Duhet të marrim parasysh prirjet e vëzhgimit empirik, të kuptojmë teorikisht prirjet që prodhojnë zvarritja dhe vrulli pasnormal, si dhe të përfshijmë sa më shumë përfytyrim dhe krijimtari në të gjithë zbatueshmërinë. Themeli që kemi ndërtuar për të kuptuar dhe për të lundruar kohët pasnormale, si dhe për të hulumtuar të ardhmen, është *Tri të nesërmet e kohëve pasnormale*.

Lidhur me themelin, duhet të kemi parasysh se e tashmja është gjallëruese, e kyçur në rrjet, përbëhet nga normaliteti i sajuar dhe metodat e tejngopura me mundësitë për të anuar nga pasnormalja. Me fjalë të tjera, e tashmja është e ndërlikuar, e larmishme dhe pjesërisht pasnormale. Të gjitha këto duhet të shpërfaqen pikërisht në fillim të hulumtimit tonë të së ardhmes. Por e tashmja nuk është thjesht e tashmja. Ajo është 'stërzgatur', sepse shumë prirje për vëzhgim empirik janë të ngulitura thellë në të tashmen dhe do të shfaqen në vitet e ardhshme. Kjo Dhuratë e Zgjeruar është e nesërmja e parë, kjo është ajo që shumica e njerëzve nënkuptojnë kur flasin për "të ardhmen".

E tashmja e stërzgatur mbizotërohet dhe popullohet me prirje (mbarëbotërore, krahinore dhe vendore) dhe çështje të reja, ose shenja përkeqësimi që nuk mund të shmangen. Ato thjesht shtrijnë dhe zgjerojnë të tashmen për të mbuluar pesë deri në dhjetë vitet e ardhshme, megjithëse veçoritë e përkohshme i përshtaten përmbajtjes tematike. Me fjalë të tjera, e ardhmja e përfaqësuar nga *e tashmja e stërzgatur* tashmë është pushtuar gjerësisht.<sup>38</sup> Më e mira që mund të bëjmë këtu, është të përdorim këndvështrimin e kohëve pasnormale, për të dalluar sistemet që mund të zvarriten drejt pasnormalitetit, ose buzë vrullit pasnormal. Të thuash se *e tashmja e stërzgatur* është tashmë e pushtuar, hedh në erë idenë e vendimmarrjeve që nuk kanë lidhje me vullnetin, një ndër mallkimet e Studimeve të së Ardhmes, e cila është gjithashtu mjaft e neveritshme ndaj parashikimeve. Megjithatë, është e vërtetë se një shumëllojshmëri prirjesh dhe dukurish janë të ngulitura në *të tashmen e stërzgatur* dhe janë të parashikueshme, megjithëse njohja e përsosur e asaj që mund të ndodhë më pas, mbetet e pamundur.

38 J. Dator, 'De-colonizing the Future,' in *The Next 25 Years: Challenges and Opportunities*, A. Spekke, Ed. Bethesda, Maryland: World Future Society, 1975; Z. Sardar, 'Colonizing the future: the 'other' dimension of futures studies,' *Futures*, vol. 25, no. 2, f. 179-187, Mars 1993.



Le të marrim shembullin mjaft të parëndësishëm të orës elektronike që lidhet me telefonin e dorës, prodhuar nga *Apple*. Në numrin e nëntorit 2014, *Tre të nesërmet: Revista e pajisjeve*, në letrën e fundit redaktori (tani ish-redaktor) i botimit, mburrej: “ - Ne e parashikuam ‘këtë orë’ në numrin tim të parë, pothuajse para katër vitesh...Në një afat kohor mjaft të gjatë, të gjithë ne ia qëlluam disi dhe tani kjo orë doli në treg”.<sup>39</sup> Parashikimi i Hill nuk është i jashtëzakonshëm apo i saktë. Prirja drejt ‘orëve kompjuterike’ ishte e mirënjohur nga viti 2008<sup>40</sup>, edhe si ndërmarrje që kishte krijuar një linjë ‘elektronike’ prodhimi, gjë që e bëri *Apple* të ketë vlerën 1 trilion dollarë.<sup>41</sup> Nuk ishte çudi që *Apple* të prodhojë një orë, veçanërisht pasi tregu për pajisje të tilla që merren kudo me vete, vlerësohej nga shumë njerëz si gjëja madhështore e radhës. Pohimi i Hill-it kishte një kleçkë të vogël: një ndërmarrje e vendosur në Europë regjistroi emrin e orës *iWatch* në vitin 2008, që do të thotë se ora e mençur e kompanisë *Apple*, e cila u shfaq në treg në prill të vitit 2015, nuk ishte në gjendje t’i bashkohej linjës së prodhimit ‘elektronik’, prandaj quhet thjesht *Apple Watch*. Ajo që është e rëndësishme, në lidhje me pohimin e Hill-it dhe rëndësinë e tij për vlerësimin e së tashmes së zgjeruar, është se ai nxori në pah një prirje të ngulitur që do të merrte rrjedhën e saj të natyrshme, veçse humbi, ose, më mirë, i ngatërroi hollësitë. Në të tashmen e zgjeruar, mund të jetë e mundur të parashikohet me saktësi, ose të parashikohet se çfarë na pret, veçanërisht në fushat e zhvillimit teknologjik, por duhet parë përtej një peshimi të thjeshtë, për të kuptuar gjallërinë pasnormale të këtij horizonti.

Pas së tashmes së stërzgatur, vjen e ardhmja, të ardhmet e njohura, që mund dhe duhet të zgjasin nga dhjetë, deri në njëzet vjet. Pavarësisht nga horizonti kohor, duken të njohura, sepse ndërmjetësohen nga vegimet dhe përfytyrimet e së ardhmes, që nga parashikimet e përcaktuara nga të dhënat, deri te fantashkenca. Prirjet e rrënjësura në të tashmen e stërzgatur, së bashku me pamjet nga reklamat, largpamësia e sipërmarrjeve, romanet popullore ‘të së ardhmes’ dhe fantashkencës, filmat dhe shfaqjet televizive, janë shumë të njohura dhe të parapara për krijimin e një pamjeje të së ardhmes, që të jetë sa më e njohur. Për shembull, sa zhvillime teknologjike e kanë zanafillën, ose janë gati të fillojnë, mbështetur në pamje nga filmat fantastiko-shkencorë? Njeriu robot nga *Terminatori* (1984) dhe robotët e tjerë nga *Star Wars* (1977) janë shndërruar në robotë ushtarakë të Google-it, si p.sh. *Atlasi* - roboti i

39 M. Hill, ‘Editor’s Letter,’ *T3: The Gadget Magazine*, Nëntor 2014.

40 B. Rhodes, ‘A Brief History of Wearable Computing,’ 15 Shkurt 1997. E disponueshme: [www.media.mit.edu/wearables/lizzy/timeline.html](http://www.media.mit.edu/wearables/lizzy/timeline.html) [Shikuar: 10 Mars 2015].

41 J. Yarow, ‘How Apple Becomes A \$1 Trillion Company,’ *Business Insider*, 26 Nëntor 2014.





shkathët antropomorfik' dhe *Pet Man* - roboti ushtar, që të dy në zhvillim e sipër dhe që do të lëshohen pak a shumë brenda një dhjetë vjeçari.<sup>42</sup> Apo mjediset e ndërtuara dhe popullimi i qyteteve, që na pasqyrojnë hapësirën ndërqytetëse të filmit *Blade Runner* (1982) dhe *Dark City* (1998). Vetë *Disneyland* ka frymëzuar shumë qytete, si Putra Jaya, Malajzia apo Meka, në Arabinë Saudite. Po kështu, sjellja e personazheve në *Mad Max* (1979, 2015) kopjohet nga xhihadistët e përkushtuar të 'Kalifatit Islamik'.<sup>43</sup> Pastaj vjen edhe mundësia e bashkimit të teknologjisë, biologjisë dhe fizikës njerëzore, të përshkruar në *Ex Machine* (2015), që paralajmëron nxitjen e industrisë së modës për të zhvilluar një 'lëkurë digjitale': nano-teknologjia do t'i lejojë prodhuesit të nxisin ndërveprimin në artikujt më të thjeshtë të veshjeve, ndërsa një rrjet zbuluesish, brenda dhe në trup, përmes gjilpërës ose të veshur, do ta mbështjellin trupin me një lëkurë të dytë.<sup>44</sup> Mendoni se sa teknologji të pasqyruara në filma dhe shfaqje televizive të ndryshme, si *Star Trek*, janë tashmë në përdorim të përditshëm dhe sa të tjera mund të ndjekin shembullin e tyre. Në të vërtetë, ne po hyjmë në disa të ardhme që janë, njëherësh, shumë të njohura, megjithatë fshehin gjallëri shumë të çuditshme.

Pikëpamja e Inajatullah-ut për "të ardhmen e përdorur" është e njëjtë me qëllimin e synuar të së ardhmes së njohur, e cila ka për qëllim të hulumtojë dhe sfidojë përfytyrimet e së tashmes, rreth asaj se çfarë mund të gjendet përtej së tashmes së stërzgatur.<sup>45</sup> Duke e parë të ardhmen në thelb si të larmishme, përmes një leximi të dyfishtë, e ardhmja e njohur, njëkohësisht, nënkuptohet si diçka në njëjës dhe në shumës. Është në njëjës në kuptimin e ardhmja - që synon të gjejë atë që është e njohur midis një vargu mundësish të ndërlikuara, ndërsa në shumës të ardhmet - në kuptimin që angazhohet me përfytyrime të ndryshme dhe, nganjëherë, pa ndonjë pikë takimi.

Përtej të ardhmeve të njohura, qëndrojnë të ardhmet e jashtëzakonshme, një horizont i mundësisë së pastër, që shtrihet përtej 20 viteve të ardhshme. Të ardhmet e jashtëzakonshme nuk janë të pamendueshme, por një horizont ku diçka mbetet gjithmonë e pamenduar, që do të thotë se është e mbushur me të ardhme mundësish, në dukje të pafundme, ku

42 M. Peckham, 'Watch: Humanlike darpa Robot Climbs and Leaps from Obstacles with Mad Skills,' *Time*, 26 Tetor 2012.

43 T. Harnden, 'Mad Max-Style Takeover of Ramadi Leaves Obama and West Floundering' *Real Clear Politics, Chicago Sunday Times*, 30 May 2015.

44 K. Holmes, 'Is 'Digital Skin' The Future Of Fashion?,' *The Creators Project*, 15 Gusht 2011. E disponueshme: <http://thecreatorsproject.vice.com/blog/isdigital-skin-the-future-of-fashion> [Shikuar: 17 May 2015].

45 S. Inayatullah, 'Six pillars: futures thinking for transforming,' *Foresight*, vol. 10, nr. 1, Shkurt 2008.




secila kërkon ligjëruesit e vet të përbashkët, për të filluar hulumtimin e mundësive krejt të ndryshme që i rrethojnë. Megjithëse ka grupe të dhënash, në dukje të panumërta, për këto botë - sipas parashikimeve nga demografike, deri tek ato ekonomike - ka pak (nëse ka) modele që mund të ofrojnë një pasqyrë të saktë për atë që mund të ndodhë në këtë të nesërme. Pra, krijimtaria bashkëpunuese dhe 'përfytyrimet morale nuk janë thjesht mjetet më të mira për të ndërtuar planveprimin për këtë të nesërme, por 'ato janë mjetet e vetme'.<sup>46</sup> Për më tepër, e ardhmja(et) e pamenduara nuk është thjesht diçka që nuk pritet apo parashikohet. Përkundrazi, është diçka jashtë përcaktimeve të mendimit tradicional, diçka që nuk na lejon të përqendrohemi apo të mendojmë për 'të. Nga ana tjetër, e pamenduara mund të jetë, gjithashtu, një mundësi kaq e pazakontë, sa të duket krejtësisht e paarritshme. Si e tillë, e pamenduara nuk kufizohet vetëm në të *ardhmet* e *pamenduara*. Ajo mund dhe duhet të gjendet në të tashmen e stërzgatur dhe në të ardhmen e njohur. Por vetëm në të *ardhmet* e *pamenduara* nënkuptimet e plota na dalin përpara dhe ne jemi të detyruar t'i përballojmë ato ballë për ballë.


Për ta vendosur metodën tonë brenda një fushe më të gjerë studimesh, për të ardhmen dhe largpamësinë strategjike, kemi përshtatur, ose, më saktë, kemi përpunuar bohçen e mirënjohur të së ardhmes<sup>47</sup>, për të treguar gjallërinë e marrëdhënieve ndërmjet secilit horizont. Figura 3 sqaron marrëdhëniet e luhatura midis secilit prej tre horizonteve. Në këtë pamje trashësia dhe trajektorja e linjave brenda çdo horizonti përfaqëson mprehtësinë e nuhatjes; shkallën në të cilën dikush ka aftësinë për të kapur prirjet që na shfaqen, që këmbëngulin dhe/ose përçahen; si dhe, mundësisht, aftësinë e diçkaje për t'u zhvendosur nga mundësia e thjeshtë, drejt vërtetësisë.

46 Z. Sardar, 'Welcome to postnormal times,' *Futures*, vol. 42, no. 5, f. 444, Qershor 2010.

47 S. Candy, 'The Futures of Everyday Life: Politics and the Design of Experiential Scenarios,' University of Hawaii at Manoa, Gusht 2010.; T. Hancock dhe C. Bezold, 'Possible futures, preferable futures,' *Healthcare Forum Journal*, vol. 37, nr. 2, f. 23-29, 1994.; C.W. Taylor, *Alternative World Scenarios for A New Order of Nations*. Carlisle Barracks, PA: U.S. Army War College, Strategic Studies Institute, 1993.; U. von Reibnitz, *Scenario Techniques*. Hamburg: McGraw-Hill Book, 1988.; J. Voros, 'A generic foresight process framework,' *Foresight*, vol. 5, nr. 3, f. 10-21, Qershor 2003.



Megjithëse kjo pamje dypërmasore na lë të kuptojmë ndarje, tri shtyllat e lartpërmendura nuk janë qenie të veçuara, por përcaktime hapësinore dhe kohore thellësisht të ndërlidhura të dukurive të tashme dhe të nuhatshme, që kanë një ndikim të thellë këtu dhe tani. E ardhmja(et) e njohur është pjesë përbërëse e së tashmes së stërzgjatur dhe të dyja përmbajnë shumë të ardhme të pamenduara. Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se çdo ngjarje apo dukuri nga horizonti më i largët ka një mundësi të vërtetë për të pasur ndikim këtu dhe tani. Në kohët pasnormale, ajo që duket e pamenduar, bëhet pjesë përditshmërie e së nesërme. Si e tillë, hulumtimi i së ardhmës(eve) në këtë kuadër, duhet të përfshijë dhe angazhojë të tri shtyllat njëkohësisht. Për më tepër, ka sisteme dhe dukuri me mundësi brenda vetes, për të përfunduar në pasnormale në të tria këto shtylla, që do të thotë se ne duhet të jemi në gjendje të shqyrtojmë përbërësit rrethorë në çdo të nesërme që mund të shfaqë zvarritje pasnormale ose gjendje, në prag të vrullit pasnormal. Si rrjedhim, tri shtyllat, në të vërtetë, janë më të dobishme, ashtu siç paraqitet në Figurën 4.






## PADIJA, PASIGURIA DHE VARGANI I MUNDËSIVE PASNORMALE

Çdo e nesërme ka një lloj të veçantë pasigurie dhe padije të lidhur me të. Kur bashkohen ndërlikimi, çoroditja dhe mosmarrëveshjet, nuk duhet të habitemi, nëse përfundimi është pasiguria. Shumëllojshmëria më themlore e pasigurisë shfaqet kur dihet drejtimi i ndryshimit, por madhësia dhe gjasa e ngjarjeve dhe pasojave nuk mund të vlerësohet. Kjo është rrethana që gjejmë brenda së *tashmes së tejzgjatur*, ku e ardhmja është kryesisht e pushtuar dhe prirje të caktuara janë të rrënjosura thellë. Kemi një grup të kufizuar të ardhmesh me mundësi të mundshme, të paktën njëra prej të cilave mund të përmbushet. Ne e quajmë këtë pasiguri sipërfaqësore, e cila mund të zotërohet në një farë mase me njohuri të mjaftueshme dhe mjete parashikuese. Në të *ardhmet e njohura*, kemi një varg mundësish dhe një bollëk të ardhmesh të mundshme. Kështu, mund të flasim fare pak rreth drejtimit të përgjithshëm të ndryshimit dhe aq më pak për shfaqjen e dukurisë pasnormale, kur bashkohen ndërlikimi, çoroditja dhe mosmarrëveshjet. Por e dimë se shumë nga këto të ardhme janë thjesht një parashikim i vegimeve dhe përfytyrimeve të zakonshme të së ardhmes. Zotërimi i pasigurisë përfundimtare përbën një çështje të ndërlikuar, për të mos thënë të mbrapshtë, por ne ende mund ta kuptojmë atë deri në një farë mase. Ne e quajmë këtë *Pasiguri të Cekët*. Së fundi, e ardhmja e pamenduar, ku çdo gjë mund të ndodhë dhe asgjë nuk dihet, përbën pasiguri të thellë. Këtu, jo vetëm që nuk jemi të vetëdijshëm për drejtimin, shkallën dhe ndikimin e ndryshimit, por jemi gjithashtu të paaftë të dimë se çfarë po ndodh me sistemin, sepse botëkuptimi ose teoria jonë e dijes është krejtësisht e papërshtatshme. Të tre llojet e pasigurive janë rrënjosur në një mjedis ku ndryshimi po përshpejtohet dhe risitë, ecuritë, marrëdhëniet shoqërore dhe politike të reja po tjetërsojnë vazhdimisht pamjen që po shfaqet para syve tanë. Figura 5 tregon se si ne i ravijëzojmë tri pasiguritë.



Figura 5.



Çdo lloj pasigurie shoqërohet me një lloj të veçantë padije. Padija e thjeshtë ose e dukshme (e nënkuptuar si <sup>1</sup>) mund të përkufizohet si mungesë e njohurive dhe ka të bëjë me ato sende ose dukuri që ne nuk i kuptojmë. Kjo është padija që mund të hasim në një rrethanë të ndërlikuara ose kundërshtuese, e cila mund të kapërcehet duke kuptuar rrjetet e ndërlikuara që përfshihen, ose duke vlerësuar 'të vërtetat' e njëkohshme të pjesëmarrësve me kërkesa të papajtueshme (për shembull, një qeveri që ka nevojë për zhvillim dhe një bashkësi njerëzish që dëshiron të ruajë mjedisin, tokën dhe trashëgiminë e vet). Kjo është shumëllojshmëria mbizotëruese e padijes në të *tashmen e stërzgjatur*. Ajo mund të kapërcehet, dhe *pasiguria sipërfaqësore* mund të zvogëlohet, nëpërmjet të mësuarit, kërkimit, vlerësimit të pikëpamjeve të tjerëve dhe shtrimit të pyetjeve të duhura. *E ardhmja e njohur* na paraqet një nivel më të thellë padije, të lidhur me pasigurinë e cekët, kur as nuk e dimë se çfarë pyetjesh të bëjmë. Por ka edhe një përmasë tjetër: përgjigjet për çdo pyetje përkatëse, nëse mund t'i bënim ato, mund të gjenden vetëm në horizont. Për shembull, ne nuk e dimë me siguri, se si ushqimi i përpunuar gjenetiksht do të ndikojë në zinxhirin ushqimor; ose si do të ndikojë inxhinieria gjenetike në trupin e njeriut, ose çfarë ndikimi do të ketë 'lidhja ngjitëse'<sup>48</sup> në mendjen e njeriut. Përgjigjet mund të gjenden vetëm diku në të ardhmen, pasi të paktën një brez të ketë përjetuar ndikimet dhe pasojat e këtyre zhvillimeve. Ne e quajmë atë *Padije të kapërcyeshme*: nuk mund të kapërcehet në të tashmen duke mësuar, pasi nuk ka asgjë për të mësuar, por krijon një ndërjegjësim për atë që nuk e dimë dhe duhet të kërkojmë të dimë në të ardhmen. Kur lidhet me të *ardhmen e njohur*, ajo gjallëron *pasiguri të cekët*, e cila mund të shndërrohet në *pasiguri sipërfaqësore* në të ardhmen. Pastaj, sigurisht që është edhe 'e panjohura e të panjohurave', e Rumsfeld-it. Pra, 'ajo që nuk e


48 J.A. Sweeney, 'Infectious Connectivity: Affect and the Internet in Postnormal Times,' in *Futures of the Internet*, J. Winter dhe R. Ono, Eds. Switzerland: Springer International Publishing, 2015.



dimë dhe nuk e dimë<sup>49</sup>, lidhet me Pasigurinë e Thellë të së Ardhmeve të Pamenduara dhe renditet si Padija e Pamposhtur (e nënkuptuar si i<sup>3</sup>).

Të pamenduarit qëndron përtej përfytyrimit tonë. Ne nuk jemi në gjendje të mendojmë për gjëra që qëndrojnë jashtë përfytyrimit, i cili përcaktohet dhe kufizohet në botëkuptimin tonë, brenda kufijve të hamendësimit dhe të vërtetësive të pranuar nga ne, shpeshherë, për shkak të mungesës së një gjuhe për t'u marrë me një mendim të tillë. Pra, *padija e pamposhtur* është “padija e padijes sonë, padija e pleksur e rreziqeve të mundshme të zhvillimeve të fundit”, që “kërkon mënyra rrënjësisht të reja të të menduarit”.<sup>50</sup> Me fjalë të tjera, *padija e pamposhtur* nuk mund të kapërcehet nga mënyrat tona tradicionale, pasi është e lidhur me pjesët e pamenduara të botëkuptimit tonë. Të mos diturit (padija) na detyron të veprojmë me një ndjenjë të rreme besimi në shembujt dhe mënyrat e pranishme të të diturit, të qenit dhe të bërit. Mund të përballemi me *padijen e pamposhtur* vetëm duke vënë në pikëpyetje të vërtetat tona të pranuar, duke vërejtur hamendësimet tona themelore dhe të çmuara për një kohë të gjatë, si dhe duke rimenduar plotësisht botëkuptimin tonë. Figura 6 tregon se si ne e vendosim një pasiguri dhe padije të vetme brenda çdo horizonti.

Figura 6



49 E. Morris, *The Unknown Known*. Participant Media, 2014.

50 Z. Sardar, 'Welcome to postnormal times,' *Futures*, vol. 42, nr. 5, f. 440, Qershor 2010.



Tre nivelet e padijes dhe pasigurisë na mundësojnë të fillojmë të kuptojmë dhe të përshkruajmë shkallën e pasnormalitetit të tanishëm dhe të kuptueshëm që rrethon një çështje, metodë ose horizont të caktuar. Në të *tashmen e stërzgatur*, ne përpiqemi ta zvogëlojmë *pasigurinë sipërfaqësore*, duke përpunuar të dhënat e disponueshme për të prodhuar hamendësime që mund të hedhin dritë mbi atë që po shohim. Nëse të dhënat e disponueshme nuk janë të mjaftueshme, do të na duhet të përcaktojmë nëse mbledhja e më shumë të dhënave do të ndihmojë apo jo. Nëse pasiguria vazhdon të rritet, ky do të ishte një tregues, se po shkojmë drejt *padijes së kapërcyeshme* të së *ardhmes së njohur*. Tani do të na duhet të përcaktojmë se cilat linja hetimi mund të prodhojnë njohuri të përshtatshme dhe horizontet kohore që përfshijnë marrjen e asaj njohurie. Së fundi, nëse gjendja e rrethanave është çoroditur tërësisht, dimë se kemi të bëjmë me pasiguri të thellë të së *ardhmes së pamenduar*. Tani duhet të shqyrtojmë nëse vetë shembulli ynë është ai që po na dështon, gjë që do të tregonte praninë e *padijes së pamposhtur*. Veprimi më i përshtatshëm tani, është të punohet drejt një shembulli ndryshe, më të mirë.

Megjithatë, të tre horizontet - e tashmja e stërzgatur, e ardhmja e njohur dhe e ardhmja e pamenduar - përfshijnë sisteme dhe nënsisteme që janë ose në prag të vullit pasnormal, ose, të paktën, tregojnë shenja të zvarritjes pasnormale. Pjesa më e madhe e pasigurisë sonë, rrjedhimisht edhe padija, është e lidhur me shfaqjen e pasnormalitetit. Pra, përveç kapjes së pasigurisë dhe padijes që lidhet me çdo horizont, hulumtimi ynë drejt të ardhmes dhe çdo parashikim, qasje dhe largpamësi e mbështetur në 'të, duhet të përballet edhe me aftësitë e zhvillimit pasnormal të natyrshëm për të tre horizontet.

**DUKURIA PASNORMALE ËSHTË MË E QARTË DHE MË E LEHTË PËR T'U PARË NË TË TASHMEN E STËRZGATUR. ËSHTË SI NJË ELEFANT I ZI NË DHOMË, TË CILIN ASKUSH NUK MUND TA SHIKOJË DHE AS NUK MERR MUNDIMIN TË MOS E VËREJË. OSE, NËSE PRANOHET PRANIA E TIJ, VËRTET ASKUSH NUK MUND TË BËJË DIÇKA.**

Një elefant i zi, vëren Vinay Gupta,

është një ngjarje jashtëzakonisht e mundshme dhe e parashikuar gjerësisht nga njohësit e fushës, por që njerëzit përpiqen t'i shmangen si mjellmës së zezë, kur, më në fund, ndodh. Zakonisht, njohësit që e kishin parashikuar ngjarjen – që nga kriza ekonomike e deri te gripi mbarëbotëror – kalojnë nga të qenit të parëndësishëm, në të qenit qendra e vëmendjes, kur problemi, më në fund, ngre krye.<sup>51</sup>

51 V. Gupta, 'On Black Elephants,' E disponueshme: <http://vinay.howtolivewiki.com/blog/flu/on-black-elephants-1450> [Shikuar: 27 Prill 2009].



Në përputhje me pikëpamjen e Guptas, Markli pohon përdorimin e *kartës së mençurisë*, të tipit II, që është “gjasë e madhe dhe ndikim i lartë, siç shihet nga njohësit e fushës, nëse prirjet e tanishme vazhdojnë, por që besueshmëria është e ulët për palët e përfshira që nuk janë të asaj fushe...”<sup>52</sup>

Një shembull i qartë janë përqendrimet e karbonit në atmosferë, të cilat u regjistruan kohët e fundit në 400 pjesë-për-milion, një nivel që i paraprin njerëzimit me njëmijë vjet dhe paralajmëron ndryshime të mëdha klimatike.<sup>53</sup> Megjithëse ka shumë, duke përfshirë një shumicë të madhe amerikanësh, që mohojnë ndryshimet klimatike të shkaktuara nga dora e njeriut, mirëkuptimi i përgjithshëm shkencor është pikërisht ai: një nga pohimet më të hershme të problemit klimatik të CO2 vjen nga një punim shkencor që iu dha Presidentit Johnson, në vitin 1965.<sup>54</sup> Si të tillë, elefantët e zinj janë lloji i njohur i së panjohurës, siç thotë Rumsfeld, veçanërisht pasi hendeku midis njohësve të fushës dhe mendimit të qytetarëve ia shton ndërlikimin dhe pasigurinë çështjes.<sup>55</sup> Normalisht, ngjarjet me gjasa të mëdha pasnormale kërkojnë veprim të përbashkët dhe mbarëbotëror, siç ishte rasti në gjetjen e ilaçit të Ebolës, në vitin 2014. Elefantët e zinj shpërfaqin gjallërinë pasnormale të së *tashmes së stërzgjatur*. Ata janë qartësisht në varësi të rrethanave dhe duhet të vendosen dhe/ose sqarohen nga më shumë se një këndvështrim, qoftë edhe vetëm për të kapur kundërshtinë e qenësishme të shfaqjes së tyre. Së fundi, elefantët e zinj tregojnë se kohët pasnormale janë të pranishme dhe ndoshta mbizotërojnë brenda një sistemi të caktuar.

Përfytyrimi mjaft i njohur i Nasim Nikolas Taleb për ‘Mjellmën e Zezë’, kap thelbin e së ardhmes së njohur. Ndryshe nga elefantët e zinj të së *tashmes së stërzgjatur*, mjellmat e zeza në të *ardhmen e njohur* nuk vihen re ose nuk bëhen të qarta, as nga njohësit e fushës. Ato shfaqen si “të veçuarra” dhe dalin nga “askundi”. Siç vëren Taleb, ato janë “shumë të brishta ndaj llogaritjeve të gabuara, përgjithësisht me një nënvlerësim të vrazhdë, të përzier me një mbivlerësim të vrazhdë të rastit”.<sup>56</sup> Mjellmat e zeza janë

52 O. Markley, ‘A new methodology for anticipating steep surprises,’ *Technological Forecasting and Social Change*, vol. 78, nr. 6, f. 1079, Korrik 2011.

53 D. Biello, ‘400 ppm: Carbon Dioxide in the Atmosphere Reaches Prehistoric Levels,’ 9 May 2013. E disponueshme: <http://blogs.scientificamerican.com/observations/2013/05/09/400-ppm-carbon-dioxide-in-the-atmospherereaches-prehistoric-levels/> [Shikuar: 10 Mars 2015].

54 D.W. Keith, ‘Geoengineering the Climate: History and Prospect,’ *Annual Review of Energy and the Environment*, vol. 25, f. 245–284, 2000.; Royal Society, *Geoengineering the climate science, governance and uncertainty*. Londër: Royal Society, 2009.

55 E. Morris, *The Unknown Known*. Participant Media, 2014.

56 N.N. Taleb, *The black swan: the impact of the highly improbable*. New York: Random House, f. 420, 2007.





thelbësisht e *panjohura e të panjohurave* dhe, ndryshe nga elefantët e zinj, pa dyshim, ato mund dhe duhet të jenë të vërteta, që do të thotë se ndikimi i tyre mund të ndriçojë mundësitë e papërfytyruara më parë, gjë që u përshatet atyre për gjallërinë e ndërlikuar të së ardhmes(eve) të njohura. Në të vërtetë, është menduar se mjellmat e zeza janë përgjegjëse për disa nga ndryshimet më të mëdha shoqërore të historisë. Megjithatë, ato mund të jenë po aq të këqija dhe të shërbejnë si shenjë për shfaqjen e zvarritjes pasnormale, ose vrullit pasnormal. Si e tillë, marrja me mjellmat e zeza kërkon një nivel më të lartë zbërthimi.

Dukuritë pasnormale nuk janë të lehta për t'u parashikuar në të *ardhmen e pamenduar*, ndonëse ato janë aty. Mundësitë pasnormale të së *ardhmes së pamenduar* do t'i përfaqësojmë me kandil të zi deti. Ashtu si elefantët e zinj dhe mjellmat e zeza, kandilat e zinj janë "me ndikim të lartë", por janë dukuri "normale", të shtyra drejt pasnormalitetit nga kundërveprime të qenësishme, ose nga shtimi i rritjes ekonomike që çon drejt paqëndrueshmërisë së vazhdueshme. Pse kandili i detit? Ndryshimet klimatike kanë një ndikim të thellë në rrjetin ujqor mbarëbotëror. Rritja e temperaturave të oqeanit dhe niveleve të aciditetit po krijojnë kushte të përsosura për lulëzimin e kandilit të detit, të cilat kanë detyruar mbylljen e centraleve elektrike bregdetare në mbarë botën, duke përfshirë edhe reaktorët bërthamorë.<sup>57</sup> Duke mishëruar çudinë e natyrshme për të ardhmen e pamenduar, kandili i deti njihet, gjithashtu, për 'hedhjen në erë të ushtrisë më të madhe në botë dhe nxitjen e trazirave politike'.<sup>58</sup> Duke vërtetuar se si gjërat e vogla mund të kenë një ndikim të madh, të nxitur nga kundërveprime të qenësishme, lulëzimi i kandilit të detit na ofron përfaqësimin e përsosur të pasnormalitetit në të *ardhmen(et) e pamenduara*.

Në përlllogaritjet e Rumsfeld-it, *kandilat e zinj të detit janë të panjohurat e njohura* - gjëra që ne mendojmë se i dimë dhe i kuptojmë, por që ndodh të jenë më të ndërlikuara dhe të pasigurta sesa ç'presim. Duke e përqendruar pikëpamjen tonë te përshkallëzimi i lulëzimit të kandilit të detit, synojmë të tërheqim vëmendjen duke e peshuar se në të ardhmen e pamenduar duhet të shqyrtojmë gjërat e vogla dhe të marrim me mend ndikimin e tyre në shkallë më të mëdha dhe në sisteme të shumta të mbi-vendosura me kalimin e kohës. Kandili i zi i detit ka të bëjë me faktin se si rrethanat dhe ngjarjet normale bëhen pasnormale; se si ato ndryshojnë

57 L.A. Gershwin, *Stung!: on jellyfish blooms and the future of the ocean*. Chicago: The University of Chicago Press, 2013

58 J.A. Sweeney, 'Signs of Postnormal Times,' *East-West Affairs: A Quarterly Journal of North-South Relations in Postnormal Times*, vol. 1, nr. 3/4, f. 6, Dhjetor 2013



përmes zvarritjes pasnormale, duke u bërë të ndërlidhura, të lidhura në rrjet, të ndërlikuara dhe mospërputhëse. Në këtë kuptim, kandili i zi i detit riprodhon thellësisht punën thelbësore të Molitorit, lidhur me zbërthimin e çështjeve në zhvillim. Ne e përfytyrojmë kandilin e zi si 'ngjarje përshejtuese', që paralajmëron me vendosmëri mundësi të pamenduara, megjithëse nuk besojmë se të gjitha ato duhet të ndjekin modelin e njohur të ndryshimit, sipas lakores  $S^{59}$ , e cila është e dobishme për ravijëzimin e ndikimeve të një ngjarjeje ose një ndikimi të vetëm. Por kjo lakore nuk përmirëson aftësinë tonë të nuhatjes [...] për veçimin e përbërësve të rinj në hapësira që, ose kanë lindur që nga hartimi i hartës, ose janë në lëvizje'.<sup>60</sup> Ashtu si me pikëpamjen e de Jouvenel për gjërat e ardhshme, 'nuk ka kohë gjatë së cilës mund ta numërojmë në mënyrë shteruese' kandilin e zi.<sup>61</sup>

Së bashku, ne i quajmë elefantët e zinj, mjellmat e zeza dhe kandilin e zi si *Varganin e Mundësive Pasnormale* (në faqet e mëposhtme - Vargani), i cili synon të përqendrojë vëmendjen tonë tek ecuria e zhvillimit pasnormal të tre të nesërmeve njëkohësisht. Vargani, megjithatë, nuk duhet parë si një shumëllojshmëri ose varg mundësish. Duke shkruar mbi rëndësinë e madhe të parashtrimit të shembujve përçarës brenda këshillave rreth parashikimit, Barber pohon se 'ravijëzimi i një mundësie çasti që zgjeron pikëpamjen e blerësit, do të siguronte një themel të qëndrueshëm që mundëson përdorimin në mënyrë të dobishme të shumë prej metodave dhe mjeteve të tjera të parashikimit'.<sup>62</sup> Ndërkohë që besojmë se modeli i ecurive pasnormale është thelbësor për largpamësinë e fuqishme dhe përfundimisht të dobishme, ne i shmangemi përdorimit të "mundësisë së çastit", pasi ky përcaktim e vendos dikë plotësisht brenda kufijve të zotërimin të rrezikut. Nëse ka diçka të vërtetë në kohët pasnormale, është se impulset tona urdhëruese dhe zotëruese do të shërbejnë vetëm për të rritur padijen tonë dhe për të rrënjosur pasigurinë. Ne nuk mund ta zotërojmë rrezikun ose përshtypjet tona për rreziqet, që nga 'befasitë e pashmangshme'<sup>63</sup> e deri te gjërat që mbeten të pamenduara. Në kohët pasnormale rregullat e lojës kanë ndryshuar në mënyrë që të gjitha mundësitë të jenë të çastit. Si të tilla, siç synon Miller, duhet të bëhemi të aftë për të

59 G.T.T. Molitor, 'How to Anticipate Public-Policy Changes,' *S.A.M. Advanced Management Journal*, Summer 1977.

60 W.L. Schultz, 'The cultural contradictions of managing change: using horizon scanning in an evidence-based policy context,' *Foresight*, vol. 8, nr. 4, f. 7, Korrik 2006.

61 B. de Jouvenel, *The Art of Conjecture*. Londër: Weidenfeld and Nicolson, f. 19, 1967.

62 M. Barber, 'Wildcards - Signals from a Future Near You,' *Journal of Futures Studies*, 11 (1), f. 79, Gusht 2006.

63 F. Schwartz, *Inevitable surprises: thinking ahead in a time of turbulence*. New York: Gotham Books, 2001.



ardhmen dhe të përmirësojmë 'stërhollimin e sistemeve tona parashikuese', duke përdorur 'të ardhmen për të vënë në dyshim, shpalosur e shpikur atë që po ndodh dhe çfarë është e mundur në të tashmen'.<sup>64</sup> Si një tërësi që synon të sfidojë bindjet e ngulitura thellë, të hedhë dritë mbi mosmarrëveshjet e rrënjosura dhe të gjallërojë vlerësimet e një lloji të ri, ne besojmë se Vargani ynë bën pikërisht këtë gjë.

## PUNA ME TRI TË NESËRMET

Themeli i tri të nesërmeve ka tri detyra të përcaktuara: të ndihmojë hulumtimet tona për mundësitë e të ardhmes, duke theksuar shumësinë e mundësive pasnormale; të tërheqë vërejtjen rreth parashikimeve dhe nuhatjen e prirjeve të tashme; të ndërtojë e formojë mënyra veprimi, me qëllim të posaçëm lundrimin në kohët pasnormale. Për këtë, na ndihmon hartimi i një grupi pyetjesh të përcaktuara për çdo horizont:

### *E tashme e stërzgjatur*

- Çfarë prirjesh janë rrënjosur në të tashmen e stërzgjatur?
- Çfarë nuk dimë? (padija e thjeshtë)
- Cilat janë pasiguritë sipërfaqësore të së tashmes së stërzgjatur?
- Cilat janë rreziqet e dukshme që nuk po i marrim parasysh?
- A ka elemente të së tashmes së tejzgjatur që shpërfaqin *vonesën pasnormale*?
- Çfarë çështjesh/gjërash të pakëndshme i frikësojnë ose turpërojnë njerëzit, për të cilat ata nuk duan të flasin? Me fjalë të tjera, çfarë lloj elefantësh të zinj po na shikojnë në sy?
- Çfarë bashkësie dijetarësh na duhen për të hulumtuar ndikimet e fuqizimit të mundshëm të elefantëve të zinj?

### *Të ardhme të njohura*

- Çfarë lloj prirjesh dhe përfytyrimesh të së ardhmes po na 'shtyjnë' drejt këtij horizonti?

64 R. Miller, 'Futures literacy: A hybrid strategic scenario method,' *Futures*, vol. 39, nr. 4, f. 27-28, Maj 2007.



- Çfarë na tregojnë këto të ardhme të njohura, rreth asaj që mund të kemi nevojë të dimë – *padija e mposhtur*?
- Çfarë kuptojmë rreth pasigurive të cekëta të këtyre të ardhmeve të njohura?
- A ka përbërës të këtyre të ardhmeve me mundësi fuqizimi të pasnormales?
- Çfarë mendojnë njerëzit, që nuk do të ndodhte kurrë? Me fjalë të tjera, çfarë janë mjellmat e zeza?
- Çfarë bashkësie dijetarësh na duhen për të hulumtuar ndikimet e mundësisë së fuqizimit të mjellmave të zeza?

### *Të ardhme të pamenduara*

- Cilat të vërteta dhe hamendësime janë kthyer në përlogaritje dhe parashikime të këtij horizonti?
- A mund t'i marrim këto të vërteta dhe hamendësime si të vlefshme, përballë pasigurisë së thellë dhe *padijes së pamposhtur*?
- Cilët përbërës të së *ardhmes së pamenduar* përmbajnë mundësi fuqizimi të pasnormales?
- Çfarë gjëje mund të përshkallëzohet shpejt drejt diçkaje, me një ndikim të tejskajshëm? Me fjalë të tjera, a ka ndonjë kandil të zi deti, që na tregon shenja të zvarritjes pasnormale?
- A janë pjekur kushtet për një vrull pasnormal? Çfarë duhet të ndodhë për të nxitur vrullin pasnormal?
- Çfarë bashkësie dijetarësh na duhen për hulumtimin e ndikimeve të mundësisë së fuqizimit të kandilit të zi të detit?

Përpunimi i mënyrës së veprimit për të përballuar kohët pasnormale, kërkon një vlerësim të njëkohshmerisë hapësirë-kohë të tre të nesërmeve. Gjithashtu, nevojitet kuptimi i padijes dhe pasigurisë që lidhet me çdo horizont, si dhe vlerësimi i përbërësve rrethanorë që mund të jenë sisteme ose nënsisteme të tëra, me mundësinë e rrëshqitjes drejt pasnormales - ato që ne i njohëm si elefantët e zinj, mjellmat e zeza dhe kandilat e zinj. Çdo përjasje që synon shtjellimin e mundësive të së ardhmes, duhet t'i marrë parasysh të gjitha këto. Bashkërisht, tre llojet e padijes dhe pasigurive, si dhe vargani, të çojnë drejt zvarritjes pasnormale - ecuria përmes së cilës gjërat dhe ngjarjet normale çoroditen dhe kthehen në pasnormale.



Për të shqyrtuar *zvarritjen pasnormale*, vendimmarrësit dhe politikëbërësit duhet të studiojnë ndërlikimin e një sistemi, të shqyrtojnë nëse sistemi është i ndërlidhur, nëse shfaq mospërputhje të dukshme dhe të nxjerrin në pah rrugët e mundshme të vlerësimeve të qenësishme. Nëse janë të pranishëm këta katër faktorë, ka të ngjarë që sistemi të shndërrohet në pasnormal. Brenda shumë sistemeve, ka institucione dhe përbërës që janë tashmë aq të ndërlikuar dhe të lidhur në rrjet, sa që mund të shndërrohen në pasnormalitet në çdo kohë, siç janë tregjet financiare dhe sëmundjet ngjitëse. Në përgjithësi, zvarritja pasnormale kalon nëpër tri periudha. Në të parën, sistemi është i ndërlikuar dhe i ndërlidhur, por punon rregullisht. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se do të vazhdojë të punojë siç duhet. Çdo ndryshim ose shqetësim i vogël në sistem, që mund të shfaqet pa ia vënë veshin një niveli të caktuar të padijes, apo duke anashkuar pasigurinë, mund të prodhojë me shpejtësi pasoja që nuk mund të zotërohen dhe të sjellë gjendjen pasnormale. Një elefant i zi ose një mjellmë e zezë mund të jenë gjithashtu të pranishëm në sistem. Në periudhën e dytë shfaqen vlerësimet e qenësishme, ndoshta një mundësi fuqizimi pasnormale është vënë në lëvizje dhe sistemi fillon të tregojë shenja çoroditjeje. Periudha e tretë fillon kur mbizotëron çoroditja dhe sistemi shndërrohet në pasnormal. Ne kemi nevojë për mënyra të ndryshme vepërimit, për t'u marrë me secilën periudhë.

Çfarë mund të bëjmë kur një sistem shfaq shenja të zvarritjes pasnormale? Gjatë periudhës së parë, mundësia më e mirë është thjeshtimi i sistemit, sepse ndërlikimi na dënon me njohuri të kufizuara dhe të pasigurta dhe nevojën për thjeshtim. Në botën tonë të globalizuar, nuk ka sisteme të mbyllura, të gjitha sistemet janë të hapura për ndërlidhje. Por edhe sistemet e hapura kanë ndërlidhje (të panevojshme) që mund të thjeshtohen, gjë që do të çonte në uljen e ndërlikimit të tyre. Këtu duhet të jemi të vetëdijshëm për varësinë e ndjeshme. Çdo ndërhyrje, si një përjasje e keqmenduar: tubimet, mosmarrëveshjet, veprime të padrejtësisë së rëndë, ndikimi shkatërrues në mjedis, mund ta përshpejtojnë ecurinë e sistemit drejt pasnormales. Për më tepër, ne duhet të vëmë në dukje edhe përbërës të përcaktuar të sistemit që kanë mundësi fuqizimi pasnormale. Cilët janë elefantët e zinj në dhomë, me të cilët duhet të merremi menjëherë? Në botën tonë të globalizuar, të gjitha qeveritë kombëtare janë sisteme të ndërlikuara, të ndërlidhura, me elefantët e zinj të ulur në pikën e kthesës drejt pasnormalitetit. Vëmendja e fundit ndaj krizave të mërgimtarëve në Europë dhe Azi flet drejtpërdrejt për këtë pikë. Në periudhën e dytë, kur



vlerësimet e qenësishme kanë filluar, duhet t'i kushtojmë vëmendje tërheqësve që rrisin vlerësimet e qenësishme. Në çdo sistem gjallërues do të ketë një sërë faktorësh – përqsasje, mospërputhje, fushata, tubime, mosmarrëveshje, media digjitale, teknologji të reja, ndryshime shoqërore, ndërrime të pushtetit – të cilat krijojnë dhe përmirësojnë vlerësimet e qenësishme, drejt të cilave sistemi tenton të përparojë, pavarësisht kushteve fillestare, ose të drejtave dhe gabimeve të një çështjeje të caktuar.

Për të parandaluar shndërrimin e një sistemi në pasnormal, duhet të vëmë në dukje – dhe, nëse është e mundur, të pengojmë - rrugët e prapaveprimimit të prerë, të zhveshim ndërlidhjet e sistemit dhe të vëmë në dukje mospërputhjet. Ndjesia për të vepruar menjëherë mund të jetë e arsyeshme, por kjo nuk duhet të nënkuptojë një veprim të pamenduar. Theksi duhet vënë te një zberthim më i thellë, një ndërthurje të shumësisë dhe larmisë, si dhe te cilësia. Kjo kërkon thjeshtësi dhe tërësi në të njëjtën kohë. Ne duhet të 'tërësohemi', sepse sistemet e ndërlikuara mund të tjetërsohen vetëm nga sisteme të tjera të ndërlikuara.<sup>65</sup> Për më tepër, e gjithë kjo duhet të ndërmerret në rrethanat e të pranuarit të padijes së mposhtur dhe pasigurisë së cekët. Kjo kërkon, siç vëren Sterling, 'një përqsasje më të rreptë për vlerësimin e njohurive të mangëta, duke shmanhur tundimin për ta parë çdo problem si një gozhdë rreziku, që zvogëlohet me një çekiç gjasash të ndryshme. Në vend të kësaj, njohësit e fushës duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje hapësirave të pasigurisë që janë lënë pas dore, si dhe sfidave më të thella të paqartësisë dhe padijes'.<sup>66</sup> Vërtet, nuk mund të bëjmë asgjë, kur sistemi hyn në periudhën e tretë, përveçse ndoshta të vazhdojmë të zgjidhim mosmarrëveshjet në sistem dhe të përpiqemi të zvogëlojmë prapaveprimin sa më shumë që të jetë e mundur.

Përpunimi i Përqsajes Pasnormale, domethënë, i mënyrës së të vepruarit që rrit aftësinë tonë për të lundruar në kohët pasnormale, nuk ka të bëjë me drejtimin dhe zotërimin. Këto pikëpamje janë të tepërta, madje të rrezikshme në kohët pasnormale. Përkundrazi, qëllimi i përqsajes pasnormale është vetëdijesimi rreth padijes sonë në tre llojet e veta: të kuptojë ndërlikimet dhe pasiguritë e përfshira; të parashikojë mundësinë e fuqizimit pasnormal; dhe kështu, të përshkruajë një rrugë të qëndrueshme, edhe pse të papëlqyeshme, që shtrihet përpara nesh. Detyra e një qasjeje tradicionale është të udhëzojë vendimet për të dalë në përfundime

65 H. Keune, 'Critical complexity in environmental health practice: simplify and complexify,' *Environmental Health*, vol. 11, nr. 1, f. S19, 2012.

66 A. Stirling, 'Keep it complex,' *Nature*, vol. 468, no. 7327, f. 1029–1031, Dhjetor 2010.



të arsyeshme, të paracaktuara. E gjithë ecuria nënkupton një lidhje drejtvizore shkak-pasojë midis përqasjes dhe përfundimit. Përqasja pasnormale, nga ana tjetër, nuk na e jep mundësinë e një hamendësimi të tillë dhe detyra e saj kryesore është të merret – dhe, nëse është e mundur, ta parandalojë - me zvarritjen pasnormale, të tërheqë vëmendjen kundrejt ndërlikimeve të përdorshme që na përballin jo vetëm me pyetje thelbësore, por edhe me sfida themelore, duke na ndihmuar kështu, në hartimin dhe lundrimin e të ardhmes pasnormale. Ndërsa ne besojmë se ka disa shembuj të nismave të reja në përqasje të tilla, si: zgjerimi i të drejtave ligjore në lumin Whangan<sup>67</sup>, ose përhapja e Rojtarëve të Brezave të Ardhshëm, ne ende nuk e kemi parë të shfaqet përqasja pasnormale.

### VENDI I TRE TË NESËRMEVE NË HAPËSIRËN E SË ARDHMES

Ndërsa studimet e së ardhmes vënë theksin te mundësitë, shumica e metodave të parashikimit të së ardhmes rrallëherë përfshijnë shumësinë dhe larminë, si thelbin e kuadrit të tyre. Pak ose aspak theksojnë natyrën gjallëruese dhe përbashkuese të mundësive të së ardhmes, apo të nxjerrin në pah padijen dhe pasiguritë me të cilat përballemi vazhdimisht. Në përgjigje të kësaj nevojë, shumë veprimtarë dhe studiues kanë sajuar termin “përzjerje”, duke “ndërthurur dhe shtresuar teknika të ndryshme për të pasuruar rendimentin”.<sup>68</sup> Themeli i tre të nesërmeve ofron pikërisht një përqasje të tillë me shumë shtresa, që mund të shërbejë si një mjet i dobishëm për të tërhequr vërejtje dhe për të hulumtuar të ardhmet vendimtare, ose për “tërësoren vendimtare” të mundësive të së ardhmes.<sup>69</sup> Tre të nesërmet mund të shërbejnë, gjithashtu, si një mjet shqyrtues për të vendosur brenda rrethanave të caktuara prirjet, çështjet në zhvillim dhe përfytyrimet drejt së ardhmes(eve), duke përfshirë parashikime të ndërlikuara dhe të përcaktuara për horizontin. Ne besojmë se metodat e tjera të hulumtimit të së ardhmes mund të jenë plotësuese për disa, nëse jo shumicën, duke përfshirë edhe përqasjen *Tre Horizontet*.

67 D. Isaksson, ‘Global Disorders – A New Global Order?’, *Development Dialogue*, nr. 62, f. 52, 2014.

68 A. Curry dhe W. Schultz, ‘Roads Less Travelled: Different Methods, Different Futures’, *Journal of Intercultural Studies*, vol. 13, no. 4, f. 58, May 2009.

69 H. Keune, ‘Critical complexity in environmental health practice: simplify and complexify’, *Environmental Health*, vol. 11, no. 1, f. 4, 2012.



Nga përpilimi i planit të veprimit, te përfytyrimi dhe përkufizimi i së ardhmes së dëshiruar e deri te zbërthimi i të gjitha mënyrave, tre të nesërmet mund ta përforcojnë idenë se si shqyrtohen padija dhe pasiguria, apo si themelohen dhe/ose hartohen ato. Ne e kemi parë tashmë Varganin tonë të përshtatur nga një njësi parashikimi e qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, e cila e përfshin atë në ecurinë e vet të angazhimit të palëve të përfshira. Ne kemi paraparë themelet e tre të nesërmeve, që të jenë të kuptueshme dhe përfshirëse. Si të tilla, ato e vendosin të ardhmen brenda rrethanave të mundësive të njëkohshme që janë të largëta dhe njëkohësisht të pranishme. Kjo thekson ndërlikimin dhe na tërheq vëmendjen drejt padijes dhe pasigurisë në çdo hap. *Tre të nesërmet* synojnë të përqendrohen vazhdimisht në të pamenduarit, duke na detyruar të bëjmë pyetje shoqëruese dhe të sfidojmë hamendësimet, vlerat dhe të vërtetat tona themelore. Së fundi, ato përpriqen të na ofrojnë një hapësirë për të qartësuar fuqitë e zhvillimit të pasnormales - elefantët e zinj, mjellmat e zeza dhe kandilat e zinj - për t'u përqendruar te qëndresa, si në kuptimin e qëndrësës kundërshtuese të një rrethane të caktuar, për të mos parë sfidat përpara, ashtu edhe në pikëpamjen e ndërtimit të një qëndrueshmërie ndaj një verbërie të tillë. Megjithëse përshtatja dhe përfitimi nga ndryshimet e ardhshme është në qendër të largpamësisë, gjithashtu ne besojmë se një anë e rëndësishme e tre të nesërmeve luhetet rreth asaj që ne duhet ta përforcojmë dhe ta ruajmë. Një varg popujsh të lashtë dhe vendas vazhdojnë ta mishërojnë këtë moral.

Në kohët pasnormale, shtyrja e kufijve të besueshmërisë kërkon një lloj të ri të menduari, shoqëruar me krijimtari dhe përfytyrim. Duhet të jemi në gjendje të përballemi me ndërlikimin dhe njohuritë e mangëta, të lidhim atë që është e ndarë dhe të merremi me ndërlikohet dhe ndërvarësinë. Si e tillë, përqasja jonë duhet të jetë sa rrënjësore, aq edhe e thjeshtë, nëse duam të mishërohet dhe të jetë dobiprurëse. Krijimtaria dhe përfytyrimi, siç ka sqaruar Monturi, duhet të lëvizin nga pikëpamja vetjake/copëzuese e bashkëkohores, drejt një qasjeje më rrethanore, bashkëpunuese, të ndërlikuar – duke u shkëputur nga gojëdhëna e gjeniut dhe frymëzimit që përshkrijnë filozofinë, moralin dhe veprimin.<sup>70</sup> Ky është drejtimi që na çon përfundimisht themeli i tre të nesërmeve - drejt të pamenduarës.

70 A. Montuori, 'Beyond postnormal times: The future of creativity and the creativity of the future,' *Futures*, vol. 43, no. 2, f. 221–227, Mars 2011







## Lidhshmëria ngjitëse: sqarimi i tri të nesërmeve

*John Sweeney*

E vetmja gjë që binte në sy deri në vitin 2011, në qytezën *Le Roy* të Nju Jorkut, ishte lindja e Jell-O (një lloj ëmbëlsire e tulët), së bashku me një muze përkatës, në nder të kësaj ëmbëlsire të mirënjohur amerikane, por ndoshta jo dhe aq shumë të pëlqyer. E gjithë kjo ndryshoi kur një grup vajzash të reja dhe një djalë në shkollën e mesme *Le Roy* filluan të shfaqnin ngërçe të papërmbajtura, dridhje, gulçim dhe belbëzim. Në kulmin e shpërthimit, 20 veta, duke përfshirë disa që nuk ishin nxënës, vuanin nga shenja të ngjashme me sëmundjen *Tourette*. Mbulimet e mediave vendase shumë shpejt u shndërruan në lajme kombëtare dhe njohësit e zanafillës së kësaj sëmundjeje paraqitën në pohimet e tyre të panumërta, ku pezmatimi, ndotja e mjedisit dhe bakteri *Borrelia* ishin nga më të përmendurat. Një studim i thelluar nga Departamenti i Shëndetësisë, i shtetit të Nju Jorkut, doli në përfundimin se: “Përgjegjësit e kujdesit shëndetësor dhe agjencitë e shëndetit të qytetarëve të përfshirë në këtë hetim, mendojnë se raste të tilla u shfaqën si pasojë e një çrregullimi që u shndërrua në sëmundje psikologjike.<sup>1</sup> Përcaktimi i kësaj sëmundjeje psikologjike të përhapur, e cila dikur njihej si tërbim, nuk ishte pa kundërshtime (ose vërejtje), veçanërisht pasi Udhëzuesi i Përcaktimit dhe i të Dhënave për Çrregullime Mendore nuk ofron udhëzime të qarta, që do të thotë se përcaktimi i llojit të sëmundjes është tërësisht vetjak. Në të vërtetë, përcaktimi është po aq i çuditshëm, sa edhe sëmundja. Ajo çka thanë përfaqësuesit e shëndetit publik ishte fare pak për të shuar etjen mediatike që rrethonte rastin në fjalë,

1 New York State Department of Health. (2012). Investigation of neurologic symptoms among Le Roy Jr/Sr High School students, Tetor 2011-Janar 2012: Interim report. Marrë nga [www.health.ny.gov/press/releases/2012/leroy/docs/investigation\\_summary.pdf](http://www.health.ny.gov/press/releases/2012/leroy/docs/investigation_summary.pdf)



gjë që vetëm e përkeqësoi rrethanën, duke ndihmuar më shumë në përhapjen e sëmundjes ngjitëse.<sup>2</sup> Siç njofton Dimon, “Disa besojnë se trazira e Le Roy-it ishte pasojë e drejtpërdrejtë e videove të botuara në *You Tube* nga Lori Braunell, një vajzë me dridhje trupi të rënda në Korinth të Nju Jorkut, 250 milje në lindje të Le Roy -it”.<sup>3</sup> Njoftimet e hershme vunë re se si grupi fillestar i vajzave të reja që do të prekeshin, kishin parë video në *You Tube* dhe përsërisnin atë që shihnin. Në kulmin e ngjarjes, Dr. David Lichter, Profesor i Neurologjisë në Universitetin Bufalo, i tha një stacioni vendor lajmesh: “Mendoj se është tërësisht e mundur, që njerëzit të hyjnë në internet dhe të shohin sjelljen e nxënësve të tjerë. Për pasojë, mendoj se kjo lloj media e ka mundësinë ta përhapë atë, përtej mjedisit që e rrethon”.<sup>4</sup>

Parandjenja parashikuese e Dr. Lichter duket se u vërtetua në Le Roy, pasi Marge Fitzsimmons, një infermiere 36-vjeçare që nuk kishte lidhje të drejtpërdrejta me asnjë nga nxënësit, filloi të shfaqte të njëjtat shenja, gjoja të marra përmes rrjeteve shoqërore që ishin mjetet kryesore përmes së cilave ajo kishte hyrë dhe kishte marrë të dhënat dhe përditësimet mbi të prekurit. Përsëri, Dimon njoftoi: “Facebook-u jo vetëm që po rrit përhapjen e sëmundjes mes të rinjve, por gjithashtu po përkeqëson gjendjen e nderë dhe, për rrjedhojë, shenjat e atyre që tashmë vuanin”.<sup>5</sup> Duke menduar rreth sëmundjes ngjitëse në Le Roy dhe se si mund të përhapen sëmundje të tilla ngjitëse në të ardhmen, Dr. Robert Bartholomew, një sociolog i specializuar për ndodhi të tilla, parashtroi një mundësi ogurzezë të “një ngjarjeje shumë më të madhe ose mbarëbotërore, nëse nuk kuptojmë sa më shpejt, se si rrjetet shoqërore, për herë të parë, veprojnë si drejtimi kryesor ose përfaqësuesi i përhapjes së çrregullimeve tjetërsuese”.<sup>6</sup> Si mund të përfytyrohen mundësi të tilla në të ardhmen? Një vështrim në të kaluarën mund të jetë i dobishëm për të menduar për mundësitë e së ardhmes. Në verën e vitit 1518, shumë njerëz në Strasburg dolën në rrugë për të kërcyer. Nuk ishte festival apo rast i veçantë që i frymëzoi ata për ta bërë këtë. Ata u detyruan në mënyrë të pashpjegueshme. Një forcë e panjohur i çoi disa drejt vdekjes dhe kjo murtajë e ethshme goditi papritur dhe me shpejtësi, duke përfshirë qytetin me rrethina, duke u kthyer në një tmerr. Murtaja e vallëzimit, e vitit 1518, nuk ishte e para nga

2 Abbott, M. (2014, Qershor 26). When social media makes something go viral in real life.” Marrë nga [www.huffingtonpost.com/megan-abbott-/dontlook-nowsocial-medi\\_b\\_5534200.html](http://www.huffingtonpost.com/megan-abbott-/dontlook-nowsocial-medi_b_5534200.html)

3 Dimon, L. (2013, Shtator 11). “What witchcraft is Facebook?” *The Atlantic*. Marrë nga [www.theatlantic.com/health/archive/2013/09/what-witchcraft-is-facebook/279499/](http://www.theatlantic.com/health/archive/2013/09/what-witchcraft-is-facebook/279499/)

4 Admin wkbw. 2012. “Social Networking to Blame for Spreading LeRoy Illness?” Shkurt. [www.wkbw.com/news/Social-Networking-to-Blamefor-Spreading-LeRoy-Illness-138821059.html](http://www.wkbw.com/news/Social-Networking-to-Blamefor-Spreading-LeRoy-Illness-138821059.html)

5 Dimon, L. (2013, Shtator 11). “What witchcraft is Facebook?” *The Atlantic*. Marrë nga [www.theatlantic.com/health/archive/2013/09/what-witchcraft-is-facebook/279499/](http://www.theatlantic.com/health/archive/2013/09/what-witchcraft-is-facebook/279499/)

6 Po aty.



pandemitë e tilla që goditën Europën në Mesjetë, por është një nga më të dukshmet dhe të mirëstudiuarat. Çfarë i çmendi 400 njerëz, gjatë një kërcimi të dalldisur? Siç shpjegon Waller<sup>7</sup>:

Ishte një veprim i ethshëm, por kjo është ajo që mund të kishte ndodhur vetëm në një kulturë të zhytur në një lloj të veçantë të mbinatyrshmërisë. Populli i Strasburgut kërceu në mjerimin e tij, për shkak të një besimi të padiskutueshëm në zemërimin e Zotit dhe shenjtoreve të Tij të shenjtëruar. Ishte një shprehje e mbrapshtë e dëshpërimit dhe e frikës së përkushtuar.<sup>8</sup>

Hamendësimet e Waller-it rreth shkaqeve të Murtajës së Vallëzimit, janë ndër më të vlerësuarat, por autori që shkroi dy monografi mbi ndodhinë e vitit 1518, gjithashtu, nuk ia përton të nxjerrë në pah, se sa shumë nga kjo ndodhi mbeti e panjohur dhe se përcaktimet bashkëkohore të dukurive të tilla janë thjesht përsiatje. Waller vazhdon:

Në një epokë ku mbizotërojnë shpjegimet gjenetike, epidemitë e vallëzimit na kujtojnë se përcaktimet e sëmundjeve mendore nuk janë të palëvizshme dhe të pandryshueshme, por ato mund të përshtaten në varësi të mjediseve kulturore. Në të njëjtën kohë, dukuria e kërcimit të shfrenuar, me gjithë zvetënimin e saj të plotë, zbulon skajet në të cilat mund të na çojë frika dhe e mbinatyrshmja.<sup>9</sup>

Ndërsa Waller përqendrohet tek e mbinatyrshmja, si themel për vendosjen e kushteve mendore-shoqërore të Murtajës së Vallëzimit që goditi Strasburgun, të tjerë vënë në dukje një varg faktorësh jogjenetikë dhe ndryshorësh, megjithëse të gjithë ata që shkruajnë për Murtajën e Vallëzimit, në fund u kthehen hamendjeve mbi gjendjen mendore-shoqërore të kërcimtarëve që e pësuan. Siç vërejnë Donaldson, Cavanagh dhe Rankin<sup>10</sup>:

Te një përbërës i dietës, helmues ose ngjitës, gjenden të gjitha mundësitë. Megjithatë, duket se ka qenë një çrregullim mendor, i cili ndodhi aty ku kishte një prapavijë frymëzimi kulturor dhe është shkaktuar nga rrethana të papërshtatshme shoqërore - një shenjë e kohërave që kanë ikur me kohë.<sup>11</sup>

7 Waller, J.C. (2008). In a spin: The mysterious dancing epidemic of 1518." *Endeavour*, 32(3), 117–21. doi:10.1016/j.endeavour.2008.05.00

8 Po aty.

9 Waller, J. (2009b). A forgotten plague: Making sense of dancing mania. *The Lancet*, 373 (9664), f. 624–625.

10 Donaldson, L.J., Cavanagh, J., & Rankin, J. (1997). The dancing plague: A public health conundrum. *Public Health*, 111 (4), f. 201–204.

11 Donaldson, L.J., Cavanagh, J., & Rankin, J. (1997). The dancing plague: A public health conundrum. *Public Health*, 111(4), f. 201–204.



Nëse prapavija kulturore është ajo çfarë ndihmon në ndodhi të tilla, si mund ta ndihmojë kjo dikë për të kuptuar se çfarë ndodhi në Le Roy? Duke pasur parasysh jehonën e jashtëzakonshme dhe përhapjen e vazhdueshme të rrjeteve shoqërore, a mund të përfillet kjo pikë ndërveprimi (internet) si prapavijë kulturore? Çfarë ndikimesh mund të shpalosen në ndodhitë e ardhshme?

Pavarësisht rritjes verbuese të rrjeteve shoqërore dhe pyetjeve pa përgjigje rreth ndodhive të tilla si Le Roy, disa, për të mos thënë shumica e planeve të veprimit për të ardhmen e Rrjetit Mbarëbotëror (në vijim, *www*) iu shmangen përfshirjeve në dukuri që lidhen me ndjenjat dhe mërzinë. Unë kam zgjedhur qëllimisht përcaktimin më pak të përdorur, *www*, dhe jo Internet, pasi i pari vë në dukje mjetin parësor, megjithëse jo të vetmin, përmes së cilit merren dhe ndahen të dhënat digjitale, në vend të ndërtesave të preکشme, megjithëse njëra dukshëm ka nevojë për tjetrën për të mbijetuar. Kjo nuk do të thotë se ky arsyesim është mosbesues në lidhje me një varg ravijëzimesh teknike që janë të nevojshme për të ngarkuar një video në *You Tube*, ose për të shpërndarë një mendim në *Facebook*, duke përdorur telefonin e dikujt. Përkundrazi, asnjë nga këto veprime nuk mund, ose nuk do të mundësohej, pa përsheptuar përparimet e rëndësishme të internetit, i cili ka varganin e vet të ndikimeve. Por shumica e atyre që hyjnë në *www*, kanë pak lidhje me mekanizma të tillë, përtej ekraneve të ndriçuara të madhësive të ndryshme përpara tyre. Siç vëren Galloway, “Kultura e burimeve të hapura të mediave të reja vërtet që ka një kuptim në ditët e sotme, kjo do të thotë pikë ndërveprimi e hapur”.<sup>12</sup> Dhe është pikërisht ekrani rrezatues përpara nesh, ai që na prek më shumë, që do të thotë se njerëzimi është në vetvete një pikë ndërvepruese e hapur, e cila varet nga një varg ndikimesh, duke përfshirë lidhjen ngjitëse. Duke shpërfaqur një kuadër të dobishëm ndikimi që bën dallimin midis tronditjeve, ndjenjave dhe vetë rrethanave që shkaktojnë lidhjen ngjitëse, Massumi sqaron:

Le ta ruajmë emërtesën “tronditje” në kuptimin e një nevoje vetjake, si ndikim drejt vazhdimësisë! Tronditja varet nga rrethanat, ndikimi varet nga gjendja. Rrjedhimisht, lidhet me rrethanën. Në mënyrë të përsëritur, ndikimi është kalimtar. Sa ç’është vazhdimësi, po aq është edhe paraprirje, ndikimi popullon udhëtimin. Është para dhe pas-rrethanor, para dhe pas-vetjak, një tepricë vazhdimësie e taksur vetëm në ecurinë e vet.<sup>13</sup>

12 Galloway, A.R. (2012). *The interface effect*. Cambridge, UK: Polity.

13 Massumi, B. (2002). *Parables for the virtual: Movement, affect, sensation*. Durham: Duke University Press Books.



Ndikimi është bërë një ide mjaft e përhapur në qarqet teorike, pasi tregon për lakueshmërinë tonë të qenësishme, si “sisteme poresh të hapura”<sup>14</sup>. Siç shpjegon Hemmings, “[ndikimi] shpërngulet te të tjerët dhe dyfishohet, duke rritur fuqinë e tij fillestare. Kështu, ndikimi mund të thuhet se e vendos njeriun në një qark ndjesie dhe kundërveprimi ...”<sup>15</sup> Duke sfiduar sundimin jashtë vullnetit të lirë në një marrëdhënie, si dhe nuhatjen për ta dobësuar atë, ndikimi na çon te një varg përfundimesh të pathëna shoqërore dhe politike. Më dërrmuesja prej tyre është se truri dhe trupi ynë janë aq shumë të ndjeshëm ndaj një varg forcash të shprehura gjenetikisht, sa që vetë renditjet e përdorura për të përcaktuar vetveten – në shumë vende, pra themeli i të drejtave dhe shtetësisë – janë, në rastin më të mirë, të paqarta, nëse jo krejtësisht të paarsyeshme. Në botën tonë shumë bashkëkohore, kjo lakueshmëri është e ndërthurur, si shkak dhe pasojë e lidhjes ngjitëse. Për shumë njerëz, lidhja ngjitëse është shtysa e bezdisur për të parë e-mailin tuaj; dëshira për të prekur pullën e rifreskimit në burimin tuaj të rrjeteve shoqërore, kur sapo e keni ngarkuar faqen; zhgënjimi i të rrotulluarit sa andej-këndej gjatë natës, vetëm për t’u ngushëlluar nga ndriçimi i butë i një ekrani të njohur. Për të tjerët, lidhja ngjitëse është ajo që i ndodhi Marge Fitzsimmons, shtysa nervore-trupore për të jetuar larg botës bashkëkohore; shtysa e së ardhmes digjitale, pesha e një të shkuare krejtësisht njerëzore, ose diçka e mesme, që mund dhe duhet të formësojë atë që shtrihet paksa mbi horizont. Pra, lidhshmëria ngjitëse është ndikim i mishëruar, rrethanë e përkohshme e një ngjarjeje për trupat tanë tepër njerëzorë që nuk shqiten nga media “gjithnjë në ndryshim e sipër”, në të tashmen e stërzgatur dhe një varg të ardhmesh të mundshme.<sup>16</sup>

A është e mundur, që *ndikimi* të shpjegojë ndodhinë në Le Roy? E ka *www-ja* fuqinë për t’u kthyer në diçka ngjitëse? A mund të shfrytëzohet lidhja ngjitëse, apo ndoshta edhe të armatoset? Ndërsa disa plane vepri mi për të ardhmen e internetit përqendrohen në mbështetjen e përmirësimit të shëndetit përmes të dhënave elektronike<sup>17</sup> dhe shumë të tjera

14 Dator, J.A., Sweeney, J.A., & Yee, A.M. (2015). *Mutative Media. Lecture Notes in Social Networks*. Cham: Springer International Publishing. <http://link.springer.com/10.1007/978-3-319-07809-0>

15 Hemmings, Clare. 2005. “Invoking Affect: Cultural Theory and the Ontological Turn.” *Cultural Studies* 19 (5), f. 548–567.

16 Dator, J.A., Sweeney, J.A., & Yee, A.M. (2015). *Mutative Media. Lecture Notes in Social Networks*. Cham: Springer International Publishing. <http://link.springer.com/10.1007/978-3-319-07809-0>

17 Burns, A., & McGrail, S. (2012). Australia’s potential Internet futures: Incasting alternatives using a new technology images framework. *Journal of Futures Studies*, 16(4), f. 33–50.



po zbavitën me një varg mundësish për sigurinë kibernetike<sup>18</sup>, pak përballen me ndërlidikimet e lidhjes ngjitëse, edhe pse synime të tilla kanë qenë në qendër të vëmendjes së atyre që kërkojnë të përfitojnë nga njerëzimi ynë shumë i depërtueshëm. Siç thekson Sampson, “tronditjet, ndjenjat dhe ndikimet janë bërë, në të vërtetë, pika qendrore e parapëlqyer për ideatorët me përvojë dhe tregtarët që merren me kundërveprimin e trurit ndaj reklamave”.<sup>19</sup> Që nga eksperimenti i miratuar, por i mbajtur fshehur nga *Facebook*, rreth tronditjeve të përdoruesve<sup>20</sup>, dhe deri te njoftimet e grupeve të agjërimit në internet, në Japoni<sup>21</sup>, ndikimi i ndjenjave në veprimet tona, të shkaktuara nga www-ja, nuk është ndjerë kurrë më shumë.

Duke përdorur thjerrëzën e kohëve pasnormale për të hetuar lidhjen ngjitëse të www-së, ky studim përdor një metodë të re parashikuese për të hulumtuar forcat dhe çështjet gjithnjë në rritje që shtynë dhe peshojnë www-të në vitet në vijim. Ideja e kohëve pasnormale, përpiluar në vitin 2010 nga Sardar, thekson se ne jetojmë në “një periudhë ndërmjetëse, ku traditat e vjetra po vdesin, të rejtat ende nuk kanë lindur dhe shumë pak gjëra duket se kanë kuptim.”<sup>22</sup> Kjo dukuri mbarëbotërore përjetohet në mënyra shumë të kufizuara dhe nuk na jep të kuptojmë se gjendet një gjë e tillë që mund ta quajmë “normale”, në një kuptim të padyshimtë. Përkundrazi, ajo synon nxitjen e një vështrimi të thellë ndaj normave themelore dhe përshtypjeve, duke ndriçuar ndjenjën, shpeshherë të nënkuptuar, që shumë prej nesh e kanë lidhur me ndryshimet e vazhdueshme në të tashmen dhe asaj që shtrihet pak mbi horizont.

- 
- 18 Burns, A., & McGrail, S. (2012). Australia's potential Internet futures: Incasting alternatives using a new technology images framework. *Journal of Futures Studies*, 16(4), f. 33–50.; Creech, H., Andjelkovic, M., Vetter, T., MacLean, D., Rothman, D., & Vergragt, F. J. (2009). *Mapping the future of the Internet onto global scenarios: A preliminary view*. Winnipeg, Canada: International Institute for Sustainable Development; Rueda-Sabater, E., & Derosby, D. (2011). *The evolving Internet in 2025: Four scenarios*. *Strategy & Leadership*, 39 (1), f. 32–38. doi:10.1108/108785711111095402
- 19 Sampson, T.D. (2012). *Virality: Contagion theory in the age of networks*. Minneapolis: University of Minnesota Press.
- 20 Kramer, A.D.I., Guillory, J.E., dhe Hancock, J.T. (2014). Experimental evidence of massive-scale emotional contagion through social networks. *Proceedings of the National Academy of Sciences*, 111 (24), 8788–8790. doi:10.1073/pnas.1320040111.; Meyer, R. (2014, Qershor 28). Everything we know about Facebook's secret mood manipulation experiment. *The Atlantic*. Marrë nga [www.theatlantic.com/technology/archive/2014/06/everything-we-knowabout-facebookssecret-mood-manipulation-experiment/373648/](http://www.theatlantic.com/technology/archive/2014/06/everything-we-knowabout-facebookssecret-mood-manipulation-experiment/373648/)
- 21 Samakow, J. (2013, Gusht 28). “Japan Internet ‘fasting camps’ aim to treat screen-addicted kids.” *Huffington Post*. Marrë nga [www.huffingtonpost.com/2013/08/28/japan-internetfasting-camp\\_n\\_3824697.html?](http://www.huffingtonpost.com/2013/08/28/japan-internetfasting-camp_n_3824697.html?)
- 22 Sardar, Z. (2010). Welcome to Postnormal Times. *Futures*, 42(5), 435–44. doi:10.1016/j.futures.2009.11.028



## SI JANË KOHËT PASNORMALE?

Në fund të shtatorit 2013, njësia e tretë në termocentralin bërthamor Oskarshamn, në Suedi, u detyrua të mbyllej. Ishe reaktori më i madh në botë me ujë të valuar dhe burimi më i madh bërthamor në krahinën nordike. Mbyllja e papritur e Oskarshamnit shqetësoi jo pak njerëz, veçanërisht në vazhden e krizës së vazhdueshme dhe njëkohësisht të pazgjidhur të Fukushima-s. Ndërsa punëtorët në Oskarshamn nxituan të mohonin mundësinë e një shkrirjeje të impiantit Baltik nga tejngrohja, në fakt, shkaku i ndalimit është shumë më shqetësues: një lulëzim i pamat i kandilit të detit që bllokoi tubacionet e marrjes së impiantit, të cilët sigurojnë ujë për të ftohur njësinë bërthamore prej 1.400 megavat.<sup>23</sup> Ndërsa ngjarja në Oskarshamn mori vëmendje mëse të mjaftueshme mediatike, kjo nuk është hera e parë që kandilat e detit të cilët nuk janë peshq, por butakë, ndikuan në mbylljen e njësisë së tretë. Në vitin 2005, Oskarshamni që siguron afërsisht 10% të energjisë së Suedisë, u detyrua të pushonte për të njëjtën arsye. Kjo dukuri nuk ka qenë e kufizuar në Oskarshamn, pasi lulëzimi i pamat ka çuar në mbyllje të ngjashme të burimeve bërthamore në Shtetet e Bashkuara, Izrael, Skoci dhe Japoni. Përveç shkatërrimit në rrjetet e energjisë, gjithashtu, kandili i detit ka shkaktuar zhvendosjen e prodhimeve të mëdha të filmave dhe ka shkaktuar dhimbje koke për organizatorët e ngjarjeve sportive oqeanike, duke përfshirë Komitetin Olimpik në Sidnej. Mirëpo, këta butakë rebelë, gjithashtu, i kanë dhënë një mësim të mirë ushtrisë më të madhe në botë dhe ka nxitur fërkimet politike.

Në vitin 2006, anija amerikane Ronald Reagan, e cila në atë kohë ishte anija detare më e përparuar në botë, përjetoj atë që Komandanti i Forcave Ajrore Detare të Shteteve të Bashkuara e quajti një “rast fatkeq molepsjeje”, ndërsa ishte ankoruar në Brisbanë të Australisë.<sup>24</sup> Megjithëse anija dhe ekuipazhi i saj prej 6000 vetash kishin aftësi taktike të përballeshin me një shtet të vogël, një lulëzim i kandilit të detit bllokoi sistemin e ftohjes së anijes Regan, duke detyruar mbylljen e të gjitha veprimtarive në bord, për ta kthyer anijen përsëri në det. Në vitin 1999, butakët që fusin hundët kudo, çuan në mbylljen e Sualit, termocentrali me qymyr në Luzon të Filipineve. Ndërprerja la 40 milionë njerëz pa energji elektrike dhe

23 Guilford, G. (2013, Tetor 15). *“Jellyfish are taking over the seas, and it might be too late to stop them.”* Quartz. Marrë nga <http://qz.com/133251/jellyfish-are-taking-over-the-seas-and-it-might-be-toolate-to-stop-them/>

24 Gershwin, L.-A. (2013). *Stung!: On jellyfish blooms and the future of the ocean*. Chicago: The University of Chicago Press.





nxiti “frikën se do të ndodhte një grusht shteti ushtarak, i përfolur prej kohësh”.<sup>25</sup> Edhe pse energjia ra vetëm për rreth dhjetë minuta, Presidenti Estrada lëshoi një deklaratë, duke siguruar qytetarët se ndërprerja e energjisë elektrike nuk ishte “pjesë e një përpjekjeje për të dobësuar qeverinë”.<sup>26</sup>

Ndoshta ajo që është më shqetësuese për këto dukuri të çuditshme, është se ato pritet të shumohen, pasi puqjet me njëra-tjetrën, si mbipe-shkimi, ndotja detare dhe rritja e aciditetit oqeanik dhe niveleve të temperaturës, të cilat janë të gjitha pasojë e veprimtarisë njerëzore, krijojnë kushte të përshtatshme për më shumë lulëzime butakësh, veçanërisht pranë zonave bregdetare ku gjenden shumë nga 430 termocentralet bërthamore të botës.<sup>27</sup> Në përgjigje të këtyre të papriturave, shkencëtarët nga Instituti i Përparuar i Shkencës dhe Teknologjisë, në Korenë e Jugut, ndër-tuan “Muzeun Robotik të Zhdukjes së Kandilit të detit”. Këta përmbarues të pavarur të kandilit të detit janë programuar për të kërkuar dhe shkatërruar lulëzimin e bregdetit, i cili vetëm në Korenë e Jugut ndikon rreth 300 milionë dollarë në vit të peshkimit vendor.<sup>28</sup>

Sido që të jetë, këto ngjarje të çuditshme dhe disa prej përgjigjeve kundrejt tyre, janë shenja treguese që, në të vërtetë, ne jetojmë në kohë pasnormale, një epokë ku përshkallëzimi është bërë i zakonshëm. Siç vëren Sardar, frymëzimi i kohëve pasnormale është Shkenca Pasnormale, e cila

shquhet për rreziqe të mëdha, fakte të pasigurta, luftë vlerash dhe vendime të menjëhershme. Prandaj, marrëdhënia çmim/përfitim s’ka dyshim që do të shqyrtohet. Në këto rrethana, ndikimet e jashtme në këshillin shkencor janë të ulëta ose të papranishme, lënda teorike mbështetet në përpunimin dhe hyrjen e të dhënave, ndërsa pasiguria priret të shkojë drejt padijes.<sup>29</sup>

Në fund të fundit, kohët pasnormale kërkojnë mënyra të reja kërkimi dhe zbrërthimi, qoftë edhe vetëm për t’u marrë me çoroditjen, mospërputhjet dhe ndërlikimin e jetës, në një periudhë pasigurie të pabindur dhe ndryshimi të përshpejtuar. Siç vëren Sardar, “është e qartë se vështirësitë e

25 Tucker, A. (2010, Gusht). “Jellyfish: The next king of the sea.” *Smithsonian Magazine*. Marrë nga [www.smithsonianmag.com/40th-anniversary/jellyfish-the-next-king-of-the-sea-679915/](http://www.smithsonianmag.com/40th-anniversary/jellyfish-the-next-king-of-the-sea-679915/)

26 “Dark days for Estrada.” (1999, Dhjetor 16). *The Economist*. Marrë nga [www.economist.com/node/327446](http://www.economist.com/node/327446)

27 World Nuclear Association. (2015, Shkurt). “Nuclear power in the world today.” Shkurt. [www.world-nuclear.org/info/Current-andFutureGeneration/Nuclear-Power-in-the-World-Today/](http://www.world-nuclear.org/info/Current-andFutureGeneration/Nuclear-Power-in-the-World-Today/)

28 Gray, R. (2013, Tetor 2). “Jellyfish shredding robot tested to control swarms.” *Telegraph.co.uk*. Marrë nga [www.telegraph.co.uk/news/newstopics/howaboutthat/10349839/Jellyfish-shredding-robot-tested-to-control-swarms.html](http://www.telegraph.co.uk/news/newstopics/howaboutthat/10349839/Jellyfish-shredding-robot-tested-to-control-swarms.html)

29 Elahi, S. (2011). Here be dragons... Exploring the ‘unknown unknowns.’ *Futures*, 43 (2), 196–201. doi:10.1016/j.futures.2010.10.008



kohëve pasnormale nuk mund të zgjidhen me mjetet që kemi në dispozicion. Ato kërkojnë mënyra të reja të të menduarit dhe të vepruarit ...”<sup>30</sup> Megjithatë, gjetja e mënyrave të reja dhe më të dobishme për të lundruar në kohët pasnormale është më e lehtë të thuhet, sesa të bëhet, veçanërisht kur ka plot që rrinë të ngulitur brenda fushës së normalitetit të sajuar. Siç shpjegon Rao:

Ka mekanizma që veprojnë – një përzierje e natyrshme, e ngutshme dhe largpamëse – që punojnë për të na penguar të kuptojmë se e ardhmja po ndodh në të vërtetë, ndërsa flasim. Për të kuptuar me të vërtetë botën dhe se si ajo po përparon, ju duhet të kapërceni përmes kësaj fushe normaliteti të sajuar.<sup>31</sup>

Për Raon, *fusha e normalitetit të sajuar* është ajo që e pengon njeriun të përballlet me kohët pasnormale, megjithëse dukuri të tilla, si ndryshimi i klimës dhe lulëzimi i kandilit të detit, po bëjnë çmos për të përshpejtuar një ndryshim të thellë në mendim dhe veprim. Në pikëtakimet e çoroditjes, mospërputhjes dhe ndërlikimit të kohëve pasnormale qëndron çuditshmëria e qenësishme e çastit tonë historik. Në këtë gjendje të kufizuar, është e pamundur të ktheheni në një gjendje normale të sajuar. Dikush e ka të pamundur që thjesht të rindezë përshtatjen me një rrethanë të re të dikujt tjetër. Duke pasur parasysh kuadrin e mësipërm, Qendra për Studimet e Përqasjeve Pasnormale dhe Ardhmërisë zhvilloi një mënyrë të re për zbërthimin e forcave në zhvillim, të nxitura nga idetë kryesore që qëndrojnë në themel të kohëve pasnormale.

Në punën tradicionale të së ardhmes dhe parashikimit strategjik, e ardhmja shpesh ndahet në plane veprimi të së ardhmes së afërt, të mesme dhe të largët, ose, edhe më keq, në plane veprimi të së ardhmes së lartë, të mesme dhe të ulët. Ndërsa kjo përjasje është përdorur gjerësisht për ta menduar dhe modeluar të ardhmen në të kaluarën (dhe të tashmen), këto ndarje janë shumë të cekëta, shumë të përgjithshme dhe shumë të thjeshta. Atyre u mungon ndërlikimi i nevojshëm i vetë botës dhe, për rrjedhojë, gjithmonë do të dështojnë në gjallërimin e njohurive vërtetë të reja dhe pyetjeve të reja. Në kohët pasnormale, duhet menduar për të ardhmet e mundshme në kuptimin e grupimeve të veçanta të së nesërmeve të ndër-lidhura – një ekologji e ndërlikuar e mundësive për atë çka na pret. Për më tepër, pyetjet janë shumë më të rëndësishme se përgjigjet. Studimet e së

30 Sardar, Z. (2010). Welcome to Postnormal Times. *Futures*, 42(5), 435–44. doi:10.1016/j.futures.2009.11.028

31 Rao, V. (2012, May 9). “Welcome to the future nauseous.” Ribbonfarm: Experiments in Refactored Perception. Marrë nga [www.ribbonfarm.com/2012/05/09/welcome-to-the-future-nauseous/](http://www.ribbonfarm.com/2012/05/09/welcome-to-the-future-nauseous/)



Ardhmes janë rrënuar nga një shtysë e pandërprerë drejt veprimit strategjik, në vend që të përqendrohen për analiza të thella dhe krijuese të hamendësimeve, pikave të errëta dhe normaliteteve të sajua, të cilat ushtrojnë një ndikim të jashtëzakonshëm në kohët që po kalojmë, në të tashmen e stërzgatur dhe në një varg të ardhmesh të mundshme. Siç arsyeton Sardar:

Nuk mjafton më thjesht të hulumtosh një shumëllojshmëri të ardhmesh të mundshme. Ne, gjithashtu, duhet t'i kushtojmë vëmendje të madhe mënyrës se si do të lundrojmë në gjendjen pasnormale [...], për të mbërritur një të ardhme të arsyeshme dhe të qëndrueshme. Në përgjithësi, largpamësit kanë shmangur pyetjet e rëndësishme (ngaqë shihen si lëndë e filozofisë) dhe janë përqendruar në shqyrtimin e prirjeve, soditjen e horizontit, ndërtimin e modeleve mbarëbotërore dhe krijimin e planveprimit, vegimeve e përfytyrimeve të së ardhmes së larmishme.<sup>32</sup>

Ndërsa *ndikimi* paralajmëron atë që është më e brishtë për njerëzimin tonë të shkrifët, shkalla në të cilën ne vazhdojmë të jemi njerëz në një varg të ardhmesh, është vendimtare për shtjellimet që ne marrim përsipër. Një pikë tjetër e ngritur nga Sardar është e rëndësishme, ngaqë na ndihmon të kuptojmë se çfarë na pret në të ardhmen. Nuk mjafton më të flasim për të ardhmen parimore, pasi disa dukuri, si ngrohja globale, duhet të përfshihen tani në të gjitha planet e veprimit, edhe nëse jemi marrë me 'to vetëm në kohët e shkuara, pa e menduar mënyrën e shërimit të tyre. Ky përcaktim qëllimisht i sikletshëm paralajmëron një përbashkësi midis asaj që është e papërfytyrueshme, kundrejt asaj të pamenduar, ose asaj që na detyron të mendojmë përtej sfidave, shembujve dhe hamendësimeve tona të tani-shme. Jim Dator, kohët e fundit, ka bërë një arsyetim të ngjashëm në lidhje me atë që ai e quan "Trinia e Pa Shenjtë"<sup>33</sup> dhe "normalja e re", për mënyrën e modelimit të planveprimit sipas shkollës Manoa.<sup>34</sup> Prandaj, ky punim përdor të ardhme(et) qëllimisht të vështira, për të nxitur një lexim të dyfishtë të gjërave që do të vijnë. Nga njëra anë, ka gjithmonë të ardhme - një larmi të ardhmesh të ndryshme dhe të mundshme, sado të pamundura dhe të pabesueshme. Nga ana tjetër, "e ardhmja" nënkupton një ndërveprim të nevojshëm - një hapësirë e përbashkët, e përcaktuar nga sfidat dhe mundësitë e përbashkëta që qëndrojnë fort brenda gjallërisë së *kohëve pasnormale*. Tre të nesërmet (3T) është një mënyrë për ta modeluar këtë gjallëri dhe për të ofruar një kuadër dhe përjasje më të fuqishme

32 Sardar, Z. (2015). Postnormal Times revisited. *Futures*, 67 (Mars), 26–39. doi:10.1016/j.futures.2015.02.003

33 Dator, J. (2009). The unholy trinity, plus one. *Journal of Futures Studies*, 13 (3), f. 33–48.

34 Dator, J. (2014). 'New beginnings' within a new normal for the four futures. *Foresight*, 16 (6), 496–511. doi:10.1108/fs-09-2013-0046



në kërkimin e së ardhmes. Duke ofruar një mjet për të hulumtuar planveprime të ndryshme e të ndërlydhura të së ardhmes, në shtrirje dhe madhësi të ndryshme, *tre të nesërmet* përdor një dukuri ose lëndë të vetme - në këtë rast, *ndikimin* dhe *www-n* - për të hetuar mundësitë mbi atë çka na pret. Kështu, planveprimet që dalin në dritë, duke përdorur mënyrën e *tre të nesërmeve*, përqendrohen në çështjet e reja dhe kanë për qëllim të ngrenë shqetësime dhe pyetje të pamenduara më parë.

## NGJIZJA E TRE TË NESËRMEVE

E nesërmja e parë është thjesht e tashmja e stërzgatur: që do të thotë se prirjet dhe zhvillimet që mund të vërehen sot, do të formësojnë të ardhmen e 10-15 viteve të ardhshme. Kjo është ajo që shumica e njerëzve nënkuptojnë, kur bëjnë thirrje për “të ardhmen”. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se *e tashmja e tejzgatur* nuk mund të ndikohet nga turbullirat e kohëve pasnormale. Por, në përgjithësi, ndryshimi në të ardhmen e afërt do të përcaktohet nga çasti i së tashmes. Në këtë periudhë ku mbizotërojnë prirjet e mëdha dhe të tjera, të populluara me shenja dobësimi, ideja Guptas për “elefantin e zi” kap thelbin e këtij horizonti. Ai shpjegon se një elefant i zi është:

një ngjarje e cila është jashtëzakonisht e mundshme dhe e parashikuar gjerësisht nga njohësit e fushës, por njerëzit përpiqen ta kalojnë atë si një mjellmë të zezë, kur, më në fund, ndodh. Zakonisht, njohësit e fushës që e kishin parashikuar ngjarjen – që nga kriza ekonomike e deri te gripi mbarëbotëror – kalojnë nga të qenit të parëndësishëm, drejt të qenit të lavdishëm, kur çështja, më në fund, ngre krye.<sup>35</sup>

Pra, elefantët e zinj janë, si të thuash, “në dhomë” dhe kjo është arsyeja, pse ata janë pjesë përbërëse e së tashmes së tejzgatur.

Përtej të tashmes së tejzgatur, gjejmë të *ardhmet e njohura*, të cilat gjenden diku përtej 15-20 viteve të ardhshme, ndonëse nuk ka një horizont kohor të caktuar. Të ardhmet e njohura nënkuptojnë planveprime për të cilat ne kemi (shpesh ndërmjetësuar) dëshira (të krijuara nga vegjime dhe metafora mbizotëruese rreth nesh), të ardhme për të cilat mund të kemi punuar dhe/ose ndërmjetësuar, si dhe të ardhme të formuara me vetëdije, ose të ndjera në mënyrë të pavetëdijshme. Ideja e Inajatullahut për të ardhmen e “përdorur” dhe/ose “të mohuar” është një të njëjtën

35 Gupta, V. (2009, Prill 27). “On black elephants.” Vinay.howtolivewiki.com. Marrë nga <http://vinay.howtolivewiki.com/blog/flu/on-blackelephants1450>



gjatësi vale me këtë qasje ideore, por të ardhmet e njohura nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht një rrethanë të kundërt ose tjetërsuese.<sup>36</sup> E ardhmja e njohur është vendi ku përqendrohet pjesa më e madhe e punës dhe e kërkimit të së ardhmes, veçanërisht pasi “vegimet” ose “përfytyrimet” e së ardhmes mbeten në thelb të Studimeve të së Ardhme.<sup>37</sup> Planveprimet e zhvilluara për të parashikuar ose përfytyruar të ardhmen(et) e Internetit – pavarësisht nga horizonti kohor – përputhen plotësisht me këtë horizont. Ideja e mirënjohur e Talebit për “mjellmën e zezë” kap thelbin e kësaj të nesërmeje.<sup>38</sup> Në ndryshim nga elefantët e zinj të së tashmes së tejzgjatur, mjellmat e zeza në të ardhmen(et) e njohura nuk janë të dukshme apo të qarta, madje edhe për njohësit e fushës, që do të thotë se ato mund dhe duhet të duken gjoja “të paqarta”. Por, siç vëren Talebi, ato kanë kuptim sipas shprehjes: kur të vijë mendtë. s’i hanë aq qentë.

Së fundi, të ardhmet e pamenduara përbëjnë të nesërmen e tretë. Këto të ardhme mbeten jashtë kuadrin të mendimit në fuqi dhe kjo e nesërme e detyron njeriun të rishqyrtojë vetë fillosat e botëkuptimit të dikujt dhe hamendësimet që theksojnë parapëlqimet tona rreth asaj që mund të vijë më pas. Si e tillë, e ardhmja(et) e pamenduara është thellësisht një hapësirë e mundësisë së pastër – nuk është e papërfytyrueshme, siç na lë të kuptojmë titulli, por më tepër një hapësirë e populluar me të ardhme të larmishme, në dukje të pafundme. Çdo gjë shkon, si të thuash, në të ardhmen(et) e pamenduara dhe ka gjithmonë pyetje që duhen bërë për këto të ardhme(t). Për të llogaritur këtë gjallëri, unë zhvillova idenë e “kandilit të zi”, për të kapur thelbin e këtij horizonti.

Siç mund të shihet në shembujt e hyrjes, kohët pasnormale kërkojnë që ne t’i kushtojmë vëmendje ndërlimit të dukurive të mëdha dhe të vogla. Ashtu sikurse elefanti i zi dhe mjellma e zezë, edhe kandilat e zinj të detit kanë “ndikueshmëri të lartë”, por ato janë dukuri “normale”, të shtyra drejt një gjendjeje pasnormale nga të dhëna të sigurta, ose nga rritja ekonomike që çon drejt paqëndrueshmërisë së vazhdueshme. Siç shpjegon Sardar:

Meqenëse gjithçka është e lidhur dhe e kyçur në rrjet me çdo gjë tjetër, një ngecje, kudo qoftë, ka një ndikim zinxhir, duke shqetësuar pjesët e tjera të rrjetit, madje duke shembur të gjithë rrjetin. Për më tepër, mundësia për të dhëna të sigurta, që gjërat të shumohen me shpejtësi dhe në mënyrë të rrezikshme në progresion gjeometrik,

36 Inayatullah, S. (2008). Six pillars: *Futures thinking for transforming*. *Foresight*, 10 (1), 4–21. doi: 10.1108/14636680810855991

37 Dator, J. (2009). The unholy trinity, plus one. *Journal of Futures Studies*, 13 (3), f. 33–48.

38 Taleb, N.N. (2007). *The black swan: The impact of the highly improbable* (1st ed). New York: Random House.



është e madhe. Këtu fillojnë të futen në përdorim ato kushte fillestare të vogla, të parëndësishme, që mund të shkaktojnë trazira të mëdha, madje edhe një ndryshim i vogël mund të çojë drejt rrënojave me një shpejtësi përsheptuese.<sup>39</sup>

Kur vendosen përkrah njëri-tjetrit, elefantët e zinj, mjellmat e zeza dhe kandili i zi detit formojnë thelbin e analizës së brendshme të *tri të nesërmeve* dhe përbëjnë varganin e larmisë pasnormale të Qendrës për Përqasje Pasnormale dhe Studime të së Ardhmes. Tri pjesët në vazhdim përshkruajnë disa elefantë të zinj, mjellma të zeza dhe kandila të zinj deti, të cilët shtyjnë dhe peshojnë www-të.

## ELEFANTËT E ZINJ TË SË TASHMES SË TEJZGJATUR

Në vitin 2013, një faqe sondazhesh në internet ia doli të bindë 2.403 prindër për t'iu nënshtuar një pyetësi rreth përdorimit të pajisjeve elektronike të fëmijëve të vegjël. 86% e të pyeturve, një shifër e jashtëzakonshme, por ndoshta jo dhe aq befasuese, pranuan se përdornin një telefon dore, ose për të qetësuar, ose për t'u kujdesur për një fëmijë të mërziur.<sup>40</sup> Përafërsisht në të njëjtën kohë me pyetësin, Akademia Amerikane e Sëmundjeve të Fëmijëve bëri një njoftim me shkrim të titulluar: *Fëmijët, Adoleshentët dhe Mediat*. Njoftimi i nxiste prindërit që t'i "mbanin larg ekraneve mediatike fëmijët nën dy vjeç".<sup>41</sup> Duke qenë se përhapja në rritje e telefonave dhe tabletave është një dukuri e kohëve të fundit, nuk ka studime afatgjata që mund të vërtetojnë, apo edhe të hamendësojnë, mbi ndikimet apo një varg dëmtime, megjithëse janë bërë thirrje të shumta për ta ndrequr këtë shkelje. Duke shkruar në revistën *Pediatrics*, Radesky, Schumacher dhe Zuckerman<sup>42</sup>, mendojnë se:

Nevojiten udhëzime të reja, ngaqë ndërmjetësimi përmes telefonit të dorës ndryshon nga televizioni, për nga mënyrat e tij të shumta (p.sh., video, lojëra, përdorime edukative), aftësitë ndërvepruese dhe pothuajse e kudondodhur në jetën e fëmijëve.

- 39 Sardar, Z. (2010). Welcome to Postnormal Times. *Futures*, 42 (5), 435–44. doi:10.1016/j.futures.2009.11.028
- 40 Amodio, Mi. (2013, Qershor 27). *High-tech babysitters: Gadgets as attention grabbers for little ones*. Marrë nga <http://zone.tmcnet.com/topics/articles/343806-high-tech-babysitters-gadgets-as-attention-grabberslittle.htm>
- 41 Council on Communications and Media. (2013). Children, adolescents, and themedia. *Pediatrics*, 132(5), 958–61. doi:10.1542/peds.2013–2656
- 42 Radesky, J.S., Schumacher, J., & Zuckerman, B. (2015). Mobile and interactive media use by young children: The good, the bad, and the unknown. *Pediatrics*, 135(1), 1–3. doi:10.1542/peds.2014–2251



Udhëzimet rreth përdorimit nga foshnjat, fëmijët e vegjël dhe fëmijët e moshës parashkollore, janë veçanërisht të rëndësishme, sepse ndikimet e shkaktuara nga qëndrimi para ekranit mund të jenë më të theksuara te ky grup moshash.<sup>43</sup>

Ndërsa ndikimet e www-së mbeten hamendësime, jo të gjithë njohësit e fushës pajtohen se çfarë paralajmëron digjitalizimi në rritje i lojërave, ose i vetë jetës, për (shumicën, por jo të gjithë) fëmijët. Siç vërejnë Holloway, Green dhe Livingstone<sup>44</sup>:

Mbrojtësit e fëmijëve dhe komentuesit e medias priren të fajësojnë çdo teknologji të re (televizion, kompjuter, platforma lojërash, ekrane me prekje) që, sipas tyre, ua merr gjithë kohën të cilën, përndryshe, fëmijët mund ta shpenzonin duke luajtur, shpesh, pa marrë parasysh ndryshimet e tjera ekonomiko-shoqërore që kanë gërryer në mënyrë të vazhdueshme kohën e lojës së fëmijëve gjatë brezave të fundit. [Ginsburg, 2007]. Për shembull, prindërit që punojnë, priren të kenë më pak kohë për të mbikëqyrur fëmijët, kur luajnë jashtë [Mc Bride, 2012]. Brezat e prindërve kanë rritur kufizimet e vendeve ku fëmijët mund të luajnë pa mbikëqyrje [Lou, 2005; Tandy, 1999] dhe loja e vetvetishme është zëvendësuar në mënyrë të vazhdueshme nga veprimtari të organizuara prej të rriturve [Skår & Krogh, 2009]. Ky pakësim i ngadaltë i mundësisë së fëmijëve për të luajtur, vë në pikëpyetje pohimin se teknologjitë e argëtimit me baza shtëpiake janë apo jo arsyeja e vetme, apo edhe kryesore, për pakësimin e lojës së vetvetishme.<sup>45</sup>

Duke pasur parasysh kufizimet e ndasisë digjitale, që do të thotë se vetëm gjysma e botës ka hyrë ndonjëherë në www, ndikimet e shtimit të kohës së shpenzuar para ekranit duket që janë padyshim krahinore – vetëm në rast se eksperimentet e Nikolas Negropontes, në Afrikë, shtrihen më gjerë.

Në vitin 2012, nisma e tij: *një laptop për çdo fëmijë*, hodh mbi dy fshatra të largëta në Etiopi *tablete Androidë*, të paketuara në kuti. Siç pohon Talbot<sup>46</sup>, “qëllimi ishte të shihej nëse fëmijët analfabetë që nuk e dinin se

43 Po aty.

44 Holloway, D., Green, L. & Livingstone, S. (2013). *Zero to eight: Young children and their Internet Usage*. EU Kids Online. Londër: Londër School of Economics. Për më shumë shih: Ginsburg, K. (2007). The Importance of Play in Promoting Healthy Child Development and Maintaining Strong Parent-Child Bonds. *Pediatrics*, 119(1), f. 182-191; McBride, D.L. (2012). Children and Outdoor Play. *Journal of Pediatric Nursing*, 27(4), f. 421-422; Lou, R. (2005). *Last Child in the Woods: Saving Our Children from Nature-Deficit Disorder*. New York: Algonquin Books; Tandy, C.A. (1999). Children’s Diminishing Play Space: a Study of Inter-generational Change in Children’s Use of their Neighbourhoods. *Australian Geographical Studies*, 37(2), f. 154-164; Skår, M., dhe Krogh, E. (2009). Changes in children’s nature-based experiences near home: from spontaneous play to adult-controlled, planned and organised activities. *Children’s Geographies*, 7(3), f. 339-354.

45 Po aty.

46 Talbot, D. (2012, Tetor 29). “Given tablets but no teachers, Ethiopian children teach Themselves.” mit Technology Review. Marrë nga [www.technologyreview.com/news/506466/given-tablets-but-noteachers-ethiopian-children-teach-themselves/](http://www.technologyreview.com/news/506466/given-tablets-but-noteachers-ethiopian-children-teach-themselves/)





çfarë është fjala e shkruar, mund të mësonin se si të lexonin vetë, duke eksperimentuar me tabletin dhe lojërat alfabetike të ngarkuara paraprakisht, si libra elektronikë, filma artistikë e vizatimorë, piktura dhe programe të tjera”.<sup>47</sup> Me sa duket, eksperimenti i Negropontes “ishte i dobishëm” dhe fëmijët filluan të përdornin pajisjet dhe të hynin në programe për të mësuar, gjë që u vërtetua nga teknikët, kur mblodhën kartat e kujtesës së pajisjes. Sidoqoftë, në vitin 2014, shpresa u bë realitet, pasi të dhënat për rënie të theksuar të përdorimit dhe rendimente të dobëta në krahina të tjera e gjymtuan fillimin, dikur të vrullshëm. Duke u përqendruar te projekti *një laptop për çdo fëmijë*, hodhën edhe 570 mijë laptopë në Uruguaj. Mirëpo të dhënat nga studiuesit në *Institutin Ekonomik të Universidad de la República*, treguan se nisma nuk pati asnjë ndikim “në notat e provimeve të gjuhës dhe matematikës. Kjo përputhej me vlerësimet për Izraelin, Perunë, Rumaninë, Nepalën dhe SHBA-në (Karolinën e Veriut)”.<sup>48</sup> Përveç mungesës së ndikimit në zhvillimin arsimor të atyre që morën pjesë në nismën *një laptop për çdo fëmijë*, ka pak (mbase asnjë) prova që na lënë të kuptojmë se kjo nismë mori ndonjë masë paraprake, lidhur me ndikimin që mund të kenë tablete të tilla nga pikëpamje të ndryshme shoqërore-kulturale, si: Çfarë lidhjeje ngjitëse mund të lindë nga ndërhyrje të tilla? Ndërsa fëmijët pjesëmarrës në këto eksperimente rriten, çfarë ndikimesh mund të shfaqen?

## MJELLMAT E ZEZA TË SË ARDHMEVE TË NJOHURA

Nuk mungojnë planveprimet për të ardhmen e internetit. Në të vërtetë, një varg studimesh që prodhojnë një sërë të ardhmesh të besueshme, bindëse, të mundshme dhe të parapëlqyera janë lehtësisht të gatshme.<sup>49</sup>

47 Talbot, D. (2012, Tetor 29). “Given tablets but no teachers, Ethiopian children teach Themselves.” mit Technology Review. Marrë nga [www.technologyreview.com/news/506466/given-tablets-but-noteachers-ethiopian-children-teach-themselves/](http://www.technologyreview.com/news/506466/given-tablets-but-noteachers-ethiopian-children-teach-themselves/)

48 Mejía, F. (2014, Shtator 19). “Laptops, children and Darth Vader.” *Development That Works*. Marrë nga [http://blogs.iadb.org/desarrolloefectivo\\_en/2014/09/19/laptops-children-darth-vader/](http://blogs.iadb.org/desarrolloefectivo_en/2014/09/19/laptops-children-darth-vader/)

49 Blackman, C., Brown, I., Cave, J., Forge, S., Guevara, K., Srivastava, L., Tsuchiya, M., & Popper, R. (2010). *Towards a future Internet: Interrelation between technological, social and economic trends*. Oxford, UK: Oxford Internet Institute. Marrë nga [www.internetfutures.eu/wp-content/uploads/2010/11/tafi-Final-Report.pdf](http://www.internetfutures.eu/wp-content/uploads/2010/11/tafi-Final-Report.pdf); Burns, A., & McGrail, S. (2012). Australia’s potential Internet futures: Incasting alternatives using a new technology images framework. *Journal of Futures Studies*, 16 (4), f. 33–50; Creech, H., Andjelkovic, M., Vetter, T., MacLean, D., Rothman, D., & Vergragt, F. J. (2009). *Mapping the future of the Internet onto global scenarios: A preliminary view*. Winnipeg, Canada: International Institute for Sustainable Development; Rueda-Sabater, E., & Derosby, D. (2011). *The evolving Internet in 2025: Four scenarios*. Strategy & Leadership, 39 (1), f. 32–38. doi: 10.1108/10878571111095402





Megjithatë, plot prej tyre, nëse jo shumica, përqendrohen vetëm në internet, që do të thotë infrastruktura, pajisjet dhe shërbimet e ndryshme që e rrethojnë atë, në vend që të merren me fuqinë ndikuese të www-së, me përjashtim të disa përsiatjeve rreth zbutjes së ndikimeve të www-së. Instituti i Internetit në Oxford, *Drejt një Interneti të Ardhshëm dhe Ndërlidhja mes Prirjeve Teknologjike, Shoqërore dhe Ekonomike*, kanë dalë me përfundime mbi nevojat dhe drejtimit e ardhshme, duke nxjerrë në pah 11 shtytësit kryesorë, duke përfshirë: “Ndikimet mjedisore, për mirë dhe për keq, në nivele vetjake dhe mbarëbotërore”.<sup>50</sup> Megjithëse shkresa përmend shërbimet shëndetësore dhe kujdesin shëndetësor në mënyrë të përsëritur, ajo kurrë nuk bën një lidhje të qartë midis ndërveprimeve të ndryshme në www dhe mundësisë për një varg ndikimesh zhvillimore dhe psiko-shoqërore, megjithëse një lexim zemërgjerë i shtysës së mësipërme mund të shtrihet deri te ndikimet vetjake dhe mjedisore. Në të njëjtën mënyrë, një përmbledhje nga Instituti Ndërkombëtar për Zhvillim të Qëndrueshëm vëren:

Ndërsa çështjet e energjisë dhe rrezatimit mbizotërojnë, tashmë shtjellimet rreth gjurmës që le interneti, më pak të dukshme, por me shqetësim mjaft të madh, janë çështjet rreth materialeve të shpenzuara në prodhimin e pajisjeve dhe ndërlikimet lidhur me mbetjet elektronike, duke përfshirë rrezatimin dhe asgjësimin e lëndëve të rrezikshme që gjenden në prodhimet elektronike.<sup>51</sup>

Ndërsa shumica, nëse jo të gjitha, vegimet e së ardhmes së internetit përqendrohen rreth kyçes sa më shpejt në rrjet, shërbimeve dhe infrastrukturës, mjellmat e zeza brenda këtij horizonti duhet të bien diku brenda puqjes së ndikimeve të mundshme të www-së me lëndën e lartpërmendur të internetit. Për më tepër, duke pasur parasysh synimin e gjithanshëm për siguri në internetit – nga fshehtësia vetjake, deri te lufta kibernetike – krijimi i një *mundësie çasti* të çuditshme, e cila mund të veprojë si shtytje drejt të ardhmes(ve) të njohura, brenda kësaj fushe është e rëndësishme. Ndonjëherë, megjithatë, mënyra më e mirë për të parë përpara përfshin zbrërthimin e vegimeve të së kaluarës për të ardhmen.

Vepra e Zbigniew Brzezinski, *Midis dy epokave: Roli i Amerikës në Epokën e Teknologjisë së të Dhënave*<sup>52</sup>, ofron një pamje gjithëpërfshirëse të një varg

50 Blackman, C., Brown, I., Cave, J., Forge, S., Guevara, K., Srivastava, L., Tsuchiya, M., & Popper, R. (2010). *Towards a future Internet: Interrelation between technological, social and economic trends*. Oxford, UK: Oxford Internet Institute. Marrë nga [www.internetfutures.eu/wp-content/uploads/2010/11/tafi-Final-Report.pdf](http://www.internetfutures.eu/wp-content/uploads/2010/11/tafi-Final-Report.pdf)

51 Creech, H., Andjelkovic, M., Vetter, T., MacLean, D., Rothman, D., & Vergragt, F. J. (2009). *Mapping the future of the Internet onto global scenarios: A preliminary view*. Winnipeg, Canada: International Institute for Sustainable Development.

52 Brzezinski, Z. (1970). *Between two ages: America's role in the technetronic era*. New York: The Viking Press.



mundësish në të ardhmen. Duke vënë në dukje përparimin e Amerikës drejt një shoqërie teknologjike, Brzezinski përshkruan ardhjen e një shoqërie “që është formuar kulturalisht, mendërisht, shoqërisht dhe ekonomikisht, si pasojë e ndikimit të teknologjisë dhe elektronikës, veçanërisht në fushën e kompjuterëve dhe ndërlidhjeve”.<sup>53</sup> Megjithëse parashikimi i Brzezinskit nënkupton teknologjitë e ndërlidhjes në rrjet, vëmendja e tij ndaj sigurisë dhe militarizmit vlen të përmendet dhe lidhet drejtpërdrejt me synimin e këtij hetimi, lidhur me ndikimin. Duke cituar Gordon J. F. Mac Donald, Brzezinski shkruan:

Mund të jetë e mundur dhe joshëse të shfrytëzohen për qëllime strategjike-politike dobitë e kërkimit mbi trurin dhe sjelljen njerëzore. [...] ‘Dikush mund të zhvillojë një sistem që do të dëmtonte thellësisht rendimentin e trurit të popullatave shumë të mëdha në krahina të caktuara për një periudhë të gjatë’ [...].<sup>54</sup>

Fakti që thirrja e Brzezinskit për luftën mjedisore erdhi në të njëjtën kohë, kur Shtetet e Bashkuara u angazhuan në detyra të fshehta të mbjelljes së reve, gjatë angazhimit të tyre në Vietnam, për të prodhuar më shumë shi dhe për të ndërprerë rrugët e furnizimit, flet për natyrën parashikuese të punës së tij dhe prirjen për mundësi me ndikim të gjerë.<sup>55</sup>

Një mundësi e tillë shërben si themel i një planveprimi të hartuar nga Dunagan, i cili shkruan: “Një tjetër sulm terrorist shkatërrues çon jo vetëm drejt qasjes së ndërgjegjësimit tërësor të të dhënave nervore, por për ligj zotërimin e mendjes së armikut si strategji lufte. Drogat që ndryshojnë mendjen dhe teknologjitë nervore të armatosura, bëhen veprime standarde ushtarake”.<sup>56</sup> Ndërsa përdorimi i teknologjive të tilla nga shteti - dhe veçanërisht ushtria - nuk do të përbënte ndonjë vështirësi të madhe për t’u besuar nga dikush, ose të shërbente si një mjellmë e zezë e përshtatshme, veçanërisht duke pasur parasysh historinë mjaft të pasur të CIA-s në lojën me zjarrin, siç është sipërmarrja MKULTRA.<sup>57</sup> Jo vetëm kaq, mundësia për të ndërmarrë një nismë të tillë nga dikush që nuk ka lidhje me shtetin, por që është i aftësuar në teknologjitë bashkëkohore të ndërmjetësimit, duke përdorur një

53 Po aty.

54 Po aty.

55 Simons, F. (2001, Shtator 23). “Controlling the weather.” *The Guardian*. Marrë nga [www.guardian.co.uk/environment/2001/sep/24/weather.climatechange](http://www.guardian.co.uk/environment/2001/sep/24/weather.climatechange)

56 Dunagan, Jake F. (2010). “Politics for the Neurocentric Age.” *Journal of Futures Studies* 15 (2): 51–70.

57 Select Committee on Intelligence, and Committee on Human Resources. (1977). Project mkultra, the cia’s program of research in behavioral modification. Washington, D.C.: 95th Congress. Marrë nga <http://web.archive.org/web/20071128230208/www.arts.rpi.edu/~pellr/lansberry/mkultra.pdf>



sërë faqesh ndërveprimi në www, padyshim që i përshtatet këtij qëllimi. Po sikur vëmendja e njerit prej këtyre njerëzve të kthehet nga përvetësimi i armëve bërthamore, biologjike dhe/ose kibernetike, tek armët e fshehta *nervore-trupore*, duke përdorur faqet ndërvepruese të tanishme www? A do të ishte e mundur që dikush t'i armatosë rrjetet shoqërore?

## KANDILI I ZI I DETIT I TË ARDHMES(VE) TË PAMENDUARA

Gjatë dhjetë vjeçarit të fundit, popullsia e *Green Bank*, Virxhinia Perëndimore, është rritur me 147 banorë. Ndërsa mjediset e qeta në *Green Bank* janë arsye të mjaftueshme për të joshur njerëzit që kërkojnë një pjesë të qytezave të vogla amerikane, të gjitha ndërtesat e përkohshme më të fundit të këtij fshati të vogël u zhvendosën për shkak të qëndrimit të banorëve përbrenda hapësirës Radio Kombëtare Zona e Qetë. Kjo zonë e qetë ishte zhvilluar nga Komisioni Federal i Ndërlidhjeve, që në vitin 1958, dhe synonte ta mbante atë larg vëmendjes dhe sa më të fshehur. Brenda 13.000 milje katrore, hapësira strehonte antena marrëse të radio-valëve, si dhe pajisje të inteligjencës ushtarake. Por, si mund të durojnë njerëzit në ditët e sotme, pa hyrë në www? Pse dikush do të dëshironte të jetonte në një bashkësi ku shumica e ndërlidhjeve elektronike shfrytëzohen përmes një rregulloreje të rreptë? Edhe pse ndjeshmëria e lartë elektromagnetike mbetet një përcaktim mjekësor i panjohur, shumë prej banorëve ankohen rreth përkeqësimit të shëndetit: dhimbje koke, lodhje dhe ndjesi djegieje, mbështetur në shkallën e ndryshimit të ndjeshmërisë ndaj fushave elektromagnetike. Për shumë viktime të ndjeshmërisë së lartë elektromagnetike, diçka e tillë, si rrezatimi i nivelit të ulët, nuk vlen. Edhe dozat e vogla të rrezatuara nga telefonat e dorës janë të mjaftueshme për të sjellë një varg shenjash të dhimbshme.

Por, siç pohon Stromberg, “parashikuesi më i mirë, nëse një njeri me ndjeshmëri të lartë do të përjetojë ndonjë shenjë, nuk është prania e radio-valëve, por është besimi se një pajisje është ndezur diku pranë”.<sup>58</sup> Për më tepër, përfundimet e studimeve të ndryshme provokuese tregojnë për shkakun më të pakapshëm - *ndikimin*. Siç sqaron Mild et al:

58 Stromberg, J. (2013, Prill 12). “Refugees of the modern world.” Slate. Marrë nga [www.slate.com/articles/technology/future\\_tense/2013/04/green\\_bank\\_w\\_v\\_where\\_the\\_electrosensitive\\_can\\_escape\\_the\\_modern\\_world.single.html](http://www.slate.com/articles/technology/future_tense/2013/04/green_bank_w_v_where_the_electrosensitive_can_escape_the_modern_world.single.html)



Kur studiohet ngacmimi përmes ushqimeve, ngacmimi përmes barnave apo gjallesave që të rrethojnë, pra, prirja për të vepruar në ndjeshmëri, apo detergjenteve shtëpiake, aromave dhe fushave elektromagnetike, gjithçka kryhet në kushte metodologjike të shëndosha, pa dhënë asnjë lloj sqarimi. Pra, njerëzit që provohen, mendojnë se po mjekohen përmes kokrrave apo ndërhyrjeve të ndryshme, kur, në të vërtetë, ilaçi që marrin, shërben për të matur ngacmimet e lart përmendura. Por shenjat e kundërveprimit ndaj ngacmuesve nuk përputhen asnjëherë me atë që vërtet mund të shkaktojnë këta ngacmues te këta njerëz. Ngatërresa është e qartë; kundërveprimet merren me mend dhe janë të ndër-mjetësuar nga njohuritë e mëparshme, të mbështetura te përvoja.<sup>59</sup>

Nëse viktimat e ndjeshmërisë së lartë magnetike nuk janë të ndjeshme ndaj fushave magnetike, por, përkundrazi, ndaj pranisë së përfytyruar të këtyre fushave, atëherë shkaku i gjendjes është pakënaqësia therëse nervore-trupore. Kjo është një mënyrë tjetër për të thënë se ndjeshmëria e lartë elektromagnetike ndikohet nga lidhja ngjitëse që prek njerëz të ndryshëm - duke përfshirë disa fëmijë - në mënyra të ndryshme. Siç thotë Mc Carty et al, “brenda mundësive të studimit, ne vërtetuaam sëmundjen nervore-trupore të njeriu që studiuam. Çështja, nëse ndjeshmëria e lartë ndaj fushës elektromagnetike përbën një shqetësim të rëndësishëm për shëndetin e qytetarëve, nuk u trajtua në këtë studim”.<sup>60</sup> Është e pamundur të shqyrtohet mundësia që ndjeshmëria e lartë elektromagnetike të shndërrohet në një “shqetësim të madh për shëndetin e qytetarëve”, pa u shkuar sipas qejfit një vargu teorish të fshehta dhe të dëmshme. Megjithatë, kjo është pikërisht ajo që kërkojnë të ardhmet e pamenduara.

Kandili i zi i detit ka të bëjë me masën. Ai kërkon që dikush të marrë diçka të vogël dhe ta përfytyrojë atë në një shkallë shumë më të madhe dhe më me ndikim. Po sikur 10%, 20% ose 30% e popullsisë botërore të përjetonte sëmundjen e ndjeshmërisë së lartë elektromagnetike? Po sikur lëvizjet dhe shtysat kryesore të mohuesve të klimës dhe lëvizja më e fundit kundër vaksinimit të zbatoheshin në eksperimentin e fushës elektromagnetike? Shkurtimisht, po sikur njerëzve t’u tregohej e vërteta që rrethon ndikimet e nuhatura (dhe jo ato të vërtetat) të fushave elektromagnetike? A mund të zgjerohej zona e qetë e radio-valëve? A mund të kthehen të prekurit në refugjatë? Si mund të përplasen dhe të konkurrojnë

59 Staudenmayer, Herman (2006). “Idiopathic Environmental Intolerance (iei): A Causation Analysis.” In *Electromagnetic Hypersensitivity: Proceedings International Workshop on emf Hypersensitivity*, edited by Kjell Hannson Mild, Mike Repacholi, Emilie van Deventer dhe Paolo Ravazzani. Prague, Czech Republic: World Health Organization. Tetor 25–27, 2004.

60 McCarty, D.E., Carrubba, S., Chesson, A.L., Frilot, C., Gonzalez-Toledo, E., & Marino, A.A. (2011). Electromagnetic hypersensitivity: Evidence for a novel neurological syndrome. *International Journal of Neuroscience*, 121(12), 670–76. doi:10.3109/00207454.2011.608139



synimet kombëtare dhe ndërkombëtare mbi ndikimet e shëndetit të qytetarëve? Kërkime të tilla janë qartësisht të papërfytyrueshme, por pasojat e mundshme kërkojnë që njeriu të përballet me atë që s'ia merr mendja.

## PLANET E VEPRIMIT

### *E tashmja e tejzgjatur*

Ajo që filloi si shfryrje dufi e disa prindërve në internet, shumë shpejt u shndërrua në themelin e një lëvizjeje që kërkon përgjigje. Një pandemi e pashpjegueshme ka bërë që shkencëtarët të kruajnë kokën, ngaqë mijëra fëmijë në 27 vende po shfaqin një sërë sjelljesh të çuditshme, nga gulçima të pakontrollueshme, deri në gjendje ankthi. I vetmi emërues i përbashkët që lidh të prekurit, është shfrytëzimi i një përdoruesi mjaft të përhapur të mësimit të gjuhës që në fëmijërinë e hershme, i cili u shndërrua në dukuri mbarëbotërore, në vitin 2018. Nga mesi i vitit 2019, përdoruesi ishte shkarkuar miliona herë, megjithëse menjëherë nxiti paralajmërime nga njohës të fushës së mjekësisë, të shqetësuar për ndërveprimin e tij tërheqës dhe rrezikun nga varësia. Shumë shkencëtarë të nderuar folën në kulmin e zhurmës, por shqetësimet e tyre të arsyeshme u shurdhuan nga brohoritjet e prindërve që brohorisnin arritjet e kënaqshme zhvillimore të fëmijëve të tyre. Një hetim nga Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve nuk ka dhënë ende ndonjë vlerësim përfundimtar dhe udhëheqësit politikë kanë mbajtur takime të shumta dëgjimore, në një përpjekje për të qetësuar votuesit e zemëruar. Tubimet po bëhen gjithnjë e më të dhunshme, pasi prindërit e tërbuar dalin në rrugë të zemëruar. Ndërsa takimet ndërkombëtare të nivelit të lartë po zhvillohen për të shqyrtuar masat shumëpaleshe për parandalimin e përhapjes së kësaj ndodhie, disa prej tyre tashmë parashikojnë ndodhinë e radhës.

### *E ardhmja(et) e njohura*

Pas daljes së mijëra shkresave shumë të ndjeshme qeveritare, lidhur me një skandal tjetër rreth një informatori, një njoftim mbi programin e fshehtë të paguar nga qeveria po ringjall zemërimin midis prindërve të pikëlluar që humbën fëmijët e tyre gjatë një pandemie të çuditshme, e cila goditi rreth



një dekadë më parë. Duke mbajtur shënim përfshirjen e qeverisë në përkrahjen e hulmimit dhe zhvillimit të teknologjisë që ndihmon çrregullimet nervore, nëpërmjet një vargu ndërveprimesh të mediave në internet, të cilat më vonë u përdorën për të ndërtuar *përdoruesin risi* për mësimin e fëmijëve, shkresa vë në dukje, gjithashtu, se si teknologjia ishte pjesë e një sasive të dhënash që humbën gjatë një sulmi të hatashëm kibernetik, në vitin 2028. Megjithëse kjo hollësi u varros që në lajmet fillestare, organizatat shëndetësore dhe një numër veteranësh kanë bërë presion për më shumë të dhëna dhe shpejtësi veprimi në dritën e sëmundjes së çuditshme nervore, të përjetuar nga mijëra ushtarë që kanë shërbyer në Afrikë, gjatë një numri ndërhyrjesh ushtarake të udhëhequra nga Kombet e Bashkuara, në vitet 2030. Duke e ndërlikuar rrethanën, një grup vendas i shquar ekstremist ka shpallur agimin e një epoke të re luftimi dhe të dalldisur kanë theksuar se si “armët e reja” do t’ua sigurojnë fitoren dhe do t’i lejojnë ata të kryejnë sulme vdekjeprurëse në shkallë të gjerë jashtë vendit.

### *E ardhmja(et) e pamenduara*

Kur filloi të përhapej lajmi mbi përmbajtjen e një videoje të gjetur nga një grup ekstremist, që njoftonte për një sulm në qytetin e Nju Jorkut, duke përdorur një armë të papërballueshme e të padukshme, shumë vetë, duke përfshirë zyrtarë të lartë të qeverisë, e nënvlerësuan menjëherë kërcënimin. Ndërsa qeveria u përgjigj me qetësi, përgjigjja e qytetarëve ishte frika. E nxitur nga hamendësimet e shfrenuara dhe përvoja me shpërthimet e dyshimta në të kaluarën e afërt, duke përfshirë edhe të dhëna të dëmshme nga një varg shkresash të zbuluara, frika u shndërrua në ndrojtje, ndërsa mijëra filluan të kërkonin ndihmë mjekësore për një sërë sëmundjesh. Duke kërkuar mjekim për çdo gjë - nga dhimbje koke të lehta, por të përsëritura, deri te të vjella - të prekurit nuk donin ta besonin se ishin mirë, edhe pse shumë prej tyre, nëse jo shumica, u cilësuan nga mjeku të shëndoshë. Grupet e mbështetjes në internet për të prekurit u rritën fuqishëm, të nxitur edhe nga teoria se mbrojtja e vetvetes nga elektronika, veçanërisht nga pajisjet që vihen në veprim përmes internetit, do të ofronte lehtësim. Ajo që filloi me mërgimin e disa familjeve, u shndërrua shpejt në zhvendosjen e mijëra njerëzve që kërkonin strehim dhe qeveria u detyrua të ofronte ndihmë për kampet që ishin ngritur qëllimisht nëpër rrethina. Ndërlidhja me kampet ka qenë thujtë e pamundur, për shkak të rregullave të rrepta kundër-elektronike dhe rrethit të sigurisë së këtyre kampeve.



## GJALLËRIA DHE PESHIMI I SË ARDHMES

**NDIKIMET JANË PREDHA, NJËSOJ SI ARMËT; NDJENJAT JANË NJË LLOJ SHTYTSE. [...] ARMËT JANË NDIKIM DHE NDIKIMET JANË ARMË.**<sup>61</sup>

Zbulimi i virusit *Stuxnet* nga qytetarët, i cili ishte ngjizur për të gjymtuar programin bërthamor të Iranit, befasoi shumë njerëz dhe tërhoqi vëmendjen e mediave ndërkombëtare. Disa prej tyre e shpallën hyrjen e tij në skenën ndërkombëtare si një “luftë të hapur kibernetike”<sup>62</sup> dhe mbërritja e një “arme kibernetike të shkatërrimit në masë”.<sup>63</sup> Ndërsa *Stuxnet* ishte ngjizur me një qëllim shumë të qartë në mendje, më vonë është lëshuar “ngado” dhe, që atëherë, ka molepsur një reaktor bërthamor rus dhe Stationin Ndërkombëtar të Hapësirës.<sup>64</sup> Duke shkruar mbi natyrën e një virusi kompjuterik, Sampson mendon se:

Virusi digjital është si një mbytje anijeje apo përplasje avioni, që njihet si pjesë përbërëse e teknologjisë nga e cila erdhi: një ndodhi me prejardhje të njohur. Me fjalë të tjera, është shpikja e rrjetit që “nxit” ngjarjen, sepse mundësia e ngecjes diku ekzistonte paraprakisht, fuqia-paraprake që gjendet në thelbin e shpikjes së tij.<sup>65</sup>

Ashtu si rrjetet e molepsura nga një virus kompjuterik, njerëzimi ynë i brishtë është, gjithashtu, i prirë ndaj ngjarjeve fatkeqe. Por *ndikimi* si ngjarje që ti e ndjell vetë, është vetëm një mënyrë për të lexuar gjallërimin e sëmundjes psikologjike që u përhap në Le Roy. Zbulimi nga fëmijët e vegjël dhe përdorimi i faqeve ndërvepruese www, mundësia e njerëzve jashtë strukturave shtetërore, që të përdorin armë nervore-trupore dhe përshkallëzimi i mundshëm i ndjeshmërisë së lartë elektromagnetike, drejt një shqetësimi të rëndësishëm për shëndetin e qytetarëve. Ka

- 
- 61 Deleuze, G., & Guattari, F. (1987). *A thousand plateaus: Capitalism and schizophrenia*. Minneapolis: University of Minnesota Press.
  - 62 Gross, M.J. (2011, Prill). “A declaration of cyber-war.” Vanity Fair, Marrë nga [www.vanityfair.com/news/2011/04/stuxnet-201104](http://www.vanityfair.com/news/2011/04/stuxnet-201104)
  - 63 Langner, R. (2011, Mars). “*Transcript of ‘Cracking Stuxnet, a 21st-Century Cyber Weapon.’*” ted. Marrë nga [www.ted.com/talks/ralph\\_langner\\_cracking\\_stuxnet\\_a\\_21st\\_century\\_cyberweapon/transcript](http://www.ted.com/talks/ralph_langner_cracking_stuxnet_a_21st_century_cyberweapon/transcript)
  - 64 Shamah, D. (2013, Nëntor 11). “*Stuxnet, gone rogue, hit Russian nuke plant, space station.*” *The Times of Israel*. Marrë nga [www.timesofisrael.com/stuxnet-gone-rogue-hit-russian-uke-plant-spacestation/](http://www.timesofisrael.com/stuxnet-gone-rogue-hit-russian-uke-plant-spacestation/)Stone, R.A. (1994). Split subjects, not atoms; Or, how I fell in love with my prosthesis. *Configurations: A Journal of Literature, Science and Technology*, 2 (1), f. 173–190
  - 65 Sampson, T.D. (2012). *Virality: Contagion theory in the age of networks*. Minneapolis: University of Minnesota Press.



mënyra të tjera për të lexuar këto dukuri të ndryshme, njëkohësisht të ndërlihdura.

Të gjitha dukuritë e mësipërme janë të rrënjësura brenda dredhive dinamike të lidhjes ngjitëse dhe secila mbështetet në shfrytëzimet nervore-trupore të natyrshme, në faqet ndërvepruese tepër njerëzore, me teknologjitë bashkëkohore www, që në themel ka internetin, me qëllimin e vetëm, që të jenë ngjitëse. Qeniet njerëzore kanë përdorur gjithmonë mjete për të rritur kufijtë e qenësisë sonë në botë, por gjithnjë e më shumë mjetet tona po bëhen proteza më të theksuara, të cilat paraqesin një varg mundësish të rëndësishme dhe ndoshta të padëshiruara . Më saktë, ndoshta ne po “bëhemi proteza” ku vetë veprimtaria shoqërore e të cilave është mbështetur në një sërë gjërash.<sup>66</sup> Siç vëren Stone, “shoqëria protezë nënkupton përkufizime të reja dhe shpesh të çuditshme të hapësirës, vëllimit, sipërfaqes dhe largësisë. Në veprimtaritë e një shoqërie *protezë*, mjete i lidhjes përcakton kuptimin e bashkësisë”. Po sikur mjete i lidhjes të jetë ngjitës? Po sikur disa të detyrohen të lidhen, ashtu siç disa u detyruan të kërcenin në rrugët e Strasburgut, në vitin 1518? Shkalla në të cilën ndikimi mund të veprojë si një shtysë kundrejt një peshe, drejt të ardhmes së www/internetit, mbetet për t’u parë. Një nga shqetësimet themelore të këtij shtjellimi, përqendrohet në faktin se si mund të zhvillohen ngjarje të tilla? Kjo kërkon një qasje më të gjallë ndaj planifikimit të qasjeve të larmishme drejt të ardhmes. Ndërsa pyetjet e parashtruara mund të duken shumë të mëdha, të ndërlikuara dhe të pazgjidhshme, kjo është pikërisht ajo që kërkojnë kohët pasnormale.

66 Dator, J.A., Sweeney, J.A., & Yee, A.M. (2015). *Mutative Media. Lecture Notes in Social Networks*. Cham: Springer International Publishing. <http://link.springer.com/10.1007/978-3-319-07809-0>







## Paditura, Pasiguria dhe 'Po sikur?'

Jerome Ravetz

Deri më tani, në përgjithësi pranohet se zemra e sipërmarrjes shkencore nuk është më zbulimi, përparimi fitimtar i njohurive të caktuara ndaj të panjohurës. Vetëm zëdhënësit e 'kuptimit qytetar të shkencës' mbeten ende të pavetëdijshëm, se çështjet kryesore për shkencën tani burojnë nga sfidat (dhe kërcënimet) që shfaqen si rrjedhojë e rritjes së verbër dhe të pakontrolluar të tërë sistemit tonë shkencor-teknik-industrial. Qoftë çështja mbarëborërore e rrezatimit të karbonit, ndryshimet klimatike, sëmundjet e shkaktuara nga dora e njeriut, lëndët e panjohura gjunjëzuese si *xeno-estrogens*, apo qoftë edhe pasojat shoqërore dhe kulturore të teknologjisë së vrullshme të të dhënave - si problemet, ashtu dhe mënyrat e duhura të zgjidhjes së tyre - janë të reja. Ato ndryshojnë rrënjësisht nga kërkimet tradicionale të shtyra nga kureshtja, apo nga grupet e zhvillimit të teknologjisë që anojnë drejt një qëllimi të caktuar. Le të shqyrtojmë pohimin e mëposhtëm:

Me çështje aq të ndërlikuara, sa ç'është ndikimi i veprimtarisë njerëzore në mjedisin natyror, kërkimi për të vërteta të thjeshta mund ta errësojë pasigurinë e vërtetësisë jetësore. Pothuajse çdo gjë që bëjmë, shpenzojmë ose i nënshtrohemi, ka disa rreziqe. Ne duhet të vendosim se me cilat rreziqe ka nevojë të merremi, me çfarë përparësie, në çfarë mënyre, në çfarë shkalle dhe me çfarë çmimi. Shkenca e mjedisit është e ndërlikuar; përshkrimi i të dhënave teknike dhe vlerësimi me hollësi i rrezikut është i vështirë, por ai pasqyron vërtetësinë e zgjedhjeve që shoqëria duhet të bëjë. Çështjet nuk janë të thjeshta dhe shkenca ka rëndësi.

Ata që më njohin përmes disa shkrimeve të mia të rëndësishme, do t'i kuptojnë disa prej temave, megjithëse ndoshta gjuha nuk është e njëjtë. Kjo thënie nuk është e imja, apo e ndonjë kritiku tjetër shkencor, veprimtar i mjedisit, por nga Dr. Kris Fej, Kryetar dhe Drejtor Ekzekutiv i *Shell UK Limited*. Ai e tha



këtë në maj të vitit 1966 dhe mund ta gjeni në faqen e internetit të *Shell-it*, me emrin '*brentspar*'.<sup>1</sup> Është e qartë se Dr. Fej mori mësim rreth çështjeve shoqërore të njohurive shkencore, të cilat nuk ishin lehtësisht të disponueshme në universitete, por që iu parashtruan papritur gjatë punës së tij.

Thënia na sjell ndërmend, se humbja e sigurisë dhe përfshirja në çështjet e moralit janë thelbi i kësaj sëmundjeje të të shkencës. Bashkë me 'të vjen edhe humbja e mbizotërimit të njohësve shkencorë të fushës së shqyrtimit dhe përqasjes së çështjeve të lidhura me shkencën. Një kuptim i arsyeshëm i kësaj rrethane të re po merr udhë vetëm tani. Sipas saj, ne mund të mbështemi në disa përbërës thellësisht tradicionale në studimet e shkencës që janë zhvilluar gjatë dhjetë vjeçarëve të fundit. Zbërthimi i plotë i Feyerabend-it, ndjekur nga studimet e dukurive shoqërore që e gjejnë shpjegimin te vetë shoqëria, e ka kthyer 'të vërtetën e pamohueshme' më shumë në një shqetësim sesa themel të shkencës. Fillimisht, vepra ime ka qenë një përzjerje e kritikës rrënjësore të shoqërisë, lidhur me "shkencën e madhe", dhe nostalgjisë konservatore për "shkencën e vogël". Kohët e fundit, me Silvio Funtowicz-in e kam vendosur shkencën tradicionale në një kuadër që ndërthur mënyrat e hulumtimit me teorinë e dijes. Ne përdorim emërtesën "shkencë pasnormale"<sup>2</sup> në kuptimin ironik të veprës kryesore të Kunit, për të përcaktuar një vendndodhje historike për këtë lloj të ri të shkencës.

Pikëpamja rreth shkencës pasnormale mbështetet në një dallim të trefishtë midis llojeve të ndryshme të zbatimit në zgjidhjen e çështjeve, mbështetur në ashpërsinë e secilit prej dy tipareve: pasiguritë e rrjetit dhe rreziqet e vendimmarrjes. Vatra 'e brendshme', ku të dyja këto tipare janë të ulëta, ne e quajmë 'shkencë në zbatim' (shkenca tradicionale 'bërthamë', ose 'themeli', mund të vendoset në qoshk të grafikut). Kur njëri nga tiparet është "i mesëm", ne përftojmë "këshillë profesionale", siç veprojmë me këshillat e mjekut ose inxhinierit. Kur një nga tiparet ashpërsohet, ne përfundojmë në fushën e 'shkencës pasnormale' dhe na duhet të sqarojmë se në rrethana të tilla, sigurimi i cilësisë së gjithë ecurisë kërkon një "këshill të zgjeruar shkencor", duke përfshirë të gjitha llojet përkatëse të njerëzve laikë të interesuar. Ata sjellin me vete 'faktet e tyre të zgjeruara', mbështetur në përvojën e tyre të përjetuar të çështjes. Shembuj të shkencës pasnormale mund të gjenden në mjekësinë bashkëkohore, si në rastin e hulumtimit rreth SIDA-s<sup>3</sup>, gjithashtu çështjet e ndotjes dhe mjedisit që kanë të bëjnë me shëndetin e qytetarëve. Në këtë të

1 [www.shellexpro.brentspar.com](http://www.shellexpro.brentspar.com)

2 Funtowicz, S., dhe Ravetz, J.R., Science for the Post-Normal Age. *Futures*, 25(7), f. 735-755 (1993).

3 Epstein, S., The construction of lay expertise: Aids activism and the forging of credibility in the reform of clinical trials. *Science Technology and Human Values*, 1995, 20 (4), f. 408-437.



fundit, “faktet e zgjeruara”, të siguruara nga hetimet e gazetarëve, mund të jenë po aq vendimtare, sa shembulli më i mirë i një pune kërkimore që përzgjidhet të bëhet e njohur për të gjithë qytetarët.

Deri më tani, unë dhe Silvio Funtowicz nuk i kemi shqyrtuar vazhdimisht mënyrat e ndryshme kërkimore, të përshtatshme për llojet e ndryshme të zgjidhjes së çështjeve. Kjo është tema që unë po hulumtoj këtu. Për këtë, ofroj një lloj renditje të trefishtë, në një farë mënyre paralele me atë të shkencës pasnormale. Me mjetet e kësaj renditjeje, ne mund të shohim më qartë, se përse qëndrimet e reja, teksa marrin parasysh llojet e reja të pyetjeve, janë të domosdoshme, nëse shkenca dëshiron të përshtatet me sfidat e saj të reja kryesore.

Shumëllojshmëria e llojeve kërkimore është e njohur prej kohësh në shkencë. Në çdo kohë ka një renditje ndër-disiplinore. Kohët e fundit ajo u ka dhënë përparësi atyre që studiojnë anët më të paqarta dhe më të thjeshta të botës së jashtme. Sipas kushteve mbizotëruese, të dhënat duhet të jenë sasiore dhe shembujt e arsyesimit duhet të jenë të mbështetur në përfundimin e nxjerrë prej shembujve të caktuar të një ligji të përgjithshëm, nëse është e mundur, zyrtarisht. Degët e shkencës që veprojnë në afërsi të përvojës tonë jetësore, priren të gjykojnë si “të buta” dhe detyrimisht përfundojnë në një gjendje të llojit “fizika e zilisë”. Llojet e hetimit të përshtatshme për synimet dhe punët e tyre (më të vetvetishme dhe jozyrtare) shtrydhen vazhdimisht nga imitimet e fizikës, të cilat kanë besueshmëri dhe rendiment në shkallë të ndryshme (vazhdimisht pak rendiment). Herë pas here, kjo e dhënë e sikletshme pranohet nga një numër i shumë zbatuesish, më pas qytetarët mësojnë për një zvetënim brenda fushës. I tillë tani duket të jetë rasti në ekonomi, ku lloji i ushtrimeve të paqarta matematikore është tashmë i shpërfaqur në sytë e të gjithëve si një zbrazëti.<sup>4</sup> Shkaqet e sëmundjeve të tilla janë studiuar fare pak. U unë mora në shqyrtim çështjen e cilësisë në librin tim të mëparshëm.<sup>5</sup> Kohët e fundit, kam shqyrtuar mënyrat me të cilat anët shoqërore të lëndëve shkencore mund t’i mbizotërojnë plotësisht parakushteve të cilësisë, në kurriz të përmbajtjes së tyre të vërtetë.<sup>6</sup>

4 Cassidy, J., The end of economics. *The New Yorker* 2 Dhjetor, f. 50–60 (1996).

5 Ravetz, J.R., *Scientific Knowledge and its Social Problems (with a new introduction)*. Transaction Press, New Brunswick, NJ, 1996.

6 Ravetz, J.R., Economics as an elite folk-science: the suppression of uncertainty. *The Journal of Post-Keynesian Economics*, 1994/5, 17 (2), f. 165–184.



## PYETJET KRYESORE

Duke pranuar idenë e llojeve të ndryshme kërkimore, me shkallë të ndryshme përshtatshmërie, mund të vazhdojmë me renditjen time, e cila sillet rreth ‘pyetjeve kryesore’. Mund të fillojmë me tre lloje hetimesh që mund t’i quajmë kërkimore, përcaktore dhe hulumtuese. Për secilën prej tyre kemi pyetjet e përshtatshme, përkatësisht: ‘çfarë dhe si?’, ‘si dhe pse?’ dhe ‘po si kur?’. Kjo renditje sipas pyetjeve të kujton katër llojet e shpjegimeve të Aristotelit, të shprehura fillimisht si ‘çfarë’, ‘qysh’, ‘cila’ dhe ‘përse’, të quajtura më vonë ‘thelbi’, ‘rendimenti’, ‘përpunimi’ dhe shkaku ‘përfundimtar’. Rënditja e Aristotelit u hartua t’i shërbente teorisë së tij të përgjithshme të përvetësimit të njohurive, me parimin e një analogjie midis “artit” dhe “natyrës”, në mënyrë që çdo gjallesë të shpjegohet sikur të ishte e paracaktuar që në ngjizje. Rënditja ime, nga ana tjetër, sillet rreth punëve të ndryshme të një kërkimi shkencor, kështu që kategoritë e mia do të përkohjnë pjesërisht me ato të Aristotelit.

Këto ‘pyetje kryesore’ nuk kanë asgjë të përbashkët me renditjen e përkryer dhe as nuk duhet të merren si përcaktuese të tërësisë së ndonjë lloji të caktuar kërkimor. Ato synojnë të ndriçojnë dhe jo të përcaktojnë. Emërtesa ‘pyetje kryesore’ na lejon të përfytyrojmë se në çdo hetim të veçantë, të tre llojet e pyetjeve shfaqen në vendet e tyre të përshtatshme. Për punën kërkimore, përfundimi i të cilës është një deklaratë që synon të jetë e mbështetur në prova, pyetja kryesore është ‘çfarë dhe si?’ Në skemën e Aristotelit këto pyetje kanë të bëjnë me përmbajtjen dhe ndikimin: ‘nga çfarë përbëhet kjo?’; ‘si mundet kjo ta shkaktojë atë?’. Po aq domethënëse sa edhe llojet e pyetjeve që përfshihen te “çfarë dhe si”, janë edhe pyetjet që përjashohen. Këto shfaqen në pyetjen tjetër kryesore: ‘si dhe pse?’ paskan qenë lejuar ‘shkaku përfundimtar’, një ‘veprim’ apo edhe një ‘qëllim’. Pyetje të tilla janë të zbatueshme për shpjegimin e çdo sendi, një pajisjeje ose një mjeti. Sepse ajo që ka rëndësi, zakonisht, nuk është aq shumë lënda që e përbën atë, apo puna e tij e brendshme, por më shumë rëndësi ka se si ravijëzimi i tij ia mundëson të kryejë detyrën e dhënë, të bëjë punën e vet. Sigurisht që këto dy lloje hetimesh do të përkohjnë pjesërisht në të shumtën e rasteve. Edhe në punën kërkimore, mjetet matëse përfshijnë një përcaktim ecurie dhe kështu, përfshihen pyetjet ‘si dhe pse?’, ndonëse si pyetje ndihmëse dhe jo kryesore në punën kërkimore. Për më tepër, në ngrehinën shpjeguese të shkencave (“përse?” e Aristotelit), duke përfshirë pjesën më të madhe të biologjisë, ka një gojëtar të pashmangshme rreth ravijëzimit, pavarësisht nga këmbëngulja e sertë për mungesën e një vizatuesi.



Pyetja kryesore “po sikur”, është krejt e ndryshme nga dy të tjerat. Në llojet e njohura të kërkimit shkencor, ajo shfaqet vetëm në periudhat fillestare hulumtuese të punës, duke i nisur gjërat përpara se çështjet të përcaktohen qartë dhe teoritë të forcohen. Në këtë kuptim, “po sikur?” shpreh frymën e krijimtarisë, të shpikjes, të sulmeve drejt një të panjohure që është pësore dhe pritëse. Në kuptimin e sfidave të reja për shkencën, “po sikur?” bëhet pyetja kryesore, me një ngutshmëri të mëtejshme. Tani padija jonë nuk është më e parrezikshme, por kërcënuese. ‘Po sikur’ një agjent bakterial për bagëtitë të jetë përqendruar dhe moleps ushqimet që ato hanë dhe, në këtë mënyrë, bëhet më i fuqishëm dhe i përçueshëm te të tjerët? ‘Po sikur’ portat e përparme të ngarkimit të mos kontrollohen për siguri, përpara se të niset një traget në thelb i paqëndrueshëm? ‘Po sikur’ të vazhdojmë të shtojmë mikroorganizma që janë të qëndrueshëm ndaj gjithnjë e më shumë antibiotikëve që marrim? ‘Po sikur’ vetëm hormonet artificiale të gjinisë femërore të hyjnë në të gjithë zinxhirët ushqimorë të kafshëve? Ndoshta nuk ndodh asgjë për disa prej nesh, për shumicën, apo gjatë gjithë kohës; por ndoshta ndodh diçka, një herë të vetme, ose herë pas here.

Përdorimi i ‘po sikur?’, si pyetje kryesore, tashmë është e gdhendur në mënyrën e vlerësimit të rrezikut. Në rastin e rreziqeve të punëtorive kimike, metodika HAZOP<sup>7</sup> shqyrton veprimet e njësisë në të gjitha pikëpamjet e tyre: praninë, vendndodhjen dhe shtrirjen kohë-hapësirë, si dhe sasinë e fuqinë. Duke shqyrtuar renditjen e plotë të të gjitha planveprimeve, lind pyetja “po sikur” njëri prej tyre të shtrihet jashtë mundësive të pritshme. Më tej mund të shfaqet një ndodhi, një rastësi, apo edhe një pararendës i një fatkeqësie. Duke renditur të gjitha mundësitë e ‘po sikur?’, metodika HAZOP siguron një drejtim të dobishëm në këtë pikëpamje, të paktën vargëzimin e rrethanave të papritura, të paparashikuara ose të panjohura, që përfundimisht përcaktojnë një fatkeqësi. Jo të gjitha rreziqet mund të ndahen kaq mirë në njësi të njohura të ngjarjes. Pavarësisht nga HAZOPI, ende ndodhin gjëra shumë të padëshirueshme në punëtoritë kimike. Megjithatë, njohja e ‘po sikur?’, si një pyetje e arsyeshme kryesore shkencore, së bashku me ‘çfarë/si?’ dhe ‘si/pse?’, do të na ndihmonte të formonim një përgjigje të dobishme shkencore ndaj sfidave dhe kërcënimeve të reja që dalin nga shqetësimi ynë rreth mjedisit natyror.

### ME ‘PO SIKUR?’, SI PYETJE KRYESORE, TËRËSIA E PËRSHTYPJES SONË RRETH SIPËRMARRJES SHKENCORE MUND TË PËRPAROJË

7 *Chemical Industries Association, Hazard and Operability Studies*. Chemical Industries Association, Londër, 1992.



## NË MËNYRË TË DOBISHME. QËNDRIMI MBIZOTËRUES NDAJ PASIGURISË DHE NDËRLIKIMIT DO TË TJETËRSOHEJ.

Në shkencën tradicionale, ashtu siç është përhapur dhe mësuar, pasiguria është një shqetësim. Normalisht, ajo përmendet vetëm kur është zbutur plotësisht, me anë të zbatimit të përdorimit të të dhënave pa ndërprerje. Deri kohët e fundit, filozofët e shkencës janë përpjekur të gjejnë një metodikë të thjeshtë për të shpjeguar sukseset e shkencës, duke zbutur punën e vërtetë kërkimore në kacafytjet me pasiguritë e çdo lloji. Në punën kërkimore “si/pse?”, të përqendruar te “detyrat” ose pajisjet që kryejnë një detyrë të caktuar, pasiguria vlerësohet, por vetëm si diçka që kërkon të zotërohet. Në atë rast, detyra është të sigurohemi që pasiguritë e mjedisit brenda të cilit punon sistemi, ndërhyjnë vetëm në një shkallë të pranueshme. Përveç kësaj, në shumë mënyra të skicimit dhe inxhinierisë, pasiguritë tashmë janë filtruar përmes rregulloreve ose kodeve të përcaktuara të veprimit, në mënyrë që përfaqja e zgjidhjes së çështjeve të merret kryesisht me këto përafrime të mirëpërcaktuara për një vërtetësi të pasigurt. Për të mundësuar një përballje të vazhdueshme të qasjes së zgjidhjes së çështjeve me botën atje tej, kemi nevojë për qasjen “po sikur?”.

Bashkë me pasigurinë e botës që na rrethon, gjithashtu duhet të merremi në mënyrë të dobishme me ndërlikimin e saj. Për shekuj me radhë, që nga Galileo dhe Dekarti, shkenca jonë është ndërtuar rreth parimit të studimit të botës në pjesë të thjeshtuara dhe të veçuara. Kjo qasje përshkon gjithë kulturën tonë shkencore dhe teknologjike; dhe, kur sfidohet, vihet re më lehtë. Në këtë mënyrë, ne tani fillojmë të vlerësojmë kufizimet e një zakoni mjekësor i cili njëjtëson sëmundjen me mikrobet dhe shërimin me vrasjen e mikrobeve, duke u prirë kështu të shpërfillë, si dallimet vetjake, ashtu edhe të gjithë rrethanën ekologjike dhe shoqërore të sëmundjes. Sigurisht, ushtrimi i përditshëm me sukses i çdo gjëje kërkon detyra të thjeshta dhe vetëm me pasiguri të zbutura. Gjithçka që na duhet, është të vlerësojmë se ky ‘thjeshtëzim’ është një pikëpamje e pjesshme që mandej shtrihet kundrejt rëndësisë së largpamësive që janë pjesë plotësuese e tij. Në të vërtetë, vetëm kur jemi mësuar të pyesim ‘po sikur?’ dhe, si të thuash, presim të papriturën, atëherë e vlerësojmë plotësisht, se asnjë largpamësi e vetme nuk mund të kapë plotësisht çdo rrethanë të vërtetë. Kjo është ajo që përbën ndërlikimin e vërtetë, në krahasim me ndërlikimin e thjeshtë.



Miratimi i 'po sikur?', si një model shkencor, do të ketë gjithashtu ndikime të rëndësishme në ecurinë e veprimit. Tani e dimë se shkenca në veprim është shumë e ndryshme nga ecuria e thjeshtë e 'mbledhjes së të dhënave'. Sepse të dhënat nuk "merren" thjesht, por për t'i siguruar ato kërkon një përcaktim fillestar të përparësive, në mënyrë që të mbështetet ana kërkimore. Më pas, hulumtimi duhet të hartohet rreth pyetjeve të përshtatshme, sepse përjasja ndaj çdo teme është e ndërlikuar, duke përfshirë këtu edhe anët e natyrës dhe shoqërisë, ku 'shkaku' i problemit do të jetë po aq i ndërlikuar. Historia e fatkeqësisë së sëmundjes së lopëve të çmendura në UK, tregon se si puna kërkimore paksa e vonuar, madje shumë e vonuar, dhe e përqendruar larg pyetjeve vendimtare të përjasjes, mund të lejojnë që një krizë të maturohet me kalimin e viteve, deri në pikën pa kthim, pavarësisht nga përpjekjet më të mira me çiltërsi të shkencëtarëve të përkushtuar.

Modeli 'po sikur?' është gjithashtu një shprehje e *Parimit të Parandalimit*, i cili po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm në përjasjet mjedisore. Ai mbron shkencëtarët nga një zgjedhje e parakohshme e çështjeve kërkimore që do të hetohen, dhe nga një mbyllje e nxituar e hulumtimit. Dikush vetëm mund ta marrë me mend një dialog të vazhdueshëm midis pjesëmarrësve të llojeve të ndryshme të hetimit. Megjithëse 'po sikur?', domosdoshmërisht, i shmanget qendrës së vëmendjes, sapo të fillojë përpjekja kërkimore, ajo duhet të nxitet gjithmonë, si një plotësues thelbësor për zgjidhjen e gjëgjëzës nga e cila përfundimisht dalin 'të dhënat' përkatëse.

Ka arsye të forta, se përse shkenca e 'po sikur-it?' duhet të shfaqet pikërisht tani. Çështja e 'sigurisë' po shfaqet si një detyrë e madhe për shkencën, si një pasuese e synimeve të binjakëzuara mes dijes dhe fuqisë, që u bë e qartë gati katër shekuj më parë, gjatë Revolucionit Shkencor. Gjendemi në një rrethanë disi të pakuptimte: nga njëra anë, njerëzit në shumë shoqëri të ndryshme nuk kanë qenë kurrë kaq të sigurt; nga ana tjetër, nuk ka pasur kurrë një vetëdije qytetare kaq të madhe për kanosje rreziku. Në një farë mënyre, e pakuptimta është në mendjet tona, sepse, teksa arrijmë të besojmë se (në sajë të shkencës) jetët tona mund të jenë vërtet të sigurta, ne kërkojmë asgjësimin e çdo rreziku që hasim (dhe, shpesh, fajësojmë shkencën për praninë e tij). Megjithatë, edhe këtu ka diçka të vërtetë. Ndërsa rreziqet janë zvogëluar, tipari i tyre ka ndryshuar, pasi nuk janë më mishërimi i mortajave shkatërruese dhe fatkeqësive natyrore të përhapura në të kaluarën. Ato priren të bëhen më të brishta, ndoshta më tinëzare, madje edhe kërcënuese. Ne përjetojmë kërcënime që janë krejtësisht të reja, të tilla si dëmtimi gjenetik nga rrezatimi bërthamor që do të shtrihet pafundësisht në të ardhmen. Ne përballemi me





sëmundje të reja, zanafilla e të cilave është po aq e pasigurt dhe e ndërlikuar, sa ç'është mjekimi i tyre. Përballë këtyre llojeve të reja të rreziqeve, nuk ka asnjë mundësi tjetër të dobishme për modelin e shkencës "po sikur?". Gjendja e ndërlikuar e të qenit të sigurtë nuk do të arrihet nga tradita e thjeshtuar, zvogëluese e shkencës, e mishëruar në qasjet "çfarë/si" dhe "si/pse?". Ne kemi nevojë për 'po sikur?', si një pjesë plotësuese e tyre, për t'u zhvilluar dhe përdorur në rrethanat e duhura dhe mënyrat e duhura.

Së fundi, modeli shkencor "po sikur?" çon drejt ndërlikimeve shoqërore. Ushtrimet për zgjidhjen e të panjohurave të 'shkencës normale', ose, në të vërtetë, të çdo pune të përditshme, kërkojnë dhe nxisin një lloj 'përafrie', në të cilën është e nevojshme të mbizotërojë një lloj mjeshtërie. Metoda 'po sikur?' vepron në kufijtë e kësaj lloj mjeshtërie. Njohuritë dhe këshillat e njerëzve me lloje të ndryshme dijesh, ose edhe atyre pa ndonjë syresh, duhet të pranohen gjatë bashkëbisedimit. Në lidhje me shkencën pasnormale, ne e kemi përshkruar këtë si një "këshill shkencor të zgjeruar". Aty kemi parashtruar idenë lidhur me sigurimin e cilësisë së lëndës shkencore të parashtruar në ecurinë e veprimtarisë. Metoda 'po sikur?' kryen një detyrë tjetër për këshillat e zgjeruar shkencorë dhe për ligj ende më shumë 'faktet e zgjeruara' të tyre. Këto janë të dhëna që rrjedhin nga burime jashtë punës kërkimore tradicionale. Ato mund të vijnë nga gojëdhënat, njohuritë tradicionale, studimet përgjatë gjithë jetës ose nga gazetaria hulumtuese. Meqenëse kaq shumë nga pyetjet 'po sikur?' nxiten nga të dhëna të tilla jashtë traditës, miratimi i metodës 'po sikur?' është i pandashëm nga njohja e fakteve të zgjeruara, këshillit shkencor të zgjeruar dhe qasjes së shkencës pasnormale.

## PËRFUNDIM: RRETHANAT E KUPTIMIT DHE VLERËSIMIT TË "PO SIKUR?"

Nga pikëpamja e një përzgjedhjeje esesh mbi "Vegimet shkencore", ky hulumtim rreth një ideje akademike mund të duket mjaft i zbehtë dhe i zbutur. Atëherë, ç'mund të themi për shkencën që hulumton fuqinë e shkatërrimit të marrëdhënieve njerëzore të një brezi më përpara nesh?<sup>8</sup> Ka dy arsye të përafërta, për të lënë mënjanë një qasje të tillë aq të politizuar, të paktën hëpërhë. Njëra është gjendja e politikës së shkencës në kohën e

8 Ravetz, J.R., *Critical Science: politics and philosophy*. In *Scientific Knowledge and its Social Problems*. Transaction Press, New Brunswick, nj, 1996, f. 422-436.



tanishme. Për njëfarë kohë, kur e vërteta e “ndërlikuar ushtarake-industriale-shkencore” u bë një zbulim i ri për mbarë qytetarët, në lidhje me Bombën atomike dhe Vietnamin, të dukej e mundur që shkencë vetvetiu mund të pësonte një ndryshim rrënjësor. “Shkencë për Popullin” në Amerikë dhe “Shoqata për Përgjegjësi Shoqërore në Shkencë” në Britani, ishin përgjigje premtuese ndaj gjendjes luftarake të viteve të fundit 1960.

Megjithatë, të paktën në afat të shkurtër, ajo shpresë nuk mund të mbahej gjallë. Vëmendja e tubimit u zhvendos te ‘mjedisi’ në të cilin vetë shkencë nuk shihej si e dyshimtë. Vërejtjet vërtet gërryese ndaj shkencës, duke zvetënuar synimet e saj për njohuri të vjera, u përçuan gjoja si një stërvitje akademike nga shkolla të rëndësishme pas Fajrebend-it. Ndërkohë, vetë politika ka ndryshuar. Rënia e socializmit, si një rend shoqëror mundësisht i zbatueshëm, i ka dobësuar së tepërmi fuqitë themelore, sa i përket çështjeve tradicionale të shpërndarjes. ‘Mosmarrëveshja kryesore’ e rrjetit industrial është zhvendosur te ‘qëndrueshmëria’ ose, me fjalë të tjera, te mbijetesa. Nëse shkencë do të bëhet një çështje qendrore brenda kësaj rrethane të re, rrahja e mendimeve do të përqendrohet më pak në punët e shpërndarjes (mundësia e punësimit dhe shfrytëzimi i të dhënave përfundimtare) dhe më shumë në themelet filozofike të kësaj rrethane.

Ky përqendrim i ri shprehet në fushatën e Sardar-it për “Të tjerët”.<sup>9</sup> Ndërsa maturohet, kjo duhet të na sigurojë dhuratën e çmuar të ‘të parit të vetes, ashtu siç na shohin të tjerët’. Mbi këtë themel, ne mund të përmbylлим reformën e nevojshme të shkencës, në pjesëmarrjen shoqërore, mënyrat e punës dhe qëllimet ideore. Ky ndryshim mund të jetë po aq i thellë, sa ai që ndodhi katërqind vjet më parë në Revolucionin Shkencor. Megjithatë, kjo reformë e re është ende në një periudhë shumë të hershme, pjesërisht për shkak se kulturave që synojnë të udhëheqin gjendjen “Tjetër”, ende u mungon tërheqja e ndërsjellë dhe vetëbesimi që do t’ua mundësonte atyre kyçjen në një bashkëbisedim. Ka të ngjarë që secilës prej tyre do t’i duhet të kalojë një periudhë kundërshtimi dhe armiqësie (në fushën fetare që shfaqet si ‘fundamentalizëm’), përpara se të mundësohet ndonjë bashkëbisedim ndërkulturor, sado i vështirë të jetë.

Një zhvillim i mëtejshëm ka gjasë të ndodhë brenda kulturës rastësore, midis prirjeve të njohura në mënyra të ndryshme, si ‘e gjelbër’, ‘feministe’ ose ‘Epokë e re’. Shumëllojshmëria e emrave tregon larminë e madhe të çështjeve, disa që përkohë pjesërisht dhe disa ndërsjellës të papajteshme dhe armiqësore. Çdo vegim i qëndrueshëm i shkencës, mbështetur

9 Sardar, Z., *Conquests, Chaos, Complexity. The Other in Modern and Postmodern Science. Futures*, 1994, 26 (6), f. 665–682.



në një pjesë të kësaj lëvizjeje të larmishme, sigurisht që do të tjetërsonte shumicën e pjesëve të tjera, në një farë mënyre. Megjithatë, kjo lëvizje, mbështetur në një zhgënjim të gjerë, me njërin apo tjetrin mashtrim të rrjetit tonë bashkëkohor industrial, është ende në një periudhë të hershme rritjeje. Thuajse vetëm një brez na ndan nga 'kundër-kultura' e viteve 1960, kur shpërtheu e gjitha.

Sa për tani, qasja ime ka qenë zhvillimi i ideve për pjesë të veçanta të së panjohurës. Këto përfshijnë studimet e mia të mëparshme mbi pasigurinë dhe shkencën pasnormale, të kryera me Silvio Fanteviç-in, si dhe ato të bëra me ose për Sardar-in, siç u botuan te *Shkrirja e Dijes me Fuqinë*.<sup>10</sup> Asnjë nga këto hulumtime nuk ka pasur ende një jehonë (sa për dijeninë time) askund në Perëndim. Nga kjo, dal në përfundimin se çdo përbashkim idesh që kam synuar, tani do të ishte ose shumë përpara kohës së vet, ose jashtë rrjedhës kryesore të zhvillimit. Kështu që parapëlqej të mos e nxitoj punën, por, në vend të kësaj, të lëvroj mirëkuptimin tim për çështje të ndryshme të veçanta. Metoda shkencore 'po sikur?' është një nga këto çështje; ndërkohë jam duke punuar me Silvio Fanteviç-in mbi teorinë e 'rrjetit të ndërlikuar vetvetor'. Pas kësaj, mund të vijë një studim i arsyes (siç e kuptoj unë idenë), i cili duhet të thellojë teoritë e dijes dhe shtjellimit të shoqërisë, të cilat unë i qartësova fillimisht në *Njohuritë Shkencore dhe Problemet e saj Shoqërore*.<sup>11</sup>

10 Ravetz, J.R., *The Merger of Knowledge with Power*. Cassell, Londër, 1990.

11 Ravetz, J.R., *Scientific Knowledge and its Social Problems (with a new introduction)*. Transaction Press, New Brunswick, NJ, 1996.



# Rreziqet gjenden këtu: Hulumtimi i “Të panjohurës së të panjohurave”

*Shirin Elahi*

## HYRJE

Gdhendur në një fletë bakri, në *Lenox Globe*, një nga globet më të vjetra tokësore të njohura, që daton rreth vitit 1500, gjenden fjalët joshëse: HIC SVNT DRACONES. Kjo shprehje: ‘Këtu gjenden dragonjtë’, u përdor për të nënkuptuar toka të rrezikshme ose të pazbuluara. Ajo ka një histori të gjatë, që nga kohët greke dhe romake, kur mungesa e njohurive ishte e barabartë me rrezikun. Ky rrezik u sqarua edhe nga ana pamore prej hartografëve të cilët mbushën vendet e zbrazëta të hartave me gjarpërinj deti, dragonj ose krijesa gojëdhënash me pamje të ashpër, për të paralajmëruar udhëtarët për rreziqet me të cilat mund të përballeshin, ndërsa zgjeronin kufijtë gjeografikë të botës që ata njihnin. Për çdo përdorues të hartës, të kuptuarit se ku shtriheshin kufijtë e njohurive, ishte pothuajse po aq e rëndësishme, sa vetë njohuria. Nga gjithë rreziqet e tjera, përshtypja e gabuar rreth dijes ishte më e madhja.<sup>12</sup>

Po në botën e ditëve të sotme, ku gjenden rreziqet? Ato bien në sy prej mungesës së tyre në veprimtarinë e zotërimit të rreziqeve dhe pasigurisë. Po bëhet gjithnjë e më e qartë, se ato shtrihen kudo rreth nesh: buzë kufijve institucionalë, jashtë kullave të fildishta të lëndëve akademike, të pakapshme për njësitë matëse të rrezikut, të llogaritura me kaq kujdes... Në çdo rast, ato janë pika të vdekura, të papranuara, që përfshijnë kufijtë shkencorë, gjeografikë,

12 J.R. Ravetz, Usable knowledge, usable ignorance: incomplete science with policy implications, në: W.C. Clark, R.C. Munn (Eds.), *Sustainable development of the biosphere*, Cambridge University Press, New York, 1986, f. 415–432.



kohorë dhe institucionalë, por të panjohur, për shkak të sfidave që përfaqësojnë ndaj dëshirës sonë njerëzore për rregull dhe zotërim.

Nëse padija, pasiguria dhe rreziku shtrihen të gjitha brenda fushës së të panjohurës, përqendrimi ynë këtu do të jetë te çështjet e pahulumtuara në skajet më të largëta të fushës. Mund të gjenden marrëveshje të panumërta që përcaktojnë dhe zbërthejnë ndryshimet midis pasigurisë dhe rrezikut.<sup>13</sup> Çdo përpjekje për ta zbardhur këtë përcaktim është përtej qëllimit të këtij punimi. Synimi ynë është të sigurohemi se “rreziqet gjenden këtu”, që tregojnë pasiguri të papërcaktuara, nuk janë marrë parasysht dhe pse.

## SHEMBUJ NGA ‘RREZIQET GJENDEN KËTU’

“Rreziqet gjenden këtu” nuk njihet, prandaj ka pak kërkime mbi këtë temë. Ky punim ka zbardhur tre shembuj, përkatësisht: ‘çështjet djallëzore’, ‘mjellmat e zeza’ dhe ‘shkenca pasnormale’, të cilat janë paraqitur si më poshtë.

‘Çështjet djallëzore’, ose rrëmujat, nuk janë thjesht çështje të ndërlikuara. Ato janë mëdyshje të paqarta, shumë të kufizuara, të ndërlihdura ngushtë, të ndërlikuara, shoqërore, teknike, ekonomike dhe politike. Natyra e tyre në ndryshim dhe ndërvarësitë në tërësi, e bëjnë pothuajse të pamundur përcaktimin e tyre bashkërisht, sepse janë në lojë kaq shumë këndvështrime dhe çështje të ndryshme.<sup>14</sup>

Një shembull tjetër është ‘mjellma e zezë’, një ngjarje e paparashikueshme, e pamundur, me veçorinë brenda vetes për të ndikuar fuqishëm në gjendjen e tanishme.<sup>15</sup> Ajo që është më e rëndësishme, ka të bëjë me faktin se pas një dukurie të llojit ‘mjellma e zezë’, posaçërisht sulmet e 11 shtatorit nga Al-Kaeda, ngjarja sqarohet përmes arsytimit dhe ripërcaktohet si diçka më e parashikueshme, duke përdorur prapaskenat për të provuar praninë e largpamësisë.<sup>16</sup>

13 G.M. Morgan dhe M. Henrion, *Uncertainty: A Guide to Dealing with Uncertainty in Quantitative Risk and Policy Analysis*, Cambridge University Press, Cambridge, 1990; M.B.A. van Asselt, The complex significance of uncertainty in a risk era: logics, manners and strategies in use, *International Journal for Risk Assessment and Management* 5 (2/3/4) (2005) 125–58; R.E. Lofstedt, and M.B.A. van Asselt, A Framework for Risk Governance Revisited, in: O. Renn, K.D. Walker (Eds.) *Global Risk Governance: Concept and Practice Using the IRGC Framework*, Springer, Netherlands, 2008, f. 77–86.

14 H. Rittel, dhe M. Webber, Dilemmas in a General Theory of Planning, *Policy Sciences* (4) (1973) 155–169; R. Ackoff, *Redesigning the Future: A Systems Approach to Societal Problems*, John Wiley & Sons, NJ, Londër, 1974.

15 N.N. Taleb, *The Black Swan*, Allen Lane, Londër, 2007.

16 B. Fischhoff, Hindsight-Foresight: The Effects of Outcome Knowledge on Judgment under Uncertainty, *Journal of Experiential Psychology: Human Perception and Performance* 1 (1975) 288–299; B. Fischhoff, An Early History of Hindsight Research, *Social Cognition*, 25 (1) (1998) 10–13.



Lloji i tretë është grupimi "shkenca pasnormale", e përdorur për të treguar mënyra të papërcaktuara, shpesh të reja, të teknologjisë, të tilla si inxhinieria gjenetike, nano-teknologjia, ose energjia bërthamore.<sup>17</sup> Shkenca pasnormale shquhet për rreziqe të larta, të vërteta, të pasigurta, vlera të kundërshtueshme dhe vendime të ngutshme, prandaj ekuacioni shpenzim/fitim do të shqyrtohet ashpër, pa ndonjë dallim. Në këto rrethana, miratimi nga këshilli shkencor është i papërfillshëm ose i asgjësuar, strukturat teorike mbështeten në përpunimin e të dhënave dhe prurjet e reja, ndërsa pasiguria priret të kthehet në padije.

Këta shembuj janë shumë të ndryshëm, por kanë ngjashmëri. Në çdo rast, ato janë çështje të ndërlikuara shoqërore me shumë përmasa. Të gjitha kanë të bëjnë me ndërveprimet midis rrjeteve të shumëfishta, të ndërlidhura, të ndërvarura, me shumë aktorë të ndryshëm, kështu që të dhënat do të jetë gjithmonë të pamjaftueshme. Rrjetet politike, shoqërore dhe teknologjike, janë të gjitha në varësi të mënyrës se si gjithsecush i sheh gjërat, duke e bërë të pamundur llogaritjen e saktë të mundësive që kemi në dorë. Një tjetër ngjashmëri e theksuar është aftësia e tyre për të sfiduar të menduarit tradicional dhe gjendjen e tanishme.

## "RREZIQET GJENDEN KËTU" - VLERAT E TYRE

**PADIJA ËSHTË SI HAPËSIRAT E ZBRAZËTA NË HARTËN TONË TË NJOHURIVE: BRENDA TYRE NUK KA HOLLËSI, ASNJË TË DHËNË TË PËRDORSHME. NË HARTAT E BOTËS SË RILINDJES... HARTUESIT E KUPTUAN SE MË E KEQE SE PADIJA E FAKTEVE ËSHTË PADIJA E VETË PADIJES; PËRSHTYPJA SE JEMI TË DITUR MUND TË NA ÇOJË ME VETËBESIM DREJT FATKEQËSISË.**<sup>18</sup>

Ngadhënjimi në çdo përpjekje për të zotëruar pasigurinë ose rrezikun varret nga zbrërthimi i përshtatshëm i çështjes. Në rastet e pasigurisë së

17 S.O. Funtowicz, dhe J.R. Ravetz, *Uncertainty and Quality in Science for Policy*, Kluwer, Dordrecht, 1990; S. Funtowicz, J. Ravetz, Three Types of Risk Assessment and the Emergence of Post-Normal Science, in: S. Krimsky, D. Golding, (Eds.), *Social Theories of Risk*, Praeger Publishers, Westport, Londër, (1992) f. 251-273; J.R. Ravetz, Science for the PostNormal Age, *Futures*, 25 (7) (1993) 735-755.

18 J.R. Ravetz, dhe S.O. Funtowicz, Usable Knowledge, Usable Ignorance: A Discourse on Two Sorts of Science, Paper presented at the *International Congress: The Experts are Categorical: Scientific Controversies and Political Decisions Concerning the Environment*, Arc et Senans, France, 11-13 Shtator 1989.



papërcaktuar, kjo nënkupton njohjen e të panjohurës. Sokrati pohoi se di një gjë që s’di asgjë<sup>19</sup>, por sot padija nuk shoqërohet me mençurinë.

Për shkak të mungesës së njohjes, ‘Rreziqet gjenden këtu’ përgjithësisht mbetet e fshehur, e padëshiruar dhe e panjohur - një mënjanim që mund të jetë i rëndësishëm, kur merremi me çështje të pasigurta që përfshijnë ndërlikimin shkencor, pasigurinë e natyrshme<sup>20</sup>, grupet e shumta të palëve të përfshira, tërësinë e rrjeteve të ndërvarura<sup>21</sup>, ose kuadër më të gjatë kohor. Pasojat e fshirjes së “Rreziqet gjenden këtu” mund të çojnë, gjithashtu, në vendimmarrje që lënë për të dëshiruar, ujdi të pasigurta, gërryerje të besueshmërisë institucionale dhe ngatërresa të mëdha kërkimore.<sup>22</sup> Më e rëndësishmja, duke pasur parasysh se ne jetojmë në kohë pasnormale<sup>23</sup>, a nuk është koha të braktisim idetë e ‘zotërimit dhe udhëheqjes’ dhe të pranojmë vlerën ‘Rreziqet gjenden këtu’, si një shenjë paralajmëruese për të lundruar dhe për t’u përshtatur përballë pasigurisë?

Çështja e rëndësishme që duhet kuptuar, është se përse prania e “Rreziqet gjenden këtu” nxit një mohim kaq të përhapur dhe të plotë. Ky punim e gjen përgjigjen te mungesa e njohjes së tre faktorëve, përkatësisht:

- Psikologjia njerëzore dhe dëshira për zotërim.
- Shtypja institucionale dhe kufijtë e saj.
- Marrëveshja shkencore dhe shtypja e mendjeve të arsyeshme.

## PSIKOLOGJIA NJERËZORE DHE DËSHIRA PËR ZOTËRIM

Të gjitha qeniet njerëzore ndajnë dëshirën e lindur për të ushtruar zotërimin e tyre mbi mjedisin. Disa studiues pohojnë se ndjenja e zotërimit, qoftë e vërtetë, qoftë përshtypje, është një nga burimet kryesore të shëndetit mendor.<sup>24</sup> Për sa i përket nuhatjes së rrezikut, dy faktorë të rëndësishëm

19 D. Laertius, trans. C.D. Yonge *The Lives and Opinions of Eminent Philosophers*, George Bell & Sons, Londër, 1895.

20 National Research Council, *Science and Judgment in Risk Assessment*, National Academy Press, Washington DC, 1994; F. C. Stern, H. V. Fineberg, (Eds.), *Understanding Risk: Informing Decisions in a Democratic Society*, National Academy Press, Washington dc, 1996.

21 A. Wilkinson, S. Elahi, dhe E. Eidinow, Riskworld, *Journal of Risk Research*, 6 (4–6) (2003) 289–579 (Special Issue); Joint United Nations Programme on hiv/aids, aids in Africa: Three Scenarios to 2025, UNAIDS, Geneva, 2005.

22 A. Finkel, *Confronting Uncertainty in Risk Management: A Guide for Decision Makers*, Center for Risk Management, Resources for the Future, Washington DC, 1990; J. Graham, dhe J.B. Wiener, *Risk vs. Risk: Tradeoffs in Protecting Health and the Environment*, Harvard University Press, Cambridge, 1996.

23 Z. Sardar, Welcome to postnormal times, *Futures*, doi:10.1016/j.futures.2009.11.028, 2009.

24 S.E. Taylor dhe J.D. Brown, Illusion and Well-Being: A Social Psychological Perspective on Mental Health, *Psychological Bulletin*, 103 (1988) f. 193–210.



që ndikojnë në gjykimin e njeriut, janë 'droja' - d.m.th shkalla e zotërimit të rrezikut, dhe 'rreziku i panjohur' - nëse rreziqet janë apo jo të njohura për shkencën - d.m.th. niveli i pasigurisë.<sup>25</sup>

Ngjarjet e pashpjegueshme ose të pakuptueshme kanë anën e mirë që e përforcojnë dhe zgjerojnë ndikimin e tyre tronditës. Për shkak se ato nuhaten si të ndryshme nga e zakonshmja, ne kemi më shumë gjasa të vazhdojmë të mendojmë për 'to, duke u përpjekur t'i shpjegojmë dhe t'i zotërojmë, ose të shmangim dukuri të ngjashme në të ardhmen.

'Pasi të shpjegojmë një ngjarje, mund ta palosim si një rrobë të sapo larë e ta vendosim në sirtarin e kujtesës dhe të kalojmë te tjetra. Por, nëse një ngjarje kundërshton shpjegimin, ajo bëhet e pakuptimtë ose e panjohur... Këto, në përgjithësi, nuk pranojnë të rrinë diku në fund të mendjes sonë.'<sup>26</sup>

Në përpjekje për të kuptuar dhe zotëruar ngjarjet që duken të ndryshme nga e zakonshmja, qeniet njerëzore mbështeten në përfytyrimin e tyre. Megjithatë, kjo kufizohet nga përvojat, kultura dhe botëkuptimet tona. Për shembull, në vitin 1520, Ferdinand Magelani lundroi drejt *Tierra del Fuego*, në skajin më jugor të Amerikës së Jugut. Ai dhe ekuipazhi i tij u befasuan kur zbuluan se indianët e *Del Fuegos* nuk i kishin parë varkat e tyre duke hyrë në gjirin bregdetar. Më vonë u bë e qartë se indianët e mendonin anijen si një lundër të vogël dhe asgjë në përvojën dhe kuptimin e tyre nga e kaluara nuk i kishte përgatitur ata për anije të mëdha me vela të hapura.<sup>27</sup> Në mënyrë të ngjashme, përvojat tona janë të kufizuara nga mendimet tona për vërtetësinë jetësore dhe është e vështirë të përfytyrohen ngjarje me fuqi shkatërruese që nuk kanë një shembull paraprak. Megjithatë, duke mohuar ngjarje të tilla të papërfytyruara, ne e bëjmë veten jo vetëm mos njohës të fakteve, por më të paditur rreth padijes sonë.

Ka dallime lidhur me shkallën e kërcënimit që shoqëritë ndjejnë nga rrethana të pasigurta ose të panjohura. Këto dallime, brenda lejitimit që ne shfaqim në lidhje me pasigurinë, varen jo vetëm nga kultura, pasuria dhe institucionet socio-politike, por edhe nga botëkuptimet.<sup>28</sup> Pavarësisht këtyre dallimeve, ka mjete parashikuese, siç janë planet e veprimit. Ato ua

25 B. Fischhoff, F. Slovic, S. Lichtenstein, S. Read, dhe B. Combs, How Safe is Safe Enough? A psychometric study of attitudes toward technological risk and benefits, *Policy Science* 9 (1978) 127–152; F. Slovic, B. Fischhoff, and S. Lichtenstein, Facts and fears – understanding risk, in: R. Schwing, W.A. Albers, (Eds.), *Societal Risk Assessment*, Plenum, New York, 1980, f. 181–218.

26 D. Gilbert, *Stumbling on Happiness*, Harper Press, Londër, 2006, f. 189.

27 J. Diamond, Guns, Germs, dhe Steel. *The Fates of Human Societies*, W.W. Norton & Company, New York, Londër, 1997.

28 O. Renn dhe B. Rohrmann, (Eds.), *Cross-cultural Risk Perception*, Kluwer, Dordrecht, 2000; G. Hofstede, *Culture's Consequences: Comparing Values, Behaviours, Institutions and Organisations across Nations*, second ed., Sage, Thousand Oaks, ca, 2001.





mundësojnë grupeve me pikëpamje të ndryshme dhe kundërshtuese, të hulumtojnë bashkërisht shenja sado pak të dukshme të ndryshimeve me fuqi shkatërruese dhe të vlerësojnë së bashku pasigurinë e pazgjidhshme, duke kapërcyer pengesat psikologjike të përcaktuara më sipër.

## PËRGJIGJET INSTITUCIONALE NDAJ PASIGURISË

Edhe pse politikëbërësit dhe institucionet janë të ndarë mjeshtërisht në pjesë përbërëse, rrjetet e ndërlikuara njerëzore, teknologjike dhe mjedisore nuk janë të tilla. Si rregull, shqyrtimi ose vendimmarrja që ndikon në çështje të tilla të shumanshme, trajtohet pjesë-pjesë brenda kufijve institucionalë, duke përdorur nga një pikë vështrimi për secilën çështje. Kjo u mundëson politikëbërësve të kenë plotësisht të drejtë brenda një modeli të ngushtë, kur bindjet janë të sakta – ose krejtësisht të gabuar, nëse ndonjë nga bindjet qëllon të jetë e pasaktë. Shoqëria bashkëkohore pasindustriale është e tillë, që shqetësimi për rrezikun dhe shmangien e rrezikut është i lartë në ndërgjegjen kolektive. Siç e përshkruan krijuesi i idesë së *Shoqërisë së Rrezikut*: “Veprimtaria e vënë në lëvizje nga shoqëria e rrezikut... pasqyrohet në thënien: Kam frikë!”<sup>29</sup> Për institucionet përgjegjëse për drejtimin e shoqërisë dhe rreziqet me të cilat përballlet, kjo paraqet sfida të vërteta. A duhet pranuar dhe përçarur pasiguria të qytetarët, përbën një pyetje të rëndësishme. Është e qartë se kjo është e këshillueshme, duke qenë se të folurit hapur është një element kyç i besimit qytetar. Pranimi i pasigurisë mund të rrisë besueshmërinë e atij që flet, megjithatë mund të përshkallëzojë edhe frikën e qytetarëve, ose të gërryëjë besimin, duke krijuar përshtypjen e një vendimmarrjeje të papërshtatshme.<sup>30</sup>

Në shumë raste, kundërvënia institucionale pohon më shumë cilësi se ç’duhet rreth gjërave të njohura dhe zgjedh mohimin e pasigurisë, duke shmanhur shqetësimin institucional që mund të nxisë pranimi i llojit të qasjes “Rreziqet gjenden këtu”. Si përfundim, ata anashkalojnë mjeshtërisht shumë çështje të vështira politike, shoqërore dhe teknologjike.

Ka disa mënyra, përmes së cilave mohimi i pasigurisë institucionale zë vend. Mosmarrëveshjet e nivelit më të lartë shoqëror me nivelet e larta të

29 U. Beck, *Risk Society: Toward a New Modernity*, Sage Publications, Londër, 1992, f. 49.

30 R.J. Bord, dhe R.E. O’Connor, Determinants of Risk Perceptions of a Hazardous Waste Site, *Risk Analysis*, 12 (3) (1992) 411–415; B. Johnson dhe F. Slovic, Explaining uncertainty in health risk assessments: Initial studies of its effects on risk perception and trust, *Risk Analysis* 15 (1995) 485–494.



pasigurisë shkencore mund të tjetërsohen në ato të nivelit më të ulët, ku ka më shumë siguri shkencore dhe ku njohësit e fushës mund t'i shqyrtojnë me një farë pushteti më të madh.<sup>31</sup> Përndryshe, institucionet mund ta përcjellin përgjegjësinë për vlerësimin e rrezikut të prodhuesit të rrezikut në fjalë. Ose, nëse kjo strategji është e papërshtatshme, thjesht shmangin barrën e vendimmarrjes, duke lënë një zbrazëti mënyrash veprimi.<sup>32</sup> Si rrjedhojë e këtij shfuqizimi të përgjegjësisë, qytetarët që marrin pjesë në ligjërime, detyrohen të rrahin çështjet e ngritura brenda një kuadri të ngushtë të njohurive teknike, duke u mbështetur në fakte të arsyetuara. Kjo siguron që shqetësimet në lidhje me vlerat dhe botëkuptimet e kundërshtuara të jenë të arsyetueshme dhe në shumicën e rasteve të paqartësuara, duke prapësuar kështu shqyrtimin kuptimplotë dhe duke krijuar hap pas hapi një tjetërsim qytetar në ecurinë e vendimmarrjes.<sup>33</sup>

"Rreziqet gjenden këtu" përbuzet nga politikëbërësit për një varg arsyesh. Ndonjëherë, kjo bëhet për të qetësuar qytetarët; ndonjëherë sepse njohësit e fushës nuk duan të shpërfaqin padijen e tyre; ndonjëherë sepse pesha e detyrës është aq e madhe, sa institucionet nuk mund të zbulojnë shkallën e hendekut midis përgjegjësisë rregullatore dhe vërtetësisë jetësore. Cilado qoftë arsyeja, një gjë është e sigurt:

**MOHIMI I KËTYRE PASIGURIVE NUK I ASGJËSON ATO, THJESHT DO TË THOTË SE MUNGOJNË MEKANIZMAT QË MBIKËQYRIN VENDNDODHJEN DHE MUNDËSITË E RREZIQEVE QË ATO PARAQESIN.**

Ndoshta është koha për t'u përqendruar më shumë në natyrën sistematike të rrezikut dhe pasigurisë, duke pranuar "Rreziqet gjenden këtu" dhe duke gjetur mjete për t'i vënë në dukje, mbikëqyrur dhe menaxhuar më të rëndësishmit.

- 
- 31 O. Renn, The role of risk communication and public dialogue for improving risk management, *Risk Decision and Policy*, 3 (1) (1998) 5–30.
- 32 M.B.A. Van Asselt, E. Vos, Precautionary principle and the uncertainty paradox, *Journal of Risk Research* 9 (4) (2006) 313–336.
- 33 R.E. Löfstedt, dhe O. Renn, The Brent Spar controversy: An example of risk communication gone wrong, *Risk Analysis* 17 (1997) 131–136; G. Cvetkovich dhe R. Löfstedt, (Eds.), *Social Trust and the Management of Risk*, Earthscan, Londër, 1999.



## MARRËVESHJA SHKENCORE PËRBALLË PASIGURISË

Ndërsa bota mesjetare njohu idenë dhe vlerën e “Rreziqet gjenden këtu”, shkenca, e mbështetur në parimet e vëzhgimit dhe eksperimentit, i qaset çështjes së pasigurisë së papërcaktuar nga një këndvështrim tjetër. Vetë thelbi i shkencës është parimi i hamendjes dhe provës. Shkenca nuk mund të ofrojë siguri, në thelbin e saj qëndron teoria më e mirë e punës së deri tanishme. Në çdo kohë mund të dalin të dhëna të reja për të hedhur poshtë teoritë e tanishme dhe për të kërkuar ndryshimin e tyre. Në parim, shkenca është një ecuri gjallëruese, që pranon dhe përfshin gabueshmërinë duke përparuar, ndërkohë që teoritë më të sakta zëvendësojnë ato të mëparshmet. Megjithatë, sukcesi i të menduarit shkencor në nxitjen e risive teknologjike të shpejta dhe thelbësore, si dhe rritjes ekonomike që vjen bashkë me ‘to, e ka bërë pothuajse të pamundur që gjatë zbatimit të sfidosh morinë e përpjekjeve shkencore dhe rreziqet e qenësishme që mund të paraqesin teknologjitë e reja që ajo krijon.

Shkenca mbështetet kryesisht në dy ecuri, përkatësisht, mendimin dhe shqyrtimin. Ecuria e mendimit përdoret për të vendosur parime përcaktuese që u mundësojnë shkencëtarëve të merren me grupe të mëdha idesh dhe gjërash, mbështetur në veçoritë e tyre të përbashkëta. Ecuria e shqyrtimit u mundëson shkencëtarëve të copëzojnë një çështje në shkallën më të vogël të mundshme.<sup>34</sup> Kjo pikë e ngushtë vështrimi nxit ndjesinë se bota bashkëkohore është e rregulluar dhe e parashikueshme. Përveç kësaj, natyra thjeshtëzuese e të dy ecurive mbështetet në hamendësimin se hollësia e shqyrtimit është përfaqësuesi i tërësisë – duke hedhur poshtë kështu, ndërlikimin e lindur të shumë rrjeteve njerëzore dhe natyrore.<sup>35</sup>

Kjo marrëveshje shkencore ka çuar, rrjedhimisht, në ndjesinë bashkëkohore të një bote të arsyeshme, të matshme dhe të numërueshme. Ka shumë përjasje ndaj rrezikut dhe pasigurisë, duke u mbështetur në njësi themelore të ndryshme, metodika, masa kundër rrezikut dhe qëllime: shqyrtime vendimesh, shqyrtime sasiore të rrezikut, teoria e matjes së aftësive mendore, ndërlikimja e rrezikut, arsytimi i kufizuar, llogaritjet e siguritit dhe kërkimi i rreziqeve natyrore.<sup>36</sup> Ajo çfarë të gjitha këto pikëpamje të ndryshme kanë të përbashkët, është një hamendësim themelor i arsytimit.

34 J. Barzun, *From Dawn to Decadence: 1500 to the Present: 500 Years of Western Cultural Life*, HarperCollins, Londër, 2000.

35 L.H. Gunderson dhe C.S. Holling, (Eds.), *Panarchy: Understanding Transformations in Human and Natural Systems*, Island Press, Washington DC, 2002.

36 C. Jaeger, O. Renn, E. Rosa dhe T. Webler, *Risk, Uncertainty and Rational Action*, Earthscan, Londër, 2001.



Ky model arsyetues mbështetet te ndjesia se pasiguria ka qenë e kufizuar dhe se rreziqet mund të bëhen të njohura dhe të zotërohen. Rrjedhimisht, punimi "Rreziqet gjenden këtu" u pa si i papërshtatshëm dhe, për këtë arsye, u përbuz ose u vra me sukses.

Sipas Këshillit Kombëtar të Hulumtimit, "shtjellimi i pasigurisë është e vetmja mënyrë për të luftuar "ndjenjën e rreme të sigurisë", e cila shkaktohet nga një kokëfortësi për të pranuar dhe (përpjekje për) të numëruar pasiguritë në parashikimet e rrezikut".<sup>37</sup> Megjithatë, nuk ka ende një udhëzim të njohur për një përfaqje të mbrojtur shkencërisht dhe të qëndrueshme ndaj shqyrtimit të pasigurisë<sup>38</sup>, veçanërisht pasi edhe njohësit e fushës ka të ngjarë të përdorin ecurinë e vetëdijes ose anshmërinë, aty ku ka pasiguri të papërcaktuar.<sup>39</sup> Një përfaqje e tillë është grupi i udhëzimeve NUSAP, i sajuar të përcaktojë shkallën e pasigurisë së natyrshme në Shkencën Pas Normale. NUSAP është një shkurtime për pesë kategori të cilat pasqyrojnë cilësinë e të dhënave mbi pasigurinë: 'Numër', 'Njësi', 'Përhapje', 'Vlerësim' dhe 'Zanafillë'.<sup>40</sup> Mundësi të tjera janë të 'fushës shoqërore', ku pjesëmarrës të ndryshëm luftojnë për të vënë në lëvizje burimet shoqërore dhe provat për të fituar mbështetjen e qytetarëve, nën syrin vrojtues të një zbatuesi të rregullave qeveritare dhe medias, ose një 'shesh pазari', një arenë qytetare ku shkenca dhe shoqëria, tregu dhe politika mund të merren vesh rreth përmbajtjes së njohurive të së ardhmes shkencore dhe pasiguritë që ato prodhojnë.<sup>41</sup> Të gjitha këto këshilla përfshijnë qoftë të dhëna 'dijetarësh', qoftë 'qytetarie', shtrojnë pyetje dhe zgjerojnë themelin e njohurive dhe pranimin pa mëdyshje të 'Rreziqet gjenden këtu'.

## DUKE PRANUAR "RREZIQET GJENDEN KËTU"

Në pjesën e mëparshme kam sqaruar se psikologjia njerëzore, kuadri institucional dhe marrëveshjet shkencore, të gjitha kanë punuar në fshehtësi për ta mënjanuar "Rreziqet gjenden këtu" nga vetëdija e përbashkët. Gjithashtu,

37 National Research Council, *Science and Judgment in Risk Assessment*, National Academy Press, Washington DC, 1994, f. 161.

38 *US Environmental Protection Agency, Science Policy Council Handbook: Risk Characterization, EPA 100-B-00-002*, Washington DC, 2000.

39 B. Fischhoff, S. Lichtenstein, F. Slovic, S.L. Derby dhe R.L. Keeney, *Acceptable Risk*, Cambridge University Press, Cambridge, 1981; H. Otway, Public Wisdom, Expert Fallibility: Toward a Contextual Theory of Risk, in: S. Krimsky dhe D. Golding, (Eds.), *Social Theories of Risk*, Praeger, Westport, Londër, 1992, f. 215-228.

40 S.O. Funtowicz dhe J.R. Ravetz, *Uncertainty and Quality in Science for Policy*, Kluwer, Dordrecht, 1990.

41 O. Renn, The social arena concept of risk debates, in: S. Krimsky dhe D. Golding (Eds.) *Social Theories of Risk*, Praeger, Westport, 1992, f. 179-197; H. Nowotny, F. Scott dhe M. Gibbons, *Re-thinking Science: Knowledge and the Public in an Age of Uncertainty*, Polity, Cambridge, 2001.



kam përmendur rreziqet që lindin nga ngurrimi për t'i njohur këto fusha të pasigurisë. Përcaktova se si mund të kundërshtohet kjo ecuri, duke përdorur mjetet dhe ecuritë e reja digjitale të zotërueshme, për t'u mbështetur në një kuadër më të gjerë shoqëror. Duke vepruar kështu, ka të ngjarë të jetë e mundur përfshirja e vlerave dhe botëkuptimeve të ndryshme kulturore, kësisoj, duke përfutuar pranueshmëri më të madhe shoqërore, duke pranuar dhe gjetur më shumë nga 'Rreziqet gjenden këtu'.

Kjo ka edhe disa përparësi të tjera të mundshme. Në shoqërinë e sotme të rrjetëzuar, janë krijuar mundësi të papara dhe ndoshta të pakufishme për njohuri. Të dhënat që disponon shoqëria, ndikojnë në përshtypjen e saj për botën, së bashku me rreziqet dhe mundësitë që kjo përfaqëson.<sup>42</sup> Duke hequr kufizimet e të dhënave të së kaluarës, shoqëria e sotme e ndërlidhur duhet të bëjë një zgjedhje të qartë mes dy përfundimeve të mundshme: një Babel të ditëve të sotme, ose përndryshe, urtësi më të madhe shoqërore të përbashkët.

Si mund të shmangët përfundimi drejt një Babeli? Ka disa veçori të caktuara që duhet t'i kenë një grup njerëzish për të zotëruar 'urtësinë e turmave'.<sup>43</sup> Më e rëndësishmja, grupi duhet të ketë larmi të mjaftueshme, në mënyrë që të prodhojë mendime të ndryshme dhe në mënyrë të pavarur, bashkë me aftësinë për të sfiduar këndvështrime të tjera dhe përjasje në njohuritë e sakta të rrethanave, qofshin ato që kanë të bëjnë me aftësinë, apo me vendndodhjen. Megjithatë, kjo kërkon mjete të përshtatshme për të kthyer shumë gjykime vetjake në një vendim të përbashkët të përmbledhur dhe mosha digjitale ka krijuar lloje të ndryshme prej tyre.

Disa prej shembujve përfshijnë *Wikipedia-n* - faqen e internetit të enciklopedisë bashkëpunuese; *Slashdot* - një faqe interneti që ka të bëjë me teknologjinë e mbushur me lajme të paraqitura nga lexuesit e vet dhe të vlerësuar nga redaktorët; ose *Project Open Dictionary* - që mbështetet në gjashtëdhjetë mijë vullnetarë. Zyra e Shpikjeve dhe Stemave të Shteteve të Bashkuara krijoi kohët e fundit një shembull fillestar *Peer-to-Patent*, që ua mundësoi mbarë qytetarëve me një nivel të caktuar aftësie, të bëheshin *vlerësues vendorë* dhe të ndihmonin zyrën e shpikjeve në gjetjen e të dhënave të rëndësishme për vlerësimin e kërkesave të mbetura pasnormale për shpikjen e gjithsecilit.<sup>44</sup> Gjatë zgjedhjeve presidenciale të vitit 2008, *Tech President*, një grusht njerëzish ndërpartiakë, botues në internet, themeluan Kuvendin e Demokracisë Vetjake, një faqe interneti ndërvepruese që mbikëqyrte mënyrën se si

42 Y. Benkler, *The Wealth of Networks: How Social Production Transforms Markets and Freedom*, Yale University Press, New Haven, 2006.

43 Surowiecki, *The Wisdom of Crowds*, Doubleday, New York, 2004.

44 Ky projekt krijoi një kornizë ligjore, politikash dhe softuerike e cila hapi për herë të parë procesin e shqyrtimit të patentave për pjesëmarrjen e publikut. Referojuni [www.peertopatent.org](http://www.peertopatent.org) [Shikuar: 30 Prill 2010].



votuesit iu përgjigjën përfaqësuesve, por edhe se si ndikoi përmbajtja e asaj që thanë gjatë fushatës.<sup>45</sup> Në secilin rast, njohuritë dhe dhuntitë e një grupi u përdorën për të krijuar përmbajtje, për të parashikuar pengesat, ose për të renditur shqetësimet.<sup>46</sup>

Turmat nuk janë gjithmonë të mençura dhe në kushte të caktuara pasoja Babel është një përfundim më i mundshëm. Pa larminë e mjaftueshme, apo aftësinë për të sfiduar pikëpamjet e të tjerëve, shtohen gjasat e 'mendimit në grup', shmangia psikologjike e mendimeve të kundërta.<sup>47</sup> Për shembull, *digg* - një faqe interneti që përdor teknologjinë on-line për të vlerësuar çështjet përmes votave që ata marrin, u keqpërdor nga një njeri i etur për të ndikuar në mendimet e grupit. Ai thjesht bleu vota, që të fitonte një popullaritet mjaft të lartë, por, çuditërisht, pasi kishte arritur një nivel të caktuar, nuk kishte më nevojë të blinte vota, pasi ndërhyrja e tij në rrjet kishte krijuar vrullin e vet.<sup>48</sup> Dëshira njerëzore për t'u lidhur me suksesin dhe pranimin në grup, çoi në një 'pikë kthese' ku idetë, prodhimet, porosinë dhe sjellja përhapen, ashtu siç bëjnë edhe viruset.<sup>49</sup> Kjo dukuri mund të çojë në vendimmarrje nën lartësinë e duhur, ose në keqpërdorime të stërholluara nga palë të ndryshme të përfshira.

Në ekonominë e sotme të rrjetit të të dhënave, vëllimi i madh dhe mundësia e ndërlikimit të tyre, zakonisht, mundëson një mënyrë të redaktimit të të dhënave të disponueshme. Ka shumë mjete dhe ecuri në themel të *web*-it, që ofrojnë një veprimtari të tillë redaktimi, duke e shoqëruar në këtë mënyrë atë vend pune me fuqi të mëdha. Rrojtari/redaktori është në gjendje të zotërojë rrjedhën e të dhënave dhe të filtrojë përmbajtjen e tyre, duke ndikuar kështu, jo vetëm në të dhënat e disponueshme, por edhe në përshtypjen e faqes për botën, si dhe "Rreziqet gjenden këtu" - ose mungesën e këtyre rreziqeve.

Një qasje më e shtërtë për të hulmtuar përshtypje të ndryshme të një rreziku të veçantë është metodika e Modeleve Mendore - CMU, e zhvilluar fillimisht për të hulmtuar përshtypjen qytetare rreth radonit, një lëndë e rrezikshme që mund të ndotë cilësinë e ajrit në brendi dhe të shkaktojë kancer të mushkërive. Metodika është përshtatur për përdorim në rrethana të tjera dhe ofron një kuadër teorik për zbërthimin e vazhdueshëm të

45 Referojuni <http://techpresident.com> [Shikuar: 30 Prill 2010].

46 J. Howe, *Crowdsourcing: Why the Power of the Crowd Is Driving the Future of Business*, Crown, New York, 2008.

47 I. Janis, *Groupthink: Psychological Studies of Policy Decisions and Fiascoes*, Houghton Mifflin, Boston, 1982.

48 A. Newitz, I Bought Votes on Digg, *Wired*, 2007. [www.wired.com/techbiz/people/news/2007/03/72832](http://www.wired.com/techbiz/people/news/2007/03/72832) [Shikuar: 30 Prill 2010]

49 M. Gladwell, *The Tipping Point: How Little Things can make a Big Difference*, Little, Brown and Company, Londër, 2000.



qëndrimeve, vlerave dhe përshtypjeve të qytetarëve, së bashku me mënyrat përmes së cilave ata përpunojnë të dhënat e tyre.<sup>50</sup>

Një tjetër mënyrë për t'i gjetur dhe krahasuar "Rreziqet gjenden këtu", është harta e të dhënave. Një nga veçoritë e "Rreziqet gjenden këtu" është ana e tyre me shumë përmasa që krijon ndërlikim që vështirë se mund të kuptohet. Kjo veçori mund të mbartet në një murale të madhe, duke sqaruar marrëdhëniet dhe ndërlidhjet me çështjet afërndenjese dhe duke krijuar një gjuhë pamore si dhe një hartë të përbashkët mendore që mund të dyfishohet dhe ndryshohet - me 'Rreziqet gjenden këtu' të vendosura në tërësi, aty ku është e përshtatshme.<sup>51</sup>

Ka shumë çështje me të cilat duhet të merremi, nëse dëshirojmë të përfshijmë një kuadër më të gjerë shoqëror. Një nga çështjet është nëse qytetaria është në gjendje të zgjedhë dhe ndryshojë lirisht redaktorin e vet dhe, nëse jo, cilat mund të jenë nivelet e varësisë dhe zgjidhjes. Çështja e dytë ka të bëjë me nivelin e interesit të të gjithë njerëzve që japin ndihmën e nevojshme, me qëllim që të përfshihen prurjet e tyre në ecurinë e përbashkët dhe cilën mënyrë shpërblimi nënkupton kjo ecuri. Në fund të fundit, pyetja që ka rëndësi, është nëse këto mjete dhe ecuri të reja digjitale mund të çojnë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe pranimit të "Rreziqet gjenden këtu" - apo mos shtypja e psikologjisë njerëzore, kuadrit institucional dhe marrëveshjeve shkencore do vazhdojnë t'ua zënë frymën njohurive të pranueshme. Besimi im vetjak është se këto mjete, të përdorura në lidhje me planveprimet dhe metodikën e parashikimit, të shqyrtuara më poshtë, mund të sigurojnë që "Rreziqet gjenden këtu" do të vendosen në hartat tona mendore të përbashkëta.

## PLANVEPRIMET SI SHQYRTIME TË RREZIQVEVE PËRTEJ FUSHËVEPRIMIT FINANCIAR

Parashikimi është ecuria drejt hulumtimit të së ardhmes. Fuqitë tona njerëzore të largpamësisë na lejojnë të përfytyrojmë atë që nuk ka ndodhur ende, në mënyrë që të mbrohemi nga të vërtetat e ashpra të përvojës së tanishme. Ne

50 A. Bostrom, B. Fischhoff dhe G.M. Morgan, Characterising Mental Models of Hazardous Processes: A Methodology and an Application to Radon, *Journal of Social Issues*, 48 (4) (1992) 85–100; G.M. Morgan, B. Fischhoff, A. Bostrom dhe C.J. Atman, *Risk Communication: A Mental Models Approach*, Cambridge University Press, New York, 2002.

51 R.E. Horn, *What we do not know: Using information murals to portray scientific ignorance*, *Futures*, doi:10.1016/j.futures.2005.07.009, (2005) 1–5; Referojuni gjithashtu [www.stanford.edu/~rhorn/a/site/Horncv.html](http://www.stanford.edu/~rhorn/a/site/Horncv.html)





e ndërmarrim këtë ecuri për të kuptuar dhe formësuar drejtimin në të cilin mund të shpaloiset e ardhmja, pasi disa të ardhme janë pafundësisht më të dëshirueshme se të tjerat. Megjithatë, ka ecuri zhbiruese dhe thellësisht njohëse, që do të paragjykojnë të dhënat që ne nxjerrim.<sup>52</sup> Kjo mund të pengojë përpjekjet për të gjetur dhe kuptuar se “Rreziqet gjenden këtu”.

Metodika e planveprimeve është metodikë parashikuese që ia ngarkon vetes hulumentimin e ndërlikimit dhe rrjeteve të shkollave, mendimet e të cilave nuk përputhen. Planveprimet ofrojnë një mënyrë hulumentimi të përbashkët të pasigurive, për të gjallëruar kështu, një kuptim të përbashkët të energjive dhe çështjeve themelore që mund të ndikojnë në të ardhmen. Për shkak se planveprimet miratojnë një horizont më të gjatë kohor, hartuesit e tyre kanë të drejtën për të parë përtej interesave dhe çështjeve afatshkurtra, veçori këto për shumë vendimmarrje institucionale dhe politike, duke u dhënë krijuesve të planveprimit ‘lejen’ për të hulumentuar ‘Rreziqet gjenden këtu’.

Edhe pse jo një qëllim në vetvete, planveprimet janë një mënyrë e dobishme për të kuptuar një varg zgjedhjesh të mundshme, si dhe për të zbardhur rreziqet dhe mundësitë e mundshme. Ato janë ndërtuar nga një grup i larmishëm njerëzish që përfshijnë aftësi nga një fushë e gjerë shkencash të ndryshme, duke nxitur kështu bashkëpunimin dhe pjellorinë mendore të kryqëzuar e duke thjeshtëzuar mendimin e mundshëm të grupit. Planveprimet vijnë në tufë dhe përmbajnë disa lloj mundësish për të ardhmen barazisht të besueshme, duke detyruar grupet e ndryshme të pranojnë disa të dhëna që sfidojnë botëkuptimet e tyre, por, në të njëjtën kohë, pranojnë fushë pamjen e tyre. Ecuria rrit gjasat për të kuptuar mundësitë se “Rreziqet gjenden këtu” dhe, në fund të fundit, nevojën e një ndërgjegjësimi më të madh dhe kundërveprimi ndaj botës së ndërlikuar të së tashmes.

**PËRDORIMI I PLANVEPRIMEVE SI MJET PARASHIKIMI KA KUFIZIME TË QENËSISHME: DALJET DO TË JENË PO AQ TË MIRA, SA EDHE HYRJET.**

Cilësia do të varet nga ecuria dhe shumëllojshmëria e nevojshme e mendjeve të përbashkëta, pjesëmarrësve në sallë, ose të atyre, mendimi i të cilëve,

52 A. Tversky dhe D. Kahnemann, Judgment under Uncertainty: Heuristics and Biases, *Science* 185 (1974) 1124–1131; A. Tversky dhe D. Kahnemann, The Framing of Decisions and the Psychology of Choice, *Science* 211 (1981) 453–458; L. Festinger, *A Theory of Cognitive Dissonance*, Stanford University Press, Stanford, 1957.





në një farë mënyre, është përfshirë. Edhe pse planveprimet janë një mënyrë e papërsosur, ato lehtësojnë gatishmërinë për të ardhmen. Në mungesë të një shkopi magjik, zakonisht, është më mirë të kesh pjesërisht të drejtë në një varg hamendësimesh të mundshme, sesa të gabosh krejtësisht.

Njerëzit dhe institucionet e tyre janë zakonisht kundërshtues ndaj ndryshimeve. Pothuajse pesë shekuj më parë, Makiaveli tha: “Duhet të mbahet mend, se nuk ka asgjë më të vështirë për t’u marrë në dorë, më të rrezikshme për t’u kryer, ose më të pasigurt në suksesin e vet, sesa të marrësh përsipër udhëheqjen e parashtrimit të një rendi të ri”. Sepse shpikësi ka për armiq të gjithë ata që kanë përparuar në kushtet e vjetra dhe ka mbrojtës të vakët të gjithë ata që mbase mund të përparojnë në të reja.<sup>53</sup> Megjithatë, nuk ka pasur kurrë nevojë më të madhe për përshtatshmëri shoqërore, përballë ndryshimeve me tregues të dukshëm. Sot, shoqëritë njerëzore janë aq të ndërlidhura dhe të ndërvarura, sa ka një nevojë të madhe për lakueshmëri, megjithatë kjo do të kërkojë njohjen e “Rreziqet gjenden këtu” dhe strategji për t’u marrë me vënie e tyre në jetë. Për këtë arsye, unë besoj se planveprimet ofrojnë një mënyrë të mundshme për shqyrtimin e “Rreziqet gjenden këtu”, përtej fushëveprimit financiar, si dhe për çështjet me të cilat shoqëria jonë përballet vazhdimisht. Ato mund ta kapërcejnë sigurinë e rreme të krijuar nga verbëria shoqërore dhe, gjithashtu, të merren me çështje të zbatueshmërisë së paanshme dhe mundësisht përfundimeve të paanshme.<sup>54</sup>

## PËRFUNDIM

Shkenca i ka mundësuar shumë përgjigje botës në të cilën jetojmë. Rrjedhimisht, kjo ka çuar në përparim të paparë teknologjik dhe zhvillim ekonomik. Megjithatë, padija, paqartësia dhe pasiguria shkencore shumë shpesh janë fshirë me lehtësi nga hartat tona të njohurive. Zakonisht, “Shkencës së shëndoshë” i kërkohet mbështetje për mënyrat e vendimmarrjeve. Por me dijetarët shkencorë të disponueshëm, për të shtjelluar pro ose kundër, sipas nevojës, hidhet në erë çdo pamje asnjësie dhe arsyetimi.

Tani është koha për të pranuar se “Rreziqet gjenden këtu” dhe për të hulumtuar se cilat prej tyre përbëjnë rrezikun më të madh për shoqërinë


53 N. Machiavelli dhe F. Rodd, (Trans.) *The Ruler*, The Bodley Head, Londër, 1954 (originali, 1532), f. xx.

54 S. Elahi, Conceptions of Fairness and Forming the Common Ground, in: R. Ramirez, J.W. Selsky dhe K. van der Heijden (Eds.) *Business Planning for Turbulent Times: New Methods for Applying Scenarios*, Earthscan, Londër, 2008, f. 223–241



që dëshirojmë për veten dhe pasardhësit tanë. Kjo do të siguronte që vendimmarrjet afatshkurtra të mos bëhen në kurriz të largpamësive afatgjata, për të mirën e njerëzimit. Gjithashtu, kjo duhet të çojë në një shpërndarje më të drejtë dhe më me rendiment të burimeve të pakta.

Bota po ndryshon përgjithmonë. E vetmja siguri në këtë botë të pasigurt është se "Rreziqet gjenden këtu" të së nesërme nuk ka gjasa të jenë ata të sotmet. Rreziqet e sotme mund të jenë të fshehura, të padëshiruara dhe të panjohura, por ato nuk do të qëndrojnë përgjithmonë jashtë kufijve të hartës sonë të përbashkët mendore. Vendimmarrja jonë sot, do të ndikojë në botën e së nesërme, duke përfshirë vendndodhjen, madhësinë dhe shkallën e 'Rreziqet gjenden këtu'. Sido që të jenë përfundimet që dalin nga politikëbërësit dhe institucionet, padija rrit mundësinë e paqëndrueshmërisë së vazhdueshme dhe ndryshimeve shkatërruese. "Rreziqet gjenden këtu" dhe janë rreth nesh. Meqenëse qeniet njerëzore varen nga rrjetat e ndërlikuara të sistemeve të ndërlidhura njerëzore dhe natyrore, i përbuzin këto rreziqe, pa marrë parasysh pasojat.



The image features a vibrant blue background with several overlapping black circles of varying sizes and thicknesses. The circles are arranged in a way that they appear to be in motion or layered, creating a sense of depth and complexity. The text is centered within the composition.

KOHA DHE  
HAPËSIRA





## Artefaktet e kohëve pasnormale

Ziauddin Sardar

Zakonisht, na pëlqen ta ndajmë historinë në periudha kohore. Kjo na ndihmon të shohim se si lëviz historia, çfarë përparimesh janë bërë dhe të marrim parasysh ndryshimet e lakores, nëse ka. Prirja për renditjen e historisë ka rrëfenjën e vet dhe mund të gjurmohet që te poeti grek Hesiod, i cili e ndau parahistorinë në Epokën e Artë, të Argjendte dhe të Bronztë, në Epokën Heroike dhe, në fund, në Epokën e Hekurit. Ovidi, poeti romak, u pajtua me 'të dhe prodhoi gojëdhëna të ngjashme në librin e tij *Metamorfozat*. Veçse ai pa vetëm katër periudha: pa heronj që përmirësonin gjendjen e trishtuar të njerëzimit në renditjen e tij. Megjithatë, drejtësia dhe paqja mbretëruan gjatë Epokës së Artë, ndoshta ngaqë, siç na thotë Ovidi, njeriu nuk mund të lundronte, ishte i kufizuar rreth vendit ku lindi dhe nuk u ndesh me tjetrin. Në të kundërt, astrologët iu shmangën metaleve dhe zgjodhën shenjat e zodiakut. Pra, ne kemi Epokën e Demit, Dashit, Peshqve, e kështu me radhë, duke përfshirë 'Epokën e Ujorit', e cila ishte shumë në zë gjatë viteve 1960 dhe 1970, kohë kur edhe unë isha një fëmijë i dhënë pas luleve, si shenjë paqeje dhe dashurie, dhe iu bashkova të tjerëve për t'u habitur nga 'Hair', muzikali amerikan i dashurisë për *rock'n'roll*. Krishterimi ka Gjashtë Epokat e Botës; ndërkohë që hinduizmi ka katër Yuga (Satya, Treta, Dvapara dhe Kali), gjatë të cilave ne vazhdimisht bëhemi gjithnjë e më të pamoralshëm dhe shtazarakë.

Në përgjithësi, ndarjet e historisë shihen nga tre këndvështrime kryesore: kozmologjike, gjeologjike dhe historike. Pikëvështrimi kozmologjik, siç mund të pritej, shkon më përtej *Big Beng*-ut, 13.8 miliardë vjet më parë. Fillimisht, nis me të dhjetat e sekondës: Epoka e Plank-ut<sup>1</sup> (10–43 sekonda pas Big Beng-ut); Epoka e Bashkimit të Madh (ndërmjet 10–43 deri në 10–36 sekondave pas Big Beng-ut); Epoka e Ndërveprimit të dobët (midis 10–36

1 Shkencëtari gjerman që në vitin 1900 hartoi Teorinë e Fizikës Kuantike.



deri në 10–12 sekondave pas Big Beng-ut, ndërsa gjithësia ftohet); Epoka e fryrjes (midis 10–36 deri në 10–32 sekondave pas Big Beng-ut, ndërsa gjithësia rrafshohet). Pas këtyre periudhave, ne lëvizim deri në fund përmes grimcave të thjeshta (kuarke, hadrone, leptone, fotone). Kur mbërrijmë te minutat, kemi Epokën e krijimit të bërthamës (3 deri në 20 minuta pas Big Beng-ut) dhe, më pas, duhet të presim 377.000 vjet, para se të vijë Epoka e ndërthurjes dhe 150 milion deri në një miliard vjet, derisa yjet e para fillojnë të formohen në Epokën e rizonizimit. Pikëvështrimi gjeologjik përmban Epoka kenozoike, mesozoike, paleozoike, neo-proterozoike, meso-poterozoike dhe paleo-proterozoike, secila e nën-ndarë në periudha, epoka dhe moshë, me një ecuri ngjarjesh shtresë pas shtrese. Kur bëhet fjalë për këndvështrimin historik, renditja është e thjeshtë ose problematike, në varësi të këndvështrimit tuaj. Skema mbizotëruese fillon me Historinë e Lashtë (3600– 500 f. e.s.), pastaj njerëzimi zhduket me shekuj dhe asgjë nuk ndodh realisht (nga pikëpamja perëndimore), derisa vijmë në epokën pas-klasike (500–1500) dhe kalojmë me shpejtësi në Historinë Moderne (1500 e këtej), e cila ndahet në Modernen e Hershme, Modernen e Mesme dhe Bashkëkohore. Në thelb, historia shihet kryesisht si Historia e Qytetërimit Perëndimor, e hamendësuar të jetë kulmi i arritjeve njerëzore dhe renditja e saj pasqyron këtë qëndërzim European. Ne, zakonisht, fillojmë me Greqinë dhe kalojmë në Mesjetë, sikur asgjë të mos kishte ndodhur në mes.

Islami dhe Kina janë të mënjanuara, nëse jo të harruara, se historia dhe ideologjia rrallë janë të ndara. Sigurisht, kultura, qytetërime dhe kombe të ndryshme do të kishin renditjet e tyre dhe autorë të ndryshëm kanë prodhuar ndarjet e tyre.

Historiani mysliman i shekullit të XIV-të, Ibn Khaldun, e ndau historinë në vetëm dy pjesë: shfaqja dhe thelbi.<sup>2</sup> Për Ibn Khaldun-in, renditja e historisë nuk ishte e rëndësishme, as ngjarjet aktuale përgjatë historisë. Ajo çfarë vlen sipas tij, është vështrimi se si historia i dha formë jetës shoqërore dhe mjedisit vendor e botëror. Te *Rënia e Perëndimit* (1981), historiani gjerman Oswald Spengler hodhi poshtë idenë e historisë drejtvizore, të ndarë në periudha të papërlyera me emërtesa ‘antike-mesjetare-moderne’.<sup>3</sup> Spengler këshilloi se historia duhet parë nga pikëpamja e kulturave që rriten organikisht në një qytetërim dhe pranoi tetë ‘kultura të larta’: babilonase, egjiptiane, kineze, indiane, meksikane (maja/astek), klasike (greke/romake), arabe dhe perëndimore.

2 Ibn Khaldun, *The Muqaddimah: An Introduction to History*, translated by Franz Rosenthal (Princeton: Princeton University Press, 1967).

3 Oswald Spengler, *The Decline of the West* (Sydney: Oxford University Press, 1991).



Historiani amerikan i shkencës, Xhorxh Sarton, i ndau periudhat historike, duke i caktuar çdo gjysmë shekulli një dietari të shquar mbizotërues.<sup>4</sup> Pra, ne fillojmë me “Epokën e Homerit” dhe rregullisht vazhdojmë përpara nga grekët te “Koha e Hsuan Tsang”, “Koha e I-ching” dhe “Koha e Bede”, gjysma e parë e shekullit të XVIII-të. Tani e tutje është koha e mendimtarëve myslimanë: ‘Koha e Xhabir ibn Hajanit’, babait të Kimisë; ‘Koha e el-Kuarizmit’, shpikësit të Algjebrës; ‘Koha e al-Razi’ e kështu me radhë, deri te Koperniku dhe rilindësit perëndimorë. Historiani britanik, Arnold Tojnbi, e pa historinë nga këndvështrimi i shkëlqimit dhe rënies së qytetërimeve. Ai përshkroi 23 qytetërime.<sup>5</sup> Sigurisht që ju, gjithashtu, mund ta ndani historinë sipas mbretërive, mbretërve, luftërave dhe pushtimeve, duke përfshirë imperializmin dhe kolonializmin, gjë që e kanë bërë shumë historianë. Kohët e fundit, historiani marksist britanik, Eric Hobsbawm, e ndau historinë e pas-Rilindjes në Epokën e Revolucionit, 1789–1848; Epokën e Kapitalit, 1848–1875; Epokën e Perandorisë, 1875–1914 dhe Epokën e Ekstremeve, 1914–1991<sup>6</sup>, kjo sipas titujve të veprës së tij madhështore me katër vëllime. Në librin e tij të ri, Henry Kissinger<sup>7</sup> e ndan historinë në katër ‘rende botërore’: islamik, kinez, europian dhe amerikan.

Por nuk janë vetëm historianët dhe shkencëtarët politikë ata që kanë qenë të zënë duke e ndarë të kaluarën në copa të tretshme. Edhe hulumtuesit e së ardhmes kanë bërë të njëjtën lojë. Alvin Tofler e pa historinë si diçka që lëviz në tre valë. E para fillon me shoqërinë bujqësore e cila zëvendësoi gjuetarët me bujq dhe blegtorë. E dyta me Revolucionin Industrial në Europë, i cili solli për herë të parë prodhimin dhe shpenzimin në masë të gjerë, dhe Tofler besonte romantikisht në edukimin e masave. *Vala e Tretë*<sup>8</sup> do të jetë shoqëria pas-industriale, ose, nëse dëshironi, shoqëria e të dhënave. Hulmuesit ndjellakeqë të së ardhmes e panë historinë e kohëve të fundit, teksa hidhet nga kriza në krizë. Ronald Higgins mendon se ne kemi kaluar nga gjashtë kërcënime - shpërthimi i popullsisë, mungesa e ushqimit, varfërimi i burimeve, pakësimi i mjedisit, kërcënimi bërthamor, shpërdorimi i shkencës dhe i teknologjisë - *tek Armiku i Shtatë*<sup>9</sup>: amulli politike dhe verbëri industriale. Që të dy, Tofler dhe

4 George Sarton, *Introduction to the History of Science* (New York: Robert E Krieger, 1975), 3 volumes.

5 Arnold Toynbee, *A Study of History* (Oxford: Oxford University Press, 1961), 12 volumes.

6 Eric Hobsbawm, *The Age of Revolution 1789–1848* (Londër: Weidenfeld and Nicolson, 1962); Eric Hobsbawm, *The Age of Capital 1848–1875* (Londër: Weidenfeld and Nicolson, 1975); Eric Hobsbawm, *The Age of Empire 1875–1914* (Londër: Weidenfeld and Nicolson, 1987); Eric Hobsbawm, *Age of Extremes 1914–1991* (Londër: Weidenfeld and Nicolson, 1994).

7 Henry Kissinger, *World Order* (Londër: Allen Lane, 2014).

8 Alvin Toffler, *The Third Wave* (New York: Bantam Books, 1980).

9 Ronald Higgins, *The Seventh Enemy* (Londër: Hodder and Stoughton, 1978).





Higins, ishin pjesërisht të saktë. Ndoshta zhvillimet e fundit në biologjinë artificiale, shtypi 3-D dhe 'Interneti i Shtëpisë' po na shtyjnë përtej valës së tretë, në të katërtën. Edhe nëse nuk ua kemi kushtuar kujdesin e duhur gjashtë kërcënimeve të Higins-it, amullia politike dhe verbëria e plotë ndaj çoroditjes mbarëbotërore është shumë e dukshme.

Megjithatë, ka pasur disa ndërhyrje të rëndësishme në renditjen e historisë, gjë që tregon se ne po shkojmë drejt një ndryshimi të lakores. Për shembull:

**KA QENË MENDUAR SE SJELLJA E NJERIUT ËSHTË TASHMË E  
NGATËRRUAR AQ THELLË NË NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE  
NDRYSHIMET NË ATMOSFERËN E TOKËS, SAQË SHËNJON  
MBËRRITJEN E NJË EPOKE GJEOLOGJIKE: ANTROPOCENE, EPOKA E  
RE GJEOLOGJIKE E MATUR QË NGA KOHA KUR VEPRIMTARITË  
NJERËZORE FILLUAN TË KISHIN NJË NDIKIM MBARËBOTËROR NË  
BOTËN BIMORE DHE SHTAZORE TË TOKËS.**

Shkrimtarja shkencore, Elizabeth Kolbert, sqaron se shkalla e zhdukjes së gjallesave po rritet aq shpejt, saqë tani po shkojmë drejt Zhdukjes së Gjashtë. Pesë të mëparshmet shkaktuan dobësimin e thellë të larmisë:

e para ndodhi gjatë periudhës së vonë të Ordovicianit, rreth 450 milionë vjet më parë, kur gjallesat ishin ende të kufizuara kryesisht në ujë. Më shkatërruesja ndodhi në fund të periudhës Permiane, rreth 250 milionë vjet më parë, dhe ishte shumë afër zbrazjes së tokës kretësisht. (Kjo ngjarje, nganjëherë, përmendet si "nëna e zhdukjeve masive", ose "vdekja e madhe"). Zhdukja masive më e fundit dhe më e dëgjuaardhi në fund të periudhës së Kretakut. Ajo zhduku, përveç dinozaurëve, edhe plezozaurët, mosazaurët, amonitët dhe pterozaurët.<sup>10</sup>

Kolbert vëren se një vështrim i shpejtë i shkallës së tanishme të zhdukjes përgjatë amfibëve tregon se kemi të bëjmë me një ngjarje fatkeqësie të ngjashme, e cila është rrugës.

Por, pavarësisht se si e ndani historinë, ju duhet të jeni në gjendje t'i lidhni ndarjet tuaja me disa lloj artefaktesh - një grusht idesh, pikëpamjesh, arritjesh, shkresash, vendesh, sendesh - që nxjerrin në pah veçorinë përcaktuese të secilës ndarje. Arkeologjia, për shembull, në thelb mbështetet te studimi i sendeve me vlerë – sende që paraardhësit tanë kanë prodhuar në

10 Elizabeth Kolbert, *The Sixth Extinction* (Londër: Bloomsbury, 2014), f. 6.



qelq, qeramikë, dru, metal dhe gur – të cilat thonë diçka për të kaluarën. Periudha Neolitike, fjala vjen, shpërfaq sende të tilla madhështore, të ruajtura me përkushtim. Ato të Epokës së Bronzit përfshijnë armë, të tilla si kamë, vegla, stoli si unaza dhe gjerdan, tenxhere dhe vazo, miniatura të kuajve, tigrave dhe njerëzve, si dhe makineri prej bronzit. Në mënyrë të ngjashme, ne mund të nxjerrim në pah artefaktet e veçanta dhe veçoritë e tyre të veçanta – sende dhe ide, bashkë me ndryshimet në institucionet politike dhe shoqërore – në krahasim me periudha të tjera.

Nga një këndvështrim i kohëve pasnormale<sup>11</sup>, vetvetiu lind pyetja: Nëse kohët pasnormale janë një periudhë e veçantë e historisë dhe shënojnë një largim nga periudha të tjera të fundit të historisë, çfarë artefaktesh dhe veçorish të veçanta kanë prodhuar, ose ka të ngjarë të prodhojnë? Çfarë ‘gjërash’, siç thuhet në gjuhën e përditshme, që e njëjtësojnë atë si një periudhë të veçantë?

Gjëja e parë që duhet të theksohet këtu, është se shkalla kohore për të cilën po flasim, është krejt e ndryshme nga matjet në shkallë të gjerë të historisë. Ndryshimi i përshpejtuar vazhdon të tkurrë dhe të shembë periudhat historike. Për shembull, historia e teknologjisë e ndan periudhën moderne në Epokën e Makinerisë (1880–1945), Epokën e Naftës (pas 1901), Epokën Atomike (pas 1945), Epokën e Hapësirës (pas 1957) dhe Epokën e të Dhënave (1970 – deri tani). Vini re, se si epokat tkurren dhe si mbivendosen. Epoka e të Dhënave na ka çuar në Epokën e Internetit (1985 e këtej), Epokën e Multimedias (1987–2007) dhe Epokën e të Dhënave Masive (2007- deri tani)<sup>12</sup>, Pasmodernizmi është pasojë e Epokës së të Dhënave. Me fjalë të tjera, është botëkuptimi mbizotërues, që nga vitet 1970, deri në 2000, që në vetvete ishte një kundërveprim ndaj teprive të modernitetit, periudhë e njëjtësuar me ‘modernen’. Sigurisht, këto nuk janë ndarje të rregullta dhe të pastra. Ato mbivendosen së tepërmi. Kohët pasnormale shfaqen pas dhjetë vjeçarëve pasmodernë, gjatë asaj që mund ta quajmë Periudha Bashkëkohore.

Periudha Bashkëkohore, në përgjithësi, mbulon historinë ende në kujtesën e gjallë. Zakonisht, ne kemi besuar se kujtesa e gjallë zgjat rreth 80 vjet - shumica e njerëzve të gjallë në të 80-at, sot mund ta kujtojnë fëmijërinë e tyre (nëse nuk vuajnë nga murtaja bashkëkohore e çmendurisë dhe Alzajmerit). Pra, është afërsisht periudha që përfshin Luftën e

11 Ziauddin Sardar, ‘Welcome to Postnormal Times’ *Futures* 42 (2010) f. 435–444; Ziauddin Sardar, ‘Postnormal Times Revisited’ *Futures* 67 (2015) f. 26–39; Ziauddin Sardar dhe John Sweeney, ‘The Three Tomorrows of Postnormal Times’ *Futures* 75 (2016) f. 1–13.

12 Daniel R Headdrick, *The Tools of Empire* (Oxford: Oxford University Press, 1981).



Dytë Botërore, e cila shënjon fillimin e Epokës Atomike dhe që ndan epokat e kaluara, nga ajo që shihet si periudha më e re e historisë botërore: kohët e tanishme.

Nëse kohët pasnormale kanë prodhuar artefaktet e tyre, ne duhet të jemi në gjendje t'i dallojmë ato nga artefaktet e periudhave të tjera bashkëkohore, si kohët moderne apo pasmoderne. Për qëllime studimi, le ta ndajmë Periudhën Bashkëkohore në katër pjesë:

Klasike: 1920 -1950

Moderne: 1950 -1975

Pasmoderne: 1975 - 2005

Pasnormale: 2005 - ...

Kjo ndarje është po aq e paarsyeshme, sa periudhizimet e tjera, apo përpjekjet e tjera për ta renditur historinë në blloqe të emërtuara. Mirëpo, puna është se ne mund të zbardhim artefakte të lidhura me periudhat klasike, moderne dhe pasmoderne dhe të shohim nëse kohët pasnormale kanë prodhuar diçka që është e ndryshme në mënyrë bindëse. Por, së pari, le të përcaktojmë me pak më shumë kujdes tri periudhat tona paraardhëse të kohëve pasnormale.

Klasikja - nuk duhet të ngatërrohet me *klasikët* - ka të bëjë veçanërisht me prurjet kulturore të Greqisë dhe Romës së Lashtë. Kur studiojmë klasikët, studiojmë gjuhën dhe letërsinë e lashtësisë klasike (600 f. e.s. - 600 e.s.). Është e qartë se nuk po flasim për Platonin apo Filonin e Aleksandrisë. Por ne po e përdorim emërtesën në kuptimin e diçkaje që ka një tërheqje të qëndrueshme dhe një cilësi të qëndrueshme dhe të përjetshme; edhe si mbimër (një makinë klasike), ose si emër (një klasik i letërsisë). Një klasik mund të jetë diçka e vjetër, por nuk është diçka antike; ende çmohet dhe shihet si me vlerë të brendshme. Mund të jetë një ide, si përparimi, ose një institucion shoqëror, siç është martesë.

Por ne e kemi fjalën posaçërisht për prurje klasike të Periudhës Bashkëkohore. Për shembull, *Cadillac V16* dhe një *Rolls Royce*, para vitit 1940, shihen si makina klasike. Kur mendojmë për kinemanë klasike të Hollivudit, na vjen ndërmend një periudhë e caktuar që përdoret për Studimet e Filmit, "*Gone With the Wind*" (1939) dhe "*Citizen Kane*" (1941). Kjo është afërsisht periudha midis viteve 1920 dhe 1950.

Epoka moderne është paksa e vështirë për t'u përcaktuar. Periudha e hershme moderne e ka zanafillën që me Kristofor Kolombin, vazhdon me Rilindjen dhe Iluminizmin dhe mbaron me Epokën Viktoriane. Periudha moderne e vonë fillon me Revolucionin Industrial dhe mbaron me Luftën e



Ftohtë. Është e qartë se kjo nuk është ajo çfarë ne nënkuptojmë me modernen. Ne po përdorim modernen, ashtu siç përdoret në historinë e artit, ku “modernizmi i vonë” është periudha që fillon pas Luftës së Dytë Botërore. (Duhet të theksohet se modernizmi që është një lëvizje në art dhe moderniteti që është një këndvështrim ideor, nuk janë të njëjta dhe nuk mund të shkëmbehen). Lidhur me pikësynimet tona, Epoka moderne fillon në vitin 1955, kur shfaqen për herë të parë televizioni, nëndetëset bërthamore, përzjerja e frekuencave muzikore dhe kur konferencat për shtyp të kryetarëve të shteteve përçohen përmes televizionit.

Çuditërisht, periudha pasmoderne është më e lehtë për t’u vënë re. Ajo paralajmërohet që me botimin e *Gjendjes Pasmoderne*, nga Jean-François Lyotard.<sup>13</sup> Megjithëse këtu ka gjithashtu një farë ngatërrese me sociologun britanik, Zigmunt Bauman, që flet për *Modernitetin e Lëngshëm*<sup>14</sup>, atë që të tjerët e kanë quajtur Moderniteti i Vonë, por që anon drejt shkrirjes së kufirit dhe nuk dallohet nga pasmodernizmi. Kritiku letrar amerikan, Fredrik Xhejmeson, e përshkruan pasmodernizmin te nëntitulli i librit të tij të mirënjohur, si “Logjika kulturore e kapitalizmit të vonë”.<sup>15</sup> Sigurisht, duhet të ketë pasur arsye të forta që në krye të herës, që Lajotardi të na jepte një libër si ‘Raporti i gjendjes së artit’. Pra, përmes këtyre, mund të shënojmë fillimin e Epokës pasmoderne, që nga viti 1975.

Deri në vitin 2005, pasmodernizmi u zhvlerësua në masë të madhe, edhe pse ende mbrohet fuqimisht nëpër skuta të caktuara akademike. Pra, le të themi që kohët pasnormale fillojnë diku nga viti 2005, kur folja ‘to google’, d.m.th. kërko në *Google*, mbizotëronte gjithandej.

Ne mund ta shoqërojmë secilën nga këto periudha me veçori të caktuara. Për shembull, gjatë periudhës klasike, ndryshimi ishte i ngadaltë, ose gjërat nuk ndryshonin fare. Ndryshimi u rrit gjatë periudhës moderne, duke u bërë gjithnjë e më i shpejtë gjatë periudhës pasmoderne dhe po përshpejtohet e çoroditet gjatë kohëve pasnormale. Gjatë periudhës klasike, politikisht, bota u organizua në mbretëri dhe u copëtua në shtete kombëtare gjatë periudhës moderne. Ndërkohë që shtetet kombëtare vazhdojnë ende, grupime dhe lidhje krahinore – si Bashkimi Europian dhe Shoqata e Kombeve të Azisë Juglindore – marrin rëndësi të madhe gjatë periudhës pasmoderne. Në kohët pasnormale, pushteti po zhvendoset drejt lojtarëve të fuqishëm tregtarë joshtetërorë, si Google dhe Facebook,

13 Jean-François Lyotard, *The Postmodern Condition* (Manchester: Manchester University Press, 1978).

14 Zygmunt Bauman, *Liquid Modernity* (Oxford: Polity Press, 2000).

15 Fredric Jameson, *Postmodernism: Or, the Cultural Logic of Late Capitalism* (Londër: Verso, 1992).



madje edhe grupe terroriste si Al-Kaeda, për të përmendur vetëm njërin prej tyre. Gjatë dhjetë vjeçarëve klasikë, rendi botëror u mbikëqyr nga fuqitë pushtuese konkurrenente (Britania, Franca, Holanda dhe SHBA-ja). Që në krye të herës, periudha moderne rrëshqiti drejt Luftës së Ftohtë dhe një bote të dyzuar mes SHBA-së dhe Bashkimit Sovjetik, si dy superfuqi konkurrenente. Ne hymë në një botë të njëanshme me rënien e Bashkimit Sovjetik, ku SHBA-ja ishte e vetmja Superfuqi e periudhës pasmoderne. Tani, në kohët pasnormale, ne po shkojmë drejt një bote me disa fuqi, ndërsa fuqia zhvendoset drejt Kinës, Ruisë, Indisë dhe Brazilit. Idetë kryesore të periudhës klasike ishin pushtimi, epërsia dhe përparimi. Periudha moderne vazhdoi të theksonte përparimin, por e zhvendosi vëmendjen drejt rendimentit dhe modernizmit. Pasmmodernizmi shpalli shpërbërjen e të gjitha “atyre që na janë thënë” deri më tani, duke përfshirë përparimin, ideologjinë dhe fenë, si dhe vuri në pah të vërtetat përmes një shumësie zërash. Kohët pasnormale e vënë theksin te ndërlíkimi dhe çoroditja, si dhe nënvizojnë pasigurinë dhe padijen. Kujtesa luan një rol të rëndësishëm, si në periudhën klasike, ashtu edhe në atë moderne. Por pasmodernizmi shquhet për humbjen e kujtesës. Ndërsa shkruante në vitin 2003, Timothy Mei vuri në dukje se ‘ndihmat për përmirësimin e kujtesës janë kthyer në modë. Një kulturë e re letrare është formuar rreth kujtimeve. Kritikë të panumërt kanë pohuar se ne jetojmë në “një periudhë harrese” dhe se Shtetet e Bashkuara vuajnë nga “humbja e kujtesës historike”.<sup>16</sup> Por pasmodernizmi nuk preku vetëm SHBA-në.

**NGAQË KULTURA MBARËBOTËRORE PASMERNISTE U PËRPOQ TË FSHIJË KUJTESËN E TË GJITHA KULTURAVE, NË KOHËT PASNORMALE FSHIRJA E KUJTESËS SË PADËSHIRUAR LIDHUR ME INTERNETIN ËSHTË KTHYER NË NJË SHQETËSIM TË MADH.**

Mund të vazhdojmë kështu edhe me shembuj të tjerë, por ndoshta do të ishte më mirë që dallimet mes kohëve klasike, moderne, pasmoderne dhe pasnormale të paraqiteshin në një trajtë më të ngjeshur. Duke qenë se jemi në hapat fillestarë të kohëve pasnormale, kjo mund të jetë vetëm një përpjekje. Për më tepër, duhet të theksojmë se këto nuk janë “parashikime” për të ardhmen. Përkundrazi, ato janë rrjedhojë e prirjeve tashmë të

16 Timothy Melley, ‘Postmodern Amnesia: Trauma and Forgetting in Tim O’Brien’s “In the Lake of the Woods”’ *Contemporary Literature* Vol. 44, No. 1 (Spring, 2003), f. 106–131



rrënjësura thellë në një “të tashme të tejzgjatur” dhe, si të tilla, janë përshkrime të asaj që po ndodh në të vërtetë.

Pra, këtu është lista ime e kujdesshme e artefakteve pasnormale në zhvillim.

### Kuptimi

- Klasike:** “Unë mendoj, prandaj jam!”  
**Moderne:** “Unë përparoj, prandaj jam!”  
**Postmoderne:** “Unë blej, prandaj jam!”  
**Pasnormale:** “Unë shpërndaj, prandaj jam!”

### E vërteta

- Klasike:** Bindëse  
**Moderne:** Bindëse  
**Postmoderne:** Përkatëse dhe e shumëfishtë  
**Pasnormale:** Kundërshtuese

### Veçoria

- Klasike:** “Unë jam traditë dhe kulturë!”  
**Moderne:** “Unë jam shkencë dhe teknologji!”  
**Postmoderne:** “Unë jam ajo që blej!”  
**Pasnormale:** “Unë jam faqja ime në Facebook!”

### Ndryshimi

- Klasike:** Pothuajse prehje, i ngadaltë.  
**Moderne:** I shpejtë.  
**Postmoderne:** Gjithnjë e më i shpejtë.  
**Pasnormale:** Përshpejtues, çoroditës.

### Sistemet

- Klasike:** I thjeshtë, i mbyllur.  
**Moderne:** I ndërlikuar, i mbyllur.  
**Postmoderne:** Tërësor, i hapur.  
**Pasnormale:** I hapur, i ndërlidhur, tërësor, çoroditës.



### Idetë kryesore

- Klasike:** Pushtimi, epërsia, përparimi.  
**Moderne:** Përparimi, rendimenti, modernizimi.  
**Postmoderne:** Shpërbërja e atyre që na janë thënë (kuptimit), shumë të vërteta, shumë zëra.  
**Pasnormale:** Ndërlikimi, çoroditja, mosmarrëveshjet, pasiguria, padija.

### Rendi botëror

- Klasike:** Fuqitë pushtuese konkurrente (Britania, Franca, Holanda, SHBA-ja)  
**Moderne:** Bota dydrejtimëshe, “Lufta e Ftohtë” (SHBA-ja, Bashkimi Sovjetik)  
**Postmoderne:** Njësirejtimëshe (SHBA)  
**Pasnormale:** Bota shumëpolare (SHBA-ja, Kina, Rusia, BE-ja, India, Brazili)

### Njohuritë

- Klasike:** Ndjekja e një hetimi të arsyetuar...  
**Moderne:** ...Përfiturat përmes përparimit dhe zhvillimit shkencor.  
**Postmoderne:** Të ndërtuara bashkërisht dhe njohuri përkatëse, Wikipedia.  
**Pasnormale:** ‘Fakte të zgjeruara’, të ngulitura në pasiguri dhe padije.

### Shkenca

- Klasike:** Rendja pas së vërtetës, e paguar kryesisht nga shteti.  
**Moderne:** Metoda shkencore asnjëse, e vërteta lakuriq, e paguar nga shteti dhe ndërmarrjet (Njësi Ushtarake-Industriale); botime shkencore të rishikuara.  
**Postmoderne:** E ndërtuar bashkërisht, e paguar kryesisht nga ndërmarrjet (Njësi Ushtarake-Industriale), botime shkencore të rishikuara.  
**Pasnormale:** ‘Fakte të Pasigurta, Vlera të Dyshimta, Rreziqe të Mëdha dhe Vendime të Ngutshme’; të shtyra nga ndërmarrje gjigande (Google, Microsoft) dhe filantropistë miliarderë; ‘Këshilla shkencore të zgjeruara’, por ende paguhen kryesisht nga Njësi Ushtarake-Industriale në bashkëpunim.



## Teknologjia

- Klasike:** Zbatimi i ngadaltë i shkencës për ta bërë punën më të lehtë.
- Moderne:** E shtyrë ideologjikisht për të 'përmirësuar shoqërinë', antibiotikë por edhe armë bërthamore.
- Postmoderne:** E rrënjosur në politikë; përcaktimi i ADN-së; Bio-teknologjia; Teknologjitë e të dhënave dhe ndërlihdjes.
- Pasnormale:** Ndërthurja njeri-makineri; përmirësimi i ADN-së; Fluturakë; Terminatorë.

## Barnat

- Klasike:** Pa antibiotikë apo qetësues të përshtatshëm.
- Moderne:** 'Kirurgji bashkëkohore', antibiotikë, shiriti i rrahjeve të zemrës (EKG), vëzhgim, kirurgjia e zemrës në tavolinë, mbëltime i veshkave.
- Postmoderne:** Vëzhgimi elektronik i të sëmurëve, Mikro-kirurgjia, mbëltime i fytyrës.
- Pasnormale:** Kirurgjia nga larg, mjekimi me qeliza të shartuara, organe artificiale.

## Ndërlidhja

- Klasike:** Telefoni, telegrafi, alfabeti Mors, radio.
- Moderne:** Televizori, furra me mikrovalë.
- Postmoderne:** Telefon dore, e-mail, Internet, W.W.W.
- Pasnormale:** E menjëhershme, e pandërprerë, lajme mbarëbotërore 24-orë, kanale televizive, Facebook, Twitter, 'Interneti i Gjërave'.

## Organizimi Politik

- Klasike:** Perandoritë.
- Moderne:** Shtetet Kombe.
- Postmoderne:** Grupimet dhe bashkimet krahinore (ec, asean, oic).
- Pasnormale:** Fuqia zhvendoset te njerëz dhe ndërmarrje të fuqishme private.





## Qeverisja

- Klasike:** Demokracia përfaqësuese.
- Moderne:** Demokracia e bazuar në interes (neo-liberale, hiper moderne).
- Postmoderne:** Demokracia e mirëmenduar (larmia, shumësia, 'politika që bën dallimin')
- Pasnormale:** E ndërlikuar, çoroditëse, e papërmbajtshme.

## Ekonomia

- Klasike:** Makro-ekonomia Klasike (e Adam Smith).
- Moderne:** Kapitaliste (tregu i lirë), Komuniste (e kontrolluar nga qendra).
- Postmoderne:** Ekonomia mbarëbotërore Neo-Liberale (tregtia e përbashkët në shkallë të gjerë, privatizimi i burimeve).
- Pasnormale:** Digjitale, arratisje nga mbikëqyrja qeveritare.

## Feja

- Klasike:** Besimi te një Zot.
- Moderne:** Besimi te një Zot.
- Postmoderne:** Epoka e Re, Fundamentalizmi.
- Pasnormale:** E larmishme, Fundamentaliste, besimi te shumë Zota.

## Barazia

- Klasike:** Paragjykime të ligjëruara, ligj i dobët.
- Moderne:** Shteti i mirëqenies, barazia para ligjit (e hamendësuar), parimi *nga lart-poshtë* do të përmirësojë fatin e të varfërve.
- Postmoderne:** Larmi kulturash, përzierje, shkrirje.
- Pasnormale:** Përsheptimi i pabarazisë, të pasurit bëhen më të pasur me sheptësi rrufeje.

## Kufijtë

- Klasike:** Të caktuar.
- Moderne:** Të lakueshëm.
- Postmoderne:** Të depërtueshëm.
- Pasnormale:** Duke u shkrirë.



## Natyra

- Klasike:** Të zbutet për t'u shfrytëzuar.
- Moderne:** E zbutur, nën zotërim, por 'shfrytëzimi ka një kufi'.
- Postmoderne:** Ndërtimi i natyrës me mirëkuptim të përbashkët, përqa-sja ndaj botës bimore dhe shtazore
- Pasnormale:** Vdekjeprurëse, ndryshime klimatike, gjallesa drejt zhdukjes.

## Mjedisi

- Klasike:** Gëzon shëndetin e duhur.
- Moderne:** I ndotur.
- Postmoderne:** Helmues.
- Pasnormale:** Shkatërrimtar, ndryshimet klimatike.

## Zoti

- Klasike:** Zoti është kudo dhe çdo herë.
- Moderne:** Zoti është e Vërteta (me V të madhe, gjatë modernes së hershme) Zoti ka vdekur (gjatë modernes së vonë).
- Postmoderne:** Zoti është makineri, ose Zoti jam unë.
- Pasnormale:** Zoti është Padije.

## Feja

- Klasike:** Feja shpjegon botën.
- Moderne:** Feja na ndihmon të kuptojmë botën.
- Postmoderne:** Feja ishte një gënjeshtër; Laicizmi liberal është Teoria e re e shpëtimit.
- Pasnormale:** Feja është e dyshimtë, prandaj duhet të jetë e hapur ndaj interpretimeve të shumëfishta dhe duhet parë si një tërësi.

## Lufta

- Klasike:** Lufta e Parë Botërore.
- Moderne:** Holokausti.
- Postmoderne:** "Lufta e Gjirit Persik" (siç është parë në TV).
- Pasnormale:** Sulmet me fluturak, Lufta Kibernetike, Robotët e Armatosur (lufta është një lojë që e mënjanon njeriun).



## Tubimet

- Klasike:** Mosbindja qytetare (Lëvizja e të Drejtave Qytetare Afrikano-Amerikane), qëndresa jo e dhunshme (Gandi).
- Moderne:** Përmbysja me dhunë, tubime të dhunshme (panterat e zeza), marshimet paqësore (fushata për çarmatim bërt-hamor).
- Postmoderne:** Lëvizje të përgjithshme (“Krenaria homoseksuale”, tubimet kundër luftës së Gjirit Persik).
- Pasnormale:** Të nxitura nga media digjitale, të ndërlydhura, të ndërlykuara dhe të çoroditura (“Pranvera Arabe”; tubimet e shoferëve të kamionëve në Britani, SHBA dhe gjetkë; tubimet e transportit publik argjentinës).

## Terrorizmi

- Klasike:** Njësitë qytetase, terrorizmi për pavarësinë (Beteja për Algjerinë).
- Moderne:** Vendas, me qëllime të caktuara (IRA, ETA).
- Postmoderne:** Mbarëbotëror, njeriu bombë vetëflijues, grupim josh-tetëror (al-Kaeda).
- Pasnormale:** Mbarëbotëror, i ndërlydhur me dinakëri përmes rrjeteve shoqërore, luftë për territore (“Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë”, talibanët, Boko Haram).

## Trupi

- Klasike:** Muskulor.
- Moderne:** Atletik.
- Postmoderne:** Me hormone.
- Pasnormale:** I përmirësuar përmes teknologjisë.

## Qytetet

- Klasike:** Misisipi, Kejp Taun (gjatë ndasive racore).
- Moderne:** Nju Jork, Londër, Paris.
- Postmoderne:** Tokio, Dubai, Putra Jaja (Malajzi).
- Pasnormale:** Bagdadi (pas tërheqjes së aleatëve), Kajro (pas dy kryen-gritjeve), Alepo, Ferguson, SHBA.



## Filmat

- Klasike:** Zoti Smith shkon në Uashington.  
**Moderne:** Pushtimi i rrëmbyesve të trupit.  
**Postmoderne:** Seks, gënjeshtër dhe videokaseta  
**Pasnormale:** Ajo.

## Televizioni

- Klasike:** Unë e dua Lusinë.  
**Moderne:** Detyrë e pamundur.  
**Postmoderne:** Star Track: Brezi tjetër.  
**Pasnormale:** Lugina e Silikonit.

## Muzikë

- Klasike:** Xhaz, orkestër e plotë.  
**Moderne:** Pop, Rock n Roll, Disko, Heavy Metal.  
**Postmoderne:** Epokë e Re, nën ndikimin e drogës, përzierje Lindje-Perëndim, Punk, Grunge dhe House.  
**Pasnormale:** Ende mbetet për t'u parë (por grupi kanadez 'Post Normal' po bën një përpjekje).

## Heronjtë e Hollivudit

- Klasike:** Clark Gable - "Me thënë të drejtën, e dashur, as që dua t'ia di!"  
**Moderne:** James Dean - "Djali i mbrapshtë nga një familje e mirë".  
**Postmoderne:** Arnold Schwarzenegger - "Hasta la vista, baby!"  
**Pasnormale:** Johnny Depp: "Çiltërsisht, janë të ndershmit ata që duhen vëzhguar, se kurrë nuk e parashikon dot, nëse do të bëjnë apo jo diçka trashanike!"

## Femra Ikonë

- Klasike:** Mae West - "A është kjo një armë, apo thjesht je i kënaqur që më takon?"  
**Moderne:** Marilyn Monroe - "Zotërinjve u pëlqejnë biondet".  
**Postmoderne:** Madona - "Unë jam një vajzë materialiste".  
**Pasnormale:** Laverne Cox- "Duke u shtirur".



## Seksi

- Klasike:** Sipas kodit Hejs (pa shtrat dopio, pa puthje që zgjasin më shumë se dhjetë sekonda, pa lakuriqësi).
- Moderne:** 'I shpejtë, pa ndonjë ndjeshmëri'.
- Postmoderne:** Seks përmes Internetit – Hyr - Mbaro punë – Dil.
- Pasnormale:** Pornografia është e zakonshme.

## Martesat

- Klasike:** Një martesë.
- Moderne:** Martesë pas martese.
- Postmoderne:** Martesë pas martese, madje me dy gra njëherësh.
- Pasnormale:** Burrë-grua, Burrë-burrë, Grua-grua, vazhdimisht dhe të shumta.

## Ndërtesat

- Klasike:** Ndërtesa e shtetit perandorak, Nju Jork.
- Moderne:** Muzeu Guggenheim, Nju Jork.
- Postmoderne:** Hoteli Portman's Bonaventure, Los Anxheles.
- Pasnormale:** Kulla e Sahatit, Mekë.

## Piktorët

- Klasike:** Pikaso
- Moderne:** Jackson Pollack
- Postmoderne:** Andy Warhol
- Pasnormale:** Banksy

## Romanet

- Klasike:** Fitzgerald, "Getsbi i Madh".
- Moderne:** Kamy, "I huaji".
- Postmoderne:** Rushdi, "Fëmijët e Mesnatës".
- Pasnormale:** Wilson, "Alif - I padukshmi".



## Çudia e përbotshme

*John Sweeney*

**KUR VAZHDIMI BËHET I ÇUDITSHËM, ÇUDIA MBAN ANËN TËNDE.  
- HUNTER S. THOMPSON**

Bandar Masar është i njohur për temperatura të larta. Nuk është e pazakon- të që ky fshat iraniano-verior të përjetojë vazhdimisht gjatë verës tempera- tura mbi 45 gradë Celsius. Por, kur treguesi i nxehtësisë arriti në 74 gradë Celsius (165 gradë Fahrenheit) që ishte niveli i dytë më i lartë i nxehtësisë, i regjistruar ndonjëherë botërisht, tërhoqi vëmendjen e botës. Bandar Masar tani është i lidhur pazgjidhshmërisht me ndikimet dërrmuese të ngrohjes globale. Për vite të tëra, treguesit kanë paralajmëruar se ekstremet do ta gllabërojnë klimën mbarëbotërore dhe kjo shkreti 'normale', shoqëruar me 'valë të nxehti, përmytje, thatësira dhe zjarre', do të bëhet 'realiteti i ri i një bote që ngrohet gjithnjë e më shumë'. Megjithatë, vetëm për shkak se na është thënë që të presim më shumë përkeqësime, nuk do të thotë se ne kemi, ose do të fitojmë, aftësinë për t'i parashikuar dhe/ose për t'i zbutur ato. Në të vërtetë, marrëdhëniet shkakësore që qëndrojnë në themel të sis- temit të klimës botërore, janë padyshim të ndërlikuara dhe ndryshimi i klimës po i ndërlikon gjërat më tej. Siç edhe vërehet në natyrë:

Moti i skajshëm dhe mënyrat e ndryshimit të motit – shfaqet e dukshme të ndryshimit të klimës botërore - nuk pasqyrojnë thjesht ndryshime lehtësisht të dallueshme në peshimin e energjisë së Tokës, siç është rritja e temperaturave të atmosferës. Shkaqet e këtyre ndryshimeve, zakonisht, duhen parë në tërësi dhe ato përfshijnë të meta në qarkullimin atmosferik, nivelet e lagështisë së tokës dhe



të tjera dukuri të ngjashme. Kuptimi i plotë i këtyre faktorëve është thelbësor, nëse studiuesit duan të përmirësojnë rendimentin dhe besimin në llojet e klimës nga të cilat varen shkaqet e ngjarjeve dhe parashikimet afatgjata të klimës.<sup>1</sup>

Ndërsa nxehtësia e tejskajshme e Bandar Masar ishte jetëshkurtër, shpresat për siguri të kufizuar, nëse jo padije të plotë, në lidhje me rrjetin mbarëbotëror të klimës janë shumë afatgjata, qoftë sa i përket dukurive që përsëriten, qoftë atyre të llojeve të reja. Shkurtimisht, rrjeti klimatik, siç e njohim ne dhe që jemi rritur dhe përshtatur bashkë me të, po shkon drejt pasnormales dhe përpjekja për të hartuar trevën përpara nesh po bëhet gjithnjë e më e pamundur. E tillë është jeta në Antropocen - një epokë e çuditshme dhe e tejskajshme, falë dorës së njeriut. Sa të çuditshme do të bëhen gjërat? Kjo mund të jetë pyetja përcaktuese e shekullit të XXI-të.

Në Maj të vitit 2013, observatori Mauna Loa tregoi se dyoksidi i karbonit në atmosferë mbërriti 400 njësi për një milion për herë të parë në 'më shumë se 2.5 milionë vjet'. Duke e krahasuar këtë çast historik shqetësues, simbolik dhe ekstrem, shkencëtarët vunë re se herën e fundit, kur nivelet e karbonit në atmosferë ishin kaq të larta, 'temperatura e Tokës ishte mesatarisht rreth 3 gradë Celsius më e ngrohtë dhe niveli i detit kapërcente brigjet 5 metra të larta, ose më shumë', që do të thotë se bota ishte një vend rrënjësisht i ndryshëm—një vend, si të thuash, ku mungonte njerëzia. Edhe pse vazhdon të ketë rrahje mendimesh rreth ndikimeve të shtuara të rritjes së niveleve të CO<sub>2</sub> në atmosferë, ka pak rrahje mendimesh për shkakun: veprimtarinë njerëzore, veçanërisht mekanizmat me energji të vullshme të kapitalizmit industrial dhe pasindustrial. Shkurtimisht, ne e kemi përçudnuar rrjetin klimatik botëror dhe, ndërsa kjo ecuri është në vazhdim e sipër, ne jetojmë në një botë që i nënshtrohet përçudnimit të tejskajshëm.

Çudira mbarëbotërore në ngrohjen mbarëbotërore është më shumë se një lojë fjalësh - është një parashikim. Siç kam arsyetuar diku tjetër, përçudnimi mbarëbotëror 'është një emërtim i përshtatshëm për rrjetën e saposhaqur të:

- Rritjes së përparimit teknologjik, të kudondodhur dhe nga i cili varemi.
- Fatkeqësive të afërta të botës bimore dhe shtazore.
- Nxitjes dhe shtrirjes ndërkombëtare të përfaqësuesve pasnormalë.

Me anë të përfaqësuesve pasnormalë, kam parasysh saktësisht marrëdhëniet e ndërlidhura që përbëjnë themelin dhe që na rrethojnë të gjithëve, gjë që

1 Nature, 'Extreme Weather', *Nature* 489 (Shtator): 335–36 (2012)



bëhet veçanërisht e dukshme në atë që Ziaudin Sardar e ka quajtur Kohët Pasnormale. Në kohët pasnormale, gjërat që i marrim si të mirëqena, bëhen të pasigurta, kuptimi i gjërave nga ana jonë mund të kthehet në një lloj padije dhe normat e vjetra, nëse jo vetë ideja e të qenit normalë, shkërmoqen para syve tanë. Kjo, përndryshe, është ajo që nënkuptohet me përcudnim mbarëbotëror. Përcudnimi i tejskajshëm anon drejt fuqisë në rritje të dukurive të dëmshme për të ndryshuar ndjenjën tonë të të qenit në këtë botë. Në gjuhën e kohëve pasnormale, puqja e “ndërlimit, çoroditjes dhe mosmarrëveshjeve” tashmë është dhe do të vazhdojë të çojë drejt përçarjeve të vazhdueshme, të cilat mund dhe duhet të fillojnë me faktorë që shtrihen gjerë e gjatë.

Kur shitësi ambulant në Tunizi u vetëflijua, në dhjetor të vitit 2010, pak njerëz mund të parashikonin ndikimet që do të kishte më pas. Në një kohë përcudnimi të tejskajshëm, Mohamed Buazizi është një shembull thelbësor i një përfaqësuesi pasnormal. Megjithatë, vetëm kur kuptojmë veprimin e tij vetëmohues të kundërshtimit nga pikëpamja e rrjeteve shoqërore – shumë prej të cilave përdorën platforma on-line për t’u organizuar – të cilat i bashkon pakënaqësia politike në rajon, gjallëria e çuditshme e kohëve pasnormale bëhet më e dukshme. Falë, të paktën pjesërisht, mediave të lidhura përmes internetit, kryengritjet në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut u përhapën si një zjarr i egërsuar. Metafora të tilla janë më se të përshtatshme, veçanërisht ngaqë disa tregojnë për ndikimet e jashtëzakonshme të ndryshimeve klimatike, si njëri prej faktorëve të përhapjes së tubimeve në mbarë krahinën. Siç edhe vihet në dukje nga një shkresë rreth arsyeve kryesore të ndërprerjes së vazhdueshme të protestave në Egjipt, “një thatësi dimërore që mund të ndodhë një herë në njëqind vjet në Kinë, zvogëloi furnizimin me grurë në mbarë botën dhe ndikoi në mungesat mbarëbotërore të grurit, si dhe në rritjen e çmimit të bukës në Egjipt, importuesi më i madh i grurit në botë”. Ligjshmëria e qeverisë dhe shoqëria civile në Egjipt u vunë në pikëpyetje nga tubimet që përqendroheshin te varfëria, buka dhe pakënaqësitë politike.’

Edhe pse pakënaqësia politike ishte padyshim e pranishme gjatë sundimit despotik të Mubarakut, një rritje e jashtëzakonshme e çmimit të bukës u kthye në një fuqi bashkimi dhe puqi interesa të ndryshme, fjalë për fjalë, e çoroditi rendin politik egjiptian. Sigurisht që njerëzimi ka qenë gjithmonë i ndjeshëm ndaj ngjarjeve të jashtëzakonshme, por do të ishte marrëzi të mendohej se përmes historisë mund të gjejmë çelësin për të kuptuar dhe lundruar në kohët pasnormale. Si mund t’i shqyrtojmë imtësisht të tilla ndryshime? Cila është përqasja ideore që mund të na ndihmojnë në kuptimin e asaj që në





dukje është e pabesueshme? Sa të përçudnuara do të bëhen gjërat? Për të llogaritur dhe përcaktuar ndikimet e jashtëzakonshme të dorës së njeriut në rrjetin mbarëbotëror të klimës, dy shkencëtarë të njohur ndërkombëtarisht, Poll Krutzen dhe Euxhine Storme, shpikën emërtesën *Antropocen* , për të theksuar rolin vendimtar të njerëzimit në gjeologji dhe ekologji.<sup>2</sup> Duke pasur parasysh përçudnimin e jashtëzakonshëm që pritet të ndodhë, mund të jetë e dobishme të mendojmë me largpamësi – qoftë nga e shkuara, qoftë nga e ardhmja - për të kuptuar se për çfarë mund të na paralajmërojë Antropoceni.

Në vitin 1873, gjeologu italian, Antonio Stopani, përdori shprehjen ‘periudha antropozoike’ për të kuptuar në vija të përgjithshme ndikimin në shkallë gjeologjike të veprimtarisë njerëzore. Ndonëse përmendet nga Krutzen, si një dijetar paraardhës, shtrirja e njohurive të Stopanit është shfaqur vetëm kohët e fundit, të paktën për ithtarët që flasin dhe lexojnë anglisht. Duke shprehur habinë e tij për ardhjen e periudhës Antropozoike, Stopani lëshon paralajmërimin:

Ne jemi vetëm në fillimin e kësaj periudhe të re, megjithatë, mendoni sa e thellë është tashmë gjurma e njeriut në tokë! Njeriu e ka zotëruar atë vetëm për një kohë të shkurtër, megjithatë, ne mund t’i kërkojmë shkaqet e sa e sa dukurive gjeologjike jo në agjentët tokësorë, atmosferë, ujëra apo kafshë, por, përkundrazi, te mendja e njeriut, te vullneti i tij për të ndërhyrë fuqishëm.

Si një nga zërat më të hershëm shkencorë (nëse jo më i hershmi) që i kushtoi vëmendje ndikimit të qëndrueshëm, d.m.th. edhe të jashtëzakonshëm, të veprimtarisë njerëzore, parashikimi i Stopanit ishte i rrallë për kohën e tij, qoftë edhe sa i përket vëmendjes së tij ndaj shkallës së ndikimit. Por ndjenja të tilla shpejt do të bëheshin të zakonshme për ata që e ndjenin veten pjesë të lëndës së ekologjisë në zhvillim.

Ndërsa kjo fushë kërkimore shkencore e sapolindur u zhvillua në gjysmën e dytë të shekullit të XIX-të, ideja e rëndësishme e ekosistemit nuk u pranua gjerësisht, deri në botimin e librit të Arthur Tanzli-t, *Përdorimi dhe shpërdorimi i emërtesave dhe ideve të botës bimore*, në vitin 1935. Mbërritja e idesë së ekosistemit ndihmoi shumë për të çuar më tej shqyrtimin e vazhdueshëm të veprimtarisë njerëzore në biosferë. Mirëpo, nga fundi i shekullit, një varg mendimtarësh tashmë kishin pikësynime më madhështore për rolin dhe pasojat e mundshme të ndryshimeve të shkaktuara nga njeriu në ecurinë e planetit. Kjo do të thoshte se disa e kishin

2 Paul Crutzen dhe Christian Schwägerl, ‘Living in the Anthropocene: Toward a New Global Ethos.’ *environment360*, Janar 2010



teorizuar botën si një rrjet të vetëm e të përbashkuar – një sistem, si të thash, që gjithnjë e më shumë po përballej me ekstremet e zotërimit njerëzor.

Megjithatë, më pak se një shekull më vonë, ideja e drejtimit dhe e zotërimit (nëse jo e tërë qëndrueshmërisë), në lidhje me rrjetin mbarëbotëror të klimës, po viheshin në pikëpyetje. Në vitin 1988, Xhejms E. Hansen, përfaqësues i NASA-s, dëshmoi rreth klimës në një mbledhje dëgjimore para Kongresit dhe përdori qëllimisht emërtesën ‘ngrohje globale’, për të përshkruar ‘një marrëdhënie shkak-pasojë mes ndikimit serrë dhe ngrohjes së vëzhguar.’ Me botimin e librit të Bill McKibben-it, *Fundi i Natyrës*<sup>3</sup>, të cilin shumë njerëz e shohin si “një nga librat e parë për ithtarët e ngrohjes globale në përgjithësi”, Antropoceni u vendos në qendër të vëmendjes. Shumë veta ishin të prirë për të krijuar një ide rreth ekstremeve të jetës në periudhën ‘Antroceni’, që është emërtesa fillestare e përdorur nga Andrew Revkin, një shkrimtar dhe gazetar që shkruante për New York Times, në librin e tij: *Ngrohja globale: Kuptimi i parashikimit*<sup>4</sup>, për të treguar ‘një periudhë gjeologjike të krijuar nga vetë ne.’ Pak më herët, Krutzen shpiku ‘fjalën pa ndonjë paramendim’<sup>5</sup>, që është ndoshta paksa e zbukuruar, duke pasur parasysh historinë e pasur ideore të kësaj emërtese, pa përmendur këtu Antropozoikun e Stopani-t dhe Antrocenin e Revkin-it, duke dhënë idenë se veprimtaria njerëzore po ndikonte jashtëzakonisht në biosferën e tokës. Kjo gjë dihej mirë në mesin e këshillave shkencorë, por nënkuptimi ekzistencial i emërtesës që linte të kuptohej se natyra nuk ekziston më, vazhdon të jetë një pikë grindjeje për shumë njerëz.

**SHUMË GJËRA QË NE I MARRIM SI “TË ZAKONSHME”, TASHMË PO SHNDËRROHEN NË TË JASHTËZAKONSHME, SAQË NUK ËSHTË E LEHTË TA PËRMbledhim gjithë sjelljen e jashtëzakonshme brenda një emërtese të vetme.**

Teknologjia jonë është bërë e jashtëzakonshme, të qenit modern ka marrë ngjyrimet e jashtëzakonshme, sistemi ekonomik, sjellja e sipërmarrjeve, pothuajse çdo ideologji e ka kapërcyer të zakonshmen. Nuk është për t’u habitur, që disa njohës të fushës po përpiqen të shpikin emërtesa që

3 Bill McKibben, *The End of Nature* (Londër: Bloomsbury, 2003; original 1989).

4 Andrew Revkin, *Global Warming: Understanding the Forecast* (New York: Abbeville Press, 1992)

5 Timothy Morton, ‘This Biosphere Which Is Not One: Towards Weird Essentialism.’ *Journal of the British Society for Phenomenology* 46 (2): 141–55 (2015).



përqendrohen në një anë të veçantë të moshës sonë të jashtëzakonshme. Duke marrë parasysh përparimet teknologjike, që nga shpikja e motorit me avull, deri tek algoritmet e përkryera, në përsheptimin dhe zbutjen e pikave të kundërta të Antropocenit, Pierre Berthon dhe Brajan Donellan, dy ekologë nga Universiteti Bentley i Bostonit dhe Universiteti Kombëtar i Irlandës, këshillojnë se një emërtim më i përshtatshëm mund të jetë *Teknopocen*. Kjo, sqarojnë ata, i jep shtysë “një niveli të ri të vetëdijes nga ana e njerëzve për veten dhe pasardhësit e tyre teknologjikë.”<sup>6</sup>

Njerëzimi nuk e ka kufizuar veten kurrë me ecurinë e natyrës, megjithëse vazhdon të mbetet i ndërlidhur dhe i ndërthurur ngushtë me punët e botës. Si i tillë, Teknopoceni ofron një përcaktim të thekshëm dhe, pse jo, një parashikim për sfidat e Antropocenit, veçanërisht pasi shumë prej nesh mendojnë se e vetmja mënyrë për të shmangur krizën mund të jetë vazhdimi më me vendosmëri, si të thuash, duke sajuar sisteme të ndërlikuara të jetës që i përshtaten planetit. Pra, Teknopoceni, nuk duhet kuptuar si një lloj i jashtëzakonshëm Antropoceni, por më tepër duhet parë si paraardhësi i tij i përfytyruar, pasi nuk ka pasur kurrë njerëz pa teknologji, gjë që ende vazhdon, për mirë a për keq, të na përkufizojë ne si gjallesa. Ndërsa Teknopoceni i mungon shkëlqimi dhe lavdia e Antropocenit, mbetet shumë për të thënë lidhur me zgjedhjen e një përcaktimi të përshtatshëm për atë që njerëzit i kanë bërë dhe po vazhdojnë t’i bëjnë rruzullit tokësor.

Jussi Parikka, një dijetar finlandez, i përqendruar në studimet e medias, si një mënyrë për të kapur ndikimin e jashtëzakonshëm të njeriut në tokë, shpiku termin ‘Antrobseni’, për të shënuar ‘shkeljet e ndryshme mjedisore dhe jetës së njeriut përmes veprimtarisë dhe kulturës teknologjike të ndërmarrjeve, duke u përpjekur të sigurohen që të mos kenë nevojë për shumë njerëz në skenën e ardhshme të jetës.’ Duke pohuar se mënyra e vetme për t’i dhënë kuptim tekno-kulturës bashkëkohore është përmes këndvështrimit gjeografik, Parikka thekson materializmin e pamasë të jetëve tona krejtësisht moderne dhe, si të thuash, edhe të së ardhmes. Ashtu sikurse nivelet e karbonit në atmosferë, të cilat do të vazhdojnë të rriten për 50 vjet, edhe nëse i gjithë çlirimi i gazrave do të ndalojë që nësër, nuk ka asnjë mënyrë për të zhbërë ndryshimet strukturore që ka shkaktuar tekno-kultura në mbarë botën. Ky ekstrem është i lehtë për t’u parë, nëse u hedhim një sy pamjeve nga ajri të minierave të përdorura për të nxjerrë mineralet dhe metalet e çmuara të nevojshme për pajisjet që na rrethojnë. Antroceni na detyron të përballemi me mënyrën se si ‘media

6 Pierre Berthon dhe Brian Donnellan, ‘The Greening of IT: Paradox or Promise?’ *The Journal of Strategic Information Systems* 20 (1): 3–5 (2011)



ndikon në historinë e tokës dhe kohët e fosileve të së ardhmes.' Shkurtimeisht, Parikka na kujton se parimet e modernitetit janë shumë bashkëkohore.

Në librin *Ne nuk kemi qenë kurrë modernë*, Bruno Latour, filozof francez dhe sociolog i shkencës, u tregua i ashpër duke tërhequr vërejtjen lidhur me shkaqet dhe ndikimet që ka trashëgimia e modernitetit, edhe pse ndikime të jashtme, të cilat i qëndrojnë kohës: ndarja e njerëzimit nga natyra. Nga këndvështrimi modernist, detyra e shkencave, veçanërisht e fizikës, ishte të shqyrtonin natyrën si objekt dhe të njohin në përputhje me rrethanat. Me ndarjen e politikës dhe fizikës në dy botë të ndryshme, moderniteti ishte jashtëzakonisht *Njutonian* në këndvështrimin e vet rreth natyrës dhe shoqërisë. Në pohimin e maturisë së objekteve natyrore, moderniteti nguliti në mendje një mendim të sëmurë mbi përparimin dhe rritjen ekonomike që nxiti zgjerimin i cili solli edhe përqendrimin më të madh të pasurisë në historinë e njerëzimit. Por kjo histori, si të thuash, mund të mos ketë një fund të lumtur. Siç vëren Latour,

për sa kohë që natyra ishte e largët dhe nën sundim, ajo ende, në mënyrë të turbullt, i ngjante shtyllës kushtetuese të traditës dhe shkencë mund të shihej ende si një ndërmjetëse e thjeshtë për ta zbuluar atë. Natyra dukej sikur mbahej në ruajtje, si një mrekulli e pashtershme, mjaft e largët. Po nga çfarë pikëvështrimi duhet ta renditim historinë e vrimës së ozonit, ngrohjen botërore, apo shpyllëzimin?<sup>7</sup>

Duke vënë në pikëpyetje kufijtë dhe shkatërrueshmërinë e përfytyrimit të rremë të natyrës së modernizmit, Latour shtjellon se ngrohja botërore ka qenë gjithmonë, por tashmë njerëzore dhe e natyrshme, që do të thotë se ne kurrë nuk kemi qenë modernë, apo të ndarë nga natyra. Kjo, përkundrazi, është ajo që Antropoceni dhe llojet e tij të shumta kanë për qëllim të përcjellin. Por, a mund të na përgatisë vërtet kjo ide për atë çfarë na pret në të ardhmen?

Megjithëse shumë njerëz mezi presin për të parë fundin e luftës së përgjakshme në Siri, të tjerët janë përpjekur të kuptojnë zanafillën e saj dhe ndryshimi i klimës është i dyshuari kryesor. Sipas një studimi të botuar në *Punimet e Akademisë Kombëtare të Shkencës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës*, lufta në Siri tregon ndikimin e një ngjarjeje të jashtëzakonshme klimatike, përveç dështimit të qeverisë, e përkeqësuar nga rrethanat e veçanta të vërshimit të madh të refugjatëve irakianë. Thatësisht shumëvjeçare ndodhin vazhdimisht në [Gjysmëhënën pjellore], për shkak të shkaqeve

7 Bruno Latour, *We Have Never Been Modern* (Cambridge, Mass: Harvard University Press, 1993)



natyrore, por nuk ka gjasa që thatësira e fundit të ketë qenë po aq ekstreme, pa një prirje për thatësira shekullore.

Edhe pse disa njerëz, veçanërisht gazetarja kanadeze Gwynne Dyer, besojnë se luftërat klimatike ka të ngjarë të ndodhin në vitet në vijim, përshtetëzimi i fundit i refugjatëve në Europë, kryesisht nga Siria dhe Libia, na bëri me dije se përcudnimi i tejskajshëm ka dhe do të vazhdojë të ketë pasoja vdekjeprurëse.<sup>8</sup> Ndërsa tani kemi shumë arsye për t'u shqetësuar, shumë prej nesh mendojnë se më e keqja nuk ka ardhur ende, megjithëse është e vështirë të përbuzësh përcudnimin e tejskajshëm që po ndodh përreth nesh.

Zanafilla e përcudnimit të tejskajshëm në Shtetet e Bashkuara është Kalifornia. Parulla e shtetit është *Eureka* dhe dëgjohet që nga kohët e etheve të arit. Kjo pasthirmë përkthehet si "E kam gjetur!" dhe lidhet me shpikësin grek, Arkimedin, i cili thuhet se e ka shqiptuar frazën, pasi ka bërë një zbulim të madh. Fatkeqësisht, gjithçka që ka zbuluar Kalifornia, është se sa jashtëzakonisht e çuditshme është bërë bota. Sot, 97% e shtetit 'po përjeton deri diku një lloj thatësire' dhe vendi ka pasur aq pak reshje, saqë bora në Sierra Nevada është në pikën më të ulët të '500 viteve të fundit.' Kushtet për zjarret në pyje janë të përkryera dhe Kryetari i shtetit shpalli kohët e fundit gjendjen e jashtëzakonshme, pasi një zjarr përbindësh dogji '50.000 hektarë' në pjesën veriore të shtetit. Ndërsa për shumë banorë një stuhi e paparë mund të jetë e mirëseardhur, shkencëtarët parashikojnë se shteti, tashmë në vështirësi, do të përballet me një nga ndryshimet klimatike më të forta - *El Nino*, që mbahet mend ndonjëherë. Të nxitur nga temperaturat e ngrohta të oqeanit, të cilat janë pasojë e drejtpërdrejtë e ndryshimeve klimatike, ndikimet e një "Përbindëshi El Nino" mund të jenë as më shumë dhe as më pak se një fatkeqësi, pasi përmbytjet dhe rrëshqitjet e dheut me siguri që do të bëjnë kërdrinë në rrjetet e kundërveprimit tashmë të molisura. Ngaqë PBB-ja e Kalifornisë është mbi 2 trilionë dollarë, gjë që e vendos atë pak përpara Brazilit, ndikimet e një ngjarjeje fatkeqe si *El Nino*, sigurisht që do të kenë pasoja mbarëbotërore.

Përcudnimi i tejskajshëm, shkaktuar nga ndryshimet klimatike, ka bërë që disa të mendojnë për 'zgjdhje' përfundimtare të cilat ende mbeben hamendësime dhe mbartin një sërë pasigurish. Ndërsa disa besojnë se e vetmja mënyrë që njerëzimi mund të zvogëlojë përcudnimin e tejskajshëm, është përmes nismave që përkrahin zbutjen e klimës, të tjerët kanë filluar të marrin parasysh 'mjekime' më të kufizuara, por po aq kundërshtuese. Në vitin 2012, *Mathew Liao et al*, një grusht shkencëtarësh nga

8 Gwynne Dyer, *Climate Wars: The Fight for Survival as the World Overheats* (Oxford: Oneworld Publications, 2011)



Universiteti i Oxfordit dhe New Yorkut, botuan shkrimin: *'Inxhinieria njerëzore dhe ndryshimet klimatike'*, në *Etikë, Politikë dhe Mjedis*, madje me shumë bujë. Duke arsyetuar se "ndryshimi biomjekësor i njerëzve" duhet të merret parasysh, ngaqë përçudnimi i tejskajshëm është i pashmangshëm, autorët pohojnë se rritja e ndjeshmërisë, nxitja e një qëndrese ndaj ndikimeve anësore, të prodhimeve me përbërës karboni, si mishi i kuq, dhe ndërhyrjet gjenetike që njerëzit të lindin më të shkurtër, janë të arsyeshme dhe ndoshta më pak të rrezikshme sesa nismat në shkallë të gjerë të zbutjes klimatike.<sup>9</sup> Megjithëse Liao dhe kolegët e tij bëjnë të qartë se nuk mbrojnë idenë e ndërhyrjeve të pavullnetshme te njerëzit, si një mundësi veprimi, ata janë të vendosur në bindjen e tyre, se nismat e qëllimshme bio-inxhinierike duhet 'të pleqërohen dhe të hulumtohen më tej', veçanërisht pasi kjo mënyrë veprimi 'ka gjasa të mëdha, që tregu të mund t'i paraprijë kërkesave të blerësve'. Ndërsa njerëzit gjithmonë kanë eksperimentuar me veten e tyre, qoftë edhe vetëm si rrjedhojë e risisë teknologjike, përshtatja biofizike e qëllimshme, si një mjet për të zbutur ndryshimet klimatike, përfaqëson një përgjigje jashtëzakonisht të çuditshme ndaj një sfide të frikshme. Zi e më zi!

Në një botë të pushtuar nga përçudnimi i tejskajshëm, njerëzit mund dhe duhet të shqetësohen jo vetëm për kërcënimet e reja, por edhe për rreziqet nga e kaluara që pritet të rishfaqen, teksa rrjeti mbarëbotëror i klimës anon për nga pasnormaliteti. Kjo kahje është më e dukshme në pjesët e Arktikut ku nëntoka është përherë e ngrirë dhe ngricat e përhershme kanë zënë në grackë çdo gjë që mund të na shkaktojë makth. Zbulimi në vitin 2003, i një virusi madhështor që është ende mikroskopik, tronditi këshillat shkencorë. Ndërsa shkencëtarët janë të bindur, se asnjë nga ato që janë gjetur deri më tani, nuk përbën ndonjë 'kërcënim për njerëzit ose kafshët', të njëjtët shkencëtarë pranojnë mundësinë që 'viruset e rrezikshëm fshihen në gjallesat e kohës pasnormale thellë nën tokë', pasi ngrica e përhershme prehistorike krijon kushte për ruajtjen e tejzgatur të çdo molepsjeje. Edhe pse një mundësi e tillë duket sikur tingëllon si fantashkencë, ndikimet e përçudnimit të tejskajshëm nuk mund të nënvlerësohen ose të dorëzohen përpara sajësive. Kjo është ajo që mund të na mësojë dhe duhet të na mësojë Antropoceni, si një epokë e përçudnimit të tejskajshëm: e jashtëzakonshme po bëhet gjithnjë e më shumë e pashmangshme.

9 S.M. Liao, S. Anders dhe R. Rebecca, 'Human engineering and climate change' *Ethics, Policy & Environment* 15 (Qershor (2)) (2012) 206-221.





# Lindja-Perëndimi në kohët pasnormale

*Ziauddin Sardar*

**OH, LINDJA ËSHTË LINDJE DHE PERËNDIMI ËSHTË PERËNDIM!**

**ATO TË DYJA KURRË NUK DO TË PUQEN DOT,**

**GJERSA TOKA DHE QIELLI SIÇ JANË, RRINË,**

**DERI NË DITËN E GYKIMIT TË TË MADHIT ZOT!**

Kur Rudyard Kipling shkroi këto rreshta në “Baladën e Lindjes dhe Perëndimit”<sup>1</sup>, ato u duartrokitën dhe patën një sukses të furishëm, ngaqë shprehnin saktësisht mënyrën se si shihej bota në kulmin e Perandorisë Britanike. Fatkeqësisht, mënyra e të menduarit vazhdon shumë më gjatë sesa puna e dorës së njeriut. Idetë pushtojnë më shumë hapësirë dhe janë më shumë të besueshme se të gjitha ushtritë e Mbretëreshës së lavdëruar nga Kiplingu, i cili ishte thellësisht i dyzuar rreth prejardhjes së tij nga Lindja, si një anglo-indian. Pavarësisht dëshmimeve të historisë, politikës, ekonomisë dhe kulturës, thënia e thjeshtuar e Kipling-ut mbetet ende përqsaja e parapëlqyer për të kuptuar botën.

1 Kipling, Rudyard (1889) ‘The Ballad of East and West’, E disponueshme from [www.bartleby.com/246/1129.html](http://www.bartleby.com/246/1129.html)





Ajo për çfarë bëjnë fjalë vargjet e Kipling-ut, nuk gjendet vetëm në fillim të poemës. Lindja dhe Perëndimi janë të ndryshme, dallimet janë thelbësore dhe të një rëndësie të veçantë, ngaqë i qëndrojnë kohës. Qytetërimi, kultura dhe përvoja historike e dallojnë ndryshimin e veçantë që e bën Lindjen lindore dhe Perëndimin perëndimor. Gabimi bëhet në përfundimin prej mendjemadhi: “Kurrë nuk do të puqen”, të paktën deri në Ditën e Gjykimit. Brenda këtij përfundimi gjenden fuqia dhe besueshmëria, thjesht fuqia e kundërshtimit të dyanshëm. Nuk përbën asnjë shqetësim, nëse Lindja dhe Perëndimi janë vërtet të ndryshme. Shqetësimi lind atëherë kur dallimi merret si një hendek i pakalueshëm: “të dyja kurrë nuk do të puqen”. Dallimi ka fuqinë e një vlere të kundërt. Ajo që shënohet nga kjo vlerë e kundërt, është themeli i frikës, dyshimi te tjetri, pasiguria e përhershme dhe paragjykimi. Vlera e kundërt në veprim shndërrohet në një gjykim të shpejtë vlerash, në një parim renditjeje. Në kundërshtime aq të thjeshta, pala tjetër duhet të jetë më e ulët, armiqësore ndaj mirëqenies “sonë”, përndryshe dallimet do të ishin të kapërcyeshme dhe nuk do të përbënin asnjë kërcënim. Kështu, ndryshimi i pakapërcyeshëm kthehet në një lloj besimi të ruajtjes së largësisë, mbajtjes së vetvetes të pastër dhe të siguruarit që të dy palët të mos takohen kurrë. Ky përcaktim përmbush parashikimin e vet dhe mbështet mashtrimin e pushtetit dhe eprorit nga të dyja palët, për të mbajtur një opozitë të përjetshme të paepur. Pra, e vërteta e kushtit paraprak, Lindja është Lindje dhe Perëndimi është Perëndim, marrë në mënyrë jokritike, ashtu siç është, duke vërtetuar ndërlikimet dhe ndërtimin e kuptimit që vendoset mbi dallimet e dukshme.

Edhe pse Kiplingu gaboi fillimisht, ngaqë u tregua i njëanshëm në parakushtin dhe krejtësisht i gabuar në përfundimin e tij, shpërblimi i tij i vetëm është fuqia e mbijetesës së thënies së tij të thjeshtuar. Sthurja e ngadaltë e kundërshtimit thjesht të dyanshëm të garës mes superfuqive, fundi i ‘perandorisë së keqe’ të komunizmit, krijoi rastin e rikthimit të një kundërshtie shumë më të vjetër, më të vetvetishme të Kipling-ut, me një lloj hakmarrje për të shpëtuar tregtinë, politikën, historinë dhe gjithçka tjetër nga mundësia e tmerrshme e të menduarit përmes një këndvështrimi të ri. Ne e kemi përjetuar ‘fundin e historisë’ ku liberalizmi perëndimor u shpall fitimtar i pamohueshëm, si dhe ‘përplasjen e qytetërimeve’ ku Perëndimi ishte përballë gjithë qytetërimeve të tjera të botës. Shpejtësia me të cilën vdiq komunizmi dhe parashtrimi i tezës së Samuel Hantington-it për ‘përplasjen e qytetërimeve’, që pastaj u bë pika qendrore, se si ne e shqyrtojmë të ardhmen, është vërtet



befasuese. Si një ithtar pa të meta, me vetinë e kundërshtimit të pamëshirshëm të Luftës së Ftohtë, Huntingtoni e zbërtheu të ardhmen paskomuniste pikërisht përmes të njëjtin kuadër. Gabimet e opozitës së ardhshme, ndonëse të pashmangshme, thelbësore dhe të padiskutueshme, do të ishin shtatë “qytetërimet” që ajo i vuri në dukje si kundërshtarë të Perëndimit: konfucian, japonez, islamik, hindu, sllavo-ortodoks, latino-amerikan dhe “ndoshta” afrikan.<sup>2</sup> Çështja thelbësore është se ai që nxit këto gabime, është pikërisht pohimi i Kipling-ut dhe kundërshtimet e tij të vjetra, tashmë të njohura. “Qytetërimet” është një shprehje ndjellëse, por shumë e vjetruar për realitetin në fuqi: dallimi armiqësor dhe i pakalueshëm. Petku i shtetit komb, zhvillimi, globalizimi dhe moderniteti i gëlltitur nuk mund ta fshehin gjithmonë të vërtetën përfundimtare dhe të vetmen pikë kuptimplotë, se pjesa tjetër e botës është e ndryshme dhe, për këtë arsye, do të veprojë dhe do të luftojë me Perëndimin me mënyrat e vjetra dhe të njohura. Çfarëdo që ne të mendojmë për tezën e përplasjes së qytetërimeve, ajo depërton sepse është përfaqësuese shumë e saktë e asaj se si përfytyrohet e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja. Ndjenjat që zëvendësonin arsyen, ishin në veprim përpara se Huntingtoni t’i parashtronte ato si një teori të marrëdhënieve ndërkombëtare.

**LINDJA, ME GJITHË NDËRLIKIMET E SAJ, VAZHDON TË SHIHET SI BURIMI I NJË SHËRBIMI THEMELOR PËR PERËNDIMIN; FURNIZIMIN ME ‘SHTRIGA’ DHE HORRA; MORI NJERËZISH TË PAQYTETËRUAR QË MARSHOJNË DREJT KUFIJVE TANË SI ‘MËRGIMTARË’ DHE ‘TË PALIGJSHËM’; MYSLIMANËT QË SULEN TA TMERROJNË SHBA-NË; HORRA TË VJETËR DHE TË RINJ QË SHOQËROHEN ME HORRAT E KOMUNIZMIT, QË NGA RUSIA E PUTIN-IT E DERI TE KINA KËRCËNUESE. KËSHTU ISHTE DHE PIKËRISHT KËSHTU MBETET.**

Por tani ka ardhur koha që ne ta kapërcejmë këtë logjikë të dëmshme dyzimi. Të flasësh për një ndarje të qartë midis Lindjes dhe Perëndimit në një botë të globalizuar, të larmishme, të ndërvarur të çështjeve të përbashkëta dhe fatit të përbashkët njerëzor është e rrezikshme dhe e pakuptimtë. Kufijtë dhe vijat ndarëse të Lindjes dhe Perëndimit jo vetëm që kanë ndryshuar, por janë bërë të paqarta dhe të padallueshme. Ka aq Lindje në Perëndim, sa

2 Huntington, Samuel (1996) *The Clash of Civilizations and the Remaking of World Order* (New York: Simon and Schuster).



ç'ka Perëndim në Lindje. Perëndimi nuk mund të vazhdojë ta përfytyrojë Lindjen si të patjetërsueshme dhe ndryshe. Fjalimet kërcënuese kundër Perëndimit që lartësojnë pafajësinë dhe lavdërojnë epërsinë e Lindjes janë të pakuptimta. Fuqia e ideve që nxitën imperializmin perëndimor, është shëndoshë e mirë dhe e zbatuar nga vetë Lindja brenda vetes.

Kërkimi i keqbërësit fillestar dhe ndarja e fajit është një mënyrë e të vazhduarit të lojës së opozitës së paepur dhe, në këtë mënyrë, të ruajtjes së të gjitha nevojave të saj – dyshimit, gatishmërisë ushtarake, tjetërsimit dhe mendimit të qytetarëve, sjelljeve të dyfishta dhe shpërfilljes së nevojave të ngutshme njerëzore. Lindja ka qenë bashkëfajtoare në përjetësimin e moralit të kundërshtimeve të dyzuara. Sa më shumë që Lindja ka kërkuar pa diskutim të përvetësojë mjetet e Perëndimit, të modernizohet me mënyra skllavëruese, pa pranuar vërejtje, aq më shumë këmbëngul të shihet si ndryshe, aq më shumë ka romantizuar përsosmëritë eprorë të traditave dhe vlerave të veta. Por, pavarësisht se sa keq shkojnë gjërat, Lindja ka një nen shpëtimi të menjëhershëm, falë kuptimit mbizotërues Kiplingesk të botës. Mjafton dënimi i Perëndimit për urdhërimin e veprimeve të tilla si (pushtim, neo-imperializëm, mbizotërim politik dhe ekonomik) dhe përjashtimin (paaftësia për të kuptuar ose vlerësuar dhe kundërshtimi i paepur ndaj rëndësisë së vlerave dhe ideve lindore). Kjo mbulon të gjitha rastet me vetëkënaqësi dhe shmang nevojën e Lindjes për të shqyrtuar të metat e veta të brendshme. Lindja është Lindje dhe Perëndimi është Perëndim u shërben të gjithëve.

Pavarësisht se Lindja dhe Perëndimi janë prodhim njerëzor, shoqëritë njerëzore, kulturat njerëzore, qytetërimet njerëzore, mënyrat njerëzore të mendimit janë të pajisura me të mirën dhe të keqen. Asnjë shoqëri nuk është thjesht e keqe, se kjo do ta bënte atë një pohim të pamundur. Por asnjë shoqëri nuk është plotësisht e mirë, kjo do ta bënte atë engjëllorë dhe jo njerëzore. Çdo përpjekje për të lëvizur nga kundërshtimet e dyzimit, duhet të marrë parasysh mirësinë në Lindje dhe Perëndim, si dhe të këqijat brenda të dyjave. Vetëm duke pranuar se nuk ka njeri me duar të pastra, mund të pranojmë se ne të gjithë duhet të gjejmë mënyra të reja për të pastruar ndotjen e papërsosmërive tona, si në Lindje, ashtu edhe në Perëndim. Për të kuptuar atë që është e gabuar në botën tonë, duhet të bëjmë të dukshme atë që është e njëjtë dhe e papranueshme, si në Perëndim, ashtu edhe në Lindje, si dhe atë që është e mirë dhe e shëndetshme kudo që gjendet në botë.

Një botë e globalizuar është një botë në të cilën të gjithë kanë probleme dhe asnjë shoqëri nuk i ka të gjitha zgjidhjet. Ne duhet të mësojmë nga



njëri-tjetri, kushdo qofshim 'ne'. Dallimet midis Lindjes dhe Perëndimit nuk janë të pakapërcyeshme, ato janë bërë të tilla nga zvetënimi i të kuptuarit të njeriut. Ne duhet të krijojmë një gjuhë ndërsjellas të kuptueshme, me të cilën të hulumtojmë se si parimet e ngjashme dhe vlerat e përbashkëta kallëzojnë larminë e mënyrave tona të mendimit dhe organizimit shoqëror. Kjo është një trevë e vështirë. Megjithatë ka vlera, parime, domosdoshmëri, vetëdije për drejtësi, barazi, zemërgjerësi, e drejta e lirisë vetjake dhe e përgjegjësisë ndaj qytetarëve dhe shumë të tjera në çdo shoqëri, popull dhe qytetërim, dukshëm të ndryshëm nga njëri-tjetri. Kemi nevojë për një gjuhë që përqendrohet në këto ngjashmëri dhe i nxjerr ato në plan të parë. Ne duhet të jemi në gjendje të mendojmë rrugën tonë përpara, për të kuptuar se Lindja është Lindje dhe Perëndimi është Perëndim, dhe kjo është shpresa e fundit më e mirë për të gjithë, Lindjen dhe Perëndimin. Nëse nuk mund të përqafojmë mundësitë e së ardhmes vërtet të larmishme, duhet t'i dorëzohemi përfundimit dëshpërues, se çështjet bashkëkohore nuk kanë zgjidhje, në Lindje apo Perëndim, por janë pikërisht të tilla.

Nevoja për të bashkuar Lindjen dhe Perëndimin bëhet edhe më e ngutshme, kur marrim parasysh natyrën me të vërtetë botërore të shumë çështjeve që na rrethojnë, nga ndryshimet klimatike, kërcënimi i pandemive, rritja e garës për energji, deri te rritja e paqëndrueshmërisë politike dhe financiare, si dhe rritja e pabarazisë. Asnjë nga këto çështje nuk mund të 'rregullohet' nga shtete të veçanta, ato prekin çdo njeri në tokë. Ato nuk janë të thjeshta: nuk ka asgjë të thjeshtë për rregullimin e ekonomisë, sigurimin e nevojave tona me energji, luftimin e pandemive, ose ruajtjen e sigurisë sonë, apo edhe të bërit diçka bindëse për ndryshimin e klimës që vetëm në vitin 2012 solli përmybtje në Manila dhe thatësi në disa shtete të SHBA-së. Këto janë çështje të ndërlikuara. Në të vërtetë, pothuajse gjithçka me të cilën duhet të përballemi në ditët e sotme, është e ndërlikuar. Ndërlikimi rritet nga fakti se të gjitha çështjet tona janë të ndërlidhura, ndodhin njëkohësisht, janë botërore nga natyra dhe i nënshtrohen një ritmi të shpejtë ndryshimi.

Lidhur me sa u tha më sipër, ka edhe një përmasë tjetër të shtuar. Çështjet e ndërlikuara dhe të ndërlidhura, shpesh, çojnë drejt çoroditjes. Sjellja çoroditëse është e dukshme jo vetëm në tregje dhe në institucionet tona financiare, por edhe në veprimtaritë tona shoqërore, vetjake dhe institucionale. Falë telefonave të dorës, përditësimin të bisedave, e-maileve dhe lajmeve 24-orëshe, ne jemi vazhdimisht në dijeni. Prandaj, jemi të përgatitur për të vepruar menjëherë, të pajisur me mjete që mundësojnë nisjen e



modeleve të reja të veprimeve zinxhir. Gjërat shumohen shpejt dhe ndryshimi ndodh në përpjesëtim gjeometrik. Kështu pra, shqetësimet e vogla marrin me shpejtësi përmasa botërore. Sjellja e një grushti bankierësh të pafytyrë mund të çojë në rënie financiare. Një shitës perimesh mund të fillojë një lëvizje për liri dhe demokraci, ajo që u bë e njohur si “Pranvera Arabe”.

Kur ndërlikimi dhe çoroditja ndërthuren me ndryshimet e përshpejtuarra, i vetmi përfundim i paracaktuar është pasiguria. Dhjetë vjeçarët e parë të shekullit XXI e kanë bërë të qartë, se po jetojmë në një periudhë pasigurie, ndryshimi të shpejtë, paqartësie, përmbysjeje dhe riorganizimi të pushtetit. Është një kohë kur traditat e vjetra po vdesin, të rejat ende nuk kanë lindur, shumë pak gjëra duket se kanë kuptim dhe ka pak gjëra që mund të besohen ose të na bëjnë të besojmë. Diku tjetër, unë e kam përcaktuar këtë periudhë si ‘kohë pasnormale’, një epokë e ndërmjetme ku asgjë që ne e konsiderojmë në mënyrë tradicionale si normale, nuk ka kuptim.

Ku ndryshojnë kaq shumë kohët pasnormale? Në kohët normale ruhet një pranim i përgjithshëm i shpërndarjes së tanishme të pushtetit dhe rendit të nevojave. Kohët normale nuk janë pa mospajtime ose pakënaqësi, por ndryshimi pranohet në masë të madhe, përgjatë ecurisë dhe në përputhje me mënyrën se si janë gjërat. Ujdia shoqërore që e mban atë të bashkuar, është pranimi se nevojat e caktuara dhe pushtetarët kujdesen për të mirën e përbashkët. Prandaj, fuqitë dhe renditja shoqërore e gjërave janë themeli nga i cili parashikohet një e ardhme më e mirë dhe parakushti mbi të cilin ne drejtojmë përpjekjet tona për ta përmbushur të ardhmen. Në kohët normale, gojëdhënat e pasura përforcojnë mirëkuptimin dhe mbështetjen popullore për shoqërinë, shkencën dhe ekonominë. Gjithashtu, ka paralajmërime dhe nene shpëtimi që lejojnë papërsosmëritë në sistemet që drejtojnë jetën tonë. Por paralajmërimet nuk e hedhin në erë besimin qytetar dhe pranimin e institucioneve tona: të mendjes, akademike, politike, shoqërore dhe kulturore. Shkenca heroike, vullneti i popullit - i përkthyer heroikisht në ligje dhe qeverisje të mirë, maturi dhe ndershmëri, si parime të zakonshme që qeverisin ekonominë dhe qeverinë, ngjallin besim në të tashmen dhe shpresë për të ardhmen. Nëse gjërat nuk janë në rregull, apo edhe larg së qeni të përkryera, ne mbetemi të bindur se kemi mjetet, aftësinë dhe qëllimin e përbashkët për t’i vënë ato jo thjesht në punë, por të punojnë më mirë. Përforcimi i gojëdhënave krijon gjithashtu gjënë më të kërkuar të kohëve normale: vetë kohën. Gjërat mund të jenë të ndërlidhura, por mbizotëron besimi se problemet nuk janë të menjëhershme, gjithmonë ka kohë për t’i zgjidhur ato. Shqetësimet mund të ndreqen përmes një ecurie të rastësishme të rregulluar, ku pasojat, madje edhe ato të paparashikuara, do të mbikëqyren në



mënyrë të arsyeshme. Në kohët normale u besojmë, ose të paktën pranojmë, aftësinë e institucioneve të shoqërisë - politikën dhe qeverisjen, shkencën dhe ekonominë, organizatat financiare dhe marrëdhëniet shoqërore, shëndetësinë dhe ndihmën shoqërore – për të gjallëruar zgjidhje. Për këtë janë institucionet: të zgjidhin hallet, të mbështesin shoqërinë që përfaqësojnë. Sistemi mund të jetë i papërsosur, por ai ka aftësinë të ndreqë hallet dhe të përmbajë shtrembërimet e ndryshme, brenda mundësisë së vet.

Në kohët pasnormale janë institucionet, pra vetë sistemi, që bëhen pengesë. Për më tepër, nuk ka asnjë lloj kohe të mjaftueshme: çështjet kërkohen vëmendje të menjëhershme dhe të ngutshme. Edhe pse ne përpique mi t'i zgjidhim, ato veçse ngatërrohen në një rrjetë të ndërlikuar dhe shumohen shpejt, njëkohësisht dhe në mënyrë të rrezikshme. Gjithçka që e kemi marrë si të mirëqenë, duket se po zhduket dhe nuk mund t'i besohet për të dhënë atë që hamendësohej të jepte. Mbretërit të cilët ne kishim besim – shkencëtarë, ekonomistë, llogaritarë, bankierë, politikanë; qeveritë; tregjet; institucionet financiare; ndërmarrjet e barnave; përbindëshat e teknologjisë – e nxjerrin veten zbuluar. Nuk është se i kemi parë ndonjëherë themelet e shoqërive tona si të përsosura. Përkundrazi, është të kuptuarit se këto themele janë jashtëzakonisht të lëkundura, janë të paafta për të zgjidhur të papërsosurën e qëndrueshme të rendit tonë botëror, që, në fakt, mund ta çojnë shoqërinë drejt një rrëtimi të mundshëm. I gjithë rrjeti është përshtatur që të shpërblejë në mënyrë të shpërpjesëtuar pakicën në kurriz të shumicës. Uni i pushtetarëve dhe të fuqishmëve zbulohen si i vetmi mjet që bën punë dhe e vetmja vërtetësi nga e cila varen të gjithë. Mbikëqyrja dhe drejtimi kthehen në shpresa tepër të kota. Të gjitha shpjegimet gjithëpërfshirëse, gojëdhënat që e lidhën dhe e bënë shoqërinë të qëndrueshme, kthehen në helm, bartëse të shkaktarëve që molepsin shoqërinë me mosbesim dhe mungesë vetëbesimi. Në kohët pasnormale ne e dimë se kemi aftësi, por jo mundësi të vazhdueshme - morale dhe organizative - për t'i përkthyer aftësitë tona në përkushtim të zgjidhjeve të qëndrueshme të çështjeve vendore, të ndërli dhura dhe në rritje. Në kohët normale pasiguritë janë të vogla dhe të zotërueshme. Por në kohët pasnormale, pasiguria zë qendrën e vëmendjes. Meqenëse gjithçka është e ndërli dhur, e ndërlikuar dhe çoroditëse, si dhe në ndryshim me shpejtësi, asgjë nuk mund të përshkruhet me ndonjë farë sigurie. Aq më tepër, duke pasur parasysh ndërlikimin e rrjetit të shqetësimeve në rritje dhe shkallën e ndryshimit, ne nuk jemi në gjendje ta lidhim gjendjen tonë të tanishme me ndonjë të kaluar. Prandaj, nuk jemi në



gjendje të mësojmë asgjë nga e kaluara, edhe kur e dimë se ka pasur dështime të krahasueshme vazhdimisht përgjatë historisë.

Është e qartë se vështirësitë e kohërave pasnormale nuk mund të zgjidhen me mjetet që kemi. Ato kërkojnë mënyra të reja të të menduarit të bërit të gjërave, si në Lindje, ashtu edhe në Perëndim. Megjithatë, ka mësim për t'u nxjerrë nga veçoritë mbizotëruese të vetë kohëve pasnormale. Ndërlikimi na tregon se dëshira e rregullit dhe e sigurisë janë duke u vjetruar. Nuk ka asnjë model të vetëm sjelljeje, mënyrë të menduari, ose metodë që mund të na japë një përgjigje për të gjitha sëmundjet tona të ndërlikdhura dhe të ndërlikuara. "Tregu i lirë" është po aq vegim, sa edhe pohimi se shkenca dhe teknologjia, laicizmi liberal, apo fundamentalizmi fetar do të na shpëtojnë nga ngërçi i tanishëm. Prandaj është marrëzi që ne të kemi besim në një ideologji të vetme, ose në një ide themelore të së vërtetës. Larmia dhe shumësia janë thelbësore, si për të kuptuar, ashtu edhe për t'u marrë me ndërlikimin. Çoroditja na mëson se përgjegjësia dhe llogaridhënia vetjake e shoqërore janë të gjitha të rëndësishme për mbijetesën tonë bashkërisht. Veprimet e çdonjërit, apo një grushti njerëzish - nga bankierët e pafytyrë, deri te një punonjës zyre i shpërfillur - mund të shkaktojnë paqëndrueshmëri dhe trazira të thella. Nga ana tjetër, mbështetja te vetja, ideja që ndonjëri mund të përmbushë veten dhe të bëjë gjithçka që dëshiron, është një përcaktim keqandjellës. Në kohët pasnormale, botën vërtet mund ta shkatërrojë veprimtaria e një grushti njerëzish.

Kur bashkohen çoroditja dhe ndërlikimi, shpeshherë, malli përfundimtar është mosmarrëveshja. Një vit Londra ndizet nga trazirat (multikulturalizmi është shpallur një fatkeqësi e pandreqshme) dhe vitin e tjetër multikulturalizmi përshëndetet si një arritje madhështore, pasi qyteti kremton larminë dhe fitoret olimpike. India mendohet të jetë një superfuqi ekonomike, megjithatë shumica dërrmuese e popullsisë së saj jeton në varfëri të tmerrshme. Ndërsa shoqëritë bëhen më të larmishme dhe të shumëllojshme, pjesë të mëdha të popullsisë brenda vendit bëhen gjithnjë e më rrënjësisht kombëtariste dhe mendjengushta. Ndërsa pjesë të caktuara të botës po përjetojnë ndryshime të pashembullta, ku teknologjia e të dhënave dyfishon fuqinë e saj çdo vit, zotësia jonë për të renditur të dhënat gjenetike dyfishohet çdo vit. Pjesë të mëdha të botës dhe pjesë të jetës sonë shoqërore janë pothuajse në prehje. Ndërsa teknologjia na detyron të punojmë shpejt e më shpejt, shpejtësia e udhëtimit ajror, që nga rënia e Konkordit, në fakt, është ngadalësuar. Ndërsa miliardërit dhe milionerët janë rritur në të gjithë botën, varfëria e thellë në Afrikë është po aq e keqe, sa në kohët e





pushtimeve, mos edhe më keq për shumë njerëz. Në një botë me ushqime të bollshme, rreth 850 milionë vetë ende shkojnë në shtrat të uritur çdo natë. Ndërsa njohuritë tona rriten me hapa të mëdhenj në pothuajse të gjitha fushat, padija jonë rreth kulturave të tjera është për të ardhur keq.

Jo të gjitha mosmarrëveshjet e dukshme rreth nesh janë prodhime të kohëve pasnormale. Por kohët pasnormale kanë nxjerrë në pah lloje të veçanta mosmarrëveshjesh. Shumë probleme bashkëkohore, të tilla si shërimi i epidemive botërore, pasojat nga ushqimet e përshtatura gjenetike dhe me përbërës *nano*, kanë një pasiguri të brendshme që mund të zgjidhet vetëm diku në të ardhmen. Prandaj, mbetemi të paditur për pasojat e tyre në të tashmen dhe të ardhmen e afërt. Ndryshimi i shpejtë në një mjedis të pasigurt do të thotë, gjithashtu, se ne mbetemi të paditur rreth zgjedhjes dhe mundësia për të fituar njohuri të reja na ikën nga dora. Padija nuk zgjidhet me anë të kërkimit të zakonshëm, prandaj nuk kemi asnjë ide të pranishme së saj. Kështu që jemi sulmuar nga një goditje e trefishtë e padijes. Ne duhet ta hulumtojmë të ardhmen në një gjendje pasigurie të vazhdueshme dhe, nëse jo në padije të plotë, atëherë të paktën me njohuri të pjesshme ose të pamjaftueshme. Le të marrim parasysh risitë. Ne mendojmë se mallra të reja dhe të ndryshme po prodhohen vazhdimisht, ndërsa teknologjia ecën përpara me hapa të mëdhenj. Në të vërtetë, risitë janë ngadalësuar rrënjësisht, që nga viti 1970, siç thekson Tajler Kauen, në librin *Amullia e Madhe*. Shumica e mallrave ‘të reja dhe të përmirësuar’, që nga pajisjet elektronike, deri te mallrat e qendrave tregtare, nuk janë risi të vërteta, por përmirësime të vogla. Rreth 85-90 për qind e barnave të reja nuk janë asgjë tjetër, veçse ato që kanë qenë: janë ndryshime të vogla të barnave që kemi, me pothuajse asnjë përparësi shërimi.<sup>3</sup> Risitë tani janë zëvendësuar me *qiramarrje*, siç tregon Xhozef Stiglets në mënyrë kaq të shkëlqyer, në librin *Çmimi i pabarazisë*. Në fakt, kërkimi i qirasë tani është bërë normë, pasi sjell kamje shumë më të madha për tregtarët e mëdhenj dhe përfitime për drejtuesit, sesa mund të sjellin risitë e dobishme për shoqërinë.<sup>4</sup>

Ne mund të nxjerrim mësimë edhe nga mosmarrëveshjet. Ato e përqendrojnë shikimin tonë drejt asaj që Amin Maluf e quan pragu i “paaftësisë morale”. Mosmarrëveshjet brenda rrjetit tonë ekonomik dhe financiar, mënyra e përqasjes së industrisë dhe ndërmarrjeve të barnave, sjellja e politikanëve e kështu me radhë, janë në thelb çështje të parimeve morale që ne

3 Cowen, Tyler (2011) *The Great Stagnation* (Londër: Dutton Books).

4 Stiglets, Joseph (2012) *The Price of Inequality* (Londër: Allan Lane).



i kemi shpërfillur prej kohësh.<sup>5</sup> Në kohët pasnormale, parimet e modës së vjetër lëvizin nga rrethina drejt qendrës. Mosmarrëveshjet, gjithashtu, na mësojnë të pranojmë dhe vlerësojmë këndvështrime të ndryshme. Nuk ka përgjigje të saktë ose të gabuar për asnjë çështje të caktuar. Edhe kuptimi shumë themelor i një çështjeje kërkon një ligjërimit rreth përmasave të saj të ndryshme, duke përfshirë një varg këndvështrimesh dhe nevojash, mes tyre edhe ato të njohësve të fushës, qytetarëve, të rriturve dhe fëmijëve, njerëzve me prejardhje të ndryshme shoqërore dhe kulturore, me ide të ndryshme rreth parimeve morale, por edhe duke marrë parasysh nevojat e gjallesave jonjerëzore. Mosmarrëveshjet nuk mund të zgjidhen, ato duhet të kapërcehen. Kjo do të thotë që ne duhet të lëmë mënjane dallimet tona, Lindjen dhe Perëndimin, dhe të zotërojmë mosmarrëveshjet dhe ndërlikimin, duke u marrë vesh përmes miratimit, ku të gjithë pjesëmarrësve u jepet zë i barabartë. Nuk ka mjete të dhunshme për të zgjidhur mosmarrëveshjet, apo për t'u marrë me ndërlikimin. Dhuna vetëm sa shton ndërlikimin e mëtejshëm dhe na çon edhe më shumë buzë çoroditjes, siç e kanë treguar aq mirë rasti i Afganistanit dhe Pakistanit. Veprimet ushtarake për të larguar një kërcënim të përfytyruar, vetëm sa gjallërojnë më shumë çoroditje, duke sjellë kërcënime të reja dhe të padukshme.

Përulësia, modestia, përgjegjshmëria, përgjegjësia, larmia dhe ligjërimi nuk janë shtesa të shtuara, por një kërkesë thelbësore për të mbijetuar në kohët pasnormale të pasigurisë, çoroditjes, ndërlikimit dhe mosmarrëveshjeve. Në kohët pasnormale, nuk ka vend për thënien e thjeshtuar të Kiplingut rreth Lindjes dhe Perëndimit, si dy dema të zjarrtë në një ring boksi. Përkundrazi, Lindja dhe Perëndimi duhet të bashkohen dhe të përdorin më të mirën që kanë për të zbatuar traditën, historinë dhe qytetarinë e tyre për t'u marrë vesh gjatë kohëve tona të trazuara, me mendjen dhe njerëzimin të pacenuar.

Si në Lindje, ashtu edhe në Perëndim, ka më shumë mënyra të të menduarit, parime për përcaktimin e kërimit, ngjizjen e teorisë dhe vënien në dije rreth të kuptuarit, sesa mund ta kemi përfytyruar ndonjëherë. Për të kapërcyer ngërçin e vështirë të kohës sonë, kemi nevojë për pyetje dhe njohuri të reja, përpara se të mund të shpresojmë të kemi përgjigje të reja, më të mira.

Ky është udhëtimi hulumtues që ne duhet të ndërmarrim.

---

5 Maalouf, Amin (2011) *Disordered World: Setting a New Course for the Twenty-First Century* (Londër: Bloomsbury)



## Mosmarrëveshjet e Bashkimit European

*Jordi Serra*

Një hije po e ndjek gjithandej Bashkimit European (BE) – hija e mosmarrëveshjeve mes vetes. Këto mosmarrëveshje pohojnë se BE-ja po kthehet në një institucion vërtet pasnormal. Gjithashtu, ato tregojnë se BE-ja po shkon drejt parëndësisë. Mosmarrëveshjet janë pasojë e politikave ekonomike të BE-së, fuqia kryesore lëvizëse që e ngjizi Bashkimit. Por janë përmasat e saj politike, shoqërore, madje edhe kulturore, ato që do të sigurojnë rëndësinë e saj në të ardhmen.

Është e lehtë të përfytyrohen rrethanat e Europës së pas Luftës së Dytë Botërore, që dëshmuar krijimin e ‘Bashkësisë Europiane të Qymyrit dhe Çelikut’ dhe ‘Bashkimit Ekonomik European’, në vitin 1957, dy institucione që ishin fara e BE-së. Nuk mund të ketë aspak dyshim, se, në atë kohë, kjo ishte një arritje e jashtëzakonshme, ku gjashtë vende që kishin qenë armiq deri vonë (Belgjika, Franca, Italia, Luksemburgu, Holanda dhe Gjermania Perëndimore), u pajtuan për krijimin e një bashkimi doganor dhe disa përjasje të përbashkëta ekonomike. Sigurisht, fillimi me çështjet ekonomike asokohe e bëri punën më të lehtë, por lënda djegëse për të vazhduar dhe për të zgjeruar atë projekt themelor duhej të ndërthurte vullnetin politik dhe përparimin shoqëror.

Ose të paktën kështu dukej, deri në vitin 2004. Gjatë atij viti, anëtarët duhej të miratonin Kushtetutën Europiane. Megjithatë, të dhënat shfuqizuese nga referendimet franceze dhe holandeze e sollën ecurinë drejt një fundi të parakohshëm. Është me vend të shqyrtohet se përse ndodhi. Përparimi i BE-së i hodhi rrënjët në një mori marrëveshjesh, nga të cilat tri janë kryesoret: Marrëveshja për Rrjedhat e Bashkimit European, Marrëveshja për



Themelimin e Bashkimit Ekonomik Europian (të dyja të nënshkruara në Romë, në 1958) dhe Marrëveshja për Bashkimin Europian (nënshkruar në Mاستriht, më 1992). Deri në vitin 2001, ishte e qartë se Bashkimit i duhej një hap cilësor përpara dhe, kështu, Këshilli Europian në Laeken (Bruksel) u pajtua për hartimin e një kushtetute europiane. Qëllimi ishte përafrimi i ligjeve të larmishme dhe nxitja e këtij çasti politik. Megjithatë, këshilli që do ta shkruante atë, i kryesuar nga ish-presidenti francez, Valéry Giscard d'Estaing, së shpejti hasi në kufizime të rëndësishme. Ndoshta ngaqë kishin një përfaqësues të vendit më socialist të Europës, i cili drejtonte ecurinë, por fakti është se ajo që duhej të ishte themeli i një qenieje vërtet mbi-shtetërore, u kthye në planin e një klubi anëtarësh vetëm shtetëror.

Kështu që Kushtetuta Europiane u shfaq si mosmarrëveshja e parë që vuante BE-ja. Ajo është larg së qeni Kushtetutë Ndërkombëtare dhe është shumë e te zgjatur për një anëtarësi midis shteteve. E thënë troç, shumë shpesh, BE-së i mungon fuqia për të ndërmarrë politika të përbashkëta, por shteteve, gjithashtu shpesh, u mungon ndikimi i mjaftueshëm për të mbrojtur nevojat e veta të veçanta. Për ta përmbledhur me fjalë të tjera: shpesh, anëtarët duan që politikat e BE-së të mbrojnë nevojat e tyre, pa varësisht ndonjë largpamësie të përgjithshme (ose, më saktë, në kurriz të çdo politike të përbashkët). Si rrjedhojë, shumë politika nuk kanë as vendosmërinë apo guximin për t'u marrë me çështjet e thella që prekin Europën. Kjo shpjegon se përse politikat europiane janë gjithmonë të ngatërruara, duhet të përfshijnë pëlqimet më të pakta dhe të shumanshme, si dhe kurrë nuk përmbushin asgjë të prerë, që të kënaqë shumicën e qytetarëve të këtij Bashkimi.

Megjithatë, BE-ja shihet si një shembull i qeverisjes së suksesshme ndërkombëtare; të paktën derisa erdhi kriza e vitit 2008. E veçanta e kësaj krize është se ajo është e vazhdueshme dhe botërore. Në përgjithësi, kjo krizë financiare paraqiti një sfidë dhe një mundësi për BE-në. Por sfida nuk u pranua dhe rasti u humb. Nëse pranojmë se shkaku kryesor i krizës ishte këmbëngulja te një model ekonomik të papërshtatshëm për kërkesat dhe nevojat e kohëve pasnormale, atëherë fillon të bëhet e qartë, pse mund të ishte një mundësi e shkëlqyer për të përmirësuar ravijëzimin e Bashkimit Europian. Në vend të kësaj, anëtarët e BE-së kanë vendosur t'i varin shpresat te zgjidhjet që tashmë ishin pjesë e problemit. Fjala kyçe, në këtë rast, është shtrëngesë. Megjithatë, tani që e dimë se themeli ekonomik i një shtrëngese të arsyeshme, të paktën është i dyshimtë, duhet të pajtohemi me faktin se ajo është thjesht një zgjidhje politike. Zgjidhjet politike janë të



hapura për shqyrtim, për hulumtime pro dhe kundër, si dhe kanë nevojë për një miratim të përbashkët, për të mbërritur në një mundësi më të mirë dhe të disponueshme. Në vend të kësaj, institucionet europiane përqafuan masat shtrënguese dhe me besim të patundur u thanë njerëzve të kontinentit, ta pranojnë atë, pa bërë pyetje, ose, përndryshe, do të përfundojnë keq.

Në mënyrë krejt të pakuptimtë, shkurtimet e thella të buxhetit duken si zgjidhja më e qëndrueshme, duke pasur parasysh kufizimet e ravijëzimit europian. Për shembull, politika ekonomike europiane sillet rreth euros, e cila vendos kushte dhe kufizime të rënda në mundësinë e zgjedhjes për BE-në. Euro u përcaktua në 1995, u miratua në 1999 dhe u shndërrua në monedha dhe kartëmonedha të përdorshme në 2002. Në atë kohë, ajo mishëronte shtytjen politike për të arritur një nivel më të lartë bashkëngjitjeje, një monedhë të përbashkët për një Bashkim më të fortë. Por, fatkeqësisht, është kthyer edhe në një ogur të mungesës së vullnetit politik. Euro ishte dhe është e pamjaftueshme për të gjallëruar një politikë të përbashkët ekonomike dhe, pa një politikë të përbashkët, është e dënuar. Në të vërtetë, euro lindi e mohuar nga kushtet e nevojshme për suksesin e saj të vërtetë. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për Bankën Qendrore Europiane: BQE. Ajo nuk mund të veprojë si një bankë qendrore, siç është Rezerva Federale Amerikane, ose Banka e Anglisë. Kushtet që Gjermania i vendosi BQE-së, ishin se ajo mund të vepronte vetëm për të mbajtur inflacionin në një nivel të ulët dhe do të ndalohej veçanërisht të jepte hua për anëtarët e shteteve (megjithëse kjo pikëpamje e veçantë u përmirësua në vitin 2012, kur BQE-ja filloi ta blinte borxhin e huave të marra prej anëtarëve të shteteve). Megjithatë, në shumë pikëpamje, BQE-ja ende duket si një bankë gjaku e drejtuar nga dëshmitarët e Jehovahit.

Në këtë mënyrë, euro vuan nga dy dobësi të tmerrshme. Së pari, ajo përcaktohet si monedhë e përbashkët për vendet me kushte dhe gjallëri thellësisht të ndryshme ekonomike. Së dyti, drejtimi i saj është në duart e një institucioni, BQE-së, i cili është plotësisht i pavarur nga kontrolli shtetëror. Nuk është për t'u habitur dhe kuptohet që disa vende (Danimarka, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar) parashikuan se shpenzimet e anëtarësimit në euro i tejkalojnë përfitimet e saj. Kriza financiare e ka nxjerrë lakuriq mbretërinë europiane. Ndryshe nga SHB-ja dhe Britania e Madhe, ku bankat qendrore kanë mundur të shmangin disa nga ndikimet më të këqija të rënies ekonomike, BQE-ja ka qenë në gjendje vetëm të japë hua të lira për bankat private europiane, me shpresën se këto banka do të ndihmonin shtetet e tyre kombëtare. Por, çfarë kanë bërë këto banka? Deri



kur BQE-ja filloi të blinte drejtpërdrejt borxhin e huave shtetërore, ajo përdorte paratë e BQE-së (me një normë interesi prej 1%, ose më pak, që nga viti 2011) për të blerë këto borxhe (me një normë shumë më të lartë) dhe për të nxjerrë fitime brenda rregullave, gjatë ecurisë. Në çdo rast, për uljen e borxhit shtetëror, shtetet e BE-së mund të bënin vetëm një gjë: të shkurtonin shpenzimet e tyre buxhetore. Në fund të fundit, masat shtrënguese kanë qenë më shumë një përpjekje për të ofruar një ngushëllim moral të dyshimtë për shkurtime buxhetore, sesa një arsytim i vërtetë ekonomik.

**DHËNIA PAS MASAVE SHTRËNGUESE KA ÇUAR NË PËRSHPEJTIMIN E NJË MOSMARRËVESHJEJE TË DYTË: KAMJA VJEN PËRPARA NJERËZVE. MUND TË JETË E VËSHTIRË PËR ANËTARËT E BE-SË TË ARRIJNË NDONJË MARRËVESHJE, PËRVEÇSE NË NJË RAST TË CAKTUAR: ATA BASHKOHEN MENJËHERË, KUR VJEN PUNA PËR TË MBROJTUR BANKAT.**

BE-ja ka hedhur miliona në një program për të siguruar qëndrueshmërinë e rrjetit financiar, por shumë pak prej tyre u kanë dhënë hua tregtarëve në vështirësi, ose njerëzve të varur nga hipoteka të kushtueshme. Megjithatë, të mos harrojmë se burimi i këtij financimi (duke përfshirë derdhjet e drejtpërdrejta dhe kreditë e lira nga BQE) janë paratë e qytetarëve, para që vijnë nga taksat e tyre dhe, në fund të fundit, nga xhepat e të gjithëve në BE. Kjo, për arsye se rënia e mundshme e bankave do të kishte pasur një ndikim të vazhdueshëm, që do ta kishte përkeqësuar krizën dhe do të zgjeronte pasojat e saj. Tragjedia është se kriza ishte një mundësi e shkëlqyer për të rimenduar sistemin financiar europian. Sigurisht që do të kishte pasur kundërshtime, pasi një reformë e tillë do të shkaktonte më shumë mundime dhe vuajtje për qytetarët. Por vë bast se, pikërisht tani, shumë grekë, irlandezë, portugezë, italianë dhe spanjollë do ta kishin marrë këtë rrezik, pa ndonjë ngurrim. Jo vetëm kaq, duke pasur parasysh rrethanat dhe gjithë përpjekjet e bëra për forcimin e sistemit bankar europian, përfundimi i arsyeshem do të ishte krijimi i një politike të përbashkët bankare dhe një sistemi të përbashkët financiar. Por një fat i tillë nuk na erdhi nga dera. Disa shtete anëtare, të udhëhequra nga Gjermania, kanë penguar parashtrimin e çdo bisede kuptimplotë për reforma dhe mundësi të tjera. Sistemi u shërben disa të përzgjedhurve që po bëjnë lekë me thasë, ndërsa shumë të tjerë kanë ngelur nën ngrehinën e varfërisë.



Si përfundim, të gjitha përpjekjet e BE-së për të lundruar në krizat financiare kanë prodhuar çarje të thella brenda kufijve të saj, duke gjallëruar më shumë mosmarrëveshje. Ç'është e vërteta, brenda këtij Bashkimi ka qytetarë të dorës së parë dhe të dytë; d.m.th., njerëz nga vendet e shpëtuar (të dorës së dytë), kundrejt atyre që i shpëtuan (të dorës së parë). Mjeti i shpëtimit ka qenë një provë e rëndë për bashkimin e BE-së. Vendet e veriut fajësojnë ato të jugut, se janë të pakujdesshme me shpenzimet e tyre. Ato të jugut bërtasin se edhe vendet e veriut kanë përfituar nga ato shpenzime dhe se disa prej tyre, gjithashtu, kanë pasur nevojë dhe kanë marrë ndihmë në të kaluarën, si për shembull, në rastin gjatë ecures së ribashkimit gjerman. Megjithatë, do të ishte e padrejtë të thuhet se këto çarje janë mes qytetarëve të shteteve veriore, kundrejt atyre jugore. Në fakt, ndarja e vërtetë, mes të gjithëve dhe çdo vendi, është midis atyre që po rriten ekonomikisht dhe atyre që nuk po rriten. Gjermania është një shembull i përsosur: ndërsa shifrat makro të saj janë të lakmueshme, e vërteta është se shumë nga qytetarët e saj po mbijetojnë me punë të rëndomta që mezi i mbajnë. Gjithnjë e më shumë europianë po pajtohen me bindjen se fëmijët dhe nipërit e tyre mund të mos arrijnë kurrë nivelin e mirëqenies që kanë gëzuar vetë ata. Përsëri, është e vështirë t'i shpëtosh përfundimit se ravijëzimi fillestar i BE-së nderon ata që zotërojnë pasuri, në krahasim me të tjerët që mbështeten në punën e tyre mendore ose fizike për mbijetesë. Gjë që, nga ana tjetër, përforcon mendimin se ka një mospërputhje në rritje midis qëllimeve ekonomike dhe shqetësimeve shoqërore brenda BE-së.

Paketa e shpëtimit ka zbuluar botërisht, se sa e brishtë është struktura e Bashkimit Europian. Por brenda Bashkimit, paketa e shpëtimit ka përforcuar përshtypjen se BE-ja përkrah qëndrueshmërinë ekonomike, përpara ligjshmërisë demokratike. Le të marrim parasysh rastin e Italisë. Shumë gjëra mund të thuhet për qeverinë e shthurur, të drejtuar nga Silvio Berlusconi Unë do të jem njeriu i fundit që do ta mbroj, por Berlusconi u zgjodh në mënyrë demokratike, me një shumicë dërrmuese. Megjithatë, BE-ja bekoj emërimin e një qeverie teknike të pazgjedhur; që, në të vërtetë, u kundërshtua në masë të madhe nga votuesit italianë.

Kriza e Qipros është një shembull tjetër. Kur qeveria qipriote kërkoi një paketë shpëtimi nga Mekanizmi Europian i Qëndrueshmërisë, në vitin 2012, këshilla fillestare europiane ishte vendosja e një takse në të gjitha kursimet dhe llogaritë bankare (në kundërshtim me vetë ligjet që sigurojnë të gjitha kursimet, deri në 100.000 euro). Për të parandaluar një rrjedhje bankare, u krijua një 'corralito'. Emërtesa 'corralito' u farkëtua në



Argjentinë, në vitin 2001, kur qeveria ngriu të gjitha llogaritë bankare dhe ndaloi tërheqjet për të shmangur rrjedhjet bankare. Si rrjedhim, qytetarët qipriotë nuk u lejuan t'i preknin kursimet e tyre të ruajtura nëpër banka. Edhe kur Kuvendi i Qipros e kundërshtoi këtë lloj qasje, "corralito" u ruajt. Ndërsa pakënaqësia në Qipro u rrit (bashkë me frikën midis shumicës së kursimtarëve nëpër Europë), më në fund, vendosën të hiqnin dorë nga llogaritë nën 100.000 euro dhe kërkuan që kursimet mbi këtë shifër të taksoheshin jo më pak se 20% të shumës së përgjithshme (mund të ketë qenë deri në 60%, në disa raste). Kjo nuk është demokraci, siç e kupton çdonjëri, por diktat ekonomik i llojit më të keq. Dhe, sërish, na tregon se disa qytetarë të BE-së janë më të barabartë se të tjerët.

Pra, cili është përfundimi? BE-ja duhet të vendosë në një lloj mënyre, as më pak e as më shumë, sesa të mrekullueshme. A është një Bashkim i bazuar në logjikën e kapitalizmit të kohëve të fundit, apo është diçka tjetër? A është qëllimi i saj për të bashkuar qytetarët, për t'i bërë jehonë vërshimit të njerëzve dhe punës midis shteteve europiane, për t'i afruar qytetarët e Europës, për të festuar historitë e tyre mendore dhe kulturore, apo... për të pasuruar bankierët dhe institucionet financiare? BE-ja duhet të merret me disa çështje të thella dhe thelbësore. Së paku, Bashkimi European duhet të shtrojë pyetjen: A është BE-ja:

- një treg i përbashkët?
- një monedhë e përbashkët?
- një ravijëzim i papërfunduar për një qeverisje federale?
- Apo të gjitha sa thamë më sipër?

E ardhmja e BE-së dhe rëndësia e saj në kohët pasnormale varet nga kjo përgjigje.

Unë do të theksoja se kufizimi i BE-së vetëm në përmasën e saj ekonomike, ose, edhe më keq, lejimin e logjikës ekonomike të përcaktojë mënyrat e veprimit, është një gabim i madh. Europa ka qenë gjithmonë një sixhade trevash, popujsh, kulturash dhe lloj-lloj besnikërisht. Ajo kurrë nuk ka lulëzuar në mirëkuptim (në fakt, lufta ka qenë normë në historinë europiane) dhe vërtet është e vështirë të përfytyrohet si tërësi njëfarëshe. Pra, nuk duhet të na vijë çudi që është kaq (për dreq) e vështirë ta vësh në punë si një njësi të vetme. Sepse, edhe kur bëhet fjalë për të vepruar si njësi ekonomike, veçoritë ekonomike nuk pasqyrojnë thelbin e vërtetë të BE-së. Si një bashkim i arsyeshëm, sukcesi i saj i vërtetë qëndron diku tjetër.



Lidhur me këtë, dy shembuj më vijnë posaçërisht në mendje: të drejtat dhe mbrojtja e mjedisit. Nëse marrim parasysh udhërrëfyesin zyrtar të BE-së, të ashtuquajtur ‘sigurimet bashkërisht’, mund të pranojmë se është një përmbledhje e jashtëzakonshme e të drejtave që ndoshta përcaktojnë trevën më demokratike në botë. Merrni parasysh, fjala vjen, çështjen e të drejtave të njeriut: qytetarët europianë janë veshur me të drejta që njerëzit nga pjesët e tjera të botës vetëm mund t’i ëndërrojnë. Fakti është se Bashkimi Europian është një nga aktorët kryesorë në zbardhjen e të drejtave të njeriut. Më në thelb, këto të drejta kanë qenë një nga kushtet kryesore, kur është gjykuar përshtatshmëria e çdo shteti të ri anëtar për anëtarësim në këtë Bashkësi. Për më tepër, roli i Gjykatës Europiane ka qenë vendimtar në mbrojtjen dhe mbështetjen e këtyre të drejtave. Kur një vend është treguar i pakujdesshëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, qytetarët e kanë ditur se gjendet një epror më i lartë ku ata, më në fund, mund të gjejnë drejtësi. Dhe, me të vërtetë, shumë shtete anëtare me një qëndrim të dobët ndaj zbatimit të të drejtave të njeriut, si Britania e Madhe, dëshmojnë se Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut për ata ka qenë një fshikullimë. E njëjta gjë mund të thuhet për mjedisin. BE-ja ka zhvilluar ligjet më të përparuara për çështjet mjedisore. Kuptohet që disa mund t’i kundërshtojnë ato, si shumë të ndrojtura ose dritëshkurtra. Të tjerë do të thonë se nuk shkojnë aq larg sa duhet. Por është gjithashtu e vërtetë, se shumica e shteteve të vendeve anëtare do të kishin bërë shumë më pak, pa udhëzimet e BE-së. Jo vetëm kaq, shkresat e Komisionit Europian për çështje të tilla, si shëndetësia, arsimi, barazia gjinore, kushtet e punës dhe të drejtat e pakicave, kanë detyruar disa shtete të shtyjnë përpara ecurinë e ligjeve të tyre përkatëse në përputhje me parimet e BE-së.

Shpesh, këto arritje të vërteta anashkalohen, për shkak të theksit të tepërt mbi ekonominë, e cila përmbys dhe rrënon gjithçka. Unë do të arsyetoja se shumica e qytetarëve të BE-së tani e kuptojnë, në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar, se Bashkimi ka arritur një pikë kthese.

**TUNDIMI I ELITËS DREJTUESE ËSHTË QË TË NDRYSHOJË GJËRA TË VOGLA PËR TA RUAJTUR GJITHË PJESËN TJETËR TË PAPERKUR. ME FJALË TË TJERA, T’I MBAJË GJËRAT ASHTU SIÇ JANË. POR KY MENDIM TASHMË ËSHTË I VJETRUAR DHE I RREZIKSHËM.**





BE-ja duhet të thellojë ecurinë e vet politike për t'u bërë vërtet një tërësi shumëkombëshe dhe jo vetëm një super-shtet, por duhet të prodhojë një ravijëzim dhe strukturë të re më të përparuar të qeverisjes ndërkombëtare. Disa nga shtetet anëtare të saj përbëjnë një pengesë të madhe për këtë qëllim; ato janë pjesë e problemit, jo e zgjidhjes. Disa janë shumë të fuqishme dhe pengojnë ndryshime domethënëse; të tjerë janë shumë të dobët, që t'ia fillojnë dhe të bëjnë ndryshimin. Shtetet, gjithashtu, turbullojnë përshtypjen e qytetarëve, duke i bërë ata të ndjejnë se nevojat e tyre mund të plotësohen dhe mbrohen vetëm nga shteti i tyre kombëtar. Për rrjedhojë, ata parandalojnë lidhje më të drejtpërdrejta ndërmjet institucioneve europiane dhe shtetësisë së tyre.

Zgjedhjet europiane të vitit 2014, ishin shenja e parë. Me partitë e skajit të djathtë në rritje, kuvendi strehoi përqindjen më të lartë të përfaqësuesve anti-Europë në historinë e vet. Çështja këtu është se, përtej demagogjisë, porosia e këtyre partive përfshinte disa grimca të së vërtetës. Ka një problem me BE-në, ajo është shumë e mbingarkuar me mosmarrëveshje, shumë e ndërlikuar, e paaftë për t'u përshtatur me ndryshimet e shpejta, kështu që nuk bën punë. Me fjalë të tjera, nuk ecën me hapin e kohëve pasnormale. Për partitë e kraut të djathtë (dhe të skajit të djathtë) zgjidhja është më pak BE, ndërkaq, për të tjerat mundësia e vetme logjike është pikërisht e kundërta: më shumë BE.

Megjithatë, ngjarjet e vitit 2015 dëshmuar se të dyja palët kishin të drejtë dhe, njëkohësisht, gabuan. Gjatë asaj vere, disa arsye të ndryshme nxitën një nga shpërnguljet më të mëdha të qenieve njerëzore drejt Europës. Miliona refugjatë nga Siria dhe vende të tjera filluan të hyjnë në Europë, përmes Greqisë dhe Ballkanit. Duke qenë se po shpëtonin nga një rrethanë e tmerrshme (dhe përkeqësuese), pakkush i kundërshtoi haptazi në fillim. Por, ndërsa shifrat u përshkallëzuan, u rritën edhe kundërshtimet. Shumë pak vende u përballën me sfidën e pranimit dhe pritjes së refugjatëve, shumica thjesht mbyllën kufijtë e tyre, disa madje ndërtuan gardh me tela me gjemba përreth. Mosmarrëveshjet e brendshme të BE-së dolën sheshit. Ana më e keqe e Bashkimit doli në pah: shtirja dhe fanatizmi i shfrenuar. Disa shtete anëtare, si Hungaria, Sllovakia dhe Polonia, kundërshtuan haptazi marrëveshjet europiane, për të mos përmendur parimet e veta të të drejtave të njeriut. Mbikëqyrja e kësaj fatkeqësie njerëzore ka qenë një burim turpi për shumë europianë, që atëherë. Çfarëdo që mund të ketë qenë këndvështrimi moral, BE-ja e ka humbur. Në fund të fundit, unë do të thosha se BE-ja, si një projekt i bashkëpunimit shumëkombësh, ka vdekur. Në ditët



e sotme, shumë pak njerëz mendojnë se BE-ja u shërben interesave ose nevojave të tyre, madje nuk është çudi që shumica mendojnë se nuk ka mbetur asgjë për 'ta, brenda atij Bashkimi. Dalja e Britanisë, një kamberë alarmi për administratën europiane, është një provë bindëse dhe s'ka si të bëhet ndryshe. Shumë nëpunës në Bruksel, tani pyesin veten të habitur, pse kaq shumë britanikë besonin se BE-ja është më shumë një pengesë, sesa një nxitje për begatinë dhe mirëqenien e tyre? E vërteta është se, deri në një pikë, nuk ka rëndësi, nëse kanë votuar për daljen nga BE-ja, për arsye të gabuara apo jo. Një gjë është e vërtetë: shumë qytetarë europianë janë të bindur se BE-ja është thjesht një ngrehinë burokratike, e gatshme t'u japë përparësi fuqive ekonomike mbi njerëzit e zakonshëm dhe, ende më keq, do t'i detyrojë ata të pranojnë të porsaardhurit nga vende të tjera. Britanikët janë vetëm të parët që shprehën ankesat e tyre dhe vepruan në përputhje me rrethanat, por mund të mos jenë të fundit.

Pra, mundësia tani është: ose ta çojmë BE-në drejt një fundi të qytetëruar dhe të denjë, ose të tejkalojë mosmarrëveshjet e saj dhe të lundrojë në kohët pasnormale me mendjehollësi, duke i paraprirë të keqes. Mundësia e dytë kërkon që të plotësohen të paktën tre kushte. Së pari, ndërgjegjësimi i njerëzve për rëndësinë e anës krahinore, në një botë vazhdimisht të ndërlikuar, të ndërlikuar dhe çoroditëse që duhet të përmirësohet. Fuqia politike dhe ekonomike po zhvendoset gjithnjë e më shumë drejt një grushti kombesh dhe larg shteteve vetjake (përveç rastit kur je një nga këto shtete superfuqi). Së dyti, BE-ja ka nevojë për një ravijëzim të ri të përshtatshëm për kohët pasnormale, i cili merr parasysh si mirëqenien ekonomike të të gjithë njerëzve të vet, ashtu edhe strukturën e saj qeverisëse – një sistem që i vlerëson njerëzit më shumë sesa fitimin. Së treti, Bashkimi Europian ka nevojë të ngutshme për udhëheqje të re. Në kohët pasnormale parimet morale luajnë një rol shumë të rëndësishëm. Në të vërtetë, ndonjëherë është e vetmja busull që mund të përdorim për të lundruar në kohë të trazuara. Udhëheqja e tanishme, siç është shumë e qartë, është e marrë fund nga ana morale. Për të mbijetuar në të ardhmen, BE-ja ka nevojë për një brez të ri prijësish, të aftë për të lundruar në kohët pasnormale, të përkushtuar ndaj mirëqenies së të gjithë qytetarëve europianë dhe të rrënjës së një ndjenje të vërtetë përkatësie.

Ndoshta kjo që po kërkoj unë, është shumë. Por, kush tha që kapërcimi i mosmarrëveshjeve do të jetë i lehtë?!





## Kinemaja amerikane e kohëve pasnormale

*C. Scott Jordan*

Për ta matur veten në rastet e ndryshimeve rrënjësore, kinemaja amerikane ka përdorur të tjerët, të brendshëm dhe të jashtëm. Klasikët e paraluf-tës, *Këngëtarja e xhazit* (1927) dhe *Ikur bashkë me erën* (1939), përdorën personazhe afrikano-amerikanë. Kinemaja e pas Luftës së Dytë Botërore ishte e yshtur nga hija e komunizmit: *Unë u martova me një komunist* (1949) dhe *Pushtimi i rrëmbyesve të trupit* (1956), janë vetëm disa prej shembujve të shumtë. Shëmbëlltyrat orientaliste u përhapën gjatë viteve 1960 dhe 1970, përpara se “terroristi arab” të shfaqej si një kërcënim i regjur dhe gjithnjë i pranishëm në filma si *Gënjeshtra të vërteta* (1994) dhe *Vendim i zbatueshëm* (1996).<sup>1</sup> Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, ka pasur një ndryshim të lehtë: frika nga *tjetri* ka zëvendësuar tani frikën e kohës që jetojmë: frika nga ndryshimet klimatike (*Bota nënujore* (1995), *Dita e pasnesërme* (2004))<sup>2</sup>; ankthi i rënies ekonomike (*Puna në brendi* (2010), *Wall Street: Leku nuk fle kurrë* (2010), *Shite për ta blerë më lirë* (2015)); ankthi për internetin dhe Wiki Leaks (*Shtresa e pestë* (2013), *Roboti* (2015)); si dhe shqetësimi për përhapjen e automatit, zgjuarsisë artificiale dhe e riprodhimit të njëjtë (*Ish Makineria* (2015), *Ajo* (2013), *Gjindja* (2015), *Bota përëndimore* (2016)). Duke pasur parasysh se filmi dhe televizioni shpesh pasqyrojnë mbrojtjen e shpirtit të kohës, nuk është për t’u

1 Shih Matthew Bernstein dhe Gaylyn Studlar, editors, *Visions of the East: Orientalism on Film* (I.B. Tauris, Londër, 1997); dhe Ziauddin Sardar, *Orientalism* (Open University Press, Buckingham, 1999).

2 E. Ann Kaplan, *Climate Trauma: Foreseeing the Future in Dystopian Film and Fiction* (Rutgers University Press, 2015).



habitur që kjo kulturë e re merret me anë të ndryshme të kohëve pasnormale.

Do të doja të flisja për dy filma që mendoj se pasqyrojnë mosmarrëveshjet, ndërlikimin dhe çoroditjen e Amerikës së kohëve pasnormale: *Shenjëtari amerikan*, nga Clint Eastwood (2014), dhe *Hija e vdekjes*, nga Alejandro González Iñárritu (2015). Me sa duket, këta filma kanë pak ose aspak lidhje me kohët pasnormale. Por ne mund të kërkojmë metafora<sup>3</sup> që mund të mos jenë menjëherë të dukshme, që hedhin dritë kryesisht mbi frikën e brendshme të Amerikës, ankthet e padijes dhe nuhatja e pasigurive. *Shenjëtari Amerikan* është frymëzuar nga libri me të njëjtin titull, i cili tregon historinë e marinsit të ndjerë, Chris Kyle, që u bë i njohur për vrasjen e shumë njerëzve. Kur mendoj për të tjerë amerikanë të tillë, mendja më shkon te Timothy Mc Veigh, apo Charles Manson, megjithatë marinsi është kthyer në një ikonë njerëzore të mirënjohur. Një hero i vërtetë amerikan. Sipas vetë dëshmisë së tij në librin "*Jetëshkrimi i shenjëtarit më vdekjeprurës në historinë e SHBA-së*"<sup>4</sup>, ai është një amerikan i zakonshëm, i lindur në Teksas, i thjeshtë dhe një mik i mirë. Vinte nga një familje e shquar, e ngjashme me atë të filmit televiziv *Kujdesem unë Biver*, ku familja është e vetmja mburojë nga bota e kalbur dhe që ëndërronte të bëhej një kauboj. Jetëshkrimi është 377 faqe me mburrje, pa ndonjë pendesë, dhe një tufë letrash dashurie kushtuar miqve të tij, ushtarë amerikanë të rënë. Filmi ka më shumë ngjyra dhe na jep zhvillimin e një personazhi, krejt ndryshe nga libri, i cili që në fjalitë e para zbulon përbindëshin brenda mendjes së një amerikani. Ai nuk përmirësohet ngaqë dëmi tashmë është shkaktuar, stërvitja ka përfunduar dhe ai është zhveshur nga ana njerëzore. Dikush mund të habitet me largësinë nga e cila është i aftë të qëllojë në shenjë, kur dyshon në aftësinë e tij për të zbuluar vetveten dhe për të kuptuar nëse ka gjëra të tjera në këtë botë. Vullnetarizmi i tij pas mbarimit të detyrës, që i krijon atij përshtypjen e të qenit hero i vërtetë, është vetëm një ngushëllim i vogël dhe shfaqet më shumë si një shpërqendrim ose nevojë për t'u marrë me diçka tjetër, sesa me luftën. Për 'të, lufta dhe vrasja dikur ishin mekanizmi i vetëm për zgjidhjen e halleve. Në mënyrë tragjike, ai përfundon në duart e një të lajthituri tjetër kokëshkretë, pjellë e Amerikës bashkëkohore. Ngjarje zinxhir, njëra pas tjetrës.

Filmi i Clint Eastwood e merr këtë përzierje tragjike amerikane dhe e kthen rrëfenjën e tij në një metaforë të çuditshme për Amerikën e kohëve

3 Trevor Whittock, *Metaphor and Film* (Cambridge University Press, 1990).

4 Chris Kyle, *American Sniper: The Autobiography of the Most Lethal Sniper in U.S. History* (Harper Collins Publishers, New York, 2012).



pasnormale. Pjesa më e madhe e filmit ka ndjesinë tashmë të njohur të njeriut që e ndjen vuajtjen dhe padrejtësinë, pjesë e lëvizjeve luftarake amerikane të pas 11 shtatorit. Filmi hapet me varganin e shumëparë të trupave amerikane, që lëviz nëpër një 'zonë banimi luftarake' të Lindjes së Mesme. Një prapavijë që nuk e zhvlerëson rëndësinë e filmit, ndërsa ngjarja përparon mbase duke i sjellë dikujt ndërmend ndjesinë e lojës së Robert Ludlum, si macja me miun. Shikuesi krijon një përshtypje të qartë të çrregullimeve të shkaktuara nga ankthet e këtyre ngjarjeve tronditëse, si dhe humbjen e pafajësisë së të rinjve, gjatë luftës moderne. Ndërsa filmi shkon më tej, një domethënie më e thellë shfaqet para nesh.

Bradli Kuper luan rolin e Kris Kajëll (Chris Kyle), shenjëtarit tonë. Filmi leshon idenë e trashëgimisë së tij. Të paktën, në fund të fundit, Kris mbetet dikush që mundohet për të mirën e SHBA-së. Një metaforë e asaj që janë shndërruar Shtetet e Bashkuara, që kur janë ngritur në nivelin e superfuqisë botërore, duke e lënë shikuesin ta zgjedhë vetë flurudhën e udhëtimit drejt të ardhmes. Ne takojmë Kajëll-in e ri në një Amerikë të njollosur prej kohësh nga ngjarjet e fundit. Babai e ka shoqëruar gjatë vrasjes së tij të parë, kartëmonedhë një dollarëshe. Fillimi është një ogur i mirë, ndërsa ai e lë mënjanë armën e tij për të shijuar lavdinë, por i ati shpejt e qorton, se ai kurrë nuk duhet ta hedhë armën përdhë. Ne e shohim Krisin të shpëtojë vëllain e tij më të vogël nga një rrugaç, ndërsa i ati na sjell një përfytyrim të qartë të një bote të romantizuar, ku bashkëjetojnë të varfrit, grabitqarët dhe, më pas, një qenie eprore, rojtari. Ai e do Teksasin, i pëlqen armët dhe dëshiron të bëhet lopçar. Më e rëndësishmja, ka ndjenjën klasike amerikane, krejt të veçantë, rreth drejtësisë. Rrugaçërit duhet të mposhten gjithmonë. Babai përdor një zgjedhje tërheqëse fjalësh për mësimin e fëmijëve të tij. Metafora e përdorur i ngjan metaforave të tjera të panumërta boshe rreth ujërve dhe deleve, që bazohen në një botëkuptim themelor të shkëputjes nga vërtetësia, brenda thelbit të mendjes realiste amerikane. Pastaj, Kajëlli thirret në një detyrë më të lartë, e ngjashme me thirrjen e Amerikës për ta mbrojtur botën. Ndërsa nevoja e Amerikës për të qenë mburoja e botës kundër së keqes ndoshta i paraprin *Doktrinës Monro*, një thirrje më hyjnore vijon pas largimit të George W. Bush nga pushteti. Gjatë filmit, Kajëll shikon përmes lajmeve bombardimin e Ambasadës së SHBA-së në Kenia, në 1998, sikur po sheh vëllain e tij të vogël shtrirë përtokë nga një rrugaç. Ky plan i thjeshtë kap në mënyrë të brishtë çastin kur atij i përmbysen bota. Një shoqëri kaq e prirë ndaj idesë se njeriu që duhet ta marrë drejtësinë në duart e veta, befas



kuptoheh nga të huajt vetëm kur lidhet me ‘ta përmes fjalës “amerikan”. Kjo ndjesi jehon edhe më vonë në film, ndërsa Kajëll dhe gruaja e tij shikojnë tmerrin e 11 shtatorit në ekranin e televizorit, një kujtim i paharruar për amerikanët që përjetuan atë ditë të veçantë.

Lajmet e shoqëruara me analiza, nxjerrin në pah frikën çoroditëse dhe një pasiguri të madhe rreth armikut të ri. Ky armik nuk mund të njihet aq lehtë sa armiqtë tanë të mëparshëm. Komunisti, japonezi, gjermani, të gjithë me veçori dalluesi, të lehtë për t’u vizatuar, tani janë mbërthyer nga një hije.

**ARMIKU NUK ËSHTË MË NJERI QË MUND TË SHKATËRROHET PËRMES LENTEVE TË SHUMËFISHTA TË NACIONALIZMIT DHE RACIZMIT. ARMIKU ËSHTË NJË HIJE, POTHUAJSE ÇNJERËZORE.**

Kështu që, Amerikës i duhet të humbasë edhe anën e saj njerëzore. Ne shikojmë Kajëllin duke u stërvitur si marins, gjë e cila pritet ta zhveshë atë nga gjithçka njerëzore, por, në vend të kësaj, kjo stërvitje është një shëmbëlltjërë e udhëzuesit stërvitor *on-line*, d.m.th. vetëstërvitje, një telash që duhet ta durojmë të gjithë për të fituar edhe një orë pune shtesë në javë. Pastaj jeta e përditshme qetësohet.

Në çastin që Kajëll i ka të gjitha, një nuse të përsosur, një fëmijë që presin të lindë, pra ëndrra e realizuar amerikane, mësojmë se gjuajtja e drerëve apo e kartëmonedhave prej letre nuk është përgatitja e duhur për të vrarë njerëz të gjallë. Armiku nuk janë thjesht burra të thirrur ushtarë. Në të vërtetë, armiku është një fuqi e ligë që mund të përfshijë fëmijë dhe gra. Mosmarrëveshjet shtohen, ndërsa detyra e lavdishme për të luftuar kthehet në një dëshirë historikisht kafshërore për vrasje dhe gjakësi, por e sajuar me mirësjellje. Amerika e shikon botën nga maja e një rrafshnalte dhe për të qenë mburoja që i duhet botës, ajo duhet të vendosë përmes syrit të ndërmjetësuesit, se kush jeton dhe kush vdes. Tragjedia fillon teksa ne zbulojmë një fakt të thjeshtë: Kajëll është vërtet i mirë në zanatin e vet.

Përpjekja për të mbrojtur vendin më të madh në tokë e bën atë një legjendë. Amerikanët mezi presin të kenë një simbol, që t’u qëndrojë nga mbrapa, si në filmin *Kapiten Amerika*, por goditja e Hitlerit me grushta hundëve nuk mjafton. Armiku është i vrazhdë, i egër dhe i pamëshirshëm. Lufta për amerikanët nuk është burra kundër burrave, e mira kundër të keqes, është ajo që ka mbetur nga vargjet e shenjta njerëzore, dreqi vetë.



Kështu mund ta përlijim egërsinë tonë. Ata përpiqen të na vrasin, atëherë kur ne nuk e presim, prandaj duhet të jemi gjithmonë gati. Është krijuar besimi se armiku nuk është më njeri. Ashtu si jashtëtokësorët në filmat fantastiko-shkencorë, ata janë thjesht bisha dhe vrasja e tyre nuk është gjë e madhe. Ushtarët e tjerë rreth tij i bëjnë jehonë përjashtimit që gëzojnë amerikanët, racizmit kundër njerëzve të Lindjes së Mesme dhe një etje e pashuar gjaku rrethon çështjet e së mirës dhe së keqes, natyrën e Perëndisë dhe shenjtërinë e jetës. E gjithë kjo është një mjegull zhurme e zbardhëlyer, që rrethon syrin e ftohtë e të gjithëdijshëm të asaj çfarë do të bëhet Kajëll mëpastaj.

Madje, ai përballet me *Tjetrin*, që shfaqet në gjendjen e një shenjëtari armik të padukshëm. Ai është përcaktimi amerikan i terroristit të sotëm. Ai është Al-Kaeda, është ISIS, ai është fatkeqësia e radhës së qytetarëve perëndimorë. Ai vishet krejt me të zeza, është i prerë me një përzierje të lehtë rinore dhe joshje djallëzore. Duke kërcyer nga maja e një çatie në tjetrën, ky shenjëtar armik është një ninxha me një saktësi dhe përpikëri të përkryer, madje mban të lidhur një shirit rreth koke. Ai e fton Kajëllin në fushëbetejë, duke e kthyer veten në boshtin e së keqes, teksa dyluftimi bëhet shëmbëlltë e Luftës kundër Terrorit, a thua se është një ngjarje që ndodh vetëm njëherë në jetë dhe që askush që paguan për kanalet televizive, nuk do të donte ta humbiste.

Vetë emërtesa “hero” hidhet në fushë si një top futbollit që shkelmohet para dhe mbrapa, duke u tjetërsuar para syve të shikuesit. Kris Kajëll është heroi ynë. Ai nuk është thjesht një njeri që kërkon të kapërcejë një sfidë dhe, për pasojë, të lartësohet. Lufta e tij është e shumanshme, e ndërlikuar. Ai përballet me sfidën e tij të brendshme për ruajtjen e mendjes së shëndoshë, përballë shkatërrimit tërësor. Sfidat e ruajtjes së njerëzimit dhe familjes së tij, gjithashtu rëndojnë mbi supet e Kajëll, pasi ai duhet të përjetojë ndryshimet çoroditëse të personazhit, që do ta ngjizin atë gjatë gjithë filmit. Detyra e tij është të vrasë këdo që përpiqet ta vrasë atë ose vëllezërit e tij, përpara se ata të mund ta kryejnë detyrën e tyre. Ne shikojmë një djalë të thjeshtë nga Teksasi, duke u tjetërsuar në një njeri të ndërlikuar, i zënë në vijën që ndan makinerinë vrastare dhe rojtarin super hero. Të gjitha mospërputhjet e shfaqura qartazi në vlerat e tij, e tërheqin drejt një pasigurie të thellë të kohëve pasnormale. Rrjedhimisht, ai kthehet në një hero të vetëveçuar, don kishotesk, të cilin shikuesit vazhdimisht e përplasnin mes përkrahjes dhe shpresës që të dështojë e të kthehet në shtëpi sa më parë, se s’është nevoja të vdesë askush.





Por bota nuk është më aq e thjeshtë. Ne jetojmë në një botë ku ndërlikimi është normë, e përshkruar nga pjesë të pavarura me tepri, që ndërveprojnë me njëra-tjetrën në shumë mënyra. Gjithçka është e lidhur me çdo gjë tjetër, thurje pas thurjeje, që gjallërojnë prapaveprime të vërteta, të cilat i fryjnë gjërat në përpjesëtim gjeometrik, duke u prirë drejt çoroditjes. Si rrjedhim, përfundojmë me shumë qëndrime që janë logjikisht të paqëndrueshme dhe në mospërputhje. Përfundimisht, ajo çfarë ato prodhojnë, janë pasiguri dhe padije. Në kohët pasnormale, nuk mund të shpëtohesh nga *Supermeni* që fluturon më shpejt se plumbi, ose nga i sapozgjedhuri i *Matriks-it*, që pranon se është i dërguar nga i Plotfuqishmi dhe i mund ata që ushtrojnë fuqinë mbi të tjerët. Heroi i kohëve pasnormale thjesht nuk mund ta mposhtë keqbërësin, apo t'ia heqë siguresën një bombe, sepse kohët pasnormale nuk mund të udhëhiqen drejt një zgjidhjeje. Heroi i kohëve pasnormale, mbi të gjitha, është një lundrues. Ky hero nxitet nga ndërlikimi i botës dhe nga vetja jonë e shumëfishtë. Ai është në mëshirën e çoroditjes së plotë dhe i nënshtruar prej mosmarrëveshjeve të panumërta. Heroi i këtyre kohërave përballet me përvetësimin e ideve tona të vjetra, duke i vënë ato në provë dhe duke kërkuar që ne të riedukojmë veten, ose të jemi të dënuar për të rënë në duart e armikut të vërtetë - vetvetes. Ai nuk është një antihero vetvetiu, ndonëse nuk është aspak diçka që mund të shndërrohet lehtësisht në ikonën e njeriut që s'ia përton.

Të parët prej këtyre heronjve, janë pothuajse me siguri të dënuar të përfundojnë në heronj tragjikë, sepse mungesa e përvojës me kohët pasnormale do të kthehet në një sfidë vdekjeprurëse. Nuk e përjashtoj mundësinë që heronjtë e kohëve pasnormale të shfaqen në të gjitha format dhe madhësitë. Disa do të pranojnë ndërlikimin dhe mosmarrëveshjet përreth nesh, disa do të mundohen t'i kapërcejnë ato dhe të tjerë do të vriten prej tyre. Lloji i veçantë që unë hetoj këtu, janë personazhe që përballen me një ndërlikim në rritje, i cili paraqet sfida më të mëdha çoroditëse që, nga ana e tyre, nxjerrin në pah mosmarrëveshje brenda vlerave të tyre themelore. Këto personazhe do të gëlltiten nga pasiguria që i rrethon. Mundësitë e tyre janë të kufizuara në mënyrat se si do të merren me padijen e tyre. Natyrisht, personazhet e mirëfillta amerikane, në thelb, janë të sigurt. Zgjedhja që duhet të bëjnë tani, është nëse do të qëndrojnë kokëfortë ndaj mënyrave të tyre të vjetra, apo do të zgjedhin një përjasje të re ndaj padijes së tyre.

Dhe Kajëll i del ballë për ballë zgjedhjes së tij. Njëra nga skenat na jep Kajëllin mbi një çati të largët, duke ofruar mbështetje për shokët e tij në



tokë. Një burrë i zyrtë, me një granatahedhëse, duket pranë qoshes, shënjestra i tij janë njerëzit e Kajëllit. Ai e vë re dhe e nxjerr jashtë luftimit. Një klasik pa ndonjë mundim të madh, ku heroi ynë mund të keqen. Më pas, shohim një djalë vendas që shikon i tronditur dhe i zhytur në mendime, nga një largësi e shkurtër. Djali afrohet drejt njeriut të vdekur dhe ia merr granatahedhësen. Kajëll e vëren dhe nis të lutet me zë të lartë: - Ule poshtë, të lutem! Metafora e përkryer për Amerikën. Ne vazhdojmë ta ndjekim ngjarjen përmes fushëveprimit të një shenjëtari, ndërsa rrëfenja zhvillohet në djepin çoroditës të një frike dhe rrëmuje vrastare. Kajëll përballë me një vendim të pamundur. Gratë dhe fëmijët duhet të kursehen me çdo kusht. Amerikanët që luftojnë për drejtësi, duhet të shpëtojnë nga lëndimet me çdo kusht. Të gjithë rrugaçërit duhet të vdesin. Pasiguria dhe mospërputhjet shfaqen në një shpërthim kohësh pasnormale, ndërsa rrahjet e zemrës së shikuesve rriten.

Pas ecejakesh të shumëfishta para-mbrapa, midis Kajëllit dhe Mustafës - hijes mbinjerëzore, më në fund, Kajëll e fut Mustafën në shënjestër, goditje mbi një milje larg, goditje gati e pamundur. Kajëll e di se mund ta shtrijë përtokë dhe ta përfundojë luftën e vet. Njeriu që ka vlarë disa amerikane, mund të dalë jashtë luftimit. Drejtësi e çuar në vend. Ushtarë të tjerë i bëjnë thirrje të largohet. Nëse ai qëllon, vendndodhja e tyre zbulohet dhe mund t'i hanë të gjallë. Nëse e vret këtë njeri, Kajëll i jep fund luftës së tij, vret një për të shpëtuar një mijë. Por, duke vlarë këtë njeri, ka dënuar me vdekje të gjithë njerëzit e vet, burrat që është betuar t'i mbrojë përballë vdekjes së sigurt. Një stuhi rëre afrohet. Kajëll qëllon dhe stuhia e rërës përpin ndërtesën ku janë vendosur trupat amerikane. Kajëll vë pushkën anash tij, në tokë, dhe nxjerr një radiotelefon. Ai thërret gruan e vet, nën vorbullën e rërës që qarkullon në të gjitha drejtimet, duke i premtuar se është gati të kthehet në shtëpi. Ai e gjen veten në një ngjarje pasnormale, pothuajse të mirëfilltë, dhe përpjekjet e tij për të zotëruar pikëtakimin e ndërlikimit, çoroditjes dhe mosmarrëveshjeve, e kanë futur atë në një gropë të pakontrollueshme pasigurie. Vetëm një lundrim me zotësi do ta nxjerrë atë përsëri në sipërfaqe. Metodrat dhe mendësia e vjetër nuk do të hyjnë më në punë. Mendja e tij është kthyer në një ide primitive fëmijërore të nevojës për siguri. Njeriu që nuk donte kurrë që udhëtimet e tij të përfundonin, i cili donte të ishte vetëm me vëllezërit e tij, duke vlarë përbindësia, tani s'do gjë tjetër, veçse të kthehet në shtëpi. Një shërim i gjatë mendor e pret Kris Kajëllin, përtej kësaj hallakatjeje. Rrëfenjat e fëmijërisë sonë që na çojnë në vende kaq të tmerrshme, por gjithmonë ia



dalin të kenë një fund të lumtur, në fund të fundit, janë vetëm përralla të trilluara.

Te *Shenjëtarit Amerikan*, s'ka asnjë paralajmërim të teorisë së kohëve pasnormale; është vërtetësia jetësore e kohëve pasnormale që formëson tregimin e filmit. Dhe, sigurisht, ajo nuk jep përgjigje për mënyrën se si do të lundrojmë në kohët pasnormale. Megjithatë, në mënyrë krejt të pavetëdijshme, ai pasqyron mëdyshjet themelore, mosmarrëveshjet e brendshme dhe padijen e thellë të Amerikës në kohët pasnormale. Por dyshoj se metaforat janë shumë të thella për t'i bindur amerikanët e mi të vrasin mendjen mbi gjendjen qesharake në të cilën gjendemi. Ne ende i përmbahemi 'ligjeve amerikane' të Ziauddin Sardar dhe Meryll Win Dejvis, që i vishen mendjes amerikane në kohët e sotme<sup>5</sup>: "Frika është thelbësore", "Lufta është e nevojshme" dhe "Padija është lumturi". Ne jetojmë në një Amerikë ku ka më shumë armë sesa qenie njerëzore (rreth 350 milionë), të shtënat nëpër ndërtesa janë të zakonshme dhe vatrat e luftës janë një përbërës thelbësor i politikës së jashtme. Ne hyjnizojmë burra që janë vërtet të aftë për t'i dhënë fund jetës njerëzore dhe politika jonë drejtohet nga ajo që kemi frikë: ne duam armë, në mënyrë që askush të mos na qëllojë; ne kundërshtojmë ndryshimin, sepse nuk duam që ai të bëhet pjesë e pandashme e jetës sonë; ne mbështesim luftën me të huajt, që t'i vrasim ata, para se ata të na vrasin ne.

**SHPREHJA: AMERIKA - "VENDI MË MADHËSHTOR NË TOKË",  
ËSHTË SHTREMBËRUAR NGA BESIMET E RREME TË PËRHERSHME,  
EPËRSIA E PËRBASHKËT E VLERAVE TË SAJ DHE TË NJË  
PAAFTËSIE PËR T'U PËRSHTATUR NË NJË BOTË QË NDRYSHON ME  
SHPEJTËSI.**

Pavarësisht gabimeve, *Shenjëtarit Amerikan* na shpërfaq një Amerikë me nevojë të madhe për ndreqje dhe arsyetim. Është një pasqyrë e cila zbulon mendësinë tonë të gatshme për të na shtyrë drejt dhunës së përhershme. Racizmi, vendimmarrja e nxituar dhe një përpjekje për t'u fshehur nga besimi te njeriu ballafaqohen me shpresën se ne do t'i japim fund të jetuarit në errësirë. Lufta e vazhdueshme e Amerikës kundër hijeve, e nxitur nga pasiguria e thellë, dhe përkushtimi ndaj botës së panjohur përtej kufijve të saj,

5 Ziauddin Sardar dhe Merryll Wyn Davies, *American Dream, Global Nightmare* (Icon Books, Cambridge, 2004) f. 20-26.



gjithmonë do të sjellë tragjedi për heroin e kohëve pasnormale dhe, siç thotë metafora, për vetë Amerikën.

Kohët pasnormale janë të trazuar dhe të pakëndshme. Një përfytyrim, se si amerikanët mund të pajtohen me kohët pasnormale, jepet në filmin *Hija e vdekjes*, të regjisorit Inárritu. E thënë ashtu siç është, filmi rrëfen për një burrë, Hju Gllas, i cili i mbijeton një sulmi të dhunshëm, duke kërkuar më pas hakmarrje ndaj atyre që i vranë djalin dhe e lanë të vdesë. Ndërsa filmi i fundit i tij, *Njeriu zog* (2014), mori vlerësime nga kritikët. Është vërtet e çuditshme, se përse regjisori meksikan do të zgjidhte një temë të tillë, si atë të Hju Gllas. Ai është një kufitar amerikan i shekullit të XIX-të, i cili mbi-jetoi në mënyrë të bujshme dhe shpëtoi duke u zvarritur, pasi u la të vdiste nga shokët e tij, fill pasi i sulmoi një ari, diku në Dakotën e Jugut të ditëve të sotme. Udhëtimi i tij i mrekullueshëm është një temë popullore e Perëndimit Amerikan, që u përjetësua me të njëjtin titull në romanin e Michael (Majkëll) Punke, të vitit 2002<sup>6</sup>, ku filmi i Inárritu-s përafërsisht mbështetet në këtë roman. Libri i Punks u cilësua si një histori e ashpër klasike hakmarrjeje, një shembull i përkryer i gjinisë letrare *Western*, por që nuk ishte pikërisht në nivelin e një thirrjeje mbarëbotërore dhe të ndërlikuar të Inárritu-s. Përpara se të bënte filmin *Njeriu zog*, mbase shumica e amerikanëve do ta ngatërronin Inárritu-n me Alfonso Cuarón, ose Guillermo Del Toron. Përpara filmit *Njeriu zog*, veprat e tij burojnë nga një botëkuptim ndërkombëtar të trajtuarit të çështjeve të tilla, si besimi dhe krishterimi, ose betejat në lidhje me drejtësinë, nga një këndvështrim latin. *Njeriu zog* përbën një shmangie të thellë; *Hija e vdekjes* është vazhdim i po atij udhëtimi. Ajo çfarë mbetet pas çdo filmi të Inárritu-s, sa i përket shikuesit, është domosdoshmëria për të vranë mendjen. Në këtë periudhë të re të karrierës së Inárritu-s, ne vërejmë një botë në telashe. *Njeriu zog* na ofron një botë të zhytur në ndërlikime, plot me çoroditje, që pasqyron mosmarrëveshjet e veta. Kohët Pasnormale në ekranin e madh të kinemasë. Te *Hija e vdekjes*, Inárritu shpalos përpjekjen e tij për të lundruar përmes kohëve shqetësuese. Mund të jetë vendosur në shekullin e XIX-të, por filmi merret me çështjet e kohëve tona pasnormale.

Për të përcaktuar udhëtimin tonë, filmi fillon në një vend të çuditshëm, në ujë të rrjedhshëm. Uji, duke qenë një element kyç i jetës, është një vend i përshtatshëm për të filluar. Prej tij lartësohen pemët, toka dhe dy njerëz, babë e bir. Një Leonardo Di Caprio pothuajse i panjohur, luan Hugh Glass-in e ashpër, ndërsa Forrest Goodluck në rolin e tij të parë, luan Hok. Mandej ka

6 Michael Punke, *The Revenant: A Novel of Revenge* (Carroll and Graf, New York, 2002).



diçka të tmerrshme në vetvete, armët e tyre. Një dre, brirët me rrema të pafund, pema e jetës e mishëruar në një gjallesë. Kërcet pushka! Tingulli i panatyrshëm nis udhëtimin tonë që do të jetë i mbushur me tinguj natyralë të luftës për jetë. Aty, së pari, shohim një fushim me burra që jetojnë në natyrë, por që ngadalë e tjetërsojnë atë, zjarre që digjen, burra duke u rrotur dhe grumbullimi i lëkurëve të kafshëve. Ecuria e mëngjesit ndërpritet nga të shtënat me armë. John Fitzgerald (Tom Hardy) ia shpreh shqetësimin për zhurmën e panatyrshme eprorit të tij, kapitenit Andrew Henry (Domhnall Gleeson). *Tjetri* ogurzi fshihet rreth e rrotull.

Një tingull i panatyrshëm shënjon lëshimin e shigjetave të panumërta që u paraprijnë trokëllimës së një kopeje hamshorësh. Një kushtrim i pafund dhe i përsëritur për të luftuar është zëri që u prin thirrjeve dhe lutjeve të dhimbshme të këtyre burrave të sulmuar. Kamera fluturon lart në rrotullim e sipër 360°. Shikuesit i shfaqet e gjithë bota përreth, por nuk sheh asgjë. Papritmas, syri i vogël që ofron plani i filmit, nuk mjafton. Shigjetat vijnë nga përpara, prapa dhe matanë. Gjithçka kthehet në marrëzi, ndërsa burrat kërkojnë të përdorin Tokën për t'u fshehur, me sa duket, nga vetë Toka e cila ka nisur këtë sulm të egër kundër tyre. Gllas dhe Hok hidhen në erë para syve tanë, teksa vrapojnë. Qëllimi i burrave është të mbërrijnë deri te varka. Gllasi duhet ta mbrojë Hokun me çdo kusht. Dikur, merret vesh se po sulmojnë indianët vendas dhe vetë Hok është vendas. Kjo botë është shumë e ndërlikuar për një racizëm kaq të thjeshtë. Kapiteni Henri nuk është në gjendje të shpëtojë njerëzit nën urdhrat e tij; ai është i përhumur, zhytur në pasiguri. Niveli i ujit ngrihet, ndërsa ata i afrohen varkës. Kushtrimi i pafund për të luftuar tingëllon edhe më i fortë, shigjetat shpeshohen, frymëmarrja rëndohet dhe mbizotëron kolonën zanore. Këtu është e rëndësishme të theksohet se Gllas e shpëton të birin, ndërsa vetë mbetet prapa tij vazhdimisht.

Rrëfenja në thelb është një udhëzues i të atit rreth kohëve pasnormale. Filmi është i paqartë, për sa i përket faktit nëse Gllas është apo jo i ati biologjik i Hokut. Dikush mund të mendojë se Gllas është thjesht njëfarë kujdestari birësues i Hokut, megjithatë kjo nuk e zbeh përkushtimin e tij për mbarëvajtjen e të birit. Roli i Gllasit si baba është i ndërlikuar deri në kërshëri. Fytyra e Hokut është e frikshme prej djegieve që ka marrë dhe që janë të dukshme gjatë gjithë kohës. Metafora e thjeshtë është se Gllas, ashtu sikurse këndvështrimi i gabuar politik i Amerikës, po e çon botën e mundur të paqytetëruar drejt begatisë. Gllas nuk mund të parashikojë një dritë në fund të tunelit në këtë udhëtim. Ai thjesht përpiqet t'i çojë ata në



një vend të sigurtë, një përforcim aty pranë. Ai detyrohet të bëhet prijësi i këtij grupi burrash të bardhë që shpresojnë vetëm tek ai, për t'i shpëtuar një sulmi tjetër të mundshëm, gjithnjë të pranishëm nga fisi *Arikara*. Hok është *Pawnee*, një fis më paqësor dhe, për fat të keq, një fis që po vdes. Gllas po përpriqet të shpëtojë kulturën e Pawnee, të cilën ai vetë e ka përqa-fuar, pa e vrarë mendjen për detyrimin e të qenit racë e bardhë. Ky qëllim përballet me një mundësi të madhe dështimi, madje edhe me të arritur te përforcimi. Gllas duhet të përqafojë pasigurinë e kohëve pasnormale, duke u përpjekur të mos e teprojë me padijen, sepse padija mund të jetë vdekjeprurëse.

Fitzgerald, gjithashtu, është një lloj babai. Le ta quajmë atë *babai i pa-dijes dhe i prapambetjes së kohëve pasnormale*. Ai e pranon Bridger-in e ri (Will Poulter) si djalin e vet, duke e prishur me shembuj të vjetër që po shkatërrohen ngadalë në fundin e një epoke. Fitzgerald i sheh të gjithë vendasit, qofshin ata *Arikara* apo *Pawnee*, si të egër. Ai e pranon punën jo si një mirësi të njeriut, por si një mjet i thjeshtë fitimi, e vetmja mundësi që njeriu ka për të përdorur pushtetin mbi fatin e tij. Filozofia e tij është secili për vete, vuajtja është krejtësisht e panevojshme dhe gënjeshtër është e përligjur. Të gjitha këto do t'i shemben përballë pasigurisë. Bridger, në përpjekje të dëshpëruara për të lundruar, ngrin gjatë sulmit nga fisi *Arikara*. Ai i ka përqaftuar idetë e Fitzgerald-it dhe i nënshtrohet mëkateve të këtij babai të pavullnetshëm. Bridger, më pas, lidhet me krimet e Fitzgerald-it dhe pikëpamjet e tij për botën. Bridger duhet ta dojë të atin dhe të mos pranojë ndryshimin e madh me të cilin përballet Fitzgerald, që do t'i zhysë të dy në një padije të thellë.

Kapiteni Henri është baba i rremë. Ky është babai që ne kërkojmë të jenë qeveritë tona dhe shoqatat e ndryshme në të cilat besojmë. Tragjedia është se ata janë në mëshirën e ekspertëve dhe mendimit të qytetarëve, të dyja i nënshtrohen fatit të mallkuar të çoroditjes dhe mosmarrëveshjeve të pashmangshme. Henri nuk mund t'i shpëtojë fëmijët apo njerëzit e tij. Besimi i tij në vetvete si udhëheqës dhe përkushtimi ndaj rendit ushtarak nuk mund ta lejojnë atë të zhbëjë çfarë ka ndodhur rishtas. Ai përballet me të njëjtin problem të baballarëve të rremë në jetën e vërtetë. Qeveritë dhe shoqatat përballen me sfidën e vërtetë të pranimit të ndryshimit, ngaqë ndryshimi i pranon gabimet në sistem dhe shpërfaq brishtësinë e mbajtjes së pushtetit të tyre. Shefi i *Arikara* ofron një lloj shembulli të kundërt për kapiten Henrin. Ai është i frymëzuar, për rrjedhojë, i gjithë fisi, për të gjetur vajzën e vet. Ai i qëndron besnik përkatësisë së tij, por i shfrytëzon përparësitë e armëve të të bardhëve. Madje,



ai merr mundimin të mësojë gjuhën e tyre. Mosbindja e tij ndaj padijes ofron një mundësi për të gjithë baballarët e rremë, ndërsa përballen me pasigurinë e së nesërmes.

Ky film është një rrëfenjë e pikëtakimit të këtyre teknikave të ndryshme atërore dhe na jep një provë mjaft tërheqëse të kohëve pasnormale. Këto pikëtakime ngjizen përmes ballafaqimit, më i dukshëm është ai i Gllas me Atin e Thinjur.

Pikëpamja e tim ati për arinjtë ka qenë shumë e ndikuar nga jeta e tij gjatë Luftës së Ftohtë. Ariu ishte lëmshi i fuqisë së padiskutueshme të pyllit që gjithmonë na bënte përshtypje. Mishërimi i sovjetikëve, të kuqëve. E vraftë shqiponja e demokracisë ariun komunist! Gjatë jetës sime, arinjtë janë tjetërsuar nga filmi vizatimor miqësor, në fuqi shkatërrimtare. Jam rritur me arushat *Winnie, Yogi* dhe *Baloo*, që të gjithë lozonjarë, mendjempreh-të dhe përgjithësisht të padëmshëm. Ëndrra e Teodor Rusveltit për ariun miqësor u përmbush. Ata ishin qenie natyrore, diçka që duhej shpëtuar, së bashku me pyjet tropikale dhe kafshët shtëpiake të shfrytëzuara. Pastaj erdhi *Grizzly Man*, filmi i regjisorit Uerne Herzog (2005). Ky dokumentar u nxit nga fryma e shpëtimimit të natyrës dhe e vlerësimit të bukurisë së saj, ndërkohë na dha edhe një mësim të vlefshëm. Natyra është e egër dhe ata që ecin në trevat e saj, janë të detyruar t'i zbatojnë rregullat. Amerika nuk ka luanë apo tigra. Ariu është mbreti i xhunglës amerikane. Pra, pse të mos lejojmë që ai të jetë babai i natyrshëm në filmin e Inárritu-s?

Gllas çan përpara, në kërkim të një shtegu të pasigurte, para njerëzve që ai është zgjedhur t'i udhëheqë. Fryma e tij është e pashtuar, ajo e një bishe natyrore, gjithnjë në vrojtim. Pastaj dëgjojmë një zhurmë të çuditshme, e ndjekur nga afër nga një shpupuritje gjethesh. Dy këlyshë të rinj ariu po luajnë. Gllas ngrin. Ai di diçka që është larg të qenit e sigurtë dhe shikuesi gjithashtu e di se çfarë do të ndodhë më pas. Sepse, kur fëmijët luajnë, prindi nuk është kurrë larg. Kur merr parasysh madhësinë e pushkës së Gllas-it, beson se do të jetë e vështirë për 'të, që të mos shihet si një kërcënim. Përsëri kamera rrotullohet në një lëvizje 360 gradë. Ne shqejmë sytë në mënyrë të dëshpëruar për të gjitha të dhënat e përvojës jetësore. Ku është? Mandej dëgjojmë një vikamë të mprehtë, por të zhurmshme. Gllas-it i ngrin gjaku. Ne nuk jemi zotërit e botës, siç mendonim dikur. Pastaj pemët nxitojnë t'ia hapin rrugën ariut, teksa afrohet. Sapo ariu vëren Gllas-in, fillon kundërpërgjigja për t'u mbrojtur. Sulmi është dy faza grahmash, përpjekjesh dhe shkatërrimit të trupit. Fjalë për fjalë, duket se është përplasja klasike e njeriut me natyrën. Por ky film nuk ka të bëjë me



përballjen e njeriut me natyrën. Beteja ka gjithmonë një qëllim, çfarë fituam? As njeriu dhe as natyra nuk përfitojnë nga kjo betejë. Përkundrazi, ky është një film që vështron mosmarrëveshjet e njeriut brenda vetvetes. Ndërsa njeriu e prish natyrën, ajo bëhet e çuditshme dhe sajton mënyra për ta shkatërruar njeriun. Natyra mban vendin e vet në prapavijë, megjithatë mbetet një fuqi gjallëruese, një lloj fuqie morale. Natyra është e pandryshuar, sepse është në rrjedhë të vazhdueshme.

Tragjedia e këtij filmi është se përplasja ndodh mes baballarëve. Ashtu si një piknik babë e bir, fituesi i këtij konkursi nuk varet nga ai që dashuron më shumë, apo nga ai që ka zotësinë më të lindur atërore, ose ndonjë ndjenjë tjetër të lidhjes së ngushtë prindërore. Është kryesisht punë pasigurie dhe padije. Gllas, Fitzgerald, Henry, Kryeplaku i Arikara-s, as ariu nuk janë heronj në këto bëma, gjithashtu, nuk janë as anti-heronj të njëri-tjetrit. Përlëshja mes tyre është e panevojshme dhe krejtësisht e rastësishme. Këta personazhe kanë një pikëtakimi vetëm për shkak të padijes që të gjithë mbartin në përqasjen e tyre ndaj të ardhmes së pasigurt. Nëse vajza e Kryeplakut të Arikara-s nuk do të ishte rrëmbyer, sulmet e tyre nuk do të kishin qenë kaq të egra. Nëse Fitzgeraldi nuk do të ishte viktimitë (ose ndoshta i mbijetuar) i një përpjekjeje për t'ia prerë kokën, padija e tij nuk do të ishte kaq e shfrenuar. Këto veprime madhore të nxitura nga padija e shtynjë përpara rrëfenjën. Në të vërtetë, ato janë shtysa thelbësore e tregimit. Në kohët pasnormale, heronjtë (ose për Afrimi më i ngjashëm me 'ta) nuk janë personazhe të sfiduar për të kapërcyer një përballje që vë në provë qenien e tyre. Përkundrazi, këto personazhe përballen me një shkatërrim të sigurt, një fuqi ndaj të cilës ne jemi kundërshtarë. Në filmin *Hija e vdekjes*, kjo përmblihet në mendësinë e fladit.

Një vegim i gruas së vet, i flet Gllas-it gjatë një ëndrre. Ajo i thotë: 'Kur ka stuhi dhe qëndron përballë një peme, nëse shikon degët e saj, bën njëmi-jë be se do të bjerë. Por, nëse shikon trungun, do të vëresh qëndrueshmërinë e saj'. Era dhe frymëmarrja janë fuqi të padukshme, që mesa duket kanë mendjen e vet. Ato janë vazhdimësia e vetë kohës gjatë kohëve pasnormale. Ndërsa ndihmojnë në përzierjen e mrekullueshme të kolonës zanore të filmit, gjithashtu na lënë të kuptojmë vërtetësinë e lojës së aktorëve në film.

**FRYMIMI SHPESH KA QENË E RËNDËSISHME PËR SHKENCËN  
FETARE. PËR SHEMBULL, JAHU - FJALA HEBRAIKE PËR ZOTIN,  
ËSHTË GJITHASHTU PËRAFRIMI FONETIK I NJË FRYME. SUFISTËT**





THONË 'HUA, HUA' – FRYMA, QË SHQIPTOHET 'AI ËSHTË AI'. ZOTI I DHA JETË ADAMIT PËRMES FRYMËS. NË KËNDIMET E JUDAIZMIT DHE KRISHTERIMIT, SI DHE ATO *ZIKR* (KUJTIMI I ZOTIT) NË ISLAM, ZOTI LËVDOHET PËRMES SHQIPTIMEVE ÇUDIBËRËSE. NË KËTË FILM, ASHTU SI NË JETËN E PËRDITSHME, LUHET PËR JETË A VDEKJE. KJO THËNIE ËSHTË NJË FUQI, PËRBALLË ERËS SË TOKËS, NJË QËNDRESË. PADIJA, NGA ANA TJETËR, ËSHTË NJË FRYMË E KALBUR, NJË FUQI QË E ZHYT TË DËRGUARIN NË PASIGURI TË THELLË DHE ASGJËSIM, TË MUNDSHME NË KOHËT PASNORMALE.

Filmi i kushton vëmendje hakmarrjes. Hakmarrja kërkohet gjithandej. Ajo përftohet nga këndvështrime të caktuara. Por kjo nuk është një rrëfenjë hakmarrjeje. Përkundrazi, ky është zbërthimi i përfytyrimit të hakmarrjes. Hakmarrja nënkupton drejtësi dhe moral. Në bëma të tjera, hakmarrja përqeshet si një fitore e zbrazët, ndërsa këtu hakmarrja vërehet me një shikim më të lartësuar. Personazhe të ndryshme, hakmarrjen e lënë të kuptohet si diçka që i përket Zotit dhe vetëm Zotit. Ky nënkuptim nxjerr në dritë thënien e Gandit për pasojat verbuese të drejtësisë hak për hak. Në fund të fundit, është vetëm një baraspeshim i hyrjeve dhe daljeve, jo mes njerëzve, por për Tokën në përgjithësi. Era kundrejt frymës.

Në njërën prej pamjeve përmbyllëse të filmit, uji i rrjedhshëm gurgullon përmes një treve, diku pranë Arktikut, teksa një pellg gjaku përzihet me shtratin e lumit. Një pamje e zymtë që të ndjek përherë, se era, uji dhe bora rishtas mund ta kthejnë atë në bukurinë që ishte në fillim të filmit. Këto janë rreziqet e kohëve pasnormale. Idetë e vjetra kanë gjithnjë e më pak kuptim në jetën e përditshme. Shembujt e kështjellave prej rëre të ndërtuara për t'u mbrojtur nga era e plotfuqishme po zbulojnë fytyrën e tyre të vërtetë. Duhet të mendojmë më thellë, sa herë që marrim frymë. Asnjë rrotullim i kamerës prej 360 gradë nuk mund të zbulojë të gjithë të vërtetën. E vërteta nuk është thjesht përvojë jetësore, por kërkon një mendim të një shkalle më të lartë. Frymëmarrjet e paditura do të mposhten nga era e natyrës.

Si do të marrë frymë Amerika në kohët pasnormale?



## Qeverisja në kohët pasnormale

Jordi Serra

Qoftë dhe një vështrim i rastësishëm i ngjarjeve të fundit botërore, zbulon se si politika dhe qeverisja po shkojnë me shpejtësi drejt kohëve pasnormale. Por, përpara se të shqyrtojmë se si po ndryshon qeverisja, le të themi disa fjalë për secilën prej tyre. Përzgjedhja e emërtesës është mjaft e rëndësishme këtu. “Pasnormale” lidh dy ide përkatëse: tregon se ajo që po përjetojmë, nuk është normale, ose, të paktën, ajo që mund të presim si normale. Besëlidhjet sipas të cilave ne kemi jetuar gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, po bëhen gjithnjë e më të parëndësishme. Por emërtesa gjithashtu nënkupton se ajo që po përjetojmë, nuk është saktësisht pasnormale. Përkundrazi, ajo që po ndodh, është se ne po kapërcejmë kuptimin e zakonshëm të normalitetit dhe po hyjmë në një trevë të pahulumtuar, në atë të zotërimeve ‘pasnormale’. Por, në çfarë kuptimi po e tejkalojmë normalitetin? Përgjigjja e shkurtër do të ishte në kuptimin modern-industrial. Moderniteti u shfaq si përgjigje për një lloj të ri pushteti që kishte nevojë për një burim të ri të përligjur, që do të shpërbente nga traditat dhe ngrehinat mesjetare. Prandaj, moderniteti përjetoj shfaqjen e një udhëheqësi të ri, *Princi* i Makiavelit, i cili sundoi shtetin sipas një ideje të re, ose i përcaktuar më qartë, “shteti-komb”. Shkenca shërbeu si një mjet i dobishëm për të shkëputur besnikërinë e mbetur ndaj sistemit të vjetër feudal dhe për të siguruar themele të reja për ngrehinën e re. Shkenca dhe politika (pushtuese) u bashkuan për të lindur Revolucionin Industrial, me një theks të veçantë mbi modernitetin, që u bë kushti kryesor për rregullimin e jetës sonë. Moderniteti, botëkuptimi industrial dhe shkenca kishin një marrëdhënie të ndërsjellë, pasi të tre përkrahnin rritjen e nivelit, duke



nxitur një lloj mesatareje të dhënash si nënkuptim për normalitetin. Asokohe kishte rregulla të përcaktuara që zbatoheshin për të gjithë, u shërbenin të gjithëve dhe që zgjidhën të gjitha hallet tona. Nga pikëpamja tradicionale, këto parime shiheshin si 'mbarëbotërore' dhe qytetërimi perëndimor, me tiparet e tij dalluese të "demokracisë" dhe "të drejtave të njeriut", ishte paraparë si e ardhmja e të gjitha kulturave dhe shoqërive.

Por këto kapardisje të një bote gjoja të njëtrajtshme, me kulturën perëndimore – si i vetmi burim pushteti, të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara dhe Europa – nuk janë më të vlefshme në një botë disa drejtimëshe dhe shumë kulturash. Moderniteti është një pikë vlimi dhe pasardhësi i tij, pasmodernizmi, thjesht qëlloj të ishte një "imperializëm i ri i kulturës perëndimore".<sup>1</sup> Edhe shkenca mbi të cilën ai bazohet, na del se nuk është aq e vërtetë dhe asnjansë, sa na pëlqente të mendonim. Ajo që Fanteviç dhe Ravetz morën si të mirëqenë në punën e tyre kryesore<sup>2</sup> mbi shkencën pasnormale, është se ne duhet të shkojmë përtej theksit normal të shkencës që përqendrohet te përfundimi ose prodhimi, për të përfshirë qasjet, qëllimet dhe njerëzit në zbrërthimet tona. Domethënë, vlera e kërkimit shkencor nuk mund të mbështetet vetëm në përfundimet e tij, por edhe në zgjedhjen e mënyrës, qëllimit të ndjekur, politikës dhe botëkuptimit të njerëzve në krye. Me fjalë të tjera, shkenca pushon së qeni e padyshimtë dhe bëhet e varur nga rrethanat, ashtu si shumica e përpjekjeve njerëzore.

Ajo që vlen për shkencën, vlen edhe për qeverisjen dhe shoqërinë. Mjetet tradicionale të qeverisjes janë duke u vjetruar në mënyrë të rrezikshme. Shoqëria është në një gjendje çoroditjeje të përgjithshme. Për pasojë, shumica e njerëzve kanë humbur çdo kërshëri për politikën. Dallimet midis partive Republikane dhe Demokratike në Shtetet e Bashkuara, për shembull, tani janë bërë një humnerë që duket e pamundur të kapërcehet. Dallimet brenda një partie të vetme janë po aq të thella: Partia Konservatore në Britani është e ndarë mes përçarjeve pro dhe kundër europiane; Republikanët zhvlerësuan përfaqësuesin e tyre për president, Donald Trump, në zgjedhjet e përgjithshme të 2016-ës. Në të vërtetë, vetë fakti që një tregtar miliarder me mendime dhe qëndrime të padurueshme, i cili është pothuajse përgjithësisht i urryer brenda Partisë Republikane, mund të synojë të bëhet kryetar shteti, tregon se ka diçka thellësisht të gabuar me sistemin politik amerikan. Është një sistem që shpesh çon në ngërç, me hije dyshimi të çuditshme, siç ishte mbyllja e pashembullt e

1 Ziauddin Sardar, *Postmodernism and the Other*, Pluto, Londër, 1998.

2 Silvio O. Funtowicz dhe Jerome R. Ravetz, "Science for the post-normal age," *Futures* 25 7 (1993): f. 739.



Qeverisë Federale të SHBA-së, në tetor 2013. Siç pohon republikani amerikan i palëkundur, F. J. O'Rourke, për emisionin e BBC-së, *News night*: “Trump shpalos zhgënjimin me shtetin modern. Ky zhgënjim e ka treguar veten me të gjitha llojet e shpërthimeve populiste në mbarë botën. Një dukuri e tillë si Trump, është një përkthim mjaft komik i këtij zhgënjimi. Marine Le Pen është më pak komike. Dhe, nëse vërtet iu pëlqen tragjikja, keni Putinin. Edhe Putini është populist. Po ashtu, edhe dalja e Britanisë nga BE-ja. Po kështu është edhe hedhja poshtë e marrëveshjes së paqes nga kolumbianët”. Mundësia më e mirë për Amerikën është përfaqësuesja e Partisë Demokratike, Hilary Clinton, e cila është ‘gabim në çdo gjë’, por ‘gabim brenda përmasave të pranuar të gabimit’.<sup>3</sup> Mirëpo çështja është se “përcaktorët e normales” po avullojnë me shpejtësi.

**NDJESIA E ÇASTIT ËSHTË NJË PËRZIERJE MIDIS PASIGURISË DHE ANKTHIT, TË NGACMUAR NGA PAAFTËSIA JONË PËR TË KUPTUAR ÇFARË PO NDODH.**

Njerëzit duan të kapen pas çfarëdolloj gjëje të vogël që kanë, e cila u jep siguri: malli për të kaluarën e lavdishme, kombëtarizma e zhveshur dhe mbrojtja e tregtisë së brendshme përmes taksave. Ndërsa ndryshimi i përsheptuar rrit ndjenjën e pasigurisë, padija del në pah. E vërteta dhe faktet humbasin vlerën e tyre. Parullat boshe, të tilla si ajo e Trumpit: “Ta bëjmë Amerikën madhështore sërish!”, ose e Brexit: “Duam të na kthehet vendi ynë!”, nxisin ndjenjat dhe zemërimin. Media tradicionale dhe digjitale nxit tërbimin. Nuk ka dyshim, që është krijuar një sistem hyrje-dalje me prapaveprim. Populizmi është rrjedhojë e natyrshme e kohëve pasnormale. Zhvillimet politike shfaqen dhe shumohen me një ritëm të tillë, saqë mezi i përballojmë. Ne vazhdimisht e gjejmë veten në një gjendje të turbullt çoroditëse dhe që nuk përputhet.

Le të marrim, për shembull, rastin e Ukrainës. E gjitha filloi me tubimet kundër qeverisë në Kiev. Qeveria e Presidentit Viktor Janukoviç ishte me të vërtetë e kalbur, por ajo u zgjodh në mënyrë demokratike. Mëkati i tij kryesor, megjithatë, nuk ishte se ai ishte i blerë, por se dëshironte të përfronte lidhjet e Ukrainës me Rusinë. Nga këndvështrimi perëndimor, ai duhej ta anëtarësonte vendin në NATO dhe jo të për afrohej me Rusinë.

3 BBC, Newsnight, 10 Tetor 2016.



Pa humbur kohë, tubuesit e armatosur në Kiev pushtuan ndërtesat qeveritare dhe kërkuan ndryshimin e qeverisë dhe Kushtetutës. Politikanët nga SHBA-ja dhe Europa qëndruan krah për krah me tubuesit, duke përfshirë edhe udhëheqësit e partisë së skajit të djathtë, Svoboda, për të shfaqur mbështetjen e tyre. Kur kuvendi votoi për rrëzimin e Presidentit, rendi politik në Ukrainë u përmbys brenda një dite të vetme. Presidenti Janukoviç shkoi në Rusi dhe ish-kryeministrja po aq e blerë, Yulia Tymoshenko, u nxor nga burgu për t'iu drejtuar tubuesve.

Pak më shumë se dhjetë vjet më parë, kjo ndoshta do të kishte qenë fundi i çështjes. Fuqitë perëndimore do të kishin krijuar një qeveri sipas zgjedhjes së tyre në Ukrainë, ashtu siç kishin bërë gjatë shekullit të XX-të, në shumë vende të tjera, që nga Irani, ku SHBA-ja përmbysi demokracinë për të vendosur Shahun, më 1963, deri në Kili, ku qeveria marksiste e zgjedhur në mënyrë demokratike, u rrëzua në vitin 1973. Por, në një botë shumë drejtimëshe pasnormale, gjërat nuk janë aq të drejtpërdrejta si dikur. Pranimi i përgjithësuar i ndarjes tradicionale të pushtetit dhe renditja e nevojave nuk janë të vlefshme. Një Rusi e rilindur tregoi muskujt e saj dhe lëvizti me shpejtësi, duke pushtuar Krimenë. Shpejtësia me të cilën u mor Krimea, ishte po aq befasuese, sa shpejtësia me të cilën u rrëzua qeveria në Kiev. Përveç lëshimit të kërcënimeve për dënime dhe zbatimit të disa prej tyre, fuqitë perëndimore u dukën të pafuqishme. Jo sepse, siç mendohet gjerësisht, vullneti nuk është aty, por sepse mjetet kanë avulluar. E vërteta se pushteti, pa dyshim, ka ndryshuar, është i vështirë për t'u kuptuar e jo më për t'u përballur me 'të.

Pra, vini re ndërlikimin dhe mosmarrëveshjet me të cilat ndeshemi në punët e Ukrainës. Nuk janë vetëm qëllimet e dy fuqive që rrezikohen. Ukraina ka 120 pakica të ndryshme, secila me kërkesat e veta të arsyeshme dhe të paarsyeshme. Ka synime demokratike të bashkësive të mëdha, si ukrainasit, ukrainasit rusë, rusët e Ukrainës Lindore dhe tartarët myslimanë në Krime, të cilët kanë arsye historike për të urreyer Rusinë. Qëllimet jodemokratike të nacionalistëve dhe grupeve të së djathtës së tejskajshme në të dy krahët, ukrainase dhe ruse. Pafuqia e qeverisë së Kievit, e mbështetur nga Perëndimi; militantizmi i bashkësive nostalgjike pro-ruse në Lindjen e industrializuar; lufta civile; rreziku i një lufte botërore që duhet të na shqetësojë të gjithëve. Mosmarrëveshjet qenë po aq të dukshme. Qëllimet perëndimore ishin parësore, ndërsa qëllimet ruse ishin të parëndësishme. Presidenti i Ukrainës, i zgjedhur në mënyrë demokratike, u zëvendësua nga një pushtim tërësisht antikushtetues dhe



jodemokratik. Kërkesat demokratike të turmës në Kiev u panë si të përli-gjura, por kërkesat demokratike të turmës në Krime, të cilat u hodhën në votë, u konsideruan “të paligjshme”. Fashistët tanë që janë pjesë përbërëse e qeverisë së re në Kiev, ku zotërojnë një varg ministrish, janë dashami-rës. Fashistët matanë, janë kafshë raciste. Këto lloj shprehjesh dhe politi-kat e bazuara në to, janë tashmë të vjetruara deri në rrezikim.

**NËSE PËRPIQESH T'I BËSH GROPËN DIKUJT NË BOTËN  
PASNORMALE, DO BIESH BRENDA GROPËS, BASHKË ME ATË  
TJETRIN.**

Kjo sqarohet fare mirë në rastin e Egjiptit, ku një tjetër qeveri e zgjedhur në mënyrë demokratike u rrëzua nga tubimet e mbështetura nga ushtria. Qeveria e Presidentit Muhamed Morsi nuk ishte e blerë, por në themel të Kushtetutës egjiptiane që ai parashtroi, vuri Sheriatin (ligjin tradicional islamik) dhe e shpalli Egjiptin si një shtet sunit, duke krijuar përshtypjen, se po u jepte përparësi myslimanëve sunitë. Tubimet fillestare kundër qe-verisë Mubarak nisën përmes Facebook-ut dhe u përshkallëzuan me shpejtësi në një dukuri çoroditëse, që çoi në përmbysjen e qeverisë. Tubi-met kundër qeverisë së Morsit ndoqën të njëjtin shteg. I njëjti grup tubu-esish tani kërkonte një qeveri laike dhe përdori të njëjtat mjete për të rrëzuar një qeveri të zgjedhur në mënyrë demokratike, me mbështetjen e plotë të ushtrisë. Ndoshta shumë laikë të përfshirë në demonstratat anti-Morsi donin një demokraci të vërtetë, një pranim të larmisë dhe liri të vërtetë të mendimit dhe veprimit. Por ajo që ata morën, në të vërtetë, ishte diçka krejtësisht e ndryshme. Mirëpo, lëvdatat që kthehen me shpej-tësi në një rrëmujë, mund të çojnë ose në shembje, ose në tjetërsim tërësor. Tubimet anti-Morsi çuan në shembje. Ushtria e gjithëfuqishme egjiptiane përfitoi nga rrëmuja dhe laikët syleshë ndoqën lojën e saj. Përfundimi: një qeveri e përliqur, e zgjedhur në mënyrë demokratike, ndonëse me pu-shtet të pakufizuar, u zëvendësua nga sundimi ushtarak. Pra, një ‘grusht shteti’ nuk ishte një grusht shteti. Një pjesë e mirë e popullsisë, për shkak të mbështetjes së tyre ndaj Vëllazërisë Myslimane, tani shihej si ‘terrori-ste’. Filluan të zbatoheshin gjerësisht dënimet me vdekje. Askush në Perëndim nuk u ngrit kundër zbatimit të tyre; nuk u mbajtën tubime në mbështetje të të rënëve gjatë grushtit të shteti që nuk ishte grusht shteti.



Në vend që ta shtynin Egjiptin drejt demokracisë, laikët ia dolën ta kthenin atë në një shtet policor të tmerrshëm, gjithnjë në prag të luftës civile.

Le të marrim parasysh gjendjen pasnormale të vendit tim, Spanjës. Pas një periudhe të artë në tregtinë e pasurive të paluajtshme, e cila e ktheu Spanjën në një lloj “mrekullie ekonomike”, shpërthimi i mëvonshëm i shit-blerjes së banesave shpuri në rrënim ekonomik. Megjithëse Spanja nuk u shpëtua zyrtarisht si Greqia, Portugalia apo Irlanda, asaj iu desh të kërkonte ndihmë nga Bashkimi Europian për të pastruar sistemin e saj bankar. Dhe, siç pritej, në këmbim, BE-së iu dha një shkallë e lartë zotërimi mbi ekonominë spanjolle. Për të respektuar udhëzimet europiane, Spanjës i është dashur të durojë shkurtime të rënda buxhetore dhe disa përmirësime strukturore që, në thelb, kanë çuar në një rënie të vullshme të mirëqenies. Në përgjithësi, niveli i papunësisë në Spanjë u rrit mbi 20% (dhe arriti kulmin me 27.2%, në tremujorin e parë të vitit 2013), duke prodhuar jo më pak se pesë milionë njerëz të papunë gjatë kësaj periudhe, përfshirë një grup të madh qytetarësh të moshuar, të cilët – me shumë mundësi – nuk do të gjejnë më kurrë një punë dhe do të përballen me pensione të pakta të parakohshme. Për ta përkeqësuar rrethanën, borxhi qeveritar spanjoll që, më në fund, e tejkaloi PBB-në e vendit, në qershor 2016<sup>4</sup>, po e detyron qeverinë spanjolle t’ia kushtojë një pjesë të madhe të buxhetit kombëtar pagesës së normave të interesit të borxhit. Kjo është një shumë më e madhe se ajo që i kushtohet papunësisë dhe duket se do të mbetet e tillë për një kohë të gjatë. Rrethanat politike janë po aq të zymta, sa edhe pamja e përgjithshme e ekonomisë. Për disa vite radhazi, politika spanjolle ka hasur pengesa, derisa ndaloi, falë një ngërçi katër drejtimësh. Zgjedhjet në dhjetor 2015, që u mbajtën për të zgjidhur ngërçin, vetëm sa sollën në sipërfaqe ndërlikimet e krijimit të një qeverie të dobishme. Dallimet në qëndrime të katër partive kryesore kombëtare – Partia Popullore Konservatore, Partia e Moderuar e Punëtorëve Socialistë Spanjollë, *Ciudadanos* liberale dhe *Podemos* përparimtare – janë të ngulitura shumë thellë për t’u zgjidhur. Si e tillë, krijimi i një qeverie përbashkimi ndërmjet këtyre partive është një detyrë e mundimshme. Ngërçi e mbajti Spanjën të topitur për muaj të tërë. Është zgjidhur pjesërisht me një përbashkim të brishtë, por është vetëm çështje kohe, para se të shpërbëhet sërish.

Kjo zgjidhje e ka rikthyer Spanjën në rrethanën *status quo*, me një qeveri të përkohshme, të udhëhequr nga një kryeministër në detyrë - konservatori Mariano Rajoy. Mirëpo qeveria në detyrë e Rajoy-t është po aq e

4 Sarah White dhe Carlos Ruano, “Spanish public debt jumps above 100 percent of gdp in Qershor,” *Reuters*, Gusht 17, 2016, shikuar Tetor 3, 2016, [www.reuters.com/article/spain-economy-debt-idusl8N1AY1QN](http://www.reuters.com/article/spain-economy-debt-idusl8N1AY1QN)



përfolur dhe e blerë, sa ç'janë ato të vjetrat dhe të rejat në Ukrainë. Në sytë e shumicës së popullatës ajo është po aq e vetinteresuar dhe e interesuar vetëm për të përfituar në kurriz të shoqërisë, sa ç'janë pushtetarët sundimtarë kudo gjetkë. Qeveria konservatore e Rajoy-t fitoi zgjedhjet e vitit 2010, me premtimin se do të kapërcente ngërçin dhe do ta kthente vendin në rrugën e rritjes ekonomike. Por, pas katër viteve në qeverisje, e vërteta doli në shesh: menaxhimi i një ekonomie kombëtare në kohët pasnormale është një çështje e ndërlikuar. Në të vërtetë, qeveria konservatore përfundoi duke bërë pikërisht të kundërtën e asaj që tha se do të bënte. Jo vetëm që nuk i ulën, por i rritën taksat; jo vetëm që nuk e ulën papunësinë, por e panë me sytë e tyre të rritej ndjeshëm. Por ekonomia nuk ishte sfida e saj kryesore. Sfida kryesore vjen nga Katalonja. Për arsye të ndryshme, duke filluar nga çështjet ekonomike, deri tek ato kulturore dhe te veçoria kombëtare, Katalonja dëshiron të shkëputet nga Spanja dhe të bëhet një shtet i pavarur. Siç edhe kanë treguar vazhdimisht votimet, lëvizja për pavarësi ka mbështetje masive nga shoqëria katalanase. Vërtet, nuk është koha më e përshtatshme për të qeverisur Spanjën.

Pra, çfarë ka bërë qeveria konservatore spanjolle, e tanishme dhe e mëparshme, për ta zgjidhur këto çështje? Ajo ka zgjedhur t'i kthejë shpinën të ardhmes dhe t'i kthehet historisë. Së pari, ajo ndikoi në rritjen e nivelit të besueshmërisë të Kisha Katolike, pa asnjë ndryshim nga Kushtetuta e ish-Presidentit Morsi, lidhur me disa çështje shoqërore. Ligji i dështimit të fëmijës u përmirësua për t'u përshtatur me qëndrimin e Kishës (diçka për të cilën nuk duhet të habitemi, pasi Ministri i Drejtësisë në atë kohë, ishte anëtar i *Opus Dei*). Feja katolike u rivendos si lëndë e detyrueshme në programet shkollore. Në këmbim, krerët katolikë do të mbanin qëndrime kundër Lëvizjes Katalanase për Pavarësi, duke e emërtuar atë si "të pamoralshme". Pra, kërkimi i pavarësisë bëhet edhe çështje fetare, edhe morale. Por veprimi më i çuditshëm ishte dhurimi i Medaljes së Artë të zotësisë policore, *Virgjëreshës Maria*, nga ministri i Brendshëm. Për të qenë më të saktë, ajo i është dhënë Maries së Virgjër të Dashurisë shumë të Shenjtë (*Virgen María del Santísimo Amor*), sepse 'ajo mbart vlerat e përkushtimit, përbashkimit dhe vetëflijimit që policia spanjolle mbështet' – dhe është e qartë se *Virgjëresha* shoqëron rregullisht patrullën e policisë. Ky vendim u kundërshtua në gjykatë nga disa shoqata laike<sup>5</sup>, megjithatë, kjo nuk e pengoi ministrin që t'i jepte një medalje të dytë një virgjëreshe tjetër, Virgjëreshës shumë të

5 Ashifa Kassam, "Spanish government to face court after policing award given to the Virgin Mary," *The Guardian*, Prill 29, 2014, shikuar Tetor 3, 2016, [www.theguardian.com/world/2014/apr/29/spanish-govt-court-after-award-giventovirgin-mary](http://www.theguardian.com/world/2014/apr/29/spanish-govt-court-after-award-giventovirgin-mary)





Shenjtë të Dhimbjeve (*Santísima Virgen de los Dolores*), ndërsa padia e parë për medaljen ishte ende në gjyq.<sup>6</sup> Më vonë, u duk se e gjithë kjo ishte pjesë e një skeme më të madhe për të marrë ndihmën hyjnore, ngaqë, mesa dukej, Shën Tereza po bënte 'ndërmjetësime të rëndësishme në Spanjë në këto kohë të vështira'.<sup>7</sup> Pra, përballë një rrethane ekonomike dhe politike tejet të ndërlikuar dhe me plot mosmarrëveshje, ku politikat e zbatueshme janë të vështira thjesht për t'u kuptuar, pa përmendur vështirësitë e përcaktimit të tyre, qeveria i është drejtuar për ndihmë shenjtorëve dhe besimit fetar.

Së dyti, ajo cungoi, ose thjesht shfuqizoi shumë të drejta demokratike. E drejta për t'u tubuar, për shembull, është kufizuar nga i ashtuquajtimi "Ligji i Gag". Strategjia është që disa veprime publike, si tubimet dhe parakalimet në rrugë, të cilësohen si shkelje administrative. Pra, ato nxirren jashtë ligjërimit të gjykatave dhe vendosen në duart e burokratëve dhe administratorëve. Kështu që disa të drejta ligjore, si *habeas corpus*, ose prania e detyrueshme e një avokati, janë fshirë. E gjithë kjo, e bën më të lehtë fajësimin e nismëtarëve ose mbështetësve të tubimeve qytetare. Kjo lëvizje shkaktoi një tjetër padi kundër qeverisë spanjolle, këtë herë në Gjykatën Europiane të Drejtave të Njeriut.<sup>8</sup>

Së treti, ajo u rreshtua me kapitalistët e lirë. Shembulli më i prekshëm është kundërshtimi i saj për të përmirësuar rregulloren e hipotekës. Aktualisht, hipotekat spanjolle nuk janë realisht hipoteka; janë kredi personale me garanci reale (nënkupton strehim). Ndryshe nga vendet e tjera, ku mungesa e pagesës nënkupton humbjen e pronës dhe përfundimin e kredisë, në Spanjë humbja e pronës sjell fundin e kredisë, vetëm nëse vlera e shitjes mbulon shumën e plotë të kredisë, përndryshe, ish-pronarët ende janë të detyruar të paguajnë pjesën e mbetur të parave të marra hua. Ndërsa vlerat e pronave kanë rënë në mënyrë të ndjeshme, shumë njerëz kanë humbur shtëpitë e tyre. Deri në vitin 2015, u vlerësua se, që nga fillimi i ngërçit, më shumë se 100.000 familje janë dëbuar nga shtëpitë e tyre. Tragjedia e vërtetë është se shumica e këtyre njerëzve janë të papunë dhe ende u detyrohen shumë para bankave. Janë të njëjtat banka që kanë

6 Óscar López, "Fernández Díaz entrega una medalla a otra virgen mientras la primera sigue pendiente de fallo judicial," *Voz pópuli*, Tetor 30, 2015, shikuar Tetor 3, 2016, [www.vozpopuli.com/actualidad/nacional/Jorge\\_Fernandez\\_DiazMinisterio\\_del\\_InteriorMedallasVirgenministro\\_del\\_Interiormedalla\\_0\\_848615163.html](http://www.vozpopuli.com/actualidad/nacional/Jorge_Fernandez_DiazMinisterio_del_InteriorMedallasVirgenministro_del_Interiormedalla_0_848615163.html)

7 Ashifa Kassam, "Spanish government questioned over claims of divine help in economic crisis", *The Guardian*, Janar 30, 2014, shikuar Tetor 3, 2016, [www.theguardian.com/world/2014/jan/30/spanishgovernmentsaintteresaeconomic-crisis](http://www.theguardian.com/world/2014/jan/30/spanishgovernmentsaintteresaeconomic-crisis)

8 Ashifa Kassam, "Journalists take fight against Spanish 'gag law' to European court", *The Guardian*, Dhjetor 15, 2015, shikuar Tetor 3, 2016, [www.theguardian.com/world/2015/dec/15/journalists-take-fight-against-spanish-gag-law-to-european-court](http://www.theguardian.com/world/2015/dec/15/journalists-take-fight-against-spanish-gag-law-to-european-court)



marrë 41 milionë euro nga paketa europiane e shpëtimit, përveç shumave të mëdha nga taksapaguesit, për të mbuluar humbjet e tyre.

Këto përjasje, nëse mund t'i quajmë të tilla, në kohët pasnormale çojnë drejt fatkeqësisë, kur një trazirë e vogël në sistem - një tubim kundër paretjesisë ekonomike, ose një tubim në Katalonjë për pavarësi, apo një tërheqje nga shkollat ku filozofia dhe muzika janë hequr nga programi dhe besimi katolik është bërë i detyrueshëm për të gjithë - mund të ketë çoroditje me pasoja të mëdha dhe të padëshiruara. Siç e kemi parë në *You Tube*, shkëndija të tilla sollën shqetësime të thella në Turqi dhe Venezuelë, si dhe në Egjipt e Ukrainë. Dhe, sigurisht, nuk është vetëm Spanja, por edhe vende të tjera perëndimore që po përballen me çështje të ngjashme. *Brexit* dhe rënia e tregut të banesave në Britani do të sjellë tronditje. Mbretëria e Bashkuar mund të mos jetë aq e 'Bashkuar' dhe jo aq shumë 'Mbretërore', nëse Skocia fiton pavarësinë. Italia ka pësuar ngërçe politike njëri pas tjetrit. Po ashtu, Greqia, Belgjika, Norvegjia, Iraku, Afganistani... Në fakt, ngërçet politike janë normat e reja në kohët pasnormale.

Me sa duket, qeveritë ende veprojnë të mbështetura në hamendësimin e zakonshëm, se veprimet e tyre do të shkaktonin pikërisht pasojat që ata synojnë të kenë.

**POLITIKAT NDËRTOHEN MBI THEMELET E DREJTPËRDREJTA, TRADICIONALE DHE DREJTVIZORE SHKAK-PASOJË: VEPRIMI PËRMES VULLNETIT SHKAKTON PASOJËN E DËSHIRUAR NË B. POR NË KOHËT PASNORMALE SHKAKU DHE PASOJA JANË RRALLËHERË TË DREJTPËRDREJTA. DUKURITË E SOTME JANË PASOJË E NDËRTHURJEVE TË NDËRLIKUARA DHE SHKAKORE, NË TË CILAT PLEKSEN SHUMË FAKTORË RASTËSORË. NË RASTE TË TILLA, VEPRIMI I NJËANSHËM JO VETËM ËSHTË I KOTË, POR SHPESH EDHE MJAFT I RREZIKSHËM. VEPRIMI NDAJ A SHKAKTON KUNDËRVEPRIME ZINXHIR NË B, C, D, DERI NË FUND, ZH. SHUMË NGA KËTO KUNDËRVEPRIME MUND TË PËRVETËSOJNË PJESËZA ÇORODITËSE ME SHPEJTËSI DRITE. POLITIKA DUHET TË NDËRMARRË NJË HAP TË RËNDËSISHËM, QË TË JETË KUPTIMPLOTË NË KOHËT PASNORMALE.**

Për të qenë i ndershëm, ne nuk dimë se si të hartojmë politika të qëndrueshme për kohët pasnormale. Megjithatë, ka tre parime themelore që mund



të na udhëheqin. Së pari, duhet të pranojmë se askush nuk është në zotërim të posaçëm, të paktën jo në një shoqëri demokratike. Përfundimi është se ata që mendojnë se vetëm qeveritë mund të japin, shkaktojnë ose arrijnë çdo gjë që duhet bërë, por mashtrojnë veten. Në të vërtetë, qëllimi i çdo ndërhyrjeje të qeverisë është zbehur në mënyrë të vazhdueshme, kështu që është gjithmonë i paplotë, është shumë më i vogël nga sa mendojnë shumica e politikëbërësve. Gjithnjë e më shumë anë të qeverisjes përfundojnë jashtë fuqisë ligjore, apo mundësisë së zbatuesit. Në disa raste, nevojitet bashkëpunimi i disa administratave për të arritur qëllimin e dëshiruar, shpesh duke përfshirë ndërhyrjet e një shumice përfaqësuesish të ndryshëm shoqërorë. Pra, sipas përkufizimit, hartimi i politikave duhet të marrë parasysh dhe të përfshijë një varg këndvështrimesh të ndryshme dhe nevojash në mospërputhje, madje edhe kundërshtuese. Në marrëdhëniet ndërkombëtare, “nevojat tona” nuk plotësohen duke u përqendruar në atë që “dëshirojmë”. Synimet tona do të shqyrtohen, ashtu sikurse ne do të shqyrtonim ‘qëllimet e tyre’ dhe vetëm përmes një ecurie mirëkuptimi në shqyrtim, mund të arrihet një përfundim i kënaqshëm.

Në ligjërimin e shkencës pasnormale, bisedimet e shqyrtuara zhvillohen brenda asaj që quhet “këshill shkencor”. Përveç shkencëtarëve dhe akademikëve, këshilli përfshin një sërë veprimtarësh të tjerë shoqërorë, si nga mjedisi, kritikë, mosbesues, shkrimtarë, deri te shtëpiaket dhe punëtorët me ndërresa. Të gjithë ata që preken nga prodhimet shkencore, bashkohen dhe marrin pjesë në shqyrtimin dhe vlerësimin e çdo pune të caktuar. Ideja e bashkësisë së zgjeruar të bashkëmoshatarëve tani duhet të zbatohet për të gjitha çështjet e qeverisjes, si dhe për çështjet shoqërore në tërësi. Diku tjetër kam treguar se si kjo ide mund të përdoret në bashkësitë e dijetarëve.<sup>9</sup> Kjo është po aq e vlefshme dhe e rëndësishme për institucionet politike, administrative, kulturore dhe sipërmarrëse. Natyrisht, kjo kërkon që ne të zgjerojmë pikëpamjen tonë për pjesëmarrje. Shumica e drejtuesve janë të kujdesshëm ndaj pjesëmarrjes dhe mendojnë se ecuritë e pjesëmarrjes janë shumë të bezdisshme dhe se ka pak për të përfituar prej tyre, përveç një shkalle të caktuar ligjshmërie. Prandaj, shtypa e shumicës së administratave është të zbutin dhe kufizojnë pjesëmarrjet, brenda një numri të kufizuar burimesh. Për t’i shërbyer qeverisjes pasnormale, pjesëmarrja duhet të pasurohet dhe të jetë e larmishme, jo vetëm duke u dhënë mundësi një larmie veprimtarësh, por, gjithashtu,

9 Jordi Serra, “Los retos de la inteligencia en un mundo postnormal,” in *Cultura de inteligencia: un elemento para la reflexión y la colaboración internacional* edited by Fernando Velasco dhe Ruben Arcos, 143–156. Madrid: Plaza y Valdes, 2012.



duke përcaktuar shumë mënyra dhe rregulla të ndryshme për të ngjizur politikat. Teknikisht, kjo nuk përbën një pengesë. Pengesa kryesore do të ishte besnikëria ndaj idealit modern të zotërimit, që është krejtësisht i paparashikueshëm për kohët pasnormale.

Së dyti, ne duhet të vlerësojmë se në një mjedis të ndërlikuar, mekanizmi drejtues duhet të jetë në vetvete i ndërlikuar - ky njihet si *Ligji i larmisë së nevojshme* të Ashbi-t. Me fjalë të tjera, shumësia dhe larmia duhet të jenë në qendër të qeverisjes dhe të pasqyrohen në të gjitha institucionet shtetërore, që demokracitë të qëndrojnë të palëkundura. Kur kjo nuk ndodh, edhe shtetet më të suksesshme përballen me pengesa thellësisht të përçudnuara. Së treti, një politikë e denjë për emrin e vet duhet të marrë parasysh ndikimin e thjerrës së vlerësimit. Si do të përballemi me një grusht pasojash të padëshiruara? Si do të merremi vesh rreth trazirave çoroditëse? Ndërsa ne nuk mund të parashikojmë frytin e një politike, ne duhet të kemi njëfarë vetëdijesimi për pasojat e saj të mundshme.

Përgjigjja ndaj sfidave pasnormale nuk është të kthehemi te disa veprime të përfytyruara si normale (ose paranormale), siç e tregon aq mirë gjendja në Ukrainë, rënia e Presidentit Morsi dhe vendosja e diktaturës ushtarake në Egjipt, si dhe ndjenja fetare e pakuptimtë e qeverisë konservatore në Spanjë. Përgjigjja ka të bëjë me të kuptuarit dhe përqaftimin e gjallërisë së kohëve pasnormale dhe të vepruarit në përputhje me rrethanat. Ne kemi humbur aftësinë tonë për ta zotëruar dhe për t'i dhënë drejtim ndryshimit. Ne mund ta vajtojmë atë humbje, ose ta shfrytëzojmë sa më shumë gjendjen pasnormale.





## Japonia e kohëve pasnormale

*C. Scott Jordan*

S'ka asgjë 'normale' në Japoni. Normaliteti nuk ka qenë kurrë sjellje japoneze dhe ka pak shenja që prirja do të ndryshojë në të ardhmen. Në të vërtetë, Japonia është përballur me çoroditje të brendshme, pasiguri dhe mosmarrëveshje për dhjetëra vjet, si një shtet i rrallë midis kombeve të botës. Lëvizja në drejtim të kohëve pasnormale në Japoni, që u kthye me ngut në një miratim të tyre, nuk ishte aq shumë një vrasje e traditës, sesa një pas-trim i vazhdueshëm i elementeve klasike nga shoqëria e saj. Kjo zhveshje e rregullt ndodhi pa ndonjë nguti të madhe. Ajo u bë më e theksuar fillimisht gjatë revolucionit industrial, që pastaj çoi në Luftën e Dytë Botërore dhe, më pas, me një ritëm më të shpejtë, që nga Marrëveshja e San Franciskos, e vitit 1951. Një peshim i politikës dhe i veprimeve japoneze zbulon se si vendi praktikisht lundroi vetë përmes kohëve pasnormale.

Mënyra se si u zhvillua ky rrjet lundrimi, ofron njohuri të nevojshme rreth idesë së ndryshimit. Në të kaluarën, ndryshimi ka qenë një ide që shtetet e kanë vrojtuar me kujdes në përpjekjet e tyre për të ruajtur rregullin dhe rendin. Kina, për shembull, kërkon revolucion të vazhdueshëm për të përdorur ndryshimin, me qëllim mbajtjen e pushtetit të saj. Përkundrazi, Koreja e Veriut shtiret sikur vetë ideja nuk ekziston dhe, në vend të kësaj, ka zgjedhur të mbetet në një gjendje të ngrirë, që as ngrohja globale nuk mund ta shkrijë. Shumica e shteteve perëndimore mbështesin një marrëdhënie dashurie/urrejtjeje me ndryshimin, e cila është kthyer në një rregull veprimi standard, që kur ata u ngjitën nga Rilindja, në modernitet. Japonia, nga ana tjetër, ka zgjedhur një mënyrë veprimi rrënjësisht të ndryshme, sa i përket ndryshimit. Republika e Japonisë, duke mos pasur tanimë një shtysë



kombëtare, ka përqafuar me guxim tre shtyllat e kohëve pasnormale: mosmarrëveshjet, ndërlikimet dhe çoroditjen, teksa ecën drejt një të nesërmeje të re.

Kur hetohen kohët pasnormale, sa i përket politikës dhe gjendjes, duhet pasur parasysh një pandehje paraprake e rëndësishme. Rregulli i botës së lashtë tregon se çdo shtet (e njëjta gjë mund të thuhet për shoqatat ndërqeveritare dhe joqeveritare) ka tabiatin e vet, përmes të cilit zgjidhen çështjet e përditshme.

JETA, DIKUR, ISHTE E PATRAZUAR, KUR PËR ÇDO PENGESË X, KISHTE NJË ARSYE QË LEHTËSISHT ÇONTE NË Y. NË KOHËT PASNORMALE, KY EKUACION I THJESHTË PRODHON NJË SHUMËSI PËRGJIGJESH TË NDRYSHME. PËR ÇDO ZGJIDHJE Y, PROBLEMI X RRITET ME SHPEJTËSI DHE SHUMË MË SHUMË PROBLEME TË TJERA SHFAQEN: A, B, C, D E KËSHTU ME RADHË, SECILI ME NJË TË PANJOHUR ENDE PËR T'U PËRCAKTUAR.

Qetësia dhe siguria e përqasjes së botës së vjetër ndaj zgjidhjes së çështjeve, bën që shtytja fillestare drejt kohëve pasnormale të duket sikur po hyn në një det të rrezikshëm shkëmbor. Është një mjedis që nuk mund të zotërohet, apo të pushtohet. Japonia e kuptoi këtë disa kohë më parë dhe të kuptuarit e një gjëje të tillë është ndoshta ndihmesa më e madhe në studimin e kohëve pasnormale.

Që nga hapja e Japonisë ndaj botës perëndimore, veçanërisht me nënshkrimin e Marrëveshjes në *Kanagawa*, në vitin 1854, shoqëria japoneze është bërë më e ndërlikuar. Mundësitë e shumta për çoroditje dhe kundërshti të shfrenuara në politikë dhe kulturë, kanë dhënë plot shenja paralajmëruese të mbërritjes së kohëve pasnormale në vendin prej nga ku lind dielli. Artisti japonez Katsushika Hokusai, pikturoi *Valën e Madhe në Kanagawa*, veprën e tij më të njohur dhe më të lartësuar, midis viteve 1829-1833, gjatë periudhës së vonë Edo. Piktura shpërfaq një valë të madhe - ose më saktë, një 'tsunam ndryshimi' - që kërcënon varkat në brigjet e qarkut të Kanagawas. Që nga Kanagawa e asaj kohe, historia e Japonisë është treguar me ndërrime të shpeshta përcaktorësh, një ndryshim që çon në një tjetër, që përfundimisht e ktheu Japoninë nga historikisht të mbështetur në traditë, në një pjellë të fuqisë dhe kulturës perëndimore. Por djali dorëlëshuar u



kthye për të tejkaluar të atin. Japonia hyri në skenën botërore përmes industrializimit, pushtimit, luftës botërore dhe, më në fund, globalizimit në një masë që asnjë komb tjetër joperëndimor nuk e kishte pasur në atë kohë. Madje ka luajtur lojën e paqes, të cilën pak shtete perëndimore kanë guxuar ta luajnë. Kjo përvojë e ndryshimit të shpejtë dhe e përqafimit të pasigurisë, është një tregues, se përse Japonia mund të jetë në gjendje të lundrojë kohët pasnormale më me sukses sesa shumica e vendeve të tjera.

*Vala e Madhe në Kanagawa, Katsushika Hokusai (ca. 1829–1833)*



Për të kuptuar, pse Japonia është e pajisur më së miri për kohët pasnormale, së pari, duhet të shohim se si vendi ka lundruar përmes tre shtyllave gjatë historisë.

Le të fillojmë me ndërlikimin. Sigurisht, është e lehtë të thuash, pavarësisht se ku ndodhesh, që bota në vitin 2015 ishte shumë më e ndërlikuar sesa në vitin 1954. Por ndërlikimi mund të shfaqet në një varg mënyrash. Më lejoni ta sqaroj këtë me shembullin e Kubit të Rubikut. Nëse ia jepni një njeriu të zakonshëm një kub të tillë, me gjithë ato kuadrate të vogla të përziëra, ai ose ajo do ta shohë atë mjaft të ndërlikuar. Por, siç e





kanë shfaqur herë pas here nxënësit e nivelit të shkollës së mesme, gjendet një mënyrë, me anë të së cilës kubi mund të zgjidhet shpejt dhe thjesht, duke e bërë secilën nga gjashtë anët e tij një ngjyrëshe. Ç'është e vërteta, Kubi i Rubikut nuk është i ndërlikuar, por tepër i thjeshtë. Por, le të ndryshojmë pak rregullat! Së pari, ju jeni i verbër për ngjyrat; së dyti, për çdo zhvendosje që bëni në kub, një tjetër zhvendosje vetvetiu, rastësisht, bëhet pa miratimin tuaj. Papritur, zgjidhja e thjeshtë e krijuar nga nxënësit tanë të shkollave të mesme, bëhet e vjetruar.

Ndërlikimi nuk është aspak ide e huaj për shoqërinë japoneze. Përkundrazi, ka qenë një banor i veçantë përgjatë historisë së saj. Jeta dhe strukturat e shoqërisë në Japoni janë të mbushura me pritshmëri të ngurta të renditjes, besnikërisë, nderimit dhe krenimit. Edhe një vështrim i rastësishëm mbi historinë japoneze tregon një rrjet të ndërlikuar feudal brenda shtetit mbretëror, madje edhe midis Samurai-ve, të cilët mendohej se bënin jetë të dërrmuar nga disiplina e rreptë. Parashtrimi dhe përshtatja e ideve të Konfucit, të ardhura nga Kina, krijoi rregulloren e renditjes dhe moralit. Një Japoni e ndikuar nga Perëndimi, vetëm sa e rëndoi ndërlikimin e vetvetes, ndërsa ekuacionit i shtoheshin edhe idetë e rritjes ekonomike, industrisë, pushtimit dhe demokracisë. Rrëfenja e historisë japoneze është më shumë një tregim i shkrirjes së të resë dhe të jashtës, me atë që ishte vendore dhe e lashtë, për të bërë diçka të re, por që ruante vlerat e vjetra tradicionale. Ndërthurja e dokeve dhe traditave u puqën me arsyetimin dhe risinë perëndimore për të ngjizur një përzierje harmonike, ku përbërësit e secilës plotësonin njëri-tjetrin dhe, si rrjedhojë, bëheshin të përdorshme për kulturën dhe jetën japoneze.<sup>1</sup>

Kjo endi një pëlhurë të ndërlikuar, të përbërë nga një shumësi fijesh të ndryshme që ende përshkon mendimin japonez. Pas çdo shtrese ndërlikimi shtesë, Japonia përjetoi një rilindje të re. Gjithmonë e re dhe, megjithatë, gjithmonë tërësisht japoneze. Sistemet e arsimit, qeverisjes dhe ushtrisë, të krijuara me hijeshi, u përmirësuan për t'u shndërruar në një pjellë të re, por që njehtë vjetrën, njëkohësisht e gdhendur me një nënshkrim të veçantë perëndimor. Arsimi është ende i dorës së parë, megjithatë ide të reja shtohen në program dhe studentët fitojnë një arsim të përzier, të mbledhur aty-këtu, jashtë vendit. Sundimi i pakufizuar i mbretit plotësohet nga një kuvend me sjellje shumë perëndimore, por ky kuvend zbaton doket dhe traditat, ndërkohë që ende kapet fort pas idesë së demokracisë. Me kalimin e kohës, ne shohim se qeveria anon më shumë nga kamja, ndërsa fuqia e

1 Brian McVeigh, *The Nature of the Japanese State* (Londër: Routledge, 1998).



mbretit zvogëlohet dhe një institucion me shumë zëra sundon vendin. Më vonë, përparësia e të njohurve dhe familjet politike futen në rrjetin politik japonez.<sup>2</sup> Por, pavarësisht gjithë kësaj, ideja shumë demokratike e përfaqësimit të barabartë shihet nga vetë kuvendi, si një zë i vetëm japonez. Një fuqi besnike luftëtarësh dhe kujdestarësh, posaçërisht e stërvitur, e betuar për të mbrojtur mbretin, zëvendësohet vazhdimisht me një tërësi ushtarake industriale, por përbërja e re ende mban zotimin e vjetër: “besnik deri në vdekje”.<sup>3</sup> Përfundimisht, të gjitha elementet e një shoqërie ndërluftuese hiqen, për t’u përmirësuar, vite më vonë, në një ushtri besnike ndaj ‘paqes dhe sigurisë së mbarë njerëzimit’.

Japonezët janë shndërruar vazhdimisht në një dyndje organike të Lindjes dhe Perëndimit. Por çoroditja nuk është kurrë larg një sistemi të ndërlikuar. Japonia ka qenë pothuajse vazhdimisht në buzë të çoroditjes, gjatë përpjekjeve të saj për t’i dhënë drejtim rrjedhës së ngjarjeve. Le të shtojmë një shtresë ndërlikimi shtesë në Kubin e Rubikut. Përfytyroni sikur 54 katrorët brenda kubit të mund të ndërlidheshin. Për çdo zhvendosje të një kubi, një nga nëntë katrorët në secilën faqe ndryshon rastësisht. Tani, çoroditja merr në dorë frenat e këtij udhëtimit pasnormal dhe ndryshimet më të vogla lënë pasoja rrënjësore.

Ndryshimet e gjithanshme, gjallëria e brendshme dhe e jashtme, përzierjet e ëndrrave nënkuptonin se vërshimet çoroditëse e kanë të siguruar shtratin shkëmbor mbi të cilin duhet të rrjedhë lumi kalimtar japonez. Çoroditja në Japoni është vërejtur kryesisht përmes betejave të saj për pushtet. Njerëz të veçantë dhe grupe të vogla ishin gjithnjë e më shumë përgjegjës për ndryshimet e thella në politikën dhe drejtimin e Japonisë. Qëllimi i pushtetit dhe ata që e kërkuan atë, e çuan ushtrinë e kombit përmes një zhvillimi të trazuar, derisa e zhdukën atë përfundimisht. Mendimi perëndimor mund të ketë prodhuar ndarje fitimesh ekonomike, por, gjithashtu, çoi në shfaqjen e herë pas hershme të afshit nacionalist dhe në beteja të brendshme çoroditëse e të hidhura. Nacionalistët e shtynë shtetin të lëvizte dhe të përforconte zotërimin e Azisë dhe Paqësorit, duke e shtyrë vendin drejt Luftës së Dytë Botërore. Ndërsa këshilltarët e arsimuar kërkuan të zhduknin doket e Samurait dhe të përqendroheshin në ndërtimin e ushtrisë bashkëkohore industriale. Kjo gjallëri e brendshme kulmoi me hedhjen e dy bombave atomike dhe humbjen më të tmerrshme të jetëve në historinë

2 Mohammed Moussa, ‘Kith and Kin in Japanese Politics’, *Critical Muslim* 21: Relations (Hurst, Londër, 2017).

3 Kenneth B. Pyle, Kenneth, *Japan Rising: The Resurgence of Japanese Power and Purpose* (Public Affairs, The Century Foundation, New York, 2007).



njerëzore. Japonia e pasluftës u ndikua shumë nga frymëzimi i huaj dhe përqafimi i idealeve, të tilla si rendimenti dhe zhvillimi, të mbikëqyrura rreptësisht nga politika japoneze. Madje, edhe përplasjet e huaja, të tilla si Lufta e Ftohtë dhe Lufta kundër Terrorit, u morën parasysh. Kohët e fundit, Japonia është detyruar të ndjekë shtegun e ngushtë mes sundimit ekonomik dhe rënies ekonomike, aftësive drejtuese teknologjike dhe plaçkitjes mjedisore, paqes së harmonizuar dhe mbrojtjes së kundërshtarëve. Vlera e nesërme e *jenit* përcaktohet nga sa ‘e këndshme’ mendohet të jenë sot pajisja e fundit elektronike, apo filmi i ri komik manga, ose i vizatuar prej shteteve të industrializuara. Vendi po gulçon në përpjekje për të vazhduar me zhvillimet më të fundit në teknologji, ndërsa shpërfill mirëmbajtjen e infrastrukturës, duke mos ua vënë veshin kërcënimeve të tmerrshme ekologjike. Një grusht gurësh (ishujsh) midis Japonisë dhe Kinës, kërcënojnë baraspeshën e fuqisë për të gjithë rajonin. Dendësia e këtyre ngjarjeve çoroditëse, e nxitur nga ndërlikimi i Japonisë së re, sjell rrezikshmëri të paarsyeshme në vallëzimin vdekjeprurës me pasigurinë.

Përkundrajt kësaj prapavije të një gjendjeje të ndërlikuar dhe çoroditëse, rrjedhoja e natyrshme është mosmarrëveshja. Le të kthehemi te Kubi ynë i Rubikut. Më parë, parashtruam ndryshime të rastësishme: një lëvizje e rastësishme ndodh secilën herë që ju bëni një lëvizje të qëllimshme dhe një katror i rastësishëm lejohet të ndryshojë ngjyrën e tij, pas çdo lëvizjeje që ju bëni. Kjo i hap udhë një mundësie të re për të dalë në sipërfaqe. Ndryshimi i rastësishëm i katrorëve të vegjël lejon, për shembull, që kubi të përmbajë dhjetë katrorë të kuq. Me dhjetë katrorë të kuq, qëllimi i lojës nuk mund të përmbushet.

Në tablonë tonë të deritanishme të Japonisë, tashmë shihet një mosmarrëveshje shqetësuese, por e pranishme, midis ‘urtësisë’ së re perëndimore dhe dokeve të lashta, të lidhura besnikërisht me sundimin e plotë mbretëror.<sup>4</sup> Kjo mospërputhje u rrit për të prodhuar dy mosmarrëveshje të papajtueshme dhe shkatërruese: ndikimi i huaj pushtoi mbretin, ndërsa vetë japonezët mbetën plotësisht besnikë ndaj sundimtarit. Në të vërtetë, është një mospërputhje e rishfaqur edhe sot e kësaj dite, pasi shtytja e fuqive të jashtme (veçanërisht Shtetet e Bashkuara, Kina dhe Rusia) ka bërë përpjekje të anashkalojë ligjin kushtetues dhe qeverisjen e kuvendit kombëtar. Struktura e mangët e pushtetit në Japoni ishte e dukshme gjatë Luftës së Dytë Botërore. Degë të ndryshme të ushtrisë e shtrinë ndikimin e tyre në politikë, duke çuar në një strategji lufte kundërshtuese. Ushtria e

4 David Matsumoto, *Unmasking Japan: Myths and Realities About the Emotions of the Japanese* (Stanford University Press, Sanford, 1996).



shpalli Bashkimin Sovjetik armikun më të madh të Mbretërisë, ndërsa flota ushtarake detare pohoi të njëjtin gjë kundër Shteteve të Bashkuara. Kjo, jo vetëm që ndau politikën dhe qëllimin e strategjisë së luftës, por, gjithashtu, solli dorëzimin e Japonisë para dy armiqve të fuqishëm njëkohësisht.<sup>5</sup> Raste të tilla e kanë lënë Japoninë të mundur dhe të rraskapitur. Por shembuj të tjerë tregojnë se si ndryshimi për të kapërcyer mosmarrëveshjet hyn në punë, sa i përket përcaktimi të politikave japoneze sot.

Kuvendi kombëtar i pasluftës u mendua të ishte një nga historitë më të mëdha të suksesit për demokracinë. Fatkeqësisht, ai u kthye me të shpejtë në një makth.<sup>6</sup> Megjithëse vendi kishte shumë parti opozitare, në pushtet ishte një parti e vetme, Partia Liberal Demokrate. Kjo mospërputhje u ndreq për të mirë të demokracisë, me ndryshimet e bëra në mesin e viteve 1990, ndikimi i të cilave ende shihet sot e kësaj dite në lëkundjet e politikës japoneze. Një çështje e ditës është mosmarrëveshja midis sigurisë së shtetit dhe urdhrit të rreptë që përmban neni 9 i Kushtetutës së Japonisë, i cili parandalon formimin dhe mirëmbajtjen e një ushtrie të përhershme. Gjatë rrjedhës së kësaj historie të fundit, Japonia është bërë më e ndërlikuar, e çoroditur dhe e ndarë mes përqsajeve që nuk përputhen. Këta shënjes të kohëve pasnormale ende përshkojnë punët e shtetit.

Edhe në botën e tregtisë, sjellja e Japonisë ndaj kapitalizmit duket se është në kundërshtim me njohësit perëndimorë të fushës së tregtisë. Kapitalizmi ushqehet nga gara e cila, sipas teorisë, krijon një luftë të pafundme për të prodhuar mallra më të mira, në mënyrat më të mira të mundshme. Tradita japoneze nuk e sheh garën si një virtyt. Bota e tregtisë japoneze përbëhet nga një numër i vogël tregtish që mbulojnë kërkesa të mëdha. Monopoli nuk është një fjalë e ndyrë në Japoni. Përkundrazi, nëse një tregtar vjen për të zotëruar një treg të caktuar, japonezët e nderojnë atë dhe tregtarët e tjerë shikojnë nga tregjet e tjera. Gara e brendshme pothuajse nuk ekziston dhe tregtia e vogël është shumë më e vështirë për t'u krijuar. Në vend të përdorimit të garës së brendshme, tregtia japoneze duket të garojë në tregun botëror. Japonia, kombi, shihet si një ndërmarrje që garon kundër ndërmarrjeve të tjera në shkallë botërore. Sa e suksesshme është kjo mendësi, është e vështirë të gjykohet, pasi Japonia ka qenë një nga ekonomitë kryesore të botës, ndërkohë që po përjeton të njëjtat dhimbje nga ngërçi që ka tronditur ekonominë këto vitet e fundit në mbarë botën.

5 Ichiro Ozawa, *Blueprint for a New Japan: The Rethinking of a Nation* (Kodansha International, Tokyo, 1994).

6 Joji Watanuki, *Politics in Postwar Japanese Society* (University of Tokyo Press, Tokyo, 1997); Kevin Cooney, *Japan's Foreign Policy Since 1945* (Sharpe, M.E., Armonk: NY, 2007).



Pavarësisht gjithë këtyre pengesave dhe mosmarrëveshjeve,

**JAPONIA IA KA DALË TË KALËROJË ME SUKSES NDËRLIKIMIN DHE ÇORODITJEN E SHOQËRISË SË VET, SI DHE PASIGURITË E MJEDISIT BOTËTOR.**

Disa punë vërtet madhështore janë bërë në Japoni gjatë shtatëdhjetë viteve të fundit. Tokio mund të jetë një nga qytetet më të papajtueshme dhe më çoroditëse në planet, por ende kryeson botën në risitë teknologjike. Unë nuk do të shkoja deri aty, sa të them se Japonia ka qenë një fener ndriçues, ose shembulli që duhet ta imitojmë dhe të përpiqemi ta kemi. Por historia e fundit e Japonisë na jep disa mësimë kyçe, se si mund të lundrohen dallgët pasnormale në të ardhmen.

Tre elemente të planit të lundrimit japonez ofrojnë njohuri të rëndësishme për kohët pasnormale. I pari është thjesht *Kuvendi kombëtar japonez*. Në pamje të parë, ky institucion duket thjesht njëri nga kuvendet e panumërtat anembanë botës, por, në të vërtetë, është zhvilluar dhe tjetërsuar në diçka krejt të veçantë, i aftë për të fuqizuar mungesën e shumë ligjvënësve të tjerë. Ai që filloi si një këshill dijetarësh për mbretin, është shndërruar në një grup akademikësh me mendje qytetare, që luftojnë për të ruajtur kremtimet e rrënjësura thellë të Japonisë. Ajo që dikur dukej si kryesia e një ndërmarrjeje, më në fund, është bërë një organ qeverisës me shumë zëra, një forcë në ekonominë botërore dhe një palë e rëndësishme gjyqësore e çështjeve botërore. Ndërkohë që organet e tjera ligjvënëse prirën të përbëhen nga përplasja e të kundërtave që shpresojnë të takohen në mes, Kuvendi është përshtatur në atë mënyrë, që të udhëhiqet nga të qenit një sistem i mbizotëruar nga një parti, apo edhe dy parti, duke shpresuar të lejojë përfaqësimin më të madh të zërit japonez. Kjo, e përzier me prapavijën e ngurtë të dokeve, kërkon që çdo thyesë të ketë përjasje të ndryshme ndaj të menduarit, të folurit dhe parashtrimit, në mënyrë që të miratojnë nismat e tyre.<sup>7</sup> Kuvendi, gjithashtu, i kushton vëmendje të veçantë botës së jashtme, gjë që e kanë vetëm disa vende të tjera, përveçse në rastet kur një përplasje e mundshme është atypari.

Kjo vëmendje e jashtme shoqërohet me elementin e dytë të lundrimit pasnormal japonez, që është *vetëdija mbarëbotërore*. Japonia e kupton se

7 Steven R. Reed, Kenneth Mori McElwain dhe Kay Shimizu, *Political Change in Japan: Electoral Behavior, Party Realignment, and the Koizumi Reforms* (Stanford: The Walter H. Shorenstein Asia-Pacific Research Center, Stanford, 2009)



nuk është vetëm në këtë botë dhe e di se kjo ndikon dhe ndikohet nga ajo që po ndodh në pjesën tjetër të planetit. Kjo mund të jetë ndjerë kohët e fundit, por është e rëndësishme, pasi jo vetëm që ndryshon lojën që luan Japonia me politikën, por edhe mendësinë e politikanit japonez. Vetë mbi-jetesa e tyre varet nga kjo. Ushtarakisht, Japonia duhet të jetë gjithmonë e vetëdijshme, veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore, për strukturën e sigurisë së trevave të saj dhe tani, me rritjen e terrorizmit botëror, edhe të pjesës tjetër të botës.

Në ekonomi, ata kanë parë të mirat dhe të këqijat, veçanërisht me hijen e rënies ekonomike - gjithmonë të pranishme gjatë kohëve pasnormale - politika japoneze duhet të pasqyrojë një kuptim dhe vlerësim të kujdesshëm të ekonomisë botërore.

Elementi i tretë është *të menduarit drejt të ardhmes*. Duket i thjeshtë, por në baraspeshën e politikës së brendshme dhe asaj të jashtme nuk është larg mendjes, që një qeveri të ngatërrohet me shpejtësi në të tashmen e afërt dhe të humbasë aftësinë për të parë shumë përpara sesa ngjarjet e ngutshme të ditës. Por vendi që tashmë zë Japonia, e kërkon mendimin drejt të ardhmes. Japonia duhet të qëndrojë disa hapa përpara në politikën e saj, në mënyrë që të mbijetojë. Duke qenë një komb pa një ushtri të qëndrueshme, me fqinjë që janë bërë me shpejtësi fuqi kryesore ushtarake dhe fërkimet historike që rishfaqen, vendi është i detyruar t'i japë përparësi të plotë paqes ndërkombëtare. Herën e fundit që Japonia përjetoj kushte të ngjashme, ajo kishte ushtrinë më të fortë në rajon. Tani, ajo duhet të mbështetet (për sigurinë e saj) te Shtetet e Bashkuara që tashmë janë të përkushtuara ndaj ngatërresave të veta dhe do të ngurronin të hynin në luftë kundër Kinës dhe të humbnin ushtarët e vet për një çështje të huaj. Gjithashtu, Japonia është ngritur nga asgjëja në grafikët e krahasimit ekonomik botëror dhe vazhdimisht renditet në pesëshen e parë. Për t'u bërë një fuqi e madhe ekonomike, kërkon më shumë se një kuptim të rastësishëm të tregjeve dhe financave ndërkombëtare. Japonisë i duhej të kishte largpamësinë jo vetëm që të mund të hahej me tregun botëror, por edhe të prodhonte mallra më të dobishme dhe me çmim të arsyeshëm, në mënyrë që të ishte në krye, siç bëri në fund të viteve 1980 dhe në fillim të viteve 1990. Për të ruajtur këtë nivel risish, duhet të jetë në gjendje të mendojë dhe të planifikojë dhjetëra vjet përpara.

Ndërsa dukuria e kohëve pasnormale bëhet gjithnjë e më e dukshme, do të ishte tërheqëse të shihej se si vendimmarrësit japonezë i japin formë politikës së tyre shtetërore dhe përshtaten me një mjedis botëror gjithnjë e më të pasigurt. Kubi i ri i rastësishëm i Rubikut nuk mund të zgjidhet,

por prej tij mund të mësojmë shumë për veten dhe mënyrën se si duhet të ecim mbi këtë planet. Ndryshimet e thella që kanë ndodhur në Japoni, që nga hapja e saj me botën perëndimore, në mesin e viteve 1800, dhe veçanërisht pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, japin të dhëna thelbësore dhe mësimë që ofrojnë njohuri, se si shtetet e tjera mund të jenë në gjendje t'i përballojnë kohët pasnormale. Sigurisht, Japonia nuk është i vetmi vend që ka lundruar apo përjetuar kohët pasnormale, por na jep një shembull, se si një shtet bashkëkohor përshtatet me ndryshimin dhe pasigurinë. Duke studiuar Japoninë, ne mund të jemi në gjendje të përparojmë drejt një kuptimi më të thellë të dukurisë së kohëve pasnormale dhe ndoshta t'i përgjigjemi pyetjes, se si ndryshimi pasnormal mund të lundrohet në një nivel vetjak, krahinor e botëror, në mënyrë që të përgatitemi dhe ta përqafojmë botën që shtrihet përpara nesh.



## Lindja e Mesme në kohët pasnormale

*Ziauddin Sardar*

Lindja e Mesme ka parë ndryshime të pashembullta gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Me shfaqjen e “Pranverës Arabe”, pati shumë shpresa për demokraci dhe një të ardhme të qëndrueshme për rajonin. “Revolucionet” në të gjithë Lindjen e Mesme nuk ishin vetëm si rrjedhojë e pakënaqësisë dhe tërbimit kundër sundimeve. Në fund të fundit, arabët janë tërbuar kundër sundimtarëve të tyre për më shumë se gjysmë shekulli. Pranvera Arabe ishte, gjithashtu, krijim i një periudhe të caktuar kohore, një kohë ku globalizimi, lidhja dhe ndër lidhja e menjëhershme janë normë, fuqia e ligjit dhe ligjshmëria politike janë në vërshim e sipër. Po kështu, faktorët nxitës të pranverës ishin ekonomikë: ndryshimi i klimës po ndikon thellësisht në ato vende, thatësira dhe mungesa e ushqimit ishin çështjet më të përforlura midis kombeve më të varfra arabe. Por, brenda disa viteve, Pranvera Arabe u shndërrua në një dimër arab. Çoroditja dhe kundër revolucionet vijuan me të njëjtën shpejtësi mahnitëse, ndërsa kryengritje të veçanta përhapeshin në rajon. Egjipti iu kthye një sundimi ushtarak edhe më shtypës. Libia u copëtua midis fiseve ndër luftuese. Iraku pushoi së qeni një shtet i qëndrueshëm dhe Siria u zhyt në një luftë civile të vështirë. Gjërat ndryshuan, por, në tërësi, ato u përkeqësuan.

Për të vlerësuar gjendjen e vërtetë në Lindjen e Mesme bashkëkohore, është e rëndësishme të kuptojmë se çështjet e shtetit arab dhe, në të vërtetë, çështjet e të gjitha shoqërive janë të ndërlikuara. Për qasja e një demokracie, çështjet e reformave ekonomike, shpresat dhe dëshirat e një shoqërie të larmishme dhe pluraliste, kokëfortësitë e rrënjësura institucionale, si policia dhe ushtria, janë të gjitha çështje të ndërlikuara që nuk kanë përgjigje të thjeshta apo të drejtpërdrejta. Ndërlikimi shtohet edhe





nga fakti se të gjitha këto çështje janë të ndërlikura, kanë lidhje të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën, ndodhin njëkohësisht dhe mund të shumohen me shpejtësi. Kur përfshihen përfaqësuesit ndërkombëtarë – dhe ata janë gjithmonë të përfshirë – ndërlikimi mund të rritet më tej. Lindja e Mesme ka popullsinë e dytë më të madhe të përdoruesve të telefonave të dorës në botë, ndërkohë që përdorimi i telefonit çudibërës po dyfishohet çdo vit. Gjithashtu, ajo ka popullsinë më të re në botë, ku pothuajse 65 për qind e njerëzve në këto hapësira janë nën 30 vjeç. Tre të katërtat e këtyre të rinjve dhe të rejave janë përherë të ngjitur pas telefonave të tyre çudibërës, duke postuar në Twitter, duke biseduar bashkërisht dhe duke përdorur rrjetet shoqërore për të ngarkuar fotografi, mendime, lajme, apo për të bërë kërkesa të ndryshme, janë të përfshirë në tubime e veprimtari të tjera politike. Çatitë në shumicën e qyteteve të mëdha në botën arabe duken si pëlhura enësh satelitore. Ka më shumë se 300 stacione satelitore që përçojnë 24 orë - kryesisht propagandë të një lloji apo tjetër, por ka edhe një pjesë të vogël të kanaleve të mirëfillta të lajmeve, si Al-Jazeera. Kjo ndërlikohet gjithëpërfshirëse shpesh mund të prodhojë vlerësime të sakta. Të rinjtë e zemëruar dhe të shqetësuar janë të prirë për t'iu kthyer në çast dhe për të nxitur mënyra të reja të kundërveprimeve zinxhir. Nuk është për t'u habitur, që Lindja e Mesme është vazhdimisht në buzë të greminës. Si të tilla, çështjet e Lindjes së Mesme nuk mund të zgjidhen veçmas. Ka pak syresh që mund të fshihen nga vështrimi mbarëbotëror. Një çështje e vetme kërkon të dhëna nga këndvështrime dhe përfaqësues të ndryshëm, ndërkohë vetë ajo çështje mund të lidhet me një mori pengesash të tjera.

Në kohë lufte, një shtet sundimtarësh shpërfaq një lloj ndërlikimi edhe më befasues. Merrni parasysh fushëbetejat në Siri dhe Irak, ku nuk është e lehtë të dallosh se kush po lufton me kë. Forcat Demokratike Siriane (FDS), ku mbizotërojnë kurdët, mbështeten nga CIA dhe Pentagoni. Por një degë e CIA-s ka luftuar divizionin e Pentagonit, po aq sa ç'po luftojnë ISIS-in të dy bashkë, ose të ashtuquajturin shtet islamik, Frontin al-Nusra, qeverinë e Bashir al Assad-it, si dhe rusët. Edhe brenda FDS-së ka degë të veçanta që nuk gëzojnë mbështetjen amerikane dhe që luftojnë me përçarësit e mbështetur nga CIA dhe Pentagoni. Al-Nusra, fillimisht e lidhur me Al-Kaedan dhe, ndonjëherë, e mbështetur nga Arabia Saudite dhe Katari, po luftonte kundër SDP-së laike, por, më pas, bashkoi forcat me ta për të mbrojtur Alepon nga ushtria qeveritare e Asadit. Turqia po lufton ISIS-in dhe po bombardon kurdët, edhe pse kurdët po luftojnë ISIS-in. Rusia gjoja lufton ISIS-in, por, në të vërtetë, po bombardon të gjithë ata që mendohen të jenë kundër Asadit, duke përfshirë edhe civilët. SHBA-ja dhe



Britania mbështetin luftëtarët laikë dhe grupet sunitë kundër atyre shiite dhe milicisë shiite të Hezbollahut nga Libani, por kurrë nuk i kanë bombarduar forcat e Asadit, pavarësisht se kanë shfaqur shqetësim për qytetarët e pafajshëm. Në Irak ndodh e kundërta: këtu, SHBA-ja dhe Britania mbështetin qeverinë shiite kundër kryengritjes sunitë. Milicitë shiite iraniane dhe Hezbollahu po luftojnë sunitët kudo. Besnikëria dhe qëndrimet ndryshojnë shpesh dhe ndërlikimi i këtij niveli nuk mund të zgjidhet lehtë.

Përveç çoroditjes dhe ndërlikimit, të cilat janë të ndërlidhura dhe ushqehen me njëra-tjetrën, Lindja e Mesme është e mbushur me mosmarrëveshje. Mosmarrëveshjet në fushëbetejat e Irakut dhe Sirisë janë shumë të dukshme. Po aq të dukshme janë dëshirat e kundërta të popullit dhe udhëheqësve të tyre politikë që tërheqin dhe shtyjnë në drejtime të ndryshme. Tradita dhe bashkëkohorja janë vazhdimisht në kundërshti. Ka një përplasje të vazhdueshme dhe të përhershme të fushëpamjeve të kundërta, si 'fetare', 'laike', 'liberale' dhe 'fundamentaliste', 'kombëtare', 'racore', 'fisnore' dhe 'gjuhësore'. Fiset luftojnë për pushtet dhe ndikim, me rend ditor të veçantë dhe, shpesh, krejt të kundërt, kacafyten me njëri-tjetrin. Pabarazia është e dukshme midis të pasurve dhe të varfërve. Brenda dhe midis kombeve arabe, dëshira për të ruajtur kulturën vendore rritet, ndërsa shijohen përfitimet financiare të globalizimit. Pjesë të caktuara të shoqërisë dhe kulturës po përjetojnë ndryshime të pashembullta, ndërsa anët e tjera të jetës shoqërore janë pothuajse në prehje. Mungesa e një gjuhe të përbashkët për sheshimin e dallimeve dhe tejkalimin e mosmarrëveshjeve shton zemërimin dhe zhgënjimin e qytetarëve që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme për çështjet e ditës, si papunësia, shërbimet e thjeshta dhe siguria. Në një rrethanë të ndërlikuar dhe çoroditëse, mosmarrëveshje të tilla zmadhohen dhe bëhen më të dukshme.

Pra, të kuptuarit e natyrës së kohëve pasnormale në përgjithësi, dhe ndërlikimit në veçanti, është thelbësor, në mënyrë që Lindja e Mesme të lundrojë drejt qëndrueshmërisë paqësore. Zgjidhjet e vërteta të çështjeve të Lindjes së Mesme kërkojnë qasje dhe përpjekje afatgjata, si dhe njëfarë udhëheqësie që e ka një ide të vakët, se si të kalërojë tigrin e ndryshimit pasnormal.

### VETË PRANVERAT ARABE ISHIN RRJEDHOJË E NJË PERIUDHE GLOBALIZIMI, NDËRLIKIMI, ÇORODITJESH, MOSMARRËVESHJESH DHE NDRYSHIMESH TË SHPEJTA<sup>1</sup> – KU TRAZIRA MË E VOGËL NË

1 Ziauddin Sardar, 'Surprise, Surprise!', *Critical Muslim 1: The Arabs Are Alive*, (Hurst, Londër, 2012), f. 3–18.



**ÇDO SISTEM POLITIK APO EKONOMIK MUND TË SJELLË NJË  
NDRYSHIM TË MADH DHE TA ÇOJË SHOQËRINË DREJT GREMINËS  
DHE, ME GJASË, NË SHKËRMOQJE TËRËSORE, OSE DREJT  
GJALLËRIMIT TË NJË RENDI TË RI.<sup>2</sup>**

Prandaj, një shitës perimesh i zemëruar dhe i dëshpëruar, që vetëdigjej në Tunis, u kthye në një ngjarje televizive botërore dhe ishte në gjendje të fillonte një revolucion i cili i kaloi shpejt kufijtë kombëtarë dhe u përhap në të gjithë rajonin. Një i aftësuar në hartim programesh që punon për *Goggle*, mund të nisë një tubim madhështor në sheshin Tahrir të Kajros, vetëm me një botim të shpejtë në *Facebook*. Mirëpo, pasi të shkaktohet një ngjarje e rrëmujshme, nuk është e lehtë të parashikohet se ku do të çojë.

Për të vlerësuar tiparin e veçantë të kohëve pasnormale, ia vlen t'i krahasojmë me atë që mund ta quajmë 'kohë normale' - pra, koha para Pranverës Arabe. Në kohë normale, ruhet një pranim i përgjithshëm i shpërndarjes së tanishme të pushtetit dhe renditjes së nevojave. Mund të ketë një sundimtar të blerë në krye, por shumica e njerëzve e dinë vendin e tyre në marrëdhënien me pushtetin. Kohët normale nuk janë pa mosmarrëveshje ose pakënaqësi, duke përfshirë përpjekjet për kryengritje, por ndryshimi pranohet në masë të madhe, si përmirësim i atyre gjërave që janë. Ngjeshja politike dhe shoqërore që e mban shoqërinë të bashkuar, është pranimi se sipërmarrjet vetjake dhe zotëruesit e pushtetit, sado të shitur dhe lakmitarë, në fund të fundit, do të bëjnë diçka për kombin dhe të mirën e përbashkët. Në të vërtetë, disa prej tyre e kanë bërë. Prandaj, pushteti dhe renditja e gjërave sipas rëndësisë janë themeli nga i cili parashikohet një e ardhme më e mirë dhe është premtimi mbi të cilin një shoqëri i përqendron përpjekjet e saj për të mishëruar të ardhmen. Në kohë normale, një traditë e pasur mbështet mirëkuptimin dhe përkrahjen popullore për shoqërinë dhe ekonominë. Tradita mund të lavdërojë ushtrinë, ose 'kombin', ose udhëheqësin e lartësuar, madje mund të mbështetet në një vegim, në kundërshtim me një ideologji të mundshme që një ditë do të sjellë një gjendje të përkryer, siç është ideja e një "shteti islamik" të mbështetur në Sheriat. Ka paralajmërime dhe shtegdalje që lejojnë papërsosmëritë në sistemin qeverisës, por paralajmërimet nuk e hedhin në erë besimin e përbashkët dhe pranimin e vetëdijes kombëtare. Përforcimet e traditës krijojnë, gjithashtu, mundësinë e zotërimit të gjësë më të çmuar të kohëve normale, vetë kohën. Gjërat mund të jenë të vështira, sundimtarët mund të

<sup>2</sup> Ziauddin Sardar, *Introducing Chaos* (Londër: Icon Books, 1999).



jenë shtypës, por ka njëfarë besimi, se çështjet përfundimisht do të zgjidhen duke u dhënë kohë të mjaftueshme.

Në kohët pasnormale nuk ka kohë të mjaftueshme, të çliruar nga prangat e një sundimtari dhe me shpresat e pritshmëritë në rritje. Qytetarët kërkojnë vëmendje rreth halleve dhe zgjidhjen e menjëhershme të tyre. Por përpjekjet për të përmbushur kërkesat e tyre dhe për të zgjidhur hallet vetëm çojnë në ngatërrim të mëtejshëm në një rrjet të stërholluar, i cili shumëfishohet me shpejtësi, njëkohësisht dhe në mënyrë të rrezikshme. Hallet rëndojnë më shumë; qytetarët dhe grupet e pakënaqura me qëllime të caktuara, të sapofuqizuara, pushtojnë sërish rrugët, gjallërojnë kundërveprim të qartë, duke çuar me shpejtësi në sjellje çoroditëse dhe në një ngërç të ri. Është e rëndësishme të theksohet se tubimet në kohët pasnormale nuk hynë në punë si tubime tradicionale me një udhëheqës të përcaktuar, si politikan, kryetar sindikatash, ose student ideator, por si një rrjet pa krye. Një rrjet është një qenie e pakapshme, që shfrytëzohet nga nyjat e ndërlydhjes. Kështu, politika e rrugës merr një përmasë të re dhe të fuqishme. Ndërlidhja e menjëhershme nënkupton që turmat masive mund të shfaqen me shpejtësi; prania e mediave botërore siguron që një çështje kombëtare të bëhet një ngjarje ndërkombëtare. Mundësitë për t'u kthyer në rrëmujë, siç e pamë në tubimet e 28 majit 2013, në Parkun Gezi të Stambollit, janë jashtëzakonisht të larta. Ndikimi i kësaj ngjarjeje çoroditëse do të jehonte në politikën turke për vitet në vijim.

Për më tepër, në kohët pasnormale nuk ka besim në institucionet e shoqërisë. Të gjitha institucionet themelore të shtetit – burokracia, gjyqësori, policia, ushtria – përçmohen dhe njëjtësohen me qeveritë e vjetra. Mirëpo, të paktën ato mbaronin punë dhe u vinin kapak fiseve dhe sekteve ndërlyftuese që tani janë të lirë të shfryjnë zemërimin e tyre të ndrydhur mbi njëri-tjetrin. Tani, gjithçka që qytetarët e morën si të mirëqenë, duket se po zhduket dhe nuk mund t'i besohet të japë sadopak atë që mendohej të jepte. Nuk ka asnjë qasje të re për të zëvendësuar qasjen e kohëve normale. Ëndërrimtarët kanë fituar, demokracia është dorëzuar dhe nuk ka mundësi për qasjes shpresëdhënëse. Pra, në kohët pasnormale problemi është vetë shoqëria. Ky është një problem i ndërlikuar, përsëritës, që nuk ka zgjidhje të thjeshta apo të menjëhershme, ndërkohë që qytetarët kërkojnë zgjidhje të menjëhershme e të shpejta.

Në kohë normale pasiguritë janë të vogla dhe të zotërueshme, por në kohët pasnormale pasiguria vihet në qendër të vëmendjes. Meqenëse gjithçka është e ndërlydhur, e ndërlikuar, e çoroditur dhe që ndryshon me shpejtësi, ç'është e vërteta, asgjë nuk mund të përshkruhet ose të besohet



me ndonjë siguri. Qytetarët janë krejtësisht të hutuar. E kaluara ishte kaq rrënjësisht e ndryshme nga e tashmja, sa që nuk ka histori për të mësuar, mosmarrëveshjet e politikës së re duken të pamundura për t'u përballuar dhe hareja e revolucionit ua lë vendin anktheve të reja.

Parë nga ky këndvështrim, nuk është për t'u habitur që Pranvera Arabe u shndërrua në një dimër. Sundimtarët e zgjedhur të Egjiptit, Tunizisë dhe Libisë zbuluan se për t'u kthyer në demokraci të lulëzuara, duhej të merreshin, ose në disa raste, të krijonin sisteme tërësore qeverisjeje. Në një demokraci, qeveritë përbëhen nga shumë njerëz dhe grupe me qëllime të ndryshme, disa madje të armatosur, brenda hapësirave të rrënjësura institucionale, si burokracitë, gjyqësori dhe ushtria, me përfitimet e tyre që duhen ruajtur, të gjitha të rregulluara me rregullore zyrtare, sipas shembujve të mëparshëm tërësisht demokratikë. Nuk është vetëm një çështje e shumë pjesëve të ndryshme dhe të larmishme, por se si këto pjesë ndërvepruan për të prodhuar një tërësi ndërlikimi. Për më tepër, udhëheqësit e demokracive të reja duhet të përballen me këtë larmi dhe ndërlikim në një mjedis që ndryshon me shpejtësi, pritshmëri në rritje dhe kërcënim të vazhdueshëm të sjelljes çoroditëse nga qytetarët e pakënaqur, ose grupe me qëllime të veçanta.

**SISTEMET E DOBISHME DHE TË SUKSESSHME SHUMË TË  
NDËRLIKUARA NUK MBIJNË BRENDË NATËS. ATO ZHVILLOHEN  
NGADALË DHE DUHEN BREZA PËR TË ARRITUR DERI TE SHTETI I  
QËNDRUESHËM.**

Por, për të qenë të suksesshme, ato duhet të jenë në gjendje të përballen me disa nga veçoritë themelore të botës pasnormale. Merrni, për shembull, tregjet e globalizuara që u shërbejnë vetëm atyre që paguajnë; apo politika demokratike e cila ka të bëjë me baraspeshën e pushtetit. Pra, çdo ekonomi e pas-pranverës, që është thjesht e mbështetur në treg, nuk do të kujdeset për ata që janë dhe ishin vazhdimisht të mënjanuar nga pjesët kryesore financiare dhe ekonomike. Dhe çdo qeveri që nuk përfshin shumicën, nuk do të jetë e qëndrueshme. Nëse qeverisja zotërohet nga një palë e caktuar e shoqërisë – si në Siri, ose në Irak, pas Luftës së Gjirit – ose disa shoqëri në nivel kombëtar ndihen plotësisht të pafuqishme, apo nëse bëhen përpjekje për të mishëruar vullnetin e një pale të caktuar të shoqërisë të një palë tjetër, politika ka mbërritur në fund të rrugës. Qytetarët e fuqizuar dalin në rrugë dhe çoroditja merr rrjedhën e vet të natyrshme. Një nga parimet kryesore të mbijetesës në një



mjedis të ndërlikuar, është se mekanizmi i tij kontrollues duhet të jetë në vet-vete i komplikuar - ai që njihet si Ligji i Larmisë së kërkuar të Ashbi-t.<sup>3</sup> Me fjalë të tjera, shumësia dhe larmia duhet të jenë në qendër të qeverisjes dhe të pasqyrohen në të gjitha institucionet shtetërore, me qëllim që demokracitë e reja të qëndrojnë në këmbë. Në mungesë të kësaj, edhe shtetet më të suksesshme përballen me pengesa të mëdha.

Një shembull të mirë na ka dhënë Turqia. Këtu kemi një nga ekonomitë më të suksesshme të botës myslimane, të udhëhequr nga një parti islamike, me këmbë në tokë dhe e përkorë, Partia për Drejtësi dhe Zhvillim. Kjo parti, jo vetëm që ka përmirësuar gjendjen ekonomike të shumicës dërrmuese të qytetarëve, madje ia ka dalë të detyrojë ushtrinë, rojet e laicizmit turk, të braktisë çdo interesim lidhur me politikën. Në të vërtetë, ajo është qeveria më popullore, e zgjedhur në mënyrë demokratike në historinë e Turqisë. Megjithatë, siç treguan tubimet e Parkut Gezi, të maj-qershorit 2013, në sheshin Taksim të Stambollit, Porta e Lartë, një emërtesë me vend për të përshkruar Turqinë bashkëkohore, teksa kërkon të rizbulojë trashëgiminë dhe kulturën e saj osmane, ishte shumë pak në dijeni rreth kohëve pasnormale. Pavarësisht popullaritetit të qeverisë, vendi po tërhiqet vazhdimisht në drejtime të ndryshme nga laikët, qemalistët, kurdët dhe mbështetësit e pikëpamjeve të ndryshme për Islamin. Duke pasur parasysh qendrat tregtare, tashmë me shumicë në Stamboll, disa mendonin se edhe një tjetër ishte e panevojshme, veçanërisht nëse kjo nënkuptonte humbjen e një parku historik shumë të dashur. Qendrat tregtare janë rrjedhojë e pashmangshme e ekonomive të drejtuara nga tregu, “përparimi” shoqëror dhe kërkesës së blerësve për zgjedhje. Megjithatë, Parku Gezi nuk është thjesht një park: është metaforë e një ideje të veçantë të ‘turqizmit’ që Partia për Drejtësi dhe Zhvillim i bën jehonë, por që grupet e tjera në vend e kundërshtojnë. Me fjalë të tjera, aq sa ç’bëhet fjalë për një çështje identiteti, po aq bëhet edhe për tregjet. PDZH-ja është krenare për përkatësinë e saj islamike – dhe me të drejtë. Por identiteti nuk është diçka që mund të prodhohet, aq më pak të vendoset. Vlerat që gjallëron ai, duhet të jenë të brendshme dhe jo të detyruara nga jashtë. Ata që përqafojnë vlerat islamike të kësaj partie në Turqi, e bëjnë këtë me dëshirë; dhe ata që i kundërshtojnë ato, duhet gjithashtu të jenë po aq të lirë ta bëjnë këtë. Lloji i kombëtarizimit laik që PDZH-ja kërkon të ringjallë, mbështetet në vlerat islamike konservatore të cilat nuk mund, ose nuk do të përqafohen në mënyrë të njëjtë nga të gjitha pjesët e shoqërisë. Plani për ndalimin e alkoolit është gjithashtu një metaforë për lirinë

3 Alexander S. Gard-Murray, Yaneer Bar-Yam, ‘Complexity and the Limits of Revolution: What Will Happen to the Arab Spring?’ *arXiv:1212.3041*, Dhjetor 11, 2012.



vetjake. Askush nuk mund ta detyrojë tjetrin të pijë. Por, në një demokraci me shumicë, ata që dëshirojnë të pinë, kanë të drejtë ta bëjnë këtë. Për më tepër, ta detyrosh një shoqëri të larmishme të përqafojë vetëm një mënyrë të përfytyruari të identitetit, do të thotë të jesh kundër forcave të ndërlikimit dhe kohëve pasnormale, bashkë me pasojat që i shoqërojnë. Kjo është ndoshta gjëja më e vështirë për t'u kuptuar për të gjithë llojet e myslimanëve në Lindjen e Mesme. Në botën bashkëkohore shumësia ka një kuptim tepër të veçantë: nënkupton që të gjithë anëtarët e shoqërisë, duke përfshirë ata që kundërshtojnë vlerat tuaja dhe përqafojnë vlerat që ju i neveritni, përfshihen brenda kornizës së përgjithshme të kombit. Sigurisht, ju mund të mos i miratoni, por nuk mund t'i ndaloni, përjashtoni apo mënjanoni.

Ka një pandehje të pathënë, se mendimi islam rrjedhimisht çon te vlerat islame, sido që ato të përcaktohen, por që janë 'natyrore' dhe i sjellin dobi shoqërisë dhe qytetarëve të saj. Mëdyshja për një qeveri me prirje islame është të sigurojë udhëheqje dhe të lartësojë këto vlera islame, pa e gërryer lirinë, pra, një baraspeshë midis jehonës dhe vënies në jetë të vlerave të tilla. Ishin pikërisht politikatat e mbështetura në këtë pandehje, që e çuan kryeministrin e atëhershëm, Rexhep Tajib Erdogan, drejt përbaljes me padi për 'totalitarizëm'. Sigurisht, ai është çdo gjë tjetër, veçse i tillë. Është krejtësisht qesharake të fajësosh një kryeministër të zgjedhur në mënyrë demokratike, i cili ka fituar zgjedhjet herë pas here, për 'totalitarizëm'. Por ai mund të fajësohet për një gabim të caktuar, se ngatërroi përkrahjen e njerëzve të thjeshtë me bashkëjetesën e pushteteve. Kur u përball me kërkesat e protestuesve të Parkut Gezi, ndërlikimet e kohëve pasnormale treguan qartë se Erdogan nuk ishte i përgatitur për reagimin e tyre. Ata nuk donin 'ndërhyrje' në mënyrën e tyre të jetesës. Ozhan këshillon se Erdogani duhet të kapërcejë idenë e shekullit të XIX-të, se ligji duhet të zbatohet, edhe nëse është i padrejtë, për t'u "çliruar nga fajësimi për totalitarizëm". Unë do të thosha se ka gjithashtu nevojë për të kapërcyer mendimin islam të shekullit të IX-të dhe për një vetëdijësim të gjendjes pasnormale dhe ndërlikimet e saj.

Për ironi, si populizmi, ashtu edhe pasnormaliteti, i erdhën në ndihmë Erdogani gjatë grushtit të shtetit, të 15 korrikut 2016. Për këtë, u fajësuan ndjekësit e Fetullah Gylenit, një mësues i kthyer në udhëheqës të nderuar, i cili ishte një ish-bashkëpunëtor i Presidentit Erdogan.<sup>4</sup> Ndërsa Lëvizja Gylen në dukje ka prirje *sufiste* dhe predikon dashuri e vullnet të mirë për njerëzimin, ajo ka lidhje historike që shtrihen thellë në të gjitha anët e shoqërisë turke. Grushtet ushtarake të shtetit nuk janë të huaja për

4 Sophia Pandya, 'Gazi Warrior Vs Sufi Mystic: Turkey's Erdoğan-Gülen Breakup', *Critical Muslim* 16: Turkey, edited by Ziauddin Sardar (Hurst, Londër, 2015), f. 45–62.





Turqinë. Grushti i shtetit të 15 korrikut ndoqi një model të njohur historik. Udhëheqësit e grushtit të shtetit bllokuan një nga urat që lidhin anët aziatike dhe europiane të Stambollit, rrethuan aeroportin e Stambollit me tanke dhe ushtarët morën në zotërim një stacion televiziv ku vazhduan të parashtronin kërkesat e tyre. Por në kohët pasnormale, kanalet e ndër-lidhjes nuk kufizohen në një stacion të vetëm televiziv. Për më tepër, duke qenë se qytetarët janë të prirë të veprojnë në çast, falë rrjeteve shoqërore, një nivel i caktuar i mbështetjes popullore, është thelbësore që një grusht shteti të ketë sukses. Presidenti Erdogan ishte në gjendje të shkonte në një tjetër kanal televiziv. Ai iu drejtua kombit, duke përdorur *Facetime* në telefonin e dorës, dhe u kërkoi mbështetësve të tij të dilnin në rrugë. Çfarë mund të jetë më *pasnormale* se kjo? Por nuk ishte vetëm ushtria e mbështetësve të tij, që iu përgjigjën thirrjes së Erdoganit. Anëtarët e të gjitha partive, laikët e qemalistët (përkundër faktit se Mustafa Qemal Ataturk, themeluesi i Turqisë moderne, e bëri ushtrinë roje të laicizmit dhe qemalizmit<sup>5</sup>), njerëz nga grupe të ndryshme racore me besnikëri ndaj ideve të ndryshme, dolën në rrugë. Ndryshe nga liberalët dhe laikët në Egjipt, të barasvlershmit turq parapëlqyen demokracinë – sado e dëmtuar dhe e rrezikuar – në vend të sundimit ushtarak. Pasi rrugët u pushtuan nga qytetarët, grushti i shtetit të modës së vjetër mbërriti në fund të rrugëtimi të vet të pashmangshëm pasnormal: dështimit.

Në të kundërt, grushti i shtetit ushtarak në Egjipt pati një mbështetje të madhe popullore. Tubimet e Sheshit Tahrir, të vitit 2011, rrëzuan Hosni Mubarak-un dhe sollën në pushtet presidentin Mohamed Morsi. Morsi, një njeri me qëllime të mira, i përkiste një shekulli tjetër, në një vend tjetër. Që mendimi i tij tradicional islamik ishte krejtësisht i paaftë të merrej me një shoqëri të larmishme, u bë e dukshme në Kushtetutën e re egjiptiane<sup>6</sup>, që ai u përpoq të themelonte. Shumica e anëtarëve të këshillit të hartimit të Kushtetutës i përkisnin partisë islamike në pushtet, Partisë së Lirisë dhe Drejtësisë (PLD) dhe Partisë tejet-konservatore *Nour*. *Neni 1* i Kushtetutës e përshkruante “Republikën Arabe të Egjiptit”, si “një shtet të pavarur më vete, të bashkuar dhe të pandashëm, me rend demokratik”. *Neni 2* pohonte se “Islami është feja e shtetit dhe arabishtja gjuha e tij zyrtare”, gjë që është mjaft e drejtë, duke pasur parasysh se Egjipti është një vend mysliman arab. Por, më pas, *neni 2* vazhdonte: “Parimet e Sheriatit Islam

5 Edip Asaf Bekaroglu, “The Ambiguity of Turkish Secularism”, *Critical Muslim* 16: Turkey, edited by Ziauddin Sardar (Hurst, Londër, 2015), f. 25–44.

6 Egypt’s Morsi Constitution can be downloaded from: [www.worldcrunch.com/world-affairs/egypt039snewconstitutioninitsentiretyinenglish/egyptianconstitutione-gyptconstitutionmohammedmorsimorsy/c1s10493/](http://www.worldcrunch.com/world-affairs/egypt039snewconstitutioninitsentiretyinenglish/egyptianconstitutione-gyptconstitutionmohammedmorsimorsy/c1s10493/)





janë burimi kryesor i ligjeve”. Duke pasur parasysh, se *Sheriat* do të thotë gjëra të ndryshme për njerëz të ndryshëm, madje edhe mes myslimanëve e jo më atyre jomyslimanë, ky ishte një shteg i hapur për mospajtim, fatkeqësi të pashmangshme dhe një përpjekje e qartë për të shtypur larminë dhe shumësinë. Pasi Sheriati hyri në lojë, Egjipti vështirë se mund të mbetej, siç treguan ngjarjet e mëvonshme, “i bashkuar dhe i pandashëm”. Për t’u siguruar që idetë tradicionale të Sheriatit rreth gjinisë, jomyslimanëve dhe pikëpamjeve të tjera, po aq të padrejta, të mbeten të paprekura, *neni 4* ua dha fuqinë e shpjegimit ‘Dijetarëve të Lartë të Al-Azhar’, me të cilët ‘duhet të këshillohesh në çështjet që kanë të bëjnë me ligjin islam. Kjo, natyrisht, nuk ishte shumë e ndryshme nga Kushtetuta e Iranit, e cila ia jep këto të drejta një Udhëheqësi më të lartë dhe Këshillit të Rojtarëve. Hamendësimi themelor i qenësishëm në këto nene ishte se nuk mund t’ua besosh njerëzve, vetë njerëzve që udhëhoqën revolucionin, çështjet e moralit të shoqërisë, apo të dish se çfarë do të thotë të jesh mysliman në shekullin e XXI. Ata duhet të udhëzohen dhe të drejtohen nga një elitë e zgjedhur. Së fundi, në rast se kishte ndonjë dyshim, *neni 219* e bëri të qartë, se “parimet e Sheriatit Islam përfshijnë prova të përgjithshme, rregullat themelore, rregullat ligjvënëse dhe burime të besueshme të pranuar nga mësimet fetare sunite dhe nga bashkësia e gjerë”. Pra, shiitët, sufistët, ismailitët dhe shumëllojshmëri të tjera të myslimanëve që nuk pajtohen me prirjen sunite, nuk duhet të kërkojnë shtetësi; gratë duhet të qëndrojnë në shtëpi, pasi detyrimet e tyre ndaj familjes dhe shoqërisë janë të parashikuara në Kushtetutë; ndërsa ata që nuk janë myslimanë, duhet të largohen. Për më tepër, presidenti emëron vetë një të dhjetën e anëtarëve të Këshillit *Shura*, anëtarët e të cilit mendohet të zgjidhen me votim të fshehtë (*neni 128*). Ai emëron drejtuesit e të gjitha institucioneve kombëtare, përfshirë Bankën Qendrore dhe Zyrën e Mbikëqyrjes financiare, gjë që e bën përcaktimin e tyre si ‘të pavarur’, disi të mangët. Kjo do të thotë se presidenti ka pothuajse zotërim të plotë mbi ecurinë e gjyqësorit. Por, Kushtetuta pati edhe një varg nenesh të tjera, po aq të padurueshme. Ndërsa *neni 45* mundësonte lirinë e mendimit në mënyrë të plotë, *neni 44* i mëparshëm ndalonte shpifjen e lajmëtarëve dhe profetëve, duke hapur kështu derën për blasfeminë pakistaneze, ku shumë njerëz të pafajshëm kanë vuajtur nga një ligj i tillë, madje edhe djem të rinj të krishterë janë dënuar me vdekje. Në të vërtetë, nuk ishin vetëm profetët, por dikush nuk mund të shfaqte asnjë përbuzje ndaj asnjë qenieje tjetër njerëzore, sipas *nenit 31*. Duke qenë se edhe presidenti është qenie njerëzore, çdo kritikë



e drejtuar ndaj tij do ta çonte një qytetar drejtpërdrejt në burg për 'Fyerje të Presidentit'. Dhe, nëse do të fyesh ushtrinë, të themi duke e fajësuar si të shitur, të ashpër, apo për keqmenaxhim, do të gjykoresh nga një gjykatë ushtarake për 'krime që dëmtojnë forcat e armatosura'.

Nuk është për t'u habitur, që islamistët dhe konservatorët ishin më se të kënaqur me Kushtetutën e parashtruar. "Përkrahësit pohuan se Kushtetuta do të sillte qëndrueshmëri", vuri në dukje Ahmad Taher, "dhe, për këtë arsye, do të mundësonte zhvillimin dhe investimet e huaja që kërkoheshin për të arritur qëllimet dhe dëshirat e popullit egjiptian. Ata, gjithashtu, pohuan se neni 2 dhe neni 219, kanë për qëllim zbutjen e rregullit të Sheriatit Islam."<sup>7</sup> Çështja është se 'sundimi i Sheriatit Islam' rrallëherë zbutet. Ai, jo vetëm që nuk i sjell qëndrueshmëri zhvillimit dhe investimeve të huaja, por ka çuar gjithmonë, kudo që është zbatuar me detyrim, në padrejtësi, shtypje dhe grindje. Ai është një krijim i pandashëm, në një botë që i nevojitet ndërlikimi, për t'u marrë me çështje tërësore. Kufizon lirinë dhe barazinë në një botë që e dëshiron atë, tërheq shoqërinë përsëri mbrapsht në historinë e lashtë, kur vetë bota po ecën përpara. Ndoshta kjo është arsyeja, pse pjesa e popullsisë egjiptiane që 'rregulli i Sheriatit Islam' nuk i ngjallte ndonjë dashuri, dridhej nga vetë ideja. "Kundërshtarët pohuan se Kushtetuta do të sillte një sundim të ri, të ashpër, që e shndërron kreun e shtetit në të plotfuqishëm me të drejta të pakufizuara, duke mos lënë hapësirë për përgjegjësi dhe mbikëqyrje. U mendua se zvogëlon të drejtat e qytetarëve dhe vendos kufizime të lirisë në atë masë, sa që kundërshtarët kërkuan rivendosjen e Kushtetutës së vitit 1971, së bashku me një Kuvend të ri Kushtetues", shkruante Taher.<sup>8</sup> Me fjalë të tjera, gjysma e popullsisë së Egjiptit ishte aq e tmerruar, sa parapëlqeu ligjet e hartuara nga sundimtarët e mëparshëm. U bë e qartë, se revolucioni ia doli të thyente vetëm shtresat e jashtme të thundrës. Ai la të paprekura strukturat burokratike, policore dhe ushtarake, si dhe mendësinë e shtypjes. Së shpejti, kërkesat për rrëzimin e Morsit filluan të përshkallëzohen.

Pasi shijuan fuqinë e internetit, për të vënë njerëzit në lëvizje dhe për të krijuar rrëmujë, pjesa e pakënaqur e shoqërisë doli përsëri në rrugë. Tubimet kundër Morsit në sheshin Tahrir përbëheshin kryesisht nga të njëjtët njerëz - laikë, liberalë, modernistë - që e rrëzuan Mubarakun nga pushteti. Këtë herë, atyre iu bë krah edhe ushtria. Në të vërtetë, ushtria jo vetëm që përdori rrjetet shoqërore për të vënë në lëvizje turmat, por përdori edhe mediat tradicionale për të nxitur një valë kundër Morsit. Edhe

7 Ahmed Taher, "The New Egyptian Constitution: An Outcome of a Complex Political Process" *Insight Turkey* 15 1 (Winter 2013) f. 25-37.

8 Po aty.



një herë, ngjarjet çoroditëse morën rrjedhën e tyre normale. Marrja e pushtetit nga gjeneral Abdel Fattah el-Sisi në Egjipt, më 3 korrik 2013, çoi në pasnormalitetin e Kushtetutës së Morsit dhe u pa nga shumë të huaj, si një grusht shteti kundër një presidenti të zgjedhur në mënyrë demokratike. Por vetë ushtria s'e pranoi një emërtesë të tillë. Në fund të fundit, ai u mundësua me pjesëmarrjen e plotë të shumicës së qytetarëve, të cilët i kërkuan ushtrisë të ndërhynte dhe brohorisnin ushtrinë dhe policinë, teksa vinin për të vrarë. Mijëra ndjekës të Morsit u therën pa mëshirë. Megjithatë, askush nuk kundërshtoi në Egjipt apo në Perëndim. Qindra mbështetës të Morsit u gjykuan dhe shumica u dënuan me vdekje, megjithatë, askush nuk kundërshtoi. Ngjarjet në Egjipt na japin mësim të rëndësishme për kohët pasnormale. Ndryshimi është i shpejtë dhe mund të përmbysë një sistem disa herë, brenda pak viteve. Çoroditja mund të sjellë çlirim dhe nënshtrim. Kohët pasnormale nuk mund të lundrohen me sukses, as me mendimin tradicional islam, as me grushtin e hekurt, as përmes nënshtrimit; ndërsa marrja me shumicën kërkon qasje të ndërlikuar.

Kur mbreti Salman bin Abdul Aziz al Saud mori detyrën, si kreu i Derës së Saudit, të Arabisë Saudite, në janar 2015, ai trashëgoi një mbretëri që po shpërbëhej dhe një ekonomi që nuk përputhej. Çmimi i naftës, buri mi i vetëm i të ardhurave të mbretërisë, kishte rënë thellësisht - nga 100 dollarë, në rreth 30 dollarë për fuçi. Mangësitë buxhetore kishte mbërritur shumë marramendëse prej 100 miliardë dollarësh. Një ekonomi me të ardhura të lakmueshme që e ka zili bota, duhej të kërkonte një kredi pesëvjeçare prej 10 miliardë dollarësh në tregun e hapur. Një popullsi që nuk paguante kurrë taksë, duhej të pranonte të pamendueshmen dhe të fillonte të paguante tatimin. Një vend i pasur me energji, ku popullsia i shikonte energjinë elektrike dhe ujin të paguara nga shteti, si të drejtat e tyre themelore, duhej të përballëj me vërtetësinë e masave shtrënguese.

## DERA E SAUDIT VURI RE SE VENDIT I NEVOJITËJ NJË LARGPAMËSI.

Largpamësia Saudite 2030<sup>9</sup> pohon se mbështetet në besimin e fortë, që Arabia Saudite është dhurata e veçantë e Zotit për njerëzimin. Mbartja e zbehtë, e pandashme dhe shtypëse e Islamit *Wahabist* do të mbretërojë e lartësuar dhe Arabia Saudite do të bëhet 'zemra e botës arabe dhe islame', e cila do të shërbejë si zanafilla e shndërrimit të mbretërisë në 'një fuçi

9 Kingdom of Saudi Arabia, *Vision 2030*, shikuar nga: [vision2030.gov.sa/en](http://vision2030.gov.sa/en)



botërore investimi' dhe 'një qendër botërore që lidh tre kontinente, Azinë, Europën dhe Afrikën'.

Largpamësia e një shoqërie nuk mund të blihet në shitore dhe as nuk mund të detyrohet nga lart. Ajo buron nga pjesëmarrja e plotë e qytetarëve, përmes rrahjes së mendimeve – diçka që mbretëria ende ka nevojë për ta zhvilluar. Trazirat dhe paqëndrueshmëria e rajonit në kohët pasnormale vështirë se do ta lënë mbretërinë të paprekur.

Në dallim të theksuar, Tunizia ka treguar më shumë vetëdije për gjendjen pasnormale. Partia politike mbizotëruese në Tunizi, *Ennahda*, si Vëllazëria Myslimane e Presidentit Morsi, është pjellë e Lëvizjes Islamike. Ajo fitoi Zgjedhjet e Përgjithshme të 2011-ës, fill pas rënies së qeverisë së Zine El Abidine Ben Ali - ngjarja e parë e madhe e Pranverës Arabe. Dhe, ashtu si Egjipti, edhe Tunizia duhej të kalonte përmes një ecurie të vështirë të hartimit të një Kushtetute të re<sup>10</sup>, e cila doli pas një sërë qasjesh të ndryshme. Por, ndryshe nga Vëllazëria Myslimane e Egjiptit, *Ennahda* e kuptoi se mendimi islam i shekullit të IX-të nuk është i përshtatshëm për të lundruar në ndërlikimet e kohëve pasnormale. "Tunizia është po aq islamike, sa Egjipti apo Turqia", duket sikur thotë parathënia e Kushtetutës, "dhe do t'i mbetet besnike mësimëve të Islamit". *Neni 1* thotë se "feja e Tunizisë është Islami, gjuha e saj është arabishtja", por vendi i beson popullit të saj, ndërsa *neni 3* shpall se "pushteti i takon popullit tunizian" (jo Zotit, i cili është i gjithëpushtetshëm në çdo rast, edhe pse kjo është kërkesa e shumicës së fundamentalistëve myslimanë dhe që zë vendin e krenarisë në Kushtetutën e Pakistanit, një burim çoroditjeje dhe argëtimi të pafund shkencor). Për më tepër, në asnjë rast nuk përmend "Sheriatin Islamik", por përqendrohet në të drejtat e njeriut, të drejtat për punë, kujdes shëndetësor dhe arsim, si dhe ndarjen e pushteteve. Kështu, pushteti ligjvënës nuk i përket Kryetarit të shtetit, por një Dhome përfaqësuesish 'që del me votë nga zgjedhjet e përgjithshme, të lira dhe të fshehta' (neni 18). Ata e këshillojnë dhe i japin të drejtën zyrtare Kryetarit - për një periudhë të caktuar kohe dhe për një qëllim të caktuar -, që të nxjerrë urdhra të cilat, sipas rastit, ia paraqet për miratim Dhomës së përfaqësuesve" (neni 28). Për më tepër, ka edhe një formulë për t'u siguruar që Dhoma e përfaqësuesve përfaqëson shoqërinë në tërësi, me përfaqësimin e duhur nga krahinat, punëdhënësit, bujqit, punëtorët – dhe ata nuk përfaqësojnë nevojat e tyre, por të gjithë kombit. Gjyqësori është i pavarur dhe zgjedh gjyqtarë nga radhët e veta, pushteti vendor ka pavarësinë e duhur për t'u dhënë drejtim punëve të tyre.

10 Tunisia's new constitution is, e disponueshme: <http://confinder.richmond.edu/admin/docs/Tunisiaconstitution.pdf>



Vlen të përmendet, se, ndërsa *Ennahda* këmbënguli në krijimin e një sistemi kuvendor me zotërimë, baraspeshë dhe llogaridhënie të plotë, parti-të laike luftuan për një sistem gjysmëparlamentar, me një president veprues me të drejta shumë më të mëdha. Këto mosmarrëveshje të pazgjidhshme (dhe ironike) midis qëndrimeve të ndryshme u zgjidhën përfundimisht, duke u marrë vesh përmes bisedimeve. Qëllimi i *Ennahda*-s nuk ishte të nxjerrë një kushtetutë që ka të bëjë me drejtimin dhe zotërimin, por një kushtetutë që përfaqësonte pikëpamjet dhe dëshirat e shoqërisë së larmishme të Tunizisë dhe të përfshinte të gjitha palët në ndërtimin e kombit. Përveçse është më e hapur dhe gjithëpërfshirëse, Kushtetuta tuniziane e pranon shumësinë dhe larminë e shoqërisë që synon të drejtojë. Ajo siguron një sistem të ndërlikuar qeverisjeje për një shoqëri dhe kohë të ndërlikuar. Pavarësisht kësaj, Tunizia nuk është çliruar nga tubimet, kryesisht pjellë e papunësisë së lartë e të rinjve dhe rënies ekonomike për të cilën qeveria, në të vërtetë, çdo qeveri, nuk mund të ofrojë zgjidhje të menjëhershme. Por i vetmi tubim që mori përmasa çoroditëse, ishin trazirat e nisura nga salafistët, gjatë qershorit 2012, pasi sulmuan një ekspozitë arti. Gjithashtu, pati një sulm nga terroristët e lidhur me ISIS-in, në qershor 2015, në qytetin turistik të Sousse. Megjithatë, pavarësisht nga këto trazira, Tunizia duket se është në gjendje të gjejë mirëkuptim për një rrugë të kujdesshme drejt të ardhmes. Ndryshe nga klerikët sauditë, që zbatojnë ligje që dhunojnë dhe fyejnë gratë, ose nga Vëllazëria Myslimane që ishin të lumtur të zbatonin urdhrat shtypëse të 'Sheriatit Islamik', *Ennahda* mbron të drejtat e grave dhe ligjëron mundësi të barabarta në Kushtetutën e 2014-ës. Pothuajse një e treta e Kuvendit të saj përbëhet nga përfaqësuese femra. Në vitin 2010, një e treta e gjyqtarëve dhe një e pesta e avokatëve në vend ishin gra. Në vitin 2013, një e treta e inxhinierëve në vend ishin gra. Janë mbi 700 shoqata të shoqërisë civile, që punojnë për ngjizjen e një shoqërie civile, duke përfshirë çështjet gjinore, ngacmimin seksual dhe dhunën ndaj grave.<sup>11</sup> Në vitin 2016, *Ennahda* parashtroi një projekt-ligj risi në Kuvend, për të forcuar ligjet kundër ngacmimit seksual dhe dhunës ndaj grave, duke mbuluar kështu edhe dëmtimet mendore dhe ekonomike në jetën shoqërore e shtëpiake. Ndryshe nga largpamësia e huazuar e Arabisë Saudite që e detyron shoqërinë, Tunizia po ngjiz një përfytyrim për të ardhmen e saj, i cili buron nga themelet, përfshin të gjitha palët e shoqërisë, kërkon të kapërcejë mosmarrëveshjet, pranon ndërlikimin dhe shumësinë. Si i tillë, është kthyer në një mjet më të mirë lundrimi në ujërat e rrëmujshme të kohëve pasnormale.

11 Harriet Sherwood, 'Women in Tunisia Take Gender Fight to Legislature', *The Guardian*, 24 Tetor 2016.



Dallimi midis Tunizisë dhe Egjiptit, siç pasqyrohet në përpjekjet e tyre përkatëse për të hartuar një kushtetutë të re, është në thelb një ndryshim i mënyrës së të menduarit dhe një vlerësim i gjendjes panormale. Egjipti është rikthyer nën kthetrat e sundimtarëve dhe përballet me mundësinë e një lufte civile, pikërisht për shkak se udhëheqësit e Vëllazërisë Myslimane u mundën brenda kuadrit të ngjeshur të mendimit islam, i cili kurrë nuk ka qenë në gjendje të merret me larminë dhe shumësinë. Është një strukturë drejtvizore që shmang ndërlikimin. Arabia Saudite është thellësisht e përcaktuar në një rrugë të ngjashme, tashmë e rënduar me një dozë helmuese të ekonomisë neoliberalë. Qëndrueshmëria e Tunizisë, edhe pse mund të jetë pak e lëkundur, vjen nga vetë fakti se ajo ka përqaftuar larminë dhe shumësinë e qytetarëve të vet, si dhe ka vendosur ndërlikimin në zemër të qeverisjes.

Vështirësitë e kohëve pasnormale thjesht nuk mund të zgjidhen pa shumicën e vërtetë, ose pa kapërcyer dallimet e rrënjosura thellë në shoqëri. Për fat të keq, për ata që janë më të shqetësuar dhe të dhënë pas 'Islamit', që rrahin gjoksin dhe bërtasin më shumë për 'mbrojtjen e tij' dhe të 'Sheriatit Islamik', është vetë Islami ai që paraqet rrezikun më të madh. Ndërlikimi na tregon se asnjë mënyrë e vetme e të menduarit, mënyrë sjelljeje, apo metode, nuk mund të japë një përgjigje për të gjitha sëmundjet tona të ndërlikdhura e të ndërlikuara. "Tregu i lirë" është një vegim, sa ç'është mendimi se laicizmi liberal, ose disa pikëpamje të pandryshueshme të idealizuara të Islamit, do të na shpëtojnë nga ngërçi i tanishëm. Prandaj është marrëzi ta vendosim besimin tonë në duart e një ideologjie të vetme, ose një pikëpamjeje të pandryshueshme ndaj të vërtetës. Larmia dhe shumësia janë thelbësore, si për të kuptuar, ashtu edhe për t'u marrë me ndërlikimin dhe për të zgjidhur çështjet tona të ndërlikdhura.

### **NË KOHËT PASNORMALE NUK KA MËNYRË PËR TA NDËRTUAR RENDIN MORAL, PËRVEÇSE MBËSHTETJES TE BARAZIA DHE MIRËKUPITIMI.**

Kundërshtitë na mësojnë të pranojmë dhe vlerësojmë këndvështrime të ndryshme dhe të jemi të përlulur. Nuk ka përgjigje krejt të drejta ose krejt të gabuara për asnjë çështje të caktuar. Edhe një kuptim shumë themelor i një çështjeje kërkon një rrahje mendimesh të gjithanshme, duke përfshirë një gamë të tërë pikëpamjesh e qëllimesh, që përfshijnë ato të qytetarëve të



besimeve të ndryshme, myslimanëve të bindjeve të ndryshme, burrave, grave e fëmijëve, njerëzve të ndryshëm të shoqërisë, me prejardhje kulturore dhe mendime të ndryshme morale. Meqenëse mosmarrëveshjet nuk mund të zgjidhen, ne duhet të lëmë mënjanë dallimet tona dhe të zotërojmë mosmarrëveshjet dhe ndërlikimin, përmes marrjes vesh me mirëkuptim, ku të gjithë pjesëmarrësve u jepet një zë i barabartë. Nuk ka mjete shtypëse ose të dhunshme për të zgjidhur mosmarrëveshjet, apo për t'u marrë me ndërlikimin.

Pothuajse të gjitha shtetet e Lindjes së Mesme janë në buzë të greminës. Ato, ose do të shemben tërësisht – nëse nuk e kanë bërë tashmë, ose do të tjetërsohen në një rend të ri ekzistence. Gjithçka varet nga mënyra se si çdo shtet e kapërcen ndërlikimin dhe çoroditjen e kohëve pasnormale në mënyrën e tij të veçantë, sipas rrethanës së vet të posaçme.

The background is a solid blue color. Overlaid on this background is a repeating pattern of black line-art swans. Each swan is depicted in profile, facing right, with its long neck curved downwards and then upwards. The swans are rendered in a simple, elegant style using only black outlines. The pattern is dense and covers the entire page.

# JETA DHE VEPRAT







## Loja e pushteteve fetare

*C. Scott Jordan*

Pavarësisht nëse ne besojmë diçka apo jo, kur bëhet fjalë për mbrojtjen e trevës sonë të vogël e të shenjtë, duket sikur marrim një qëndrim të qartë. Kush e ka ushqyer këtë ndryshim të zjarrtë? Kush i qëndroi besnik ideologjisë që në fillim, për t'u shndërruar në *Brutin* e saj? Vetëm një fjalë, një emër, i shqiptuar përmes këngës, rreshtave, pamjes dhe përditshmërisë që rrezaton që nga kohërat e lashta dhe që mirëpritet edhe në ditët e sotme. Zoti. Një Zot i veçantë? Jo! Është feja vetë, me gjithë morinë e saj të përfaqësimeve që kanë përshkuar shoqërinë, mendjen dhe jetën në përgjithësi. Në kundërshtim me përrallat e Rilindjes dhe pasmodernizmit, Zoti është shëndoshë e mirë - Ai është në xhepat tanë, në qeverinë tonë, në politikën, në kulturën dhe në zemrat tona. Që nga më i përkushtuari e deri te mohuesi më i ngurtë, Zoti është po aq pjesë e identitetit tonë, sa ç'është numri i kartës së sigurimeve shoqërore.

Në pamje të parë, kjo nuk ofron shqetësim të menjëhershëm. Në fund të fundit, ne jetojmë në stërhollimet e shekullit të XX-të. Ju keni mendimet tuaja dhe unë kam të miat, derisa unë vendos të të vras ty. Kjo mospërputhje përfundimtare u fanitet vrasjeve politike, sulmeve në qendrat fetare, të shtënave në shkolla, luftërave, kampeve verore, sulmeve vetëvrasëse, ISIS-it dhe zgjedhjeve politike. Një fjalë e urtë thotë se “mashtrimi më i madh që ka bërë dreqi, ishte ta bindte botën, se ai nuk ekzistonte”. Në ditët tona, feja ia ka dalë mbanë të bëjë pikërisht të njëjtën gjë. Ne mendojmë se jetojmë në një epokë laike, megjithatë Zoti është kudo.

Një shkollë dijesh të caktuara mendon se i gjithë trillimi duhet të jetë një arratisje nga vërtetësia e përditshmërisë gërryese. Por, ndonjëherë, “arratia” nga trillimet është gati e mjaftueshme edhe për të zbuluar njohuri



të thella mbi vërtetësinë jetësore ndaj të cilës ne vetë jemi të verbër, teksa ngrysim ditët tona. Kjo pikë sqarohet më së miri, përmes serialit të mirënjohur televiziv, *Loja e Pushteteve*, dhe serisë së librave të shkrimtarit George R.R. Martin, në të cilën është mbështetur.<sup>1</sup> Bota që Martin krijoi, nderon dhe hulumton fenë ashtu siç është në jetën e përditshme, pa e fshehur atë nën rrogos, si shumica e veprave të tjera mbështetur në fantazi.<sup>2</sup> Martin nuk e mbivendos Krishterimin, Islamin apo Hinduizmin në botën e tij të përfytyruar, por, në vend të tyre, krijon një botë besimesh fetare, idealesh mitologjike dhe politike që hahen me njëra-tjetrën dhe që i nënshtrohen mashtrimit të pasurisë, familjes dhe pushtetit. Duke vepruar në këtë mënyrë, në të vërtetë, ai e ka fjalën për ndërveprimet fetare të botës sonë dhe mosmarrëveshjet që lindin në 'të.

Ngjarja e titulluar "Çfarë është i vdekur, nuk mund të vdesë kurrë", nga stina e dytë e serialit, hulumton posaçërisht temat e këtij ndërveprimi. Që nga fillimi e deri në rrokullisjen e titrave në fund, shohim shembuj të mrekullueshëm të ngjarjeve që ndryshojnë norma, të cilat tronditin rrjedhën e rrëfimeve, duke e çuar atë në drejtime të pamatshme, ndërsa seriali ecën përpara. Ne shohim një grua të mposhtë një nga kalorësit më të mëdhenj meshkuj, në një vend të ndërtuar kryesisht mbi hierarkinë patriarkale; vëllai më i vogël që pretendon të drejtën e tij për një fron të ndërtuar pikërisht në këtë hierarki; ndërsa dukuritë fetare e mistike fillojnë të zvarriten në një botë që tani njihet si pa magji (ndërkohë që perënditë ecin mes njerëzve, njerëzit kontrollojnë trupat e kafshëve, ose dragonjtë kanë mundësinë të shkelin përsëri në tokë). Prej kësaj lindin tema që tregojnë se kontinenti *Westeros* dhe pjesa tjetër e botës së Martinit po ecin drejt kohëve pasnormale.

Në një skenë të veçantë, një nga personazhet kryesore, Tyrion Lanister, një xhuxh i cili në këtë pikë është gjithashtu dora e djathtë, ose Kryekëshilltar, i Mbretit të *Westeros*, përballet me një të panjohur që përfshin në vetvetë rrënjët e pushtetit të botës së Martinit. Gjëgjëza përhapet nga kryespiuni Varys, një tjetër anëtar i Këshillit të Mbretit. "Tre burra të mëdhenj ulen në një dhomë: një mbret, një prift dhe një i pasur. Midis tyre qëndron një shpatë në shitje. Secili prej tyre vë bast që shpata në shitje të vrasë dy të tjerët. Kush jeton? Kush vdes?" Pasi tregon gjëgjëzën e tij, Varys pret me padurim, ende pa përgjigjen e Tyrion-it. Tyrion, në vend të përgjigjes, shfaq pakënaqësi, ngaqë ka çështje shumë më të ngutshme në mendjen e tij dhe

1 George R.R. Martin, *A Game of Thrones (A Song of Ice and Fire, Book 1)*, (Harper Voyager, New York, 2014); Home Box Office, New York, 2012.

2 George R.R. Martin, Elio M. Garcia, Jr. dhe Linda Antonsson. *The World of Ice & Fire: The Untold History of Westeros and the Game of Thrones* (Bantam Books: New York, 2014).



pranon humbjen. Varys i përgjigjet me një mësim të mençur: 'Fuqia prehet aty ku njerëzit besojnë se ajo prehet. Është një rreng, një hije në mur dhe një njeri shumë i vogël mund të lëshojë hije shumë të madhe'.

Varys ia ka shpjeguar gjendjen pasnormale të Shtatë Mbretërive, dorës së tij të djathtë, por, gjithashtu, na ka dhënë edhe ne një pasqyrim jetësor mbi fenë në ditët tona. Natyrisht, feja dhe pushteti kanë ecur dorë për dore gjatë historisë. Rilindja, moderniteti, laicizmi dhe, së fundmi, pasmodernizmi, e hodhën 'rrëfenjën madhështore' të fesë në koshin e plehrave të historisë. Por feja është rikthyer tani për të marrë një vend të rëndësishëm: si një fuqi dhe si një sistem përqaqshesh dhe vendimmarrjesh. Por, gjithashtu, diçka e çuditshme ka ndodhur. Falë mediave shoqërore, kanaleve të lajmeve 24-orëshe dhe mënyrave të tjera të ndërlidhjes së menjëhershme,

### **BURRAT E VEGJËL TANI MUND TË LËSHOJNË VËRTET HIJE BOTËRORE TË MËDHA.**

Le të marrim parasysh, për shembull, Uratën Fred Felps dhe ndjekësit e tij, të njohur si Kisha Baptiste Uestboro. Ata janë të njohur për tubimet e tyre të tepruara dhe nxitëse kundër varrimeve dhe ngjarjeve të tjera, në mbështetje të anëtarëve të shërbimit ushtarak dhe bashkësisë LGBT. Nëpërmjet shpjegimit të tyre të mirëfilltë të Biblës, ata kanë arritur në përfundimin, se të qenit anëtar i LGBT-së, ose t'ia kushtosh jetën shërbimit ushtarak, është një fyerje ndaj Zotit dhe një biletë e shpejtë për në Ferr. Ata, madje, kanë shkuar aq larg, sa gjoja të besojnë se këto raste janë shkak i drejtpërdrejtë i fatkeqësive natyrore (si uragani Katrina, në vitin 2005) dhe rreziqet e përgjithshme për Amerikën (sulmet e 11 shtatorit 2001, fjala vjen). Kur vdiq Felps, kjo kishë u tha se kishte 40 anëtarë.<sup>3</sup> Felps nuk është aspak e vetmja kishë rrënjësisht e krishterë radikale në Amerikë dhe, ndryshe nga bashkëkohësit e saj, ka arritur të tërheqë më shumë vëmendjen e Amerikës dhe botës. Kështu, ka arritur të gjallërojë një fuqi të madhe. Çdo veprim që ata ndërmarrin, bëhet një mega-ngjarje e menjëhershme, falë Twitter, Facebook dhe mediave të uritura për të mbushur vendet e tyre me shkrime të bujshme. Me veprimet e tyre, ata i kanë krijuar mbarë botës një përshtypje të përgjithshme, se të gjithë anëtarët e bashkësisë së krishterë, që numërojnë rreth dy miliardë në

3 Michel Paulson, "Fred Phelps, Anti-Gay Preacher Who Targeted Military Funerals, Dies at 84." *The New York Times*. 20 Mars, 2014.



botë, sillen në një mënyrë të tillë. Edhe brenda vetë krishterimit, veçanërisht në Amerikë, shembulli i Kishës Baptiste Uestboro ka lënë një njollë të errët mbi të gjithë ndjekësit e emërtimit të posaçëm baptist dhe ndarjes më të lartë të Protestantizmit. Baptistëve anembanë vendit u është dashur të bëjnë hapa të mëdhenj për ta ndarë besimin e tyre baptist nga thirrjet e Uratës Felps. Kjo është tmerrësisht çoroditëse, për jo të krishterët. Zbërthimi i gjithë ngrehinës së sistemit bëhet më i dukshëm; ai është në të njëjtin nivel me krahasimin e përkushtimit të dikujt ndaj shtetësisë amerikane, mbështetur vetëm në mendimin për presidentin William Henry Harrison (i cili zgjati vetëm tridhjetë ditë).

Urata Tery Johns na jep një shembull tjetër. Johns ishte një prift i *Dove World Outreach Center*, një kishë që pranon të gjitha rrymat e krishtera në Gainesville, Florida. Ai ishte njëri prej shumë të krishterëve anti-islamike që njoftoi se një ditë do ta djegë Kuranin.<sup>4</sup> Synimi i tij u shndërrua menjëherë në një ngjarje botërore. Pamjet e Uratës me këtë deklaratë u përsëritën pa fund në kanale lajmesh të ndryshme. Botimet në Twitter ishin të papërmbajtshme. Brenda pak orësh nisën tubimet në Egjipt, Pakistan dhe Malajzi. Autobusët u dogjën, *Mc Donald's* u plaçkitën, madje disa njerëz u vranë. Hillary Clinton, atëherë Sekretare e Shtetit, iu desh t'i telefononte Uratës Johns dhe t'i lutej që të mos e kthente synimin e tij në një veprim të vërtetë. Nëpërmjet veprimeve të tij, Johns, i cili kishte pak më shumë se njëzet ndjekës, dhe nëpërmjet shpejtësisë me të cilën teknologjia e ndërlihdjes e ktheu synimin e tij në një dukuri botërore anti-islame, jo vetëm që u bë një ide e krishterë, por një ndjenjë mbarë amerikane, europiane dhe, përgjithësisht, perëndimore në sytë e të huajve. Johns nuk e realizoi veprimin duke djegur Kuranin, ndaj është e paqartë, nëse ai kishte ndonjë qëllim për ta bërë një veprim të tillë.

Ajo çfarë ne shohim me sytë tanë, nuk është thjesht një ndryshim i mënyrës së sjelljes, por një rindërtim themelor i asaj që është dhe çfarë nuk është normale në fe. Shtrirja e ekstremistëve, fanatikëve të mirëfilltë, puritanëve dhe adhuruesve të dhunshëm, të cilët normalisht do të gjallojnë në rrethina, është zgjeruar dhe është bërë botërore, si në përmasa, ashtu edhe në shtrirje. Vetëm dy dhjetë vjeçarë më parë, do të ishte praktikisht e pamundur, që këta njerëz të përçonin mendimet e tyre. Sot, ata kanë kanalet e tyre televizive dhe mund të ngarkojnë përmbajtjen e tyre në You Tube për t'i shpërndarë menjëherë në mbarë botët.

Është qesharake, kur, ndërkohë që ne jemi vazhdimisht të lidhur me bashkësinë virtuale, bashkësitë në jetën e vërtetë pothuajse janë zhdukur.

4 Paul Harris dhe Paul Gallagher. "Terry Jones defiant despite murders in Afghanistan over Qur'an burning." *The Guardian*. 2 Prill, 2011.



Në vend që të flasin me njëri-tjetrin ballë për ballë, njerëzit gjithnjë e më shumë parapëlqejnë të merren vesh me shkrim në Facebook, Twitter dhe shumë teknologji të tjera të rrjeteve shoqërore. Në mungesë të bashkësisë, të rinjtë po tjetërsohen gjithnjë e më shumë. Përballë pasigurisë në rritje, të shkaktuar nga ndryshimi i përshpejtuar, ata dëshirojnë vetëm sigurinë. Në një botë vlerash të dyshimta dhe të pasigurta, ata kërkojnë dhe pastaj zmbarsen tërësisht. Në një epokë ku kuptimi është shfuqizuar, ata e kërkojnë kuptimin në jetët e tyre gjithnjë e më të tjetërsuara, të pasigurta dhe të paqarta. Mosmarrëveshjet e jetëve pasnormale te të rinjtë e sotëm shfaqen në titujt që i bëjnë jehonë shqetësimit të gjëgjëzës së Varys-it. Le t'u hedhim një sy këtyre titujve:

**Z. YAKEN DONTE TË BËHEJ MËSUES GJIMNASTIKE. AI U STËRVIT PA NDËRPRERË, ME SHPRESËN SE PËRPJEKJET E TIJ DO TË SILLNIN SUKSES, DASHNORE DHE PASURI...**<sup>5</sup>

**AJO DËGJON GRUPIN MUZIKOR COLDPLAY, LEXON NOVELA TË HERRY POTTER DHE I PËLQEN TË PIJË IRN BRU, NJË PIJE SKOCEZE PA ALKOOL...**

**AJO ISHTE NXITËSE TIFOZËSH, STUDENTE NDERI, E BIJA E NJË POLICI DHE ANËTARE E KËSHILLIT TË MIKPRITJES NË SHKOLLË, QË DONTE TË BËHEJ MJEKE...**

**AJO DËSHIRONTE TË BËHEJ FARMACISTE OSE MJEKE...**<sup>6</sup>

**AI ISHTE STUDENT I PSIKOLOGJISË, I HESHTUR, POR I SHKUJDESUR...**<sup>7</sup>

Këto, mesa duket, janë përshkrime mjaft të veçanta të një brezi që pritej të ishte i tillë, i njohur edhe si mijëvjeçarët. Ata ndajnë qëllime të qarta për të ardhmen, përfshirjen në shkollë, edukimin e shtresës së mesme dhe mençurinë e dukshme. Ata ndryshojnë sa i përket prejardhjes së tyre. Thënia e parë përshkruan z. Islam Yaken nga Kajro, Egjipt. E dyta përshkruan zonjën

5 Mona El-Naggar. 'From Cairo Private School to Syria's Killing Fields.' *The New York Times*, 19 Shkurt, 2015.

6 Kimiko De Freytas-Tamura, 'Teenage Girl Leaves for isis, and Others Follow.' *The New York Times*, 24 Shkurt, 2015.

7 Richard Fausset, 'Disbelief in Mississippi at How Far isis' Message Can Travel.' *The New York Times*, Gusht 14, 2015.



Aqsa Mahmood nga Gllasgou, Skoci. Dy të fundit janë znj. Jaelyn Young dhe z. Muhammad Dakhllalla nga shteti i Misisipit, në Shtetet e Bashkuara. Ata kanë edhe një gjë tjetër shumë të rëndësishme të përbashkët: të gjithë dëshironin të largoheshin nga shtëpia për në Siri, për t'iu bashkuar ISIS-it. Por këta studentë nuk janë vetëm. Kjo nuk është thjesht një dukuri e të shtypurve, të mënjanuar në një qoshk të vogël të Tokës. Është dukuri botërore dhe është një pjellë qartësisht e kohëve tona pasnormale, ku vrima në trajtën e Zotit në mendjen e njerëzve mund të mbushet vetëm me diçka të bujshme.

Normalisht që prirjet e ndjekura nga shoqëritë e pasura dhe të arsimuara duhet të tregojnë një zvogëlim të ndikimit të fesë apo institucioneve fetare. Përkufizimet klasike të fesë e bënë atë një frutë të pjekur për të varfrit dhe të paarsimuarit, një formë fuqizimi. Megjithatë, ndërsa shoqëria u bë më e 'përparuar', doket dhe parimet u lakuan në emër të përparimit. Zoti, në njëfarë kuptimi, është provuar pasi njeriu mori nën zotërim fatin e tij dhe krijoi për vete një botë robotike, zgjuarsi kompjuterike, vërtetësi të përafërt, përparime mjekësore dhe Twitter. Aty ku Zoti dikur ishte pajtimi për vdekshmërinë e njerëzimit, është shkenca dhe teknologjia tani që e mbushin atë zbrazëti ankthi dhe kërkimi.<sup>8</sup> Zoti, për të gjitha synimet dhe qëllimet, duhet të ishte zbehur si çdo teori, shembull apo prirje e modës së vjetër. Por Zoti është kthyer me kamxhik dhe veprimet e ndërmarra nga këta të rinj, thjesht nuk kanë asnjë kuptim për shumicën e njerëzve. Kjo dukuri nuk ka lidhje me Islamin. Ajo vlen për të gjitha fetë. Vini re, se sa të gatshëm janë fundamentalistët e rinj hindu në Indi për të vrrarë dhe për t'u vrrarë! Ose rinia e djathtë fetare në Europën Lindore, ose fundamentalistët e krishterë në Afrikë dhe ungjilltarët me armë në SHBA. Ata janë të gjithë po aq të prirë, sa ç'janë edhe të tjerët për të krijuar shtetet e tyre fetare në vendet e tyre.

Pasiguria i ka copëzuar fetë, përtej ndarjeve tradicionale. Në Westeros-in e *Lojës së Pushteteve*, ka disa fe që fillojnë me më mbizotëruesen nga Shtatë Mbretëritë, Besimin e Shtatë, në të cilin, ashtu si te trinia e Krishterimit, besimtarët luten për shtatë brenditë e thelbit të një perëndie. Para se Besimi i Shtatë të sillej nga pushtuesit e huaj, Westeros besonte kryesisht në disa perëndi, të ngjashëm me fetë vendase amerikane dhe Shinton vendase japoneze, të cilat vendosin një perëndi në të gjitha anët e natyrës, që nga qiejt, toka dhe detet. Këtyre perëndive 'të vjetra' u luten ende gjerësisht familjet e lashta të Veriut, si Starks, në kohën e rrëfenjës së Martinit. Zoti i mbytur i Ishujve të Hekurt lavdërohet gjatë përlëshjeve, në një dallim të theksuar me Perëndinë e stuhisë së atdheut të mbretit Robert, të quajtur

8 Mathew Burrows, *The Future Declassified: Megatrends that Will Undo the World Unless We Take Action* (Palgrave MacMillan, New York, 2014). f. 65–80.



me vend, *Tokat e Stuhisë*. Madje zbulohet se një nga vëllezërit e mbretit Robert është kthyer në një fe krejt tjetër të Lindjes, Besimi i Zotit të Dritës, *R'hllor*. Ky është një grup fetar thelbësor, i ndërtuar mbi një zot që ndriçon botën kundër errësirës dhe me dhunë krijon një rend të ri botëror. Në Lindje përmenden perëndi të tjera që rrjedhin nga degëzime kulturore ose gjeografike të rrënjëve të tyre. Thuajse si një shaka, ose për të na e sjellë ndër mend një pikë të shumëpërfolur mbi fenë në përgjithësi, Martini na i jep njerëzit pa fytyrë dhe shërbëtorët e Zotit me shumë fytyra. Ndryshe nga fetë e tjera të botës së Martinut, burrat pa fytyrë janë vrasës të heshtur, në kundërshtim me ushtruesit e Ungjillit të një, apo tjetër lloji. Ithtarët e Zotit me shumë fytyra nuk kundërshtojnë asnjë nga perënditë e tjera. Në fakt, tempulli i tyre është i veshur me ikonathyes të perëndive të tjera. Sipas tyre, të gjithë po adhurojnë të njëjtin zot, të njëjtin zot me shumë pikëpamje. Ky Zot shpesh përmendet si *Vdekje*.

Ndarjet dhe ndërlikimi i feve në jetën e vërtetë pasnormale janë po aq të frikshme. Shumë zhurmë është bërë lidhur me ndarjen *Shia-Sunni* në botën myslimane. Por, siç tregon Fredrik Ueri<sup>9</sup>, në antologjinë e tij të përshatur, ndarjet sipas besimeve të posaçme brenda Islamit, në Lindjen e Mesme, janë bërë shumë më të ndërlikuara. Përqasja ekonomike, rrjetet shoqërore, veprimtaria shtetërore dhe joshetërore, udhëheqësit fetarë joshës dhe besnikëria fisnore kanë prodhuar veçori sektare vërtetë befasese. Sekti, me rrënjët e tij të thella historike, por jo qytetaria, shërben si porta kryesore midis njeriut dhe shtetit. Në SHBA, sektet dhe ndarjet e krishtera po rriten dita-ditës, duke filluar nga zionistët e krishterë që duan fundin e botës dhe e duan atë TANI, deri te grupe të panumërta ungjillore, të vjetra dhe të reja. Nëse i hedhim një sy renditjes së emërtimeve të krishtera në Wikipedia, do të habitemi. Kjo, përpara se të përmendim “çudi” të tilla, si Shkencologjia, Epërsia e Myslimanëve Afrikanë, Kisha e vdekjes së vullnetshme (e cila kërkon të vrasim veten për të shpëtuar planetin), Kisha e Subgjenit, Kisha e të Gjithë Botëve, Kombi i Jahuve, Lëvizja Krijuese dhe Tempulli i Mendësisë Rinore, të përkushtuar ndaj joshjes së pafajshme. Pothuajse kushdo, me pak dhunti shpirtërore dhe një llogari në Facebook, mund të fillojë një fe të re dhe atij (sepse zakonisht është mashkull) nuk do t’i mungojnë ndjekësit.

Feja është një fjalë e këndshme, e mundimshme dhe jo e lehtë për t’u përcaktuar. A është Shkencologjia një fe? A mund të thuhet se ndjekësit e një njeriu të famshëm të caktuar, të cilin ata e çmojnë pa diskutim, po

9 Frederic Wehrey, editor, *Beyond Sunni and Shia: Sectarianism in a Changing Middle East* (Hurst, Londër, 2017).





ndjekin një fe? A janë fetarë ata që vrasin në emër të fesë? Këto janë pyetje të ndërlikuara që nuk mund t'u përgjigjesh lehtë. Nuk është çudi, që humlumtuesit bashkëkohorë të fesë shmangin pyetjen: “Çfarë është feja?”, apo “Çfarë është fetare?”

Vetë fjala është bërë tepër e ndërlikuar, duke u mbështjellë me ide të paramenduara, duke bërë çdo përpjekje për ta zbërthyer atë si të kotë dhe ndoshta të pafrytshme.<sup>10</sup> Merrni, për shembull, rrahjen e mendimeve rreth asaj se çfarë është saktësisht Budizmi. Sipas David Brazier, psikoterapist britanik dhe mjeshtër i Budizmit indian e japonez, Budizmi është një fe, si Krishterimi dhe Islami, ‘dhe mund të besosh’.<sup>11</sup> Por, sipas Stiv Hagen (i njohur ndryshe si Roshi), Budizmi amerikan, apo Budizmi në tërësi nuk është fe; është “përtej besimeve” dhe ka të bëjë me të parët e botës në çdo çast.<sup>12</sup> Të dy janë barazisht të aftë të flasin për Budizmin dhe asnjëri nuk është në gjendje t'i përgjigjet pyetjes në mënyrë bindëse. Gracka e përqasjeve përfundimtare është se, kur feja shqyrtohet, ajo e gjen veten të veçuar në një zbrazëti, mirëpo, si çdo gjë tjetër në këtë botë, feja nuk ekziston në boshe. Një qasje pak më ndryshe ngre pyetje në lidhje me thelbin e fesë. Për shembull, dikush mund të shtrojë pyetjen, sipas Martin Kreig: A është feja në vetvete e dhunshme?<sup>13</sup>

Por as nga kjo nuk marrim dot një përgjigje të kënaqshme. Disa qasje të një feje mund të jenë të dhunshme në një kohë të caktuar, por ato mund të mos jenë të dhunshme në një kohë dhe vend tjetër.

**MARRËDHËNIET MIDIS FESË, SHTETIT DHE PUSHTETIT JANË BËRË AQ TË NDËRTHURURA, AQ TË NDËRLIKUARA, SAQË ËSHTË E VËSHTIRË – NËSE JO KREJT E PAMUNDUR – TË KUPTOHEN QARTË.**

Mendimtarët bashkëkohorë e shohin fenë nga një këndvështrim që e vendos atë në një rrethanë historike dhe shoqërore-kulturore. Prifti dhe teologu katolik zviceran, Hans Kung, e renditi fenë në të njëjtën mënyrë që Tomas Kun renditi shkencën - si një vargëzim epokash<sup>14</sup>, Një epokë jeton

10 Caroline Schaffalitzky de Muckadell, ‘On Essentialism and Real Definitions of Religion’, *Journal of the American Academy of Religion*, Vol. 82, No. 2, Qershor 2014, f. 495–520.  
11 David Brazier, *Buddhism is a Religion: You Can Believe It* (Woodsmoke Press, Malvern, 2014).  
12 Steve Hagen, *Buddhism is Not What You Think: Finding Freedom Beyond Beliefs by Steve Hagen* (Penguin, New York, 2012).  
13 Craig Martin, ‘What is Religion?’ *Political Theology*. Vol. 15, Nr. 6. Nëntor 2014. f. 503–508.  
14 Hans Küng, *Theology for The Third Millenium: An Ecumenical View*. Translated by Peter Heinegg (Doubleday, New York, 1988).



derisa një revolucion të hedhë poshtë idenë e vjetër dhe një e re vjen për të mbushur zbrazëtinë e kuptueshme. Kung e përkufizoi fenë si një grup të thjeshtë besimesh, rregullash dhe morali, që e çojnë atë drejt përfundimit, se hapi i ardhshëm është një moral mbarëbotëror, ku parimet themelore të të gjitha feve do të mund t'i mbijetojnë 'moçalit pasmodern'.<sup>15</sup>

Studiuesi post-kolonial, Talal Asad, qasjen e çështjes së fesë e lidh me shoqërinë njerëzore, kulturën dhe zhvillimin e saj. Në librin e tij, *Prejardhja e Fesë*, Asad shqyrton natyrën 'ndër-historike' dhe 'ndër-kulturore' të fesë. Mendësia e tij është mosbesuese në shumë drejtime. Ai është i lodhur nga përjasjet bashkëkohore ndaj historisë (ngaqë kryesisht është një marshim kapitalist perëndimor, drejt një sistemi botëror), idesë viktoriane se feja është zanafilla zhvillimore e mendimit të përparuar (si politika dhe shkencë) dhe idesë bashkëkohore se feja është diçka paraprake, që u zëvendësua nga të qytetëruarit, për sa i përket ligjit, politikës dhe shkencës.<sup>16</sup> Asad e përqendron përkufizimin e tij të fesë në hetimin e qasjes së dukurive që ofron antropologu Clifford Geertz, i cili përqendrohet në shenjat dhe të krenitet fetare. Mendimi përfundimtar është një pyetje e llojit *pula apo veza*, mbi kuptimin dhe ushtrimin, ose kuptimin dhe vetë sendin. Për ta thënë pak më thjesht: A ka kuptim një simbol fetar, apo kuptimi fetar sjell simbolin? Në të njëjtën mënyrë: A është krentimi ushtrim i një kuptimi të caktuar, apo krentimi ka marrë kuptim përmes ushtrimit të tij?<sup>17</sup> Këto pyetje duken ndihmëse, por, në fakt, janë kyçe, kur shqyrtohet ngritja e fundamentalizmit në Islamin dhe Krishterimin bashkëkohor. Ato tregojnë një pakuptimësi të qenësishme midis ushtrimit dhe besimit, si dhe ngatërrimit historik të politikës, kulturës e fesë. Ndoshta të njëjtat ecuri historike kanë çuar në shfaqjen e fundamentalizmit fetar hindu, budist, hebre dhe të tjerë.

Karen Armstrong përdor të njëjtën qasje historike në librin e saj, *Tjetërsimi madhështor*, duke filluar me fetë e epokës boshtore (900-200 f. e.s.). Për Armstrong-un, ideja themelore e fesë është dhembshuria. Në kohën kur njerëzit ndjenë për tjetrin, lindën fetë boshtore. Vështrimi kryesor që ajo paraqet, është se, ndërsa format më të reja të përparuara të këtyre feve hasën në vështirësi, ato u kthyen përsëri te themelet boshtore ende të paprekura. Armstrong tregon se dëshira për perandori dhe pushtet politik shënon pikën e thyerjes së këtyre modeleve fetare. Receta e saj për të ecur përpara është kthimi mbrapa te fetë boshtore (arsyeja greke, Hinduizmi/Budizmi,

15 Hans Küng, *Global Responsibility: In Search of a New World Ethic* (Crossroad Publishing Company, New York, 1991).

16 Talal Asad, *Genealogies of Religion: Discipline and Reasons of Power in Christianity and Islam*. (The Johns Hopkins University Press, Baltimore, MD, 1993) f. 2-27.

17 Po aty, f. 28-55.



Daoizmi/Konfucianizmi dhe Judaizmi), kërkimi i një emëruesi të përbashkët (p.sh. Duaje fqinj të tënd!) dhe gjetja e parimeve themelore që qëndrojnë në themel të këtyre feve qendrore.<sup>18</sup> Ky këshillim mund të merret si një metodë për të lundruar në kohët e tanishme pasnormale nga ana e mendimit fetar, mirëpo lypset të tejkalojë idenë se “Feja ime është e vetmja fe e vërtetë”.

Arsyetimi i Kung-ut, Asad-it dhe Armstrong-ut tregojnë se feja shpesh shprehet si një besim në vetvete: jo vetëm një besim në të mbinatyrshmen, por edhe një besim në bindjen e dikujt për zotërimin e së vërtetës së pamohueshme. Besimet e tepruara në vetvete shpërfaqen si lëvizje të tepruara në vetvete, që synojnë të formësojnë botën. Dhe kështu, feja del jashtë kufijve të besimit dhe bëhet një mënyrë vendimmarrjeje. Në mënyrë të pashmangshme, feja shkon drejt mosmarrëveshjes me ecuritë e tjera të vendimmarrjes, si politika, shkenca, shteti dhe laicizmi. Në rrethana normale, mund të ketë një ndarje të “Kishës” dhe “Shtetit” – diçka njaft e dobishme për disa shekuj në qytetërimin perëndimor. Por gjërat ndryshojnë rrënjësisht në kohë trazirash, pasigurie, ndërlikimi dhe çoroditjeje. Tani, feja bëhet burimi i vetëm i sigurisë për besimtarët; jo vetëm feja në kuptimin gjithëpërfshirës, por siguria kërkohet në sektin e veçantë të dikujt. Nëse të gjitha sektet nuk ofrojnë sigurinë e kërkuar, krijohen sekte të reja, të mbështetura rreth fiseve, bashkësive, lidhjeve historike, besimeve politike, ankesave, të huajve apo udhëheqësve me dhunti shpirtërore për të mbushur zbrazëtinë. Vetja dhe Besimi bëhen një dhe e njëjta gjë, pasi Vetja ngulitet thellë në fe. Sulmi ndaj fesë nuhatet si sulm ndaj Vetes, braktisja e parimeve fetare në shoqëri shihet si humbje e Vetes. Vetja e humbur është një gjë e rrezikshme, është ajo që çon në grupe ekstremiste në Lindjen e Mesme, ose fundamentalizëm që gjendet në Shtetet e Bashkuara dhe Europë.

Kjo është ajo që kohët pasnormale i kanë shkaktuar fesë. Kur ngjarjet që janë pjellë e mosmarrëveshjeve dhe ndërlikimit pikëtakohen në rrugën drejt çoroditjes, krijohet një gjendje pasigurie pështjelluese dhe padije të thellë. Fetë tradicionale nuk mund ta përballojnë. Në të vërtetë, parimet themelore dhe dogmat kryesore të fesë, shembujt e saj, fillojnë të shpërbëhen. Kjo prodhon një gjendje krize e cila ushqehet me vetveten, duke gjallëruar një varg krizash të tjera. Kështu, ndërlikimi brenda fesë bëhet po aq i ndërlikuar sa dhe Vetja. Madje edhe emërtimi bëhet shqetësues. Kush është mysliman apo i krishterë? Ndjekësit e përgjithshëm që e emërtojnë veten si myslimanë ose të krishterë, mund të fajësohen nga besimtarët pak ‘më të përkushtuar’, si liberalë, të zbutur, të laicizuar, apo edhe të

18 Karen Armstrong, Karen. *The Great Transformation: The Beginning of Our Religious Traditions*, (Random House, New York, 2006) f. 3–48.



pafe. Ndjekësi A beson se ushtron një fe që e ushtron edhe ndjekësi B, por, në të vërtetë, të dy ndjekësit mund t'i mbështesin besimet e tyre në korniza rrënjësisht të ndryshme teologjike ose sqaruese. Natyrisht, kur udhëheqësit ngrihen, duke pohuar të vërteta dogmatike, ndërlikimi vërshon në vetvete, duke çuar në një stuhi të çoroditur.

Nëse udhëtoni nëpër qytetet më të vogla të krahinave Perëndimi i Mesëm, të Shteteve të Bashkuara, do të vini re se kufijtë midis qyteteve përcaktohen nga rrugët e zhurmshme, me të gjitha kishat dhe baret anash tyre. Në të vërtetë, disa nga këto qytete mund të kenë një kishë të ndryshme në çdo qoshk të një kryqëzimi. Në përgjithësi, këto janë të gjitha kisha të krishtera, por ndryshojnë në emërtim dhe, nëse jeni me fat, ato mund të kenë edhe porosi të ndryshme të shkruara në pjesën e sipërme të dyerve. Pra, Kisha e Parë Baptiste mund të jetë mjaft e ndryshme nga Kisha e Dytë Baptiste, ose Kisha e Parë Metodiste, ndërsa të gjitha mund të jenë në të njëjtin kryqëzim rrugësh. Ato mund të kenë këshillat e tyre të posaçme, që jetojnë shumë afër njëri-tjetrit. Të gjithë mund të pajtohen se Jezus Krishti është biri i Perëndisë, por mund të ndryshojnë në lidhje me nderimin dhe shkallën e përkushtimit ndaj parimeve të tjera më të vogla. Kur prifti kryesor i një kishe të caktuar flet përtej foltores së tij, pohimi i tij për vullnetin e Perëndisë mund të përplasjet me predikimet e pastorëve të tjerë. Më shpesh, përplasjet kalojnë pa u vënë re. Por, ndonjëherë, shqetësime të tilla të vogla mund të çojnë në ndodhi të rëndësishme. Në kohët pasnormale, një njeri, ose një grup i vogël njerëzish, mund të ketë fuqi të jashtëzakonshme për të shkaktuar ngjarje çoroditëse. Sillni ndërmend uratën Felps apo Johns, ose fakti që vetëm 19 veta shkaktuan mizorinë më të tmerrshme në historinë e Shteteve të Bashkuara dhe sollën një zinxhir kundërvëniesh që çuan në 'luftën kundër terrorit', gjuetinë e Bin Laden-it, pushtimin e Afganistanit dhe Irakut dhe shkatërrimin e të djave, trazimin e Pakistanit dhe tmerret e shumta që shohim sot në Lindjen e Mesme. Teoria e çoroditjes në veprim!

**SECILA KISHË E NJË BESIMI TË KAKTUAR NË QOSHK TË ÇDO  
RRUGE KA MUNDËSINË PËR TË SHKAKTUAR NJË VARG NGJARJESH  
QË MUND TË ÇOJNË NË DIÇKA TË MADHE.**

Një lajmërim nga një prift vendas mund të shpërndahet në Twitter dhe mund të ketë 'prirjen' për të përcëlluar gjysmën e botës. Kanalet e lajmeve 24-orëshe mund ta merrnin këtë prirje dhe do ta kthenin atë në shumë



zhurmë për asgjë, në një ngjarje botërore me pasoja vërtet të rrezikshme. Ngjarja çoroditëse. Edhe nëse 'ngjarja' nuk bëhet botërore, ajo do të ketë një ndikim të madh në mënyrën se si një besim ose sekt i caktuar përfytyrohet nga të tjerët. Felps dhe Johns ndryshuan thellësisht përfytyrimin rreth Pagëzimit, një emërtim shumë i përhapur i Protestantizmit amerikan që mbizotëron në Amerikën e Jugut. Ata u bënë mishërimi i Pagëzimit dhe shumë njerëz që kundërshtojnë drejtpërdrejt mendimet e tyre, duhej të kërkonin falje, që të ishin baptistë, protestantë, të krishterë, madje edhe amerikanë, burra apo njerëz.

Në kohët pasnormale, kjo dukuri do të shumëfishohet: cikli i Vetvetes së humbur që thotë një fjalë të papëlqyeshme. që merret nga një tjetër dhe më pas shpërndahet pafund në Twitter e në rrjetet shoqërore, derisa të tejkalojë çdo lloj parashikimi dhe të dalë duarsh. Një urrejtje e madhe fetare do të përjetësohet në këtë mënyrë në kohët pasnormale. Ajo do të jetë shkak për fyerje të përhershme në të ardhmen, do të përjetësojë shembuj njerëzish të rremë dhe do t'u bëjë jehonë hamendësimeve mendjelehta të të tjerëve. Tharmi për të bashkuar njerëzit në një formë të re të shoqërisë na ngjiz vetëm për të na larguar, duke nxjerrë në pah dallimet tona dhe duke shkatërruar veten tonë gjatë kësaj ecurie.

Por ka edhe shumë më tepër. Dukuria mund të gjallojë edhe pa një njeri si shkak fillestar. "Kupa e Kuqe" e vitit 2015, është një rast i tillë. Ajo filloi kur rrjetet shoqërore filluan t'i fryjnë zjarrit, pas vendimit të kafeneve zinxhir *Starbucks*, për të vazhduar traditën vjetore të kupës së kuqe, por pa shkruar në kupë shprehjen "Gëzuar Krishtlindjet". Kjo, për 'ta ishte një sulm i qëllimshëm ndaj të krishterëve dhe Krishtlindjeve.<sup>19</sup> E vërteta e frikshme e kësaj ngjarjeje është se askush nuk e di se cili e filloi këtë prirje të mbrapshtë. Thjesht doli rastësisht. Diçka e ngjashme e çuditshme ndodhi në verën e vitit 2016. Më 12 qershor, Omar Mateen, një qytetar amerikan, qëllon në një klub nate në Orlando, duke vrarë dyzet e nëntë veta.<sup>20</sup> Mohamed Lahouaiej, një qytetar francez, iu turr me kamionin e tij një turme në Nicë, më 14 korrik, duke vrarë 84 njerëz.<sup>21</sup> Riaz Khan Ahmadzai, një mërgimtar afgan që jeton në Ochsenfurt të Gjermanisë, sulmon disa njerëz me thikë në një tren në Würzburg, më 18 korrik.<sup>22</sup>

19 Emma Green, "The Insanity of the Starbucks Christmas Cup 'Controversy'. *The Atlantic*. 10 Nëntor, 2015.

20 Mark Mazzetti, Mark, Eric Lichtblau dhe Alan Blinder. "Omar Mateen, Twice Securitized by F.B.I., Shows Threat of Lone Terrorists." *The New York Times*. 13 Qershor, 2016.

21 Sophie Sassard, Michael Bernouin dhe Tom Bergin. "With 84 dead, France investigates whether truck driver acted alone." *Reuters*. 17 Korrik, 2016.

22 Philip Oltermann, Philip dhe Kevin Rawlinson. "Teenager shot dead after attacking passengers on train in Germany." *The Guardian*. 19 Korrik, 2016.



Këto janë vetëm një numër i vogël i sulmeve të shumta që ndodhën gjatë vitit 2016. Çfarë i shtyn njerëzit të sulmojnë në emër të Islamit, apo si nderim ndaj Shtetit Islamik? Është kaq e çuditshme, saqë nuk kanë një lidhje shkakësore me qëllimin që mendohet se ata po përpiqen të tregojnë, apo qëndrimin që po përpiqen të mbajnë sulmuesit. Ndërsa sulmet e vitit 2001 në Amerikë, sulmet në Londër në 2005-ën, madje edhe sulmet e Parisit të 2015-ës, ofrojnë prova të pakundërshtueshme të një planifikimi të ndërlikuar, fshehtësie dhe lidhjeve me grupe më të mëdha. Ndonëse me shkaqe të paqarta, sulmet e verës së 2016-ës u përjetësuan përsëri nga humbja e mënjanuar e *Vetes*, pa pasur asnjë ndikim në çështjet e Islamit. Ngjashmëria e habitshme është se këto sulme nuk kryhen nga qeliza të dukshme të fjetura, ose ushtarë të ngjuar, por nga banorë të zakonshëm të Perëndimit. Gjithashtu, ka një përputhje që të rrëmben, sa u përket arsyeve të fshehta që ndërsyen këto sulme, përtej hamendësimeve dhe pohimeve të zakonshme, se ato ishin beteja historike për Kalifatin Islamik. Edhe nëse Shteti Islamik merr mbi vete të gjitha meritat, është e vështirë të thuhet se ka pasur ndonjë ndikim në ndodhitë e këtyre ngjarjeve çoroditëse, përveç fuqisë që u është dhënë atyre nëpërmjet ndikimeve që feja ka në veprim. Unë mund të bëj një sanduiç prej zanatçiu pa të meta dhe ta shpall atë në emër të Shtetit Islamik, por të kthehesh dhe të thuash se Shteti Islamik kishte dorë në mësimin e zanatit tim të sanduicbërjes, është një kapërcim i madh.

Në kohët pasnormale, veprimet e njerëzve të veçantë bashkohen në një lojë skenike të ndërlikuar, të llojit të njeriut të keqkuptuar dhe padijes së madhe. Megjithatë, vetë njerëzit mund të gjallojnë gjithashtu në një fshikëz të veçuar, të hapur vetëm pas pikëpamjeve që pasqyrojnë ato të vetvetes, duke besuar se të gjithë të tjerët ndajnë të njëjtat bindje dhe ata mund të mësojnë të gjitha aftësitë dhe pajisjet e nevojshme për të zbatuar planet e tyre me një të hapur të kompjuterit. Gjithçka që i nevojitej Anders Behring Breivik, ishte siguruar në qetësi, brenda flluskës së tij. Në verën e vitit 2011, i ulur në një furgon, ai plasi bombën, duke vrarë tetë njerëz në Oslo dhe, më pas, u nis me makinë drejt ishullit Utøya, ku qëlloi pa ndërprerje 69 kampistë verorë. Më herët, Breivik kishte shprehur qëndrimet e tij, përmes mesazheve elektronike, të cilat e përafrojnë atë me ndjenjat e krahut të djathtë fundamentalist të krishterë, kundër socializmit, multi-kulturalizmit dhe Islamit në Europë. Pjellë e një shoqërie që shihet si paqedashëse dhe pararoja e përparimit që vazhdimisht pothuajse kryeson në renditjen botërore - sa i përket arsimit, përkrahjes shoqërore dhe qëndrueshmërisë ekonomike<sup>23</sup> - ai e pa veten si trashëgimtar të Kalorësve

23 Max Fisher, "A Different Justice: Why Anders Breivik Only Got 21 Years for Killing 77 People." *The Atlantic*. 24 Gusht, 2012.



Templarë. Në pesë vjetorin e masakrës së Breivik-ut, Ali Sonboly, një gjerman me origjinë iraniane, ndoqi gjurmët e tij, duke shkuar për t'u 'zbavitur' me armë zjarri në Mynih dhe la nëntë të vdekur e njëzet e dy të plagosur. Djali 18-vjeçar, i mençur dhe i turpshëm, mundi të siguronte shumicën e librave dhe udhëzimeve, si dhe një pistoletë Glock 9 mm, me 300 fishekë, thjesht duke përdorur Whats App-in. Ajo çfarë tregojnë këta shembuj, është se dhoma e jehonës së rrjeteve shoqërore, jo vetëm që nxit dhe ushqen ekstremizmin fetar, por, gjithashtu, mund të sigurojë mjetet për të vënë në jetë përfytyrimet ekstremiste.

**RRJETET SHOQËRORE JU JAPIN PIKËRISHT ATË QË DËSHIRONI. TE GJITHA ATO FILTRA, KËRKIME, PËLQIME DHE MOSPËLQIME, I KTHEJNË MBRAPSHT PARAGJYKIMET TUAJA. JU LEXONI LAJMET QË DËSHIRONI TË LEXONI, U HIDHNI NJË SY NJOFTIMEVE TË FUNDIT QË PËRFORCOJNË PIKËPAMJET TUAJA, NXITENI VAZHDIMISHT PËR TË BLERË MALLRAT DHE SHËRBIMET QË PLOTËSOJNË DËSHIRAT TUAJA.**

Kësisoj, ju gjalloni në një normalitet të prodhuar, krijohet një fushë që ju jep përshtypjen se të gjithë besojnë si ju, mendojnë si ju, sillen si ju dhe duan të jenë si ju. Nëse jeni besimtar, mjafton një hap i vogël për të arritur në përfundimin se ky është vullneti i Zotit. Kjo është ajo që Zoti dëshiron që ju të bëni. Në nëntor të vitit 2015, Robert L. Dear Jr., mori një pushkë gjysmë automatike dhe hyri në një ndërtesë të *Planned Parenthood*, në Kolorado, duke vrarë tre veta e plagosur nëntë të tjerë. Ai mendoi se po bënte punën e Perëndisë.<sup>24</sup> Dear, një tregtar arti, u rrit si baptist, edhe pse nuk shkante rregullisht në kishë. Ai bënte një jetë të veçuar në një kasolle të largët në Kolorado dhe kalonte shumicën e kohës në internet, duke kërkuar partnerë për marrëdhënie sadomazokiste. Ai vërtet e donte Biblën e tij, të cilën e lexoi fletë për fletë, por atë që mësoi për detyrën ndaj Perëndisë, e mori në internet.

Natyrisht, gjithmonë ka pasur njerëz që do ta nxinin fenë, ose do ta përdornin atë për qëllimin e tyre. Por puna është se kohët pasnormale u kanë dhënë atyre mundësi dhe fuqi të madhe, duke ofruar mjete për nxitje dhe përhapje. Prandaj, ndodhi të tilla pritjet të shtohen në vitet e ardhshme. Gjë që i lë në harresë të gjithë ata që besojnë në një Zot të krishterë, të predikuar nga një Jezus Krisht në Biblën e Shenjtë, të cilët, mbi të gjitha,

24 Richard Fausset, "For Robert Dear, Religion and Rage Before Planned Parenthood Attack." *The New York Times*. 1 Dhjetor, 2015.





besojnë në dashuri. Edhe dashuria e Zotit është kthyer, për të përdorur fjalët e Zygmunt Bauman, 'në dashuri të qullët'.<sup>25</sup> Mund të shndërrohet lehtësisht në dashuri ekstreme për dhunën ekstreme, siç e vërtetoi kaq mirë ISIS. Fuqia e madhe e grumbulluar dhe e krijuar përmes këtyre ngjarjeve të dhunshme çoroditëse, çon vetëm në rritjen e padijes ndaj fesë dhe të gjithë asaj që ka mbijetuar për shekuj prej besimeve që burojnë nga Abrahami.

Kështu,

**TË JESH VËRTET FETAR, NË KUPTIMIN MË TË MIRË TË FJALËS, ËSHTË TË SYNOSH TË PAMUNDURËN. TË JESH I KRISHTERË OSE MYSLIMAN, ËSHTË PËRTEJ LLOGARITJEVE LINEARE TË MENDJES NJERËZORE, NË TË CILAT TANIMË ËSHTË PAKËSUAR GJITHÇKA. KJO ËSHTË E BARASVLERSHME MË PËRPJEKJET PËR TË PJESËTUAR ME ZERO NË LLOGARITË TUAJA. AI MESAZH I 'GABUAR' QË NUK TË SHQITET, ËSHTË METAFORA FETARE E KOHËVE TONA PASNORMALE.**

Mosmarrëveshjet, ndërlikimi dhe çoroditjet e kohëve pasnormale prodhojnë një ndjenjë pafuqie tek ata që kanë prirje fetare dhe shpirtërore. Në një botë ku shumë pak ka arsye, kuptimi avullon. Por dëshira jonë për kuptim rritet dhe ne shpesh e gjejmë atë kudo që e kërkojmë. Shpesh, besimet përkthehen si identitet dhe kuptim. Kjo çmenduri e njohjes së vetvetes, në vend që të na japë një ndjenje të vërtetë përkatësie dhe kuptimi, në fakt, vetëm sa rrit tjetërsimin. Sa më dëshpërimisht përpiqemi të kërkojmë kuptimin e bindjeve mbi vetveten, aq më të tjetërsuar bëhemi. Në shumë mënyra, kohët pasnormale janë epokat e Vetes së humbur që kërkon furishëm të vetë-transmetohet përmes Facebook, Twitter, You Tube dhe mediave të tjera digjitale pa fund. Nuk është për t'u habitur, që në këtë kohë pasigurie, ndryshimesh klimatike, lufte dhe çudie botërore, besimet rreth fundit të botës janë përhapur. Mesazhi themelor i ISIS-it është se fundi i ditëve po afron. Pothuajse gjysma e popullsisë së Iranit pret që Mehdiu të arrijë në çdo çast tani. Shikoni sa shumë sekte të krishtera po predikojnë se fundi i kohërave është afër! Madje edhe renditja e tyre është një detyrë e frikshme, pasi ato variojnë nga mijëvjeçaristë, paramijëvjeçaristë, shpëtimtarë, pasmijëvjeçaristë, deri te mohuesit e mbretërimit njëmijëvjeçar të Krishtit. Dhe të gjithë kanë kanalet e tyre televizive, kanalet në You Tube, faqet e Facebook-ut, faqet e internetit, burimet në Twitter dhe

25 Zygmunt Bauman, *Liquid Love: On the Frailty of Human Bonds* (Polity, Oxford, 2003).





gjithçka që keni edhe ju. Të gjithë mezi presin të përfshihen në dallinë e botës së tyre të veçuar, në pritje të mbledhjes së komenteve ose pëlqimeve.

E megjithatë, kurrë nuk është ndjerë më shumë nevoja për njerëz dhe bashkësi me vlera të vërteta fetare dhe shpirtërore. Shumë nga mosmarrëveshjet e kohëve pasnormale kërkojnë virtyte fetare të modës së vjetër, si përlësia, durimi, dashuria, dhembshuria dhe mirëkuptimi për t'i kapërcyer ngatërresat. Teknologjia lidh dhe ndan njëkohësisht bashkësinë njerëzore, si kurrë më parë. Ky qëndrim nuk mund të zgjidhet pa dashurinë e tjetrit. Së shpejti, shumica e vendimeve tona do të merren përmes makinerive. Si do ta ruajmë njerëzimin tonë, në një botë të mbizotëruar nga makineritë, inxhinieria gjenetike dhe inteligjenca artificiale? Në të vërtetë, çfarë do të thotë të jesh njeri në këto kohë të trazuar, të pasigurta të padijes së thellë? Feja nuk mund të qëndrojë e heshtur përballë çështjeve të tilla të ndërlikuara moralisht dhe ndryshimeve e sfidave madhështore.

Është theksuar vazhdimisht, se kohëve pasnormale nuk mund t'u jepet drejtim apo të zotërohen, ato vetëm mund të lundrohen. Pra, si mundet feja të kalojë nëpër kohët pasnormale dhe të na çojë drejt një të ardhmeje më të arsyeshme, të përgjegjshme, të larmishme dhe vërtet të ndriçuar? Sigurisht, nuk ka zgjidhje të lehta. Por ka disa ide të çmuara që besimet monoteiste duhet t'i kapërcejnë për t'u përgatitur për kohët e ardhshme.

Unë do të këshilloja se qëllimi i fesë nuk mund të jetë përjetësimi i besimit mbi vetveten, teksa tregon dashuri, dhembshuri dhe t'u ofrojë shërbim të tjerëve. Sigurisht që dashuria e Zotit që theksojnë besimet të cilat burojnë nga Abrahami, shprehet më së miri në dashurinë e të gjithë të tjerëve, duke përfshirë dashurinë për natyrën dhe Tokën, të gjithçkaje që nuk është 'ne'. Gjithashtu, është si një lloj mirësjelljeje fillestare, mendimi se edhe të tjerët kanë njëfarë ideje të vakët për të Vërtetën Hyjnore, se besimi ynë nuk është i vetmi besim i Vërtetë. Larmia dhe shumësia e kohëve pasnormale mund të lundrohet vetëm duke pranuar se besimi i të tjerëve është po aq i rëndësishëm për ta, sa ç'është besimi ynë për ne. Secilit duhet t'i lejohet të pranojë atë që e sheh si të vërtetë dhe ta kundërshtojnë atë që nuk i duket e vërtetë, duke përfshirë edhe brendinë e kufijve të një besimi të vetëm. Ideja e një të vërtete fetare të vetme, monolitike, është e vjetruar deri në kërcënim në kohët pasnormale dhe shërben vetëm si burim grindjesh e dhune.

Ndarja midis Shtetit dhe Kishës, si dy ide dhe fusha të veçanta të ekzistencës, është po aq e parëndësishme. Në kohët pasnormale gjithçka është e lidhur me gjithçka tjetër. Asgjë nuk ekziston në një mënjanim të përkryer, krejt i shkëputur nga çdo gjë tjetër. Fakti është se të dyja këto ide janë të njëjta, por ndryshojnë vetëm në emër. Si shteti, ashtu edhe feja,



kërkojnë të rregullojnë dhe shpjegojnë botën. Të dyja janë një formë e përpunimit të vendimmarrjes. Të dyja mund të tjetërsohen dhe janë tjetërsuar në një trajtë pushteti. Dëshirat e zjarrta nacionaliste e fetare shpesh çojnë në të njëjtat pasoja. Ne lavdërojmë, nderojmë dhe luftojmë në emër të 'kombin tonë', ashtu siç lavdërojmë, nderojmë dhe luftojmë për Zotin. Edhe feja, edhe shteti kanë aftësinë t'i zotërojnë zemrat dhe mendjet tona. Sigurisht, kjo nuk do të thotë se ne duhet të përqafojmë sundimin e priftërinjve në emër të Zotit. Por kjo do të thotë se fesë duhet t'i jepet mundësia e plotë në hapësirën shoqërore dhe ajo duhet të marrë pjesë hapur në ecuritë demokratike. Kjo është rruga më e mirë për të zvogëluar mosmarrëveshjet dhe për t'u marrë me larminë e ndërlikuar të shoqërive tona. Si feja, ashtu edhe shteti, duhet të njohin kufizimin dhe padijen e tyre, ndërlikimin dhe pasigurinë e vërtetë të kohës sonë. Që të dyja duhet të nxiten të përparojnë, me qëllim që të frymojnë përmes mënyrave të reja.

Gjithashtu, duhet të kapërcejmë një varg çarjesh mes për mes dhe të rreme që mendojnë shoqëritë tona: fërkimet midis njeriut dhe shoqërisë; vetvetja kundër shoqërisë; e djathta dhe e majta; kapitalizmi kundrejt socializmit; Lindja dhe Perëndimi. Mosmarrëveshje të tilla kanë pak kuptim në një botë me *Vetvete* të shumëfishta që kërkon zgjidhje me shumësi nga këndvështrime të shumëfishta. Hamendësimi i pakuptimtë, se dikush duhet të jetë ose i mëvetësuar, ose bashkërisht, ka nxitur luftën, urrejtjen dhe vdekjen. E vërteta është se, si njeriu, ashtu edhe shoqëria, janë po aq të rëndësishme, ku njëra nuk mund të ekzistojë pa tjetrën. Një ekonomi e qëndrueshme që kujdeset për tregun dhe shoqërinë, ka nevojë për pak baraspeshë të të dyjave – kapitalizmit dhe socializmit. Të theksosh një mendim, ideologji ose botëkuptim të veçantë, në kurriz të tjetrit, do të thotë të nxitësh një padije që e ka lënë njerëzimin në një nga periudhat më të gjata dhe më shkatërruese të historisë së tij. Unë do të thosha se është detyra e fesë t'i mëshojë tërësisë, të zvogëlojë përçarjet e panevojshme dhe të rrezikshme, si dhe të sjellë në vete *Vetvetet* e çuara dëm.

Mbi të gjitha, feja duhet të qëndrojë kundër padijeve të të gjitha llojeve dhe ta shohë pasigurinë jo si një kërcënim, por si një mundësi për të formuar të ardhme më të dëshirueshme. Në kohët pasnormale, siç e kemi parë, gjërat e vogla mund të kenë ndikime të mëdha dhe të sjellin ndryshime me peshë. Ka shpresë në veprimet e Papa Françeskut I, i cili po përpiqet të tjetërsojë Kishën Katolike, për ta përgatitur atë për turbullirat që e presin gjatë kohëve pasnormale. Ka gjithashtu shpresë në lëvizjet e shumta reformuese brenda Islamit, që kërkojnë rimendimin e ligjit islam, ripërcaktimin e marrëdhënieve ndërmjet Islamit dhe politikës dhe të prodhojnë



kuptime të reja të fesë. Një shpresë e bukur qëndron te nisma e njohur si “përfaqoni një terrorist” në Danimarkë, ku qytetarët i mirëpresin dhe i ndihmojnë për t’u ripërshtatur, në vend të përjashtimit, ata të rinj që kanë ikur në Siri për t’iu bashkuar ISIS-it.<sup>26</sup> Këto nisma mund të duken të vogla dhe të veçuara, por ato janë “tërheqje të çuditshme”. Ato pajtojnë mosmarrëveshjet, tërheqin mënyra të tjera të sigurta që kanë pikëtakime të përbashkëta dhe, si të tilla, ato mund të bëhen përshpejtuese për ndryshime madhështore dhe tregojnë se Zoti nuk ka ndërmend të rrijë duarkryq.

Në një episod të mëvonshëm, te *Loja e pushteteve*, Tyrioni e gjen veten në një qeli burgu, në pritje të gjyqit. Ai fajësohet për vrasjen e ish-mbretit të Westeros. Fati i tij do të vendoset nga gjyqi përmes luftimit, një mënyrë kjo, ku një palë e fajësuar mund të luftojë kundër fajësuesit, ose kampionëve të zgjedhur nga secili. Padyshim, fituesi i betejës është përkrahur nga perënditë, që, në fakt, vendosin fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarit. Tyrioni shoqërohet në qeli nga vëllai i tij, Xhejmi, i njohur si Kingslajer, sepse ai ishte falur më parë për vrasjen e ish-mbretit të çmendur të Westeros. Ata shqyrtojnë shumëllojshmërinë e fjalëve që ekzistojnë për të shprehur atë që një njeri vret. Për shembull, *atëvrasja* - është vrasja e babait të dikujt, ose *foshnjëvrasja* - është vrasja e fëmijëve. Xhejmi tallet, ngase nuk gjen fjalë për vrasjen e kushëririt. Tyrioni pyet se çfarë na tregon kjo për perënditë dhe çfarë mund të tregojë kjo për qeniet njerëzore. Më pas, Tyrioni flet për Orsonin, kushëririn e vet dhe për Xhejmin në vendlindjen e tyre.

Orsoni rrinte i vetmuar si fëmijë dhe, gjatë gjithë rinisë së tyre, i kalonte ditët duke shtypur brumbujt. “Dua të shtyp brumbujt!” - bërtiste ai vazhdimisht. I shqetësuar shumë nga veprimet e Orsonit, Tyrioni u përpoq shumë të gjente një përgjigje të kënaqshme rreth sjelljes së kushëririt të tij. A ka një arsye, një shtysë e cila qëndron prapa veprimeve të tij? Por Tyrioni nuk mundi të gjente kurrë një përgjigje që ta kënaqte. Edhe Xhejmi nuk mundi të jepte asnjë përgjigje bindëse. Atëherë, Tyrioni mendon se ndoshta po shfrytëzohen zotat për të përligjur sjelljen njerëzore. “- A ka thirrje më të lartë për njerëzimin, sesa thjesht ta shtypim njëri-tjetrin pa pushim?” - pyet ai. Kohët pasnormale i kanë bërë 140 shkronjat që lejohet t’i përdorësh në Twitter për të përcjellë një mesazh, aq të fuqishme, sa edhe shprehja “Jezusi qau”, apo çfarëdo thënie tjetër nga teksti fetar që mund të zgjidhni. Ne kthehemi te gjëegjëza e Varys dhe vrasim mendjen, se kush jeton dhe kush vdes. Dhe jemi të detyruar të pyesim: Ku duan njerëzit me prirje fetare, që të prehet pushteti në të ardhmen?

26 Hanna Rosin, ‘How A Danish Town Helped Young Muslims Turn Away From isis.’ nr. Korrik 15, 2016.



# E ardhmja e Islamit në kohët pasnormale

Ziauddin Sardar

## HYRJE

Ligjërata e sotme islame është, në pjesën më të madhe, një zonë e lirë e së ardhmes. Pothuajse gjithçka që shkruhet për Islamin, ka të bëjë me të kaluarën ose të tashmen. Duke qenë se bota po përjeton një periudhë ndryshimesh të shpejta, në të vërtetë, ndryshime të përshpejtuara, ku vlerat, qëndrimet, madje edhe besimet e vjetra e të çmuara të njerëzve ndryshojnë pothuajse po aq shpejt, sa prodhimi i shpikjeve dhe i risive të reja, vëmendja jonë duhet të përqendrohet drejt të ardhmes. Çdo njeri ka një investim në të ardhmen, që është mënyra se si jeta dhe mjedisi ynë vetjak do të ndryshojnë ndikimin e përparimeve të reja në shkencë dhe teknologji, zhvillimet ekonomike apo mungesën e përparimit ekonomik, deri te zhvendosjet në fuqinë botërore, si dhe çfarë lloj shoqërie dhe planeti duam të trashëgojnë fëmijët e nipërit tanë. E ardhmja është një temë që duhet të shqetësojë çdo mysliman. Megjithatë, biseda për të ardhmen mungon dukshëm në qarqet myslimane.

Pse është kështu? Fillimisht, nuk ndihmon fakti që nuk ka pothuajse asnjë punim shkencor mbi të ardhmen e Islamit dhe shoqërive myslimane, me të cilat dikush të merret me 'të. Ka disa libra ku fjala 'e ardhme' shfaqet në titull: *Jo Zot, Por Zoti: Zanafilla, Përparimi dhe e Ardhmja e Islamit*<sup>1</sup>, nga Reza Aslan; *Myslimanët Perëndimorë dhe e Ardhmja e Islamit*, nga

---

1 Reza Aslan, *No God But God: The Origins, Evolution and Future of Islam*, William Heinemann, Londër, 2005.



Tarik Ramadan<sup>2</sup>; *Islami: e Kaluara, e Tashmja dhe e Ardhmja*<sup>3</sup>, nga Hans Kung; si dhe nga John Esposito, e titulluar qartazi: *E ardhmja e Islamit*.<sup>4</sup>

Por emërtesa ‘e ardhme’, në këtë rast, është një shtojcë; nuk pranohet se ‘e ardhmja’ është një fushë e zhvilluar dhe e stërholluar kërkimi e studimi. Libri i shkëlqyer i Aslan-it, i cili ia kushton kapitullin e fundit ‘Reformimit Islamik’, nuk përfshihet as në treguesin e lëndës për hulumtimet e së ardhmes. Libri i Ramadan-it ka të bëjë kryesisht me angazhimin e myslimanëve me Perëndimin, si dhe shqyrtimin e përpjekjeve të ndryshme për reforma. Studimi i shkëlqyer dhe madhështor i Kung-ut i kushton një të katërtën e librit “mundësive për të ardhmen”. Por, përsëri, analiza është fuqimisht e përqendruar në çështjet bashkëkohore, si të drejtat e njeriut, barazia për gratë, marrëdhënia midis fesë dhe shtetit, apo reformat ekonomike, edhe pse pjesa e fundit mbi shpresën ofron një përfytyrim të mundshëm për të ardhmen. Më zhgënjyesja është *E ardhmja e Islamit*, shkruar nga Esposito. Duke pasur parasysh titullin, ne do të prisnim që libri t’i kushtohej çështjeve në vazhdimësi të disa dekadave të ardhshme. Megjithatë, libri ka pak për të thënë mbi të ardhmen. Ai thekson larminë dhe shumësinë e myslimanëve, çështjet e xhihadit dhe shtetit, ndërtimin e urave midis Amerikës dhe botës myslimane, shqyrton çështjet e reformës, gjithashtu përfshin një rrahje mendimi rreth ‘xhihadit gjinor’ dhe ungjilltarëve televizivë. Me një titull tjetër, do të ishte një libër i shkëlqyer.

Për një libër që i përshtatet titullit, duhet t’i drejtohem librit të Wilfrid Scawen Blunt: *E ardhmja e Islamit*<sup>5</sup>, shkruar si një seri esesh për revistën *The Fortnightly Review*, botuar si libër në vitin 1882. Si një mik i ngushtë i rilindësit mysliman, Xhemaludin Afganistani, Blunt ishte i shqetësuar rreth prirjeve të caktuara në shoqëritë myslimane. Këto prirje tregonin një të ardhme të caktuar. Blunt nuk ishte një ‘futurist’ në kuptimin bashkëkohor dhe as ‘mjeshtër i parashikimit’, siç është bërë i njohur në qarqet qeveritare dhe tregtare, por ai kishte njohuri të mjaftueshme për të kuptuar se prirjet historike mund të pengohen dhe ndryshohen dhe se një e ardhme ndryshe për shoqëritë myslimane mund të ngjizet përmes përqasjeve. Me fjalë të tjera, nuk ekziston diçka e tillë, si “e ardhmja” e mirëqenë, e parë dhe e caktuar si një fat i pashmangshëm. Ka një varg të ardhmesh dhe ajo e dëshirueshmja mund të formësohet.

2 Tariq Ramadan, *Western Muslims and The Future of Islam*, Oxford University Press, Oxford, 2004.

3 Hans Kung, *Islam: Past, Present and Future*, One World, Oxford, 2007.

4 John Esposito, *The Future of Islam*, Oxford University Press, Oxford, 2010.

5 Wilfred Scawen Blunt, *The Future of Islam*, Londër, 1882; reprinted by Sind Sagar Academy, Lahore, 1975. Të gjitha citimet nga ky botim.



Prirjet që shqetësonin Blunt-in, përfshinin pushtimin e Tunisit nga francezët. Ai shkruante se francezët nxitën 'lëvizjen muhamedane' në Afrikën e Veriut; reformat kombëtare dhe fetare në Egjipt; rënien e Perandorisë Osmane; shfaqjen e 'mendimit përparimtar në Islam' dhe një 'teologji arabe', të bazuar në al-Azhar. Ku do të çonin këto prirje? Përgjigjja e Blunt-it ishte se duhej t'u bëhej jehonë këtyre prirjeve, në mënyrë që një Islam 'liberalizues' dhe një qeveri liberale muhamedane e popullit të lirë muhamedan të themeloheshin vendosmërisht në brigjet e Nilit, që më pas të shërbenin si 'themel i një reformimi shoqëror e politik për të gjithë Islamin'.<sup>6</sup> Pra, një varg prirjesh bashkohen për të prodhuar një tjetërsim të madh në të ardhmen afatgjatë. Duke marrë parasysh, kur u shkruan esetë e mbledhura në "E ardhmja e Islamit", Blunti shpërfaq një kuptim mbresëlënës, se si mund të shqyrtohen prirjet politike dhe intelektuale. Sigurisht që ai ka një qëllim politik. Ai parashikon fundin e Perandorisë Osmane me egërsi dhe në mënyrë të përsëritur, duke e ditur se "profeci të tilla shpesh herë i shërbejnë përmbushjes së vetvetes". Ai parashikon zhvendosjen e "kryeqendrës" islame nga Kostandinopoja, në Mekë, sigurisht e mirëpritur me "krahët hapur", duke çuar në kryengritje kundër fuqive koloniale. Dhe, si një parashikues i mirë që ishte, ai dëshiron t'i kthejë analizat dhe parashikimet e tij në politika. "Anglia, - sqaron ai, - duhet të përgatitet për rënien e Perandorisë Osmane dhe duhet të sigurojë udhëzime politike për kombet e ndryshme të Islamit. Pas osmanëve, myslimanët e Kontinentit Jugor Indian do të jenë më të shumtët në numër dhe më të pasurit (ai e nxjerr këtë nëpërmjet një analize të statistikave të pelegrinëve) dhe kjo gjendje e krijuar rishitazi duhet të përdoret për të forcuar Mbretërinë Britanike - *Quod erat demonstrandum*".

Blunti po mendonte për ngjarje që do të ndodhnin të paktën pas pesëdhjetë vjetësh dhe brenda asaj kohe, shumë nga parashikimet e tij u vunë në jetë: Perandoria Osmane u shpërbë, një Mehdi u shfaq në Sudan, myslimanët në krahina të ndryshme rrokën armët kundër fuqive koloniale, ulema egjiptiane ndërmori reforma liberale, pushteti u zhvendos nga Stambolli në Mekë, pas rënies së Kalifatit, dhe Britania (së bashku me fuqitë e tjera) ndërhyri dhe, rrjedhimisht, u bë më e fortë. Parashikimet dhe politikat e tij u bënë pjesë përbërëse e politikës koloniale britanike. Blunt parashikoi një të ardhme të veçantë për botën myslimane dhe ai ndihmoi në krijimin e një mekanizmi për t'i dhënë formë asaj.

Kuptimi ynë, se si shpaloset e ardhmja, ka bërë një rrugë të gjatë, që nga ditët e Blunt-it. Por Blunti sqaron përbërësit themelorë të një analize,

6 Po aty, f. vii.



mbështetur në të ardhmen. Bëhet fjalë për të kuptuarit dhe shkallën e ndryshimit. Nuk ka të bëjë aq shumë me shqetësimet e përditshme, por më shumë me kërcënimet, fuqitë dhe mundësitë afatgjata. Ka të bëjë me të kuptuarit e prirjeve dhe shtrirjen e zbatimit tyre, për të parë se çfarë lloj të ardhmeje mund të gjallërojnë. Nuk bëhet fjalë për një të ardhme të vetme, por për një spektër të ardhmesh të ndryshme. Bëhet fjalë për parashikimin, por edhe për formësimin. Dhe ka të bëjë me përcaktimin e mënyrave të veprimit dhe ndërmarrjen e këtyre veprimeve në të tashmen, me qëllim që të ndihmojnë një të ardhme të dëshirueshme.<sup>7</sup> Gjithashtu, ai sqaron një tjetër pikë kyçe: nëse myslimanët nuk angazhohen në të menduarit dhe formësimin e së ardhmes së tyre, të tjerët do ta bëjnë me kënaqësi këtë, ndërsa vetë ata do të përfshihehin në të ardhmen e dikujt tjetër.<sup>8</sup>

Sigurisht, kjo është pikërisht ajo që ka ndodhur gjatë shekujve të fundit. Kolonizimi i botës myslimane, gjatë shekujve të XVIII-të dhe XIX-të, nënkuptonte se e ardhmja e *umetit* u formësua nga fuqitë koloniale. Në agimin e shekullit të XX-të, Xhemaludin Afgani bëri thirrje për ringjalljen e *itihadit* (arsyetimit të pavarur). Nëpërmjet një lidhjeje botërore mbarë-islamike, ai u bëri thirrje myslimanëve të përqafojnë shkencën dhe teknologjinë dhe të 'modernizojnë Islam'. Pas rënies së Kalifatit, lëvizjet kombëtare për fitimin e pavarësinë filluan në të gjithë botën myslimane. Nga mesi i shekullit të XX-të, u shfaqën një mori shtetesh të reja të pavarura. Por ata shpejt zbuluan se e ardhmja e tyre politike dhe ekonomike ishte ende duke u formësuar nga ish-zotërit e tyre kolonialë. Gjatë viteve 1970 dhe 1980, u fol shumë për 'ringjalljen islame', por kjo u shua shpejt, kur realiteti i dekadave të 'perëndimizimit' dhe 'zhvillimit' zbuloi se e ardhmja myslimane po formësohej nga largpamësi dhe planifikime perëndimore. Tani, 'Pranvera Arabe' ka sjellë një shpresë të re; por duket se po kthehet, edhe një herë, në një tjetër rrugë pa krye. Pjesa e shumicës dërrmuese të myslimanëve, të zhytur në varfëri dhe trazira, duket se nuk kanë zgjidhje. Në një botë që ndryshon me shpejtësi, strukturat e shtypjes dhe ndrydhjes po thellohen edhe më shumë.

Lloji i dëshpërimit që po pllakos tani shoqëritë myslimane, është sqaruar mirë nga Jasmin Alibhai-Braun, në rubrikën e saj të dhimbshme në

7 Shih Ziauddin Sardar, *Future: All that Matters*, Hodder, Londër, 2013,

8 Për më shumë detaje, se si mund të kolonizohet e ardhmja, shihni Ziauddin Sardar, 'Colonising the Future: The 'Other' Dimension of Future Studies', *Futures* 25 (3) 1993 dhe 'Other Futures: Non-Western Cultures in Futures Studies' in Richard A Slaughter (editor), *The Knowledge Base of Future Studies: Directions and Outlook* (volume three), DDM Media Group/Futures Study Centre, Hawthorn, Victoria, 1996; dhe Ziauddin Sardar, editor, *Rescuing All Our Futures: The Future of Future Studies*, Adamantine Press, Londër; Praeger Publishers, Westport, CT, 1998.



*Independent*. "Shtypja dhe tirania, - shkruan Alibhai-Braun, - janë të zakonshme edhe në vendet jomyslimane, por në botën myslimane ato janë tregues të një modeli, të një sëmundjeje të përhapur kulturore. Dhuna është tipike dhe shihet si përgjigje e lehtë për të gjitha çështjet e myslimanëve. Në mbarë botën, dhuna më e tmerrshme përjetësohet nga myslimanët, më së shpeshti kundër bashkëbesimtarëve. Premtimet për demokraci zbehen më shpejt se lëkura e nxirë nga dielli; liritë rrëmbehen; liritë dërrmohen; barazia shkëputet nga fjalori zyrtar. Mjerim, kudo mjerim!". Kjo nuk është një ndjenjë e përveçme, por e përgjithshme. Siç vëren Alibhai-Braun, disa myslimanë tani besojnë se 'kjo është periudha e errët, ku sundon tërbimi dhe nuk ka vend për mendjen, njerëzoren, dashurinë, përgjegjësinë qytetare dhe bashkëpunimin, se ne të gjithë jemi pjesë e qytetërimit tonë të madh të së kaluarës'.<sup>9</sup>

Shumë pak mund të bëhet për këtë gjendje në një afat të shkurtër.

**NUK KA NDREQJE TË SHPEJTA, APO ZGJIDHJE TË MENJËHERSHME. MANGËSITË DHE PROBLEME SHEKULLORE, PAAFTËSIA PËR TË KUPTUAR GJENDJEN BASHKËKOHORE, PAAFTËSIA E RRËNJOSUR PËR T'IU PËRSHTATUR NDRYSHIMEVE TË SHPEJTA NUK MUND TË KALOHEN BRENDA DISA VITEVE.**

Pa dyshim që përpjekjet për të zgjidhur çështjet sa më shpejt, gjallërojnë pengesat e veta. Jeni të detyruar të veproni ndaj sfidave njëra pas tjetrës. Ju ngecni në një cikël çështjesh që përsëriten dhe përfundoni nga një qorrsoak në tjetrin. Në të vërtetë, më duket se shoqëritë myslimane janë shoqëri që kryesisht kundërveprojnë ndaj cenimit dhe shtrëngesave njëra pas tjetrës, kryesisht pa sukses.

E vetmja rrugëdalje nga ngërçi i tanishëm, është të mendosh me guxim për kushtet e së ardhmes së largët. Ne duhet të hartojmë një rrugë drejt një të ardhmeje të dëshirueshme, të zhvillojmë njohuritë për zotërimin dhe parashikimin e ndryshimeve dhe të punojmë vazhdimisht për të arritur qëllimet tona të dëshiruara. Duhet të largohemi nga mënyrat e vjetruara dhe të ngurtësuara të mendimit mysliman dhe të përqafojmë një kuptim të freskët, më të thellë, *ardhmëri* të Islamit dhe një vullnet të ndërgjegjshëm, bashkërisht, për të kapërcyer ngërçin e tanishëm. Mbi të

9 Yasmin Alibhai-Brown, "In Muslim lands there was a dream of democracy. But now it has died", *The Independent*, 10 Gusht 2013.





gjitha, kemi nevojë për guxim dhe largpamësi intelektuale. Ne duhet të përfytyrojmë atë që, deri më tani, ka qenë e pamundur të përfytyrohet, të zhvillojmë ide që, deri më tani, janë parë si heretike ose të paudha, si dhe të parashikojmë mënyra të tjera rreth asaj se çfarë mund të thotë të jesh mysliman në dhjetëvjeçarët dhe shekujt e ardhshëm. Me fjalë të tjera, duhet të zhvillojmë një vetëdije gjallëruese drejt të ardhmes.

## GJETJA E SË ARDHMES

Çfarë nënkuptoj saktësisht me “vetëdije të së ardhmes”? E kam fjalën për një vlerësim të ndryshimit të përshpejtuar, një ndërgjegjësim për rreziqet dhe grackat e fatit në horizontin e së ardhmes jo shumë të largët dhe një angazhim për të formuar një të ardhme të dëshirueshme. Kuptimi dhe zotërimi i ndryshimit është një sipërmarrje që ndodh në të tashmen, natyrisht që kërkon një njohje të vërtetësisë bashkëkohore, me të cilën do merremi së shpejti. Por, së pari, si të ndërgjegjësohemi për mundësitë e së ardhmes dhe të punojmë drejt formësimit të një të ardhmeje që dëshirojmë?

Të mendosh për të ardhmen është e frikshme. Ndryshe nga e kaluara, me historitë, traditën, kujtimet dhe veçorinë e veta, e ardhmja nuk ka ‘fakte’ me të cilat mund të krijojmë ndonjë afrimitet, apo t’u drejtohem atyre. E ardhmja është e panjohur dhe në shumicën e traditave myslimane është dorëzuar kryesisht në fushën e ‘vullnetit të Zotit’. (Por, siç na thotë Kurani, në 13:11: “Zoti nuk e ndryshon gjendjen e një populli, nëse ata nuk ndryshojnë atë që është brenda vetes së tyre”). Vështirësia shtohet nga fakti se e ardhmja nuk ekziston në të vërtetë: është gjithmonë një kohë që ende nuk ka ardhur. Por e ardhmja nuk do të ekzistojë as në të ardhmen, sepse e ardhmja ekziston vetëm kur bëhet e tashmja, pikë në të cilën pushon së qeni e ardhme.

Megjithatë, vetëm për shkak se e ardhmja nuk ekziston dhe, në të vërtetë, nuk mund të ekzistojë, nuk do të thotë se ne s’mund ta studiojmë atë, të zhvillojmë ide, përfytyrime dhe metafora rreth saj, të përpiqemi të kuptojmë dhe t’i japim formë shtegtimit të saj. Idetë dhe përfytyrimet për të ardhmen janë po aq të rëndësishme, sa idetë dhe mendimet për të shkuarën, sepse mendimet dhe veprimet tona ndikohen jo vetëm nga të kuptuarit e asaj që ka ndodhur gjatë historisë, por edhe nga ajo që mund të ndodhë ende në të ardhmen. E ardhmja mund të jetë e pakapshme dhe e pasigurt, por është një fushë mbi të cilën mund të ushtrojmë njëfarë



pushteti. Nuk mund ta ndryshojmë të kaluarën. Mund ta studiojmë dhe ta shpjegojmë historinë, por nuk mund ta ndryshojmë atë. Ne nuk mund ta ndryshojmë as të tashmen: kjo kërkon ndryshim të menjëhershëm që është i pamundur. Por paaftësia jonë për të pasur njohuri të caktuara për të ardhmen, baraspeshohet nga aftësia jonë për ta formuar atë. Është brenda aftësive të njerëzve dhe shoqërive, që t'i japin formë të ardhmes së tyre.<sup>10</sup>

Të thuash se dikush mund të formësojë të ardhmen e tij ose të saj, tingëllon pak si mungesë vetëpërmbytjeje. Megjithatë, shumica e njerëzve me qëllime në jetë punojnë drejt përcaktimit të së ardhmes së tyre. Nëse doni të bëheni kirurg ose avokat, për shembull, duhet të punoni me vetëdije drejt qëllimit tuaj. Do të filloni me një vegim, se si do të ishte të ishte kirurg apo avokat në të ardhmen; do të merrni arsimin e duhur në një institucion të përshtatshëm; do të kërkonit mundësi kudo që të jenë; do të kërkonit ata njerëz që do t'ju ndihmojnë të mbërrini qëllimin tuaj.

Le të marrim një shembull më të qartë. Kini parasysht një mysliman që dëshiron të shkojë në Haxh për herë të parë. Ai ose ajo e di se si kryhet haxhi, edhe pse ai ose ajo nuk e ka kryer kurrë Haxhin më parë dhe tani nuk është në Mekë. Ky vegim s'i përket të kaluarës apo të tashmes; por për këtë vegim kaq të çmuar për të kryer Haxhin, ka vend në të ardhmen. Koha e së ardhmes është fusha e vetme ku ai ose ajo është në gjendje ta ndjejë si "të mundshëm" një vegim që është "i rremë" në të tashmen. Dhe e ardhmja në të cilën ai ose ajo e vendos tani vegimin e çmuar, synon ta bëjë atë realitet. Për ta shndërruar këtë vegim të së ardhmes në realitet, udhëtari për në Haxh fillon të kursejë dhe, nëse është i varfër, mund të duhet të kursejë për disa vite, përpara se të ketë të holla të mjaftueshme për të udhëtuar në Mekë. Por planet tona të ardhshme të Haxhit nuk kanë të bëjnë vetëm me burimet financiare. Gjithashtu, ai ose ajo duhet të bëjë ndryshime, me qëllim që dikush të kujdeset për familjen dhe tregtinë, ndërkohë që është larg, ndoshta për një muaj. Nëse udhëtari i mundshëm është grua, duke pasur parasysht natyrën e ligjit islam, asaj mund t'i duhet të marrë parasysht një varg faktorësh të tjerë, siç është marrja e një të afërmi (*mahram*) me vete. Ka edhe raste të tjera të paparashikuara. Duke pasur parasysht se pelegrinët zgjidhen në shumicën e vendeve myslimane

10 Për një diskutim më të hollësishëm, shih studimet klasike të Bertrand de Jouvenel, *The Art of Conjecture*, Basic Books, New York, 1967 dhe Frederik Polak, *The Image of the Future*, Elsevier, Amsterdam, 1973; original Dutch edition, 1968; shih po ashtu Wendell Bell, *Foundations of Futures Studies*, Transaction Publishers, New Brunswick, 1997, dy vëllime; Për një hyrje më të përgjithshme, shih Allen Tough, *Crucial Questions About the Future*, University Press of America, New York, 1991 dhe Eleonora Barbieri Masini, *Why Futures Studies*, Grey Seal, Londër, 1993.



përmes një lotarie, udhëtarit të mundshëm mund t'i duhet të presë për disa vite, përpara se emri i tij ose i saj të shfaqet. Pavarësisht nga të gjitha paqartësitë, udhëtari formon një të ardhme të dëshiruar, punon për të dhe, më në fund – Në dashtë Zoti! – shndërrohet në një dhuratë të vërtetë.

Vini re, se sa të papritura dhe pasiguri ka edhe në shembullin e thjeshtë të udhëtarit tonë të ardhshëm. Është ende e mundur që, me gjithë përgatitjet, udhëtari ynë i mundshëm të mos arrijë në Mekë. Pavarësisht dëshirës së zjarrtë, burimet financiare mund të mos jenë aty. Emri i tij ose i saj mund të mos dalë në shortin kombëtar të Haxhit. Ata mund të mos jetojnë për ta parë ëndrrën e tyre. Ose, kur del emri i tyre, rrethanat familjare mund të nënkuptojnë se haxhi nuk mund të kryhet atë vit. Udhëtari i mundshëm mund të sëmuret në Mekë, apo edhe të vdesë atje. Pra, ndërsa dëshirohet një e ardhme e caktuar, në fakt, ka një numër të ardhmesh të mundshme. Emërtesa në njëjës “e ardhmja” e përqendron vëmendjen tonë vetëm në një të ardhme, duke na verbuar ndaj mundësisë që e ardhmja është qëllimisht shumë. Ajo ka gjithashtu ndërlikime të rënda politike. Nëse ka vetëm një të ardhme, atëherë ne jemi që të gjithë, pavarësisht nëse pajtohemi apo jo, na pëlqen apo e përçmojmë atë, pjesë e së njëjtës së ardhme që zakonisht mbështetet në dëshirat e të fuqishmëve që sundojnë botën. Sillni ndërmend shtetet totalitare dhe do ta kuptoni se çfarë dua të them. Të flasësh për një të ardhme të vetme, gjithëpërfshirëse, do të thotë ta pushtosh të ardhmen.

Ajo që është e vërtetë për njeriun, është kryesisht e vërtetë për shoqëritë. Për të formuar një të ardhme të qëndrueshme, një shoqëri ka nevojë për një vegim, një përfytyrim të së ardhmes së saj. Më pas duhet të përcaktojë një rrugë drejt përmbushjes së asaj të ardhmeje të dëshiruar: Si do të lëvizi nga ‘këtu’ në ‘atje’? Në atë hartë duhet të jenë të përfshira një varg pyetjesh ‘po sikur?': ndryshorët që mund të shkojnë keq; pengesat që mund të dalin pothuajse nga askund; shtigjet e ndryshme të mundshme, që do të prodhojnë zgjedhje të ndryshme që duhen bërë. Ajo që na paraqitet më pas, nuk është vetëm një e ardhme, por një grup i tërë të ardhmesh të ndryshme.

Për këtë arsye flitet gjithmonë për të ardhmet, duke theksuar me vendosmëri shumë. Ne nuk studiojmë të ardhmen por të ardhmet. Lënda e hulumtimit të së ardhmes quhet “studimet e së ardhmeve.” Botimi që unë redaktoj quhet, dhe me të drejtë, ‘Të ardhmet’. Shumësimi i të ardhmeve u hap rrugë të gjitha mundësive dhe gjasave për një pikëpamje ndryshe të botëkuptimit, kulturës, dhe vlerave, me ç’rast ne mund të përfytyrojmë dhe krijojmë të ardhmet tona të mundshme dhe të parapëlqyera. Kjo gjithashtu



i bën të ardhmet një hapsirë mjaft të diskutueshme. Horizonti kohor i të ardhmeve, shtrihet nga tani deri në përjetësi. Ndaj, të folurit në përgjithësi pa ndonjë ide rreth periudhës me të cilën po merremi, nuk ka ndonjë kuptim. Ne duhet të përqendrohemi te një shtrirje kohore më kuptimplotë, një periudhë të cilën mund ta hulumtojmë, provojmë dhe zotërojmë.

**E TASHMJA PËRBËHET NGA TANI: KY ÇAST, KJO ORË, SOT. POR KJO E TASHME PËRFSHIN EDHE NJË TË ARDHME QË DO TË JETË, MË SHUMË A MË PAK, SI E TASHMJA.**

Nëse diçka e papritur nuk ndodh, e nesërmja do të jetë pak a shumë si sot. Në të vërtetë, duke përjashtuar një ngjarje befasuese me rëndësi të madhe, viti i ardhshëm do të jetë pak a shumë i njëjtë dhe asgjë nuk do të ndryshojë. Kjo është ajo që unë e mendoj si ‘e ardhmja e afërt’, që në fakt është ‘e tashmja e stërzgatur’ dhe që zgjat deri në pesë vjet. Kjo është periudha gjatë së cilës bëhen parashikimet ekonomike, ndërmerren politikat e qeverisë dhe ndërtohen planet zhvillimore. Do të shpalosen shumë risi teknologjike “në të ardhmen e afërt”, por, në tërësi, ato do të jenë një zgjatim i teknologjive të pranishme. Do të ketë zgjedhje në vendet demokratike gjatë kësaj periudhe, por, normalisht, një qeveri e re vazhdon me politikat e së vjetrës në dy vitet e para të qeverisjes së saj. Kjo e ardhme – e tashmja e stërzgatur – është mjaft e qëndrueshme dhe ka prirje të dukshme që mund të vërehen. Planifikimet dhe parashikimet më domethënëse (të cilat janë dy gjëra të dallueshme) bëhen për këtë periudhë.

Megjithatë, nëse shqetësohemi për tjetërsimin e shoqërisë, atëherë ne kemi parë përtej periudhës pesëvjeçare të së tashmes së stërzgatur, ku mund të ndryshojmë fare pak. Një periudhë dhjetëvjeçare na ofron më shumë mundësi. Por njëzet vjet nga tani, ne mund të ndryshojmë pothuajse çdo gjë. Zgjedhjet dhe vendimet që marrim sot, mund të mos ndryshojnë shoqëritë tona në pesë vitet e ardhshme, por ato mund ta tjetërsojnë rrënjësisht botën në njëzet vitet e ardhshme – një periudhë e ngarkuar me tjetërsime shoqërore, kulturore, teknologjike dhe politike.

Horizonti njëzetvjeçar është gjithashtu një periudhë gjatë së cilës rritet dhe piqet një brez i tërë. Historiani mysliman, Ibn Khaldun (1332-1406), studioi se si një brez zëvendëson një tjetër. Në një vepër të shquar, ai parashikoi se kulturat dhe qytetërimet ngrihen dhe bien brenda katër



brezave.<sup>11</sup> Brezi i parë krijon dhe përtërin, ndërsa i dyti prodhon duke vëzhguar të parin. Brezi i tretë imiton dhe nuk shton asgjë me vlerë. Brezi i katërt jeton nga pasuria të cilën e sheh si trashëgimi të ligjshme të brezave të mëparshëm. Pasuria avullon, krijimtaria dhe përtëritja zhduken dhe kultura ngec. Që kultura të ngrihet përsëri, cikli duhet të përsëritet dhe një brez i ri duhet të krijojë dhe përtërijë. Dikush mund të thotë se historia myslimane kurrë nuk e mori kthesën për të prodhuar breza të rinj që krijuan dhe përtërinë, ashtu si brezat në periudhën e themelimit të Islamit.

Në periudhën bashkëkohore, ndryshimet në sjelljen e brezave studiohen duke përdorur atë që quhet *analiza e grupmoshës*.<sup>12</sup> Një grup moshash është një brez që rritet në të njëjtin vend, në të njëjtën kohë dhe njerëzit që i përkasin atij brezi, priren të ndajnë të njëjtat ide dhe besime për botën. Por idetë dhe besimet e grupmoshave të ndryshme janë mjaft të ndryshme nga njëra-tjetra. Për shembull, botëkuptimi i një brezi të rritur në vitet 1990, në një qytet të caktuar, le të themi Kuala Lumpur, do të ishte krejt ndryshe nga një brez i rritur në të njëjtin qytet, gjatë viteve 2010. Kur një grup moshash del në pension, ose largohet nga pushteti, fuqia e tij politike dhe ekonomike kalon te një grup moshash të reja, me një botëkuptim të ndryshëm. Rrjedhimisht, bota dhe e ardhmja ndryshojnë. Grupi i moshës së ardhshme zbaton politika të ndryshme, duke i dhënë vlerë ideve dhe besimeve të ndryshme. Kështu, duke studiuar sjelljen, idetë dhe mendimet e grupmoshës së ardhshme, ne mund të krijojmë një ide të qartë, se si do të duket e ardhmja, kur ai të bëhet grupi zotërues i shoqërisë. Për më tepër, duke ndikuar te brezi i ardhshëm, duke ngulitur disa ide, mënyra të të menduarit dhe të vepruarit, ne mund të kemi një ndikim të drejtpërdrejtë në të ardhmen dhe të përgatitimi për 'të. Por, nëse dëshirojmë të udhëtojmë drejt të ardhmes sonë të parapëlqyer, duhet të veprojmë.

Si mund ta formësojmë në mënyrë veprare të ardhmen e shoqërive myslimane, një ose dy breza nga dita e sotme, njëzet apo dyzet vitet e ardhshme?

Ne kemi nevojë për dy mjete thelbësore. Duhet të kemi një mirëkuptim, një përfytyrim se çfarë e ardhmeje na pret, nëse gjërat vazhdojnë ashtu siç janë. Dhe na duhet një vegim, një largpamësi për mundësi të ndryshme: e ardhmja që dëshirojmë dhe parapëlqejmë. Të dyja kërkojnë krijimtari dhe mend, kjo e dyta nevojitet më shumë se e para dhe ka lloje të ndryshme metodash për t'u marrë me secilën përjasje.

11 Ibn Khaldun, *The Muqaddimah: An Introduction to History*, Routledge dhe Kegan Paul, Londër, 1967 (original, circa 1380).

12 Një studim i madh mbi grupmoshat, është William Strauss dhe Neil Howe, *Generations: The History of America's Future*, William Morrow, New York, 1991.



Për të pasur një ide, se si po formohet e ardhmja, ne mundemi, fjala vjen, të shtrijmë zbatimin e prirjeve të së kaluarës së afërt në të tashmen dhe të shqyrtojmë se si ato do të vazhdojnë në të ardhmen. Për një zbërthim më të stërholluar, mund të marrim në shqyrtim, se si prirjet e ndryshme lidhen me njëra-tjetrën, gjasat e ndërvarësisë dhe ndodhisë së tyre, ajo që quhet zbërthim morfologjik. Ose mund të kërkojmë mendimet e dijetarëve që studiojnë prirjet në mënyrë profesionale. Kjo njihet si metoda *Delphi*, ku dijetarët pyeten pa ndërprerë, derisa të arrihet një mirëkuptim mes tyre. Gjithashtu, mund të ndërtojmë modele kompjuterike të botës, të një ekonomie ose një qyteti, dhe t'i përdorim ato për të parë çfarë ndodh në një të ardhme të caktuar, kur lëvizin ndryshorët e veçantë. Ne mund t'i përdorim këto dhe shumë metoda të tjera për të bërë parashikime, pohime mjaft të sigurtat për gjendje e çështje të ardhshme. Ose mund të prodhojmë parashikime: domethënë të bëjmë një pohim më të kujdesshëm rreth përfundimit të mundshëm në të ardhmen. Nëse një prirje e caktuar vazhdon dhe disa kushte përmbushen, atëherë mund të presim një përfundim të caktuar me një nivel të caktuar besimi. Përfytyrimet dhe vegimet e prodhuara nga planifikime dhe parashikime të tilla, mund të kthehen në mënyra veprimi, përshkrim tërësor i rrethanave të së ardhmes, me një përparim ngjarjesh që na çojnë drejt të ardhmes që është përshkruar.

Parashikimet dhe planifikimet na bëjnë të vetëdijshëm për kërcënimet dhe rreziqet e mundshme përpara. Ato shërbejnë si sinjale paralajmëruese të hershme, në mënyrë që ne të mund të ndryshojmë drejtimin, të zhvillojmë plane aty për aty, të përgatitemi për t'u përballur me sfidat e reja. Por hamendjet e tilla kanë gjithashtu kufizime. Duke qenë se ato mbështeten në çastin historik dhe prirjet e tanishme, nuk kanë fuqi ndryshimi. Ato na tregojnë se si mund të duket e ardhmja, jo si do të donim të ishte e ardhmja. Për të shpikur dhe formësuar të ardhmen tonë të parapëlqyer, duhet të shikojmë diku tjetër.

Ecuria e formësimit të një të ardhmeje të dëshirueshme është më shumë si një udhëtim. Ju duhet të keni një ide, se ku do të mbërrini, në të vërtetë, se ku dëshironi të shkoni. Ju duhet të vendosni për një mënyrë transporti, çfarë do t'ju çojë vërtet atje. Duhet të keni një ndjesi drejtimi, një mjet i brendshëm lundrimi që ju mban të orientuar në drejtimin e duhur, në mënyrë që të mos përfundoni në një stacion hekurudhor, ndërkohë që duhet të jeni në një aeroport. Duke punuar drejt një të ardhmeje të dëshiruar, vendmbërritja është një përfytyrim; mënyra e transportit është një ecuri e përsëritur planifikimi, e quajtur përmbysje (në dallim me parashikimin);



ndjesia e drejtimit vjen nga mirëkuptimi që dikush ndërton rreth përfytyrimit të një të ardhmeje të qëndrueshme, si dhe përpjekja e përbashkët që bëhet për të punuar drejt atij përfytyrimi.

**VEGIMI ËSHTË NJË PËRFYTYRIM I PËRBASHKËT PËR NJË TË ARDHME TË DËSHIRUAR. POR, NDRYSHE NGA PËRFYTYRIMET E TJERA TË SË ARDHMES, NJË VEGIM ËSHTË NJË PËRFYTYRIM I SHUMË NUMËRUAR I SË ARDHMES, ME SHUMICËN E PËRVIJIMEVE DHE HOLLËSIVE TË PËRPUNUARA, SI DHE HISTORINË E ARDHMËRISË SË DËSHIRUAR NGA NJË GRUSHT NJERËZISH, E SHPREHUR TEPËR QARTË.**

Ai duhet t'i ketë të dyja: vërtetësinë, pra duhet të jetë i arritshëm dhe bindës, në mënyrë që të mund t'i shtyjë njerëzit të veprojnë. Përfytyrimet tona drejt të ardhmes së përveçme dhe të përbashkët luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e saj. Kështu që vegimet kanë fuqinë e ndryshimit: ato nxitin mendimin dhe drejtojnë sjelljen e njerëzve dhe shoqërive drejt një të ardhmeje të dëshiruar. Një vegim është si një magnet që tërheq të tashmen drejt një të ardhmeje të përfytyruar. Si një busull, një vegim mund të tregojë drejtimin e ardhshëm drejt të cilit dëshirojmë të udhëtojmë. Kulturat dhe shoqëritë dalin nga fshikëza e tyre, përmes vegimeve të mirëqartësuar që i tejkalojnë kufizimet e tyre dhe i shndërrojnë ato, si një flutur, në nivele më të larta të ekzistencës. Mendoni se si Europa moderne u formua nga vegimi rilindës. Ose se si 'Pranvera Arabe' lindi nga vegimi i një demokracie laike (edhe pse islamistët, me disa përjashtime, nuk e kanë idenë se si vihet në punë demokracia dhe i barazojnë laikët me të pafetë).

Megjithatë, vegimet kanë një pikë të dobët. Ato mund të kthehen në utopi – domethënë, ato bëhen një vend i përfytyruar ku gjithçka është e përsosur. Aq e përsosur, saqë, në të vërtetë, është një "askundnajë" (kuptimi i fjalëpërfjalshëm i utopisë), ose një vend ku qenia njerëzore e papërsosur nuk mund të ekzistojë. Shpesh, utopitë bëhen padrejtësi, makthe dhe vuajtje. Si utopitë, ashtu edhe tiranitë, kanë një tërheqje të jashtëzakonshme largpamëse dhe fuqi shtytëse. Vini re, se si Irani pas-revolucionar u ndërtua si një utopi teokratike që shumica e myslimanëve në mbarë botën e pajtuan, derisa u bë e qartë se ishte një makth sundimtar. Shikoni utopinë islame të ndërtuar nga *salafët* dhe degët e tyre të ndryshme – talebanët e Pakistanit



dhe Afganistanit; shababët në Somali dhe degë të ndryshme të al-Kaedas. Kjo ka nxitur një brez të rinjsh myslimanë për t'u bërë xhihadistë.

Për ironi, salafët mund të thuhet se janë të vetmit myslimanë me njëfarë ndërgjegjësimi për të ardhmen, edhe pse në mënyrë të pavetëdijshme. Edhe pse utopia e tyre ndodhet jo në të ardhmen, por në Arabinë e shekullit të VII-të, gjatë periudhës së Profetit dhe pasardhësve të tij, ajo është ndërtuar si një ideal romantik dhe një shoqëri e përsosur. Është një utopi tërësore: e plotësuar me ligje, kode morali dhe marrëdhënie gjinore, një sistem qeverisjeje, luftë, politika ndaj të huajve, madje edhe marrëdhënie ndërkombëtare. Salafët punojnë drejt përmbushjes së utopisë së tyre pa asnjë ngurrim, me dhunë të ashpër e çnjerëzore dhe me vetëbesim të pagabueshëm. Utopi të tilla tradicionale, siç ka theksuar intelektualit dhe filozofi indian, Ashis Nandy, janë nga vetë natyra sundime totalitare.

**POR NJË UTOPI NUK DUHET TË DEGJENEROJË NË SHTYPJE DHE SHFRYTËZIM DHE NË NJË SISTEM TË MBYLLUR SUNDIMTAR. PËR TË SHMANGUR KËTË MUNDËSI TË VËRTETË, NJË UTOPIE I NEVOJITET NJË PIKË “DALJE”. DUHET TË JETË E HAPUR, BASHKËJETUESE DHE T’I LEJOJË ATA QË NUK PAJTOHEN ME PËRFYTYRIMIN UTOPIAN, QË TË MOS PAJTOHEN DHE TË LARGOHEN. AJO DUHET “TË TREGOJË DISA AFTËSI PËR TA ÇLIRUAR UTOPIANIN NGA XHAKETA E TIJ E NGUSHTË”.**

Ajo duhet të jetë e hapur ndaj qortimeve, nga vegimet dhe utopitë e tjera. Ajo nuk mund të synojë “një monopol mbi dhembshurinë dhe përshkrimin e shoqërisë” mbi të vërtetën, ligjin ose moralin; apo të thotë se mban “çelësin përfundimtar të moralit dhe përvojës shoqërore”.<sup>13</sup> Nëse një utopi ka këto veçori, ajo mund të shërbejë si një mjet i dobishëm për të përmirësuar të kuptuarit tonë rreth pamjes së përgjithshme të së ardhmes. Pothuajse të gjitha idetë e qëndrueshmërisë apo demokracisë, për nga natyra, janë utopike.

Historikisht, myslimanët kanë ndërtuar utopi të tilla të hapura dhe vetëqortuese. Një shembull i mirë, është libri *Qyteti i përsosur*, nga al-Farabi<sup>14</sup>, ku një qytet i mirë dhe i virtytshëm krahasohet me një trup njerëzor funksional dhe të shëndetshëm. Që të dy librat: *Hayy ibn Jaqzan*, i Ibn

13 Ashis Nandy, *Traditions, Tyranny and Utopias*, OUP, Delhi, 1987, f. 6–13.

14 Al-Farabi, *On the Perfect State*, translated by Richard Walzar, Great Books of the Islamic World, Cambridge, 1997.





*Tufejl-it*<sup>15</sup> dhe *Awaj bin Anfaq*<sup>16</sup>, të shkruara në shekullin e XIII-të nga mjeku dhe astronomi al-Qazwini, ofrojnë një pamje të përgjithshme të përmirësimit njerëzor, mbështetur në idealet islame. Në të vërtetë, *Hayy ibn Jaqzan* është njëkohësisht një mbrojtje e arsyetimit, si dhe një vegim utopik i një shoqërie më të mirë. Në librin *Awaj bin Anfaq*, botuar rreth vitit 1250, një burrë nga një planet i largët mbërrin në tokë dhe mahnitet nga sjellja njerëzore. Synimi i rrëfimit, i gjykuar si romani i parë i mirëfilltë fanta-shkencë në histori, është të shqyrtojë synimin e përbotshtëm për ndërtimin e një shoqërie të drejtë. Kohët e fundit, në librin *Udhëtimi i Ibn Fattuma*, të shkrimtarit Naguib Mahfouz<sup>17</sup>, protagonist, duke kërkuar gruan dhe djalin e tij të humbur, kalon kohën në dy utopi fetare të dallueshme, njëra ku liria vlerësohet mbi të gjitha dhe tjetra ku drejtësia mbretëron në shkallën më të lartë.

Kështu pra, utopitë nuk duhet të jenë padrejtësi. Ato mund të vihen në punë si vegime dhe t'i plotësojnë ato, për të ofruar një përfytyrim të përbashkët të një të ardhmeje të mundshme që një shoqëri mund ta synojë. Megjithatë, zhvillimi i një përfytyrimi të përbashkët, i cili përfshin të gjithë aktorët e ndryshëm në një shoqëri, nuk është një detyrë e lehtë.

Pasi të kemi përcaktuar vegimin, na duhet një datë e mundshme, deri në të cilën ai duhet të përmbushet, koha e nevojshme për të mbërritur te ndalesa jonë. Ne duhet të jemi në gjendje të mbërrijmë te ndalesa jonë brenda një ose dy brezash, le të themi dyzet vjet nga tani. Ndryshe nga parashikimi - i cili përfshin shikimin nga e tashmja tek e ardhmja - puna me vegimet që ndodhen në të ardhmen, përfshin shikimin nga e ardhmja tek e tashmja. Pra, në vend që të parashikojmë, fillimisht ne përcaktojmë të ardhmen, pastaj ndërtojmë shtigje për të mbërritur atje. Ne fillojmë nga e ardhmja në të cilën ndodhet vegimi ynë dhe numërojmë mbrapsht, duke bërë një varg pyetjesh. Nëse, për shembull, vegimi është ai i një qyteti në vitin 2050, ne pyesim: Çfarë duhet të ndodhë në qytet, në vitin 2049, që vegimi të përmbushet në vitin 2050? Çfarë duhet të ndodhë në vitin 2048, për të shkaktuar ngjarjet përkatëse, të dëshiruara për vitin 2049? E kështu me radhë. Por nuk jemi të detyruar të punojmë për çdo vit; ne mund të zbresim me periudha dy, tre ose pesë vjeçare. Qëllimi i ushtrimit është të nxjerrë në pah ngjarje që duhet të ndodhin në çdo nyje të rëndësishme dhe të bashkërendojmë hapat që duhet të ndërmerren për të mbërritur te

15 Shih Ibn Tufayl, "The Story of Hayy ibn Yaqzān" (1169–79) in *Two Andalusian Philosophers*, translated by Jim Colville (Kegan Paul International, Londër, 1999); ose download Simon Ockley's 1708 translation of Hayy ibn Yaqzan from: [www.muslimphilosophy.com/books/hayy.pdf](http://www.muslimphilosophy.com/books/hayy.pdf)

16 Fatkeqësisht, *Awaj bin Anfaq*, gjendet vetëm në formë dorëshkrimi.

17 Naguib Mahfouz, *The Journey of Ibn Fattouma*, Anchor Books, New York, 1993.



secila pikë kthese. Në këtë mënyrë, mund të krijohet një afat kohor që lidh të tashmen me vegimin; mund të zhvillohen përqasje, programe dhe vepërime të nevojshme për të mbërritur te piketa. Përfundimi është një plan i detajuar që mund të përdoret për të ecur përpara nga e tashmja, hap pas hapi, duke kaluar nga një piketë në tjetrën, drejt vegimit të dëshiruar. Cilësia e numërimit mbrapsht dhe planit aty për aty, varen se me çfarë kujdesi përcaktohen kushtet për mbërritje në çdo periudhë të veçantë. Është mekanizmi që kemi ndërtuar për trajtimin e rastisjeve ose 'kthesës së fatit', ngjarjeve të papritura që mund të na dalin duarsh. Njëkohësisht, kjo tregon edhe masën e pjesëmarrjes përgjatë gjithë ecurisë.

Më lejoni ta sqaroj këtë me një shembull të thjeshtë. Përfytyroni një qytet që shumë prej nesh do ta njohin! Le të marrim parasysh Karaçin, pas dyzet vjetësh, rreth dy breza nga dita e sotme! Cili është përfytyrimi im për Karaçin në vitin 2040? Unë e parashikoj Karaçin të lirë nga grindjet racore dhe shoqërore, nga ndotja dhe vonesat në trafik, me shumicën e banorëve të tij në punësim fitimprurës, strehim të përshtatshëm, ujë të pastër dhe energji elektrike, si dhe një rrjet të mirë transporti publik. Në Karaçin tim të vitit 2040, tregtia po lulëzon falë portit i cili është bërë qendra e vëmendjes për transportin në Azinë Jugore, ka ligj dhe rend, ka një qeveri vendore të përgjegjshme dhe llogaridhënëse. Ndërsa ky mund të jetë një përfytyrim i së vërtetës së Karaçit në të ardhmen, ai është shumë larg nga gjendja e Karaçit të sotëm.

Për ta kthyer këtë vegim në një propozim të zbatueshëm, do fillojmë numërimin mbrapsht dhe do të punojmë duke filluar nga viti 2040. Cilat kushte duhet të plotësohen në vitin 2038, që përfytyrimi im i Karaçit të vihet në vend, deri në vitin 2040? Epo, që shumica e banorëve të jenë në punë fitimprurëse, një lloj përqasjesh punësimi duhen vënë në lëvizje të plotë; infrastruktura bazë e qytetit, duke përfshirë sistemin e transportit publik, duhet të jetë në nivelin e duhur; një numër i mjaftueshëm njësisish banimi me çmim të ulët duhet të ndërtohen për të ndihmuar lagjet e varfëra etj.. Pra, që këto gjëra të kenë ndodhur deri në vitin 2038, çfarë duhet të ketë ndodhur deri në vitin 2036 dhe 2034, 2032, 2030... e kështu me radhë, deri në ditët e sotme?

Gjithashtu duhet të shqyrtojmë mundësitë e kundërta: Çfarë mund të ndodhë për të dëmtuar zbatimin e suksesshëm të qëllimeve të caktuara? Çfarë mund të shkojë keq? Në fund të ushtrimit, dalim me dy përfundime: një përfytyrim të Karaçit për vitin 2040 dhe një plan të hollësishëm, të përpunuar së prapthi, nga që nga viti 2040 e deri më sot. Plani ka synime



dhe qëllime vjetore, duke ofruar një plan veprimi hap pas hapi, se si mund të përmbushet përfytyrimi ynë. Ky lloj planifikimi është një mjet shumë fuqizues. Ai sjell atë që në dukje është një qëllim i paarrtshëm, i largët, në fushat e zgjedhjeve të mundshme për t'u përmbushur. Sa më i hollësishëm dhe i vërtetë të jetë vegimi, sa më i plotë të jetë planifikimi së prapthi, aq më e përshtatshme është e ardhmja. Natyrisht, vegimi im vetjak dhe planifikimi së prapthi nuk janë as të përshtatshëm dhe as në gjendje të formësojnë në vetvete një të ardhme të qëndrueshme për Karaçin. Për të qenë kuptimplotë, si parashikimi, ashtu edhe planifikimi së prapthi, fillimisht duhet bërë një përpjekje shoqërore e përbashkët: formësimi i së ardhmes është një përpjekje e mbështetur në pjesëmarrje.<sup>18</sup>

Ndërsa vegimet i ofrojnë një shoqërie një vend mbërritje të ardhshme, planifikimi së prapthi i mundëson asaj shtigje, mënyra dhe mjete për të mbërritur 'atje', nga 'këtu ku jemi tani'. Gjithmonë përfundon me hapat e parë që duhen ndërmarrë në të tashmen. Për më tepër, planifikimi së prapthi nuk është një përpunim një herë e përgjithmonë. Ai duhet të jetë i vazhdueshëm, përsëritës dhe duhet të mbajë në lëvizje të gjithë aktorët e përfshirë. Ai fton pjesëmarrjen, si në përcaktimin, ashtu edhe në zhvillimin e rrugëve drejt të ardhmes së dëshirueshme Duke e kthyer atë që në dukje është e 'pamundur', në një mënyrë veprimi të vazhdueshme, ai mundëson besimin në tjetërsimin e vërtetë të shoqërisë. Ndryshe, shqyrtimi dhe përcaktimi i së ardhmes është në vetvete një përpjekje shpresëdhënëse.

Por ka edhe shumë mënyra të tjera, të thjeshta dhe të ndërlikuara, për të shqyrtuar të ardhmen.<sup>19</sup> Unë jam përqendruar në disa, më të shquarat që i kam përdorur në punën time. Por cilado qoftë mënyra që përdoret, qëllimi i përgjithshëm i gjallërimit të vegimeve të së ardhmes është përmirësimi i ecurisë sonë të vendimmarrjes në të tashmen. Shumica e çështjeve tona bashkëkohore nuk janë shfaqur papritur, por kanë ekzistuar me dhjetëra vjet, në mos me shekuj, duke u zierë, derisa kanë mbërritur në pikën e vlimit. Shumë prej tyre mund të ishin trajtuar më herët, kur ishin më të zotërueshme. E kaluara hyn në të ardhmen jo vetëm si prirje, por me një vrull historik që shpesh është vështirë të shpërfillet dhe, ndonjëherë, nuk mund të lihet pas dore.

18 Ky shembull është marrë nga artikulli im: 'What do we mean by Islamic Futures?', në *The Blackwell Companion to Contemporary Islamic Thought*, edited by Ibrahim M. Abu-Rabi, Blackwell, Oxford, 2006, f. 562–586.

19 Metoda të reja për studimin e së ardhmes po zhvillohen vazhdimisht. Për një trajtim gjithëpërfshirës, shih Jerome Glenn dhe Theodore Gordon, *Futures Research Methodology*, The Millennium Project, Washington DC, 2009, version 3.0.



## QËNDRIMI NDAJ SË KALUARËS

E ardhmja jonë është gjithashtu pjellë e vendimeve që paraardhësit tanë kanë marrë në të kaluarën. Historia jo vetëm që na tregon diçka për të kaluarën tonë, por gjithashtu ndikon në të tashmen dhe formëson të ardhmen. Të gjitha shoqëritë kanë histori të përjetësuara, shpesh të përshkruara si tradita që formojnë veçantinë e tyre. Një e ardhme pa veçanti, nuk është aspak e ardhme. Megjithatë, jo e gjithë historia jonë është pjesë e së ardhmes. Po të ishte, do të jetonim në histori. Ka anë të së shkuarës që bëhen një barrë e padurueshme dhe, në të vërtetë, fshijnë të ardhmen. Ajo që na shqetëson, nuk janë faktet e historisë, të cilat në vetvete nuk kanë asnjë kuptim. Ato marrin kuptim brenda një kuadri idesh, janë idetë brenda historisë dhe rreth saj, që ndikojnë për mirë ose për keq në formësimin e së ardhmes.

Për të vlerësuar se si historia mund ta pengojë shfaqjen e së ardhmes së qëndrueshme, le ta pranojmë për një çast, se modeli ideal i shoqërisë ka ekzistuar vetëm gjatë kohës së Profetit Muhamed dhe Kalifëve apo Udhërrëfyesve të Duhur. Ky është përafrimi më i madh i Islamit me një shoqëri të përsosur. Bindja e palëkundur për shumicën e myslimanëve besimtarë është se shmangja nga përsosmëria, kundërshtimi i modelit ideal, mund të nënkuptojë vetëm një gjë dhe ajo është përkeqësimi. Për më tepër, nëse duhet t'i ndjekim salafët, brezat e parë të myslimanëve, në fakt, po ndjekim njerëz që vazhdimisht largohen nga përsosmëria e përfytyruar – domethënë, përkeqësimin. Ajo që po them këtu, është se të përshkruash shoqërinë e tre brezave të parë të myslimanëve si një utopi, do të thotë të vendosësh qytetërimin mysliman brenda kornizës së një teorie përkeqësimi. Ose, nëse mendojmë se të vetmet shpjegime të vlefshme të Kuranit janë ato të bëra në histori nga dijetarët klasikë, që janë vazhdimisht të njëzëshëm në shpjegimet e tyre, atëherë nuk mund të bëhen shpjegime rrënjësish të reja. Të gjitha këto ide janë, në fakt, teori të maskuara të përkeqësimit. Asnjë përparim nuk është i mundur, nëse i gjithë përparimi i historisë është bërë tashmë.

Nuk duhet ta harrojmë edhe idenë, se “Islami është një mënyrë e plotë jetese”. Përsëri ky është një besim tipik për shumicën e myslimanëve, pavarësisht nga prirjet e tyre sektare. Pohimi nënkupton se të gjitha çështjet e etikës, moralit, ligjit, qeverisjes, në të vërtetë, e gjithë jeta njerëzore është caktuar përmes historisë. Nëse do të ishte kështu, atëherë përparimi etik dhe moral, përmirësimi i ligjit dhe fusha të tjera të rëndësishme të mendimit njerëzor, ngelin në vendnumëro. Edhe një vëzhgim i rastësishëm mund të zbulojë se pohimi është i rremë. Për shembull, nuk



ju nevojitet Islami për t'u bërë kirurg, inxhinier apo llogaritar. Ju duhet të shkoni në një institucion të duhur dhe të mësoni. Islami nuk thotë asgjë për rregullat e trafikut, veprimet burokratike, inxhinierinë gjenetike, apo sjelljen ndaj ndërlëkimit dhe shumë anë të tjera të jetës bashkëkohore. Por, nëse mendoni se të gjitha përgjigjet janë dhënë tashmë në "mënyrën e plotë të jetesës", atëherë nuk do të shqetësoheni shumë për çështjet e ngutshme që fshihen në horizont, e jo më të kërkonti përtëritje dhe zgjidhje të reja. Për më tepër, nëse të gjitha pyetjeve tashmë u është dhënë përgjigje dhe çështjet janë zgjidhur, atëherë çfarë dobie ka jeta njerëzore, gjithësesi?! Ne mund të ekzistojmë edhe si bagëti në një fermë.

Dikush mund të bëjë një arsyetim të ngjashëm në lidhje me Sheriatin. Nëse Sheriati është Hyjnor, atëherë nuk ka asnjë argument. Urdhrat ligjore të zhvilluara për të zgjidhur çështjet e një periudhe të shkuar, mbështetur në rrethanat shoqërore dhe kulturore dhe të kuptuarit e një shoqërie mesjetare, bëhen ligji dhe morali i shoqërive myslimane për të gjitha kohët - të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Kjo do të thotë se morali nuk mund të përmirësohet, mendimet tona për barazinë nuk mund të zgjerohen, idetë tona për larminë nuk mund të përhapen dhe përpjekjet tona për të krijuar një shoqëri të drejtë dhe të barabartë, në një botë që ndryshon me shpejtësi, janë të ngrira në histori.

### **HISTORIA MYSLIMANE ËSHTË PLOT ME IDE QË MË SHUMË E MBYLLIN SESA E HAPIN TË ARDHMEN DREJT MUNDËSIVE DHE POTENCIALEVE TË NDRYSHME.**

Këto ide përqafohen jo vetëm nga vehabistët, salafistët, islamistët, lëvizjet islamike si Vëllazëria Myslimane dhe Xhemat-e-Islami, por edhe nga shumica e besimtarëve myslimanë. Ata (ne) janë përgjegjës për faktin se shoqëritë myslimane janë zhvendosur nga një e ardhme e padëshirueshme në tjetrën për shekuj me radhë dhe përfaqësojnë kërcënimin më të rëndësishëm për formimin e të ardhmes së qëndrueshme dhe më të frytshme për veten tonë. Këto ide shërbejnë si kufij të palëvizshëm, si shinat e një treni, duke siguruar që e ardhmja të lëvizë në një drejtim të vetëm, me një vend mbërritje të vetme, të caktuar nga fillimi në fund. Përpjekjet për të ndryshuar drejtimin janë të pakta: shinat janë të caktuara, drejtimi është përcaktuar nga e shkuara e largët. Ky është paracaktimi i pashmangshëm vdekjeprurës në veprim. Nuk është çudi, që ky tren i së ardhmes



myslimane shpeshherë të udhëtojë mbrapsht. Kjo është gjithashtu arsyeja, pse mysli-manët kanë jetuar në histori, në vend që të bëjnë histori.

Kurani na paralajmëron gjerësisht për marrëzi të tilla. Në një ajet të bukur gjejmë: “Kur u thuhet atyre: - Ruajuni nga ajo që qëndron para dhe pas jush, në mënyrë që të mëshiroheni!, - ata injorojnë çdo shenjë që vjen nga Zoti i tyre”(36:45). Ajeti këshillon se ne kemi nevojë për njëfarë vetëdije rreth asaj që është ‘përpara nesh’, në të ardhmen e afërt; dhe ‘prapa’ nesh, në vullin e historisë, për të pasur mëshirën e Zotit, që është begati në këtë botë dhe shpërblimi në botën e amshuar. E shkuara lidhet me të ardhmen në dy mënyra me fjalën ‘Ruajuni!’. Kur anët e errëta të historisë përcaktojnë të ardhmen, ajo mbytet dhe mohohet mëshira e Zotit. Por, kur e ardhmja përcaktohet nga ide që përmirësojnë jetën, ajo ndriçohet dhe hapet kundrejt të gjitha mundësive tradicionale dhe kundërshtuese, dhe mëshira e Zotit është dhënë. Ky ajet i paraprin sures *Jasin* me një fragment që flet për ligjet natyrore (‘Dielli, gjithashtu, ndjek rrugën e tij të përcaktuar, e shtruar për ‘të nga i Plotfuqishmi, i Gjithëdijshmi’ 36:38), duke nënkuptuar se është gjithashtu një ligj natyror, përmes së cilit disa anë të historisë do të formësojnë vetëm disa lloje të ardhmesh. Për më tepër, fragmenti që vjen më pas (36:45), hedh dritë edhe mbi lidhjen e shkuar - e ardhme: ‘Dhe ata thonë: “Kur do të përmbushet ky premtim, nëse ajo që thua është e vërtetë?” Por e vetmja gjë që ata presin, është një shpërthim i vetëm që do t’i zërë në befasi, ndërsa ata ende po grinden me njëri-tjetrin” (36:48). Premtimi në fjalë është premtimi i një të ardhmeje të gjallë, të vullshme, “me banesa të larta, të ndërtuara për ‘ta, njëra mbi tjetrën, hijeshuar me burime të rrjedhshme” (39:20). Por ky premtim nuk përmbushet duke mos bërë asgjë, thjesht duke ‘pritur’ për ‘shpërthimin e vetëm’ të Ditës së Gjykimit, ose duke u grindur për gjëra të vogla dhe pika hamendësuese të besimit. Ai arrihet duke formësuar në mënyrë veprorë të ardhmen.

Ashtu sikurse historia myslimane është plot me ide që e përjashtojnë historinë, gjithashtu është e mbushur me ide që kanë fuqi çliruese, të cilat e hapin të ardhmen drejt mundësive të shumta. Ndoshta ideja më gjallëruese që përfshin angazhimin e vazhdueshëm me të tashmen dhe me të ardhmen, është *itihadi*, i përkthyer normalisht si ‘arsyetim i pavarur’. Është e qartë se arsyetimi nuk është diçka që mund të bëhet vetëm një herë e përgjithmonë, arsyetimi shpesh çon në risi. Megjithatë, për një arsye apo një tjetër, “portat e itihadit” janë mbyllur disi, sikurse çështjet e besimit, etikës, moralit, ligjit dhe qeverisjes të mos kishin më nevojë për arsyetim. Kur përdoret itihadi, siç mburren ndonjëherë të ashtuquajturit



‘dijetarë’, ai kufizohet në çështje që të lënë me gojë hapur, por me përgjigje të kuptueshme. Ku është kibla në hapësirë? A mund të përdoret trajtimi i pjello-risë nga myslimanët? A mund të bëhen gratë anëtare të një Mexhlis-e-Shura? Megjithatë, itihadi, ideja themelore për t’iu përshtatur ndryshimeve në histo-rinë myslimane, ka të bëjë me ide madhështore dhe sfidimin e urtësisë së pranuar. Ka të bëjë me ripërcaktimin e Sheriatit, me vijat ndarëse të fuqisë shpjeguese dhe autoritetit fetar, hapjen e Islamit ndaj shumë mundësive të së ardhmes. Në një poezi të titulluar ‘Itihad’, e cila shfaqet në antologjinë e *Zarb-e-Kaleem*<sup>20</sup>, *Muhamed Iqbal, një nga mendimtarët më të thellë të shekullit të XX-të, nënvizon disa pohime me vend :*

Ku mund ta gjesh në Indi urtësinë e besimit?  
Ku janë burrat e ndershëm, ku janë mendimet e denja?  
Ku janë ata që guxojnë të dyshojnë?  
Hak! Kjo skllavëri, besnikëri ndaj urtësisë së marrë,  
mungesa e mendjes pyetësorë!  
Në vend që të përqafojnë ndryshimin, ata e keqlexojnë Kuranin.  
Oh! Vdekje e përfytyrimit të shpjeguesit e besimit.  
Është besimi i këtyre skllavërve, se Kurani qenka i mangët,  
ngaqë nuk ia mëson besimtarit rregullat e robërisë.

*Itihadi* ka të bëjë me pyetjen, përqaftimin e ndryshimit dhe përkthimin e sigu-risë së historisë në dyshime. Ajo na çliron nga të qenit skllavër të historisë dhe të bëhemi viktima të ‘rregullave të robërisë së saj’. Ka të bëjë me të menduarit me guxim dhe largpamësi për të ardhmen e mundshme, të besueshme dhe të dëshirueshme. Bëhet fjalë për të menduarit e thellë në kuptimin teorik të zbrërthimit të strukturave të pushtetit dhe dijes në të gjitha mënyrat.

Të marrim një shembull tjetër, idenë e Kalifit, kujdestaria e qenieve njerëzore që ka luajtur një rol kaq të rëndësishëm në historinë myslima-ne. Ai është në thelb një mendim i orientuar drejt të ardhmes. Si kujde-starë të besuar të Zotit, ne na kërkohet të jemi përgjegjës të besimit – Tokës, mjedisit, dheut, burimeve, pasurisë kulturore dhe historike – në një mënyrë të përgjegjshme, morale dhe shoqërore. Ato duhet t’u dorëzohen brezave të ardhshëm, të paktën në kushte po aq të mira, në mos shumë më të mira sesa janë tashmë. Disa institucione shoqërore islame u zhvilluan posaçërisht për të përballuar këtë sfidë. Për shembull, gjatë historisë, myslimanët kanë qenë të prirë për të krijuar vakëfe (themelet e devotshme) për qëllime shoqërore dhe vetjake. Vakëfet janë në thelb të orientuara drejt

20 Sir Muhammad Iqbal, *Zarb-e-Kaleem*, Lahore, 1936; pdf file from <http://urdupunch.blogspot.co.uk/2012/08/Zarb-eKaleem-ByAllama-Iqbal.html>





të ardhmes. Si janë? Ato financojnë institucione arsimore që mund të arsimojnë brezat e ardhshëm; financojnë punë kërkimore dhe zhvillimore që mund të lehtësojnë dhimbjen dhe të përmirësojnë jetën e brezave të ardhshëm; përdoren për ushqimin dhe furnizimin me ujë të nevojtarëve dhe udhëtarëve, sot dhe nesër. E njëjta e ardhme e orientuar drejt logjikës vihet re në krijimin e vendeve haram, apo të pacenuara, në të cilat zhvillimi ishte i ndaluar me ligjin islam, por edhe në krijimin e rezervateve të *hima* (të paprekshme) për ruajtjen e jetës bimore dhe shtazore. Myslimanët ndërtuan qytete, si Fez dhe Alepo, me një vlerësim të mundësisë mbajtëse dhe zonave të pacenuara përreth tyre, ku zhvillimi ishte i ndaluar. Gjithashtu, nuk lejohej zhvillimi rreth rrjedhave ujore, puseve, të korrave dhe vendbanimeve. Tokat e tjera mbroheshin për të mirën e qytetarëve. Kullotja, prerja e pemëve dhe gjuetia u ndaluan në male apo pyje përreth qyteteve. Të dy institucionet, *haram* dhe *hima* ishin në thelb e ardhmja. Qëllimi i tyre kryesor ishte ruajtja e burimeve natyrore për të gjitha kohërat. Një burim plotësues i Sheriatit, shumë i anashkalluar, është *Istislah* (interesi qytetar), i cili synon të ruajë atë që është e mirë dhe e dobishme në shoqëri për brezat e ardhshëm.

Një ndërgjegjësim për të ardhmen, gjithashtu mund ta shohim në jetën e Profetit Muhamed. Për shembull, ai ndaloi prerjen e pemëve dhe gjuetinë e kafshëve të egra në pyjet përreth qyteteve, duke përfshirë Mekën, Medinën dhe Taifin, sepse ato siguronin ushqim për njerëzit e kafshët, si dhe mbronin qytetet me një brez të gjelbër. Vazhdimisht, ai parashikonte mundësitë e ardhshme, përpara se të ndërmernte veprime. Hixhreti, shpërngulja nga Meka në Medinë, u bë me pritshmërinë për një të ardhme më të qëndrueshme për bashkësinë e vogël myslimane të atëhershme. Ishte planifikuar në mënyrë të përpiktë dhe shtegu përmes së cilit do të shpërnguleshin, u hap vazhdimisht, përgjatë disa muajve. Profeti parashikoi kryengritjen e kurejshëve kundër tij, u përgatit paraprakisht dhe u takua me ushtrinë që përparonte jashtë Medinës, në një pikë që ai e dinte se do t'i jepte ushtrisë së vogël myslimane një përparësi strategjike: ky ishte pusi i Bedrit. Në mënyrë të ngjashme, ai doli në Uhud për të siguruar përparësinë në majë të malit, ku vendosi një grup harkëtarësh, gjatë betejës së Uhudit. Muaj përpara betejës së llogoreve, Profeti parashikoi përlëshjen e ardhshme dhe u përgatit për të mbrojtur Medinën, duke hapur një llogore rreth qytetit dhe kështu, ai parandaloi një përlëshje më të gjerë. Këta shembuj tregojnë se Profeti merrej me planifikim strategjik dhe vazhdimisht parashikonte atë që fshihej në horizont.





Myslmanët e shohin Profetin si një model për t'u ndjekur, por ne e përqendrojmë vëmendjen tonë në hollësitë e jetës së tij - nga mënyra se si ai hante, ulej, ecte e deri te mënyra se si vishej, ngjyra e rrobave, stili i çallmës së tij dhe, po, gjatësia e mjekrës së tij. Por këto janë çështje rrethana të veçanta të historisë. Profeti mund ta bënte jetën e tij të përditshme, i shtyrë nga rrethanat e periudhës në të cilën jetoi. Ato nuk kanë asnjë rëndësi botërore. Ndjekja e një shembulli të tillë, mund të sigurojë një ndjenjë drejtësie për njeriun dhe shoqërinë, por nuk luan asnjë rol në formësimin e një të ardhmeje, sipas parimeve dhe moralit islam. Ajo që është botërore rreth Sunetit, ose shembullit të Profetit, është mënyra se si ai sillej në disa çaste kyçe të jetës së tij dhe parimet morale që sollën veprimet e tij. Janë këto parime që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në formësimin e së ardhmes më të sigurtë për shoqëritë myslimane.

Në jetën e Profetit gjenden tri çaste të rëndësishme që kanë nevojë për vëmendjen tonë. Pas hixhretit, një nga veprimet e para të Profetit ishte themelimi i Kushtetutës së Medinës. Ajo që duhet theksuar, është se Kushtetuta nuk përmend Zotin apo Shpalljen në fillim. Nëse Profeti e shihte Kuranin si një "kushtetutë", siç pretendojnë shumë myslimanë tani, ai do ta kishte përdorur atë si të tillë. Përkundrazi, veprimi i tij lë të kuptohet se kushtetutat janë të krijuara nga palët e interesuara në shoqëri, ato nuk shpallen. Për më tepër, Kushtetuta e Medinës është një dëshmi gjithëpërfshirëse që përfshin jo vetëm myslimanët e Medinës dhe ata që shtegtuan nga Meka, por edhe hebrenjtë dhe ata që besonin në shumë perëndi. Ajo përmban disa artikuj që synojnë veçanërisht myslimanët, por edhe bashkësive të tjera fetare ua jep detyrimet e tyre të ligjshme. Ajo siguron kuadrin ligjor për qeverisjen e Medinës, një shoqëri multifetare, ku të gjithë trajtohen në mënyrë të barabartë, në bazë të ligjit, dhe nuk përmend asnjë epror tjetër jashtëgjyqësor. Rojtarët e Kushtetutës janë qytetarët e Medinës të cilët 'formojnë një popull'. Zoti hyn në Kushtetutë drejt fundit, si "mbrojtësi i atij që është i drejtë dhe i frikësohet Zotit".<sup>21</sup>

Në *Hudaibiyah (Hudabije)*, Profeti parashikoi se e ardhmja e bashkësisë së sapolindur myslimane të Medinës, e rraskapitur pas dy betejave të mëdha dhe e treta që u shmang vetëm nga largpamësia e tij, varej nga një marrëveshje paqeje. Marrëveshja e Hudabijes është model lëshimi dypalësh; madje edhe emri i Zotit dhe fakti se Muhamedi është i Dërguari i Tij, pohimi kryesor i besimit mysliman, u fshinë prej saj. Nuk është për

21 Për 'Kushtetutën e Medinës', shih Muhammad Hamidullah, *The First Written Constitution in the World* (Ashraf, Lahore, 1970); dhe Michael Lecker, *The 'Constitution of Medina': Muhammad's First Legal Document* (Darwin Press, Princeton, 2004), i cili jep tekstin e plotë.



t'u habitur, që myslimanët e panë atë si një humbje dhe një turp, megjithatë Kurani e përshkruan atë si 'një fitore të qartë', që do të çojë në faljen e 'mëkateve të së kaluarës dhe të së ardhmes' (48:1-2). Këtu, Profeti tregon se, ndonjëherë, një lëshim, sado i dhimbshëm dhe që mund të hedhë në erë besimet tuaja të çmuara, është një mjet jetik për të formuar një të ardhme më të frytshme dhe të begatë. Mbrojtësit e vetvetes që nuk pranojnë të lëshojnë pe, kur lëshimi bëhet thelbësor, shkatërrojnë të tashmen dhe të ardhmen e tyre.

Së fundi, pas pushtimit të Mekës, Profeti qëndron fitimtar përballë armiqve të tij. Ai u drejtohet tubuesve që përfshijnë edhe ata që u përpoqën ta vrisnin, apo vranë dhe torturuan ndjekësit e tij, e dëbuan atë nga qyteti i lindjes dhe ndërmorën luftëra kundër tij. Ai thotë: "Shikoni punët tuaja, se ju jeni të liruarit!"<sup>22</sup> Ai shpall një falje të përgjithshme, duke ua falur armiqve të tij çdo krim që mund të kenë kryer në të kaluarën, duke treguar se padrejtësitë e historisë duhet t'i lihen historisë. Nëse kërkohet mbështetje për padrejtësitë historike në të tashmen, ato do të përjetësohen në të ardhmen. Falja është ndoshta mësimi më i lartësuar që mund të nxjerrim nga jeta e Profetit. Është një virtyt thelbësor për të punuar drejt çdo të ardhmeje që nuk është e zhytur në mosmarrëveshje dhe grindje të brendshme.

Pas Profetit, Kalifët, rojtarët e duhur, vazhduan traditën e të menduarit dhe veprimeve të orientuara drejt të ardhmes. Ebu Bekri, Kalifi i parë, parashikoi zgjerimin e tokave myslimane dhe kuptoi se nevojat e ardhshme nuk mund të përmbusheshin me administrimin që ishte në fuqi. Prandaj, ai zhvilloi një sistem të ri dhe thellësisht të lakueshëm, administrim dhe drejtim i cili mund të përshtatej me nevojat e së ardhmes. Umeri, Kalifi i dytë, e kuptoi se mbijetesa në të ardhmen e bashkësisë myslimane varej nga burimet në përdorim dhe se të gjitha burimet nuk mund të shpenzoheshin nga një brez. Kundër dëshirave të qarta të shokëve të tij, madje edhe në rrezik të një përlëshjeje, ai kundërshtoi ndarjen e tokave të pushtuara të Sirisë, Irakut, Iranit dhe Egjiptit midis pushtuesve. Duke thënë se tokat ishin për 'brezat pasardhës', ai i la ato mënjanë, si burime të ardhshme për bashkësinë islame që po zgjerohej me shpejtësi.

Prandaj, në historinë myslimane nuk mungojnë idetë e orientuara drejt të ardhmes. Me të vërtetë,

## UNË DO TË THOSHA SE NË THELB ISLAMI ËSHTË I ORIENTUAR DREJT TË ARDHMES

22 Ibn Ishaq, *The Life of Muhammad*, translated by A. Guillaume, Oxford University Press, Karachi, 1955, f. 553.



dhe këmbëngul se besimtarët duhet të formësojnë në mënyrë aktive të ardhmen e tyre. Nga vetë natyra e besimit të tyre, myslimanëve u kërkohet të angazhohen me botën dhe ta ndryshojnë atë. Kurani, në mënyrë të përsëritur, u kërkon myslimanëve që të ndryshojnë veten e tyre dhe të përpiqen vazhdimisht për të ndryshuar botën, në mënyrë që ajo të bëhet një vendbanim më i drejtë, më i paanshëm dhe paqësor për njerëzimin: “Njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar, se puna e tij do të shihet dhe, në fund, ai do të paguhet plotësisht për të” (53: 39-41). Pra, si individë, ashtu edhe si shoqëri, myslimanët duhet të ‘mundohen’ dhe ‘punojnë drejt’ të ardhmes që dëshirojnë. Të ardhmet e qëndrueshme dhe të dëshirueshme nuk ndodhin rastësisht. Ato kërkojnë përpjekje, vëmendje, mendim, planifikim strategjik, largpamësi dhe shartesë të fortë.

Kësisoj, e kaluara ka një rol të rëndësishëm për të luajtur në të ardhmen. Por një e kaluar që përbëhet nga adhurimi i njerëzve të periudhës së shkuar, me sende që ia vlen vetëm të prehen në muze dhe me ide që nuk kanë vlerë bashkëkohore, nuk e përmirëson jetën, ajo na çon prapa dhe jo përpara. Tradita është një përbërës i rëndësishëm i veçantisë sonë. Por tradita, gjithashtu, mund të bëhet helmuese, një fuqi mohuese e jetës që vret risinë dhe mendimin e thellë. Në të vërtetë, traditat mbeten si tradita vetëm duke ndryshuar, përndryshe ato kthehen në doke të prapambetura që mbysin dhe e shterojnë jetën nga kultura e gjallë. Vetëm kur e kaluara mundëson kuptimin, ajo kthehet nga një grumbull faktesh e ngjarjesh, ritualesh e devotshmërish, veprash të mëdha e figurash të nderuara, luftërash të kota për pushtet, lavdish e pengesash, në një kujtesë historike që na formëson dhe na drejton në rrugën e përmbushjes së të ardhmes.

Prandaj, ne duhet ta shqyrtojmë të kaluarën tonë në mënyrë të thellë. Jo çdo gjë në historinë tonë ka vlerë në të tashmen, ose do të jetë e rëndësishme në të ardhmen. Në veçanti, ne duhet të shqyrtojmë dhe të rimendojmë bindjet tona historike më të çmuara, të cilat, në të vërtetë, e përjashtojnë të ardhmen. Duhet të ecim përpara me ato ide dhe mendime që e hapin të ardhmen myslimane drejt horizonteve të ndryshme. Kur e kaluara lidhet me të tashmen si kujtesë historike, historia kthehet në një vërtetësi të jetuar. Është historia, si ide dhe mendime, ajo që formëson të tashmen dhe të ardhmen. Në të vërtetë, sapo të formohen mendimet, formohen edhe idetë, pastaj ato fillojnë të ndryshojnë dhe të ndikojnë në botë. Ato shkrihen me vërtetësinë bashkëkohore dhe bëhen pjesë përbërëse e saj. Ato përvetësohen nga kulturat e shoqëritë dhe vazhdojnë të jenë të frytshme. Kështu, ne e përjetojmë historinë si kujtesë, ndërkohë që



bëjmë histori. Si e tillë, historia e kapërcen kohën, ajo lëviz përtej të kaluarës dhe të tashmes sonë drejt të ardhmes. Pikërisht kjo është arsyeja, pse Islami i kushton kaq shumë rëndësi historisë.

## GJETJA E SË TASHMES

Pikërisht ky çast në histori - tani - është e tashmja dhe ka një rol të natyreshëm në përcaktimin e së ardhmes sonë. Por e tashmja nuk është e palëvizshme. Ndërsa e sotmja i përket të nesërme, e tashmja ndryshon. Në të vërtetë, e tashmja është në ndryshim të përhershëm. Për më tepër, e tashmja përfshin të ardhmen që do të jetë. E ardhmja e afërt, vitet e ardhshme, siç e kemi theksuar më herët, është 'e tashmja e stërzgjatur', që përfshin të ardhmet që tashmë janë shkaktuar, për shembull, nga teknologjitë në zhvillim. Pra, ne duhet ta shohim të tashmen si diçka të gjallë, në ndryshim, që përfshin vazhdimisht elemente dhe rrethana të reja të realitetit bashkëkohor. Kjo e tashme gjallëruese ka pesë elemente të dallueshme që duhet t'i marrim parasysh në formësimin e të ardhmes së qëndrueshme: globalizimi, ndërlikimi, çoroditja, mospërputhja dhe pasiguria.

*Së pari*, fakti i qartë se ne jetojmë në një botë të globalizuar. Është një botë e ndërlidhur dhe pa kufij, në të cilën gjërat nuk janë të veçuara dhe shumë çështje nuk kufizohen vetëm në rrafshin kombëtar. Çështjet e ndryshimeve klimatike, çështjet ekonomike dhe financiare si dhe sëmundjet ngjithëse janë shembuj të dukshëm me përmasa ndërkombëtare. Por edhe ato që ne mund t'i mendojmë si çështje veçanërisht krahinore, si papunësia në një vend të caktuar, apo çështjet gjinore të një kulture të caktuar, kanë përmasa botërore. Në një botë të globalizuar, çdo shoqëri ka halle dhe asnjë shoqëri nuk i ka të gjitha zgjidhjet. Për më tepër, globalizim do të thotë gjithashtu, se të gjitha shoqëritë janë tani në thelb të përziera – larmia e besimeve, mënyrat e ndryshme të të menduarit, traditat, kulturat dhe mënyrat e ndryshme të jetesës bashkëjetojnë krah për krah. Kështu, myslimanët duhet të merren me larminë brenda shoqërive të tyre dhe duhet të punojnë përgjatë kulturave dhe shoqërive për të trajtuar disa nga çështjet e tyre të ngutshme.

Megjithatë, kjo nuk është e mundur, nëse kulturat e tjera shihen si kundërshtarë ose më të ulëta, apo disi të mangëta moralisht. Myslimanët nuk kanë qenë kurrë të qetë me Tjetrin, qoftë ky Tjetri i brendshëm, si për shembull gratë, njerëzit në marrëdhënie të së njëjtës gjini, anëtarët e sekteve të tjera, ose të tjerë të jashtëm, si të krishterët, hindutë apo 'laikët'. Ç'është e



vërteta, pjesa më e madhe e ligjit islam duket se e poshtëron Tjetrin dhe paragjykimet e qëndrimet kulturore ushqehen nga Sheriati. Si të tillë, myslimanët nuk kanë gjuhë për të hulumtuar parime zëvendësuese dhe vlera të përbashkëta të sistemeve të ndryshme të mendimit dhe organizimit shoqëror.<sup>23</sup> Nën globalizimin, ku kulturat dhe botëkuptimet e ndryshme po luftojnë për pushtet dhe pikëpamje, ekziston një masë e madhe kritikash dhe kundërkritikash në mbarë botën. Ashtu siç myslimanët kanë të drejtë të kritikojnë të tjerët, për shembull, duke e përshkruar SHBA-në si “Dreq i Madh”, edhe të tjerët kanë të drejtë të barabartë për të kritikuar myslimanët. Por shoqëritë myslimane, në përgjithësi, nuk kanë qenë shumë të hapura në pranimin e kritikave, veçanërisht nëse ato u drejtohen shenjave tona të shenjta, si Profetit Muhamed, ashtu si shpjegohet nga ligjet e *blasfemisë* që gjejmë si në kushtetutat e Morsit, ashtu edhe në kushtetutën e Pakistanit. Apo në ligje që ndalojnë talljen e Presidentit, të cilat janë të pranishme edhe në Turqinë paksa ndryshe laike. Kjo paaftësi për të pranuar vërejtjet dhe për t’u marrë me larminë dhe shumësinë, lë të kuptohet se myslimanët nuk kanë qenë në gjendje të përshtaten me gjallërinë e re të një bote të globalizuar. Çështjet dhe prirjet e tyre të tanishme kanë ndërmend të shumëfishohen duke mbështjellë dhe mbytur të ardhmen e tyre.

Së dyti: çështjet me të cilat përballemi në ditët e sotme, nuk janë të thjeshta. Nuk ka asgjë të thjeshtë në krijimin e një demokracie të zbatueshme, në një shtet me një bollëk partish politike dhe grupe të shumta interesi, në rregullimin e ekonomisë, sigurimin e furnizimeve tona me energji, luftimin e pandemive, sigurinë, uljen e papunësisë së të rinjve, ose trajtimin e ndikimeve të ndryshmeve klimatike. Një përpjekje e tillë ka bërë kërdrinë në Pakistan, Bangladesh dhe Afrikën Sub-Sahariane. Asnjë nga këto çështje nuk mund të ‘zgjidhet’ pa ndihmën e të tjerëve, apo të ‘rregullohet’ nga grupe të vetme, parti ose shtete të veçanta. Këto janë çështje të ndërlikuara. Në të vërtetë, pothuajse gjithçka me të cilën duhet të përballemi në ditët e sotme, është e ndërlikuar. Theksi në të tashmen bie te ndërlikimi.

Ndërlikimi është një pjellë natyrore e faktit se shumica e çështjeve tona janë në shkallë botërore.<sup>24</sup> Globalizimi gjallëron ndërlikimin jo vetëm

23 Mbi ndikimin e globalizmit në Islam, shih Mushirul Hasan, editor, *Islam in a Globalised World: Negotiating Faultlines*, Imprint One, Delhi, 2010 dhe Nevzat Soguk, *Globalisation and Islamism*, Rowan and Littlefield, New York, 2011.

24 Për ndërlikimin, shih Roger Lewin, *Complexity: Life at the Edge of Chaos*, Macmillan, New York, 1992 dhe Mitchell Waldrop, *Complexity: The Emerging Science at the Edge of Order and Chaos*, Simon and Schuster, New York, 1992. Për një analizë të ndërlikimit nga perspektiva e së ardhmes, shiko botimin e posaçëm të *Futures*, 26 (6) Gusht 1994, ‘Complexity: Fad or Future’ edited by Ziauddin Sardar dhe Jerome R. Ravetz.



duke na bërë të ndërvarur, por edhe duke rritur ndërlidhjet tona. Në një botë të globalizuar, gjithçka është e lidhur me gjithçka tjetër. Shembulli më i dukshëm është, sigurisht, interneti dhe rrjetet shoqërore. Por ka edhe rrjete botërore lajmesh 24-orëshe, që botojnë fotografi të çdo ngjarjeje, kudo dhe në çdo kohë, për të gjithë të tjerët në planet. Vini re, se si një epidemi që mund të fillojë në një fshat të largët, siç është gripi i derrit, përhapet me shpejtësi për t'u bërë një pandemi botërore, falë rrjeteve ndërkombëtare të udhëtimit. Ose ajo 'mjegulla' e krijuar nga djegia e pyjeve në Indonezi, përhapet shpejt, për të mbytur popullatat në Malajzi dhe Singapor. Ose një sulm terrorist në Shtetet e Bashkuara çon në luftë dhe rrëmujë në Irak dhe Afganistan, të cilat, më pas, ushqejnë terrorizmin nga veriu i Anglisë, deri në veri të Nigerisë. Asgjë, në të vërtetë, nuk ekziston dhe nuk ndodh e veçuar.

Ekziston një prirje tjetër, që rrit ndërlidhimin: shkalla e ndryshimit. Jo vetëm që gjërat po ndryshojnë me shpejtësi, por edhe vetë ritmi i ndryshimit po përshpejtohet. Teknologjia e të dhënave, për shembull, dyfishon çdo vit fuqinë e saj, të matur sipas çmimit, rendimentit dhe mundësisë së përçimit të sinjalit. Pas 25 vjetësh, do të shumëzohej me herësin një miliard, ndërsa kalojmë nga përçuesit, në teknologji më të fuqishme, siç është llogaritja molekulare ose teknologjia nano. Dhe, siç bën gjithmonë teknologjia, do të tjetërsojë me shpejtësi sjelljen e shoqërisë. Në mënyrë të ngjashme, aftësia jonë për të renditur të dhënat gjenetike është dyfishuar çdo vit. Ndërsa u deshën 15 vjet për të renditur HIV-in, virusi SARS u rendit brenda një muaji. Me një çmim të pranueshëm, tani mund të bëni renditjen e genomit tuaj brenda një dite të vetme. Revolucioneve iu deshën vite për t'u planifikuar dhe zbatuar. Revolucionit francez iu deshën njëmbëdhjetë vjet, ndërsa revolucioneve njëri pas tjetrit, të vitit 1917 në Rusi, iu deshën nëntë muaj për të përmbushur qëllimin e tyre. Revolucioni iranian mori pak më shumë se një vit për të ndodhur dhe u deshën vite të planifikohej. Në ditët e sotme, revolucionet mund të lindin vetvetiu. Diktatorët përmbysen brenda javësh. Ekonomia botërore mund të shembet, siç ndodhi në 13-14 shtator 2008, brenda disa ditësh.

Ajo që e bën ndërlidhimin më të vështirë për t'u kuptuar, është se, së bashku me ritmin e përshpejtuar të ndryshimit, gjërat po ndodhin gjithashtu njëkohësisht. Kështu, për shembull, ndërsa fuqia amerikane tkurret, Kina vesh mantelin e një superfuqie të re, India sa vjen e bëhet ekonomikisht më kërcënuese; ndërsa Brazili shfaqet si një fuqi e re ekonomike, Rusia rifiton besimin e saj; ndërkohë që bie ndikimi i Japonisë,



Europa fuqizon eksperimentin e saj në pavarësinë e përbashkët, pasi aktorët josttetërorë (nga shumëkombëshe, te organizatat terroriste) rriten në fuqi dhe ndikim, ndërsa pasuria dhe fuqia përkatëse lëvizin nga Perëndimi në Lindje. I gjithë peizazhi gjeopolitik ndryshon me shpejtësi dhe në të njëjtën kohë.

Kjo do të thotë se Islami dhe myslimanët përballen me një mëdyshje të veçantë. Ndërlikimi nuk mund të trajtohet duke përdorur thjeshtësinë. Çështjet e ndërlikuara kanë nevojë për zgjidhje tërësore. Megjithatë, ajo që ne e mendojmë si 'Islam' sot, është pak më shumë se një grumbull thirrjesh të thjeshta. Ligji islamik është tkurrur në një listë të gjërave që duhen dhe nuk duhen. Prandaj, myslimanët e gjejnë veten duke u përpjekur të menaxhojnë dhe zotërojnë një botë, me anë të formulave të thjeshta shekullore, dokeve dhe zakoneve të prapambetura, ligjeve të turbullta, shprehjeve të devotshme dhe parullave të zbrazëta. Dijetari i ndjerë dhe i njohur pakistanez, Fazlur Rahman, e quajti këtë "Islam minimal", i cili thjesht nuk mund ta përballojë ndërlikimin bashkëkohor.

Gjithashtu, ndërlikimi na lë të kuptojmë se idetë më të thjeshta të 'shteteve islame', të sunduara nga 'parimet e Sheriatit', nën sundimtarët fuqiplotë, janë të vjetruara deri në rrezikshmëri. Në thelb, këto shtete përpiqen ta tkurrin ndërlikimin, duke dëbuar të gjithë larminë dhe shumësinë, duke u kthyer kështu të paqëndrueshme. Mbijetesa e tyre vihet në pikëpyetje, nëse përpiqen të ndërpresin të gjitha lidhjet me botën, siç e tregon aq mirë Irani i Ajatollahëve. Në të vërtetë, e vetmja mënyrë që një *gjoja shtet islamik* i papërkulur mund të mbijetojë, është që të varet nga një superfuqi që e mbështet atë, si në rastin e Arabisë Saudite. Ndërlikimi thjesht nuk mund të fshihet, pasi është një përbërës themelor i kohëve tona. Që do të thotë se çdo shtet me mbiemrin 'islamik', para tij ka një jetëgjatësi të kufizuar.

*Së treti:* Jemi vazhdimisht në zgrip të rrëmujës.<sup>25</sup> Çështjet e ndërli dhura dhe të ndërlikuara gjallërojnë prapaveprim të sigurtë. Gjërat shumohen shpejt dhe ndryshimi ndodh në përpjesëtim gjeometrik. Falë telefonave të dorës, postës elektronike dhe lajmeve 24-orëshe, Facebook-ut, Twitter-it dhe mënyrave të tjera të rrjeteve shoqërore, ne jemi vazhdimisht në dijeni. Prandaj, jemi të përgatitur për të vepruar menjëherë, të

25 Për një shpjegim më analitik të asaj që ndodh 'buzë greminës', shih Ziauddin Sardar, *Introducing Chaos*, Icon Books, Cambridge, 1998 shih edhe 'What Chaos? What Coherence? Across the River I Called' in Mika Mannermaa, Sohail Inayatullah dhe Rick Slaughter (editors), *Coherence and Chaos in Our Uncommon Futures: Visions, Means, Actions*, Finland Future Studies Centre, Turku, 1994 dhe 'Conquests, Chaos, Complexity: The Other in Modern and Postmodern Science', *Futures* 26 (6), f. 665-682, (Korrik/Gusht) 1994.





pajisur me mjetet për të nisur modele të reja të kundërvënies zinxhir që kulmon në çoroditje. Kur ndërlikimit i bashkohen rrjetet dhe ai ndërli-dhet, kjo çon me shpejtësi drejt sjelljes çoroditëse. Kjo është e qartë gjith-andej rreth nesh, nga mënyra se si veprojnë tregjet dhe institucionet fi-nanciare, deri te rrënimi i ekosistemeve, tubimet e papritura, rrëmuja në mbarë Europën e vitit 2010, krijuar nga hiri vullkanik; nga Islanda e deri te ‘Pranvera Arabe’. Madje edhe shndërrimi i papritur në njeri me famë botërore i Malala Yousafzait, adoleshentja që u qëllua nga talebanët, është pjellë e çoroditjes.

Çoroditja fillon gjithmonë me shqetësime të vogla, që marrin me shpej-tësi përmasa botërore. Vetëvraska e një shitësi të papunë perimesh në Tuni-zi shkaktoi Pranverën Arabe, keqbërjet e një grupi të vogël bankierësh çuan në rrënimin financiar të 2007-2008, një lloj i ri gripi u shfaq në një fshat të vogël, në krahinën e Verakruz të Meksikës dhe me shpejtësi u bë pandemia e gripit të dërrit, në vitin 2009. Kështu, si ngjarjet e vogla, në dukje të parëndësishme, ashtu edhe njerëzit, kanë aftësinë për të nxitur kundërvënie që mund të çojnë shpejt në sjellje çoroditëse. Një shembull të mirë na e jep Muhamed Tahir-ul-Qadri, një profesor pakistanez i së drejtës dhe, një-herësh, dijetar i Sufizmit. Ai ishte një udhëheqës fare pak i njohur i një shoqate joqeveritare, *Minhaj-al-Kur’an*, që jetonte në mërgim, në Kanada. Në dhjetor të vitit 2012, u kthye në Pakistan për të nxitur reforma politike dhe bëri thirrje për një marshim ‘milion burrash’, kundër qeveritarëve të kalbur. Vetëm 10 mijë veta dolën në Lahore për të protestuar. Por vëmendja e vazhdueshme televizive, e shpërndarë përmes rrjeteve shoqërore, e ktheu tubimin në një ngjarje të madhe çoroditëse. I fshehur në një kabinë an-ti-plumb, Tahir-ul-Qadri organizoi një tubim në Islamabad me dhjetëra ka-nale televizive që mbulonin dhe raportnin çdo fjalë të tij. Qeveria u parali-zua, kombi u trazua. Shfaqja përfundoi kur qeveria premtoi reformë zgje-dhore dhe me nënshkrimin e një marrëveshje midis Tahir-ul-Qadri-t (i cili në thelb nuk përfaqësonte askënd, përveç vetes) dhe qeverisë.

Urata Teri Johns ofron një shembull tjetër, se si një njeri mund të ndërmarrë dhe t’i bëjë jehonë një ngjarjeje me përmasa çoroditëse. Urata Johns, një prift i panjohur i një qendre të parëndësishme të krishterë, në Gainesville të Floridas, kërcënoi se do të digjte Kuranin në shtator të vitit 2010. Kërcënimi i tij u shfaq nga kanalet televizive botërore, sikur të ishin një qark i pafund. E gjithë bota myslimane iu kthye menjëherë dhe pa u menduar: filluan tubimet, u dogjën ambasadat, vdiqën njerëz të pafaj-shëm, u dogjën dyqanet dhe transporti publik. Të gjitha këto gjallëruan





edhe më shumë vëmendjen televizive, duke i tërbuar mediat. Urata Johns u bë një njeri me famë botërore, i përgatitur paraprakisht. Sekretarja e atëhershme e Shtetit të SHBA-së, Hillari Klinton, u detyrua të thoshte: “Është për të ardhur keq, që një prift në Gainesville, Florida, me një kishë prej jo më shumë se pesëdhjetë vetash, mund të bëjë një plan mizor, të hidhur, të turpshëm dhe të marrë për të tërhequr vëmendjen e botës”. Presidenti iu lut priftit, që të mos e zbatonte planin e tij. Edhe pse plani nuk u zbatua, në një botë të ndërlikuar dhe të globalizuar, çoroditja mori udhë. Një shembull tjetër është dhënë nga *Tea Party*, një pakicë e vogël republikanësh, të cilët në tetor 2013, e mbajtën të gjithë qeverinë amerikane peng, e detyruan qeverinë të mbyllej dhe gati sa nuk e zhytën planetin në një fatkeqësi ekonomike.

Çoroditja, ndërlikimi, globalizimi dhe teknologjia e të dhënave kanë krijuar një të tashme të re që është rrënjësisht e ndryshme nga të gjitha të kaluarat tona të afërta. Ne kemi hyrë në një periudhë ku ndryshimet e shpejta, pasiguria dhe paqartësia janë gjithmonë të pranishme dhe njeriu ka fuqi të jashtëzakonshme për të bërë mirë ose keq. Në këto kohë pasnormale, mënyrat tona tradicionale të zgjidhjes së çështjeve nuk hyjnë më në punë. Ajo që ruhet si normale, ka gjithnjë e më pak kuptim.

Në kohët pasnormale institucionet, mendimet, idetë tradicionale dhe pikëpamjet e shoqërisë kthehen në shqetësim. Jo vetëm që këto shihen thellësisht si të meta, por dështimi i tyre, ndonjëherë mahnitës, është mjaft i dukshëm, ashtu siç është dështimi i tregjeve, paaftësia e brendshme e kapitalizmit për të ndihmuar barazinë dhe prirja e tij natyrore për të nxitur monopolet, lakmia e egër e drejtuesve dhe menaxhuesve. Për më tepër, ekziston një ndjenjë e përgjithshme, se pak mund të besohet dhe zotërohet dhe se baraspeshat shoqërore nuk zbatohen. Sa më shumë që politikanët nxjerrin ligje, reformojnë dhe ndryshojnë, aq më pak të rëndësishme dhe të dobishme duken ligjet në mundësimin ose ofrimin e përfitimeve të shumta shoqërore, aq më shumë shfaqen pasojat e padëshiruarra dhe të paqëllimshme. Për më tepër, nuk ka asnjë hapësirë kohore për çështjet që kërkojnë vëmendje të menjëhershme dhe të ngutshme. Edhe pse ne përpiqemi t'i zgjidhim, ato ngatërrohen në një rrjetë të ndërlikuar dhe shumohen shpejt, njëkohësisht dhe në mënyrë të rrezikshme. Gjithçka që ne e morëm si të mirëqenë, duket se po zhduket dhe nuk mund të besohet se mund të japë atë që mendohej të jepte. ‘Mbretërve’ të cilëve ne u besonim, si shkencëtarëve, ekonomistëve, llogaritarëve, bankierëve, politikanëve, qeverive, tregjeve, institucioneve financiare, ndërmarrjeve e



barnave, gjigantëve të teknologjisë, me sa duket, u kanë rënë puplat. Nuk është se ne i kemi parë ndonjëherë themelet e shoqërive tona si të përsosura. Përkundrazi, duhet kuptuar se këto themele janë jashtëzakonisht të lëkundura, të paafta për të zgjidhur papërsosmëritë e qëndrueshme të rendit tonë botëror dhe mund ta molepsin shoqërinë, deri në një rrënim të mundshëm. I gjithë sistemi është i përshtatur për të shpërblyer në përpjesëtim të zhdrejtë pakicën në kurriz të shumicës. Uni i pushtetit dhe të të fuqishmëve zbulohen si i vetmi mekanizëm i dobishëm dhe vërtetësia nga e cila varen të gjithë. Zotërimi dhe drejtimi kthehen në zhgënjime të mëdha. Të gjitha shpjegimet gjithëpërfshirëse, mitologjia që e lidhi dhe e bëri shoqërinë të qëndrueshme, bëhen helmuese, bartëse të shkaktarëve të sëmundjeve që molepsin shoqërinë me mungesë besimi. Në kohët pasnormale ne e dimë se kemi aftësi, por jo zotësinë e vazhdueshme, morale dhe organizative, për t'i përkthyer aftësitë tona në ofrimin e zgjidhjeve të qëndrueshme për çështje posaçërisht tonat, të ndërlydhura dhe që përhapen. Në kohët normale pasiguritë janë të vogla dhe të zotërueshme. Por në kohët pasnormale pasiguria vihet në qendër të vëmendjes. Meqenëse gjithçka është e ndërlydhur, e ndërlykuar dhe e çoroditur dhe, aq më tepër, ndryshon me shpejtësi, asgjë nuk mund të përshkruhet me siguri. Përveç kësaj, duke pasur parasysh ndërlikimin në rritje të rrjetëzimit të çështjeve dhe shkallën e ndryshimit, ne nuk jemi në gjendje ta lidhim gjendjen tonë të tanishme me ndonjë të kaluar. Për pasojë, nuk jemi në gjendje të mësojmë ndonjë gjë nga e kaluara, edhe kur e dimë se ka pasur dështime të krahasueshme vazhdimisht përgjatë historisë. Për më tepër, njerëzit dhe grupet kanë fuqi të jashtëzakonshme për të gjallëruar kundërshti çoroditëse, duke e vështirësuar më tej rrethanën.

Pjesa më e madhe e të njëjtit argument vlen për Islam, sido që ne e përfytyrojmë atë. Është mjaft e qartë, se shembujt historikë të suksesit dhe të dështimeve të Islamit nuk janë veçanërisht të rëndësishme për gjendjen pasnormale.

**RRJETE TË VOGLA TERRORISTËSH JO VETËM IA ULËN VLERAT ISLAMIT, DUKE E KTHYER NË BESIMIN MË TË URRYER NË BOTË, POR, GJITHASHTU, ATO PO MBAJNË PENG GJITHË BOTËN MYSLIMANE.**



Në thelb, zakonisht, ne e shohim Sheriatin si të mirë, megjithatë, kudo që Sheriati zbatohet, ai nuk prodhon gjë tjetër, veçse padrejtësi dhe pabarazi. Në të vërtetë, Sheriati është aq i pamjaftueshëm në trajtimin e çështjeve të grave, sa që një grua që është përdhunuar shpesh, përfundon e fajësuar për tradhti bashkëshortore dhe dënohet rëndë. Të krishterët e mitur mund të akuzohen për blasfemi dhe të dënohen me vdekje. Ne e marrim për të mirëqenë, se “vlerat islame” janë të natyrshme dhe morale, megjithatë ato nuk përputhen me etikën dhe moralin e një bote ku liria e zgjedhjes dhe e vetëdijes janë parësore. Ne gëzohemi kur dikush shndërrohet në mysliman (edhe pse ai mund të jetë kriminel), megjithatë kërkojmë t’ua marrim jetën atyre që duan të largohen nga Islami drejt besimeve të tjera. Sistemi i besueshmërisë fetare është përshtatur drejt ofrimit të pushtetit të papërgjegjshëm dhe përfitimeve që vijnë bashkë me ‘të, ndaj një pakice njerëzish në kurriz të shumicës dërrmuese të myslimanëve të zakonshëm. Interesat vetjake, uni, vetëkënaqësia dhe lakmia e klerikëve të cilët sillen më shumë si bankierë, drejtues ndërmarrjesh dhe udhëheqës me pushtet pa kufi, siç e shohim në Arabinë Saudite dhe Iran, sjellin mjerim pas mjerimi të besimtarët. Idealet e Islamit, drejtësia dhe barazia që ai pritej të përkrahte, janë kthyer në zhgënjim të madh. E gjithë kjo do të thotë se ka pak besim në institucionet tradicionale islamike, ose në aftësinë e atyre që mbrojnë mënyra të tjera islame për të zgjidhur çështjet e ndërlikuara të kohës sonë, siç edhe treguan presidenti Morsi dhe Vëllazëria Myslimane në Egjipt, që e paguan me kokat e tyre.

Në të vërtetë, po të ishin të lirë për të zgjedhur, shumica dërrmuese e myslimanëve besimtarë nuk do të zgjidhnin të jetonin në një shoqëri që udhëhiqet nga rregullat dhe rregulloret tradicionale të Islamit. Natyrisht, ne mund të kthehemi te qëndrimi i vjetër dhe të themi se Islami është i përsosur, shumica e myslimanëve janë shmangur dhe pjesa tjetër e botës është krejtësisht e gabuar. Ose mund të kuptojmë zemërimin pasnormal dhe të pranojmë se ortodoksia dhe sistemi tradicional, atë që gjithmonë e kemi marrë si diçka normale, është thyer në mënyrë të pariparueshme.

*Së katërti:* e tashmja është plot mospërputhje. Në të vërtetë, mospërputhjet janë pjellë natyrore e një bote me ndërlikime, të rrjetëzuar, me qëllime dhe ideologji të panumërta që hahen me njëra-tjetrën, ravijëzime dhe dëshira që sillen në mënyrë të çoroditur. Sigurisht, jo të gjitha mospërputhjet e dukshme rreth nesh janë pjellë e kohëve pasnormale. Por kohët pasnormale i sjellin mospërputhjet në qendër të vëmendjes dhe gjallërojnë lloje të veçanta mospërputhjes. Për shembull, ndërsa pjesë të



caktuara të botës po përjetojnë ndryshime të pashembullta, pjesë të tjera të mëdha të planetit dhe pjesë të jetës sonë shoqërore janë pothuajse në prehje. Ndërsa teknologjia na detyron të punojmë shpejt e më shpejt, shpejtësia e udhëtimit ajror, që nga rrëzimi i Konkordit, në fakt, është ngadalësuar. Ndërsa kombet bëhen më të larmishme dhe të shumëllojshme, pjesa e popullsisë me pikëpamje nacionaliste, fundamentaliste dhe të ngushta po rritet. Ndërsa qeveritë dhe administratorët përpiqen të rrisin rendimentin e institucioneve, siç është Shërbimi Shëndetësor Kombëtar i Mbretërisë së Bashkuar, rendimenti po bie (ky njihet si paradoksi “Jevons”<sup>26</sup>). Brenda një viti, Londra e ndezur nga trazirat dhe multikulturalizmi, u shpall një fatkeqësi e pazbutur. Vitin tjetër, multikulturalizmi përshëndetet si një sukses i madh, pasi qyteti kremton shumëllojshmërinë dhe fitoret olimpike. India mendohet se është një superfuqi ekonomike, megjithatë shumica dërrmuese e popullsisë së saj jeton në varfëri të tmerrshme, shembull ky i sqaruar shumë mirë nga titulli i librit të shkrimtarëve Amartya Sen dhe Jean Dreze, *Një lavdi e pasigurt: India dhe mospërputhjet e saj*.<sup>27</sup> Kina është bërë superfuqia kryesore ekonomike në botë, edhe pse është një ekonomi e urdhëruar dhe një shtet komunist, një mospërputhje e vërejtur në librin: *Si u bë Kina kapitaliste*, e shkrimtarëve Ronald Coase dhe Ning Wang.<sup>28</sup> ShBA-ja është kombi më i pasur në tokë, por ka një borxh prej mbi 16 trilion dollarësh. Në Egjipt, një revolucion popullor një vjeçar zëvendëson një diktaturë me demokraci; vitin tjetër, një revolucion tjetër popullor zëvendëson demokracinë me sundimtarë ushtarakë. Pra, mospërputhjet janë të shumta.

Mospërputhjet s’kanë zgjidhje, por vetëm mund të kapërcehen. Ato theksojnë faktin se përparimi, sido që të përfytyrohet, ka gjithmonë ndikime anësore të dëmshme. Ose, siç shprehet filozofi Xheri Ravetz, “nuk ka arritje të së mirës, pa ndonjë prodhim të së keqes”.<sup>29</sup> Gjithashtu, mospërputhjet na ndihmojnë të parandalojmë analizën e tepërt të çështjeve ose rrethanave. Ne jemi të detyruar të marrim parasysh prirjet drejt përplasjes, pikëpamjet e kundërta, faktet që nuk përputhen dhe hamendësimet apo teoritë e ndryshme dhe të kuptojmë se bota nuk është e përshtatshme për zgjidhje njëpërmasore. Si ndërlikimi, ashtu edhe mospërputhjet, na lënë të kuptojmë se çdo çështje e caktuar ka përmasa të shumëfishta dhe

26 Shih John M. Polimeni, Kozo Mayumi, Mario Giampietro dhe Blake Alcott, *The Myth of Resource Efficiency: The Jevons Paradox*, Earthscan, Londër, 2009.

27 Amartya Sen dhe Jean Dreze, *An Uncertain Glory: India and Its Contradictions*, Allan Lane, Londër, 2013.

28 Ronald Coase dhe Ning Wang, *How China Became Capitalist*, Palgrave Macmillan, Londër, 2013.

29 Jerome R. Ravetz dhe Silvio Funtowicz, ‘Emergent complex systems’ *Futures* 26 (6) 568–582, 1994.



se asnjë pamje e veçantë apo e pjesshme nuk mund të përfshijë tërësinë. Në përgjithësi, çështjet nuk kanë përgjigje “të drejta” dhe “të gabuara”. Në të vërtetë, përgjigjet mund të jenë njëkohësisht të drejta dhe të gabuara. Mënyra e vetme për t’i kapërcyer mospërputhjet, është përmes rrahjes së mendimeve, shqyrtimit dhe marrëveshjes përmes dialogut.

*Së pesti:* pasiguria është normë.<sup>30</sup> Kur mosmarrëveshjet, ndërlikimet dhe çoroditja bashkërendohen me ndryshimin e përsheptuar, i vetmi përfundim i caktuar është pasiguria. Në kohët normale pasiguritë janë të vogla dhe të zotërueshme. Por në kohët pasnormale, pasiguria është qendra e vëmendjes. Meqenëse gjithçka është e ndërlidhur, e ndërlikuar dhe e çoroditur, që ndryshon me shpejtësi, asgjë nuk mund të përshkruhet me siguri. Kohët pasnormale, siç tregojnë kaq qartë ngjarjet e fundit në Lindjen e Mesme, kanë të bëjnë me të jetuarit në pasiguri.

Pra, kjo është e tashmja që lëviz dhe ndryshon, e ndërlikuar dhe e çoroditur, me mospërputhje dhe plot pasiguri, që do të përcaktojë në një masë të madhe të ardhmen tonë. Kjo është ndalesa prej nga ku e vështrojmë horizontin drejt të ardhmes së largët. Nëse prirjet e tanishme të shoqërive myslimane vazhdojnë siç janë, e ardhmja do të ishte një vazhdimësi e së kaluarës së vjetruar dhe e ngërçeve bashkëkohore. Kjo do të jetë e ardhmja e mundshme, e ardhmja që ka më shumë gjasa të përmbushet. Ajo do të përmbajë të gjithë autoritarizmin, pabarazitë, shtypjen, ndarjet sektare, grindjet shoqërore dhe dhunën që ne gjejmë në shoqëritë myslimane sot, por të lartësuar në nivele të reja. E ardhmja e mundshme është gjithashtu një e ardhme e kolonizuar. Ajo është një e ardhme në të cilën shoqëritë myslimane janë të nënshtruara, duke shkuar drejt një të ardhmeje të krijuar nga një kulturë ose qytetërim tjetër, sipas vlerave, pikëpamjeve dhe botëkuptimit të vet ekonomik, kulturor, teknologjik e politik, nevojave dhe kërkesave. Të ardhmet e mundshme shërbejnë si paralajmërime Ato nxjerrin në pah rreziqet dhe kërcënimet e mundshme që na presin. Megjithatë, e ardhmja nuk duhet të paracaktohet, ose thjesht të jetë një zgjatim i së shkuarës dhe së tashmes. Ka mundësi të tjera: të ardhme të mundshme; një përzierje mundësish të ndryshme që mund të përfytyrohen; e ardhme e besueshme, pra e ardhme që ne përcaktojmë, duke pasur parasysh kushtet e tanishme dhe çastin historik, e cila ka një mundësi të madhe përmbushjeje; si dhe të ardhme të parapëlqyera, për të cilat ne dëshirojmë dhe punojmë me vetëdije. Të ardhmet e parapëlqyera mund të kenë përbërës të së ardhmes së besueshme, që ndërlidhin atë që

30 Shih Gabriele Bammer dhe Michael Smithson, editors, *Uncertainty and Risk: Multidisciplinary Perspectives*, Earthscan, Londër, 2008.



ne dëshirojmë vërtet, me atë që është në të vërtetë e mundur. Si do të dukeshin të ardhmet e parapëlqyera për Islamit dhe shoqëritë myslimane dhe çfarë duhet të bëjmë për t'i jetuar ato?

## PËRGATITJA PËR TË ARDHMEN

Le ta zëmë se do t'i pyesnim ca myslimanë të përzgjedhur rastësisht, se çfarë lloj të ardhmeje parashikojnë ata për shoqëritë e tyre. Shumica prej tyre, me siguri, do të dëshironin një të ardhme pa sektarizëm dhe grindje qytetare, pa dhunë, tmerr, mundim e mizori, ku fëmijët e tyre mund të rriten të shëndetshëm dhe të begatë dhe ku shoqëria të jetë në paqe me vetveten. Gjithashtu mund të dëshirojnë të jetojnë në paqe dhe nderim të ndërsjellë me njerëz të besimeve të ndryshme, të krishterë, myslimanë, hindu, budistë dhe njerëz me besim të pakët ose laikë, të pabindur dhe pa zot. Për më tepër, shumica e myslimanëve do të dëshironin të shihnin një të ardhme ku s'do të kishte dallim mes 'arabëve dhe joarabëve', siç tha Profeti në predikimin e tij të lamtumirës, ose midis 'burrave besimtarë dhe grave besimtare', siç thotë Kurani. Pra, një vend ku të gjithë, pa varësisht nga raca, gjinia dhe besimi i tyre, kanë rëndësi të barabartë në shoqëri dhe ku të moshuarit apo të gjymtuarit trajtohen me nderim e dinjitet. Të gjithë, të pasur apo të varfër, sundimtarë dhe të sunduar, burra e gra, janë të barabartë përpara ligjit dhe pasuria nuk grumbullohet në duart e një elite të zgjedhur. Vërejtjet dhe mospajtimet jo vetëm që lejohen, por nxiten; larmia dhe shumëllojshmëria pranohen dhe përqafohen në mënyrë vepruese. Pa dyshim, disa anëtarë të pyetësorit tonë të rastësishëm do të ktheheshin në periudhat më të mira të Kalifatit Abbasid ose al-Andalus, posaçërisht në kulmin e tyre, dhe do të dëshironin të shihnin lulëzimin e shkencës, teknologjisë, filozofisë, mendimit dhe mësimin të të gjitha llojeve, ku arti e kultura, që nga letërsia, arkitektura, muzika, kërcimi, teatri dhe kinemaja, të bëheshin një eksport i madh botëror. Pra, myslimanët, larg të qenit vetëm shpenzues, bëhen edhe prodhues të mallrave, shërbimeve, risive, mendimeve e njohurive të reja. Për më tepër, shumica e myslimanëve do të dëshironin një të ardhme ku të kishte përgjegjësi në të gjitha nivelet e shoqërisë, që nga ata në pushtet, te burokracia, shërbimi qytetar, policia, shërbimi i fshehtë, këshillat vendorë dhe tregtia e deri te qytetari i zakonshëm. Pra, atë lloj përgjegjësie që Omeri, Kalifi i Dytë, u përpoq të themelonte në periudhën klasike.



Sigurisht, ky vegim nuk është një utopi. Është vetëm pamje e një të ardhmeje të parapëlqyer. Njerëzit ende nuk do të pajtohen me shpjegime të ndryshme të Islamit, pasi njerëz të ndryshëm do të theksonin anë të ndryshme. Disa do ta shihnin diçka si hallall ose haram, por, në përgjithësi, njerëzit respektojnë shpjegime të ndryshme dhe mënyra të ndryshme të të qenit mysliman. Sunitët mund të jenë sunitë dhe shiitët apo sektet e tjera mund ta përcaktojnë veten në çfarëdo mënyre që dëshirojnë. Ndërsa sufistët mund të bëjnë çfarëdo që bëjnë tani. Askush nuk do të fajësohet si heretik, apo jashtë kufijve të Islamit. Çështjet dhe mosmarrëveshjet që lindin, brenda dhe ndërmjet shoqërive, mund të zgjidhen me rrahje mendimi dhe shqyrtime, respekt të ndërsjellë, do të ketë mekanizma dhe një gjeneral të fortë që do të zgjidhë disa nga çështjet dhe mosmarrëveshjet e tyre.

Edhe pse kjo është një e ardhme e pëlqyeshme dhe e besueshme, ajo nuk është veçanërisht e dëshirueshme. Megjithatë, edhe për të prekur një të ardhme të tillë, një ose dy breza nga tani, pas njëzet deri në dyzet vitesh, do të na duhet ta rimendojmë Islamin rrënjësisht.

**SHIHET QARTË, SE MENDIMI TRADICIONAL ISLAM, ME PUSHTET TË PAKUFIZUAR NË THELB, NUK DO TË OFROJË NJË TË ARDHME TË BARABARTË OSE TË LARMISHME. NË TË VËRTETË, AS NUK MUND TË PËRBALLET ME VËRTETËSINË JETËSORE TË KOHËVE PASNORMALE.**

Hamendësimi i pashpallur në dogmën dhe vlerat islame, sido që ato të përcaktohen, se janë ‘natyrore’ dhe të dhëna nga vetë Zoti, është haptazi i rremë.<sup>31</sup> Nëse mendimi tradicional do të ishte në gjendje të zgjidhte çështjet tona, shoqëritë myslimane nuk do ta gjenin veten në një gjendje kaq të rëndë. Ose, nëse ‘vlerat islame’ do të ishin po aq të natyrshme, sa ligjet e fizikës, atëherë shoqëritë myslimane do të ishin të lira nga shtypja, keqtrajtimi, pabarazia, paragjykimi, dhuna dhe çnjerëzimi që ne dëshmojmë çdo ditë. Mënyra se si ne e kemi përfytyruar dhe kuptuar tradicionalisht Islamin, thjesht nuk mund ta përballojë ndërlikimin dhe mosmarrëveshjet e jetës sonë të rrëmujshme pasnormale.

Si pasojë, ne kemi nevojë për një pikënisje të re, nga e cila të ecim përpara drejt të ardhmes së dëshiruar dhe të parapëlqyer.

31 Për mënyrën se si ne mbahemi pas besimeve të rreme, shih Solomon Schimmel, *The Tenacity of Unreasonable Beliefs*, Oxford University Press, New York, 2008.



**NE DUHET TA SHIKOJMË ISLAMIN JO THJESHT SI FE TË PËRCAKTUAR,  
POR SI NJË BOTËKÛPTIM QË LEJON USHTRIMIN E SHUMË BESIMEVE  
FETARE BRENTA KUFIJVE TË TIJ IDEORË DHE MORALË.**

Ndërlikimi na tregon se asnjë mënyrë e vetme e të menduarit apo modeli sjelljeje nuk mund të japë përgjigje për çështjet tona të ndërlidhura. Në nivel shoqëror, në një botë të globalizuar dhe të ndërlidhur, ne veprojmë jo nga pikëpamja e besimit, por e moralit. Për më tepër, ne angazhohemi me botën, e ndryshojmë dhe e tjetërsojmë atë me ide dhe mendime. Prandaj, 'shpjegimi' ynë i Islamit duhet të përfshijë një botëkuptim të mbështetur në ide të caktuara që rrjedhin nga Kurani dhe një etikë që mund të merret në tërësi me realitetin shoqëror, kulturor e teknologjik të kohëve pasnormale. Burimi ideor i një botëkuptimi shërben jo vetëm si mënyra për trajtimin e halleve, ngritjen e çështjeve të etikës dhe moralit, që mund të trajtohen dhe shtjellohen, por, gjithashtu, gjallëron zgjedhje dhe mundësi të ardhshme për shoqëritë myslimane.

Pjesërisht, kjo kërkon që ne ta rikthejmë njeriun në ligjërimin islam, duke pranuar mendimin dhe teologjinë tradicionale. Tani, Profeti nuk shihet si një njeri që lufton me mosmarrëveshje të jashtëzakonshme, brenda një rrethane të veçantë historike, por në kundërshtim me atë që shpall Kurani, si mbinjerëzor, çdo veprim i të cilit është i përsosur dhe duhet të kopjohet deri në hollësi, pavarësisht nga rrethanat e tij historike, shoqërore, kulturore dhe teknologjike. Sheriati është hyjnor dhe nuk mund të ndryshohet. Puna është se, po të jetë dhënë gjithçka nga Zoti, çfarë roli kanë njerëzit në zhvillimin e mendimit dhe moralit fetar, në mënyrë që të ndërtojnë një moral të ri për kohët tona pasnormale?

Shpallja e Kuranit: "Muhamedi është i Dërguari i Zotit dhe vula e profetëve" (33:40), është e rëndësishme. Ajo lë të kuptohet jo vetëm se nuk ka Shpallje Hyjnore pas Muhamedit, por edhe se barra e krijimit të një shoqërie të mirë, tani është vendosur fort mbi supet e njeriut. Do të ishte një gabim renditjeje, të mendohej se e gjithë dituria, morali dhe mendimi fetar merr një fund të papritur me Kuranin dhe Profetin. Përkundrazi, ata shënojnë fillimin e përpjekjeve njerëzore për të rifreskuar dhe rishpjeguar vazhdimisht mësimet hyjnore, sipas rrethanave në ndryshim, duke respektuar udhëzimet e Kuranit dhe Suneteve.

Në mjedisin që ndryshon me shpejtësi të kohëve pasnormale, ku ndërlikimi, pasiguria dhe çoroditja janë gjithmonë të pranishme, një rend





moral mund të ndërtohet vetëm mbi themelet e barazisë dhe dialogut, me vlerësimin e këndvështrimeve të ndryshme. Një qeveri përfaqësuese, për shembull, nuk mund të jetë e dobishme, nëse nuk merr parasysh shqetësimet dhe përshtypjet e të gjithë qytetarëve të saj: myslimanë të bindjeve të ndryshme, jomyslimanë të besimeve të ndryshme dhe njerëz pa fe, njerëz me prejardhje të ndryshme shoqërore dhe kulturore, si dhe ata me mendime të ndryshme mbi moralin. Në një mjedis të globalizuar, me të ardhme që nuk përputhet, nuk mund të shpresohet që shprehjet simbolike të Islamit nuk do të ndezin nxitje shqetësuese. Meqenëse mosmarrëveshjet nuk mund të vërtiten sa andej-këtej, myslimanët duhet të mësohen të merren vesh rreth çështjeve kundërshtuese, përmes mirëkuptimit, sipas parimit të barazisë.

Ironikisht, ata që janë më të shqetësuar dhe më të dhënë pas 'Islamit', që rrahin gjoksin dhe bërtasin me zë të lartë për 'mbrojtjen e Islamit' dhe 'Sheriatit Islamik', këmbëngulin në politizimin e veçantisë së tyre dhe shprehjen e saj në mënyrë të ashpër dhe të dukshme (p.sh.: në nikabe ose hixhabe, apo në gjatësinë e mjekrës së tyre), duke u bërë kërcënimi më i madh për Islamin dhe të ardhmen e tij. Formime të tilla monolite dhe të palakueshme të Islamit mund ta çojnë lehtësisht çoroditjen drejt përmasave katastrofike. Për më tepër, siç e tregon ndërlikimi, asnjë mënyrë e vetme e të menduarit apo modeli sjelljeje nuk mund të japë një përgjigje për shqetësimet dhe çështjet tona të ndërlidhura dhe të ndërlikuara. Ndërlikimi mund të zbutet vetëm me përfshirjen e larmisë dhe shumëllojshmërisë.

Gjenden dy parakushte të besueshme dhe të qëndrueshme, për përgatitjen dhe punën drejt të ardhmes së parapëlqyer. Të dyja kërkojnë braktisjen e shtyllave kryesore të këndvështrimit teologjik tradicional mysliman dhe janë shumë të vonuara, por kohët pasnormale e kanë përshpejtuar ngutshmërinë e tyre. Së pari, qëllimi që myslimanët e vlerësojnë mbi gjithë të tjerët: ngulitjen e një të vërtete të vetme, në një shoqëri të larmishme dhe një botë të shumëllojshme. Besohet se Islami nuk është vetëm i vërtetë, porse ai është e vërteta e vetme, jo vetëm se të gjitha fetë e tjera janë të rreme, por edhe më të ulëta kundrejt Islamit; se të gjitha mënyrat e tjera për të vlerësuar Hyjnoren, frikën dhe mrekuillinë e Gjithësisë, janë jo vetëm të gabuara, por edhe qartazi imorale. Ideja se Islami është e vërteta e vetme, krijon kundërshtime të kota brenda shoqërive myslimane, si dhe ndërmjet myslimanëve dhe jomyslimanëve. Nëse e gjithë e vërteta është e njëjtë për të gjithë, në çdo kohë, atëherë, nëse unë kam të drejtë, ju duhet ta keni gabim. Dhe, nëse realisht kujdesem për të vërtetën, duhet t'ju kthej në pikëpamjen time, duke ju



bindur me ligje ose forcë, nëse është e nevojshme. Ose, të paktën, duhet të sigurohem që e vërteta ime të mbetet disi mbizotëruese në shoqëri. Siç e dimë të gjithë, ka myslimanë që mendojnë se Islami i tyre është e vetmja e Vërtetë dhe ata kanë një urdhër hyjnor për t'ua imponuar myslimanëve dhe gjithë të tjerëve, me mjete të dhunshme. Ky përcaktim i së Vërtetës ka gjallëruar luftë dhe grindje të patregueshme në historinë myslimane dhe ka gjallëruar sektarizëm, terrorizëm dhe gjakderdhje në kohën tonë. Prandaj është e domosdoshme, që myslimanët t'i largohen sa më shumë mendësisë së vjetër, se 'Islami është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe, për këtë arsye, të gjithë burrat/gratë duhet të kenë një Islam të vërtetë'. Ata duhet të rendin drejt një përcaktimi ri, se 'Islami është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe, për këtë arsye, çdo burrë/grua duhet të lejohet të jetojë sipas Islamit që i duket i vërtetë, ose të mos pranojë atë që atij/asaj nuk i duket e vërtetë'. Kjo është diçka që të përkushtuarit dhe konservatorët do ta kenë të vështirë ta kapërdijnë. Por, e vërteta është se idetë e tyre historike dhe tradicionale të 'së vërtetës islame' janë të vjetruara në mënyrë të tmerrshme për kohët pasnormale dhe shërbejnë vetëm si burim grindjesh e dhune.

Ne duhet të vlerësojmë se Sheriati është një formulim njerëzor i njeriut të gabueshëm në histori. Kuptimi ynë rreth Burimeve tona të Shenjta mund të jetë vetëm një shpjegim njerëzor, një përpjekje për të kuptuar Hyjnoren, brenda një rrethane të veçantë historike. Pikërisht për këtë arsye, pjesa më e madhe e Sheriatit, në fakt, përbëhet nga *fikhu* ose ligjet që nuk janë gjë tjetër, veçse mendim ligjor i juristëve klasikë. Ne kemi nevojë për një Sheriat të përshtatshëm për kohët pasnormale; që merr parasysh ndërlidhjet dhe ndërlikimin e një bote të globalizuar; që e hap Islamin si një botëkuptim gjithëpërfshirës; që përkrah barazinë dhe larminë në të gjitha nivelet e shoqërisë dhe që përbashkon myslimanët dhe jomyslimanët, për të punuar mbi një botë dhe të ardhme të qëndrueshme për të gjithë. Pra, Sheriati duhet ripërcaktuar jo si ligj, por si moral bashkëkohor dhe si një metodikë për zgjidhjen e çështjeve morale. Ndoshta kjo mund të arrihet përmes *makadis*, pra, qëllimeve të Sheriatit, duke vënë theksin te interesat e qytetarëve, të drejtat e njeriut, mundësitë e barabarta për gratë, lirinë e ndërgjegjes, të drejtën për mospajtim, vërejtjen dhe kundërvërejtjen, të ndërsjellën, nderimin e feve të tjera dhe të përgjithshmen.<sup>32</sup>

Vlera kryesore në botën pasmoderne dhe një burim thelbësor i fuqisë është kultura. Edhe e ardhmja modeste e parapëlqyer që përfytyruam,

32 Shih Mohamad Hashim Kamali, 'Maqasid Al-Shariah, Ijtihad and the Civilisational Renewal', *Occasional Paper Series* Nr. 20, IIIT, Londër, 2012; dhe botime të tjera të IIIT mbi 'Maqasid Al-Shariah'.



kërkon që ne të fillojmë duke përkrahur kulturën në të gjitha shfaqjet e saj të ndryshme, brenda shoqërive myslimane. Ose, e thënë ndryshe, ne duhet të mësojmë të vlerësojmë bukurinë në të gjitha format e saj, në të gjitha përpjekjet njerëzore dhe domosdoshmërinë e saj për mbijetesën e njerëzimit. Që e ardhmja të jetë e bukur, duhet të sigurohemi që bukuria të përfshihet në të tashmen.<sup>33</sup>

## PËRMBYLLJE

Në kërkimin tonë për të ardhme të parapëlqyera dhe të vlefshme për Islam dhe për shoqëritë myslimane, ne duhet të sigurohemi që e ardhmja të jetë e hapur ndaj të gjitha mundësive ndryshe. Pa një mendim drejt të ardhmes, myslimanët mund të bëhen vetëm një shtojcë e kulturave dhe e qytetërimeve të tjera, përgjithmonë të varur nga bujaria dhe zemërgjerësia e të tjerëve. Megjithatë, siç na lënë të kuptojmë prirjet e tanishme, myslimanët thjesht mund të jenë të veçuar dhe të mos japin asnjë ndihmesë të vërtetë në formësimin e botës. Myslimanët nuk duhet të bëhen njerëz pa histori apo traditë. Nëse historia është e pranishme si vetëdije, në vend të besimeve të errëta, ne ecim përpara drejt një të ardhmeje të parapëlqyer, jo duke parë prapa në histori, por duke e përjetuar historinë si një vërtetësi të gjallë në të tashmen. Ne nuk presim që gjërat të ndryshojnë, por duhet t'i ndryshojmë vetë gjërat dhe, në këtë mënyrë, të bëjmë histori.

**DERI TANI, PENGESA MË E MADHE NË TË MENDUARIT PËR TË ARDHMEN, NGA PIKËPAMJA ISLAME, ËSHTË MUNGESA E NJË GJUHE TË PËRSHTATSHME. E ARDHMJA ËSHTË FUSHA E VETME KU ÇDO NDRYSHIM KUPTIMLOTË ËSHTË I MUNDSHËM. NE DUHET NDRYSHOJMË TË TANISHMEN PËR TË KRIJUAR TË ARDHMEN, NJË TË ARDHME QË ËSHTË NDRYSHME DHE MË E MIRË NGA E TASHMJA.**

Duke pasur parasysh, se ne e kuptojmë dhe angazhohemi me botën përmes ligjëritimit, kjo nënkupton se ligjërimi islam duhet të jetë i aftë të merret me çështjet botërore, ashtu siç janë, dhe të lehtësojë ndryshimin

33 Është interesante të theksohet se Khaled Abou el Fadl i sheh çështjet e reformës, si *The Search for Beauty in Islam*, Rowan and Littlefield, New York, 2005.



drejt të ardhmes. Gjuha nuk është vetëm një mjet bashkëbisedimi, por edhe një mjet përmes së cilit merremi vesh për nevojat shoqërore dhe kulturore, të domosdoshme për të mbijetuar. Prandaj, ka një nevojë të ngutshme për të ngjallur ligjërimin islam: hamendësimet e tij, thëniet, idetë dhe kuadrin e njohurive shoqërore dhe kulturore, duke qenë të vetëdijshëm për të ardhmen, për zhvillimin e një gjuhe që na ndihmon të shohim përpara dhe jo prapa. Ne kemi shumë nevojë për metafora dhe vegime të së ardhmes islame që krijojnë kuptime të reja.

Në një ese me një nënkuptim të bukur, shkruar mbi njëzet vjet më parë, arkitekti dhe teoricieni pakistanezo-kanadez i estetikës, Gulzar Haider, nis të kërkojë një emër për nipin e tij ende të palindur. Ai dëshiron t'i japë atij një emër që ka një kuptim të cilin ai mund ta përmbushë. I ulur në vendin e vet të parapëlqyer, midis Hagia Sofisë dhe Xhamisë Blu në Stamboll, ai arsyeton se emrat janë të ngulitur në përmbajtjen e shkencës hapësinore të Kuranit, si ndërmjetësim paraprak i dijeve që Zoti i jep Adamit. "Ishin emrat e qenieve, të shënuara në kujtesën e Adamit, ato që e vendosën atë dhe fëmijët e tij në një nivel të pakrahasueshëm dhe më të lartë se atë të engjëjve. A nuk ishin ata 'Emra të Bukur', përmes së cilëve Krijuesi zgjodhi ta prezantonte Vetën me krijimin e Tij të zgjedhur, njerëzimin?"

Nën hijen e minareve të larta, 'pasnormale mes fëmijërisë dhe gjyshërit, duke u përpjekur të zotërojë gëzimin familjar dhe ndjenjën e përgjithshme të gjëmës planetare', gati sa s'fluturon nga gëzimi. Duke e përfytyruar veten pas njëzet vjetësh, që është në të tashmen tonë, ai mbërrin në Mekë, në ditën e Arafatit. Përzihet me udhëtarëve nga e gjithë bota myslimane, duke kaluar nga tenda në tendë, duke përgjuar bisedat midis llojeve të ndryshme të myslimanëve: ortodoksë, sunitë, shiitë, vehabistë, salafistë, xhihadistë, modernistë, tradicionalistë, konservatorë, liberalë, me prejardhje dhe raca të ndryshme. Ai zbulon se e ardhmja nuk ka ndryshuar, ndërsa bota ka ndryshuar dhe ecur përpara. Sakaq, gjuha dhe retorika e myslimanëve ka mbetur po e njëjta, sikur të qenë varrosur 'në varrezat prej guri, në anën veriore të Hagia Sofisë'. Nuk ka ndodhur asnjë zhvillim apo përparim i asnjë lloji. Ai gjen nipin e tij ulur, duke dëgjuar i përhumbur këtë retorikë. Kthehet te Xhamia Blu, 'kryqëzimi madhështor i kohës ku përzierjet e kujtesës me përfytyrimin, të shkuarës me të ardhmen, i nënshtrohen një të tashmeje ndijimore tekanjoze', i lënduar dhe i zhgënjyer. Vendos t'i shkruajë një letër nipit të tij:

*Është e vërtetë, që unë u luta për një emër për ty, që të mund ta përmbushje! Por, tani e di se, duke të vënë një emër, unë do të paracaktoj të ardhmen tënde në një përmendore guri. Më lejo të jem vetëm një vëzhgues i dashur, që do të përpiqet*



t'u përgjigjet pyetjeve të tua dhe të ndihmojë në zbulimin dhe paqtimin e ndjesisë tënde të brendshme dhe të jashtme!... E ardhmja, siç do ta shohësh më vonë, është një hapësirë në të cilën ne soditim pasojat e veprimeve tona të tanishme. Dhe kjo nuk është njohuri për të ardhmen, por vegim i saj moralisht i rregulluar. Nuk është zotërimi i saj, por soditja e saj me mençuri, që na kthen në zili të engjëjve. Unë e kam parë peizazhin e së ardhmes myslimane dhe duket i copëzuar, i kufizuar, një qytet i mbikëqyrur me strehime të veçuara. Disa prej tyre janë ende gjallë dhe zgjuar, por të dëbuar nga qyteti. Ata vazhdojnë ta kërkojnë Medinën dhe, deri sa ta gjejnë, vazhdojnë të lexojnë, shkruajnë dhe flasin pa ndonjë frikë, përveç Zotit të tyre dhe Profetit të Tij. E megjithatë, asnjëri prej tyre nuk ka emër.<sup>34</sup>

---

34 Gulzar Haider, *An "Islamic Future" without a name* in Ziauddin Sardar, editor, 'Islam and the Future', special issues, *Futures* 23 (3) 311–316 (Prill 1991).



## Shkenca dhe shkencëtarët në kohët pasnormale

*Jerry Ravetz*

Ne e dimë se risitë në teknologjitë e të dhënave po revolucionarizojnë zbatimin në një larmi të madhe fushash, duke përfshirë tani edhe prodhimin e lirë të sendeve materiale. Fuqitë e shkencës kërkimore në shumë fusha po rriten, madje po tjetërsohen. Në përgjithësi, këto ndryshime në zbatimin teknik ndodhin brenda strukturave shoqërore dhe ideore që janë trashëguar nga periudhat e mëparshme në shkencë. Ato janë zhvillime të reja të rëndësishme, por jo domosdoshmërisht 'forma të reja' të shkencës. Këtu ne po marrim parasysh zbatimet dhe strukturat që shkaktojnë çudi dhe shqetësim, kur vihen re, dhe që me vrullin e tyre të çastit vazhdojnë të shkaktojnë ndryshime të shpejta. Në përgjithësi, ato shpërfaqin pasojat e teknologjive të reja të të dhënave, të kombinuara me ide dhe zbatueshmëri të mbartura nga sfera e gjerë politike. Meqenëse e gjithë kjo po ndodh së fundmi dhe kaq shpejt, vështirë se ka ndonjë literaturë shkencore që pasqyron diçka mbi këtë temë. Pra, ne duhet t'i marrim njohuritë tona nga burimet e zakonshme bashkëkohore, duke zhvlerësuar përfundimet e tyre më të papërgjegjshme.

Por, përpara se të shqyrtojmë se si struktura e veprimtarisë shkencore po ndryshon rrënjësisht, duke ndikuar te njerëzit, veprimtaria, prona, buja, sigurimi i cilësisë dhe pasojat shkencore, nevojitet një prapavijë e vogël historike.



## PRAPAVIJA HISTORIKE

Rreth gjysmë shekulli më parë, pati një ndërgjegjësimit midis shkencëtarëve, se gjërat kanë ndryshuar. Ndryshimi u kap në librin themelor, *Shkenca e vogël, shkenca e madhe*, të Derek Prajs<sup>1</sup>, i cili arsyetoi rreth zgjerimit të shpejtë të shkencës, veçanërisht në SHBA, dhe shfrytëzimit të saj për rritjen e prodhimit dhe për luftën, si në rastin e *Projektit Manhattan*. Gjatë dekadave në vijim, kjo rrethanë e re u bë shkak për shumë arsytetime, së bashku me rrahje të reja mendimesh që morën udhë gradualisht. Gjendja e tanishme e shkencës është një gjendje e ndryshimit shumë të shpejtë. Qëndrimet dhe veprimtaritë që vetëm dhjetë vjet më parë as që mund t'i merrje me mend, tani janë të mirëpërcaktuara. Pak do ta kishin përfytyruar, për shembull, që shkencëtarë të shquar do të përbuznin bashkërisht një botues kryesor shkencor. Por kjo është ajo që matematikani kryesor, Timothi Gauer, i bëri *Elsevier*-it, me mbështetjen e mijëra të tjerëve, nën parullën “Pranvera akademike”.

Ndryshimi i vetëdijes së shkencës gjatë asaj periudhe të mëparshme, na e kujton edhe njëherë, se në sistemin tekniko-shoqëror të shkencës, anët intelektuale dhe materiale të sistemit janë thellësisht të ngatërruara me njëra-tjetrën. Teksa kalojmë, ndoshta pa menduar, në një kuadër të ri marrëdhëniesh të materies dhe idesë, gjithashtu, përforcojmë paanshmërinë, duke shkuar përtej “shkencës së madhe”. Meqenëse mjetet e ndërlihdjes janë ato që po tjetërsohen dukshëm nga mediat ‘digjitale’, ne mund të sjellim ndërmend ndikimin e shkencës së shtypur gjatë Rilindjes. Kjo mundësoi përhapjen e njohurive në mënyra të dukshme, duke ushqyer rritjen e saj, si në sasi, ashtu edhe në cilësi. Atëherë nisën të shfaqeshin shembujt më të hershëm të botimit të shkencës dhe teknologjisë bashkëkohore, siç ishin librat e Agricola, Birunguccio dhe Vesalius. Kjo ua mundësonte shkencëtarëve të pavarur të reklamoin dhuntitë e tyre dhe, në këtë mënyrë, të siguronin mbrojtjen më të mirë të disponueshme në treg. Galileo e shfrytëzoi këtë teknikë, duke rrezikuar me botimin e tij, *Sidereus Nuncius*, që fillimisht i solli një rritje rroge në Venecia dhe, më pas, në një vend të lakmuar si “Kryematematikan dhe Filozof”, në oborrin mbretëror Medici të Firences.

Nga fundi i shekullit të XVI-të, si kurrë më parë, industritë e mëdha kombëtare të luftës punësuan shkencëtarë me aftësi matematikore. Pengesat tradicionale të statusit midis njohurive “liberale” dhe zbatimeve “mekanike” u ulën, të paktën për disa breza. Simon Siven ishte një gjeni që

1 Price, D.J., 1963. *Little science, big science*. Columbia University Press, New York.



punonte si zbatues, por shfaqte ambicie filozofike. Ndërsa Galileo ishte thjesht në anën tjetër të ndarjes klasë/kulturë dhe ishte i vendosur të qëndronte atje. Uilliam Gilbert ishte i pari që përbashkoi ‘filozofinë’ dhe eksperimentimin, në *de Magnete*. Atje, gjithashtu ai njoftoi me përpikëri, se cilat eksperimente bënin punë dhe cilat jo. Bindja e Bejkën për “torturimin e natyrës” gjeti një përdorim të gjerë midis “filozofëve eksperimentalë”, veçanërisht në shkollën e madhe angleze me Bojell, Huk dhe Njuton. Nga shekulli i XVIII-të, bashkimi i teorisë dhe praktikës përfundoi plotësisht dhe filozofët në ‘zonën malore’ të Britanisë ndërthurën ideologjinë dhe përmirësimin (me fitimin aty ku mund të arrihet) me shumë sukses.

Ndërsa fuqizimi i teknologjisë u rrit gjatë shekullit të XIX-të, shkencëtarët (të cilët e morën titullin më pas) mund të studionin fuqitë natyrore në rrethana të zotëruara artificialisht, veçanërisht elektricitetin dhe magnetizmin, por edhe përbërësit kimikë të vjetër dhe ata të rinj. Shtimi i kërkimeve shkencore në industrinë e rëndë, me qëllime të caktuara, fillimisht u krijua në Gjermani (duke filluar me Liebig) dhe më pas gjetkë, veçanërisht në SHBA, në laboratorët e mëdhenj të mbizotëruar nga shpikës të tillë, si Edison e Stainmets, së bashku me pothuajse të magjishmin Tesla. Sipas modelit gjerman, sistemi universitar, përfundimisht, u detyrua të shartonte kërkimin shkencor me rolet tradicionale të mësimdhënies dhe shoqërisë me elitën re. Pjellë e mëvonshme e këtij përbashkimi ishte një përhumbje në mesin e shkencëtarëve dhe studiuesve të rolit që luajti kërkimi dhe zhvillimi i industrializuar gjatë periudhës së “shkencës së vogël”, një keqkuptim që çoi në më shumë pështjellim, kur “shkenca e madhe” mbërriti me fuqinë e saj të plotë.

Gjatë periudhës së përrurimit të *Projekti Manhattan* dhe vetëm kur ishte drejt përfundimit, shkenca u ‘industrializua’ në disa drejtime: në madhësinë e përgjithshme, në shkallën e sipërmarrjeve vetjake dhe në marrëdhëniet e saj gjithnjë e më të ngushta me industrinë. Gjithashtu, ajo u ‘përfshi’<sup>2</sup> në mënyra të ndryshme në punët e shtetit, shumë përtej lidhjeve tradicionale të luftës. Shkencëtarët disi fëmijërorë besonin se atyre u kërkohet të ‘mbronin të vërtetën’, teksa blerësit e tyre shpesh donin ‘prova të bazuara në politikë’. Hulumtimi shkencor tradicional i qëndrueshëm në çdo *lëndë të veçantë*, tani është zëvendësuar me “Modalitetin 2”, ku shkencëtarët janë njësi të këmbyeshme prodhimi, për t’u punësuar ose hedhur poshtë, siç diktojnë nevojat e projekteve me qëllime të caktuara. Në marrëdhëniet me shoqërinë e gjerë, ndryshimet dhe shtrembërimet e

2 Rose, S. dhe Rose, H., 1969. *Science and Society*, Allen Lane, Londër.





kërkimit shkencor, që tashmë janë të njohura në lidhje me industrinë fitimprurëse (si ajo e duhanit, ushqimit dhe farmaceutika, ndërmjet të tjerash), pasqyrohen në mënyrën e të vepruarit më pak famëkeq, ndonëse po aq e rëndësishme, të ministrive dhe agjencive shtetërore. Bashkësitë kërkimore të dikurshme, “*Gemeinschaft*”, janë në kufijtë e mbijetesës, megjithëse Steven Shapin ka pohuar se ato po rikrijohen nga nevoja që po lind në fushat shkencore, me lëvizjen e shpejtë të risive dhe sipërmarrjes.<sup>3</sup>

## NGREHINAT E VEPRIMTARISË SHKENCORE

Pasi kemi shqyrtuar shkurtimisht prapavijën historike, tani mund të ravigëzojmë ngrehinat përkatëse të veprimtarisë shkencore. Vetëm atëherë do të dimë aq sa duhet, për të kuptuar ndikimin e teknologjive të reja në format e reja të zbatimit shkencor. Tani vlerësohet gjerësisht, se fotoja e vjetër e “shkencëtarit” që bën një zbulim dhe më pas ia kthen atë “shoqërisë”, është thjeshtuar rrënjësisht. Së pari, shtysat e mundshme për t’u angazhuar, ose për të mbështetur kërkimin janë të ndryshme. Përveç ‘kërshtërisë’ tradicionale, ka edhe kërkime me ‘qëllime të caktuara’, ‘të mandatuara’, ‘rregullatore’, ‘amatore’ dhe (tani duhet të shtojmë) ‘të rrezikshme’. Marrëdhëniet me shoqërinë e gjerë, struktura e brendshme shoqërore dhe kushtet që përcaktojnë përshtatshmërinë dhe vlerën, të gjitha varen nga shtypa fillestare. Duke vlerësuar shumëllojshmërinë themelore në sistemet e prodhimit të njohurive shkencore, mund të shqyrtojmë ciklin e veprimtarive nëpër të cilat kalon prodhimi i njohurive.

Kjo shtysë fillestare nuk është veçse hapi i parë në një cikël shumëfaktor. Ne mund ta quajmë ‘çështje’, pasi kjo është zanafilla e përcaktimit të rëndësisë së asaj që dëshmon kërkimi shkencor. Më pas vjen ‘mënyra e veprimit’, e cila shpreh zgjidhjen e shpresuar dhe përcakton parametrat e projektit që do të zbatohet. Kjo vërehet më së lehti në kërkimet mbi përcaktimin e rreziqeve, sepse ‘rreziku’, në vetvete, është gjithmonë i ndërlikuar dhe duhen bërë zgjedhje të thjeshtuara projektuese për çështjet që do të studiohen, si dhe për natyrën e rrezikut që ato përjetojnë (p.sh.: të rriturit, fëmijët, nënat shtatzëna, doza të përhershme ose të ngutshme, zbulesa mesatare ose maksimale, etj...)

‘Problemi’ lind menjëherë pas kësaj, ngaqë i kushtohet një rëndësi e posaçme hetimit, ndoshta duke përmendur një hamendësim statistikor sa

3 Shapin, S., 2008. *The Scientific Life: A Moral History of a Late Modern Vocation*, The University of Chicago Press, Chicago.



për ta provuar. Por një hap i hershëm, më i rëndësishëm, janë “njerëzit”. Kurdoherë që politika është në rrezik, ata mund të bëhen mjaft të rëndësishëm. Është si puna e gjyqtarëve, edhe në rast se të gjithë shkencëtarët kanë ndershmëri që nuk i pengon të anojnë në këtë apo atë anë, kur përballen me pasiguri dhe përplasje vlerash. Ky hap është bërë problematik në disa mënyra kohët e fundit dhe është i lidhur ngushtë me përjasjen e re të shkencës. Më pas vijnë ‘veprimet’ që janë të nevojshme, ngaqë kërkimi nuk është kurrë i drejtpërdrejtë, por është studim i ‘përfaqësuesve tipikë’ për gjëra dhe ngjarje ideore që përbëjnë shqetësim. Në të gjitha këto raste, ka shumë standarde dhe marrëveshje që përcaktojnë zbatueshmëri të mirë dhe të pranueshme, e krijuar dhe e vënë në jetë për të shmangur grackat e njohura të krijimit të të dhënave, të shpjegimit dhe pandehjes së tyre. Një punim shkencor me cilësi të lartë përmban përshkrime të dendura të këtyre veprimeve, duke siguruar kështu lexuesit, se përfundimet e këtij punimi janë të qëndrueshme. Në thelb të hetimit është ‘prodhimi’, ku dikush ndërvepron me pajisjet (ose të pyeturit), për të përfutur të dhënat parësore që do të jenë përfaqësuesit e synuar të të anketuarve për çështjet e përcaktuara të hetimit. Nga kjo del “prodhimi”, i “gdhendur” mbi një letër, i cili mund të shërbejë si “punim shkencor”, njoftim ose kërkesë për patentë shpikjeje. Përtej kësaj, është ‘pronësia’ që përfshin edhe zotërimin mbi ‘publicitetin’. Dikur mendohej se ndarja e punimeve shkencore me qytetarët përbënte përkufizimin e shkencës, në krahasim me shpikjen. Por kohët e fundit, me sa duket, botimi i të dhënave nuk është aspak i gjithanshëm, pavarësisht se kërkohet zyrtarisht nga shumë financues dhe revista.

Sigurisht,

**KUR FSHIHEN TË DHËNAT, ËSHTË E PAMUNDUR TË VIHEN NË VEPRIM NORMAT E ‘BASHKËSISË’ DHE ‘DYSHIMIT TË ORGANIZUAR’, TË CILAT U PRANUAN SI THEMELORE PËR SHKENCËN E VËRTETË.**

Diku nga fundi i ciklit, vijnë ‘zbatimi’ tradicional dhe ‘pasojat’ e pranuar së fundmi. Ndonjëherë, këto vlerësohen si të rëndësishme për hetimin dhe do të përfshijnë ‘të këqijat’ ose ‘pasojat e paqëllimshme’ që dalin nga zbatimi i përfundimeve shkencore. Shkencat përkatëse këtu janë pothuajse me tipare krejt të kundërta, në krahasim me lëndët tradicionale laboratorike. Zakonisht, problemet janë ‘pasnormale’, sa i përket pasigurisë dhe



rreziqeve të larta të vendimmarrjes dhe rrahjes së mendimeve, të politizuara rreth caktimit të barrës së provës. Përveç kësaj, mungesa e sigurisë, lidhur me cilësinë dhe financimin si zakonisht nga institucionet, ku informatorët e brendshëm ndonjëherë janë po aq të rëndësishëm sa studiuesit, çojnë në shpërthimin e përplasjeve të hapura midis grupeve që përpiqen të ndikojnë në politikat qytetare dhe në interesat vetjake.

Një cikël i tillë ndihmon për të shpjeguar ndërlikimin dhe çoroditjen që shoqëron debatet kur shkenca është e përfshirë me politikën. Pa një ndërgjegjësim të përbashkët për fazat e ndryshme të ciklit të prodhimit, rrahja e mendimeve mund të endet në udhë pa krye, nëpër një labirint temash. Për më tepër, secila nga fazat e ciklit të prodhimit ka 'ciklin e vet të kontrollit të cilësisë'. Kjo veçori përcakton ndërlikimin e vërtetë të ecursisë, sepse, sa herë që një veprim kryhet brenda një sistemi të organizuar, ai do t'i nënshtrohet 'kontrollit' lidhur me cilësinë. Kjo ndërhyrje do të përfshijë përfaqësues të veçantë, të cilët veprojnë sipas kushteve të veçanta të cilësisë dhe që miratojnë mënyra veprimi të veçanta. Sa herë që enti rregullator del para qytetarëve, do të duket qartë, se i ka të gjitha këto elemente, përfaqësues, kushte dhe mënyra veprimi. Për më tepër, cikli i kontrollit është, në vetvete, në varësi të cikleve të kontrollit. Që kjo të mos duket e pakuptimtë, ne po sjellim ndërmend mbishkrimin latin: "*Quis custodiet ipsos custodes?*" – Kush i ruan rojtaret? Shila Jasanof ishte e para që tërhoqi vëmendjen e këshillave shkencorë, lidhur me këtë dukuri, në veprën e saj kërkimore, *Lëmia e pestë*.<sup>4</sup> Një përsëritje e tillë është e njohur edhe në dhënien e drejtësisë, me një rend gjykatash apeli, deri në ndonjë gjykatë më të lartë, nga e cila nuk mund të përjashtohet ndonjë ndikim politik. Për sa i përket shqetësimeve tona të tanishme, cilësia ka zëvendësuar të vërtetën, si parim drejtues që ndikon në shkencë. Përsëritja e 'quis custodiet' na e rikujton se cilësia nuk mund të mbahet në këmbë me detyrim. Ajo kërkon një angazhim moral, i cili duhet të ushtrohet haptazi në krye të çdo institucioni. Në mungesë të tij, korrupsioni dhe kërkimet e zbrazëta sigurisht që do të vijojnë. Ne kemi vërejtur edhe më parë varësinë e thellë të prodhimit të suksesshëm të njohurive objektive shkencore nga ky angazhim moral i qëllimshëm.<sup>5</sup>

4 Jasanoff, S., 1990. *The Fifth Branch: Science Advisors as Policymakers*, Harvard University Press, Cambridge.

5 Ravetz, J.R., 1971. *Scientific Knowledge and its Social Problems*, Oxford University Press, Oxford.



## NJERËZIT

Tani jemi në gjendje të shikojmë më në hollësi ciklin e prodhimit të njohurive shkencore, duke vënë në pah çështje të rëndësishme risish. Në dhjetëvjeçarët e fundit është pranuar gjithnjë e më shumë, se shkenca e *dëshmimeve të rëndësishme* bëhet më mirë, nëse periudhat e hershme, si çështjet, madje edhe problemet, mbështeten në një përvojë më të gjerë sesa ajo e politikanëve, këshilltarëve shkencorë dhe njohësve të fushës. Disa kohë më parë u krijua emërtesa 'Këshilli i Zgjeruar Shkencor'<sup>6</sup> dhe, që atëherë, nën shumë emra të ndryshëm, përfshirja e qytetarëve është bërë gjithnjë e më shumë e pranueshme, e dëshirueshme dhe e dobishme. Çështjet e dukshme kushtetuese të veprimtarive të tilla, siç është 'pjesëmarrja', nuk kanë qenë aq të pakapërcyeshme. Sidomos për çështjet e shëndetit publik, është mundësuar një pjesëmarrje më e gjerë lidhur me përcaktimin e problemit, duke filluar që nga fushatat e aktivistëve të SIDA-s. Zhvillime të tilla kanë zbehur fuqinë parësore të vetë idesë së "shkencëtarit", pasi lloji i njerëzve të përfshirë në ciklin e kërkimit zgjerohet gjithnjë e më shumë. Në kërkimin shkencor tradicional, ka një traditë të gjatë e të vazhdueshme të ndihmës së dhënë nga shkencëtarët amatorë, por, kohët e fundit, ata janë emëruar ndihmës të thjeshtë me një status më të ulët. Të tilla qenë motrat e astronomëve të lëna pas dore në të kaluarën dhe vëzhguesit e shumtë të zogjve në të tashmen. Kjo përjasje ndaj një përfshirjeje më të gjerë, më së paku kërcënon urdhrat në fuqi, nga ana tjetër, nxiti studimet 'Galaxy Zoo'. Aty, grupet e amatorëve madje mund të hapin tema për hetim më nga afër. Mirëpo një përfshirje më gjallëruese po zhvillohet gjatë gjithë kohës, si për shembull, në faqet e internetit për palosjen e molekulave, madje edhe për zgjidhjen e problemeve të vështira matematikore. Nga ana tjetër, është edhe ajo që quhet 'biologjia e garazhit', ku shkencëtarët eksperimentojnë nëpër shtëpitë e tyre. Ajo është ende shumë e vogël dhe e mënjanuar, por me mundësi të mëdha. Më i rëndësishëm është *universi paralel* i kod thyesve të vetëstërvitur, duke përfshirë gjithçka, qoftë ata që tallen, apo liri-dashësit, deri te rrugaçët dhe agentët e shtetit. Si pasojë, rëndësia e 'shkencëtarit' po zbehet në mënyrë të vazhdueshme. Njeriu nuk ka më nevojë të ketë kaluar nëpër ecurinë e gjatë të përzgjedhjes dhe të ushtruarit, duke kulmuar me një doktoraturë në krye të piramidës së zgjuarsisë, në mënyrë që të pranohet si anëtar i një bashkësie të njohur që prodhon njohuri. Rëndësia e 'ekspertit', dikujt që ka besueshmërinë për të zgjidhur çështje të veçanta, mbështetur në formimit të tij shkencor, po gërryhet edhe më shpejt.

6 Funtowicz, S.O. dhe Ravetz, J.R., 1993. Science for the Post-Normal Age, *Futures*, 25/7, f. 739–755.



**ME RRIJTJEN E MOSMARRËVESHJEVE RRETH PËRQASJES SË SHKENCËS (QË NGA ENERGJIA BËRTHAMORE E DERI TE VAKSINIMI), BASHKË ME RRIJTJEN E PËRDORIMIT TË BURIMEVE TË QYTETARËVE PËR MARRJEN E VENDIMEVE, EKSPERTIZA PO LUAN NJË ROL GJITHNJË E MË TË KUFIZUAR.**

Një zhvillim më i rëndësishëm i kohëve të fundit ka qenë humbja e ‘interesi- mit’ në dikë të certifikuar si shkencëtar. Është bërë e udhës, që autorëve të punimeve tani t’u kërkohet të deklarojnë çdo përplasje të mundshme interesi, kinse këto ndikojnë në pohimet e tyre shkencore. Gjithashtu, ka rënë cilësia e kërkimi shkencor të mbështetur nga industria, duke e përligjur me ruajtjen e njëanshmërisë, gjë që mbështetet edhe nga mbikëqyrësit e rezultateve.<sup>7</sup> Kjo ka shkuar deri në atë pikë, sa disa ndërmarrje po braktisin sponsorizimin e kërkimit shkencor. Meqenëse një pjesë shumë e madhe e kërkimit shkencor në dukje për qytetarët është i mbështetur nga industria dhe ushtria, ky ndër- gjegjësim i ri mund të dobësojë modelet e krijuara prej kohësh.

## MËNYRAT E VEPRIMIT

Një ecuri e ngjashme ndryshimi, e parë në mënyra të ndryshme, si gërryerje apo demokratizim, dëmton mënyrën e veprimit. Për një kohë të gjatë, ekzis- tonte besimi i përbashkët te *Metoda Shkencore*, apo mënyra e të vepruarit, përmes së cilës shkenca prodhoi pa gabime përgjigjet e sakta për çështjet e veta. Detyra e historisë së shkencës ishte të tregonte se shkenca gjithmonë kishte të drejtë, por ishte detyrë e filozofisë së shkencës të tregonte se përse kishte të drejtë. Me rritjen e pasigurisë, fillimisht në fizikën teorike dhe më pas në ndërlikimin e njohurive dhe përjasjes, ky besim frymëzues humbi gradualisht besueshmërinë. Pamundësia për të përcaktuar një metodë që nuk është logjiksht e gabuar, i ka shtuar vështirësitë. Filozofia e “falsifiki- mit”, e hartuar nga Poper, sipas së cilës *hipotezat duhet të jenë të falsifikue- shme, për të qenë shkencore, po aq të vlefshme, sa urdhri moral i vetëpërmbaj- tjes, edhe kur ke të drejtë të veprosh*, doli të ishte një zbrazëti mbi të cilën nuk mund të ndërtohet dija. Përderisa puna shkencore mbizotërohet nga të

7 Lundh, A. et al., 2012. *Industry sponsorship and research outcomes*, Cochrane Database of Systematic Reviews 2012, Issue 12. Art. No.: mr000033. doi: 10.1002/14651858.mr000033.pub2. Miedema, F. 2012. *Science 3.0 / Real Science, Real Knowledge*. Amsterdam University Press, Amsterdam.



dhënat, nuk bëhet më fjalë për “të vërtetën”, siç kuptohet tradicionalisht, sepse përfundimet varen nga arsytimi i paqartë, që bie ndesh me mendimin praktik rreth hipotezave zero dhe kufijve të besimit Edhe teknikat e nxjerrjes së të dhënave, të zbatuara në mënyrë jo pasqyruese në të gjithë shkencën ‘normale’, janë kritikuar ashpër, si për shembull, Ziliak dhe Mc Closkey.<sup>8</sup> Sa i përket modeleve që përthithin gjithnjë e më shumë përpjekje kërkimore të të gjitha fushave dhe shtrydhin metodologjitë tradicionale më të shtrenjta që kërkojnë kohë, më e mira që mund të thuhet, është ajo që dëgjojmë herë pas here: “Të gjitha modelet janë të gabuara, disa janë të dobishme”. Parimi përsëritës i ‘*quis custodiet*’ zbatohet më së shumti në mënyrat e veprimit. Përfundimet e kërkimit i nënshtrohen provës së drejtpërdrejtë, sado e papërsosur; por prova e mënyrës së veprimit është e një rendi krejtësisht të ndryshëm për nga ndërlíkimi dhe vështirësia. Nuk është për t’u habitur, që një autor<sup>9</sup> ka gjetur shembuj të shumtë të punës së dobët dhe të nivelit të ulët që kanë çuar në një shkencë jo të besueshme dhe të padenjë. Është e pamundur të thuhet se sa nga ky zhvillim dëshpërues është në të vërtetë i ri. Sigurisht, shkenca e cilësisë së dobët ka qenë gjithmonë me ne dhe është vërejtur në të kaluarën. Por duket se ka një ndërgjegjësim në rritje për këto çështje brenda bashkësisë shkencore dhe kjo mund të ketë njëkohësisht ndikime të kundërta për nxitjen e reformës, duke forcuar cinizmin.

## PRONËSIA

Në epokën e mëparshme, marrëdhëniet shoqërore të Pronësisë nuk ndryshuan me shpejtësi të madhe. Pati një zëvendësim të njëtrajtshëm të ‘njohurisë qytetare’ tradicionale, me atë që mund ta quajmë ‘aftësi korporate’. Megjithatë, kohët e fundit ka filluar të pranohet një lloj rrethane thellësisht e pakuptimtë në zotërimin e pronësisë intelektuale. Në teknologjitë e reja në zhvillim, veçanërisht në nano-teknologji, gjendet një përzierje e pështjelluar e sistemeve të pronësisë intelektuale. Është bërë shumë punë me fondet qytetare dhe në emër të qytetarëve, ndërsa shumë të tjera janë pronësi me zot. Kjo ndarje nuk kufizohet vetëm te përfundimet, por edhe në të dhënat ndihmëse që janë thelbësore për kërkimin shkencor. Kohët e fundit ka pasur një paralajmërim, se përparimi i fushës

8 Ziliak, S.T. dhe McCloskey, D., 2008. *The Cult of Statistical Significance / How the Standard Error Costs Us Jobs, Justice, and Lives*, University of Michigan Press, Ann Arbor.

9 Ionnides, J.F. A., 2005. Why Most Published Research Findings are False, *PLoS Med* 2(8): e124. doi:10.1371/journal.pmed.0020124.



po dëmtohet thellësisht nga grumbullimet e të drejtave pronësore që rrethojnë pjesë të ndryshme të njohurive dhe teknikave, që janë të nevojshme për kërkime. Pra, pikërisht në shkencë, kemi një shembull tipik të përshkrimit të Marksit rreth zëvendësimit të një mënyre prodhimi me një tjetër, në Manifestin Komunist: “...marrëdhëniet feudale të pronës nuk u bënë më të pajtueshme me forcat prodhuese, tashmë të zhvilluara. U bënë vargonj të pafund. Ata duhej të copëtoheshin, ata u copëtuan.” Këtu mund të vërejmë një lloj paralelizmi në shkencë, ku studiuesi gjysmë i pavarur i artizanatit është zëvendësuar kohët e fundit nga punonjësi i ditur i shkencës së industrializuar, ose ‘Mode 2’. Marksit e pa ciklin e shkëlqimit dhe rënies së kapitalizmit industrial modern, si një shenjë të një shtrëngese të ngjashme e të thellë trupore të vetvetes dhe ia mori mendja, se së shpejti do të ndërhynte proletariati revolucionar. Kjo nuk do të ndodhte, të paktën gjatë jetës së tij. Megjithatë, tani është e njohur gjerësisht, se për të ruajtur vrullin e risisë shkencore, sistemi hibrid vetëmbytës i pronësisë intelektuale kërkon një zëvendësim me marrëdhëniet e reja shoqërore të prodhimit, të karakterizuara si ‘burim i hapur’, ose ‘krijimtari të përbashkëta’, sipas shembullit të sistemeve IP (rregulloreve të internetit) të disa prej industrive kryesore.<sup>10</sup> Pa hyrë në lojëra fjalësh për “copëtimin” e vargonjve të të drejtave të IP-së, të mbrojtura me patenta, mund të shohim se një ndryshim i thellë është i pashmangshëm dhe është duke ndodhur tashmë. Edhe *Big Pharma* e ka kuptuar, siç bëri *Fondacioni Gates* dhe *Glaxo Smith Kline*, me fondacionin e laboratorit të hapur *Tres Cantos*.<sup>11</sup> Në këto rrethana të reja, ‘varmihësit e kapitalizmit (shkencor)’ nuk do të jenë proletarët e Marksit ‘që nuk kanë asgjë për të humbur, veç vargonjve të tyre’, por zotëruesit e *Clay Shirky*, të ‘njohurisë shtesë, që përhap krijimtarinë dhe bujarinë në një epokë të ndërlydhur’ të njohurive digjitale.<sup>12</sup>

## Ë DREJTA E INFORMIMIT

Risia është edhe më e shpejtë në periudhën e botimit që, në fund të fundit, është gjaku i shkencës dhe përbëhet nga të dhënat. Ajo që është domethënëse për vetëdijen e shkencës, është zbulimi i papritur, se, në të vërtetë, ka një shqetësim të thellë dhe të ngutshëm politiko-ekonomik lidhur

10 Igoe, T. dhe Mota, C., *A Strategist’s Guide to Digital Fabrication*, *Strategy + Business*, 64.

11 Nathan, C.F., 2012. Let’s Gang up on Killer Bugs, *New York Times*, 9 Dhjetor.

12 Shirky, C., 2010, *Cognitive Surplus: Creativity and Generosity in a Connected Age*, Penguin Group.



me të drejtën e informimit. E pranuar më parë si normë, pa ndonjë kokëçarje, ndonëse me devijime të herëpashershme, e drejta e informimit po bëhet me shpejtësi qendra e shqetësimit dhe e ankesave. Kjo çështje, edhe më shumë sesa pronësia, mund të bëhet leva me anë të së cilës hamendësimet morale idealiste të “shkencës së vogël” shihen gjithnjë e më tepër si njëfarë lirie në qarqet politike, jo për t’u pranuar si të vërteta, por që kërkojnë vëmendje dhe përpjekje për ruajtjen e tyre. Matematikani i shquar që nxit Sheshin Tahrir kundër botuesve *Elsevier*, mund të jetë ikonë për kacafytjet e reja, lidhur me të qenit në dijeni të qytetarëve rreth shkencës. Çështja e fshehtësisë dhe e botimit u shfaq pothuajse rastësisht, në përparimin mjaft të trazuar të shkencës, ndonëse me qëllime të mira në fushën e ngrohjes globale. Shkencëtarët kryesorë u ndjenë të fyer nga kërkesat për të dhënat e tyre shkencore, të cilat bëheshin publike nga njerëz amatorë, kritikë të pakualifikuar, veçanërisht Stiv Makentije. Përfundimisht, u desh të përdorej ligji për lirinë e të dhënave kundër individëve dhe institucioneve, në SHBA dhe UK, për të zhbllokuar të dhënat kërkimore të prodhuara me fondet e qytetarëve. Kundërshtarët nuk mund të veçoheshin dhe asnjësoheshin, si në debatet e mëparshme (veçanërisht BSE), pasi ata formuan një ‘këshill të zgjeruar shkencor’ në një faqe të përbashkët interneti, faqja më e popullarizuar, që ka njëkohësisht miliona lexues, fituese e çmimeve për cilësinë (shih: [www.wattsupwiththat.com](http://www.wattsupwiththat.com)). Çështja e fshehtësisë së të dhënave të financuara nga qytetarët u bë aq e ngutshme, sa që Shoqëria Mbretërore e Londrës u kundërpërgjigj menjëherë zyrtarisht, në formën e një grupi pune të kryesuar nga profesor J. Bolton (*The Royal Society Policy Center, 2012*).<sup>13</sup> Në raportin e saj paraqiti qartazi mënyrat e veprimit, me qëllim që të dhëna të tilla të bëhen publike, megjithëse nuk i shtriu kërkesat e saj deri te kodet kompjuterike, me të cilat të dhëna të papërpunuara shndërroheshin në informacion të përdorshëm. Në shqyrtimin që pasoi, doli se shumë rregulla për botimin e të dhënave tashmë janë në fuqi, porse ato përgjithësisht nuk u morën parasysh nga të gjitha palët gjatë ecurisë së botimit. Ndërgjegjësimi rreth kësaj çështjeje u shtri me shpejtësi nga të dhënat e kërkimit, tek ato të përdorura gjatë punës rregullatore. U kuptua se rregullatorët publikë, zakonisht, marrin vendime mbështetur në të dhëna të fshehta. Në ajrin e dyshimit të ndërsjellë, hyri në fuqi parimi: “Nëse ata fshehin diçka, ata duhet të kenë se çfarë të fshehin”. Disa nga qendrat më të besueshme u fajësuan nga rregullatorët europianë për keqpërdorime të mundshme nga ndërmarrjet

13 The Royal Society Policy Centre, 2012. *Science as an open enterprise*. The Royal Society, Londër.





kryesore të barnave dhe për paaftësi të rëndë në zotërimin e të dhënave.<sup>14</sup> Është e natyrshme që çështjet e informimit dhe cilësisë të ngatërrohen në këtë mënyrë. Mënyra më e dobishme për të kapur nivelin e lartë moral në një debat shkencor-politik, është të kërkosh ndershmëri dhe çiltërsi, duke thirrur, në këtë mënyrë, rregullat tradicionale të shkencës, të ndërthurura me thelbin bashkëkohor të demokracisë pjesëmarrëse.

Çështjet etike të përqasjes së ndershme ndaj të dhënave, befas janë bërë të ngutshme në një tjetër front. Botimi shkencor nuk është falas, aq më tepër i lirë. Si do të shpërblehen botuesit? Çështjet e shpenzimit dhe zhdëmtimit në moshën digjitale që kishin prekur tashmë industrinë krijuese, kanë mbërritur papritur edhe në shkencë. Marrëveshjet e mëparshme komode, ku bibliotekat akademike paguanin për botimet përmes anëtarëve të tyre (dhe siguronin një fitim të madh), nuk janë më të pacenueshme. Gjithashtu, befas kuptohet se ka shumë njerëz të denjë që kanë nevojë për qasje në informacionin publik, sa për emër, dhe që nuk mund ose nuk duhet të bëjnë pagesa të mëdha për përparësinë e të hedhurit një sy.

**GJITHË ATO TË DHËNA QË PRESIN NË INTERNET, QËLLOJNË TË JENË FALAS VETËM PËR ATA QË JANË ZHDËMTUAR NGA NJË BIBLIOTEKË INSTITUCIONALE QË MUND TË PËRBALLOJË ÇMIMET E NJË LICENCE GJITHËPËRFSHIRËSE.**

Në mungesë të anëtarësimit në një institucion kaq të pasur, studiuesi i mundshëm duhet të bëjë pagesa të konsiderueshme për çdo artikull të dhënash thelbësore në sektorin, sa për emër, të 'të dhënave qytetare', madje edhe për kërkimin rreth të cilit ata vetë kanë ndihmuar nëpërmjet taksave të tyre. Papritmas, botuesit tani i nënshtrohen zemërimit, pasi akademikët i fajësojnë se marrin të gjitha shërbimet e tyre editoriale falas dhe, më pas, sigurojnë super fitime nëpërmjet kontrollit të tërësishëm të burimeve me besueshmëri të lartë. I gjithë sistemi shoqëror i botimit shkencor, i cili ka qenë një model suksesi për breza, duke kryer një larmi të madhe shërbimesh (shpërndarje, arkivim, kontroll të cilësisë, vlerësim dhe baraspeshim të burimeve), papritur i kërkohet ta rimendojë veten. Dhe kjo shtrëngesë ndodh së bashku me ardhjen e teknologjive të reja të botimeve që kërcënojnë monopolin e botimeve të letrës, me të gjitha

14 Goldacre et al., 2012. Drug companies must come clean, Letter about Roche. *The Times*, 29 Tetor 2012, Londër.



strukturat dhe kufizimet e saj shumë të dobishme. Nuk duhet të nënvlerësojmë ashpërsinë e kësaj sfide ndaj institucionit shoqëror të shkencës, siç e kemi njohur deri tani.

Në shkencë, ashtu si në fusha të tjera të prodhimit të njohurive, teknologjitë e reja i shpërbëjnë kufijtë e mëparshëm. Më herët, mënyrat e botimit janë copëzuar, në harmoni me ecurinë e prodhimit dhe qëllimeve ideore. Domethënë, sipër 'letrës' u shtyp një tekst dhe u shumëfishua në të njëjtat kopje të shumta në letër. Kjo ishte pjellë e një studimi të veçantë, të përcaktuar nga "një autor" (ose, në kushte industriale, një përmbledhje e përcaktuar autorësh). Ai studim kishte ciklin e tij të veçantë të mbyllur, nga fillimi deri në fund, siç thuhet në gazetë. Madje edhe kontrolli i cilësisë u copëzua, me vëzhgues të mangët që raportonin te një redaktor i vetëm, duke përcaktuar fatin e "gazetës". Kushtet shoqërore të prodhimit të njohurive të industrializuara, veçanërisht në lidhje me sistemin e shpërblimit që përcaktonte mundësi karriere, u kthyen kundër hetimeve në kohë të lirë, si për historinë tradicionale natyrore, apo edhe për filozofinë natyrore pasqyruese, si veçori të shkencës së tipit 'zotëri-amator'. Prandaj, projekti i copëzuar i fitimeve të menjëhershme ia ka dalë të mbizotërojë të gjitha anët e ciklit. Një zhvillim paralel në atë që mund të quhet ontologji në zbatim e shkencës, u përshtat me këtë mënyrë. Përpjekja ishte të studioheshin sisteme të thjeshta ose të thjeshtuara, duke përdorur mjete dhe qëllime ideore, zakonisht të dhëna dhe matematikë, të cilat mundësonin gjykime të thjeshta. Kështu, midis biologëve theksi u vu te përqendrimi në copëzimet më të vogla të mundshme, nga biokimia e deri te gjenetika. Sistemet të tëra të ndërlikuara u menduan si të paafta për studime shkencore, siç ishin nën këtë përkufizim të shkencës. Kjo ecuri mund të shihet në mënyrën e saj tejet të përsëritur në ekonomitë kryesore, ku vendimet përmes modeleve të paqarta matematikore nga pjesëmarrësit e sajuar të copëzimit, shërbyen për të përforcuar hamendësimet e shtyra politikisht të kësaj fushe.<sup>15</sup> Falë publikimit digjital, kërkimi i vazhdueshëm tani mund të jetë krejt ndryshe dhe të bëhet epiqendra e një rrjedhe të vazhdueshme dialogu dhe zhvillimi të përbashkët, në të cilin mund të ketë një kristalizim të përkohshëm të një 'malli', si për t'ua lehtësuar barrën. Tani, gazetatat kryesore në të gjitha fushat botojnë përmes faqeve të tyre të internetit, duke ofruar kanale të ndryshme ndërlidhjeje dhe bashkëbisedimi. Pra, të gjitha ngrehinat e mëparshme cilësore të shoqërisë, kontrollit shoqëror, botimit dhe qasjet, si dhe tërë qenia e shkencës, janë në një gjendje të

15 Ravetz, J.R., 1994/5. Economics as an Elite Folk-Science: the Suppression of Uncertainty, *The Journal of Post-Keynesian Economics*, 17/2, Dimër 1994/5, f. 165-184;



çoroditur. Së bashku me studimin në degë të ndryshme, ndërlikimi po bëhet tani një fjalë kyçe në të gjitha shkencat që lidhin zbatueshmërinë e kërkimit shkencor. Kjo tregon se si të gjitha anët e ndryshme të prodhimit të njohurive shkencore ngatërrohen në mënyrë të ndërsjellë me këtë tjetërsim, duke filluar me të drejtën e informimit. Pra, sapo kemi treguar se si ndikohet puna kërkimore, madje edhe ontologjia praktike.

## SIGURIMI I CILËSISË

Pasojat e teknologjive të reja në ciklin e sigurimit të cilësisë janë, përkundrazi, edhe më dramatike. Tradicionalisht, rrjeti i sigurimit të cilësisë së shkencës vepronte kryesisht në mirëkuptim dhe mirëbesim. Fakti i thjeshtë, që një punim shkencor botohej, ishte vula e cilësisë së tij. E gjithë ecuria e kritikës dhe e përmirësimit mbahej e fshehtë. Njësia atomike e përcaktimit të njohurive që mishërohej në letër, nuk përmbante asnjë gjysmë pasigurie ose cilësie. Sigurisht, ky sistem, në përgjithësi, funksionoi mirë, por është shumë i ndjeshëm ndaj vlerës që kanë kontrollorët e cilësisë. Është shumë e lehtë, që rishikimi i një punimi nga këshilli shkencor të përfundojë në “rishikim shoqëror”. Për shumë kohë, mangësitë e rrjetit të këshillave shkencorë janë marrë parasysht dhe përfundimi ka qenë gjithmonë se, ashtu si demokracia, ai është sistemi më i keq i mundshëm, përveç gjithë të tjerëve. Sidoqoftë, ecuria e vlerësimit të shkencëtarëve nga botuesit ka çuar në shtrëngesë të tejskajshme të të gjithë sistemit, ngaqë shprehja ‘boto ose kalbu’ po bëhet rregull, në një periudhë ku burimet pakësohen dhe vendi i punës është i pasigurtë.<sup>16</sup> Teknologjia tradicionale e të dhënave ka ndihmuar në këtë ngecje dhe mbingarkesë. Pjesa më e madhe e letrave që përmbajnë vërejtje, raporte dhe rishikime për një botim të vetëm, do të ishte e papërshtatshme dhe e kushtueshme të vihen në dispozicion për një shqyrtim më të gjerë. Hapja e dosjeve të shkresave për të gjitha botimet do të ishte e pamundur. Por, me teknologjitë e reja të të dhënave, ne kemi edhe pajisje të reja. Ndoshta më revolucionari nga të gjithë ‘aplikacionet’ e shpikura së fundmi, është *Wiki*. Siç ka treguar vetë Wikipedia, me *wiki* e gjithë ecuria e redaktimit mund të jetë e përshtatshme dhe e dukshme. Në Wikipedia, çdo shkrim shfaqet me një lloj prejardhjeje dhe bashkë-krijuesit ftohen për të

16 Harley, D. and Acord, S.K., 2011, Peer Review in Academic Promotion and Publishing: Its Meaning, Locus, and Future, Center for Studies in Higher Education, uc Berkeley. Permalink: <http://escholarship.org/uc/item/1xv148c8>



ndihmuar në ecurinë e sigurimit të cilësisë për qytetarët. Natyrisht që kjo ecuri mund të keqpërdoret dhe, shpesh, është keqpërdorur. Por, zakonisht, keqpërdorimet vërehen shpejt dhe shoqërohen nga një debat i hapur dhe i drejtpërdrejtë. Në shumë mënyra, kjo qasje është duke u përfshirë edhe në shkencën kërkimore. Ajo që deri më tani ishte një institucion jashtëzakonisht i mbyllur, me pak shqyrtim publik rreth mënyrave të veprimit të tij dhe pothuajse pa asnjë gazetar që të hetojë, tani ka filluar të hapet. Mund të shpresojmë që kalimi drejt “hapjes dhe transparencës” së dobishme në qeverisjen e shkencës, duke filluar me sigurimin e cilësisë, do të jetë i qetë, por duhet të vijë dhe do të vijë.

## PASOJAT

Afër fundit të ciklit, vijnë Pasojat. Tradicionalisht, mendohej se ato nuk kishin asnjë lidhje me zbulimin shkencor. Pasojat e shkencës mendohej që, në thelb, të ndiknin për mirë dhe zbatimin e shkencës, në shumicën dërrmuese të rasteve, të ishte i parrezikshëm. Kështu, shkencëtari i ndërgjegjshëm mund t’ia dorëzonte zbulimet e tij shoqërisë për ta zhvilluar dhe zotëruar. Gjatë shekullit të XX-të, fillimisht në luftë dhe më pas në fushat e sigurisë, shëndetit dhe mjedisit, pasojat u vunë re në mënyrë të theksuar. Kundërveprimi i natyrshëm ishte që të gjitha ato çështje të viheshin nën zotërim shkencor, ngaqë “rreziku” po bëhej koncept mbizotërues, duke zëvendësuar “sigurinë” dhe “rrezikun” në ligjërimin shkencor. Kjo u përkufizua si produkt i mundësisë së ndodhisë dhe dëmit (gjithmonë duke menduar se që të dyja janë matur me saktësi). Madje përkufizimit iu shtua edhe një kërkesë morale: Nëse një rrezik i një lloji të ri nuk do të ishte më i madh, nga ana sasiore, sesa ai i pranuar tashmë, atëherë vetëm ata që kishin gabuar, ose që ishin keqdashës, do ta kundërshtonin rrezikun e ri. Analiza të tilla u përdorën në debatet e hershme mbi fuqinë bërthamore qytetare, por që u zhvlerësuan, së bashku me vetë industrinë, si rrjedhojë e fatkeqësive në SHBA dhe BRSS. Nga fundi i shekullit, prania e pashmangshme e rrezikimit (ende jo ‘rreziku’), së bashku me veçorinë e tij politike, u analizua në veprën klasike “*Shoqëria që Rrezikon*”.<sup>17</sup> Tani, çështja e pasojave njihet si vendimtare në përfaqshjen e debateve për teknologjitë e reja, qofshin ato të korrat gjenetiksht të ndryshuara apo nano-teknologji, si dhe në debatet më të gjera të mënyrës së të vepruarit, si për shembull, lidhur me ndryshimet klimatike

17 Beck, U., 1992. *Risk Society: Towards a New Modernity*. Sage.



që vijnë nga industrializimi. Megjithatë, shkenca që pranohet botërisht si e nevojshme, e ka shumë të vështirë të fuqizohet deri në atë shkallë, saqë të jetë e mjaftueshme për kryer detyrat e saj.

Për të kuptuar këtë mungesë drejtpeshimi, detyra e shkencës, mesa duket, është të merret më shumë me të Këqijat sesa me Mallrat, që janë qëllimet tradicionale të shkencës. Zakonisht, këto çështje do të jenë “pasnormale”, për shkak të pasigurive me peshë dhe rreziqeve të vendimmarrjes. Edhe kur pasiguria shkencore është e vogël, qëllime të caktuara mund ta vonojnë veprimin, duke ndryshuar të gjithë ecurinë përkatëse. “Dyshimi i prodhimit” të industrisë së duhanit në SHBA, është rast klasik, ndërsa shumë të tjera mund të gjenden në veprën themelore “Mësime të vona nga paralajmërimet e hershme”.<sup>18</sup> Normalisht, të këqijat janë pasoja të paqëllimshme të shkencës/teknologjisë së zakonshme, të shkaktuara në mënyrë standarde të copëzuara. Fushat përkatëse për studimin e tyre, zakonisht, do të jenë të padobishme dhe të dobëta institucionalisht dhe politikisht, ndoshta të dobëta edhe shkencërisht. Pa ndonjë qëllim të vetëdijshëm, rregullat e lojës kryesore shkencore janë kopsitur kundër atyre që do të ndiqnin shkencën e të këqijave. E gjithë kjo po ndryshon me shpejtësi në kushtet e reja të zbatimit shkencor. Së pari, ka një asimetri në anët kundërshtare të çdo debati mbi të këqijat e mundshme. Nismëtarët janë të përqendruar dhe të organizuar, institucionalisht dhe personalisht. Kundërshtarët janë një bashkim i qytetarëve të dëmtuar të shpërndarë, të bashkuar me OJQ-të e pafinancuara. Mirëpo, ashtu si shtypshkronja dhe makina rrotulluese e kopjeve ndihmuan tubimet në epokat e hershme, telefonat celularë dhe rrjetet shoqërore e bëjnë këtë në ditët e sotme. Gjithashtu, duke qenë se mbrojtja e të këqijave përfshin fshehje, fuqia e teknologjisë së re të të dhënave për të depërtuar të dhëna dhe për të nxjerrë sekrete e ndreq mungesën e drejtpeshimit të njohurive dhe, rrjedhimisht, të vetë fuqisë. Më tej, në shoqërinë moderne ka shumë tubues me arsim dhe aftësi, kështu që ndarjet tradicionale klasore janë shuar. Teknika e ‘Auditimit Bashkërisht’, ku të dhënat, mënyrat dhe shembujt e ithtarëve zhvillimorë janë shqyrtuar shkencërisht nga shkencëtarët-qytetarë dhe qytetarët-shkencëtarë, që punojnë bashkërisht si parrapërgatitje për dialog, është një ndihmesë e çmuar për shkencën e të këqijave.<sup>19</sup> Ne do ta dimë se shkenca ka hyrë me të vërtetë në epokën e saj të re, kur shkenca e të këqijave të bëhet e njohur si lëndë e denjë për t’u mësuar,

18 European Environment Agency, 2002. *Late lessons from early warnings: the precautionary principle 1896–2000*, European Environment Agency, Copenhagen.

19 Tattersall, F., 2010. What is Community Based Auditing and how does it work? *Futures* 42, f. 466–474.



si pjesë e një edukimi liberal në shkencë. Një fillim i mirë është bërë me shpalljen e ‘Parimeve të Oksfordit’, për përgjegjësi në qeverisjen e kërkimit të inxhinierisë klimatike.<sup>20</sup> Kjo mund të ofrojë të njëjtin shërbim për shkencën pasnormale të të këqijave, siç kanë bërë ‘normat Mertoniane’ për përkrahshmërinë shkencore për kërkimin tradicional.

## NJË ROL PËR SHKENCËN PASNORMALE

Ndërgjegjja është ajo që mbetet gjithmonë pas zbatimit, ndërsa bota ndryshon. Brezi i vjetër i shkencëtarëve të shquar janë ende kryesisht në kurthin e përfytyrimit të vjetër të shkencës, si një kërkim i pavarur fisnik, duke prodhuar të mira për njerëzimin dhe duke i thënë të vërtetën push-tetit. Në të vërtetë, ne mezi kemi filluar të zhvillojmë një ideologji ku morali i shkencëtarëve dhe, si rrjedhim, cilësia e shkencës mund të ruhet në këto kushte të reja. Detyra është e ngutshme, sepse korrupsioni i ndër-marrjes shkencore ka përparuar shumë.

**NUK KA ASNJË SIGURI, SE SHKENCA, SIÇ E NJOHIM NE ATË, ME QENDRA TË EKSELENCËS QË PRODHOJNË RISI TË VËRTETË, DO TË MBIJETOJË.**

Edhe brenda Europës moderne, shkenca ka kaluar nëpër cikle kombëtare të përsosmërisë prej rreth tre brezash. Fillimisht, Italia me *Galileon*; pastaj Anglia me *Njutonin*, Franca me *Lavoisierin*, *Laplacen* e të tjerë; Gjermania me *Liebigun*, *Ajnshtajnin* e të tjerë dhe, së fundi, Amerika me ndihmën e mërgimtarëve. Tani mbetet për t’u parë, nëse Kina mund të marrë stafetën e shkencës “perëndimore” dhe të brumosë sasinë me cilësinë, apo nëse qytetërimi evropian, si të tjerët para tij, i ka shteruar rezervat e tij të krijimtarisë.

Në librin tim të vjetër “*Njohuria shkencore dhe problemet e saj shoqërore*”<sup>21</sup>, e trajtova këtë çështje dhe përfytyrova një “shkencë vendimtare”, që do të lindte në kundërshtim me “shkencën e industrializuar”, të cilën

20 Oxford Geoengineering Programme, 2012. *The Oxford Principles*. Oxford Geoengineering Programme, Oxford.

21 Ravetz, J.R., 1971. *Scientific Knowledge and its Social Problems*, Oxford University Press, Oxford.



pashë të bëhej mbizotëruese. Kjo ishte detyrimisht mjaft soditëse dhe unë u mbështeta në një sërë temash kundërkulturore të viteve '60, duke e përfunduar me lutjen e Francis Bajkon për bamirësi në dije. Koncepti i mëvonshëm i shkencës pasnormale ishte një përpjekje e parë, për të sqaruar atë ide të "shkencës vendimtare". Në mënyrën e vet, ishte dhe, deri diku, ende është heretike. Përfytyroj një rend çështjesh me një deklaratë shkencore, por ku pasiguritë dhe mungesat e financimit janë në rritje. Duke qenë se në rrjedhën e një edukimi shkencor studentët janë plotësisht të mbrojtur nga çështje të tilla, ata çorientohen kur ndeshen gjatë periudhës së vënies në zbatim për herë të parë. Më keq, kur përpiqen të ndajnë shqetësimet e tyre me kolegët, shpesh ata shmangen si bartës të njohurive të pakëndshme. Në shumë raste, teza e shkencës pasnormale ka shërbyer si çlirim. Sekret i ndyrë, në fund të fundit, diku ka një emër dhe një vend të respektueshëm në një shqyrtim qytetar.

Për njëfarë kohe, pyesja veten, nëse nocioni i shkencës pasnormale do të vjetërsohej, pasi vetëdija e shkencës u dha e tëra pas praktikës. Në fund të fundit, porosia thelbësore, e përcjellë nga thënia *'faktet janë të pasigurta, vlerat në mosmarrëveshje, rreziqet e larta dhe vendimet e ngutshme'*, është mjaft e thjeshtë. Nuk përmendet ndërlikimi (i cili u fut në lojë disa vite më vonë), as për shkencën e përfshirë, pasojat e padëshiruara, korrupsionin dhe shkencën e ngathët (me dobësitë e saj), dhe as për shkencën e 'të këqijave', aktivistëve, qytetarëve, amatorëve, ose krijimeve të përbashkëta (me zotësitë e saj). Por ndoshta ajo porosia e thjeshtë mund të sigurojë skeletin për njohuritë e reja, të pasuruara, për të cilat kemi nevojë të sqarohemi dhe të përparojmë.

Një kthim prapa në histori ofron mbështetje për këtë shpjegim. Përfytyrimi ynë modern i shkencës buron nga shkrimet profetike të Dekartit dhe Galileos. Përfytyrimi i tyre ishte i thjeshtë, lehtësisht i kapshëm, ndryshe nga ai i Bajkon, i cili kishte ngjyrimet dhe ndërlikime. Nga Dekarti morëm sigurinë ose lirinë nga dyshimi, nga Galileo morëm vërtetësinë ose lirinë nga vlerat dhe gjykimi. Ia vlen të përmendim të dy pasazhet e tyre thelbësore, sepse ato janë aq themelore për botëkuptimin shkencor modern evropian. Dekarti na tregon burimin e besimit të tij:

*Ata zinxhirë të gjatë arsyetimi, të thjeshtë dhe të lehtë, siç janë, të cilat gjeometria i përdori për të mbërritur te më të vështirat, që është vërtetimi, më kishin bërë të përfytyroja se të gjitha ato gjëra për të cilat njeriu është në dijeni, ka shumë të ngjarë të jenë të lidhura në mënyrë të ndërsjellë. Vetëm me një kusht, që të përbahemi nga marrja e ndonjë gjëje si të vërtetë, e cila nuk është, dhe të ruajmë*



gjithmonë rendin që është i nevojshëm për të nxjerrë një përfundim nga një tjetër, nuk mund të ketë asgjë aq të largët, sa të mos e mbërrijmë, apo as aq i paqartë, sa mos të mundemi ta zbulojmë. Nuk pata shumë vështirësi të zbuloja se me cilat sende ishte e nevojshme të filloja, sepse e dija tashmë, se duhej filluar me më të thjeshtat dhe ato më të lehtat për t'u kapur. Duke pasur parasysh gjithashtu, se nga të gjithë ata që kanë kërkuar deri më tani të vërtetën në shkenca, vetëm matematikanët kanë qenë në gjendje të kenë sukses, të vërtetojnë ndonjë gjë, domethënë të nxjerrin arsye të dukshme dhe të sigurta. Nuk dyshova se ato kishin qenë mënyra të një lloji të ngjashëm, me të cilat ata kryenin hetimet e tyre.<sup>22</sup>

Galileo është më i kufizuar në qëllimin e tij, por po aq i sigurt:

Nëse kjo që po shqyrtojmë do të ishte një çështje ligjore, apo shkencë njerëzore, në të cilat nuk ekziston as e vërteta dhe as gënjeshtra, mund të besohet në hollësinë e mendjes dhe gatishmërinë e gjuhës, si dhe në përvojën më të madhe të shkrimtarëve. Mund të pritet që ai që shkëlqeu në ato gjëra, ta bëjë arsyetimin e tij më të besueshëm dhe dikush mund ta gjykojë atë si më të mirin. Por në shkencat e natyrës, përfundimet e të cilave janë të vërteta dhe të nevojshme dhe nuk kanë të bëjnë fare me *l'arbitrio humano*, duhet pasur kujdes, që të mos i dalim në mbrojtje gabimit, sepse këtu, një mijë Demostenë dhe një mijë Aristotelë do të liheshin në baltë nga çdo i zgjuar mediokër që do të zbulonte rastësisht të vërtetën për veten e tij.<sup>23</sup>

E kam lënë thënien vendimtare në origjinal: 'arbitrio' është e paqartë, duke nënkuptuar vullnet ('arbitrary'), ose gjykim ('arbitrate'). Në secilën mënyrë, ose në të dyja së bashku, kuptimi është i qartë: dija nuk ka të bëjë fare me ne njerëzit e thjeshtë. Sa i përket mësimit klasik, të cilin kultura njerëzore e çmonte si arsimimin e vërtetë të një njeriu të kulturuar, Dekarti e vrau atë vazhdimisht në librin e tij *"Ligjërimi"* (Pjesa 2) dhe që Galileo e hodhi poshtë këtu me një fjali. Siç u shpjegua më vonë, ky përfytyrim shkencor u bë shtysa e përfytyrimit të të gjithë sunduesve të mëvonshëm të shoqërisë, nga themeluesit e sistemit metrik në Francën revolucionare, deri te profetët e psikologjisë së sjelljes, mikro-ekonomia matematikore, teoria e lojës së parandalimit bërthamor dhe teoria e fundit e mjeteve të mundshme të përfitimit financiar. Në të njëjtën frymë, ata që besonin se "shkenca (e ngrohjes globale) është punë e mbaruar", nuk mund ta përfytyrojnë se si modelet e klimës globale, duke qenë kaq të suksesshme në nxjerrjen e përfundimeve, duke shfrytëzuar ngjarjet e shekullit të kaluar, mund të gabojnë ndonjëherë për të ardhmen.

22 Descartes, R., 1638, *Discourse on Method*.

23 Galileo, G., 1632. *Dialogue Concerning the Two Chief World Systems*, translated Stillman Drake, Berkeley: University of California Press.





Në lidhje me këtë besim të papjekur të shkencës moderne europiane, shkenca pasnormale është vërtet radikale, heretike ose revolucionare, në varësi të shpjegimit tuaj të historisë bashkëkohore. Shpjegimi hap rrugën për shumësinë e këndvështrimeve, të së drejtës për të gabuar, të ndër-gjegjësimit rreth padijes, të përlësisë. Me idetë e tij të thjeshta thelbësore, ai na mundëson të shohim se si pranimi i këtij vegimi shkencor ka nxitur mendjengushtësinë, zemërngurtësinë dhe krenarinë.

Cili është përbashkimi i gjithë këtyre formave të reja të zbatimit shkencor, të shqyrtuara më sipër? Në disa mënyra, çështjet kanë qenë me ne gjatë gjithë kohës, por tani, ato po rëndohen dhe nuk mund të mohohen më. Në këtë kuptim, shkenca, si institucion, po detyrohet ta shikojë veten ashtu siç është vërtet dhe jo përmes pamjeve ideologjike. Ne mund ta quajmë këtë një ecuri maturimi, në të cilën idetë thelbësore të shkencës pasnormale kanë një rol për të luajtur, derisa vetëdija e shkencës të jetë tjetërsuar dhe ato të bëhen thjesht kuptime të dukshme të përbashkëta. Kjo ende mund t'i përkasë së ardhmes.



# Krijimtaria dhe udhëheqësia në kohët pasnormale

Alfonso Mantouri dhe Gabrielle Donnelly

## HYRJE

Bota është në grahmat e një tjetërsimi të madh.<sup>1</sup> Ndërlikimi, pluralizmi dhe pasiguria e jetës duken tejet dërrmuese. Nga Pekini në Rio, nga Kajro në Los Anxhelos, shkalla e ndryshimit nuk po qetësohet. Në të vërtetë, duket sikur ritmi me të cilin ne i marrim si të mirëqena ndryshimet rrënjësore, po përshpejtohet gjithashtu. Në një film vizatimor të kohëve të fundit, që tregon zhvillimet përparimtare të njerëzimit, diku nga pjesa e fundit, njeriu e humbet drejtqëndrimin, duke e kërrusur trupin, pamje tashmë të njohura të njerëzve që rrinë sipër telefonave të dorës. Duhet të kemi parasysh, se teknologjia e telefonave inteligjent nuk i ka as10 vite vjetërsi: *iPhone* i parë doli në vitin 2007, por në vitin 2014 duket pothuajse e papërfytyrueshme, që një shumicë dërrmuese e njerëzve të jetojnë pa 'të. Gjithsesi, ndryshimet e sjella nga teknologjia e re dhe pajtueshmëria me të cilën ajo është pranuar, e fshehin faktin që ne po flasim për një dukuri shumë të re dhe që këto ndryshime janë mundësisht të verbra ndaj pësjtjellimeve të risisë sonë të fundit, mbajtja e trupit kërrusur.

1 Macy, J., dhe Johnstone, C. (2012). *Active hope: How to face the mess without going crazy*. Novato, CA: New World Library; Morin, E., dhe Kern, B. (1999). *Homeland Earth: A manifesto for the new millennium*. Cresskill, NJ: Hampton Press; Ogilvy, J. (1989). This postmodern business. *The Deeper News*, 1(5), f. 3–23.; Slater, F. (2008). *The chrysalis effect*. Brighton & Portland: Sussex Academic.



Ziaudin Sardar arsyeton se ne jetojmë në kohët pasnormale, “një periudhë e mesme ku zakonet e vjetra po vdesin, të rejat ende s’kanë lindur dhe shumica e gjërave s’kanë kuptim”.<sup>2</sup> Teknologjia e re bën të mundur gjithnjë e më shumë ndjekjen e çdo lëvizjeje që bëjmë, nëpërmjet internetit, kamerave, satelitëve dhe mjeteve të tjera. Lajmet e befta për ndryshimet klimatike, terrorizmin, shpërdorimin e pushteti dhe pabarazinë e shfrenuar, së bashku me paaftësinë tonë në dukje për t’i kuptuar ato, do të thotë se *Future Shock*, e shqyrtuar nga Alvin Tofler<sup>3</sup> disa dhjetëra vite më parë, është mes nesh. *Tronditje më të Ardhmen* e Tofler, ishte një lojë fjalësh me emërtesën *Tronditje Kulturore*: e ardhmja është po aq çorientuese dhe tronditëse, sa të jesh në një vend të huaj, ku gjërat më të mirëqena bëhen ndryshe, çorientuese në mënyrë të çuditshme, në një mënyrë që nuk është thjesht...normale, dhe bota me të vërtetë nuk duket se ka kuptim.

Sociologu Zygmunt Bauman shkruan se moderniteti është shndërruar nga “i ngurtë”, në “i lëngët”: gjithçka rrjedh, ndryshon, nuk ka parashikueshmëri, siguri, qëndrueshmëri dhe qeniet njerëzore duhet të jenë të lakueshëm, të përshtaten, të aftë për të punuar nën kushtet e pasigurisë së madhe.<sup>4</sup> Ushtria amerikane e përshkruan botën aktuale me shkurtesën PPNP: paqëndrueshmëri, pasiguri, ndërlikim, paqartësi. Në botën e biznesit, shkurtesa FPD përdoret për të përshkruar gjendjen e frikës, pasigurisë dhe dyshimit.<sup>5</sup> Në këtë *ndërkohësi* të ndërlikuar, të lëngshme, të pasigurtë, Sardar arsyeton se krijimtaria dhe përfytyrimi janë thelbësore për të trajtuar “ndërlikimin, mosmarrëveshjen dhe çoroditjen” e kohëve pasnormale:

**PËRFYTYRIMI ËSHTË MJETI KRYESOR, NE DO TA KËSHILLONIM SI MJETI I VETËM, I CILI NA MERR NGA ARSYETIMI I THJESHTË, DREJT NJË SINTEZE MË TË LARTË.**

Ndonëse përfytyrimi nuk mund të preket me dorë, ai krijon dhe formëson vërtetësinë tonë jetësore. Ndonëse një mjet mendor, ai ndikon në sjelljen dhe pritjet tona. Ne do të duhet ta përfytyrojmë rrugën tonë për të dalë

2 Sardar, Z. (2010). Welcome to postnormal times. *Futures*, 42 (5), f. 435–444.

3 Toffler, A. (1984). *Future shock*. New York: Bantam.

4 Bauman, Z. (2005). *Liquid life*. Londër: Polity Press; Bauman, Z. (2007). *Liquid times. Living in an age of uncertainty*. Londër: Polity Press; Bauman, Z. (2008). *The art of life*. Londër: Polity Press.

5 Winograd, M., dhe Hais, M.D. (2011). *Millennial momentum: How a generation is remaking America*. New Brunswick, NJ: Rutgers University Press.



nga kohët pasnormale. Lloji i së ardhmes që përfytyrojmë përtej kohëve pasnormale, do të varej nga cilësia e përfytyrimit tonë. Duke pasur parasysh, se përfytyrimi i ka rrënjët thellë në kulturën tonë, do të na duhet të çlirojmë një spektër të gjerë përfytyrimesh nga larmia e pasur e kulturave njerëzore dhe mënyrave të shumta për të përfytyruar mundësi të tjera, përveç atyre tradicionale, të të qenit dhe të të bërit siç e do zakoni.<sup>6</sup>

Për Sardarin, përfytyrimi dhe streha e tij më e gjerë, krijimtaria, janë thelbësore 'për gjetjen e rrugëdaljes sonë nga kohët pasnormale'. Ndërsa mënyrat e vjetra të të menduarit dhe të të bërit po dështojnë, krijimtaria është si një burim jetik për të parashikuar dhe zhvilluar mundësitë, çfarëdo qofshin ato: teknologjike, ekonomike apo shoqërore. Krijimtaria është shndërruar nga një dukuri magjepsëse, e veçuar, e çuditshme dhe e pashpjegueshme, në motorin e ndryshimit dhe tjetërsimit shoqëror. Ajo është shndërruar në pikë kyçe të kalimit nga një botëkuptim *industrial-makineri*, në një botë të re, ende të pasqaruar. Por vetë krijimtaria po ndryshon në mënyrë të beftë. Ndërsa 20 vjet më parë gjeniu i vetmuar ishte ende shembulli ikonë i krijimtarisë, sot krijimtaria shihet gjithnjë e më shumë si një ecuri afrimiteti, bashkëpunimi të përditshëm gjithkush/kudo, që nuk kufizohet në arte dhe shkenca, apo në 'idenë e madhe'. Ndryshimi i krijimtarisë është edhe i nxitur, edhe nxitës në vetvete i prirjeve dhe i ndryshimeve shoqërore.

Të ashtuquajturat '*Hobbesian Machines*' përbëjnë në vetvete dy pikëpamje të rëndësishme të botëkuptimit të vjetër. Ky është një kombinim i Makinerisë Njuton/Dekart, Përpikëria, Këndvështrimi industrial i botës<sup>7</sup>, me hamendësimin se bota është e formuar thelbësisht nga një hierarki e konkurrencës së pamëshirshme dhe të një mendësie *ne kundër tyre* - 'Homo homini lupus' i Hobsit (burrat janë si ujçër me njëri-tjetrin).<sup>8</sup> Kjo ndërthuret për të përfutur atë që Slater e quan "Kultura e zotërimit"

6 Winograd, M., dhe Hais, M.D. (2011). *Millennial momentum: How a generation is remaking America*. New Brunswick, NJ: Rutgers University Press.

7 Capra, F. (1984). *The turning point: Science, society, and the rising culture*. New York: Bantam; Russell, D. W. (1983). *The religion of the machine age*. Londër: Routledge & Kegan Paul; Scott, A. (1997). Modernity's machine metaphor. *British Journal of Sociology*, f. 561-575; Toulmin, S. (1992). *Cosmopolis. The hidden agenda of modernity*. Chicago: University of Chicago Press.

8 Eisler, R. (1987). *The chalice and the blade*. San Francisco: Harper Collins; Montuori, A. (1989). *Evolutionary competence: Creating the future*. Amsterdam: Gieben; Rifkin, J. (2009). *The empathic civilization. The race to global consciousness in a world in crisis*. New York: Tarcher/Penguin; Slater, F. (1991). *A dream deferred. America's discontent and the search for a democratic ideal*. Boston: Beacon; Slater, F. (2008). *The chrysalis effect*. Brighton & Portland: Sussex Academic.



dhe Eisler e ka quajtur *një kulturë sundimtari*.<sup>9</sup> Një mundësi tjetër kundrejt kësaj pikëpamjeje, është se Gjithësia, në thelb, është një ecuri krijuese<sup>10</sup> dhe se qeniet njerëzore munden – edhe pse nuk janë aspak të vendosura – të zhvillojnë marrëdhënie bashkëpunimi ose ‘ortakërie’, fitimprurëse për të dyja palët.

Edgar Morin ka treguar se ajo që nevojitet tani, është një mendim që është *thelbi*, me të cilin ai nënkupton një mendim që shkon deri në rrënjë të hamendësimeve dhe çështjeve tona, dhe një mendim që lidh e rendit, në vend që të ndajë dhe copëtojë.<sup>11</sup> Në një periudhë kalimtare si kjo e jona, ne besojmë se është e nevojshme të ndjekim këshillat e tij, të bëjmë prapa dhe të vështrojmë pamjen e përgjithshme, të përcaktohem në kohë dhe hapësirë. Ne duhet të jemi në gjendje të kuptojmë fuqitë që formësuari botëkuptimin tonë të vjetër dhe se si ai frymëzoi zgjedhjet tona. Ne duhet të kuptojmë se nga kemi ardhur dhe si na ka ngjizur nga koha që jetojmë, në mënyrë që të ecim drejt një të ardhmeje tjetër. Në këtë punim ne gurmojmë përparimin e krijimtarisë dhe udhëheqësisë, hulumtojmë se si dhe pse ato kanë ndryshuar në shoqërinë tonë të rrjetëzuar që pa lindur. Ne i përshkruajmë këto ndryshime, më pas përfundojmë me një diskutim të shkurtër, se si krijimtaria dhe udhëheqësia mund të merren me disa prej pikëpamjeve më shqetësuese të zhvillimeve të fundit.

## RRËNJËT HISTORIKE

Koncepti i krijimtarisë, siç e njohim ne sot, në Perëndim u shfaq gjatë Rilindjes, në shekullin e XV-të.<sup>12</sup> Ai përkoi me lindjen e njerëzores dhe zbehjen e hyjnore<sup>13</sup>, si një reagim kundër pushtetit kishtar. Lulëzimin e vet

- 
- 9 Eisler, R. (1987). *The chalice and the blade*. San Francisco: Harper Collins; Slater, F. (2008). *The chrysalis effect*. Brighton & Portland: Sussex Academic.
  - 10 Ceruti, M. (2008). *Evolution without foundations*. Cresskill, NJ: Hampton Press; Davies, F. (1989). *The cosmic blueprint. New discoveries in nature's creative ability to order the Universe*. New York: Simon and Schuster; Kaufman, G.D. (2004). *In the beginning...creativity*. Minneapolis: Augsburg Fortress Publishers; Peat, F. D. (2000). *Blackwinged night. Creativity in nature and mind*. Cambridge, MA: Perseus/Helix Books; Peat, F. D. (2002). *From certainty to uncertainty. The story of science and ideas in the 20th century*. Washington, DC: Joseph Henry Press. Swimme, B., dhe Tucker, M.E. (2011). *Journey of the universe*. New Haven: Yale University Press.
  - 11 Morin, E., dhe Kern, B. (1999). *Homeland Earth: A manifesto for the new millennium*. Cresskill, NJ: Hampton Press.
  - 12 Tonelli, G. (1973). Genius from the Renaissance to 1770. In F. F. Wiener (Ed.), *Dictionary of the history of ideas* (f. 293–297). New York: Scribner.
  - 13 Wittkower, R. (1973). Genius: Individualism in art and artists. In F. F. Wiener (Ed.), *Dictionary of the history of ideas* (f. 297–312). New York: Scribner.



e pati me lindjen e gojëdhënës gjeniale të Romantizmit, në fund të shekullit të XVIII-të.<sup>14</sup> Deri në vitet 1980, kërkimi mbi krijimtarinë në Perëndim i përkiste kryesisht lëndës së Psikologjisë. Ai u përqendrua në ato që njiheshin si tre P-të: Personi, Procesi dhe Produkti.<sup>15</sup> Sipas gojëdhënës romantike që qëndron në themel të kësaj pikëpamjeje copëzuese, vetjake, njeriu krijues ishte kryesisht një gjeni i vetmuar, shpesh i çuditshëm.<sup>16</sup> Njësia e analizës ishte pothuajse posaçërisht njeriu i jashtëzakonshëm, ose ‘i shuar’.<sup>17</sup>

“Vesvesja” e krijimtarisë ndodhte posaçërisht “brenda” këtij njeriu, personit krijues. Shëmbëlltyra klasike e ecurisë krijuese ishte i një llambe që rridhte mbi kokën e krijuesit, gjatë çastit “Eureka”. Ecuria krijuese, si fillim, u pa si një ecuri vetmitare me burime shpirtërore ose hyjnore, më pas e shoqëruar gjithnjë e më shumë me gjendje të pazakonta mendore dhe psikopatologji.<sup>18</sup> “Pjella” ose fryti krijues shoqërohej me “shpërthimin e madh” dhe njohuri tronditëse.<sup>19</sup> “Vendndodhja” e krijimtarisë ishte e kufizuar në fusha të veçanta, pothuajse tërësisht në arte dhe shkencë. Kjo mund të vihet re te shembujt e mëdhenj tradicionalë të krijimtarisë, pothuajse tërësisht meshkuj dhe pothuajse tërësisht artistë e shkencëtarë, si Van Gog, Ajnshtajn, Moxart dhe Fejman.<sup>20</sup>

## FYTYRA NË NDRYSHIM E KRIJIMTARISË DHE UDHËHEQËSISË

Me fillimin e shekullit të XXI-të, mënyra se si ne e kuptojmë, ushtrojmë dhe shprehim krijimtarinë tonë, po ndryshon. Këto zhvillime të reja, nga ana e tyre, po ndikojnë në mënyrën se si vetë shoqëria po ndryshon.<sup>21</sup>

- 14 Goehr, L. (1992). *The imaginary museum of musical works*. New York: Oxford University Press.
- 15 Runco, M. (2007). *Creativity. Theories and themes: Research, development, and practice*. Amsterdam: Elsevier.
- 16 Montuori, A., & Purser, R. (1995). Deconstructing the lone genius myth: Towards a contextual view of creativity. *Journal of Humanistic Psychology*, 35(3), f. 69-112.
- 17 Glaveanu, V.F. (2010). Paradigms in the study of creativity: Introducing the perspective of cultural psychology. *New ideas in psychology*, 28, f. 79-93.
- 18 Andreasen, N.C. (2006). *The creative brain: The science of genius*. New York: Plume.
- 19 Montuori, A., dhe Purser, R. (Eds.). (1999). *Social Creativity* (Vol. 1). Cresskill, NJ: Hampton Press; Runco, M. (2004). *Creativity. Annual Review of Psychology*, 55, f. 657-687; Runco, M. (2007). *Creativity. Theories and themes: Research, development, and practice*. Amsterdam: Elsevier.
- 20 Barron, F., Montuori, A., dhe Barron, A. (Eds.). (1997). *Creators on creating. Awakening and cultivating the imaginative mind*. New York: Tarcher/Putnam.
- 21 Montuori, A., dhe Donnelly, G. (2013). Creativity at the opening of the 21st century. *Creative Nursing: A Journal of Values, Issues, Experience & Collaboration*, 19 (2), f. 58-63.



Krijimtaria çon në ndryshim dhe ndryshimi çon në krijimtari. Tri prirjet kryesore përfshijnë: a) shikimin e krijimtarisë si një ecuri bashkëpunimi të rrjetëzuar, b) si një ecuri të përditshme, kudo dhe për të gjithë, në vend që të kufizohet vetëm te gjenitë e jashtëzakonshëm<sup>22</sup> c) qartësimi i krijimtarisë si një formë udhëheqësie dhe udhëheqësia si një formë krijimtarie.<sup>23</sup>

Nuk është për t'u çuditur, që ligjërata dhe puna e udhëheqësisë në kohët pasnormale po ndryshojnë gjithashtu. Dy nga lëvizjet shoqërore më të rëndësishme të viteve të fundit, Pranvera Arabe dhe lëvizja *Occupy*, nuk patën ndonjë udhëheqës heroik, 'Njeri të Madh', apo ndonjë përfaqësues vetjak mediatik.<sup>24</sup> Konceptet bashkëkohore të udhëheqësisë dhe krijimtarisë i kanë rrënjët në të njëjtat hamendësime teorike dhe qasje kërkimore. Ne e gjurmojmë shkurtimisht historinë e tyre, më pas tregojmë mënyrat e ndryshme përmes së cilave ato po ndryshojnë në fillimet e shekullit të XXI-të. Hamendësimet dhe kuadri i ri teorik, si dhe puna e veçantë e udhëheqësisë dhe krijimtarisë, mund ta vënë në dijeni njëri-tjetrin dhe të pasqyrojnë një pikëpamje më të shpërndarë dhe krahasuese.

Udhëheqësia dhe krijimtaria po kalojnë nga një këndvështrim heroik, Njeriu i Madh, në një ecuri më të shpërndarë dhe krahasuese, të gjithë / kudo / përditë. Me rëndësi të veçantë në kohët pasnormale, është pamja e shfaqur e udhëheqësisë si një ecuri krijuese dhe e krijimtarisë si një ecuri udhëheqësie. Udhëheqësia mund të jetë një formë e vetëkrijimit nga pikëpamja e përgjegjësisë shoqërore dhe e zhvillimit të mundësive dhe alternativave. Nëse idetë dhe ecuritë krijuese mund të ndryshojnë botën, ku dhe si duam ne për veten tonë dhe të tjerët? Çfarë të bëjmë me krijimtarinë tonë? Krijimtaria po zbatohet gjithnjë e më shumë për çështjet shoqërore në lëvizje, të përqendruara në risitë

22 Montuori, A. (2011a). Beyond postnormal times: The future of creativity and the creativity of the future. *Futures: The Journal of Policy, Planning and Future Studies*, 43 (2), f. 221–227; Montuori, A. (2013). Creativity and the Arab Spring. *East West Affair*, 1(1).

23 Burns, J.M. (2004). *Transforming leadership: The pursuit of happiness*. New York: Grove; Csikszentmihalyi, M. (2004). *Good business: Leadership, flow, and the making of meaning*. New York: Penguin; Gardner, H. (1995). *Leading minds*. New York: Basic Books; Hooker, C., dhe Csikszentmihalyi, M. (2003). Flow, creativity, and shared leadership. In C.L. Pearce dhe J.A. Conger (Eds.), *Shared leadership: Reframing the hows and whys of leadership* (f. 217–234). Thousand Oaks, CA: Sage; Montuori, A. (2010). Transformative leadership for the 21st century. Reflections on the design of a graduate leadership curriculum. *ReVision*, 30 (3–4), f. 4–14; Simonton, D.K. (1984). *Genius, creativity, and leadership: Historiometric inquiries*. Cambridge: Harvard University Press; Sternberg, R.J. (2007). A systems model of leadership: wics. *American Psychologist*, 62 (1), f. 34.

24 Castells, M. (2012). *Networks of outrage and hope. Social movements in the internet age*. Malden, MA: Polity Press; Montuori, A. (2013). Creativity and the Arab Spring. *East West Affair*, 1(1).



shoqërore, sipërmarrjen shoqërore dhe laboratorët shoqërorë, të përcaktuara gjerësisht si gjallërim dhe zbatim i ideve të reja rreth marrëdhënieve shoqërore dhe organizimit shoqëror.<sup>25</sup> Vënia në jetë e mundësive kërkon që krijuesit të bëhen edhe udhëheqës. Udhëheqësia duhet të merret parasysht dhe të jetë përgjegjëse për drejtimin dhe zbatimin e krijimtarisë njerëzore. Krijimtaria duhet të ngjallë tek udhëheqësia mundësi të reja për të kapërcyer kohët pasnormale. Dyshja e ndërlydhur e krijimtarisë dhe e udhëheqësisë mund të fillojë ta trajtojë çështjet e botës së vjetër dhe të na zhvillojë e udhëheqë drejt kohëve të tjera, më njerëzore, më të drejta dhe më të ndërëgjegjshme.

## ZANAFILLA HISTORIKE DHE IDEORE E KRIJIMTARISË DHE UDHËHEQËSISË

Idetë bashkëkohore të krijimtarisë dhe udhëheqësisë në Perëndim e kanë zanafillën te Heroi Romantik, gojëdhëna e ‘Gjeniut të vetmuar’<sup>26</sup> dhe shëmbëlltyra e ‘Njeriut të Madh’.<sup>27</sup> Deri në gjysmën e dytë të shekullit të XX-të, studimi i udhëheqësisë merrej kryesisht me udhëheqësit e veçantë, ndërsa studimi i krijimtarisë merrej me njerëzit krijues.<sup>28</sup> Vëmendja më e madhe u përqendrua në atë se çfarë i bënte këta njerëz të veçantë, të jashtëzakonshëm dhe, për këtë arsye, vëmendja u përqendrua në dy fusha: personaliteti dhe dituria.<sup>29</sup> E pajisur me një dyzim të tillë klasik të Modernitetit, si krijimtari/përshtatje, gjeni/turmë (dhe sigurisht, gjeni/çmenduri), si dhe pri-jës/ndjekës, kjo qasje ka qenë ‘e veçantë’. Udhëheqësit dhe krijuesit mendoheshin të ishin njerëz të jashtëzakonshëm me *dhunti* të pazakonta, në një numër të kufizuar fushash, si politika, tregtia, artet, shkencat, apo ushtria. Një rishikim historik i atyre që janë menduar si krijues dhe udhëheqës të

- 
- 25 Hassan, Z. (2014). *The social labs: A new approach to solving our most complex challenges*. San Francisco: Berrett-Koehler; Howaldt, J., Schwarz, M., Henning, K., dhe Hees, F. (2010). *Social Innovation: Concepts, research fields and international trends*: ima/zlw.
- 26 Montuori, A., & Purser, R. (1995). *Deconstructing the lone genius myth: Towards a contextual view of creativity*. *Journal of Humanistic Psychology*, 35 (3), f. 69–112.
- 27 Western, S. (2008), *Leadership. A critical text*. Thousand Oaks: Sage.
- 28 Montuori, A. (2011b). Social psychology. In M. Runco dhe S. Pritzker (Eds.), *The encyclopedia of creativity*. Amsterdam: Elsevier; Runco, M. (2007). *Creativity. Theories and themes: Research, development, and practice* Amsterdam: Elsevier; Western, S. (2008). *Leadership. A critical text*. Thousand Oaks: Sage.
- 29 Western, S. (2008), *Leadership. A critical text*. Thousand Oaks: Sage; Pope, R. (2005). *Creativity. Theory, history, practice*. New York: Routledge; Western, S. (2008). *Leadership. A critical text*. Thousand Oaks: Sage.





mëdhenj në Perëndim, tregon një mbizotërim të burrave të bardhë, ndërsa njerëzit me njëjtësi të tjera kombëtare dhe racore, si dhe gratë në përgjithësi, mungojnë dukshëm.<sup>30</sup> Vetëm kohët e fundit ligjërimiti ka filluar të përfshijë gratë, ndërkohë që numri i shembujve të mundshëm rritet në mënyrë të dukshme dhe Gandhi, Martin Luter King, Nelson Mandela dhe Malcolm X janë bërë ikonat e udhëheqësisë joperëndimore dhe jo të bardhë.

## ZHVILLIMET E SHEKULLIT TË 20-TË

Një varg zhvillimesh intelektuale në shekullin e XX-të kanë ngritur pikëpyetje dhe kanë tërhequr vërejtje rreth pikëpamjeve mbizotëruese copëzuese të udhëheqësisë dhe krijimtarisë:

- Ndërtuesit e shoqërisë kanë thënë se ajo që ne e quajmë “krijues”, ose atë që ne e quajmë “udhëheqës”, është rrjedhojë e një gjykimi. Për pasojë, krijimtaria dhe udhëheqësia janë pjellë shoqërore: nuk ka “thelb” të udhëheqësit, ka vetëm gjykim të shoqërisë e cila i emërton udhëheqësit dhe sjelljet e njerëzve si ‘udhëheqësore’. Marrëdhënia midis vetes dhe shoqërisë duhen parë më shumë në varësi. Të ardhmet thelbësore mbi veten (‘një udhëheqës i lindur, ‘ose e ke ose nuk e ke’) shpesh janë kritikuar.<sup>31</sup>
- Lëvizja intelektuale e njohur gjerësisht si pasmodernizëm, ka tërhequr vërejtje lidhur me idenë e individit, thelbësore, “varësisë” dhe “autorit”, duke paraqitur interesat tregtare dhe

30 Bordas, J. (2007). *Salsa, soul, and spirit: Leadership for a multicultural age*. San Francisco: Berrett-Koehler; Chin, J.L., Lott, B., Rice, J.K., dhe Sanchez-Hucles, J. (Eds.). (2007). *Women and leadership. Transforming visions and diverse voices*. Malden, MA: Blackwell Publishing.

31 Fairhurst, G.T., dhe Grant, D. (2010). The social construction of leadership: A sailing guide. *Management Communication Quarterly*, 24(2), f. 171–210; Gergen, K.J. (1994). *Realities and relationships, soundings in social construction*. Cambridge: Harvard University Press; Gergen, K.J. (2000). *The saturated self: Dilemmas of Identity in contemporary life*. New York: Basic Books; Gergen, K.J. (2009). *An invitation to social construction*. Thousand Oaks: Sage; Kasof, J. (1985). Explaining creativity: The attributional perspective. *Creativity Research Journal*, 8(4), f. 311–366; Mockros, C.A., dhe Csikszentmihalyi, M. (1999). The social construction of creative lives. In A. Montuori dhe R. Purser (Eds.), *Social Creativity* (Vol. 1, f. 175–218). Cresskill, NJ: Hampton Press; Sampson, E.E. (2008). *Celebrating the other: A dialogic account of human nature*. Chagrin Falls: Taos Institute Publications.



politike të ngulitura në ligjëratat e krijimtarisë dhe udhëheqësisë.<sup>32</sup>

- Përjasjet e sistemeve dhe ndërlikimeve kanë theksuar rëndësinë e një të ardhmeje me sisteme të hapura, veçanërisht ndërveprimet mes njeriut dhe shoqërisë, si dhe rëndësinë e rrethanës. Ato kanë theksuar 'vetorganizimin' e dukurive natyrore dhe shoqërore, me një shpërndarje nga poshtë-lart, dhe jo një përjasje nga lart-poshtë, njëherazi kanë theksuar rëndësinë e përsëritjes, ndërveprimeve rastësore të dyanshme që ndikojnë si në krijimtari, ashtu edhe në udhëheqësi.<sup>33</sup>
- Shoqëria e Rrjetit, e cila tashmë po spikat (me rritjen e rrjeteve shoqërore, internetit dhe transportit botëror relativisht të lirë), ka çuar në një ndërgjegjësim të shtuar, sa i përket rëndësisë së ndërveprimeve, rrjeteve dhe ecurive bashkëpunuese, duke çuar në një hapje më të madhe ndaj kuptimeve më të ndërvarura dhe

- 
- 32 Barthes, R. (1977). *Image-music-text*. Londër: Fontana; Boje, D., Gephart, D., dhe Joseph, T. (Eds.). (1996). *Postmodernism and organization theory*. Newbury Park: Sage; Grint, K., dhe Jackson, B. (2010). Toward 'socially constructive' social constructions of leadership. *Management Communication Quarterly*, 24 (2), f. 348–355; Hare-Mustin, R.T., dhe Marecek, J. (1988). The meaning of difference: Gender theory, postmodernism, and psychology. *American Psychologist*, 43, f. 455–464; Foucault, M., & Rabinow, F. (1984). *The Foucault reader* (1st ed.). New York: Pantheon Books; Kearney, R. (1988). *The wake of imagination: Towards a postmodern culture*. Minneapolis: University of Minnesota Press; Stigliano, T. (1999). *Creativity, Romanticism, and the rise of consumerism*. In A. Montuori dhe R. Purser (Eds.), *Social Creativity* (Vol. 1). Cresskill, NJ: Hampton Press; Fairhurst, G.T., dhe Grant, D. (2010). The social construction of leadership: A sailing guide. *Management Communication Quarterly*, 24(2), f. 171–210; Montuori, A., & Purser, R. (1995). Deconstructing the lone genius myth: Towards a contextual view of creativity. *Journal of Humanistic Psychology*, 35(3), f. 69–112.
- 33 Borgo, D. (2006). *Sync or swarm: Improvising music in a complex age*. Londër: Continuum; Brafman, O., dhe Beckstron, R.A. (2008). *The starfish and the spider: The unstoppable power of leaderless organizations*. New York: Portfolio Trade; Contractor, N.S. (1999). Self-organizing systems research in the social sciences: Reconciling the metaphors and the models. *Management Communication Quarterly*, 13 (1), f. 154–166; Johnson, S. (2001). *Emergence: The connected lives of ants, brains, cities, and software*. New York: Scribner; Luhmann, Niklas. (2013). *Introduction to systems theory*. Cambridge, UK: Polity; Montuori, A. (2011c). Systems approach. In M. Runco dhe S. Pritzker (Eds.), *The encyclopedia of creativity* (Vol. 2, f. 414–421). San Diego: Academic Press; Morin, E. (2008). *On complexity*. Cresskill, NJ: Hampton Press; Wheatley, M. (2006). *Leadership and the new science*. San Francisco: Berrett-Koehler.



të rrjetëzuara të degëve dhe njësive të analizimit.<sup>34</sup> Kjo është veçanërisht e dukshme në brezin e ashtuquajtur ‘Mijëvjeçarët’.<sup>35</sup>

Pikëpamjet copëzuese vetjake, ‘Njeriu i Madh’, për krijimtarinë dhe udhëheqësinë, tashmë u bënë shqetësuese. Po bëhet e qartë, se, si krijimtaria, ashtu edhe udhëheqësia, ishin shumë më të ndërlidhura në rrjete dhe bashkëpunime, sesa mendohej fillimisht, dhe aspak për arsye se përqendrimi i posaçëm tek individët nuk merrte parasysh rolin dhe rëndësinë e ndërveprimeve, rrethanat shoqërore, ngrehinat organizative, interesat politike, gjallërinë e klasës, racës dhe gjinisë, si dhe një shumëllojshmëri faktorësh të tjerë.<sup>36</sup>

Mënyrat e veprimit që mbizotërojnë dhe pranimi i krijimtarisë dhe udhëheqësisë bashkëpunuese<sup>37</sup>, përkon me shkëlqimin e *Mijëvjeçarëve*, një brez i ri që u burrërua në vitin 2000, dukshëm më i madh edhe se brezi i *Baby Boomers*, me nevojat e industrisë për krijimtari bashkëpunuese në R&D, me një numër gjithnjë e në rritje të grave, si dhe të shumë njerëzve nga identitete të ndryshme kombëtare e racore që janë në gjendje të marrin pjesë dhe të njihen në rolet krijuese dhe udhëheqëse.<sup>38</sup>

- 
- 34 Anderson, W.T. (2001). *All connected now. Life in the first global civilization*. Boulder: Westview Press; Barabasi, A. (2003). *Linked. How everything is connected to everything else and what it means for business, science, and everyday life*. New York: Plume; Castells, M. (2000). *The rise of the network society* (New Edition). New York: Wiley-Blackwell; Christakis, N.A., dhe Fowler, J.H. (2009). *Connected: The surprising power of our social networks and how they shape our lives* (1st ed.). New York: Little, Brown and Co; Leadbeater, C. (2009). *We-think: Mass innovation, not mass production* (2nd ed.). Londër: Profile Books; Nielsen, M. (2012). *Reinventing discovery: The new era of networked science*. Princeton: Princeton University Press; Taylor, M. (2003). *The moment of complexity. Emerging network culture*. Chicago: University of Chicago Press; Borgo, D. (2006). *Sync or swarm: Improvising music in a complex age*. Londër: Continuum.
- 35 Pachucki, M.A., Lena, J.C., dhe Tepper, S.J. (2010). Creativity narratives among college students: Sociability and everyday creativity. *Sociological Quarterly*, 51, f. 122–149; Pew, Research Center. (2007). *Millennials. A portrait of a generation. Confident. Connected. Open to Change*; Pew Research Center; Winograd, M., dhe Hais, M.D. (2011). *Millennial momentum: How a generation is remaking America*. New Brunswick, NJ: Rutgers University Press.
- 36 Montuori, A., & Purser, R. (1995). Deconstructing the lone genius myth: Towards a contextual view of creativity. *Journal of Humanistic Psychology*, 35 (3), f. 69–112.
- 37 Montuori, A. (2011a). Beyond postnormal times: The future of creativity and the creativity of the future. *Futures: The Journal of Policy, Planning and Future Studies*, 43(2), f. 221–227; Sawyer, K., dhe DeZutter, S. (2009). Distributed creativity: How collective creations emerge from collaboration. *Psychology of Aesthetics, Creativity, and the Arts*, 3(2), f. 81.
- 38 Eisler, R., dhe Montuori, A. (2007). Creativity, society, and the hidden subtext of gender: A new contextualized approach. *World Futures. The Journal General Evolution*, 63(7), f. 479–499; Winograd, M., dhe Hais, M.D. (2011). *Millennial momentum: How a generation is remaking America*. New Brunswick, NJ: Rutgers University Press.



## TJETËRSIMI I KRIJIMTARISË

Njohuritë e kohëve të fundit kanë çuar në mënyra të reja konceptimi të vetvetes, shoqërisë, prodhimit, artit, shkencës dhe krijimtarisë, duke e vënë theksin te bashkëpunimi i vetëdijshëm shoqëror, duke ruajtur marrëdhëniet e vendosura në një rrethanë kulturore dhe politike, përmes respektit ndaj vetvetes.<sup>39</sup> Në fushën e artit dhe zbavitjes vërejmë që kjo po zhvendoset drejt asaj që është quajtur *kulturë pjesëmarrëse*, e cila përfshin një turbullim të kufijve midis “artistit” dhe shikuesve.<sup>40</sup> Shembulli në dukje i parëndësishëm i *karaokes*, na mundëson të kuptojmë se si tashmë zbavitja përfshin një pjesëmarrje më të madhe dhe më gjallëruese të tubuesve. Ata nuk janë thjesht pjesëmarrës që dëgjojnë muzikë, por, herë pas here, marrin mikrofonin dhe këndojnë me radhë këngë të ndryshme, sipas dëshirës. Anëtarët e audiencës janë edhe interpretues. *Wikipedia* është një shembull tjetër i “mençurisë së turmave”, ndonëse i diskutueshëm, me pjesëmarrës që botojnë dhe redaktojnë. Video-lojërat ua mundësojnë përdoruesve të dizajnojnë seritë e niveleve të tyre. Në fushën e kërkimit dhe zhvillimit të lojërave, pjesëmarrja e përdoruesit fundor në ecurinë e dizajnos po bëhet gjithnjë e më shumë normë. Sipas Xhenkins, kultura pjesëmarrëse pasqyron një zhvendosje nga shprehja vetjake, drejt përfshirjes më të madhe të njerëzve drejt ecurive të ngutshme, nga poshtë-lart, madje edhe të anëtarëve më të thjeshtë, duke iu larguar mbështetjes tradicionale të një përqsasjeje nga lart-poshtë.

Hulumtimi mbi psikologjinë e krijimtarisë tani përfshin një përqendrim të fuqishëm që po spikat në krijimtarinë *përditshme*, sesa posaçërisht në “krijimtarinë madhështore”. Ky hulumtim nuk është aspak i kufizuar tek artet dhe shkencat.<sup>41</sup> Ideja e krijimtarisë së përditshme lë të

39 Csikszentmihalyi, M. (1999). A systems perspective on creativity. In R. Sternberg (Ed.), *Handbook of creativity* (f. 313–335). Cambridge: Cambridge University Press; Gergen, K. (2009). *Relational being: Beyond self and community*. New York: Oxford University Press; Kearney, R. (1999). The narrative imagination. In A. Montuori dhe R. Purser (Eds.), *Social Creativity*. Volume (Vol. 1, f. 61–79). Cresskill, NJ: Hampton Press; Rosenau, F. M. (1992). *Post-modernism and the social sciences. Insights, inroads, and intrusions*. Princeton, NJ: Princeton University Press; Sardar, Z. (1999). *Postmodernism and the Other*. Londër: Pluto Press; Foucault, M., & Rabinow, F. (1984). *The Foucault reader* (1st ed.). New York: Pantheon Books; Kearney, R. (1988). *The wake of imagination: Towards a postmodern culture*. Minneapolis: University of Minnesota Press; Pope, R. (2005). *Creativity. Theory, history, practice*. New York: Routledge.

40 Jenkins, H. (2008). *Convergence culture: Where old and new media collide*. New York: NYU Press.

41 Richards, R. (Ed.). (2007). *Everyday creativity and new views of human nature: Psychological, social, and spiritual perspectives*. New York: American Psychological Association Press; Runco, M., dhe Richards, R. (Eds.). (1997). *Eminent creativity, everyday creativity, and health*. Westport, CT: Ablex/Greenwood.



kuptohej se krijimtaria mund të ndodhë në jetën e përditshme, në fusha më pak të lartësuar tradicionalisht dhe nuk duhet të marrë formën e një vepre të madhe arti ose zbulimi shkencor. Kjo hap mundësinë e pranimit të krijimtarisë si një dukuri që mund të përshkojë çdo fushë të jetës. *Vendndodhja* e krijimtarisë tani ka të ngjarë të jetë kudo. Çdo ditë e më shumë, gjithashtu, po pranohet krijimtaria grupore dhe bashkëpunuese. Kjo mund të vërehet në kërkimet e reja mbi risitë, krijimtarinë në grup, xhazin dhe një vlerësim në rritje të ‘urtësisë së turmave’, gjasave krijuese të ‘risisë së hapur’, ku çështjet e vështira ndahen me qytetarët, nga ku përgjigje të dobishme dalin në pah.<sup>42</sup>

### PRIRJET E BREZAVE PO BËHEN GJITHNJË E MË TË DUKSHME DHE NDIKUESE.

Hulumtimi i kryer në vitin 2010, tregoi se studentët (*mijëvjeçarët*) e kolegjit e lidhnin krijimtarinë me veprimtaritë e përditshme dhe ndërveprimet shoqërore.<sup>43</sup> Ndërsa për brezin e *Baby Boomers*, krijimtaria lidhet me ‘krijuesit e shquar’, si Ajnshtajni, Van Gogh, ose artistë të njohur individualë. Në kulturën e sotme ‘pjesëmarrëse’<sup>44</sup>, vëmendja nuk është aq shumë ‘te lartësimi’, por te pjesëmarrja, ecuria e marrëdhënieve me bashkëmoshatarët dhe familjen, ku ‘të bësh, është të ndërlihdesh.’<sup>45</sup>

Ajo që mund të duket si një pjesëmarrje e madhe, gjithashtu, i jep mundësi shtrembërimit dhe shfrytëzimit të madh. Pikërisht, këtë nënvizon Dagllas Rashkof, në filmin e tij dokumentar *Zanafilla*, ndërsa filmi *Lojërat e*

- 42 Barron, F. (1999). All creation is a collaboration. In A. Montuori dhe R. Purser (Eds.), *Social Creativity* (Vol. 1, f. 49–60). Cresskill, NJ: Hampton; Stigliano, T. (1999). *Creativity, Romanticism, and the rise of consumerism*. In A. Montuori dhe R. Purser (Eds.), *Social Creativity* (Vol. 1). Cresskill, nj: Hampton Press; Christakis, N.A., dhe Fowler, J.H. (2009). *Connected: The surprising power of our social networks and how they shape our lives* (1st ed.). New York: Little, Brown and Co; Montuori, A. (2003). The complexity of improvisation and the improvisation of complexity. *Social science, art, and creativity. Human relations*, 56(2), f. 237–255; Montuori, A., & Purser, R. (1995). Deconstructing the lone genius myth: Towards a contextual view of creativity. *Journal of Humanistic Psychology*, 35(3), f. 69–112; Montuori, A., dhe Purser, R. (Eds.). (1999). *Social Creativity* (Vol. 1). Cresskill, NJ: Hampton Press; Paulus, F. B., dhe Nijstad, B.A. (Eds.). (2003). *Group creativity: Innovation through collaboration*. New York: Oxford University Press; Schrage, M. (1999). *Serious play: How the world’s best companies simulate to innovate*. New York: Harvard Business School Press; Surowiecki, J. (2005). *The wisdom of crowds*. New York: Anchor.
- 43 Taylor, M. (2003). *The moment of complexity. Emerging network culture*. Chicago: University of Chicago Press.
- 44 Sardar, Z. (1999). *Postmodernism and the Other*. Londër: Pluto Press; Jenkins, H. (2009). *Confronting the challenges of participatory culture: Media education for the 21st century*. Boston: The mit Press.
- 45 Gauntlett, D. (2013). *Making is connecting*. New York: John Wiley & Sons.



*Urisë* ka një faqe interneti me një konkurs për ndjekësit më të mirë dhe më të përkushtuar. Në thelb, kjo nënkupton se ndjekësit tani po përdorin rrjetet shoqërore për t'i bërë jehonë filmit dhe shpërblimi për këtë, përmes rrjeteve shoqërore, është të qenit “Ndjekësi numër 1” dhe, me gjasë, të përmendesh nga një prej yjeve të filmit. Në këtë mënyrë, filmit i bëhet jehonë e vazhdueshme dhe ndjekësit ndjehen edhe më të rëndësishëm, duke ‘bashkëbiseduar’, ose duke marrë përgjigje nga aktorët e filmit, gjë që rrit statusin shoqëror të grupit të bashkëmoshatarëve dhe numrin e ‘pëlqimeve’ që ata marrin në rrjetet shoqërore. Ka pasur një zhvendosje të madhe drejt një marrëdhënieje shumë më ndërvepruese, pjesëmarrëse midis ndjekësve dhe ‘ofruesve të përmbajtjes’. Është e qartë, se tregtarët kanë mësuar se si ta shfrytëzojnë këtë për interesat e tyre. Por, ndërsa kjo është ndoshta shprehja më e dukshme e këtij tranzicioni, nuk është aspak e vetmja.

Shumë nga risitë më tërheqëse në sferën shoqërore, në 20 vitet e fundit apo më tepër, kanë qenë rreth rrjetëzimit, pjesëmarrjes dhe përpjekjeve të njerëzve të thjeshtë. Këto risi janë të lidhura me shfaqjen e internetit, rrjeteve shoqërore, ngritjen e një shoqërie të rrjetëzuar, ndryshimin e rolit të gruas, vlerat e brezit të *Mijëvjeçarit*. Një shumëllojshmëri shembujsh të krijimtarisë më pjesëmarrëse përfshin (e kufizuar në shembujt kryesisht nga SHBA/UK): You Tube, Etsy, Facebook, Wikipedia, Web Med, Lord of Warcraft, tregjet e fermerëve, ushqimet artizanale dhe lëvizjet Slow Food, My Space, blogje, Twitter, Britain’s Got Talent, muzikë dhe filma të pavarur, kultura *bëje vetë*, duke përfshirë edukimin *bëje vetë*<sup>46</sup>, Yelp, Trip Advisor, Dancing with the Stars, American Idol dhe të gjitha llojet e ‘spektakleve drejtpërdrejt. Dukuria e ‘burimeve njerëzore’ për të kërkuar fonde nëpërmjet rrjeteve shoqërore, ka hapur rrugë të reja financimi për veprimtari sipërmarrëse. Lëvizja e Krijuesve në zhvillim është një tjetër shenjë<sup>47</sup>, siç është koncepti i ndërlydhur i Toffler-it për ‘prosumer’, i cili bashkon emërtesat prodhues dhe shpenzues, për të sqaruar se si kundërshtia tradicionale midis dy roleve po e humbet qartësinë.<sup>48</sup>

Kjo pjesëmarrje e re nga njerëzit e thjeshtë nuk është pa shqetësime, siç e sqaron shembulli i *Lojërave të Urisë*. Kundërshtarët kanë arsytuar, gjithashtu, se ka filluar një lëvizje drejt amatorizmit. Nuk është e qartë, nëse fakti që kritikët e artit dhe të udhëtimit zëvendësohen nga blogje me vërejtje dhe vlerësime të përdoruesve të *Trip-Advisor*, është domosdoshmërisht një përmirësim, teksa ata që shkruajnë nëpër gazeta dhe revista, po humbasin vendin e punës. Çdo ngjasim me nivele dhe kulturë të lartë, çdo vlerësim i njohësve

46 Kamenetz, A. (2010). *diy U: edupunks, edupreneurs, and the coming transformation of higher education*. White River Junction, Vt.: Chelsea Green Pub.

47 Anderson, C. (2012). *Makers: the new industrial revolution*. New York: Random House.

48 Toffler, A., dhe Toffler, H. (2006). *Revolutionary wealth*. New York: Knopf.



dhe mjeshtërive të vërtetë, po zëvendësohet nga njohuritë e cekëta, amatore, të natyrës *ku ta di unë*.<sup>49</sup> Gjithashtu, ecuria e hamendësuar e demokratizimit mund të jetë një rrafshim, ku nivelet tradicionale të përsosurisë dhe vlerave janë të humbura. Kërcënimi i shfrytëzimit nga qeveritë dhe tregtarët e mëdhenj është gjithmonë i pranishëm dhe njerëzit e thjeshtë, grupet e kyçura në rrjet mund të përfshijnë edhe terroristë apo njerëz të urreyer.<sup>50</sup>

Tani po shtrohet pyetja, nëse ajo që ne e quajmë krijimtaria ‘gjithkush, përditë, kudo’, do të çojë në rritjen e shkallës së narcizmit (dhe në një mani 5 minutëshe të dikujt për t’u ndjerë i famshëm), në një brez shpenzuesish të papërgjegjshëm dhe në rrafshimin e të gjitha vlerave, që do ta bëjë ‘Brezin Tim’ të duket vetëmohues (‘Duhet të vazhdoj me të rejat e fundit, edhe nëse është vetëm sistemi i ri operativ, pa të cilin asnjë nga aplikacionet e mia nuk do të punojë’). Apo ndoshta, ky brez mund të shtyhet drejt ëndrrave të denja njerëzore? Në këtë pikë, gjyqtaria është në pritje, me parashikime jashtëzakonisht të ndryshme.<sup>51</sup> Pyetja tani, nuk është aq shumë, nëse jemi krijues, por çfarë do të bëjmë me krijimtarinë tonë, ku dhe si do ta kanalizojmë?

## RINGJALLJA E UDHËHEQËSISË

Le të bëjmë një hap prapa dhe ta shohim udhëheqësinë më me vëmendje. Udhëheqja është një fushë e përcaktuar brenda studimit akademik, me degë dhe nivele të veçanta. Literatura mbi këtë temë është e gjerë, pështjelluese dhe, në të vërtetë, shpesh kundërshtuese, ka shkruar Kellerman për fundin e udhëheqësisë.<sup>52</sup> Siç mund ta shohim, rrënjët e konceptimit të saj shtrihen paralel me ato të hulumtimit të krijimtarisë: studimi i njerëzve të jashtëzakonshëm.

Që në vitin 1985, Bennis dhe Nanus<sup>53</sup> shkruan:

- 
- 49 Carr, N. (2010). *The shallows: What the internet is doing to our brains*. New York: W.W. Norton; Keen, A. (2008). *The cult of the amateur: How blogs, MySpace, YouTube, and the rest of today's user-generated media are destroying our economy, our culture, and our values*. New York: Crown.
  - 50 Rushkoff, D. (2010). *Program or be programmed: Ten commands for a digital age*. New York: Or Books; Rushkoff, D. (2011). *Life Inc. How corporatism conquered the world and how we can take it back*. New York: Random House.
  - 51 Toffler, A., dhe Toffler, H. (2006). *Revolutionary wealth*. New York: Knopf; Greenberg, E., dhe Weber, K. (2008). *Generation We: How Millennial youth are taking over America and changing our world forever*. Emeryville: Pachatusan; Twenge, J.M., dhe Campbell, W.K. (2010). *The narcissism epidemic: Living in an age of entitlement*. New York Free Press.
  - 52 Kellerman, B. (2012). *The end of leadership*. New York: Harper Collins; Maccoby, M. (2001). Making sense of the leadership literature. *Research-Technology Management*, 44(5), f. 58–60; Rost, J.C. (1993). *Leadership for the twenty-first century*. Westport, CT: Praeger.
  - 53 Bennis, W., dhe Nanus, B. (1985). *Leaders: The strategies for taking charge*. New York: Harper.





Fjalë për fjalë, janë kryer mijëra hetime empirike të udhëheqësve vetëm në shtatëdhjetë e pesë vitet e fundit, por ende nuk është gjetur një mirëkuptim i qartë dhe pa mëdyshje, se çfarë i dallon udhëheqësit nga joudhëheqësit, dhe ndoshta më e rëndësishme, çfarë i dallon liderët e dobishëm nga liderët e padobishëm.<sup>54</sup>

Në 25 vitet e fundit nuk është se ka ndryshuar dhe aq shumë<sup>55</sup>. Në të njëjtin vit, u shfaq një kritikë ndaj udhëheqësisë, e cila vuri në pikëpyetje 'romancën' e udhëheqësit heroik<sup>56</sup>:

Me sa duket: si vëzhgues dhe pjesëmarrës në organizata, ne mund të kemi zhvilluar pikëpamje shumë të romantizuara, heroike të udhëheqësisë – çfarë bëjnë liderët, çfarë janë në gjendje të arrijnë dhe ndikimet e përgjithshme që kanë në jetën tonë. Një nga elementet kryesore në këtë konceptim romantik, është pikëpamja se udhëheqësia është një ecuri organizative qendrore dhe fuqia kryesore në kuadrin e ngjarjeve dhe veprimtarive organizative. Ajo përbën atë që mund të mendohet si një besim më shumë te mundësia, sesa në dobinë e tanishme të atyre njerëzve që zënë vende kyçe në drejtimin organizativ zyrtar.<sup>57</sup>

Kjo kritikë e *Njeriut të Madh* heroik përkoi me një zhvendosje nga një epokë, në një epokë të re.<sup>58</sup> Në këtë periudhë kalimtare, pasnormale, ne shohim rënien e një modeli udhëzues të udhëheqësisë dhe lindjen e mënyrave të reja të udhëheqësisë.<sup>59</sup> Për qëllimet tona, po e fillojmë shumë thjesht shqyrtimin rreth udhëheqësisë, duke pyetur: Kush mund të jetë udhëheqësi? Një përmbledhje e shkurtër e historisë së udhëheqësve të mëdhenj të botës, tregon se udhëheqësit e njohur gjerësisht, të kremtuar dhe të përbuzur, kanë qenë përfaqësues meshkuj të kulturës mbizotëruese, duke mishëruar veçori që mund të përmbliidhen (por, sigurisht, nuk kufizohen në) modelin 'heroik'. Po bëhet gjithnjë e më e dukshme, se udhëheqësit tani po dalin nga grupe tradicionalisht të nënpërfaqësuar, të tilla si gratë dhe pakicat. Presidenti amerikan Obama është ndoshta rasti më i beftë në këtë pikë. Në 'përfytyrimin shoqëror' mbarëbotëror, tani kemi një

54 Po aty.

55 Western, S. (2008). *Leadership. A critical text*. Thousand Oaks: Sage.

56 Bligh, M.C., Kohles, J.C., dhe Pillai, R. (2011). Romancing leadership: Past, present, and future. *The Leadership Quarterly*, 22(6), f. 1058–1077.

57 Po aty.

58 Montuori, A. (1989). *Evolutionary competence: Creating the future*. Amsterdam: Gieben; Montuori, A., dhe Conti, I. (1993). *From power to partnership. Creating the future of love, work, and community*. San Francisco: Harper San Francisco; Morin, E., dhe Kern, B. (1999). *Homeland Earth: A manifesto for the new millennium*. Cresskill, NJ: Hampton Press; Sardar, Z. (2010). Welcome to postnormal times. *Futures*, 42 (5), f. 435–444; Slater, F. (2008). *The chrysalis effect*. Brighton & Portland: Sussex Academic.

59 Wren, J.T. (2007). *Inventing leadership. The challenge of democracy*. Northampton, MA: Edward Elgar.





president afrikano-amerikan në Shtetet e Bashkuara. Kjo nuk do të thotë se mundësitë e udhëheqjes janë hapur për të gjithë, por shënjon fillimin e një zhvendosjeje drejt hapjes më të madhe ndaj grupeve tradicionalisht të nënpërfaqësuar në vende drejtuese.

Zhvendosja nga udhëheqës klasik, shtrihet edhe në fusha të tjera: ajo nuk kufizohet më ndoshta si detyra e njeriut më të fuqishëm në botë. Çmimi për Mjedisin, *Goldman*, për shembull, ndahet çdo vit në San Francisko, për njerëz të përshkruar si 'ambientalistë bazë' nga e gjithë bota, të cilët kanë dhënë një ndihmesë të vyer dhe, shpeshherë, të guximshme për mbrojtjen e mjedisit. Fituesit nuk janë njerëz që mund të shihen si 'udhëheqës heroikë' në një trajtë të beftë, e ngjashme me gjeneralin Patton. Ata nuk janë udhëheqës të mëdhenj luftarakë që orkestrojnë ushtri mijëra ushtarësh, apo nismëtarë të marrjes në dorëzim të ndërmarrjeve të mëdha. Ata janë burra dhe gra të zakonshme, që dëshmojnë se janë, gjithashtu, mjaft të jashtëzakonshëm, kur e kërkojnë rrethanat.

Ndonëse nuk janë tradicionale, në mënyrën se si e shohin dhe e paraqesin vetveten, këta njerëz janë heroikë në kuptimin se ata rregullisht sfidojnë ndërmarrje shumëkombëshe, qeveri ose të dyja, shpeshherë duke vënë veten në rrezik. Ata janë të përfshirë në betejat kundër shpyllëzimit, privatizimit, furnizimit me ujë, si dhe projekteve të tjera që ndikojnë në mirëqenien e bashkësive prej nga vijnë, ose që përfshijnë shkatërrimin e natyrës. Një nga këta udhëheqës dhe fitues i çmimit *Goldman*, Ken Saro-Wiwa i Nigerisë, u var nga një qeveri e korruptuar me akuza të rreme, sepse puna e tij vuri në rrezik marrëveshje shumë milionëshe. Fituesit e çmimit *Goldman* nuk janë njerëz që kishin ambicie për t'u bërë drejtorë, gjeneralë ose zyrtarë të zgjedhur. Ata nuk e shihnin veten në formën tradicionale, si 'udhëheqës të njerëzve'. Ata thjesht iu përgjigjën me mendje dhe me zemër asaj që e nihatën si të padrejtë. Ata mendonin se duhej të bënin diçka përtej mbijetesës dhe mirëqenies së tyre vetjake. Pothuajse përfunduan në udhëheqës, sepse mendonin që duhej krijuar një bashkim njerëzish për të luftuar padrejtësinë.

Mesazhi është i qartë. "*Kush*" është udhëheqësi po merr tjetër kuptim. Nëse udhëheqja ka të bëjë me dhënien e ndonjë ndihmese në ndryshimet mbarëbotërore, përmes nismave, atëherë loja është e hapur. Dhe, ndërsa anëtarë të grupeve tradicionalisht të nënpërfaqësuar bëhen udhëheqës, mund të themi me siguri, se koncepti i udhëheqësisë do të ujitet nga rrjedha të reja vlerash, krijimtarie dhe kulturash, nga të ardhme dhe gjasa të reja. Përfundimisht, nuk duhet të ndodhë që grupet, tashmë të nënpërfaqësuar, të bashkohen me klubin *ekzistues* drejtues dhe të luajnë të



njëjtën lojë. Vetë përkufizimi i udhëheqësisë, vetë rregullat e lojës, do të ndryshojnë dhe tashmë po ndryshojnë.

“Kush” është udhëheqësi, gjithashtu, lidhet drejtpërdrejt me një shqetësim qendror pasmodern: *vetëkrijimin*.<sup>60</sup> Kushti paraprak nuk është që udhëheqësia të jetë një veçori e caktuar, të cilën ose e ke, ose nuk e ke. Në një periudhë kalimtare, ka pak siguri dhe mundësi të mëdha për krijimtari. Ne nuk jemi të lidhur me role apo fate të caktuara. Është mjaft e mundur që ta krijosh veten si njeri dhe si udhëheqës. Udhëheqja e re nuk nënkupton se dikush duhet të jetë udhëheqës gjatë gjithë kohës. Gjithnjë e më shumë, udhëheqësia po shihet edhe si një hierarki, pa ndonjë renditje të caktuar, e mbështetur në aftësinë për një rrethanë, detyrë dhe gjendje të veçantë.

Studiuesit e krijimtarisë e shohin dallimin midis krijimtarisë së madhe C dhe krijimtarisë së vogël c; krijimtarisë së lartësuar dhe të përditshme.<sup>61</sup> Duket se ideja e U (udhëheqësi madhështore) dhe u (udhëheqësi e vocërr) mund të ofrojë një pikënisje për të bërë dallimin midis, le të themi, Presidentit të Shteteve të Bashkuara, detyra e të cilit është zyrtare dhe e caktuar, që shihet si një simbol qendror i udhëheqësisë për një vend të tërë; dhe veprimtaritë e përditshme ‘udhëheqëse’ të njerëzve të përfshirë në lëvizjet e ndryshimeve shoqërore, organizata ose veprimtari të përditshme të cilat mund të hyjnë dhe të dalin nga roli i udhëheqësit, në një mënyrë më të shkrifët.

## FISET DHE FABRIKAT

Një tendosje me rëndësi themelore në studimin e udhëheqësisë dhe të krijimtarisë, qëndron në dy këndvështrime të kundërta, me dy njësi të ndryshme dhe të kundërta analitike. Në filozofinë e shkencave shoqërore, këto këndvështrime njihen si copëzim dhe ndërlihdje.<sup>62</sup> Në studimin e udhëheqësisë, copëzimi qartësohet nga Karlajell, përmes teorisë së *Njeriut të madh*, që e vë theksin te njeriu (me përjashtim të faktorëve shoqërorë); ndërsa ndërlihdja qartësohet nga Tolstoi: përmes forcave të historisë dhe

60 McCracken, G. (2008). *Transformations: Identity construction in contemporary culture*. Bloomington: Indiana University Press.

61 Runco, M. (2007). *Creativity. Theories and themes: Research, development, and practice*. Amsterdam: Elsevier.

62 Fay, B. (1996). *Contemporary philosophy of social science. A multicultural approach*. New York: Blackwell Publishers.



shoqërisë, njeriu është thjesht një përfaqësues i këtyre forcave.<sup>63</sup> Në krijimtari, këto këndvështrime të kundërta përfaqësohen në lëndën kërkimore mbizotëruese të psikologjisë, e përqendruar te njeriu krijues; dhe në këndvështrimin sociologjik të ndërlidhjes, i përqendruar në rolin e faktorëve shoqërorë dhe në kapjen e gjendjes shpirtërore të periudhës në përgjithësi, me të dyja këto këndvështrime që e shohin përqendrimin e tjetrit si dukuri paralele.<sup>64</sup>

Ogilvi e ka trajtuar këtë çështje, në mënyrë bindëse dhe të përsëritur, gjatë qartësimit të një filozofie shoqërore rrënjësisht pluraliste, në veprën *Disa*.<sup>65</sup> Arsyetimi i tij është tepër i ndërlikuar për t'u përmbledhur këtu me ndonjë gjë, përveçse një ideje të shkurtër, se si ai e çon individin dhe bashkësinë në skajet më të largëta të ligjërimit. Përmes kësaj, ai tregon se deri në çfarë mase këto dallime që lindin në kundërshtim me njëra-tjetrën, janë të shkaktuara nga vetë njeriu. Kjo, sipas tij, është arsyeja që, nga njëra anë, nuk e dimë se në ç' masë ekzistojnë individët dhe deri ku, për shkak të një rrethane shoqërore, nga ana tjetër, bashkësitë ekzistojnë si përzgjedhje të individëve pak a shumë të organizuar. Filozofia shoqërore e Some parashtron një shumësi rrënjësisht mendore-shpirtërore, ndërvetjake dhe shoqërore, që nuk është e ndarë me thikë, sipas logjikës kjo ose ajo, por është një ecuri më e rrjedhshme, më e ndërlikuar, që e pranon ndërlidhjen dhe ndërvarësinë e vazhdueshme të këtyre emërtesave, si dhe shprehja e tyre në mendimin dhe veprimin njerëzor.

Libri i mirënjohur *Fiset*, nga Seth Godin, na ofron dy përshkrime të dobishme, që mund të na orientojnë lidhur me zhvillim e udhëheqësisë.<sup>66</sup> Argumenti i tij është se ne po largohemi nga epoka e Fabrikës dhe tani jemi në epokën e Fiseve. "Një fis", - shkruan ai, "është një grup njerëzish të lidhur me njëri-tjetrin, të lidhur me një udhëheqës dhe të lidhur me një ide".<sup>67</sup> Emërtesa *Fis* mund të duket si e papërcaktuar, pasi fjala 'fabrikë' tingëllon kryesisht 'bashkëkohore'. Dallimi thelbësor është në fjalën 'i lidhur'. Mediat e reja shoqërore kanë mundësuar lidhjen e njerëzve në mbarë globin. Ndërsa në kohët paramoderne një fis ishte një dukuri vendore, e përcaktuar fort nga afërsia fizike, tani është e mundur të jesh pjesë

63 Wren, J.T. (Ed.). (1995). *The leaders' companion: Insights on leadership through the ages*. New York: free Press.

64 Simonton, D.K. (1999). The creative society: Genius vis-a-vis the Zeitgeist. In A. Montuori dhe R. Purser (Eds.), *Social Creativity* (Vol. 1, f. 237–264). Cresskill, NJ: Hampton Press.

65 Ogilvy, J. (1977). *Many dimensional man*. New York: Harper. Ogilvy, J. (2002). *Creating better futures*. New York: Oxford University Press.

66 Godin, S. (2009). *Tribes. We need you to lead us*. New York: Portfolio.

67 Po aty.



e një fisi botëror, qoftë ndjekës i ndonjë grupi muzikor të panjohur *indian*, që mblidhen së bashku për të mbështetur viktimat e tërmetit në Abruzzo; apo në anën e errët të kësaj dukurie, organizata si Al-Kaeda dhe Vëllazëria Ariane. Fiset mund të shfaqen dhe të zhduken: kërkimi për avionin malajzian, MH370, përfshiu një 'fis' njerëzish që skanonin imazhe të përditësuar rregullisht të Oqeanit Paqësor në kompjuterët e tyre për gjurmë rrënojash. Veprimet e Wikipedia-s mund të thuhet se kryhen nga një fis njerëzish të përkushtuar ndaj shkrimit, vlerësimit dhe korrigjimit të të dhënave hyrëse. *Fiset* nuk janë vetëm mënyra e re më e rëndësishme e organizimit dhe e ndryshimit shoqëror, ato gjithashtu ndryshojnë në mënyrë të vullshme, se kush, çfarë, ku dhe si të udhëheqë. Për qëllime studimi, ne mund t'i mendojmë *Fiset* si pionierët e filozofisë pluraliste të *Disa-ve*, shkruar nga Ogilvi.

Fabrikat janë të mëdha, hierarkike, të ngathëta, të pandryshueshme dhe, përgjithësisht, nuk janë të prira drejt risisë. Në një fabrikë, udhëheqësia është e kufizuar në një grusht njerëzish. Urdhri dhe drejtimi janë tiparet qendrore të udhëheqësisë në fabrika. Fabrikat janë si ushtritë. Ushtria amerikane e munda ushtrinë irakiane brenda pak ditësh, por vështirë se 'e kreu detyrën'. Natyrisht, fakti i sikletshëm ishte se Iraku nuk kishte asnjë lidhje me 11 shtatorin. Nuk është aspak e qartë, se çfarë ishte saktësisht 'detyra' që u përmbush dhe pati plot 'detyra zvarritëse' në përpjekjet për të ripërcaktuar, shfajësuar dhe arsyetuar një pushtim që pasqyronte një mendësi të ngulitur në një tjetër kohë. U krijua përshtypja se kombi ishte sulmuar, se kjo ishte luftë dhe këtë mund ta bënte vetëm një komb tjetër, prandaj kjo kërkon hakmarrje ndaj atij kombi. Këtu ka një logjikë, një qartësi dhe një thjeshtësi. Në kohët pasnormale, një rrjet i shpërndarë terroristësh që jetojnë në të gjithë botën, nuk mund të mposhtet nga një ushtri në një përplasje ballë për ballë në fushën e betejës. Ky nuk është një komb armiqësor në kuptimin tradicional. Bombarduesit e 7/7 në Londër, jetonin në Angli dhe bombarduesit e 9/11, jetonin në SHBA. Ata ishin 'një grup njerëzish të lidhur me njëri-tjetrin, të lidhur me një udhëheqës dhe të lidhur me një ide'. Fiset janë të lidhura në rrjet, të ndryshueshëm, me hierarki të ndryshueshme, duke lejuar që udhëheqësia të shfaqet në një mori burimesh.<sup>68</sup> Në fakt, nëse në botën moderne të fabrikës vëmendja ishte e përqendruar te një udhëheqës për çdo sistem dhe nënsistem, në botën e fiseve të gjithë mund të jenë udhëheqës, ky është argumenti i Seth Godin-it. Demokratizimi

68 Ogilvy, J. (1989). This postmodern business. *The Deeper News*, 1 (5), f. 3–23; Nielsen, M. (2012). *Reinventing discovery: The new era of networked science*. Princeton: Princeton University Press.



i udhëheqësisë po bëhet një pikëpamje gjithnjë e më e zakonshme. Naj e përmbledh kështu pamjen e re<sup>69</sup>:

Udhëheqës mund të bëhet pothuajse çdokush. Udhëheqësia mund të mësohet. Kjo varet nga edukata si dhe nga natyra. Udhëheqësia mund të ekzistojë në çdo nivel, me ose pa eprorin zyrtar. Shumica e njerëzve janë edhe prijës, edhe ndjekës. Ata ‘udhëheqin nga mesi’.<sup>70</sup>

Kjo është shumë larg figurës heroike të udhëheqësisë së “Njeriut të madh”, kapitenit të industrisë, Jack Uellsh; gjeneralit Paton; Napoleonit dhe figurave klasike të lidhura me udhëheqësinë; apo edhe figurave më të çuditshme, por jo më pak mbizotëruese, të Bill Gates dhe Stiv Jobs, me ndjekësit e tyre të përkushtuar. Megjithatë, ajo që duket e qartë, është ndryshimi si në udhëheqësi, ashtu edhe në krijimtari: nga modeli i Njeriut të Madh, në “përditë, kudo, kushdo”, me një theks të ri mbi rolin e ndjekësve, madje edhe të organizatave “pa udhëheqës”.<sup>71</sup> Modelet më të përhapura të udhëheqësisë; të vizatuarit nga një sërë burimesh, siç është rasti në kërkimin e krijimtarisë; duke përfshirë teoritë e ndërlikimit dhe çoroditjes; apo studimin e fundit të turmave, kanë filluar të ofrojnë modele të çfarëdollojshme, që e pranojnë qendërzimin e krijimtarisë bashkëpunuese.<sup>72</sup>

## MENDIME PËRMBYLLËSE

Jetojmë në kohë pasnormale. Një botë e vjetër po vdes dhe një e re ende nuk ka lindur. Krijimtaria dhe përfytyrimi janë të nevojshme për të parashikuar botën e re, për të qartësuar dhe shpikur shtigje të tjera, ndryshe nga ato të botës së vjetër. Krijimtaria po na *udhëheq* drejt kësaj bote të re – kjo është mënyra se si ne i konceptojmë mundësitë. Kjo do të thotë se krijimtaria, në këtë çast të caktuar kohor, kërkon më shumë *përgjegjësi* se kurrë më parë. Krijuesit janë udhëheqës. Ne kemi parë se si prirjet e reja

69 Nye, J.S. (2008). *The powers to lead*. New York: Oxford University Press.

70 Po aty.

71 Brafman, O., dhe Beckstrom, R.A. (2006). *The starfish and the spider: The unstoppable power of leaderless organizations*. New York: Penguin; Meindl, J. R. (1995). The romance of leadership as a follower-centric theory: A social constructionist approach. *The Leadership Quarterly*, 6(3), f. 329–341; Riggio, R.E., Chaleff, I., dhe Lipman-Blumen, J. (2008). *The art of followership: How great followers create great leaders and organizations* (Vol. 146). New York: John Wiley & Sons.

72 Rolling, J.H. (2013). *Swarm intelligence: What nature teaches us about shaping creative leadership*. New York: Macmillan.



na lënë të kuptojmë se krijimtaria po bëhet tani më e ndërlidhur dhe më e përqendruar në dukurinë *përditë, kushdo, kudo*. Dhe kjo e ka një kuptim: mundësitë po qartësohen dhe zhvillohen në bashkëpunim nga fiset, nga 'disa' njerëz në të gjithë botën, në çdo fushë të jetës së tyre. Ecuritë gjallëruese, pjesëmarrëse, po bëhen gjithnjë e më popullore. Njerëzit po mësojnë të punojnë së bashku, përtej dallimeve, për të përpunuar zgjidhje krijuese për problemet e vjetra. Shpeshherë, në të shkuarën këto probleme ishin vetë zgjidhje, por zgjidhjet tani janë kthyer në problem.

Krijimtaria dhe udhëheqësia e re janë të ndryshme nga të vjetrat në shumë mënyra, siç e kemi përmendur. Por këto ndryshime, megjithëse në vetvete janë tërheqëse dhe ngjallin vegime, nuk janë të mjaftueshme. Nëse duam të ecim nëpër këto kohë pasnormale, drejt një bote të re, duhet të jemi të vetëdijshëm për rrënjët, degët dhe frytet e 'botës së vjetër' dhe të parashtrojmë përjasje të tjera, ndryshe nga ato të botës së vjetër.

Do ta mbyllim me një ide të shkurtër të disa prej çështjeve më të mëdha. Një epokë pasnormale është rrjedhojë e shterimit të "modelit të vjetër", ose e botëkuptimit të Modernitetit. Kjo rraskapitje është e dukshme në një sërë fushash. Siç e theksuam edhe më herët, në mund të vërejme që shumë nga zgjidhjet e ofruara nga Moderniteti, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me mbikëqyrjen e mjedisit natyror, tashmë janë bërë vetë problem. Siç thekson Ogilvi, "mjedisi i huaj" me të cilin duhet të përballemi tani, nuk është siç ishte dikur mjedisi natyror, por është teknologjia dhe politika.<sup>73</sup> Ajo me të cilën duhet të përballemi, nuk është "atje jashtë", për sa kohë që krijimet dhe mënyrat tona të të menduarit, ndjesisë dhe qenies, të institucionalizuara, ende s'janë bërë 'të vërteta'.

Zhvendosja drejt këtij botëkuptimi në zhvillim e sipër, siç thekson Sardar, do të varet shumë nga krijimtaria dhe përfytyrimi, veçanërisht se si ato që në botëkuptimin e vjetër mendoheshim si marrëdhënie baras me zero, mund të shndërrohen në marrëdhënie të dobishme. Me fjalë të tjera, se si ndasitë dhe dallimet mund të ndërmjetësohen, të nxiten, ndoshta edhe të tejkalohen, përmes krijimtarisë. Nxitja dhe mbështetja në krijimtarinë *kudo, përditë dhe kushdo*, nuk do të jetë një ecuri e lehtë apo e shpejtë, por kjo lloj krijimtarie e rrjetëzuar, 'burim i hapur', duket thelbësore për të shkuar përtej kufizimeve të '*Hobbes dhe Machine*'.

Duke pasur parasysh nevojën e ngutshme të përbaljes me çështje botërore, detyra duket e frikshme, në rastin më të mirë. Por ne po sugjerojmë që krijimtaria e re, botërisht e rrjetëzuar, e kanalizuar në zgjidhjen bashkërisht të çështjeve dhe në gjallërimin e mundësive, mund të na ofrojë gjithashtu

73 Ogilvy, J. (1977). *Many dimensional man*. New York: Harper.



gjasa dhe mundësi të jashtëzakonshme, që ishin të paimagjinueshme vetëm 20 vjet më parë.<sup>74</sup> Jeta mund të mos jetë më kurrë ‘normale’, por, nëse kjo është shkaktare e çlirimit nga prangat e ‘Hobbes and the Machine’, në fakt, mund të kemi arsye të shpresojmë tek e ardhmja.

---

74 Montuori, A. (2013). Creativity and the Arab Spring. *East West Affair*, 1 (1); Montuori, A., dhe Purser, R. (1996). Ecological futures: Systems theory, postmodernism, and participative learning in an age of uncertainty. In D. Boje, D. Gephart dhe T. Joseph (Eds.), *Postmodernism and organization theory* (f. 181–201). Newbury Park: Sage.



## Bashkautorët

**Gabrielle Donnelly**, shkrimtare dhe njohëse e ndryshimeve shoqërore dhe risive, mori Doktoraturën e saj me tezën *Hulumtim transformues*, nga Instituti i Studimeve Integrale, në Kaliforni. Ajo është bashkëpunëtore e Collective Wisdom Solutions, një shërbim këshillimor në bashkëpunim me sektorët publikë, privatë dhe jofitimprurës për përmbushjen e ideve, me qendër në Halifax, Nova Scotia, Kanada.

**Shirin Elahi**, njohëse e rreziqeve, pasigurisë, ndryshimit dhe planifikimit të mënyrave të veprimit. Ka ligjëruar gjerësisht, duke përfshirë Qendrën e Biznesit Said, Universitetin e Oxfordit; HEC-in, Parisin; Institutin Ndërkombëtar për Analizën e Sistemeve të Zbatuara (IIASA), Laxenburgun dhe Qendrën Kërkimore Benfield Greig Hazard, University College London (UCL). Është Drejtoresha Administrative e *Scenarios Architecture*, një qendër këshillimore strategjike e një rrjeti specialistësh që punojnë në rreziqet botërore të ndërlikuara.

**Silvio O. Funtowicz** ka dhënë Matematikë, Logjikë dhe Metodologji Kërkimore në Buenos Aires, Argjentinë. Për shumë vite, ka qenë shkencëtar i jashtëm pranë Qendrës së Përbashkët Kërkimore të Komunitetit Europian në Ispra, Itali. Aty ka punuar si filozof analitik në fushën e Studimeve të shkencës dhe teknologjisë. Së bashku me Jerome Ravetz, ai krijoi sistemin shënimor NUSAP, për veçoritë e pasigurisë dhe cilësisë në shprehjet sasiore, si dhe parashtroi konceptin e shkencës pasnormale. Aktualisht, është profesor në Qendrën Studimore Shkencore dhe Humane (SVT), Universiteti i Bergenit, Norvegji.





**C. Scott Jordan**, filozof dhe shkencëtar politik, i atashuar në Qendrën Botërore Aziatike, në Universitetin Creighton në Omaha, Nebraska. Është anëtar i *Nonkilling Consortium International* dhe ka punuar me Fondacionin Soong Ching Ling, në Kinë. Bashkëpunëtor i rregullt për tre-mujorëshen *Critical Muslim*; drejton emision radiofonik, *Tea Talk Asia*. Hulumtimi i tij përqendrohet në përmasat pasnormale të politikës ndërkombëtare, politikës dhe qeverisjes, të cilat shpesh i shqyrton përmes filmave. Është anëtar i Qendrës për Politikën Pasnormale dhe Studimet e së Ardhmes.

**Alfonso Montuori**, Profesor në Departamentin e Hulumtimeve Transformuese, pranë Institutit të Studimeve Integrale të Kalifornisë. Është autor i disa librave mbi krijimtarinë, ndërlikimin, ndryshimin shoqëror, drejtimin dhe edukimin, duke përfshirë bashkëredaktimin e veprës *Krijimtaria Shoqërore*, me dy vëllime (Hampton Press, 1999), si dhe së fundmi të librit *Udhëtimet drejt Ndërlikimit* (Routledge, Londër, 2015). Është Redaktor i Përgjithshëm i Përparimeve në Teorinë e Sistemeve, Ndërlikimin dhe Shkencat Njerëzore, në Hampton Press, si dhe Redaktor i Asociuar i "*Të ardhmet e Botës: Gazeta e përparimit të Përgjithshëm*".

**Jerry R. Ravetz**, një filozof i njohur i shkencës, shquhet për punime sfiduese mbi rreziqet, objektivitetin shkencor dhe historinë e shkencës. Libri i tij *Njohuria Shkencore dhe Problemet e saj Shoqërore* (OUP, 1971), konsiderohet si një vepër thelbësore. Librat e tjerë përfshijnë: *Shkrirja e Dijes me Fuqinë* (Cassell, Londër, 1990); (me S.O. Funtowicz) *Pasiguria dhe cilësia shkencore rreth përqaqseve* (Kluwer, Dordrecht, 1990); (me Ziauddin Sardar) *E ardhmja Kibernetike* (Pluto, Londër, 1997) dhe *Hyrje në Matematikë* (Icon, Cambridge 1998). I konsideruar si babai i shkencës pasnormale, ai zhvilloi, së bashku me Silvio Funtowicz, një sistem shënimit, 'NUSAP', për përfaqësimin e pasigurisë në informacionin sasior. Aktualisht është anëtar i asociuar në Institutin James Martin për Shkencë dhe Qytetërim, në Universitetin e Oxfordit.

**Ziauddin Sardar**, shkrimtar, futurist dhe edukator. Është një intelektual publik me famë ndërkombëtare. Ka botuar mbi 50 libra, duke përfshirë: *Të shpëtojme të gjitha të ardhmet* (Adamantine, New York, 1998), *Islami, Pasmodernizmi dhe të ardhmet e tjera: Një përmbledhje nga Ziauddin Sardar* (Pluto, Londër, 2003) dhe së fundi, *E ardhmja: E vetmja që ka rëndësi* (Hodder, Londër, 2013). Ka qenë redaktor i *Futures*, revista mujore e

përqasjes, planifikimit dhe studimeve të së ardhmes, nga 1999 deri në 2012. Ka shërbyer si Komisioner në Komisionin e Barazisë dhe të Drejtave të Njeriut, në Mbretërinë e Bashkuar, nga 2006 deri në 2009. Është Drejtor i Qendrës për Politikën Pasnormale dhe Studimet e së Ardhmes.

**Jordi Serra**, futurist, këshilltar dhe edukator. Është Profesor i asociuar në Fakultetin e Komunikimit dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Blanquer-na, Universiteti Ramon Llull, Barcelona, Spanjë. Më parë, ka qenë kreu i Kërkimeve Parashikuese, Qendra e Qeverisjes së Rrezikut, Universiteti Autonom i Barcelonës. Tani është në Bordin editorial të *Futures, World Future Review, dhe Revistës IAPEM*. Ka botuar një numër librash në spanjisht, më së fundi *Inteligencia y análisis prospectivo: La gestión de la incertidumbre* (Secretaria de Inteligencia, Quito, 2014). Ai është Drejtor Kërkimor i Qendrës për Politikën Pasnormale dhe Studimet e së Ardhmes.

**John Sweeney**, futurist, këshilltar dhe edukator. Ka punuar me universitete, agjenci ndërkombëtare të zhvillimit dhe ndihmës humanitare, shoqata jofitimprurëse dhe organizata arsimore e kulturore, duke përfshirë UNICEF-in, UNESCO-n, Qendrën Botërore të UNDP-së për Përsosmërinë e Shërbimit Publik, Qendrën e Përbashkët të Kërkimeve të Komisionit Europian dhe Federatën Ndërkombëtare të Kryqit dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Bashkautor i *Mutative Media: Teknologjitë e Ndërlidhjes dhe Fuqia e Marrëdhënieve në të shkuarën, të tashmen dhe në të ardhmet* (Springer, Dordrecht, 2015.) Është Zëvendës Drejtor i Qendrës për Politikën Pasnormale dhe Studimet e së Ardhmes.

---

**Qendra për Politikën Pasnormale dhe Studimet e së Ardhmes** (CPPFS) është një rrjet ndërkombëtar kërkimor dhe këshillimor, me theks të veçantë në popuj dhe bashkësi të mënjanuara. Qendra ndihmon në shkrim-leximin e së ardhmes dhe kuptimin e kohëve pasnormale, veçanërisht e përqendruar në mjetet e reja të lundrimit, rrethana dhe dukuri kundërshtuese, të ndërlikuara dhe çoroditëse. Ajo synon të nxisë kërkimin e thellë, mësimin e të vepruarit dhe përfytyrimin etik për formimin e së ardhmes së dekolonializuar, të ndryshme dhe të parapëlqyer.





## Mirënjuhje

Një numër botimesh në *Reader* u shfaqën fillimisht në *Futures*, revista mujore e Politikave, Planifikimit dhe Studimeve të së Ardhmes. Gjatë viteve 1990, *Futures* ishte pionier i punës mbi shkencën e pasnormales dhe shumë punime kyçe në këtë fushë u shfaqën për herë të parë në këtë revistë, duke përfshirë: S.O. Funtowicz dhe J.R. Ravetz, “Shkenca për epokën pasnormale” (*Futures*, 25 (7) 1993) dhe J.R. Ravetz, “Shkenca e po sikur?” (*Futures*, 29 (6) 1997). Pra, ishte e natyrshme që punimet e hershme mbi kohët pasnormale të botoheshin gjithashtu në *Futures*, në veçanti: Ziauddin Sardar, ‘Mirë se vini në kohët pasnormale!’ (*Futures*, 42 (5) 2010, f. 435-444), dhe ‘Rishqyrtimi i Kohëve Pasnormale’ (*Futures* 6 (7) 2015, f. 26-39); Shrin Elahi, ‘Rreziqet gjenden këtu: Hulumtimi i ‘të panjohurës së të panjohurave’ (*Futures* 43 (2) 2011); Ziauddin Sardar dhe John Sweeney, “Tre të Nesërmet e Kohëve Pasnormale” (*Futures* 75 (1-13) 2016). Këto shkrime u ribotuan me leje të Elsevier.

‘Artefaktet e kohëve pasnormale’, nga Ziauddin Sardar, u shfaq për herë të parë në *World Future Review*, 7 (4) f. 342-350, 2016; dhe ‘Lindja e Mesme në Kohët Pasnormale’, është një variant i përpunuar i studimit ‘E ardhmja e Pranverës Arabe në Kohët Pasnormale’, botuar në *American Journal of Islamic Social Sciences*. 30 (4) f. 125-136, vjeshtë, 2013. J. A. Sweeney ‘Lidhshmëria Ngjitetëse: Sqarimi i Tri të Nesërmeve’, u botua fillimisht në *Futures of the Internet*, me redaktorë J. Winter dhe R. Ono, (Springer, Dordrecht, 2015). ‘Çudia mbarëbotërore’ u shfaq në *Critical Muslim* 17, me redaktor Ziauddin Sardar: Ekstreme (Hurst, Londër, 2016). “Kinemaja amerikane pasnormale”, nga Scott Jordan, është një përzierje e dy shkrimeve që u shfaqën në *Critical Muslim* 17: Extreme and Critical Muslim 19: Nature (Hurst, Londër, 2016). U jemi mirënjuhës të gjithë këtyre botuesve që na lejuan t’i ribotojmë këto shkrime.



Puna e hershme e Qendrës për Politikën Pasnormale dhe Studimet e së Ardhmes u botua në revistën jetëshkurtër *East-West Affairs* (Lindja-Perëndimi në kohët pasnormale), nga Ziauddin Sardar; *“Mosmarrëveshjet e Bashkimit Europian”* dhe *“Qeverisja pasnormale”*, nga Jordi Serra; si dhe *“Shkenca dhe shkencëtarët në epokën pasnormale”*, nga Jerome R. Ravetz, u shfaqën për herë të parë në Çështjet Lindje-Perëndim. Artikujt e mbetur u shkruan posaçërisht për lexuesin.











Kohët pasnormale përkufizohen më së miri, si “një periudhë pasnormale ku zakonet e vjetra po vdesin, të rejat ende nuk kanë lindur dhe shumë pak gjëra duket se kanë kuptim”. Ose, siç shprehet Ezio Mauro: “Ne po rrimë pezull midis “jo më” dhe “ende jo”, dhe kështu, detyrimisht jemi të paqëndrueshëm. Asgjë rreth nesh nuk është e qëndrueshme, madje as drejtimi ynë i udhëtimit”.

Bota po përjeton një periudhë të ndryshimeve të menjëhershme. Prirjet e reja, teknologjitë dhe ngërçet po shfaqen me shpejtësi duke tjetërsuar peizazhet e njohura shoqërore dhe politike. Idealet e çmuara dhe të përcaktuara qartasi thellë në rrënjët historike, ka të ngjarë të përmbysen brenda natës. Mendimet dhe ngjarjet e çuditshme dhe të pazakonta mund të shfaqen papritur, të shumohen dhe të na sundojnë. Vetëm brenda pak viteve ne po dëshmojmë shfaqjen e populizmit dhe të djathtës së tejskajshme në Europë dhe SHBA, Brexit, mosmarrëveshjet në Bashkimin Europian dhe luftëra kibernetike të shoqëruara me rikthimin e luftës së ftohtë. Kina si superfuqi e re, po bëhet gjithnjë e më mbizotëruese. Sëmundjet si virusi Ebola dhe Zika shfaqen papritur. Ndryshimet klimatike çojnë në çrregullime të motit. Makina pa shofer. A1. ‘Lajme të rreme’. ‘Shkëmbim të dhënash’. ‘Pas- të vërtetës’. ‘Teknologjitë shpërqendruese’ që prishin dhe shpesh kalbin çdo gjë. Gjithçka duket se është në qendër të vëmendjes, dhe nuk mund t’i besohet asgjëje. Çdo gjë që ne e mendojmë si normale po shkrihet menjëherë para syve tanë.

Teoria e kohëve postnormale përpiqet të kuptojë një botë që ndryshon me shpejtësi, ku pasiguria është tema mbizotëruese dhe padija është kthyer në një bashkësi të vlefshme. “Lexime mbi Epokën Postnormale” është një antologji nismëtare shkrimesh mbi natyrën kundërshtuese, të ndërlikuar dhe të çrregullt të kohës sonë. Ai mbulon zanafillën, teorinë dhe metodikat e kohëve postnormale; dhe shqyrton një mori çështjesh, duke filluar nga ndryshimet klimatike, qeverisja, Lindja e Mesme, e deri te feja dhe shkenca, të para në këndvështrimin e kohërave postnormale. Duke hartuar disa nga çështjet kyçe vendore dhe botërore të kohës sonë kalimtare, lexuesi mund të na këshillojë rreth mënyrave të lundrimit drejt së ardhmes sonë të trazuar.



ISBN 9789928195470

